

**INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP**

STUDIME ALBANOLOGJIKE

10

Shkup, 2014

*Kryeredaktor
Prof. Dr. Qemal Murati*

*Redaksia
Prof. Dr. Qemal Murati
Dr. Bukurije Mustafa
Dr. Izaim Murtezani
Dr. Naim Halimi
Mr. Besnik Emini*

*Sekretar i redaksisë
Mr. Besnik Emini*

*Adresa e redaksisë:
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
Kutia Postare nr. 171
1000, Shkup
Republika e Maqedonisë*

*Adresa elektronike:
studimealbanologjike@yahoo.com
studimealbanologjike@itsh.edu.mk*

ISSN 1857-6958
UDK 930.85
COBISS.MK-ID 82595850

PËRMBAJTJA**STDUDIME DHE ARTIKUJ***Bardhyl DEMIRAJ*ALEKSANDRI I MADH I MAQEDONISË NË MENDIMIN
INTELEKTUAL-ALBANOLOGJIK SHQIPTAR.....9*Skender ASANI*

PETAR ÇAULEV DHE VEPRA E TIJ “SHQIPËRIA”.....25

*Giovanni ARMILLOTTA*ATJE KU FLUTUROJNË SHQIPONJAT
SHQIPËRIA, PUSHTIME DHE LEGJENDA.....67*Xhevat LLOSHI*

NGA VEPRIMTARIA PËR SHQIPEN NË MANASTIR.....73

Ardian VEHBUI

SHQIPJA GJUHË E LASHTË.....85

Qemal MURATI

PËR NJË QYTETËRIM GJUHËSOR SHQIPTAR.....95

Qani MEMETI

SHQIPJA MIDIS TRADITËS DHE MODERNES.....103

Izaim MURTEZANI

KONCEPTIMI I KOHËS NË POEZINË POPULLORE RITUALE.....113

*Kristo FRASHËRI*LUFTA ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE E PARË PAS 70
VJETËSH.....131*Naim HALIMI*MASAKRAT PARTIZANO-ÇETNIKE NË KARADAK NË MBARIM TË
LUFTËS SË DYTË BOTËRORE.....143*Exhlale DOBRUNA-SALIHU*PAJIMET PERSONALE TË GRUAS NË MONUMENTET
MBIVARRORE TË DARDANISË NË KOHËN ROMAKE.....151

Nuridin AHMETI

FEJA DHE PRIJËSIT FETARË NË LËVIZJEN KOMBËTARE
SHQIPTARE SIPAS GAZETËS “SHKUPI” (1911–1912).....171

Shpend AVDIU

REFLEKSIONE TË SHTYPIT SHQIPTAR MBI QEVERISJEN
SHQIPTARE 1912-1914.....181

Patrick MODIANO

DËSHIRA PËR TË SHKRUAR.....191

Shëfqet ZEKOLLI

JOSIF BAGERI - KRIJUES I PARË I LETËRSISË SHQIPE PËR FËMIJË
NË MAQEDONI.....199

Luljeta BORA (BEJLERI)

POEZIA SHQIPE E VITEVE '80 MES TRADITËS DHE RISISË.....209

Laure CAMBAU

VARGJE PËR NJË BURRË SI KALESHI.....225

Kujtim BUZA

SABRI FETAHU (BERKEL) NDËR THEMELUESIT E ARTIT MODERN
TURK.....231

Albert RAMAJ

DOM ZEF RAMAJ (1882-1914) - FAMULLITAR, MËSUES NË SHKUP
DHE PAGËZUES I GONXHE BOJAXHIUT237

Begzad BALIU

MARRËDHËNIET ARSIMORE DHE SHKENCORE JUGOSLLAVO-
SHQIPTARE NË PRAG TË DEMONSTRATAVE TË VITIT 1981.....245

Ethem ÇEKU

KOSOVA NË ZHVILLIMET POLITIKE NË JUGOSLLAVI NË VITET
'70.....259

Esilda LUKU

PASQYRIMI I DEMONSTRATAVE TË VITIT 1981 NË KOSOVË NË
TEKSTET SHKOLLORE TË HISTORISË NË SHQIPËRI.....279

Sadik V. KRASNIQI

ÇËSHITJE NGA TRASHËGIMIA MUZEORE DHE FUSHA E MUZEOLOGJISË.....	291
--	-----

ETNOKULTURË

Bukurie MUSTAFA

MBI DISA LEKSEMA POPULLORE ARTIZANALE.....	299
--	-----

Vaso NAÇO

TRADITA E VERËS NË POGRADEC.....	303
----------------------------------	-----

Miltiadh MUÇI

THESARE NGA FOLKLORI DHE ETNOGRAFIA E HARRUAR E LEKLIT TË TEPELENËS.....	307
--	-----

MATERIALE LEKSIKORE

Bexhet ASANI

FJALË TË RRALLA NGA TREVA E STRUGËS (Nga fshatrat geqe dhe toske).....	311
--	-----

RECENSIONE

RILINDËSIT SHQIPTARË NË NJË TABLO TË RE (<i>Rreth librit "Rilindësit shqiptarë", autore Gordana Sinadinovska, Shkup, 2014</i>) (Sevdail DEMIRI).....	317
--	-----

BALLKANI DJE DHE SOT SIPAS NJË STUDIUESEJE BALLKANASE (<i>"Ballkani imagjinar" i M. Todorova</i>) (Aleksandër MEKSI).....	319
---	-----

Kemalettin KUZUCU, Layihalar Işığında Bağımsızlık Sürecinde Arnavutluk'un Sosyal ve Siyasal Durumu (1860-1908), Türk Dünyası İncelemeleri Vakfı/Journal of Turkish World Studies, XII/2, 2012, f. 309-332. Gjendja Sociale dhe Politike në Periudhën e Pavarësisë së Shqipërisë në Dritën e Memorandumeve (Osmane) 1860-1908 (Murtezan IDRIZI).....

325

KRONIKA SHKENCORE

DY KONFERENCA SHKENCORE: PËR PROF. SHABAN DEMIRAJN NË ITSHKSH DHE PËR DREJTSHKRIMIN NË TIRANË (PROF.DR. RAMI MEMUSHAJ).....	333
---	-----

STUDIME DHE ARTIKUJ

BARDHYL DEMIRAJ

ALEKSANDRI I MADH I MAQEDONISË NË MENDIMIN INTELEKTUAL- ALBANOLOGJIK SHQIPTAR

Dy fjalë hyrëse

Studimi im trajton një temë që lidhet në thelb me fillesat dhe vijimësinë e debatit intelektual albanologjik, të cilin – siç dihet – e trashëgojmë për këtë periudhë të cunguar e për rrjedhojë edhe e njohim pak ose shumë pak. Lejohem të prek kështu që në hyrje atë detyrë aq të vështirë të historiografisë shqiptare për të rindërtuar këtë fazë në mënyrë sa më të plotë, duke u bazuar sigurisht në ato pak kumte fatlume që gëzojmë sot, por që rrekemi ta mbushim këtë zbrazëti duke zbatuar një metodikë të rreptë hulumtimi, në kuptimin e krehjes dhe të saktësismit të çdo detaji që arrijmë të fitojmë gjatë njohjes, përqasjes dhe interpretimit të informacionit në fjalë. Dhe metodika e punës në këtë perspektivë studimi është fiksuar ndërkohë më së miri në rrjedhën e saj: a) marrim fillimisht pikënisje prej kumtit informativ, i cili mundëson joshjen e rastit, b) për të vijuar më pas natyrshëm me kërkimin që zgjon bashkëlidhja kauzale e të dhënave, të cilat i përcjell si të mirëqena ai kumt (sidomos kur ky gëzon firmën dhe autoritetin e një kronikani, historiani ose eruditi intelektual të njohur në historinë e albanologjisë ose të kulturës shqiptare në përgjithësi); dhe janë bash këto dy momente që përgatisin kushtet paraprake c) me përsiatur e hedhur në diskutim një tezë të re, ose me vërtetuar apo falsifikuar me një argument të ri një tezë që qarkullon ndërkohë në debatin intelektual-shkencor bashkëkohor.

E bëj qëllimisht këtë ndërhyrje qysh në hyrje të këtij studimi meqë objekti dhe synimi i tij: Aleksandri i Madh i Maqedonisë dhe vendi i tij në historinë e mendimit intelektual-albanologjik mund të keqkuptohet si një lloj provokimi ndaj politikave etno-nacionale të kohës në Maqedoni e sidomos si një lloj reagim negativ ndaj projektit “Shkup 2014”, që vijon të diskutohet sot e gjithë ditën në diskursin publik dhe masmediet në Republikën e Maqedonisë, sikurse edhe në forumet (ndër)kombëtare të internetit. Nuk mund ta fsheh gjithashtu që ishte pikërisht ky diskutim që shërbeu si nxitje për shqyrtimin e kësaj teme, sigurisht pozitivisht dhe nga një tjetër perspektivë. E kjo zuri fill bash në vizitën time në Shkup në mars të këtij viti, ku më shoqëronin dy kolegë. Kur u gjenda përballë statujës së Aleksandrit të Madh mbi kalë (me emër zyrtar “Luftëtari mbi kalë”) në qendrën perëndimore të qytetit u befasova nga përmasat e saj marramendëse. Më parë kisha

parë statujën e Skënderbeut në anën tjetër të Vardarit, dhe menjëherë solla ndërmend që të dy këta heronj legjendarë janë vështruar në bashkëlidhje të ngushtë me njëri-tjetrin e sidomos në funksion të ndërgjegjësimit qoftë të elitës intelektuale, ashtu edhe të popullsisë shqiptare në hapësirën e tyre kompakte në Ballkanin Perëndimor e Qendror.

1. Aleksandri i Madh në kulturën e mendimit intelektual shqiptar: një digresion perspektiv

Në rast se lejojmë tash të hap një parantezë për rolin dhe funksionin e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë në historinë e mendimit intelektual shqiptar, atëherë kjo temë fiton në dukje të parë karakter të mirëfilltë historik, meqë si emri ashtu edhe bëmat e tij feksin e tingëllojnë sot në sytë e veshët tanë, në mos të huaja, të paktën janë të natyrës enciklopedike. Si dëshmi të dorës së parë mund të sjellim me këtë rast botimin e ri trivëllimësh të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (FESH), në të cilin portretizimi i Aleksandrit të Madh të Maqedonisë është rrudhur në 10-13 rreshta të një kolone, pra në përmasat e një liliputi historik, më saktë të një lloj atavizmi në historinë e kulturës shqiptare, pasi ngërthen jo vetëm njërin ndër zërat më të vegjël të mundshëm, por nuk gëzon kurrfarë bashkëlidhje qoftë me historinë e popullit shqiptar ashtu edhe me atë të mendimit intelektual-albanologjik, përkatësisht me atë të kulturës shqiptare në përgjithësi. Kështu, lexojmë aty që:

“Aleksandri i Maqedonisë (Aleksandri III, 356-323 p.e.r.). Mbret i Maqedonisë në v. 336-323 p.e.r., i mbiquajtur Aleksandri (Leka) i Madh. Ishte biri i Filipit II dhe i princeshës epirote Olimpia, e cila e edukoi me karakter të fortë. U edukua dhe u arsimua nga Aristoteli dhe u përgatit si ushtarak në një varg luftërash. Pas vrasjes së Filipit në v. 336. p.e.r. mori pushtetin në Maqedoni dhe u zgjodh komandanti i përgjithshëm i forcave greke kundër Persisë.



Ndërmori një fushatë në V[eri] të Maqedonisë më 335, kur rrethoi edhe qytetin ilir Pelion. Më 334 p.e.r. nisi fushatën kundër mbretërisë persiane, të cilën e nënshtroi dhe krijoi një perandori të gjerë që shtrihej nga tokat e mbretërisë maqedonase në Europë e deri në brigjet e lumit Ind në Azi, e të Nilit në Afrikë.”¹


Shumëkush që lexon këtë prezantim të thukët krijon në fakt një përfytyrim fals, sikur pakkush ndër lexuesit shqiptarë është i vetëdijshëm se si emri ashtu edhe bëmat e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë nuk janë assesi nocione të huaja në historinë e kulturës shqiptare, përkundrazi ato kanë shoqëruar shekuj me radhë rrjedhën e mendimit intelektual-albanologjik, duke arritur një pikë vërtet kulmore në kapërcyell të shek. XIX, bash në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare,

¹ FESH 2008, bl. I, f. 50, koll. II, rr. 15-33 (N. Ceka).

kur emri dhe portreti i tij erdhën e fituan përmasat e asaj simbolike që sendërtoi më pas themelet e mitologjisë shtetërore mbi etnosin dhe kombin shqiptar. Kjo simbolikë u përkujdes me thuajse të njëjtin intensitet edhe më vonë, gjatë përfutimit të disa formacioneve shtetërore, madje deri në fazën e fundme të mbretërisë shqiptare, nën Zogun e saj të Parë e të fundit, Ahmet Zogollin dora vetë, për të vijuar me një farë rrudhjeje të vazhdueshme aty nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar, më saktë pas Luftës së Dytë Botërore, kur në Shqipëri erdhi e mori formë e hodhi shtat një mitologji e re shtetërore-kombëtare, që e konsiderojmë sot si trashëgimia kulturore-historike, përkatësisht vijimësia gjuhësore-gjenealogjike iliro-/dardane-shqiptare.

Pa dashur të ndalem shumë më gjatë në këtë aspekt të mendimit intelektual shqiptar në kohë e hapësirë, lejojmë të përmbledh thukët se ky mendim ka përcjellë disa shekuj me radhë emrin e Aleksandrit të Madh – së bashku me atë të Pirros së Epirit, të Konstandinit dhe Justinianit të Madh, e sidomos atë të adashit të vet në mesjetën e vonë, të Skënderbeut dora vetë (= Aleksander prej turq./osm. Iskander Beg). Bëjmë fjalë për atë simbolikë të mitit kombëtar, në të cilën kërkoi e gjeti vetveten matriksi i kulturës etnike shqiptare, që vjen me thënë u sendërtua fillimisht vullneti i elitës intelektuale shqiptare për të fiksuar te kjo figurë historike-legjendare përkatësinë etnike-kulturore të mbarë bashkësisë shqipfolëse në hapësirën e saj sa jetike aq edhe kompakte në përfundim dhe qendër të Gadishullit Ballkanik.

Kështu p.sh. nuk kemi përse të bëjmë sot aspak çudi, kur Marin Barleti në veprën e vet mbi historinë e Skënderbeut vë jo rrallë në gojën dhe pendën e Gjergj Kastriotit kumte të tilla si “Aleksandri ynë” për Aleksandrin e Madh, sikurse edhe ëndrrën e tij të ngahershme, që paska përcjellë madje bash në fjalën e vet programatike [në Kuvendin e Lezhës: 2 mars 1444], ku mëton me zë të lartë, se:



“Etërit dhe gjyshërit tuaj – më lejoni ta them – s’e patën menduar, por ju [= prijës shqiptarë – B. D.] vërvani vetes për qëllim që me këtë bashkim ta rikrijoni gjendjen e dikurshme të Maqedonisë, nënës së kryetrimave, ...”².

Një shekull më vonë kemi Frang Bardhin, i cili në apologjinë e tij mbi origjinën shqiptare (= epirote) të Skënderbeut (1636) duke përmendur kujtimet e Papa Piut II, bashkëkohës dhe mik i Gjergjit tonë, shpejton të përzgjedhë sidomos një citat nga një letër, pas gjase autentike e vetë Gjergjit, dërguar kundërshtarit të tij, princit të Tarantos, në të cilën ai i qenka përgjigjur në mënyrë therëse, si vijon:

“Në thënj se Arbëria është një pjesë e Maqedonisë, atëherë ti i pranon të parët tanë [të jenë – B. D.] shumë më fisnikë, sepse ata nën Aleksandrin u futën deri në Indi, duke i nënshtruar të gjitha fiset, që u dilnin përpara, me lehtësinë më të madhe.”

Vetë Frang Bardhi e mbyll atë pasazh duke shtuar, se:

² Marin Barleti [1508:] 1964 [shqip] 105.

“Prej atyre kanë zbritur këta njerëz etj., deri te Skënderbeu [dora – B.D.] vetë”³

Për Frangun tonë – jo më larg se një vit më parë, kur u botua fjalori i tij latinisht-shqip (Ditionarium latino-epiroticum, Romæ 1635) – ishte e vetëkuptueshme prejardhja e tij, si: *Jam i Dheut cë Matsedoniesë, i shkodërnjanë*⁴, ndërkohë që vendlindja e Aleksandrit të Madh Pella, nuk ishte tjetër veçse shkurtimi i toponimit *Petrela* në jug-perëndim të Tiranës (?)⁵.

Të njëjtin qëndrim mban jo më larg se fundi i po atij shekulli Pjetër Bogdani, i cili fikson, madje në frontespicin e veprës së vet – sigurisht jo pa qenë krenar –, prejardhjen e vet maqedonase: <Cvnevs Prophetarum de Christo Salvatore Mvndi, et eivs Evangelica Veritate; italice, et epirotice contexta; Et in duas Partes divisa a Petro Bogdano macedone [...]. Patavini 1685>⁶. Në libër, në pjesën e kronologjisë së historisë së botës ose “Jetët e shekullit”, ai saktëson gjithashtu që: “[Në vitin] 3623 Leka i Madh prej Petrele nd'Arbënë zu fill monarkinë vet ndë Matiet”⁷ (CP I 181 6 - Omari 2014 160).

Mund të vijojmë sigurisht me mendimin intelektual shqiptar mbi Aleksandrin e Madh, sikurse edhe mbi trevat origjinare dhe përbërjen etnike-gjuhësore të Maqedonisë në periudhën e antikitetit, të cilat vijojnë të përcillen me interesin erudit-enciklopedik përkatës edhe në shekujt e mëpasëm, kur përjetojmë një kristalizim të mendimit rilindas mbi qenësinë kombëtare shqiptare në gjithë atë

³ Bardhi [1636] 1999 [bot. i tretë shqip – përkthyes Stefan I. Prifti – Tiranë] 99.

⁴ Bardhi 1635 221: <*Iam çeut ze Mattfedonieffe, i scoderngane* ~ Sum ex Macedonum regione è Scodra>

⁵ Bardhi 1635 198: “Pella (illustrate magni Alexandri Macedonum Regis natali) Pella, Petrela.” (Megjithatë shih edhe shën. nr. 7) I kësaj natyre është gjithashtu shpjegimi që jep Bardhi (po aty) për qytetin e Shkodrës: “Scodra inclyta, munitissima antiquissimaq. Vrbs in Epiro, seù Albania, quam Vrbem Turcas sine suspitione existimant esse conditam ab Alexandro magno, hac de causa illorum lingua vocant eam *Schenderia* [= Skënderia], id est minor Alexandria; ponunt enim particulam illam (minor) ad distinctionem maioris Alexandriae; quæ est Urbis Aegypti celeberrima ab eodem Alexandro condita.” Shih edhe Omari 2014, f. ...). Një trajtim të ngjashëm bën Bardhi me emrin “... Scanderbegh [= Skanderbeg], id est Alexander magnus Dux ...” (1635 197)

⁶ Bogdani 1685. Sipas Omarit “Është me interes të citojmë këtu kujtimet e udhëtares amerikane Rose Wilder Lane në malësitë e Veriut të Shqipërisë në vitin 1921 e cila sjell rrëfimin e një plakut të moçëm në Shosh të Dukagjinit. Pyetjes se nga kanë ardhur shqiptarët ai i përgjigjet me dijenitë e transmetuara gojariht nga të parët, e ata nga të parët e tyre brez pas brezi, për vendbanimin e parë të shqiptarëve, për rrugët e ardhjes së tyre, për shtrirjen e tyre në Ballkan, për mbretërit e tyre që i rendit me emra, një nga të cilët ishte Leka i Madh, një shqiptar i lindur në *Emadhia* të Matit. Rrëfimi i plakut, në kujtesën e zonjës Lane, konfirmojnë një vit më pas nga vizita e saj në Mat, përmes pohimeve të fshatarëve që flisnin me indiferencë për “qytetin e lashtë *Emadhia*” duke treguar dhe rrënojat e tij dhe për “vendlindjen e Lekës së Madh” (Omari 2014 159v.)

⁷ Mëtimi i vendndodhjes së top. <Petrele> në zonën e Matit nxit dyshimin se mos kemi të bëjmë këtu me vendlindjen e Pjetër Budit *Guri i Bardhë* [= <Petalba>], i njohur atëbotë si qendër urbane në zonën e Matit.

simbolikë që përhapte pikërisht ajo vello nebuloze sa historike aq edhe mitike, që rrethonte sikurse e rrethon sot e gjithë ditën këtë hero legjendar të antikitetit.

Origjina e tij shqiptare u përcoll si një fakt historik-gjenealogjik i mirëqenë e i dhënë njëherë e përgjithmonë. Këtë e ndeshim gjithkund kulturën e shkrimit shqip gjatë gjithë periudhës së Rilindjes, duke filluar me traktatet e mirëfillta politike-ideologjike (Pashko Vasa 1878; Sami Frashëri 1899) e duke përfunduar në krijimet letrare patriotike, si p.sh.: te Naim Frashëri (Istori e Skenderbeut, 1898; kënga I, 33-39):

...	
Ishte vënt' i Perëndisë	Aleksandr' i Math e burrë
Që së pari Shqipëria.	I cili s'pat shok ndë jetë,
Mëmëdheth i urtësisë	Nukë ka pasur kurrë,
Që del soje mirësia.	Dhe kurrë do të mos ketë.

(Marrëdhëniet e tij me Skënderbeun: K III 384 - 391)

...	
Ngaha vënt' i Perëndisë	Skënderbe' u bë i parë
Skënder' i math prapë dolli	Mi ushtërit të Tyrqisë
E i dha nder Shqipërisë	Mi mijëra ushtëtarë
se ajo sërish e polli	Kryeprens' i Shqipërisë
...	

Etimologjia popullore në funksion të programit ideologjik:

Vendlindja e Aleksandrit të Madh dhe kryeqyteti i dikurshëm i perandorisë së Maqedonisë: Pella < shq. *pelë*.

I tillë është p.sh. edhe kali po aq legjendar i Aleksandrit të Madh me emrin e famshëm *Bukëfalos*, i cili për rilindasit tanë shpjegohej natyrshëm, sigurisht vetëm me mjetet e shqipes, si qenie me përmasa gjysmë-mitologjike, që ushqehet me *bukëvale*, ndërkohë që vendlindja e Aleksandrit dhe njëkohësisht kryeqendra e Maqedonisë antike *Pella* shpjegohej po aq natyrshëm me apelativin shqip *pelë*, meqë ai vend, pra zemra e Maqedonisë antike, shquhej atëbotë sidomos për rritjen dhe mbarështrimin e kuajve të racës.

Në vitet e brishta të Shqipërisë si shtet nacional sovran (1912-1944) miti i Aleksandrit zuri rrënjë të forta në të gjitha trevat shqiptare. Atë e njohim tashmë më fort me shkurtimin *Leka i Madh*, i cili na shfaqet jo vetëm si emër personi, por edhe si titull reviste apo emërtim shoqate kulturore shqiptare⁸. Rëndësi të veçantë fiton ky emër edhe me vetë konsolidimin



⁸ Shih më hollësisht Peters 2007 246vv.

e shtetit shqiptar, duke u shndërruar si njësi bazë në shkëmbimin monetar shqiptar. Monedha e parë shqiptare *lek* mbartte atë kohë (prej vitit 1925) në formë të stilizuar në anën e parme Aleksandrin e Madh mbi kalin e tij legjendar në pozicion luftarak dhe në anën e prapme portretin e tij të stilizuar. Kjo monedhë *njëlekëshe* si monedhë bazë gëzonte një vlerë aspak të vogël; mjafton të mbajmë këtu parasysht se rroga ditore e një mëditësi atëbotë nuk shkonte kurrë më shumë se *gjysmë lek*.

Gjatë periudhës së okupacionit italian në Luftën e Dytë Botërore, monedha njëlekëshe mbeti si vlerë por jo në formë dhe *design*, ku vendin e Lekës së Madh e zuri Perandori Vittore Emanuele III.

Në shtetin e ri komunist vlera e “Lekës sonë” erdhi e u rrëgjua gjithnjë e më shumë, ndërsa monedhat dhe kartëmonedhat një-, dy- a më shumëlekëshe ndryshuan sigurisht formë dhe *design*. Megjithatë emërtimi monetar mbijetoi. Shumëkush në auditor është gjithsesi dëshmitar okular se si *leku i ri* shqiptar u vjetrua shpejt, sepse në vitin 1964 sistemi financiar në Republikën Popullore (Socialiste) të Shqipërisë përjetoi një inflacion të dukshëm, gjë që çoi në rivlerësimin e tij *një me dhjetë*. Një *lek i ri* si njësi monetare bazë u barazua (sikurse edhe sot e gjithë ditën) me *dhjetë lekë të vjetra*, pasojat e së cilës i vuajmë edhe sot e gjithë ditën, meqë jo rrallë na duhet të pyesim disa herë për vlerën e një malli që duam të blejmë, nëse bëjmë pazar me lekë të vjetra apo të reja. Megjithatë, pas vitit 1964 *një lek* i ri thyhej zyrtarisht me plot *100 qindarka*, pra kishte ende një vlerë deri diku të perceptueshme, në kuptimin që me një monedhë njëlekëshe arrije të blije diçka.

Edhe me kthesën demokratike që përjetoi Shqipëria në fillim të viteve 90-të të shekullit të kaluar, sikurse edhe sot e kësaj dite, Aleksandri i Madh, thënë më saktë “Leka ynë” mbeti përsëri *lek*, pra vetëm si njësi monetare, veçse vlera e tij mori tamam “rrokapjekthi” në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Sot Banka Kombëtare e Republikës së Shqipërisë emeton ende monedhën njëlekëshe, veçse – sikurse qindarkën dikur – me të s’blen dot gjë, madje në shumë njësi tregtare nuk e përdorin fare në shitblerjet e mallit.

Parë nga kjo perspektivë – e për t’u bërë ndoshta edhe paksa provokues!!! – mund vijmë patëkeq në përfundimin se rrëgjimi i rolit të Lekës së Madh në matriksin e kulturës etnike-gjuhësore të kombit shqiptar eci në proporcion të drejtë me rrëgjimin e vlerës së *lek*-ut si njësi monetare bazë në sistemin financiar të Republikës së Shqipërisë. Andaj shumëkush sot nuk ka përse bën çudi me faktin që, ndërsa zëri i Aleksandrit të Madh të Maqedonisë gëzon të paktën një vend sado modest në FESH, *lek*-ut d.m.th. monedhës bazë në sistemin financiar të Republikës së Shqipërisë nuk i është kushtuar asnjë centimetër vend.



Në mbyllje të këtij digresioni historik perspektiv mbi rolin e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë në historinë e mendimit intelektual shqiptar mund të mëtojmë tash pa cenuar sadopak atë frymë pozitive, me të cilën edhe e hapëm, që ky personazh sa historik aq edhe legjendar i antikitetit ndikoi që elita intelektuale shqiptare të fiksonte me gojë e me shkrim atë shqisë të gjashtë që sendërtonte matriksin e kulturës etnike-gjuhësore mbarëshqiptare: vullnetin për të qenë bashkë dhe në bashkëjetesë me tjetrin brenda asaj hapësire jetike kompakte, që mendohej t'i takonte.

2. “Kontakte të mëhershme” të Aleksandrit të Madh me *albanët* (= shqiptarët): digresion retrospektiv

Momente pak a shumë të kësaj natyre përjetuam edhe gjatë analizës së njërit prej kumteve më të hershme informative lidhur me matriksin e kulturës etnike shqiptare, të cilin e kemi bërë edhe objekt të mirëfilltë diskutimi në këtë shkrim. Siç tingëllon që në titull, bëjmë fjalë këtu për një dorë shënimesh mbi *Albaninë* dhe *albanët* e Ballkanit mesjetar, që i ka lënë në dorëshkrim një autor anonim (pas gjase i huaj) aty nga viti 1308.⁹ Teksti i dorëshkrimit, të cilin lexuesi mund ta përcjellë të plotë në shtojcë si në variantin origjinal latinisht të botuar prej Olgierd Górka-s (1916) ashtu edhe me përkthimin përkatës anglisht prej Robert Elsie-t (1990), përmban në vetvete përshkrimin më të plotë dhe autentik të albanëve, d.m.th. (të një shtrese sociale) të popullsisë shqiptare që gjëllinte atëbotë sikurse edhe sot e gjithë ditën në pjesën perëndimore të Ballkanit. Ndër komponentët themelorë në matriksin e kulturës së tyre etnike, autori dallon ndër të tjera:

- shtrirjen e konsiderueshme gjeografike të “Dheut të Arbënit”, që përshkohet prej lumenjve Erzen, Mat, Shkumbin dhe Osum, duke e kufizuar atë gjeografikisht me mbretërinë e Rashës dhe të Bizantit,
- si një vend ku kalonte rruga kryesore tranzite [= Via Egnatia] për në Konstandinopol,
- si një vend që në fakt gëzonte statusin e mbretërisë, por që ndërkohë s’kishte një mbret të vetin, dhe si i tillë ishte copëzuar ndërmjet fisnikëve vendas, të cilët kishin zgjedhur me vullnet të mirë si të parë të tyrin princin e Taranto-s, të birin e mbretit të Sicilisë,
- si një vend i pasur në prodhimin e mishit dhe të produkteve të qumështit, por jo i begatshëm në kultivimin e drithit dhe të rrushit, edhe pse dyert e fisnikëve i kishin ato me bollëk, dhe ku
- bashkësia shqiptare përbënte shtresën (sociale) rurale, ku mbizotëronte ekonomia malore dhe transhumanca, duke përkujdesur kështu marrëdhënie tregtare intensive me Durrësin, si qendra kryesore urbane e gjithë rajonit e cila ishte nën juridiksionin latin (= të Mbretërisë së Sicilisë), nga ku furnizoheshin me tekstile e prodhime fabrikate;

⁹ Anonymi Descriptio Europae Orientalis »Imperium Constantinopolitanum, Albania, Serbia, Bulgaria, Ruthenia, Ungaria, Polonia, Bohemia«, Anno MCCCVIII Exarata. Editit, praefatione et adnotationibus instruxit Dr. Olgierd Górka, Cracoviae Sumptibus Academiae Litterarum Gebethner et Socii 1916, f. 25-29.

- një bashkësi kjo e njohur si për aftësitë luftarake, duke venë kështu nën vasalitetin e tyre qendra të tilla urbane si Pulti, Dibra etj.,
- ashtu edhe për pozicionin e saj të veçantë në çështje të konfesionit, duke u lëkundur vazhdimisht ndërmjet katolicizmit dhe ortodoksisë, megjithëse parapëlqente të anonte më fort drejt Kishës Katolike-Romake, e për më tepër
- një bashkësi kjo që komunikonte në një gjuhë, e cila e dallonte atë kryekëput nga fqinjët *lëtinj* (= romanë), *grekë* dhe *shqe* (= sllavë).

Në këtë përshkrim etnografik sa befasues aq edhe marramendës të *Albanisë* në fillim të shek. XIV dhe të banorëve të saj anas, *albanëve*, anonimi ynë nuk mungon të përmendë as legjendën – pas gjase të përhapur dikur në mjediset intelektuale-klerikale – mbi burimin e toponimit *Albania*, sikurse edhe kontaktin e tyre të parë me Aleksandrin e Madh të Maqedonisë. Ky është momenti më pikant i kumtesës sonë, andaj më lejoni ta lexoj këtë pasazh të përkthyer në gjuhën shqipe. Kështu sipas tij:

“Kjo provincë quhet *Albania* sepse banorët e këtij rajoni lindin me flokë të bardhë. Qentë këtu [= në Albaninë e Ballkanit – B.D.] kanë përmasa gjigante dhe janë aq të egjër, saqë të mbysin si luanët. Sikurse përmend Plini, *albanët* i çuan një qen të tillë Aleksandrit të Madh, i cili mundte në arenë luanë, elefantë dhe buaj. Ata kanë sy të ngjyrosur, me bebëza bojë hiri, të tilla që mund të shohin më mirë natën se sa gjatë ditës. Ka dy Albani: një në Azi pranë Indisë, për të cilën ne nuk po bëjmë fjalë këtu, dhe një në Europë, e cila është pjesë e Perandorisë Bizantine dhe për të cilën jemi duke folur këtu.”¹⁰

Vërtetësia e shumë të dhënave dhe fakteve që përcjell teksti në tërësinë e vet si përshkrim etnografik, e nxit lexuesin sqimatar që t’i kushtojë vëmendjen e duhur informacionit që kumton ky pasazh,¹¹ madje edhe të zhbirilojë ndërmjet rreshtash, ku feks ndoshta jo më kot vetëm emri i Plinit (të Vjetër apo të Ri ?), i cili paska pasur edhe ai dijeni për këta *albanët* e Europës, të mirënjohur në kohën e Aleksandrit të Madh për rritjen e një race qensh të llahtarshëm, e që për t’i bërë qejfin kishin shpejtuar t’i bënë edhe dhuratë një sosh.

Sa i besueshëm është edhe ky informacion që na kumton anonimi ynë në përshkrimin e tij përgjithësisht të patëmetë që i bën provincës ballkanike me emrin *Albania* dhe vendasve të saj, *albanëve*? Vërtetësia e tij nuk do të ishte aspak pa rëndësi në hetimet tona mbi paleoetnologjinë e Ballkanit antik, pasi jo vetëm e plotëson, por e shtyn edhe më thellë në kohë atë regjistrim thuajse fluturak të fisit të *Albanëve* me qendrën e tyre urbane *Albanopolis* që trashëgojmë prej gjeografit aleksandrin në shek. II e.j. Rëndësi jo të vogël do të barte vërtetësia e këtij informacioni edhe në hulumtimin e fazave të hershme në etnogjenezën e adashëve të tretë: *albanëve* mesjetarë, përkatësisht shqiptarëve të sotëm, vendndodhjen e të

¹⁰ Shih në shtojcë botimin kritik të Gôrka-s (27-28).

¹¹ Shih p.sh. Robert Elsie: 1990 26, shën. 6.

cilëve arrijmë ta saktësojmë me siguri në trojet e tyre të sotme të paktën për periudhën në kapërcyell të antikitetit dhe fillimet e mesjetës.¹²

Ishin pikërisht këto momente diskursi me vetveten që na nxitën në punën e mirëfilltë lidhur me verifikimin e vërtetësisë ase të falsitetit në informacionin në fjalë. Dhe rezultati nuk mungoi. Këtë kumtim e ndeshim vërtet te Plini i Vjetër (= Gaius Plinius Secundus maior: ca. 23 – 79 e.j.) në veprën e tij madhore “Naturalis historia”, bash në bleun VIII të emërtuar “Animalia terrestria”, ku jepet informacion i hollësishëm për kafshë të ndryshme të steresë, ndër to në kreun nr. 61 edhe për qenin a) me cilësitë e tij si kafshë shtëpiake; b) me shembuj për marrëdhëniet e tij me të zotin, sikurse edhe c) për popuj të ndryshëm që rrisin qentë për qëllime lufte. Pikërisht në këtë detaj të fundit përmendet edhe episodi, të cilit i referohet anonimi ynë, e që po e riprodhojmë tani në përkthimin tonë, si vijon:

“[149] Kur Aleksandri i Madh ishte në ekspeditën e vet në Indi, atij iu dhurua prej mbretit të Albanisë një qen me përmasa të pazakonshme; Duke qenë shumë i mrekulluar me paraqitjen e tij fisnike, ai urdhëroi të liheshin të lirë para tij arinj, dhe pas tyre derra të egjër e më pas drerë; por qeni rrinte shtrirë dhe i vështronte ata pa lëvizur me një lloj mospërfilljeje. Shpirti fisnik i gjeneralit u irritua prej përtacisë së manifestuar në mënyrë të tillë prej një kafshe të atyre përmasave të mëdha, andaj urdhëroi ta vrisnin. Kumti i kësaj [ndodhie – B.D.] arriti te mbreti, i cili dërgoi me këtë rast një qen tjetër, e në të njëjtën kohë çoi fjalë, që fuqia e tij duhej provuar jo me kafshë të vogla, por me luanë ose elefantë; duke shtuar gjithashtu, që ai kishte fillimisht vetëm dy [qen – B. D.] dhe se në rast se edhe ky do të vritej, atëherë do të shuhej ajo racë. [150] Aleksandri, pa vonuar, porositi një luan, i cili në praninë e vet u bë menjëherë copa-copa. Pastaj ai urdhëroi të sillej një elefant dhe vërtet më parë nuk ishte mrekulluar më shumë me ndonjë spektakël; sepse qeni, duke iu ngritur leshrat përpjetë në gjithë trupin filloi të lehte aq fort sikur bubullinte dhe sulmoi pastaj kafshën, duke iu hedhur herë nga një anë e herë nga ana tjetër e duke e sulmuar në mënyrën më mjeshtërore e duke tërhequr rishtas në momentin e duhur, derisa në fund elefanti, duke iu marrë mendtë prej të rrotulluarit lart e poshtë u palos përdhe duke shkaktuar një oshtimë të madhe me rrëzimin e tij.” (lib. VIII, cap. 61)¹³

Mjafton gjithsesi leximi i rreshtit të parë – shumë-shumë edhe i të dytit – që të ngjizim menjëherë bindjen, se kumtimi i lënë në dorëshkrim nga anonimi ynë përcjell në vetvete një rrethanë kundërtëuese deri në falsifikim të të dhënave të trashëgimisë kulturore-shkrimore të antikitetit, meqë në të bëhet fjalë për fushatën e Aleksandrit në Indi, përkatësisht një dhuratë të bërë atij prej mbretit të *Albanëve* të Kaukazit. Duke lexuar në vijim krejt pasazhin te Plini, i cili përkon fund e krye me përshkrimin e bërë në dorëshkrim prej anonimët, lejohe mi të bluajmë tash patëkeq në mendje, se mos ndoshta kjo “lajthitje” e anonimët tonë vjen thjesht nga mosnjohja e drejtpërdrejtë e veprës së Plinit, përkatësisht bëhet tërthorazi, nëpërmjet transponimit – e pse jo! – të (pa)kujdesshëm të asaj pjese të debatit

¹² Shih së fundi Bardhyl Demiraj: 2010 35vv.; si edhe: 2012 382vv.

intelektual që zhvillohej atëbotë në mjedisin kulturor shqiptar ose albanologjik, të cilit i takonte.

Mbyllim këtu ndërmarrjen tonë modeste për të verifikuar një detaj shpresëdhënës që kumtonte përshkrimi më i hershëm – i thukët, por i plotë – i matrisit të kulturës etnike të popullit shqiptar në të gjithë faktorët e tij identifikues. Për fat të keq, edhe në këtë hetim nuk na buzëqeshi fati, edhe pse na u shpërblye munda, në kuptimin që pasi e hodhëm fillimisht në debat këtë detaj, arritëm në vijim të mënjanojmë si fals një konstatim kundërtshënës në dorëshkrimin e hershëm që kishte shpëtuar deri sot pa u vënë re në letërsinë shkencore albanologjike.

Facit

Se ç'drejtim mori në shekujt në vazhdim historia dhe miti i Lekës së Madh në debatin intelektual shqiptar për këtë mjafton të përmendim atë çka prekëm në pjesën e parë të kësaj kumtese. Lejohemi t'i rikthehemi tash edhe atij befasismi që përjetuam në mars të këtij viti (2014) kur u gjenda përballë statujës rrokahyjëse të Aleksandrit të Madh mbi kalë, një ngrehinë marramendëse në pozicion luftarak aty te 22 metrat e lartë. Kolegu shqiptar nga Shkupi më tha buzagaz në mirëbesim: "Ne kemi Lekën tonë", d.m.th. statujën e Skënderbeut zulmëmadh jo më shumë se 4-5 metra lartësi, i cili merr vend në pozicion ceremonial po ashtu mbi kalë e më shpatë ngrehur, aty pranë Pazarit të Vjetër, në lagjen Çair. Simbolika e të dyja statujave ushtron në instancë të fundit të njëjtin funksion: vullnetin për të qenë bashkë e në bashkëjetesë me tjetrin. Shqiptarët e kanë shumë më të lehtë t'i pranojmë e të krenohen njëlloj me të dy, e për këtë na ndihmon vetë trashëgimia e mendimit intelektual shqiptar në kohë e hapësirë.

Bibliografi e cituar

1. Burimet

Anonymi *Descriptio Europae Orientalis »Imperium Constantinopolitanum, Albania, Serbia, Bulgaria, Ruthenia, Ungaria, Polonia, Bohemia«*, Anno MCCCVIII Exarata. Editit, praefatione et adnotationibus instruxit Dr. Olgierd Górka, Cracoviae Sumptibus Academiae Litterarum Gebethner et Socii 1916, f. 25-29.

Bardhi, Frang (~ Franciscus Blanchus) 1635: shih më poshtë Demiraj 2008.

¹³ Versioni origjinal latinisht: "[149] – Indiam petenti Alexandro Magno rex Albaniae dono dederat inusitatae magnitudinis unum, cuius specie delectatus iussit ursos, mox apros et deinde dammas emitti, contemptim immobili iacente eo, qu<a> segnitia tanti corporis offensus imperator generosi spiritus interemi eum iussit. nuntiavit hoc fama regi. itaque alterum mittens addidit mandata, ne in parvis experiri vellet, sed in leone elephantove: duos sibi fuisse, hoc interempto praeterea nullum fore. [150] nec distulit Alexander leonemque fractum protinus vidit. postea elephantum iussit induci, haut alio magis spectaculo laetatus. horrentibus quippe villis per totum corpus <in>genti primum latratu intonuit, mox in<g>ruit adsultans contraque membra exurgens hinc et illinc artificii dimicatione, qua maxime opus esset, infestans atque evitans, donec adsidua rotatu<m> vertigine adflavit, ad casum eius tellure concussa." Burimi: <http://www.hs-augsburg.de/~harsch/Chronologia/Lspost01/PliniusMaior/plm_h000.html>

Bardhi, Frang (~ Franciscus Blancus) 1636: Georgius Castriotus, Epiensis vulgò Scanderbegh, Epiotarum princeps fortissimus, ac iniuctissimus Suis, & Patriae restitutus. Per Franciscum Blancum. De Alumnis, Collegij de Propaganda Fide, Episcopum Sappatensem & Sardanensem, necnon Pulatensium, aliorumque Albaniae Populorum Administratorem. – Venetiis. Typis Marci Ginammi. MDCXXXVI.

(Varianti i përkthyer shqip – Stefan I. Prifti: Frang Bardhi. Skënderbeu (Apologji), NF Tiranë 1999³ – bot. i tretë].

Bogdani, Pjetër [= Peter Bogdanus, Cvnevs Prophetarum de Christo Salvatore Mvndi, et eivs Evangelica Veritate; italice, et epirotice contexta; Et in duas Partes divisa a Petro Bogdano macedone [...]. Patavini 1685.] Shih edhe më poshtë Omari, Anila.

Marin Barleti: [Historia de vita et gestis Scanderbegi Epiotarum Principis, 1508 –] Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut (Përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrje nga Stefan J. Prifti), Tiranë 1964 105.

FESH Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2008, bl. I, f. 50, koll. II, rr. 15-33 (N. Ceka).

Michaelis Attaliothae historia (hg. W. Brunet überarbeitet von Immanuel Bekker). Bonn 1853. = Corpus scriptorum historiae Byzantinae Bd. 49. ²Berlin 1958, f. 427-429.

Burime në faqe të autorizuarara interneti

Gaius Plinius Secundus maior: Naturalis historia, (lib. VIII) Animalia terrestria, në: http://penelope.uchicago.edu/Thayer/E/Roman/Texts/Pliny_the_Elder/home.html.

Claudius Ptolemaeus: Geographia, lib. III, cap. 12: Macedonia – harta nr. 10 e Europës. http://penelope.uchicago.edu/Thayer/E/Gazetteer/Periods/Roman/_Texts/Ptolemy/

Claudius Ptolemaeus: Geographia, lib. V, kap. 11: Albania – harta nr. 3 e Azisë, në: http://penelope.uchicago.edu/Thayer/E/Gazetteer/Periods/Roman/_Texts/Ptolemy/

1. Letërsi shkencore

Ashta 2000: Leksiku historik i gjuhës shqipe, bl. III, Shkodër.

Demiraj, Bardhyl (bot.) 2008: Dictionarium latino-epiroticum per R. D. Franciscum Blanchum, (Romae 1635), Botim kritik dhe konkordanca leksikore, Botime françeskane – Shkodër.

Demiraj, Bardhyl 2010: Probleme të lëna pezull: vendbanimet e shqiptarëve në mesjetën e hershme, në: “Hylli i Dritës” 135 – 46.

Demiraj, Bardhyl 2012: Umsiedler oder Alteingesessene? Fragen zur Urheimat der Albaner im Frühmittelalter, në: “Südost-Forschungen” 71 382-392.

- Elsie, Robert 1990: Albania in the “Anonymi Descriptio Europae Orientalis” (1308 A. D.), në: ”Zeitschrift für Balkanologie” 26 157-159.
- Ködderitzsch, Rohlf 2001: Die Zwei Albanien – Albanien auf dem Balkan und „Albanien” im Kaukasus und die großen Sprachfamilien, në: Albanien. Reichtum und Vielfalt der Kultur, Staatliches Museum für Völkerkunde München, f. 122-127.
- Matzinger, Joachim 2009a: Die Albaner als Nachkommen der Illyrer aus der Sicht der historischen Sprachwissenschaft, në: Albanische Geschichte. Stand und Perspektiven der Forschung (hg. O. J. Schmitt / E. A. Frantz), Oldenbourg Verlag München, f. 13-37.
- Matzinger, Joachim 2009b: Illyrisch und Albanisch – Erkenntnisse und Desiderata, në: „Die Sprache“ 48 98-106.
- Omari, Anila (bot.): Pjetër Bogdani: Cuneus Prophetarum (Çeta e profetëve). Botim kritik përgatitur nga Anila Omari, ASHSH Tiranë 2005.
- Omari, Anila 2014: Letërsia arbëreshe nën një këndvështrim të ri metodologjik. Rreth librit të ri në shqip të prof. Matteo Mandalà: „Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe“ botuar nga SHB Naimi, në: „Hylli i Dritës“ 1-2 [2014] 157-162, Shkodër.
- Peters, Markus. W. E. 2007: Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur. Die “Buchdruckerei der Unbefleckten Empfängnis” zu Shkodra (1870-1954)”, Hamburg.
- Xhufi, Pëllumb 2006: Dilemat e Arbërit, Tiranë.

Shtojcë I: Versioni original – teksti kritik

Burimi: Anonymi Descriptio Europae Orientalis »Imperium Constantinopolitanum, Albania, Serbia, Bulgaria, Ruthenia, Ungaria, Polonia, Bohemia«, Anno MCCCVIII Exarata. Editit, praefatione et adnotationibus instruxit Dr. Olgierd Górka, Cracoviae Sumptibus Academiae Litterarum Gebethner et Socii 1916, Albania: f. 25-29.

[25 - **Albania**]. Consequenter dicendum est de albania, que est coniuncta grecie immediate a parte meridiei et est sita inter rasiam et terram despoti ¹⁾. Est enim [hec]

albania regio satis lata et magna. habens homines bellicosos ualde, sunt enim optimi sagitarii et lancearii. quatuor fluuiis magnis tota hec regio irrigatur, videlicet ersenta ²⁾, mathia ³⁾, Scumpino ⁴⁾, Epasa ⁵⁾. Terra est fertilis in carnibus, caseis, [et] lacte, [in] pane et uino non mul-

1) I. e. despotatum Epiri.

2) Arsen, flumen Albaniae?

3) Mate, Mati, hodie Matja seu Mat.

4) Skumbi, Schkumbi seu Tjerna.

5) Apsos antiquorum (Pauly: Realencyclopädie II/1; p. 283, Hapsus in Tabula Peutig.), hodie Semeni?

[26] tum habundant, sufficienter tamen habent presertim nobiles; ciuitates, castra, [opida], [et] fortalicia et uillas non habent, sed habitant in papilionibus et semper mouentur de loco ad locum per turmas et cognationes suas. habent tamen unam ciuitatem, que uocatur duracium et est latinorum ¹⁾, ab ea [enim] habent pannos et alia necessaria. partem huius regni cum ciuitate duracena [predicta] tenet nunc princeps tarentinus filius regis sycilie ²⁾ et hoc ex uoluntate libera [illorum] dominorum de terra, qui ipsum propter naturalem amorem, quem habent ad gallicos, sponte et libere eum in dominum receperunt ³⁾. De Apulia et de ciuitate brundensima [vna] nocte potest transiri in duracium ⁴⁾ et de duracio per albaniam potest iri in greciam et in Conslantinopolim ualde facilliter et bene abs que difficultate uiarum et periculo aquarum et hane uiam

1) Certum esse uidetur hoc tempore Dyrhachium a Latinis: i. e. principe Philippo Tarentino possideri: ad difficultates huius quaestionis cf. Jirecek, Gesch. Serben I, 339 et Rački Arkiv za pov. jug. VII, 28 nr. 31.

2) Philippus princeps Tarentinus.

3) De hac voluntaria receptione in dominum et Du Cange Hist. Const. I 102; Buchon: Nouvelles Recherches hist. sur la principauté français de Morée etc. Paris 1843, vol. I p. 207/208, vol. II, p. 316-319, dipl. ex a. 1272.

4) Cf. Pseudo-Brocardus Doc. arm. II, 415/16.

[27] faciebant antiquitus imperatores romanorum ¹⁾, [ut Julius cesar, octauianus Augustus et ceteri imperatores]. nam nimium tediosum est exercitum [tam] copiosum ducere tanto tempore per mare et per tam longam uiam ²⁾. Dicturn albanie regnum nunc regem nullum habet, sed terra nulli subsunt. *Dicitur autem hec prouincia albania eo quod albo crine homines illius regionis nascuntur* ³⁾. *Canes sunt in ea ingentis magnitudinis et tante ferocitatis quod* [eciam] *leones perimerunt*, unde et *plinius refert, quod albani miserunt unum canem alexandro magno, qui de leone, elephante et tauro in stadio triumphauit. Oculos habent depictos et glaucos in pupilla adeo quod melius, de nocte uident quam de die* ⁴⁾, [et ideo sunt magni fures, et de nocte discurrunt sicut et de die]. Duas tamen con-

1) Hoc loco antiqua »via Egnatia« commemoratur; cf. etiam Pseudo Brocardus 1. c. 2) cf. Pseudo-Brocardus, Doc. arm. II, 412 et Guillelmus Adae ibid. p. 539; vide etiam contrariam opinionem Petri de Dubois (De recuperatione Terrae sanctae, ed. Bongars: Gesta Dei per Francos, p. 347 et passim).

3) Vinc. Bell. I. 69 el Barth. Angl. XV. 7.

4) Barth. Augl. XV. 7.

[28] stat esse albanias, vnam in asia ¹⁾ que est circa indiam et de illa non loquimur hic, aliam [esse] in europa, que est de imperio constantinopolitano [de iure] et de hac loquimur hic, [et] duas prouincias, continet in se, uidelicet clisaram ²⁾ et tumurist ³⁾. Preter has duas prouincias habet iuxta se et alias prouincias, uidelicet cumaniam ⁴⁾, stophanatum ⁵⁾ polatum ⁶⁾, debre ⁷⁾, que quidem prouincie sunt tributarie eisdem albanensibus et quasi serue, quia exercent agriculturam et colunt vineas ipsorum ac seruant necessaria in domibus suis. homines istarum prouinciarum non mouentur de loco ad locum, sicut prefati albanenses, sed habent

stabiles mansiones et opida, nec sunt pure catholici, nec pure scismatici.

-
- 1) Hodie Daghestan in litore maris Caspii (Graesse-Benedikt: Orbis p. 8); huius Albaniae meminit Vinc. Bell. I, 69 et Isidor Hispal. XIV, c. VII.
 - 2) Clisura, hodie Klisura ad Vjossam.
 - 3) Civitas Timorum, Tomor et montes Tomoritza.
 - 4) Civitas Kumanovo (secundum Cumanos nominata. Jireček Gesch. Bulg. 380) prope Skoplje?
 - 5) Stephanaphana (Stephani fanum), locus in Albania, ad viam Egnatiam; cf. Pauly, Realencycl. (ed. 1852) VI/1, p. 1413.
 - 6) Polati, Polatum, pars Albaniae septentrionalis ad Drinum.
 - 7) Debra, Devre, Diwra = Dibra.

[29] Si tamen esset, qui eis uerbum dei proponeret, efficerentur puri catholici, quia naturaliter diligunt latinos ut dictum est; habent enim albanii prefati linguam distinctam a latinis, grecis et sclavis ita quod in nullo se inteligunt cum aliis nationibus. et hec de albania dicta sufficiant.¹⁾

-
- 1) Cf. Pseudo-Brocardus. Doc. armen. II 477/8.

Shtojcë II: Përkthimi anglisht

Robert Elsie: Albania in the 'Anonymi Descriptio Europae Orientalis' (1308 A. D.), në: "Zeitschrift für Balkanologie" 26 [1990] 24-8.

[f. 26] Now we come to speak of Albania which, on its southern side, is right next to Greece and is situated between Rascia and the land of the despot¹. Albania is a rather extensive and large region. It has warlike inhabitants indeed, for they make excellent archers and lancers. This whole region is fed by four large rivers: the Erzen, the Mat, the Shkumbin and the Osum². The land is productive in meat, cheese and milk; it is not very abundant in bread and wine, though the nobles in particular have enough. They do not have cities, camps, fortifications and farms, but live rather in tents and are constantly on the move from one place to another with the help of their troops and relatives. They do have one city called Durrës which belongs to the Latins and from which they get textiles and other necessities. The Prince of Tarento, son of the King of Sicily³, now holds sway over part of this kingdom including the city of Durrës. It was the free will of the landowners who, on account of their natural love for the French, spontaneously and [f. 26] freely received him as their lord⁴. From Apulia and the city of Brindisi one may cross over to Durrës in one night, and from Durrës one may travel on through Albania to Greece and to Constantinople much more easily and without all the road difficulties and perils of the sea. The Roman emperors of ancient times used this route⁵ for it is excessively tedious to transport a large army in such a period of time by sea and by such long roads. The said kingdom of Albania now has no king, the land being divided among the landowners who rule it themselves and who are subject to no one else. This province is called Albania because the inhabitants of this region are born with white (*albo*) hair. The dogs here are of a huge size⁶ and are so wild that

they kill like lions. As Pliny mentions, the Albanians sent such a dog to Alexander the Great which vanquished lions, elephants and bulls in the stadium. They have painted eyes, greyish in the pupils, such that they can see better at night than in the daytime. There are two Albanias, one in Asia near India of which we are not speaking here, and the other in Europe which is part of the Byzantine Empire and of which we are speaking here. It contains two provinces: Clisara⁷ and Tumurist⁸. In addition to these two provinces, it has other provinces next to it: Cumania⁹, Stophanatum¹⁰, Polatum¹¹, and Debre¹² which are provinces tributary to the Albanians and more or less subjected to them, for they are active in farming, tend their vineyards and take care of the necessities of life at home. The inhabitants of these provinces do not move from place to place as the aforementioned Albanians do, but live rather in solid mansions and towns, nor are they entirely Catholic or entirely schismatic. Should anyone preach the word of God to them, they would pretend to be true Catholics for it is reported that by nature they have a liking for the Latins. The aforementioned Albanians have a language which is distinct from that of the Latins, Greeks and Slavs such that in no way can they communicate with other peoples. This is enough on Albania.)

Shënime

- 1) I. e. the despot of Epirus.
- 2) *Epasa* no doubt ancient *Apsos*, i. e. the Osum flowing through Berat, tributary of the Seman.
- 3) Philip, Prince of Tarento.
- 4) CL DU CANGE, Hist. Const. 1. 102.
- 5) Reference is made to the Via Egnatia, the main road of ancient communication between Rome and Constantinople, passing through Durres, Elbasan and Ohrid.
- 6) Half a millenium later the English painter and poet Edward Lear (1812-1888) was to make the same discovery on his travels down the Himaran coast in 1848. In his "Journal of a landscape painter in Greece and Albania" (London 1851), he records on 10 October, 1848 being attacked by "some thirty immense dogs, who bounced out from the most secluded corners and would straightway have breakfasted on me had I not been so aptly rescued; certainly the dogs of Khimara are the most formidable brutes I have yet seen."
- 7) Këlcyra, ancient *Kleisura* on the upper Vjosa river in southern Albania.
- 8) Probably in the Myzeqe region around Kavaja. The chronicle of Giovanni Musachi speaks of a locality called Tomorista.
- 9) No doubt Chounavia, formerly the site of an Orthodox diocese somewhere between Durres and the Mat region, perhaps on the Ishem river.
- 10) No doubt Stephanatum, a diocese of the time somewhere near Durres.
- 11) Pulatum, Polati or Pult near the Drin in northern Albania east of Shkodër.
- 12) The present-day region of Dibra or Debar on the Albanian-Yugoslav border north of Lake Ohrid.

SKENDER ASANI

PETAR ÇAULEV DHE VEPRA E TIJ “SHQIPËRIA”

Parathënie

Petar /Petrush¹/ Çaulev (1880 – 1924), veprimtar i njohur nga Ohri, i përket një brezi aktivistësh, të cilëve iu desh që tërë jetën t’ia kushtojnë koncepteve revolucionare. Ai jetoi në një periudhë të rëndë kohore, që karakterizohet me sundimin osman dhe serb në këtë pjesë të Ballkanit.

Petrushi e kishte mbaruar gjimnazin dhe menjëherë ishte kyçur në procesin arsimor si mësues në fshatrat e Ohrit.² Ai është figura kryesore që do të jetë urë lidhëse ndërmjet Organizatës Revolucionare Maqedonase me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në vitin 1912, me Qeverinë e Ismail Qemalit në vitet 1912 – 1913, dhe me Komitetin e Kosovës në vitet 1919 – 1924, dhe ky angazhim i tij do të kulmojë me veprën e shkruar për Shqipërinë. Ai gjatë veprimtarisë së tij revolucionare angazhohej kundër hegjemonisë serbo – greke ndaj këtyre territoreve.³ Ndërsa, gëzonte përkrahjen e pa rezervë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Qeverisë së udhëhequr nga Ismail Qemali dhe Komitetit të Kosovës. Për përkatësinë etnike të Petrushit flet vetë veprimtaria e tij revolucionare, trimëria e treguar nëpër fushëbeteja në Strugë e Ohër, koordinimi me Qeverinë e përkohshme të Vlorës dhe qëndrimi i tij në Shqipërinë Londineze pas shuarjes së Kryengritjes së Shtatorit të vitit 1913.

Në kujtimet e Millan Matovit⁴, Petar Çaulevi paraqitet si udhëheqës i Komitëve në regjionin e Ohrit, si personalitet i veçantë që s’ka të bëjë asgjë me bullgarizmen. Babai i tij ishte shqiptar toskë nga jugu i Shqipërisë dhe rridhte nga një familje e

¹Në një shkresë të 29 shtatorit 1913 të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, dhe të gazetës “Përlindja e Shqipëniës” e 25 shtatorit, Petar Çaulevi paraqitet me emrin Petrush; Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, nëndor 1912 – janar 1914, nr.286, 29.09.1913, Tiranë, 1963, 207, 341; Lufta në Bukovë, “Përlindja e Shqipëniës” (Organ për me mbrojtur të drejtat kombëtare), 25. Vjeshtë e I.1913, faq’ e 5.

²Katerina Todorovska, “Si i pa Çaulevi shqiptarët dhe Shqipërinë”, Kryengritja e shtatorit në Ohër e Dibër e vitit 1913, Shkup, 2014, 81.

³Архив на Институтот за национална историја, фонд. Врховна команда - полициско оделение 1913 год., Министерство Unutrašnjih Dela, Poverljivo, 18 septembra 1913 god., Beograd.

⁴Millan Matovi ishte bashkëkohanik i Petar Çaulevit, dhe ishte prijës i Organizatës Revolucionare Maqedonase dhe njëri ndër udhëheqësit e Kryengritjes Antiserbe të Shtatorit të vitit 1913.

cila merrej me peshkim.⁵ Në Ohër, në periudhën kur jetoi dhe veproi Petar Çaulevi, përveç mijëra shqiptarëve me përkatësi fetare myslimane, kishte edhe qindra banorë shqiptarë me fe ortodokse. Në mesin e tyre ishte edhe familja e Petar Çaulevit, të cilët ishin shqiptarë ortodoksë, dhe sipas disa bashkëluftëtarëve të tij, në familjen e tyre flitej gjuha shqipe, ndërsa vetë ai e fliste rrjedhshëm gjuhën shqipe.

Me këtë rast duhet theksuar kontributin e veçantë të Petar Çaulevit në krijimin e lidhjeve ndërmjet komitëve dhe çetave kryengritëse shqiptare në vitin 1912, në luftë kundër politikës xhonturke. Duhet veçuar afërsinë e Petar Çaulevit me prijësin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe bashkëqytetarin Dervish Hima, i cili ishte nga qyteti i Ohrit.⁶ Në pjesën e dytë të gushtit të vitit 1912 nëpër shumë qytete largohet pushteti osman, si Shkupi, Tetova, Gostivari, Kërçova, Struga... Edhe në Ohër administratën e marrin vendorët dhe si udhëheqës caktohet Petar Çaulevi. Kjo administratë nën udhëheqjen e Petar Çaulevit, do të zgjasë deri me 22 nëntor të vitit 1912, kur në Ohër depërton ushtria serbe. Me marrjen e pushtetit nga serbët, ata menjëherë do të largojnë të gjithë personat që ishin përkrahës të Petar Çaulevit.⁷

Petar Çaulevi ishte angazhuar në përgatitjen e Kryengritjes antiserbe të vitit 1913, dhe për këtë më së miri flet raporti i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Serbe, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë, ku theksohej se duhet të kihet kujdes me prijësit e shqiptarëve që kanë filluar kryengritjen, ku duhen veçuar 32 krerët të kësaj lëvizje. Në mesin e tyre ishin Ismail Qemali, Isa Boletini, Millan Matovi, Petar Çaulevi, etj.⁸ Kryengritësit që ishin nisur nga Elbasani në drejtim të Strugës, pa vështirësi të mëdha më 15 shtator hynë në këtë qytet. Ndërsa Petar Çaulevi kishte hyrë po të njëjtën ditë me 300 kryengritës në qytetin e Ohrit. Sipas informacioneve të gazetës “Politika”, thuhej se Petar Çaulevi së shpejti qytetin e Ohrit do t’ua dorëzonte shqiptarëve, dhe ky qytet do të hynte nën juridiksionin e Qeverisë së Vlorës.⁹ Ai këtë aktivitet të luftës kundër hegjemonisë serbe pas Luftës së Parë Botërore do ta orientojë në bashkëpunimin më të ngushtë ndërmjet Komitetit të Kosovës, me Organizatën Revolucionare Maqedonase, me komitetet kroate, sllovene dhe lidhjet me të afërta me Italinë.

Në një shkresë të 29 shtatorit 1913, kryetari i Komunës së Qukësit, i drejtohet prefektit të Elbasanit, me anën e së cilës e njofton për veprimet e kryengritësve dibranë kundër pushtuesve serbë. Në bazë të kërkesës që u bë nga ana e Qeverisë së Dibrës, fuqia e rëndësishme e dibranëve që ndodhej në Ohër dhe Strugë, u tërhoq

⁵Милан Матов, “Комитата раскажува (Од спомените на еден македонски револуционер)”, Скопје, 2002, 126; Милан Матов, “За премълчаното в историята на ВМРО (Спомени)”, София, 2007, 118.

⁶Архив на Институтот за Национална Историја, фонд.Врховна команда полициско оделение 1913 год., Министерство Unutrašnjih Dela, Poverljivo, 18 septembra 1913 god., Beograd.

⁷Nebi Dervishi, “Etnokultura e fushëgropës së Ohrit”, Tetovë, 2005, 209 -210.

⁸Muzafer Bislimi, “Kryengritja e shtatorit (Dibrës) e vitit 1913 dhe bashkëpunimi me popullatën lokale maqedonase – në bazë të dokumenteve të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Serbe”, Kryengritja e shtatorit në Ohër e Dibrë e vitit 1913, Shkup, 2014, 37.

⁹Бугари у Охриду, “ Политика “, бр.3476, 16.09.1913, Београд, 1913, 1.

një ditë më parë për në Dibër. Që nga mali Petrinja deri në një vend afër Resnjës luftoi burrërisht ajo fuqi e pakët që mbeti aty së bashku me një fuqi të përbërë prej 100 vetëve të komanduar nga Petrushi. Ndërsa gazeta “Përlindja e Shqipërisë” e datës 25 shtator të vitit 1913, boton një artikull me titull “Lufta në Bukovë”, ku përshkruhej shumë qartë rrjedha e luftimeve: *“Luftë e rrept dhe e përgjakëshme u ba në Petrin, në atë mal ngjat Resnjës, në Zavu dhe në Bukovë. Trimëniën që dëftuen kryengritësit, me gjithë pakicën e tynë, ashtë lart çdo lavdie. Së vrarët t’armikut janë aqë shumë sa kapërxejnë nga të 500 a 600 shpirtë. Prapë s’na rrihet pa përmendun emënin e Petrushit, i cili tregoi kuximin e tij të zakonshëm sa u habitën gjindja e atjeshme”*.¹⁰

Autori Petar Çaulev në librin *Shqipëria* e fillon pasusin e parë me bindjen e shqiptarëve se janë pasardhës të drejtpërdrejtë të Lekës së Madh. Në këtë drejtim autori paraqet diskutimin e disa të moshuarve se: *“Si paraardhësit e tyre kanë treguar, se ata kanë qenë një fis i Lekës së Madh, si motivacion ata janë këtu, se në një luftë ndërmjet Lekës së Madh dhe grekëve, i pari në urdhrat e tij i ka thënë fjalët të cilat edhe sot përdoren në Shqipëri dhe mbahen se janë shqiptare: ecni, vritni, prishni, gur ndër këmbë mos lini... Nëse janë të vërteta këto fjalë, kjo do të jetë puna e historianëve, por shqiptarët diskutojnë se fjalët e lartpërmendura janë gjetur të shkruara në një gur në Akropolis”*. Po ashtu ai përcjell mendimet e shqiptarëve të asaj kohe ku diskutohej me plot besim në vetvete se ata janë pasardhës të ilirëve të vjetër. Më tej në hyrje të librit flet për pushtuesit e ndryshëm ndër shekuj që kanë sunduar me trojet etnike shqiptare, për heroin kombëtar të shqiptarëve Gjergj Kastriotin - Skënderbeun, e sidomos për rezistencën 25- vjeçare kundër Perandorisë Osmane, për Ali Pashë Tepelenën si udhëheqës i Vilajetit të Janinës, që të përmbillet hyrja e këtij libri me themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe sidomos për angazhimin në këtë drejtim të vëllezërve Frashëri. Në kryetitujt e mëtejme flet për çlirimin e Shqipërisë, për Shqipërinë e lirë, për Shqipërinë e sotme, për shqiptarët si popull, për organizimin shtetëror, për sistemin gjyqësor, për kryeqytetin e Shqipërisë, për gjeografinë, florën dhe faunën, për situatën ekonomike të vendit, për veprën e mësimin në Shqipëri, për rrugët në Shqipëri, për shprehitë, karakteret dhe ritet, për partitë dhe luftërat politike në Shqipëri, për atë se çka ndodhi në grushtshtetin e fundit, dhe përfundon me kabinetin e ri.

Historiana Katerina Todoroska në artikullin shkencorë kushtuar veprës *“Shqipëria”* të Petar Çaulevit, do të theksojë: *“Petar Çaulev u vra në po të njëjtin vit, më 1924, kur del nga shtypi libri i tij për Shqipërinë, për të cilin mund të thuhet se është profetik për kohën në të cilën është shkruar, veçanërisht nëse merren parasysh ngjarjet në gjysmën e dytë të viteve të 20 – ta të shek. XX në shtetin shqiptar. Por sot, libri gjithashtu është interesant, sa edhe provokues”*.¹¹

¹⁰Qeveria e Përkohëshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, nëndor 1912 – janar 1914, nr.286, 29.09.1913, Tiranë, 1963, 207, 341; Lufta në Bukovë, “Përlindja e Shqipëniës ” (Organ për mbrojtur të drejtat kombëtare), 25. Vjeshtë’ e I.1913, faq’ e 5.

¹¹Katerina Todoroska, “Si i pa Çaulevi shqiptarët dhe Shqipërinë”, Kryengritja e shtatorit në Ohër e Dibër e vitit 1913, Shkup, 2014, 90.

Pra, siç shihet, kemi të bëjmë me një autor dhe me një veprimtar të çmuar të lëvizjeve antiosmane dhe antiserbe, i cili gjithë jetën ia kushtoi lirisë së popujve të robëruar të kësaj pjese të Ballkanit, siç ishin shqiptarët dhe maqedonasit. Të dhënat autentike që flasin për prejardhjen shqiptare të Petrush Çaulevit, janë edhe një shkas më tepër që kjo figurë e shquar historike, të hulumtohet edhe më thellësisht në këtë segment të rëndësishëm të jetës dhe veprës së tij për liri e pavarësi.

Për shkak të këndvështrimit interesant të autorit Petar Çaulev, në librin e tij “Shqipëria”¹², në këtë numër të revistës “Studime Albanologjike” do ta sjellim të plotë këtë tekst.

¹² Ky libër me 49 faqe në gjuhën bullgare, për herë të parë u botua në gusht të vitit 1924 në Stamboll, me editor Spire Vasilev. Tani për herë të parë dhe në mënyrë integrale këtë libër po e sjellim në gjuhën shqipe.

П. Чаулевъ


СКИПНИЯ (АЛБАНИЯ)

Издатель: СПИРО ВАСИЛЕВЪ



Тип. Л. БАБОКЪ и С-вѣя Галата, ул. Камондо, 8

ЦАРИГРАДЪ. Августъ 1924 годъ.



Petar Çaulev, SHQIPËRIA (П.Чаулев, СКИПНИЯ (АЛБАНИЯ))

Shqiptarët e sotëm diskutojnë me plot besim në vetvete se ata janë pasardhës të Ilirëve të vjetër, të cilët shumë vjet para Krishtit janë vendosur në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Disa të moshuar diskutojnë se si paraardhësit e tyre kanë treguar, se ata kanë qenë një fis i Lekës së Madh, si motivacion ata janë këtu, se në një luftë ndërmjet Lekës së Madh dhe grekëve, i pari në urdhrat e tij i ka thënë fjalët të cilat edhe sot përdoren në Shqipëri dhe mbahen se janë shqiptare: ecni, vritni, prishni, gur ndër këmbë mos lini. Nëse janë të vërteta këto fjalë, kjo do të jetë puna e historianëve, por shqiptarët diskutojnë se fjalët e lartpërmendura janë gjetur të shkruara në një gur në Akropolis.

Fjala “Iliria” në shqip do të thotë “liri”. Çdo shqiptar të cilin e pyetni se çka je: po të ishte ai nga pjesët veriore apo jugore, pavarësisht nga cili fis shqiptar të ishte ai, në atë pyetje përgjigjet: unë jam shqiptar. Emërtimi shqiptarë del nga fjala “shqip”. Sipas sqarimeve të historianëve dhe filozofëve emërtimi shqiptar vjen nga fjala latine “Albus” nga e cila të huajt e kanë formuar fjalën shqiptar (fytyrë bardhë). Prej aty, sipas P. Ciljev, grekët i kanë thërritur albanos ose arvanis, turqit – arnautë, dhe jugoslllovenët – arbanasi.

Shqiptarët gjatë shekujve kanë qenë thuajse gjithmonë nën robëri: të romakëve, të bizantinëve, të sllavëve, dhe në shekujt e fundit të turqve. Ata kanë mundur që ta rruajnë gjuhën e tyre, kombin dhe zakonet, edhe pse ata u fshihehin dhe pengoheshin pas zotërimit të maleve të larta dhe të pakaluar, por edhe kur jepshin në shërbim të robëruesve ushtarë të mirë të cilët janë adaptuar. Kështu, për shembull, pasi Gjergj Kastrioti (Skënderbeu) – njëri nga komandantët më të mëdhenj të historisë shqiptare – do ta mbronte Shqipërinë dhjetëra vite nga turqit, pas vdekjes së tij pjesa më e madhe e trashëgimtarëve të tij dhe komandantëve pranuan myslimanizmin, u bënë ndjekës (vazalë) dhe ushtarë të mirë të sulltanëve, kurse këto të fundit e pranuan këtë me gëzim të madh sepse interesi i tyre i diktonte këtij fisi ushtarak në emër të islamit të emërtohet dhe të luftojë dhe mbrojë interesat turke përballë Greqisë dhe sllavëve. Jo nga sot, por mundet që nga shekujt e lashtë Shqipëria ka dy fise shqiptare – jugore dhe veriore. Të jugut quhen Toskë, kurse të veriut Gegë. Turqit i kanë shfrytëzuat të parët – toskët, përballë grekëve, kurse të veriut gegët, përballë sllavëve. Para një shekulli, ne pothuajse e shohim udhëheqësin e grekëve – i fundit, në krye me shefin Ali Pashë Tepelena, me seli në Janinë, kurse përballë sllavëve – gegët në krye me familjen e ashtuquajtur vezirët. bullgaro – shqiptarë.

Patriotët shqiptarë, kanë dëgjuar të thëna se në kohën e Ali Pashës dhe të vezirëve ka ardhur në Shqipëri një burrë i madh bullgar që të negociojë për një kryengritje të përbashkët bullgaro – shqiptare. Mendohet nga disa se ka qenë Sava Rakovski, sepse ai është llogaritur për më të madhin bullgar, por kjo nuk përputhet me realitetin, sepse Ali Pasha është më i vjetër se Rakovski.

Për suksesin e politikës urdhëruese, turqit menjëherë pas pushtimit të Shqipërisë kanë marrë masa për shpëputjen e lidhjeve të tyre, veçanërisht nga papa,

me të cilin si Skënderbeu, ashtu si dhe shqiptarët e parë, kanë pasur lidhje të mëdha (për këto lidhje na tregojnë faktet se me emrin e Skënderbeut u emërtua rruga në Romë mu ndër Kvirinalit dhe 250.000 shqiptarë, të larguar atëherë në Itali, dhe sot e kanë mbajtur shumë nga traditat e tyre, zakonet dhe gjuhën. Si kanë vepruar dhe çfarë masash kanë ndërmarrë që ta mbërrijnë këtë nuk e dimë, por është fakt se limani i dikurshëm i lulëzuar ka qenë Durrësi (qytet me 400.000 banorë). Kjo tregon se gojëdhënat dhe reliktet janë limani i parë i kohës, kjo flet për Porto Romanon, ta kemi sot me 4 – 5000 banorë dhe me liman të caktuar, kurse më të pasurit, ndoshta, në fushat e gadishujve, siç janë e Kavajës, Myzeqesë, Lushnjës, Beratit, të cilat kanë mundur të jenë lulishtja e parajsës në Ballkanin perëndimor, për rreth shtretërve të lumenjve Erzen, Shkumbin, Vjosë, Devoll, etj, thjesht të braktisura. Sipas gojëdhënave hasim shumë kryengritje të shqiptarëve përballë perandorisë turke. Kjo ka gjasa të ketë ndodhur për shkak të ambicieve të papërmbushura të disa udhëheqësve shqiptarë, se sa për ndonjë kërkesë politike. Pjesa më e madhe e popullatës shqiptare, pas pranimit të fesë myslimane, ishte fis mbizotërues jo vetëm mbi shqiptarët ortodoksë, zëri i të cilëve nuk dëgjohej, por edhe mbi popullatën krishtere e cila ishte e vendosur në pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik. Shqiptari ishte bërë feudal i Maqedonisë, deri në Nish: në Epir dhe Thesali. Për këtë, kur Husein Kapetani nga Bosnja e turbullon, se turqit në Stamboll e kanë ndaluar mbajtjen e kapelës – fesit nga veshja kombëtare turke, ndërmori marshim kundër qeverisë për heqjen e fesit, shqiptarët i dolën nga shpina dhe e shkatërruan, që sot fesi mbeti vetëm në Bosnjë është e madhe.

Turqit, që të mund më me qetësi ta komandojnë këtë fis ushtarak, duhej të shfrytëzonin moton "përçaj dhe sundo". Ata kanë shfrytëzuar të gjitha mënyrat që t'i mbajnë qëndrimet armiqësore njëri përballë tjetrit të dy fiseve më të mëdha : Toskët kundra Gegëve dhe anasjelltas. Kur një fis ka qenë i pathyeshëm, me mbështetjen e shtetit është dërguar fisi tjetër për të krijuar armiqësi ndërmjet fiseve, që edhe sot pjesërisht nuk ka përfunduar së ekzistuari. Shqiptarët janë kufizuar t'i eksploatojnë dhe zotërojnë mbi krishterët e mbetur nën robërinë turke, - Maqedinija dhe Epiri, -por njëkohësisht tek shqiptarët e ndërgjegjshëm, lind ideja për rilindje shqiptare.

Kuvendi i parë i nacionalistëve shqiptarë, menjëherë pas çlirimit të Bullgarisë, u mbajt në Prizren, me iniciativën e Naim bej Frashërit, nën mbrojtjen e të plotfuqishmit të atëhershëm dibranit Maliq Pasha, gjyshi i revolucionarit të njohur më pas Hamdi Beu. Hamdi Beu është i biri i Olloman Beut dhe nipi i Iljaz Pashës. Qysh prej viteve të hershme, së pari lirohet prej religjionit; më pas nga pasuria e madhe e gjyshit dhe babës dhe niset si i dërguar për rilindjen dhe pavarësinë e shqiptarëve. Shumë herë ka qenë i kapur nga kajmekami i Ohrit me rreziqe të mëdha, sa herë ishte i internuar, arrestuar dhe i robëruar, nuk e kemi pyetur. Por fakt është se ai një kohë të gjatë si i internuar jetonte në Bosnje, Rumani, Bullgari, dhe si i burgosur për shumë vjet në kalanë e Diarbekirit.

Në këtë kuvend, këta nacionalistë shqiptarë thuajse nuk kishin sukses, sepse lidhjet fetare të shqiptarëve dhe turqve u paraqitën si pengesë e madhe. Nacionalistët shqiptarë nga vitet 20 – 30 e këndeje nuk janë ndalur duke vepruar, si në Shqipërinë e sotshme të lirë, ashtu edhe në Kosovë dhe Maqedoni. Edhe në

fushën e kulturës ata nuk kishin sukses, edhe pse kishin njerëz të aftë, si Bajram Curri, Hasan bej Prishtina, Dervish Hima, Ismail Qemajli, Gurakuqi, Hilë Mosi, etj. Siç thashë, pengesa e parë është paraqitur nga religjioni mysliman. Më mbështetës për revolucion ishin shqiptarët katolikë dhe kosovarët. Veprimet e tyre para masave gjithmonë kanë qenë të karakterizuara si të nxitura nga jashtë. Patriotët dhe martirët ndoshta do të më hidhërohen, por unë do të jem i hapur dhe do të rrëfhem ashtu siç është. Çlirimi i Shqipërisë erdhi padashur prej popullit dhe papritur. E them padashur, sepse ushtritë shqiptare luftonin krah për krah me të turqve në të gjitha frontet në luftën ballkanike dhe ushtarëve turq të rraskapitur nga Maqedonia u tërhoqën të pangacmuar nga askush në Shqipëri. Heroi i Resnjës Nijazi beu, për të cilin asnjë turk nuk tregoi mëshirë, do të vritej në Vlorë jo për ndonjë zgjidhje, por nga urrejtja dhe hakmarrja.

Çlirimi i Shqipërisë

Pas shpalljes së luftës ballkanike, grekët dhe serbët, pasi depërtuan në Maqedoni, duke llogaritur dhe Shqipërinë si provincë turke, u drejtuan që ta sundojnë atë. Grekët kishin arritur deri në Korçë dhe Gjirokastrë, malazezët kishin hyrë në Shkodër, kurse serbët ishin në Elbasan dhe ishin drejtuar drejt Adriatikut dhe Durrësit të shumdëshiruar nga ata, kur qeveritari i njohur turk me prejardhje shqiptare dhe deputeti i Beratit në Parlamentin e Stambollit, Ismail Qemajl beu, ishte nisur nga Stambolli; ka kaluar nëpër Rumani dhe Austri dhe mbërrin në Durrës për një kohë të shkurtër, thërret nacionalistët shqiptarë më të shquar në kongres në qytetin e Lushnjës me 18 Nëntor 1912 dhe e shpall Shqipërinë shtet të pavarur, me qeveri të përkohshme, në të cilin udhëheqës ishte vetë ai. Konferenca e Londrës, në vitin 1913 e pranoi de facto pavarësinë e Shqipërisë. E njëjta konferencë me shpejtësi dhe pa studime i vendosi kufijtë e rinj të Shqipërisë. Të caktuarit nga ajo koherencë menjëherë filluan t'i kontestojnë kufijtë nga grekët dhe serbët. Shqiptarët thoshin se pjesa më e madhe e fiseve u ka mbetur nën robëri, kurse grekët, serbët dhe malazezët – se kufijtë i kishin shumë të ngushtë. Grekët donin që në Shqipërinë jugore të sundonin në qendër dhe në Korçë sepse aty kishte popullatë krishterë e cila e pranonte peshkopatën; serbët kishin nevojë për dalje në det, kurse malazezët e donin Shkodrën me liqenin dhe fushat përreth lumit Buna, sepse dikur vendi ishte i populluar me malazezë dhe e kishin për nevojë investigimi.

Pas Konferencës së Londrës, serbët, grekët dhe malazezët duhej që ta lëshonin Shqipërinë, por ata nuk kanë dashur ta bëjnë atë, Fuqitë e mëdha dërguan ushtri në qendër të Shkodrës. Serbët dhe malazezët u dorëzuan, kurse grekët, të cilët i kanë bërë shkrumb e hi të gjithë koloninë, Leskovikun, Gjirokastrën, Tepelenën, Përmetin etj, duke u turpëruar dhe frikësuar që të mos i shohin ato forcat evropiane, mundoheshin që t'i kontestojnë edhe disa të drejta të veta në këto vende dhe nuk i lëshonin, duke besuar se Fuqitë e Mëdha do të besojnë se “ Helada e kulturuar dhe e civilizuar “ nuk mundet të gënjejë.

Populli shqiptar, edhe pse ishte i vendosur në kufij të ngushtë, dhe jo nacionalë, kur pa se ka një Shqipëri të lirë me kufij të vet, diçka që historia nuk kishte folur deri atëherë, dëshironte që të pajtohet me situatën, madje edhe çfarëdo

që të mbetet, sepse shefi i tyre Ismail Qemal beu – një njeri me inteligjencë të lartë dhe diplomat – u thoshte: “ Nuk na janë plotësuar kushtet, kufijtë nuk janë nacionalë, të jemi gjallë, ka Zot.....”

Një tjetër pushtetar, Aqif Pasha, dhjetë vjet më pas në programin e tij manifesti drejt popullit shqiptar, shkruante: “Kufijtë e fisit tonë u vendosën nga Zot”. Me këtë ai deshi të tregonte se kufijtë e një populli mund të përcaktohen dhe mund të jenë vërtetë nacionalë atëherë kur konferenca, e cila i përcakton këta kufij, bëhen me principin e vetëvendosjes së popullit, dhe jo me dëshirë të ndonjë delegati, apo interesave qeveritare të atyre apo këtyre Forcave të Mëdha.

Në këta kufij të lirë, për herë të parë pas shumë shekujve, Kuvendi Popullor Shqiptar vendosi që qeverisja e vendit të jetë monarkiste dhe për mbret të Shqipërisë të zgjidhet gjermani Kjnaz Vidi.

Shqipëria e Lirë

Liria e Shqipërisë, të cilën e ceka edhe më lart, ishte e padëshiruar dhe e papritur nga populli. Ajo e gjeti tërësisht të papërgatitur për atë punë. Inteligjencia dhe myslimanët nuk mund të ndaheshin nga Stambolli. Shqiptarët e krishterë e dëshironin, por ishin shikues të pafjalë, sepse nuk kishin punuar aspak për këtë. Ata më shumë kanë punuar për gjallërimin e Heladës, sepse ashtu ishin të edukuar në shkollat dhe kishat. Të vetmit të cilët e donin, ishin shqiptarët e Kosovës dhe katolikët nga vilajeti i Shkodrës, por për fatkeqësi, shqiptarët e Kosovës mbetën në kufijtë e Serbisë, kurse katolikët edhe pse mbetën në Shqipërinë e lirë, ishin vetëm një minoritet i madh dhe vetëm në njërin fund të asaj ane – të Shkodrës.

Që të jem i drejtë siç them, se liria për masën shqiptare ishte e padëshiruar, do t'i tregoj shembujt vijues:

- 1.) Shqiptari nuk është mësuar të shërbejë në ushtri.
- 2.) Shqiptari nuk është mësuar të paguajë tatime me shekuj.
- 3.) Shqiptari (si myslimanët) nuk pajtohet me gjendjen, se duhet t'i shërbejë Mbretit (krajlit)
- 4.) Fanatizmi i religjionit i myslimanëve shqiptarë (si shumicë e madhe) nuk u lejonte që të shkruhet në alfabetin e <krishterë>, për të cilën u llogarite latinishtja.
- 5.) Fanatizmi i myslimanëve shqiptarë nuk e lejonte që popullata e deridjeshme (krishterët) të jenë qytetarë të barabartë.
- 6.) Shqiptari nuk mund të pajtohet me ligjin e ri, se duhet ta lërë pushkën nga krahu i tij, megjithatë, i gjithë ky konstituim i ri dhe i përshkruar nga më modernët dhe i sajuar me shpejt, i kërkonte jo vetëm pikat e mësipërme, pikërisht, se shqiptari duhet të mbajë një barrë ushtarake, të paguajë tatime, t'i shërbejë krajlit të krishterë, do të shkruajë në latinisht dhe jo në turqisht, krishterët si vëllezër të tyre do të jenë qytetarë të barabartë, dhe që asnjë

shqiptar përveç policisë, xhandarmerisë nuk guxon të mbajë armë, dhe shumë gjësende të tjera të cilat janë në kundërshtim me mendimet e tij: shqiptari do të ndërtojë rrugë, të cilat asnjëherë nuk i ka dashur, sepse me mosqasjen deri te shtëpia e tij ai ka mundur që ta ruajë gjuhën, traditën, zakonet, karakterin dhe lirinë. Konstituimi kërkonte që fëmijët medoemos të shkojnë në shkollë, diçka që ai e llogarite si ndërrim të religjionit; kurse disa kishin ardhur nga Stambolli dhe intelektualë të lartë me gradat më të larta, agjintonin në shumë sende, edhe në atë që të zbulohen gratë e tyre etj. Sendë që llogariteshin dhe ende llogariten për robëri të tmerruar dhe për ndërrim të mënyrave, zakoneve, traditave të tyre të pranuar nga kurani. Pas gjithë kësaj që u tha, të gjithë do të pyeten: shqiptari i cili si rob nuk e ka bërë robërinë, a nuk është liridashës? Në këtë pyetje është e rëndë të kuptojë ai i cili nuk ka jetuar në Shqipëri. Populli më liridashës në Ballkan është populli shqiptar. Shqiptari ta marrim veçmas, si individ, nga natyra është anarkist. Ai nuk e lejon robërinë kundër popullit të tij, por nuk ka dëshirë edhe të këtë diçka, e cila mund t'i pengojë dhe është poshtëruese në shtëpinë e tij. Shtëpia e shqiptarit është e vetme dhe ajo është larg nga shtëpitë e tjera, ndonëse edhe në një fshat, largësia e shtëpive duhet të jetë më së paku një tufek (qitje pushke). Shqiptari është qytetari më i urtë, siç e njeh Evropa. Shqiptari nuk është grabitës. Ai nga natyra nuk është vjedhës apo vrasës. Qeveritë, të cilat e drejtuan dhe e drejtojnë këtë anë, shpeshherë i detyronin që të ketë tollovi ndërmjet vrasësit dhe hajdutit. Shqiptari si dashamirës dhe i drejtë, gjatë shumë shekujve ka qenë i detyruar që ta mbrojë lirinë dhe nderin e familjes së tij me armë që sot ta mbajë njollën se ai është vrasës.

Bejlerët – feudalë, të cilët kishin harruar të gjithë vetëm për t'i mbrojtur pronat e tyre, kishin votuar bukvalisht kushtetutën e Turqisë, e cila ishte më e leverdishme dhe duke dashur që secili për vete ta mbajë qeverisjen në Shqipëri, me pamundësi, sepse ishin në numër të madh sesa duhej, filluan të grinden. Kishin nevojë për fuqi, për atë secili shpejtonte që të përfitojë nga masa, duke u shërbyer me agjitacione, të cilat njëra nga tjetra ishin me karakter dhe pranues për masën, thuajse edhe në kundërshtim me kushtetutën. Nga fillimi i vjeshtës së vitit 1913, pas njohjes së Shqipërisë nga Konferenca e Londrës, beu i njohur i Tiranës Esad Pasha filloi të mbledhë vullnetarë dhe t'i dërgojë përballë feudalëve të tjerë, siç ishte në kohën e Aqif pashës nga Elbasani, që ta marrë tërë qeverinë në duart e veta. Grindjet filluan dhe Princ Vidi u paraqit në Shqipëri, si i zoti i atij vendi, kur Esat Pasha e llogariste veten si zotërues i plotfuqishëm. Pretendimet e Esad Pashës se mund të bëhet mbret i Shqipërisë ishin shumë të mëdha. Atëherë një kopshtar nga Tirana me emrin Haxhi Qamil, njeriu i besuar i Esad Pashës, duke parë se populli kërkon reforma të mëdha sociale, të përmbajtura nga myftiu i Tiranës me fjalët se populli shqiptar kërkon që ta mbajë fenë myslimane, në një kohë tepër të shkurtër, në emër të reformave të mëdha sociale – shkatërrimin e feudalëve dhe toka për fermerët, si dhe në emër të fesë, tërheqë masat në anën e tij dhe shpall luftë fetare, edhe kundër të plotfuqishmit Esad Pasha, ashtu edhe përballë të

krishterit të posaardhur princ Vedit. Haxhi Qamili me përkrahësit e pavarësuar të tij gjatë vitit 1914 pushton tërë Shqipërinë, pasi shkatërroi shumë kulla, kënaq dhe ferma të feudalëve, largoi shumë të shquar, Esad Pasha dhe princ Vidi ishin të detyruar, së bashku me përfaqësuesit të huaj, me muaj të presin në vaporet para portit të Durrësit. Ky regjim i pastër bolshevik në Shqipëri i quajtur i Haxhi Qamilit, zgjati disa muaj, derisa Esad Pasha bëri marrëveshje me serbët dhe bëhet njëfarë guvernatori i tyre në Shqipëri dhe sipas marrëveshjes ata dërguan ushtri, okupuan Tiranën dhe e zunë Haxhi Qamili dhe myftiun, të cilët dhe i varën. Si kompensim për këtë, pasi Esad Pasha përsëri u bë i zoti i Shqipërisë, ua dorëzoi serbëve edhe revolucionarin e fundit që kishte, por edhe nga Kosova dhe Maqedonia, ndër të cilët katër ishin nga Ohri. Në një situatë të tillë Shqipërinë e gjeti lufta evropiane.

Populli shqiptar, i frikësuar nga Esad Pasha, si miku i mirë i Serbisë – Fuqitë e Mëdha aleate, ishte i detyruar që tërë vitin 1915 të kundërshtojë, por të jetë i qetë. Në fund të vitit 1915 kur ushtria bullgare u përzie me atë të serbëve në krye me dinastinë, ministrat dhe udhëheqësit e tyre ishin të detyruar të tërhiqen para depërtimit bullgar në Shqipëri, shqiptarët nga Kosova dhe Maqedonia pronat e të cilëve ishin të shkatërruara dhe të grabitura dhe të afërmit e tyre ishin therur nga serbët pa i kushtuar vëmendje sjelljes së Esad Pashës, në krye me bajraktarët e tyre si Bajram Currin, Elez Isufi, etj, ua parandalojnë rrugët serbëve, nga ana malësore, si Sharri, Bistrica, Koritniku dhe i detyruan serbët të japin viktimat të panumërta, të lënë të gjithë pasurinë e tyre dhe me mijëra mundime ta shpëtojnë mbretin e tyre, trashëgimtarët dhe disa prej ministrave.

Pas të gjitha tensioneve, mbreti Petar me një pjesë të bashkëpunëtorëve të tij ka ardhur në Krujë dhe si çdo i dështuar, i ka dërguar lutje Esad Pashës t'i dërgojë njerëz të besuar që ta sigurojnë rrugën Krujë – Tiranë. Esad Pasha e ka plotësuar kërkesën e mbretit Petar, por atë mbrëmje i ka thërritur bashkëpunëtorët nga Tirana në terasën e tij, se mbreti Petar i lutet atij dhe gjatë tërë natën me bashkëpunëtorët ka luajtur valle.

Të nesërmen Mbreti Petar, i ngarkuar me një karrocë, ka mbërritur në Tiranë dhe ishte pritur nga vllah të krishterët, në kishën në të cilën ka mbajtur fjalim, e cila nga shumica e shqiptarëve ishte e kritikuar. Ditën e njëjtë, me karrocën e njëjtë ishte i përcjellë për Durrës, ku e ka pritur anija me avull.

Gjatë tërë kohës së luftës e tërë Shqipëria ishte e okupuar: në veri të lumit Vjosë nga bullgarët dhe austriakët, dhe në jug të Vjosës nga italianët dhe francezët.

Gjatë gjithë asaj kohe Esad Pasha ishte në kampin e selisë dhe llogaritej si aleat i selisë. Meritën më të madhe, të cilën ai e llogariste se i ka përpara forcat e selisë, veçanërisht për Francën e kishte atë, se gjatë vitit 1915 përfaqësuesi bullgar në Shqipëri Todor Pavllov, pasi që i lajmëroi që do t'i bashkëngjitet në favor të aleatëve, e ka ftuar Shqipërinë që përkrah tij të bëhet aleat i Bullgarisë, Esad Pasha menjëherë e ka informuar presidentin e Francës. Me këtë meritë, Esad Pasha lufton në konferencën e Parisit, si aleat, që të përfitojë diçka më shumë për Shqipërinë, por serbët i kontestojnë çdo meritë të tij, siç tregonin, se personalisht ai është

mbajtur korrekt dhe i ka mbajtur premtimet, por popullit shqiptar i ka shkaktuar të këqijat më të mëdha.

Pas peripecive të llojllojshme dhe rreziqeve, shteti i tashëm shqiptar mund të mbahet vetëm falë Ligës së Popujve.

Shqipëria e sotshme

Shqipëria e sotshme ka rreth 40.000 m² hapësirë. Ajo kufizohet në lindje me malin e Sharrit, malin Rudoka, lumin Drini e Zi, liqenin e Ohrit dhe malin Suha Gora. Në veri fillon nga shtrati i lumit Buna, liqenit të Shkodrës, dhe shtrihet deri në majën Komë (2465 m.) dhe majë Shkëlzen (2295 m.). Në jug kufizohet me malin e Gramozit, Tumbës dhe përfundon në brigjet e bregdetit, përballë Korfusi, kurse në perëndim me detin Adriatik.

Në këta kufij, sipas numërimeve të fundit në Shqipëri ka 831,877 banorë. Me religjion përcaktohen kështu: 1) Myslimanë 584,677, 2) Të krishterë 158,215, dhe 3) Katolikë 88,987. Bashkësia fetare e myslimanëve është e pavarur. Ajo e shpalli pavarësinë më 14. 1923 në Kongresin e mbajtur po atë ditë në Tiranë. Prijësi i myslimanëve është myftiu me dy ndihmës dhe tre këshilltarë të cilët u zgjodhën në kongres.

Në kongresin e fundit për myfti kryesor u zgjodh Vehbi Dibra; ndihmës të tij Vejsel Libohova dhe Hafuz Aliu, kurse këshilltarë Hafiz Adem Vehci Baba, për religjionin e sektit Bektashi dhe Sheh Ibrahim Karbunara për Sunitët. Drejtor i vakëfit u zgjodh Sali Hoxha Vuçitëri.

Kisha ortodokse shqiptare ishte autoqefale. Ajo e bëri pavarësinë me 13. IX. 1922 në asamblenë kishtarë e cila u mbajt në Berat. Për argjipeshkëv në atë asamble u zgjodh prifti Vasili.

Shpallja e pavarësisë së kishës ortodokse shqiptare si autoqefale, ishte lajmëruar nga qeveria dhe ishte e mirëpritur dhe përsëndetur fuqishëm. Njëkohësisht telegrame do t'i dërgoheshin dhe Patriarkut të Gjithësisë në selinë e kryepeshkopit. Një pyetje dërguar papritur, Patrikana e Shenjtë, e cila duhet të përgjigjet me Po ose Jo, kërkoi që t'i paraqitet në Stamboll një delegacion nga asambleja e kishës nga Berati që të miratojë vendimet e mara.

Atë vendim të asamblesë të Beratit e futi Patrikanën në një fakt të kryer. Ajo duhej ose ta pranojë pavarësinë e kishës shqiptare, ose të veprojë sikur me kishën Bullgare, të cilët i quajtën si të përjashtuar. Nga praktika, Ati i Shenjtë në selinë e tij nuk mund të pranojë as njërën e as tjetrën. Dikush e hutonte Patrikanën, se ajo nuk është dëshirë e popullit, por është bërë me urdhër të qeverisë; për atë shkak, llogaritën që delegacioni i cili do të shkonte në Stamboll, do të përbëhet nga grekë të pastër të cilët do ta sjellin të vërtetën. Për udhëheqës të delegacionit u zgjodh prifti Vasili, i cili me prejardhje ishte nga Kolonja, dhe ishte patriot dhe nacionalist i madh. Gjyshi Vasili, në krye të komisionit të dëshiruar nga Patrikana, udhëtoi drejt Stambollit, u paraqit para pleqve udhëheqës fetarë dhe e shpalosi vendimin e marrë në asamblenë në kishën e Beratit. Patrikana nuk mund t'i pranojë kërkesat e asamblesë kishtarë të Shqipërisë. Përgjigjja e patriarkut dhënë Gjyshit Vasili dhe komisionit ishte: do të dërgojmë një Mitropolit që të vjen në Shqipëri ta shohë në vend punën dhe ta shpalosë vendimin e marrë nga Patrikana e Shenjtë. Vërtet,

menjëherë pas largimit të delegacionit shqiptar, Patrikana dërgoi një nga argjipeshkvit e Stambollit që të vjen në Shqipëri, me instruksionet që iu dhanë atij, që ta shëtisë Shqipërinë dhe ta njoftojë popullin e krishterë ortodoks për vendimin e Patrikanës. Argjipeshkvi i Stambollit Jerotei erdhi në Shqipëri dhe në javën e parë u paraqit në kishën e Korçës, dhe pas liturgjisë, njoftoi popullin ortodoks shqiptar dhe para delegatëve të të gjitha kishave ortodokse. Foli shkurt dhe qartë dhe pa asnjë variacion mbaroi me fjalët: “Madhëria e tij Shenjtëria e Gjithësisë Patriarke më dërgoi që t’ju lajmëroj: se Patrikana e Shenjtë plotësisht e njeh pavarësinë e kishës ortodokse shqiptare”.

Populli brohorit dhe e lut që të mbetet për mitropolit në ndonjë nga eparkitë në Shqipëri (ai argjipeshkëv ishte shumë i njohur në rrethin e shqiptarëve ortodoksë, se me prejardhje është shqiptar, të cilën edhe ai vetë e deklaroi).

Grekomanë të llojllojshëm, të turbulluar nga akti i Patrikanës, i dërguan protestë asaj. Selia e Patrikanës menjëherë e mohoi atë, dhe tha se ajo e ka caktuar atë mision të Argjipeshkvit Jerotej, dhe atë e thirri në Stamboll. Jerotei si patriot i mirë shqiptar mbeti në Korçë, duke mos i kushtuar vëmendje kërcënimeve të Patrikanës.

Kisha ortodokse shqiptare, duke mos i kushtuar vëmendje seriozizme për sjelljen e Patrikanës ndaj Shqipërisë, kërkoi që të ketë Kryepeshkop të vetin, por për të pasur atë duhej të ketë arhierë. Ajo u mundua të gjejë në çdo vend njerëz të duhur për punë të tilla. Ajo në mënyrë indirekte e pyeti Kryepeshkopin serb, nga i cili ishte refuzuar. Donin që t’i drejtohen dhe Kryepeshkopatës bullgare, por kishin frikë se Patrikana mund që para masave të agjitonte se janë bërë skizmatikë. Pas një kohe të gjatë, donin që t’i referohen Atit të Shenjtë rus, por për të nuk kishte asnjë mënyrë, për shkak se Shqipëria dhe Rusia nuk kishin asnjë marrëdhënie. Për fat të Shqipërisë, në kohën kur Greqia pësoi katastrofë të plotë në frontin aziatik, Patrikana në atë kohë ishte e gjysmëshkatërruar dhe kisha shqiptare u ngjallë dhe vazhdoi të ekzistojë si e pavarur.

Katolikët vareshin nga Vatikani, argjipeshkvi i tyre jeton në Shkodër, kurse pesë peshkopët jetonin në vende të ndryshme në pjesën veriore të Shqipërisë.

Pjesa më e madhe e myslimanëve ende nuk mund të çlirohen nga ndikimi i kalifatit turk, sikurse edhe ortodoksët nga klerikët ortodoksë nga selia e Patrikanës. Sikur të njëra ashtu edhe të pala tjetër kishte nacionalistë të mëdhenj, të cilët luftonin për çlirimin e popullit shqiptar nga kalifati, po ashtu edhe nga Patrikana. Katolikët ishin të përbërë nga klerikë shqiptarë nacionalistë të vetëdijshëm, të cilët për vite të tëra punojnë me zell të madh për prosperitetin e kauzës kombëtare shqiptare. Klerikët e parë katolikë ishin ndër shkrimtarët, poetët, gazetarët dhe krijuesit e parë të letërsisë shqiptare. Një ndër luftëtarët e mëdhenj në këtë drejtim ishte dhe mitropoliti ortodoks nga Durrësi, Fan Noli.

Pavarësisht fanatizmit fetar, të formuar gjatë shekujve, myslimanët kundër ortodoksëve apo ortodoksët kundër myslimanëve, mund të thuhet se pranimi e fesë në Shqipëri është relativisht i madh. Shefat e të tre religjioneve: mysliman, ortodoks dhe katolik si dhe politikanët paqedashës dhe burrat intelektualë, me të gjitha forcat, mundohen të krijojnë sa më shumë tolerancë fetare. Ngaqë e gjithë kjo buron nga shkollat, ku lënda nga historia e kishës, teologjia, shkrimi i shenjtë,

të mos i bezdisë nxënësit nga të tre religjionet të cilët mësojnë në një klasë të njëjtë, si lëndë mësimi nuk hyri në programin e mësimi javor, të cilën duhej ta mësojnë një orë në javë. Për këtë material fëmijët myslimanë çdo të premte pasdite shkojnë tek hoxha në rrëfim, kurse fëmijët ortodoksë shkonin çdo të diel pasdite tek prifti. Është interesante që të dihet, se as myslimanët dhe as ortodoksët nuk kishin dijetarë inteligjentë për rrëfim. Më të aftë në këtë fushë janë katolikët, por ata jetojnë vetëm në një pjesë veriore të Shqipërisë.

Derisa një hoxhë mysliman nuk ulet në lëkurën e deles të shtrirë në tokë dhe nuk ka se çfarë të rrëfejë nga kurani, dhe derisa prifti i vjetër qytetar apo fshatar revoltohet se flet në gjuhë tjetër përpos greqishtes me ligj të Zotit, sikurse hoxha – në turqisht, e katolikëve është me plot kuptimin e fjalës pedagogjike dhe përmes lëndës së ligjit të Zotit rrëfen nacionalizmin. Shumicës së miqve të mi mund t'u vijë keq, por ky është fakti.

Që të ketë tolerancë të madhe fetare, shumë mirë janë klasifikuar festat oficiale shtetërore dhe fetare. Tash për tash e vetmja festë shtetërore është shpallur 28 Nëntori. Festat fetare janë me ligj: madje për myslimanët është e premtja, kurse për ortodoksët e diela, për të mos patur dy ditë pushim në javë, për ditë oficiale javore llogaritet e premtja dhe e diela pasdite. Të dy ditët paradite janë ditë pune. Festat e tjera fetare janë: dy ditë bajrami, dy ditë kurban bajrami – gjithsej katër ditë për myslimanët. Dy ditë krishtlindjet dhe dy ditë pashkët – për të krishterët. Po ashtu dy ditë pashkët dhe dy ditë krishtlindjet për katolikët.

Toleranca fetare në religjionet: krerët dhe pjesëtarët oficiale, në festat zyrtare të gjithë së bashku shkojnë në kishë, apo në rast të bajramit në xhami.

Fanatizëm të religjionit në Shqipëri nuk ka pasur. Ajo u krijua nga turqit në vitet e fundit të qeverisjes së tyre. Me mundim të madh ata patën sukses që të krijojnë asisoj në qendra të mëdha.

Por religjioni në fshatra gjatë regjimit turk shihej vetëm si parti politike e Ballkanit. Nga kjo pikëpamje të masave fshatare i ka detyruar që të jenë joreligjiozë. Në shumë fshatra do të hasni shtëpi, ku nga dy vëllezër njëri është mysliman, kurse tjetri ortodoks. Nuk kam dëshirë që t'i cek me emra, por ata kanë jetuar bukalisht ashtu: kur turqit e kanë ndier veten më të fuqishëm, ata që e kanë mbajtur emrin mysliman, kurse me të atit shumica janë të krishterë, është paraqitur si i pari i shtëpisë, nëse është nga një familje e njohur, si perfekti i fshatit, nëse është nga familjet e para si bajraktari i një fisi dhe anasjelltas, kurse kur qeveria ruse, austriake apo papa ishin më të fuqishëm, atëherë vëllai i krishterë bëhej i pari. Bukalisht ashtu, siç shohim sot në Bullgari dy vëllezër çorbaxhi, në një vend dhe në një punë të njëjtë, në një situatë të njëjtë sociale dhe ekonomike, njëri është popullor, kurse tjetri liberal, siç ishte para disa viteve, kurse sot njëri është orator, kurse tjetri është bujk ose komunist.

Nuk dua të bëj lëshim në një faktor të madh, i cili luan një rol për besimin fetar shqiptar dhe progresin për pavarësi: ata janë udhëheqësit shpirtërorë të sektit mysliman të Bektashinjve, të cilët kanë luajtur dhe luajnë një rol të madh politik dhe arsimor, e ngjashme me udhëheqësit shpirtërorë katolikë në Shqipërinë Veriore, kurse ata në jug të ashtuquajtur protestantë myslimanë, të cilët ishin më liberalë në predikime, e edukojnë dhe udhëheqin masën në Shqipërinë jugore. E

rëndë është që të mësohet doktrina e tyre, megjithatë nga predikimet dhe sjelljet e tyre shihet qartë se ata udhëheqin një ndër religjionet më liberale fetare, me ideale të larta humanitare. Në ballë të atij sekti të religjionit mysliman, të ashtuquajtur bektashi, qëndrojnë dervishët, të ngjashëm me kallogjerët tanë, të cilët jetojnë në manastire, të ashtuquajtur teqe. Ata nuk janë të martuar. Në përgjithësi, dervishët në Shqipëri janë mjaft inteligjentë, nga natyra të mençur, nga familje të njohura dhe me rrëfimet e tyre në popull paraqiten si të mençur. Ndër disa nga ata ka edhe fakirluk. Me mrekullitë e tyre e magjepsin popullin.

Në Shqipëri ka më shumë se 40 teqe bektashiane, vendtakim për dervishët. Shumica e atyre teqeve ishin të plaçkitura në kohën e regjimit të Haxhi Qamilit, nën presionin e myftinisë së Tiranës, por më pas shumica e tyre u meremetuan dhe u mirëmbajtën. Në kohën e regjimit turk, ato ishin në gjendje shumë të mirë dhe mjaft të organizuara. Ato shërbenin për fidanishte të mëdha për fruta dhe ishin shtëpi të mëdha për edukatë dhe strehimore për nevojtarët, por tash janë materialisht të nevojshëm, sepse të gjitha burimet e tyre janë të mbyllura. Ato mbaheshin nga lypja dhe dhurata nga Maqedonia, Epiri dhe Shqipëria. Dervishët nuk mundën të shkojnë as në Maqedoni, as në Epir, kur besimtarët dhe haxhinjtë shqiptarë janë bashkuar. Bektashinjtë – dervishët janë njerëz të mirë, patriotë dhe nacionalistë.

Shqiptarët si popull

1. Në Shqipërinë ë sotshme të lirë.....	831.877
2. Në Kosovë e mbetur në brendi të Serbisë.....	560.000
3. Në Maqedoni (nën serbët dhe grekët).....	173.000
4. Në Greqi të vjetër (të ikur nga zullumi turk) në Kornitia përreth Athinës dhe tash të pushtuar në Epir dhe Çamëri.....	350.000
5. Në Itali (Sicili, Kalabri dhe Pulja).....	250.000
6. Në Turqi (sipas gazetës Populli nga 5.V.1823).....	150.000
7. Në Rusi (sipas fjalëve të delegatit K. Boshnjak).....	15.000
8. Në Rumani.....	15.000
9. Në Dalmaci (në qytetin Zarë).....	5.000
10. Në Egjipt.....	5.000
11. Në Amerikë (mendoj se është e ekzagjeruar).....	45.000
12. Në Bullgari.....	5.000

Totali	2.404.877
--------	-----------

Shënim. Llogaritet se, në kufijtë e sotme të Shqipërisë së lirë ka disa dhjetëra mija të paregjistruar. Ata e mbulojnë ekzistimin e tyre, me traditë dhe ndër shekuj, për të mos shkuar në ushtri dhe për të mos paguar tatime.

1. Shqiptarët e lirë në kufijtë e Shqipërisë së sotme.
2. Shqiptarët e robëruar pas luftës nga grekët dhe serbet, dhe
3. Shqiptarët, të cilët për shkaqe politike e kanë lëshuar vendlindjen.

Kategoria e parë e shqiptarëve, d.m.th. sot që janë të lirë dhe të pavarur, shpejtë rigjallërohen, mundohen për përparimin e vendit, luftojnë për ta ruajtur pavarësinë e tyre, duke mos mundur që tu ndihmojnë të dy kategorive të shqiptarëve, sepse janë ndier shumë të dobët moralisht dhe materialisht. Ata, me shikimet politike, ndahen në disa parti.

Kategoria e dytë e shqiptarëve – robërit mbas lufte, njëjtë fillojnë të ringjallen dhe të tregojnë interes politik, ku ajo i mundësohet, dhe ku ka pasur kushte politike. Deri më tani ajo është shfaqur më dukshëm në Jugosllavi, ku janë shfaqur si një grup deputetësh nën emrin “xhemiet”, emri ishte shkak se ndër ta ka pasur disa turq, që serbët i kanë akuzuar se ata kanë qenë turq bukvalisht ashtu, si një kohë, para luftërave, kur xhonturqit donin që t’u imponohet dhe të llogariten për turq. Sipas kuptimeve të mia, kjo thjesht nuk është e saktë. Pikërisht ata janë krijuesit më të mëdhenj nacionalist shqiptarë, të cilët nuk u ndalën të luftojnë për rilindjen shqiptare dhe kombëtare. Për fatkeqësi, sikur maqedonasit, të cilët nuk kishin të drejtë të kenë patri politike të veten, ashtu edhe shqiptarët nga Kosova dhe Maqedonia, nuk kishin të drejtë të kenë të drejtë për të votuar, të kenë klube të tyre politike dhe vetë t’i paraqesin të zgjedhurit e tyre. Tek populli maqedonas i cili është më demokratik dhe i edukuar nga një organizatë revolucionare që vepron 30 vjet, u shfaqën disa njerëz të zgjuar, për t’i penguar ata serbët, i quajtën me emrin Komitet.. Të njëjtën gjë e bënin edhe me shqiptarët të cilët i quanin Kaçakë. Qeveria e Serbisë, që të mund t’i shtypë çdo lloj të zgjuarsisë, i shfrytëzonte fjalët e lartpërmendura – komitë dhe kaçakë. Ndër maqedonasit – bullgarë të parët për zgjedhjet i futën me detyrim e forcë kandidatët më të urrejtur dhe më të shitur, të cilët populli i quante “spiunë”, kurse të dytit – qeveria e Serbisë zgjedh, si kandidatë pronarët e çifligut, të drejtat e të cilëve për të sunduar me tokat e tyre, edhe sot nuk janë vendosur. Atyre u thuhet: përmbani qeverinë, ajo do t’ju përmbajë për të drejtat e bujqve. Populli shqiptar, i cili është një ndër më demokratikët, e di mirë që të zgjedhurit e tyre janë nga qeveria, dhe jo nga populli, i urren të zgjedhurit dhe nuk është ndalur duke luftuar ashtu siç lufton dhe maqedonasi bullgar. E mjaftueshme është që të citojmë vetëm gazetatat qeveritare serbe për ndodhitë në Kosovë të kaçakëve, për betejën e fundit në Manastir etj.

Populli shqiptar nga Kosova, Maqedonia që të mund të përfaqësohet në parlamentin serb nga përfaqësues të ngjashëm, të zgjedhur nga vetë qeveria, siç janë: Kemal bei Kumbaxhi nga Shkupi, Abdurahman beu nga Tetova, Kenan beu nga Manastiri, etj., një rol të madh ka luajtur edhe qeveria tiranase e bejlerëve, e cila ishte përfundimisht serbofile.

Fakti që këta “përfaqësues të popullit” nuk janë ndalur së përmbajturi qenërinë e Pashiqit serb edhe sot, si opozitë përballë tyre është e tmerrshme, megjithatë, se ajo qeveri në reagimin serb shfarosi dhe i boshatisi qindra fshatra në Kosovë dhe Maqedoni, shihet qartë se këta përfaqësues të popullit luftojnë për fermat (çifligjet) e tyre, dhe jo për popullin e robëruar shqiptar, i cili nuk mund ta dëgjojë emrin serb, dhe me emërtimin “kacakë” jeton nëpër male. Populli shqiptar gjatë dhjetë vjetëve të fundit reagon për mrekulli përballë armiqve dhe okupatorëve. Ai dha aq shumë viktima, që edhe ekzekutuesit më të këqinj gjatë shekujve më të errët nuk kane parë kështu. Jo fshatra, rajone të tëra ishin të boshatisura, fëmijë dhe gra ishin të therur – akte mizore, të cilat bota rrallë i ka parë.

Unë kisha dashur që përfaqësuesi e Zvicrës, profesori Rais, që të bëjë pak mundim dhe ta shëtisë Kosovën dhe Maqedoninë, që të shohë se cila është domethënia e njeriut nga Shumadia dhe pushteti i Pashiqit, të cilit i shërben verbërisht, si njeriu shkencës, si bir i vendit, që me shekuj luftoi sikur ne dhe sot shërben si model për Evropën, të mundohet pak, që të shkojë në administratën komunale të fshatit Slatino – rrethi i Ohrit, ta ftojë kryetarin e komunës ose dikë nga prefektët e rrethit, që t’i tregojnë ku gjendet fshati Pesoçani, po nga kjo komunë. Pasi ta ketë gjetur, nuk ka nevojë të pyesë se kush i ktheu muret mbrapsht, dhe ku janë banorët e këtij fshati? Profesorit inteligjent z. Rais, unë i deklaroj, se banorët e këtij fshati i cili numëronte 175 shtëpi, burra, gra dhe fëmijë, thjesht janë therur deri në një nga ushtarët serbë gjatë vitit 1920, pasi aleatët i shpallën si më të kulturuar dhe dominues në Ballkan dhe kafkat e banorëve nga ky fshat, kuptohet se edhe të foshnjave të porsalindura, mund t’i gjeni në burimin e thellë, në mes të fshatit. Atë e kanë parë shqiptarët, përfaqësues e të cilëve në Beograd e përmbajnë programin e ekzekutuesve. Përse?!!!!

Përfaqësues të vërtetë të shqiptarëve të robëruar, të cilët luftonin për të drejtat e tyre, ishte i njohuri Bajram Curri, por ai përfaqësues, me të cilin janë gati të vdesin të gjithë shqiptarët e robëruar, nuk është as në Beograd e as në Tiranë, por diku në bjeshkët e Kosovës dhe në moshë të vjetër (ai është 70 vjeç) me armë në dorë qëndron për të drejtat e popullit.

Kategoria e tretë e shqiptarëve, shqiptarët të cilët jetojnë në vendet e huaja, mund të ndahen në dy kategori:

1) Shqiptarë, që me shekuj e kanë lëshuar Shqipërinë, të cilët janë sot në Itali, Greqi dhe Dalmaci ...dhe

2) Shqiptarë, të cilët kanë emigruar para pak kohe, në Amerikë, Bullgari, Rusi, Rumani, Turqi dhe Egjipt.

Kategorinë e parë e kanë mbajtur pjesërisht nga karakteri, zakonet dhe adetet, por në shumë vende kanë humbur pjesërisht gjuhën. Asisoj janë shqiptarët, të cilët jetojnë në Greqinë e vjetër, të nxitur nga shkollat greke dhe kishat (ata janë të gjithë të krishterë).

Ata kanë humbur vetëdijen nacionaliste dhe veten e llogaritnin si grekë.

Lirinë më të madhe nacionale ndër shqiptarët e kanë shqiptarët të ikur e të cilët jetojnë në Itali. Ata plotësisht e kanë ruajtur gjuhën, traditat popullore dhe

karakteret. Në Itali ka përparim dhe zhvillim të kulturës shqiptare. Veçanërisht në kohën e luftës së madhe, kur italianët dhe austriakët garonin se cili prej tyre të paraqitet si miku më i madh i shqiptarëve, italianët i kanë edukuar shumicën e shqiptarëve në artin ushtarak dhe në lloje të ndryshme të shkencës.

Kategoria e dytë e shqiptarëve të cilët jetojnë në Amerikë, Rumani dhe Bullgari janë treguar si të përshtatshëm për përparimin kombëtar. Në këto vende ata ndjeheshin më të lirë sesa në shtëpitë e veta, filluan të formojnë shoqata, botonin dhe akoma vazhdojnë të botojnë gazeta, revista, broshura etj. Prej viteve 1893 shqiptarët në Bullgari formuan shoqatën në Sofje dhe në qytete të tjera, të cilat llogariten si shoqatat e para shqiptare. Në Sofje hapën shtypshkronjë, e cila llogaritej një ndër të parat shqiptare. Me asisoj lirie shqiptarët ndjeheshin edhe në Rumani dhe Amerikë, ku dhe sot botojnë revistat dhe gazetat e tyre.

Organizimi shtetëror

Shqiptarët, pas pushtimit nga Turqia, pjesa më e madhe e pranoi fenë myslimane dhe gjatë shekujve, kur populli i krishterë në ballkanet vuanin nën robërinë turke, Shqipëria llogaritej si një autonomi, me një lloj të organizimit dhe me zakone të ruajtura të vjetra tradicionale. Gjatë vitit 1912 kur populli i krishterë i dëboi turqit nga ballkanet, me vendim të Konferencës së Londrës, Shqipëria mbeti si shtet i pavarur i ndarë dhe i vogël ballkanik. Asambleja Kombëtare e Parë në Shqipëri, në pika të shkurta përcaktojnë statutet e shtetit të ardhshëm. Shqipëria u bë një monarki konstitucionale dhe për kryesues u zgjodh princi gjerman Vidi. Pas largimit të tij nga Shqipëria, vendi mbetet të udhëhiqet nga 4 rajone, të zgjedhur për 4 vjet, nga të cilët dy të jenë nga besimi mysliman dhe dy të krishterë, nga të cilët njëri katolik kurse tjetri ortodoks. Pushteti suprem legjislativ në Shqipëri është asambleja kombëtare. Deputetët në Asamblenë Kombëtare të Shqipërisë zgjidhen me një sistem dyfishor (kopje nga sistemi zgjedhor turk), në 10.000 veta një. Shqipëria administrativisht ndahet në 9 qarqe. Ato janë: Shkodra, Durrësi, Elbasani, Kosova, Dibra, Berati, Vlora, Gjirokastra, dhe Korça. Qarqet ndaheshin në disa rrethe, kurse këto të fundit jo në bashki por në rajone, ose të ashtuquajtura në turqisht “mydyrlluke”. Pas shpërndarjes administrative plotësisht është marrë ligji turk. Vilajetet u përjashtuan, sepse Shqipëria shpërndahej në tre vilajete dhe hynte në zgjedhje me të turkut: i Shkodrës, Manastirit dhe i Janinës, nga këto njëri mbetet – i Manastirit nën Serbi, i Janinës nën Greqi, dhe pjesë të saj në Shqipëri, si dhe pjesë të atij të Shkodrës mbeten në Serbi.

Në Shqipëri njerëzit, të cilët udhëheqin qarqet dhe rrethet, shefat, drejtorët, dhe drejtuesit të tjerë janë mjaft të përgatitur. Vetëm mund të thuhet se zyrtarët administrativë në Shqipëri mbahen shumë më lart nga të njëjtat në shtetet ballkanike. Ata janë të gjithë të vjetër dhe të testuar nga ish- administratorë nga monarkia turke. Në Shqipëri ka 3600 veta xhandarmeri dhe 9 çeta këmbësori. Xhandarmeria ka, mund të thuhet, shumë e mirë, ajo është e përbërë nga instruktorë të huaj dhe me baza moderne. Ashtu nuk është në ushtri. Të gjithë oficerët të cilët kanë dalë nga shkolla turke, janë me përvojë dhe shumë inteligjentë, ndërsa oficerët e ulët janë krijuar për “një kupë groshë” nga italianët, francezët dhe austriakët. Secili i trajnonte ushtritë, ashtu siç ka mësuar, për atë shkak nuk ka unitet. Në një

njësi mund të shihni tre toga të marshojnë në mënyra të ndryshme. Oficerët e lartë kishin formuar ushtri më të mirë, por për fat të keq, në një anë të vogël, ata janë më shumë se sa ka nevojë, dhe e dyta të gjithë janë ngatërruar në parti politike.

Armatimi i ushtrisë ishte shumë i dobët. Ai përbëhej nga pushkë që kanë mbetur nga austriakët dhe italianët. Buxhetin modest që e kishte Shqipëria nuk e lejonte për të blerë armatim të ri.

Organizata shëndetësore ishte shumë e dobët, për shkak të mungesës së barnave. Në tërë Shqipërinë ka rreth 50 veta me shkollë të medicinës, shumica e të cilëve kanë mbaruar shkollë në Stamboll. Tri sëmundje, pikërisht: tuberkulozi, sifilizi dhe malaria pa mëshirë shpartallojnë popullin. Në qendrat e mëdha kishte disa barnatore modeste. Për ndihmë medicinare apo barnatore nëpër fshatra as nuk bëhej fjalë. Sëmundja më e tmerrshme, të cilën asnjë mjek nuk mund ta kuronte, ishte sherja nga uria dhe të ftohurit nga lakuriqësia.

Sistemi gjyqsor

Sistemi gjyqsor në vend është një ndër më të rregulltit. Në çdo qendër të qarkut ka gjykata paqësore, kurse në çdo qendër rajonale, ka gjykatë të rrethit. I tërë shteti ka një gjykatë të lartë. Gjykatësit janë njerëz me shkollë juridike, disa prej tyre nga ish- perandoria turke, dhe me përvojë të madhe. Tani ata e përdorin ligjin turk, me disa përshtatje ndaj kushteve lokale. Si çdo popull i porsaçliruar do që të tregohet para botës së kulturuar dhe para atyre që i ndihmuan për çlirimin e tyre, se janë mjaft të pjekur për një jetë të pavarur, ashtu edhe drejtësia shqiptare, lufton përballë traditave dhe ligjeve vendore dhe fisnore, duke dëshiruar për t'i vënë ato në rrugën moderne dhe kërkohet nga kombet kulturore dhe të interesuar të tillë.

Suksesi i gjyqtarëve shqiptarë ishte më se e kënaqur. Edhe pse ata gjyqtarë, të ngarkuar me atë detyrë të rëndë, që të kenë punë me popull, ku përqindja e analfabetëve është jashtëzakonisht e madhe, popull i cili me shekuj nuk ka parë asnjëherë gjykatë, dhe nuk i ka njohur, popull i cili edhe për krime më të rënda nuk u paraqitej para gjykatës, por me disa zakone tradicionale vetëm është grindur, gjykatësit e sotëm shqiptarë, të quajtur luftëtarët e drejtpërdrejt të ligjit modern, kanë mbërritur më aftësinë e tyre deri aty ku sot krimi në Shqipëri, duke i barazuar më cilindo shtet të Ballkanit, është më minimal.

Për të mundur drejtësia në Shqipëri ta mbërrijë atë lartësi, jo pak i ka shërbyer dhe xhandarmeria dhe policia, si dhe shefat rajonalë, ta cilët ishin zgjedhur për shkak të përvojës së madhe shumëvjeçare, si nëpunës administrativë, ose si njerëz të cilët ishin popullorë në rajonet ku ata udhëhiqnin. Shumica prej tyre janë njerëz nga familjet bajraktare.

Kryeqyteti i Shqipërisë

Kryeqyteti i Shqipërisë është Tirana, e shtrirë në fushën e malit të Dajtit. Emri Tiranë përbëhet nga dy fjalë: Tir dhe Han. Tir në shqip d.m.th. fill. Pas shkuarjes së turqve atje, ku tash është ndërtuar Tirana, ka pasur disa hane, ku në ditë të caktuara për çdo vit kishte panair të filleve nga jugu dhe veriu dhe Shqipëria e mesme. Tiranasi thonë se ai lokalitet i populluar ashtu e ka marrë emrin, që të

quhet Tir – Han, e cila me shkurtesë është quajtur Tir – Anë , ose siç quhet sot Tiranë. Pas regjistrimit të fundit të popullsisë nga turqit në Tiranë, ai qytet ka pasur 2373 shtëpi, 5395 popullatë të meshkujve, 5383 popullatë të femrave, gjithsej 10.778 veta. Sot Tirana mund të ketë ndoshta rreth 15.000 veta. Popullsia në Tiranë, para se ajo të bëhet kryeqytet, ka qenë e shfrytëzuar nga myslimanët. Vetëm rreth 200 shtëpi vllersh kanë ardhur nga Maqedonia, e kanë fenë ortodokse dhe kanë dy kisha.

Rrugët janë të ngushta dhe të shtrembëruara. Qyteti është i shtrirë në hapësirë të madhe. Çdo shtëpi është e ndarë nga tjetra dhe në mes tyre ka kopshte të mëdha. Vetëm në qendër, ku jetojnë të krishterët, janë ashtu të dendura, ku të gjitha shtëpitë janë nën një kulm. Kjo ngufatje e të krishterëve mund të shpjegohet vetëm me këtë, se ata e kanë bërë nga frika e madhe.

Përveç disa shtëpive të bejlerëve (ata të Toptanit), të cilat vitet e fundit janë shkatërruar, të gjitha shtëpitë e tjera u ngjajnë kolibeve, janë në dy pjesë të ndara: një dhomë e vogël dhe një han i vogël.

Rrallë mund të shihet ndonjë godinë e ngritur me më shumë se një etazh. Nëse ka asisoj, ajo është vetëm një dhomë e ngritur mbi kulm, të cilën shqiptarët e quajnë kullë. E bukura e Tiranës është se çdo shtëpi rrethohet nga një kopsht i madh, por për fat të keq, vetëm shkurre dhe hitha.

Tirana është e pasur me ujë. Në të gjitha rrugët rrjedhin përrenj, mirëpo qytetarët e Tiranës vuajnë më së shumti për ujë. Uji nuk është i kanalizuar dhe i lan të gjitha ndyrësitë e qytetit, për atë çdo qytetar i Tiranës është i detyruar të hapë një pus të thellë para shtëpisë dhe të pinë ujë të gëlqeruar, siç është ajo e pusit. Ka disa ndërtesa të porsandërtuara, dhe ato të janë të zëna nga institucionet shtetërore. Qyteti është i zhytur në gjelbërim. Aty lulëzojnë ullinj, limona, portokalle, fiq, shegë dhe rrush, por dora e njeriut sikur nuk i ka prekur. Njëqind metra larg qendrës, të dy anët e rrugës i rrethojnë thanat dhe manaferrat. Tirana është 42 km. larg nga deti. Me 121 m. lartësi mbidetare. Klimën e ka të butë, por nuk është higjienike për shkak se gjatë vjeshtës, dimrit dhe fillimit të pranverës bien shira tropikalë gjatë disa javëve. Ngaqë nuk ka asnjë kanalizim, formohen moçale të mëdha – foletë e malarie.

Dita e pazarit në Tiranë është dita e enjte. Që nga mëngjesi mbledhen pazarkhinjtë nga i gjithë rrethi. Artikujt kryesorë të cilët i sjellin fshatarët për t'i shitur janë: bagëti, drithëra, por më së shumti perimeve. Megjithëse shtëpitë tiranase janë në mes të kopshteve, qytetari i Tiranës është aq dembel, që nuk mbjell perime, madje edhe më të nevojshmet, të cilat natyra u ka falur, që të ketë çdo kopsht. Ajo që bie më së shumti në sy në pazar, që janë sjellë për shitje zogjtë, pulat, patat, dhe veçanërisht gjetat e detit. Pjesa më e madhe e tyre blihet nga kafexhinjtë, të cilët gjatë gjithë javës therin dhe pjekin për meze bekrijëve të Tiranës. Qytetarët e Tiranës pinë shumë raki. Pije tjetër nuk ka. Megjithëse trualli tiranas është më i miri për vreshta, asisoj nuk ka, sepse si myslimanë, religjioni nuk u lejon që të pinë verë, që këto të fundit e llogaritin në panevojshëm. Monedha që qarkullonte në Shqipëri ishte e arit apo e argjendit, pa marrë parasysh se nga i cili shtet ishte ajo. Shqiptarët nuk kanë ende monedhë të veten.

Tregtarët në Tiranë, me disa përjashtime, janë në miqësi dhe baxhanakë me të Kosovës dhe Dibrës. Këta të parët kanë ardhur shumë më para, kurse të dytët pas luftërave. Tirana mund të bëhet qytet i bukur dhe i pasur. Fusha e Tiranës është më e madhe se ajo e Sofjes. Dheu është një mijë herë më i pasur. Fushat u japin nga dy korrije gjatë vitit edhe atë shumë të pasura. Në pjellorinë më të varfër, njëra jep 40. Delet dy here shumëzohen. Për keqardhje, pjesa më e madhe e kësaj toke nuk është e punuar. Në horizont shihen livadhe, kullosa dhe moçale. Në horizont shihen dhe kodra të vogla me ullinj, por rrinë ashtu si i ka falë Zoti, limonë, portokalle dhe shegë mund të gjendeshin vetëm në shtëpi të bejlerëve. Luledielli nuk mbillet, për shkak se parashikon të keqen në shtëpi.

Tirana është zgjedhur për kryeqytet, si qendër e Shqipërisë, dhe me strategji domethënëse.

Në Tiranë ka dy mullinj me avull, një fabrikë të vogël për sapun dhe disa punëtori për cigare, por çdo shtëpi në Tiranë, duke i marrë ndarazi, përfaqëson një punëtori. Gratë janë shumë punëtore, punojnë këmisha me pëlhura të mëndafshit dhe shalle të ndryshme.

Qytete të tjera më të mëdha në Shqipëri janë: Shkodra, Durrësi, Elbasani, Korça, Gjirokastra, Vlora, Berati etj. Shkodra ka rreth 30.000 banorë myslimanë dhe katolikë. Pjesa më e vogël, të ardhur nga jashtë, janë ortodoksë, për të cilin serbët e përmajnë propagandën e tyre përmes kishës ortodokse dhe shkollës, duke mos u dhënë mundësi qindra mijëra shqiptarëve në territorin e tyre që të përfitojnë nga ndonjë shkollë. Shkodra është qendra më e kulturuar në Shqipërinë Veriore. Më zhvendosjen e qendrës në Tiranë, vitet e fundit, Shkodra e ka mbajtur ekonominë shumë mirë. Shkodra është e shtrirë rreth liqenit të quajtur i Shkodrës, afër lumit Buna, aty ku në të derdhet lumi Drini.

Qyteti i dytë me madhësi në Shqipëri dhe qendra kulturore dhe tregtare për shqiptarët e Jugut – toskët është qyteti i Korçës (ose Gorica). Korça është e shtrirë në fushat e malit Suva Gora, afër liqenit të Maliqit. Ky qytet numëron rreth 25.000 banorë, myslimanë dhe të krishterë ortodoksë. Derisa Shkodra është qendra e katolikëve, Korça është qendra e ortodoksëve. Klima në Korçë është shumë e thatë, sepse Korça është 835 metra në lartësi mbidetare. Qytetarët e këtij vendi merren me tregti dhe bujqësi, por shumica shkojnë në mërgim: Amerikë, Egjipt, Rumania dhe Bullgari.

Gjeografia, flora dhe fauna

Shqipëria në kufijtë e sotëm, me disa përjashtime, thuajse e tëra është e kryqëzuar me male të mëdha dhe të larta.

Në pjesën veriore, nën emra të ndryshëm shtrihen Alpet shqiptare. Në shumë vende ajo mbërrin lartësinë mbi 2000 metra.

Në pjesën lindore të Shqipërisë shtrihet mali i Sharrit, Rudokës, Velebërdës, Jabllanicës, malet e Mokranicës, të cilat lidhen me malin e Gramosit, dhe mbarojnë në jug dhe jugperëndim deri në Adriatik. Shumë nga majat e këtyre maleve po ashtu kalojnë 2000 metra. Si shtrihen degët e maleve nga perëndimi aq dhe vizitohen dhe para se të mbërrijnë në det formojnë fusha të pasura. Të gjithë këto male ndahen nga lumenj të mëdhenj dhe të vegjël, siç janë: Vjosa me degët Sushica

dhe Drin, të cilat marrin ujë thuajse afër Janinës, këpusin Gramosin, vazhdojnë në veriperëndim dhe derdhen në veri, nga Vlora në Adriatik. Lumi i dytë me madhësi është lumi i Devollit. Ai merr ujë nga liqeni i Maliqit, përreth grumbullon shumë degë, rrjedh drejt në perëndim, nga veriu i qytetit të Fierit derdhet në Adriatik. I treti është lumi i Shkumbinit. Ai merr ujë nga malet e Mokrës, afër liqenit të Ohrit, kalon drejt në perëndim mes Elbasanit, e ndan Shqipërinë në veriore dhe jugore, dhe derdhet në Adriatik. Këta lumenj, në jug të Shqipërisë, në shtratin e tyre, ujin fusha të begatshme.

Shqipëria e veriut po ashtu kryqëzohet nga mjaft lumenj të mëdhenj, siç janë: i Erzenit, Lumës, Matit, Drinit dhe Bunës.

Bregdeti shqiptar nuk është i ngjashëm si brigjet e tjera perëndimore Ballkanike, siç janë në Dalmaci dhe brigjet në Greqi. Pjesët bregdetare perëndimore të Shqipërisë janë pothuajse të rrafshëta ose kodrina të buta. Shqipëria pothuajse është malore, pjesa më e madhe merret me bagëti. Para luftërave, blegtorët shqiptarë ishin mjaft të pasur dhe kishin mjaft bagëti, por, pasi Shqipëria ishte disa herë e okupuar nga shumë gjini ushtarake të ndryshme, si e serbëve, grekëve, austriakëve, bullgarëve, italianëve dhe francezëve, me armiqësi dhe me masa të mëdha të ushtarëve, të cilët ishin barrë e pjesës së vogël, thuajse kafshët ishin therur për ushqim të këtyre ushtrive. Sot Shqipëria numëron 1.250.000 dhen të mbetura, po ashtu dhe 1.500.000 dhi. Kafshët e mëdha nuk janë të numëruara, por fakti se fshatarët kanë mbetur pa asnjë bagëti për lëvrim, kuptohet se është zvogëluar në masa të mëdha. Shpresa e vetme për ushqim lokal të shqiptarëve janë zogjtë. Ata zhvillojnë tufa të mëdha me pula, pata, kurse në pjesën perëndimore, përreth detit, dhe rreth shtretërve të lumenjve, rosa dhe gjela deti. Në Tiranë, Elbasan, Kavajë, kisha rast të shoh pulat që bëjnë më së shumti vezë. Fshatarët më bindnin se këto pula japin së paku 200 vezë në vit.

Malet Shqiptare janë përplot me kafshë të egra. Njëra ndër sendet më të vlefshme për të eksportuar është lëkura e kafshëve, megjithëse shoqata e gjuetarëve të Shqipërisë ishte primitive.

Malet në veri të Shqipërisë ishin të mbuluar me pyje të vjetra: pisha, bung, ahu etj., kurse malet në jug të Shqipërisë edhe pse nuk janë me gurrë, pyjet janë thuajse të shkretuara dhe gjithandej shihen kodra të zhveshura.

Rrafshet, rreth detit, assesi nuk janë të shfrytëzuara. Ato janë të banuara shumë dobët, kurse në shumë vende ka asisoj luginash sa që bëhet rruga e pakalueshme. Në këto lugina nuk bie borë dhe nuk ka të ftohët, jetojnë me qindra apo mijëra, në një gjendje të egër kuaj, lopë, buallica dhe derra. Kafshë të dobëta dhe të përpunuara lëshohen në këto lugina, lëvizje të madhe sot bëjnë grupe të mëdha të gjuetarëve të cilët i gjuajnë këto kafshë.

Peshkimi në Shqipëri është shumë i zhvilluar. Më së shumti peshk gjuhet në gjirin e Durrësit. Shumica e peshkatarëve, të cilët gjuajnë peshk në bregdetin shqiptar, janë italianë. Shqiptarët pak e hanë peshkun, për atë të gjithë peshqit që zihen në brigjet shqiptare, shiten në Itali.

Pjesët perëndimore rreth rrafshëve të Shqipërisë, për bujqit e mirë, ishin si kopsht i parajsës në Gadishullin Ballkanik. Ajo pjesë shqiptare mund të furnizojë shumë vende evropiane, gjatë tërë dimrit me perime dhe lule.

Shqipëria nuk është e privuar nga pasuritë nëntokësore, por deri më tani nuk janë kërkuar, kurse ato që janë gjetur, kurrsesi nuk mund të shfrytëzohen, sepse nuk ka rrugë. Në shumë vende në malin e Mokrës, deri në lumin Devoll, udhëtari sheh gurë dhe thëngjill. Po në malin e Mokrës, përreth lumit Shkumbim, ka shtresa të mëdha me azbest. Flitet se afër Vlorës ka burime të naftës. Në 2 km nga Tirana ka thëngjill.

Pasuri për Shqipërinë janë lumenjtë e Shqipërisë me ujëvarat e tyre, të cilat mund të krijojnë prosperitet në ato anë.

Në tërë Shqipërinë shtrihen fushat me ullinj. Vaji më i mirë del nga Berati. Shqipëria bën eksport të madh të vajit dhe ullinjve, që blihen nga tregtarët italianë, të cilët e rafinojnë dhe e shesin si prodhim i tyre. Kjo ndodh sepse në Shqipëri nuk ka fabrika. Në shumë vende në Shqipëri, veçanërisht në perëndim të liqenit të Ohrit, ka pyje të mëdha me gështenja. Hasen mjaft bajame dhe arra. Mirëqenie e madhe për popullsinë e varfër ishin fiqtë, të cilët, për shkak se nuk ka organizim për t'u eksportuar, janë shumë të lirë. Thuajse gjithkund, por në sasi të vogla prodhohej dhe mëndafshi. Në shumë vende në Shqipërinë perëndimore përpunohet orizi dhe pambuku, por më së shumti duhani. Duhani i Shqipërisë nuk mund të shitet jashtë shtetit, sepse pas mbledhjes nuk dinë që ta presojnë. Duhani më i bukur në shikim është i Shkodrës, kurse më i miri mbahet i Elbasanit. Ai përmban shumë silitër, kur pihet lëshon një aromë të këndshme.

Situata ekonomike e vendit

Situata ekonomike e vendit është shumë e rëndë. Burimet kryesore, të cilët e mbështetën jetën në këtë vend në të kaluarën, ishin katër: 1) blegtoria, 2) bujqësia, 3) çifligarët maqedonas dhe epirotë, shumica e fermerëve ishin bejlerë shqiptarë, të cilët punonin në shërbimet qeveritare.

Treguam më lart, se pas luftërave blegtoria ishte plotësisht e shkatërruar. Austriakët, të cilët e mbanin pjesën e Shqipërisë veriore dhe të mesme, duhej të paguanin me korona të letrës, të cilat për një moment, i mbushën qeset e shqiptarëve, pa pasur asnjë vlerë. Po ashtu, përmendëm, se shqiptari mbeti pa asnjë lloj kafshe për të lëvruar, toka punohej shumë pak, kurse në dy vitet e fundit thatësira e madhe nuk dha mundësi që të ketë korrje të mirë të misrit, e cila veçanërisht përdorej në Shqipëri.

Fermerët maqedonas dhe epirotë, të pushtuar gjatë vitit 1912 nga serbët dhe grekët, nën pretekste të ndryshme, nuk u dhanë asgjë deri tani, me zhdukjen e Turqisë nga Ballkanet, të gjitha vendet e punës për shqiptarët ishin të mbyllura. Një pendë kishte prej nga fitonte populli shqiptar, në fakt eksporti i duhanit, kripë të detit, vaj, ullinj dhe lëkura, të cilën e bënë në Maqedoni dhe në Epir. Edhe ata dy pazaret ishin të mbyllur dhe Shqipëria, e cila gjatë kohës turke nuk kishte formuar pazare të tjera, u gjend në izolim të plotë. Dy vitet e fundit ajo ishte e detyruar që të importojë disa milionë kilogram misër. Kjo e solli vendin në një pozitë shumë të rëndë. Sot një kilogram bukë misri kushton 20 – 25 leva bullgare. E gjithë kjo e bënte Shqipërinë për të qarë. Në Shqipëri nuk ka asnjë bankë. Disa këmbyes të të hollave spekulojnë. Të gjitha pasuritë në flori që i kanë pasur njerëzit me influencë, vazhdimisht janë dukë u nxjerrë jashtë shtetit. Sipas fjalëve të një

nëpunësi kompetent në ministrinë e financave, tre vjetët e fundit nga Shqipëria është nxjerrë jashtë shtetit flori me vlerë rreth 56 milionë napoleonë.

Para dy vjetësh, disa delegatë të Lidhjes së Kombeve u mundonin që të tregojnë se Shqipëria nuk mund të mbijetojë financiarisht. Delegatët shqiptarë, duke i siguruar se ajo nuk është e vërtetë, kërkuan që të dërgohet një komision në vend. Asisoj komisioni është dërguar. Për disa muaj komisioni e bredh Shqipërinë, duke e studiuar gjendjen ekonomike në vend. Raportet ishin mirënjohëse për Shqipërinë dhe e bindën Lidhjen e Kombeve se Shqipëria ka mjaft resurse që të mbijetojë financiarisht. Duke u bazuar në raportin e komisionarëve, Lidhja e Kombeve vendosi që të dërgojë Z. Hunger në Shqipëri, ekspertin financiar holandez i cili më parë kishte qenë si organizator i kolonive holandeze, që t'i organizonte financat shqiptare.

Shqipëria megjithëse dështoi që të përmbledhet në kufijtë e saj nacionalë, që t'i ruajë tregjet e vjetra dhe të hapë të reja, do të mund të gjejë të ardhura të mjaftueshme që të mund të jetojë si një njësi e veçantë qeveritare, që të zhvillohet dhe të përparojë, por ajo, pas shkatërrimeve të mëdha të shkaktuara nga luftërat, edhe pasi u bë edhe e nevojshme t'i paguajë edhe trashëgimtarëve turq, pa pasur asnjë trashëgimi, pa kapital të vet, ndërmjet të cilës duhej t'i përpunonte pasuritë natyrore, i duhej të gjente kapital nga jashtë. Ajo deri tani nuk mundi ta bën atë. Ndoshta për këtë janë fajtorë qeveritë e radhitura në Shqipëri, por arsyeja kryesore ka qenë dhe është se qeveria e këtij vendi të vogël nuk u ndal së çudituri se kush nga Forcat e Mëdha çlirimtare do t'i përmbushë dëshirën. Të gjithë e duan bashkëngjitjen, si shtet i ndarë, të gjithë dëshirojnë kush nga kush që të përfaqësohen si shtet mik i vendosur, por para se të gjithash të gjithë i duan burimet e naftës, kodrinat shqiptare dhe fushat dhe fermat e saj. Me një fjalë, të gjithë thonë se e duan pavarësinë e saj, por kërkojnë koncesion. Burrat shtetërorë shqiptarë, të dalë nga shkolla orientale, llogarisin se i kënaqin aspiratat e "miqve" të mëdhenj vetëm kur e përmendin fjalën "olaxhak" (do të bëhet). Forcat e mëdha, kompanitë e mëdha dhe koncesionarët kanë mundësi që të presin fundin e asaj fjalës "olaxhak", por populli shqiptar më mizerjen që e ka kapluar dhe nuk durohet më athua a do të mund të presë? Jo. Gjendja e tij nuk durohet. Çdo popull në Evropë, po të kishte qenë në këtë gjendje, do të mendonte për vetëshkatërrim, ose do të kishi ngritur alarmin që shoqata të ndryshme për ndihmë, me ndihma të ndryshme do të kishte shpëtuar. Populli shqiptar është krenar. Ai atë nuk e bën. Ata rebelohen dhe konsiderojnë se ndryshimi në menaxhimin e njerëzve varet nga pesha e lehtësimit e të padurueshmes. Nuk ka popull tjetër më të durueshëm se ai i shqiptarëve. 95%, që mos të them 99%, ushqehet vetëm me bukë misri dhe atë e blerë tre katër herë më shtrenjtë se kudo tjetër, sepse është kërkesa e madhe, dhe e gjitha transportohet me kuaj, 94% e banorëve ecin këmbëzbathur, pa asnjë këpucë dhe të veshur me rroba të leckosura.

Tregtarët, të stërmбуshur me mitmarrje të mëdha dhe të pabesueshme, e cila është penda e vetme për t'u mbushur buxheti shtetëror, i kanë ndalur të gjitha kontratat afariste. Dy klasë të popullatës mendojnë se jetojnë relativisht mirë. Ata janë feudalët, fermerët dhe zyrtarët.

Të parët feudalët e gjykojnë popullin se është dembel, se nuk punon dhe për atë arsye edhe është i uritur. Është e vërtetë se populli shqiptar është dembel. Për atë punon gruaja, por arsyet që ai të jetë ashtu nuk janë pak:

- 1) Shqiptari, si malazezi, thuajse me shekuj rrinë me pushkë në dorë që ta mbrojnë vendin, nderin e familjes dhe traditat shekullore, kjo i ka larguar nga puna fizike.
- 2) Të edukuar nga feudalët, të varen para derës së shtëpisë, si mbikëqyrës, të bëjnë kafe në konakë, ose të çojnë zjarr për qibukët.
- 3) Uria dhe mizerja, tuberkulozi dhe malaria janë udhëtarë të çdohershëm të dembelisë.

Në kohë të fundit, është mbushur me jetë dembelore Shqipëria, edhe kundër vullnetit të tyre, ato fillojnë të shfaqin energji dhe të punojnë, por secili duhet të paraqesë për sa ditë duhet një punëtor, me tërë familjen, ta punojë një fushë me gërmues, më pas ta mbjellë dhe si shpërblim ta ketë punën e tij, kur ajo nuk është e atij dhe për atë duhet të paguajë qira ose kompensim. Për pronarët e tokës do të jap disa të dhëna nga regjistri shqiptar. Si pronësi i Sulltan Hamidit, në të cilën tash pronar është shteti shqiptar, llogariten 35 ferma në rrethin e Fierit, 64 ferma (fshatra) në rrethin e Lushnjës, 18 ferma në rrethin e Beratit, jashtë asaj ka edhe shumë ferma të cilat janë pronë e teqeve të ndryshme, si vakëf. Asisoj ka 7 ferma në Lushnje.

Prek Bibë Doda i ka pothuajse të gjitha tokat dhe pyjet e Mirditës.

Në rrethin e Kavajës ka rreth 10 fshatra nën pronësi të qeverisë, të mbetura nga Turqia. Po ashtu asisoj ka edhe në rrethin e Durrësit.

Në Tiranë dhe rrethin e saj 60% të pronave që i përkasin familjes Toptani.

Gjashtëmbëdhjetë fshatra rreth Elbasanit janë nën pronë të Shefqet Bej Verlacit; 17 fshatra nga rrethi i njëjtë i përkasin Aqif pashës, 12 fshatra nga i njëjti rreth në rajonin e Çermenikës i përkasin Dervish begut, etj., etj.

Mjafton njeriu të shikojë në hartë dhe t'i shohë lokalitetet e Fierit, Beratit, Lushnjës, Elbasanit, Kavajës, Tiranës, Shkodrës, Durrësit, që të dijë se cilat toka janë të feudalëve dhe cilat toka i përkasin popullit, për të dashur të jetë të zellshëm dhe të punojë. Mizerja e shkretë prapë do ta kishte shtyrë që të punojë, megjithëse, munda i tij eksploatohet, ai nuk ka kafshë për të lëruar tokën, nuk ka as plug, kurse bejlerët – feudalë nuk llogarisnin që të investojnë kapitalin e tyre për modernizimin e fermave, siç shohim, se populli zgjohet nga gjumi i thellë dhe së shpejti do të vijë dita kur këto ferma do të tjetërsohen.

Unë mendo se fajtorët më të mëdhenj për mizerjen e sotshme të Shqipërisë, për të cilën tregova më lart se mundet të bëhet parajsë e Ballkanit perëndimor, është në duart e tyre dhe në duart e qeverisë, e cila deri më tani thuajse ishte në duart e tyre. Një punëtor ta punojë tokën me një mënyrë më primitive, edhe pa asnjë përkrahje nga ana e buikut, të paguajë tatim për tokën, të paguajë një të dhjetën, etj....etj, në këtë kohë të shtrenjtësisë, absolutisht nuk është e mundur. Fati i bejlerëve deri më tani përbëhej nga kjo, se populli është i thjeshtë, pa asnjë organizim. Bejlerët, nëse kishin një përputhje me gjendjen politike, si në ballkanet,

ashtu dhe në Evropë, dhe për një moment lejonin që në këtë vend të harruar do të gjenden njerëz dhe do të organizojnë një pjesë të popullit, ata do t'i hiqnin këto luftërat e pandërprera politike me intervenime ekonomike. Ato nuk e bënë atë. Për atë unë thellë jam i bindur se do të kenë pasoja nga e gjithë kjo.

E përmenda më lart se ka dy klasa të popullit, të kënaqur. Klasa e dytë një pjesë nga zyrtarët.

Shqipëria, e cila nuk trashëgoi asgjë nga perandoria turke, as rrugë, as hekurudha, as shkolla, as kazerma, bile as objekte për agjencitë qeveritare, trashëgim, pjesë e cila do ta ngjallte jetën e dalluar, trashëgoi një numër të madh zyrtarë të lartë dhe të ulët, të cilët për shtetin e vogël dhe të pashëruar, u paraqitën si një barrë shtesë. Këta zyrtarë ishin të mësuar në poste të larta shtetërore, me paga të mëdha, me mund mundën që të pranojnë ndonjë pozitë të rangut të ulët në shtetin e vogël – atdheun, për atë secili do që me mundësi ta marrë qeverisjen në duar.

I larguari në këtë popull mizor, i cili beson se ndërrimi i qeverisë do t'i sjellë lumturi, pa i studiuar shkaqet për këtë, lehtë gënjehet. Ja shkaqet për trazirat e shpeshta.

Në gabim i njëjtë, të paktën deri më tani, bie te dhe qeveria shqiptare. Ajo në vend se ta shpërndajë pjesën më të madhe të buxhetit dhe t'i krijojë punë popullatës së papunësuar ose të ndihmojë për rimëkëmbjen e bujqësisë dhe blegtorisë, dhe ta përmirësojë gjendjen materiale të kësaj popullate, qeveria pjesën më të madhe të buxhetit e ka shpenzuar në xhandarmëri dhe ushtri, pasi llogarit se me forcë do ta shuante çdo manifestim të popullit për përmirësimin e material.

Nuk është e vogël dhe pesha politike dhe ekonomike e qeverisë shqiptare me refugjatët, të ardhur nga vendet e robëruara, nga grekët dhe serbet: Kosova, Maqedonia, Epiri, Çamëria, etj.

Grekët dhe serbët, pasi morën pjesë të mëdha nga Shqipëria gjatë viteve 1912 – 13, asgjë të shëndoshë nuk lanë atje, për atë dëshmojnë vendet e shkatërruara, siç janë: Leskoviku, Kolonja, Gjirokastra, Përmeti, Tepelena etj, nga grekët. Në Kosovë, Peshkopia, e Dibrës deri në Tiranë nga serbet, të cilët i shkatërruan armiqtë e të etur për vend iu vërsulën me tërbim të madh mbi ato shqiptarë, të cilët, pas vendimeve të pafat të konferencave të ndryshme ka mbetur si subjekt i këtyre dy vendeve. Të gjithë më inteligjentët, të gjithë më të zgjuarit, të cilët nuk mundën ta durojnë robërinë e huaj, do të ishin vrarë apo ndjekur. Numri i madh i djemve të ikur, të pasurive të shkatërruara dhe të afërmit e vrarë, kurse luftëtarët me shekuj për të drejtat dhe pavarësi u larguan në Shqipëri, me dëshirë që të reagojnë, por deri sot ata nuk janë ndalur duke luftuar me qeveritë oficiale shqiptare, me të Esad Pashës, apo të Ahmet Zogut, të cilët paraqiteshin si miq të mëdhenj politik të të robëruarve të tyre. Një ndër njerëzit e parë e të larguarve, të cilin shtypi italian e quajti Garibaldi shqiptar, ishte Bajram Curri. Ai plaku 70 vjeç, i lindur në Kosovë, e mbetur nën serbet, emri i të cilit nuk është ndalur duke u përmendur 20 – 30 vitet e fundit që nga lufta për pavarësinë e Shqipërisë, edhe sot mund të gjendet prej 3 vite e këndeje, si ilegal, diku në malet e Kosovës, ndonjëherë kundër serbeve, ndonjëherë kundër qeverisë shqiptare të Ahmet Zogut, miku i atyre të parëve.....

Jo e vogël është edhe barriera ekonomike për Shqipërinë në kufijtë e sotëm. Mjafton t'i hidhet një sy hartës, ku do të mund të shihet se nga Tirana e në veri, në të gjithë territorin shqiptar, në veri të Shqipërisë mbetet vetëm një qytet, Shkodra, qendrat e tjera të mbetura shqiptare: Peja, Gjakova, Prizreni, Prishtina, Dibra etj, nuk mbesin në shtetin amë, mbesin në territoret serbe, megjithëse popullata ishte shqiptare.

Në Shqipërinë e jugut ishte e kundërta. Vendet e banuara si : Korça, Kolonja, Leskoviku, Përmeti, Gjirokastra etj. mbesin në Shqipëri, kurse humbëtitat e tyre në Greqi.

Shqipëria, për shkak të politikës turke, e kishte harruar detin Adriatik dhe nuk kishte asnjë lajm përmes saj, dhe të gjitha shikimet tregtare ishin kthyer nga Selaniku dhe Manastiri, sot rrethohet me pazare të vjetra, kurse të rejtat në perëndim janë pak më të hapur.

Vepra e mësimi në Shqipëri

Një ndër kujdeset e para të popullit shqiptar dhe qeverisë, menjëherë pas pavarësisë, ishte të formojë shkolla dhe vepra arsimore. Pavarësisht nga situata e mjerë financiare në vend, buxheti i fundit i ministrisë së arsimit ishte 2.151.820 franga në flori. Ai ishte e ndarë kështu: 1.514.840 fr. Flori për shkollat popullore, 54,840 fr. Flori për shkollat greke, të cilave u jepej e drejta e plotë në marrëveshjen për pakicat, 582.140 fr. Flori për ministrinë dhe zyrtarët administrativë në arsim.

Shkollat në Shqipëri ndahen në rrethe si vijon.....

Emrat e rretheve	Shkollat		Nxënësit		Personeli i shkollës		Shpenzi met në rrethe në franga të arit	Shënim
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Mësues	Mësuese		
Korça	117	4	5350	3361	196	26	357360	Përveç këtyre shkollave në rrethin e Gjirokastrës, grekomanët, duke shfrytëzuar ligjin për pakica kane shkolla greke të cilat financohen nga shteti shqiptar – 26 shkolla për meshkuj dhe 1 për femra, të cila vizitohen nga 1585 djem dhe 615 vajza me një personel të mësimeve prej 18 mësimeve dhe 1 mësime, për të cila qeveria shqiptare lëshon 54.840 franga të arit.
Gjirokastrë	71	4	2930	911	104	9	230400	
Vlorë	33	3	1452	548	56	7	95040	
Berat	54	7	2056	1044	82	8	161760	
Durrës	53	5	2870	854	102	7	249960	
Shkodër	42	6	2010	690	96	28	250880	
Dibër	6	-	280	-	10	-	13560	
Kosovë	8	-	310	-	12	-	18000	
Totali	423	31	18458	7731	721	98	1.514.840	

Qeveria shqiptare lëshon 54,840 franga të arit në vit Personeli i shkollës në Shqipëri është i përgatitur dobët. Të vetmit janë ata të cilët e kanë qendrën e nevojshme, që të jenë ligjërues në gjuhën shqipe, sepse asnjë prej tyre nuk ka mbaruar shkollë shqipe, sepse ato nuk ekzistonin. Ata kanë mbaruar shkollë në turqisht ose greqisht, ose janë praktikantë. Shkollat janë të furnizuara dobët me materiale nevojtare dhe me tekste shkollore. Nga 423 shkolla meshkujsh, 295 kanë vetëm klasë të parë. Puna arsimore në rrethet e Kosovës dhe Dibrës është e lënë plotësisht pas dore.

Rrugët në Shqipëri

Një ndër pjesët më të lëna anësh në Evropë, në marrëdhënie me rrugët dhe komunikacionet, si nga shteti turk ashtu dhe me ngurrimin e vetë shqiptarëve që të kenë asisoj. Deri në luftë, më 1912, Shqipëria i kishte këto rrugë, më shumë me një rëndësi ushtarake sesa tregtare: Pogradec – Korçë – Kolonjë – Leskovik – Përmet – Gjirokastër – Santa – Karanta. Ajo ishte rruga e vetme, e cila e lidhte qytetin qendror të Turqisë, Stambollin, me Adriatikut. Pas komplotit të Abdulhamitit, në vitin 1909, kur ushtria e tij ishte e mbushur me xhonturq, këto të fundit sollën disa dhjetëra mijëra malësorë nga përkrahësit e Abdul Hamitit, trasonin rrugën Strugë – Elbasan, e cila në ditën e sotme është e gjysmëmbarruar nga Qaf Thana – Kukës. Në kohë të luftës së madhe ishin ndërtuar edhe këto rrugë: Vlorë – Tepelenë, Vlorë – Fier – Berat, Vlorë – Koninë në jug të Shqipërisë, kurse në veri të Shqipërisë Shkodër – Lezhë – Tiranë, Tiranë – Durrës. Traseja e rrugës Durrës – Kavajë – Elbasan mbeti e papërfunduar. Deri në Luftën e Madhe nuk kishte asnjë lloj të hekurudhës. Komanda kryesore austriake i punoi këto drejtime: Shkodër – Lezhë – Tiranë, Tiranë – Durrës, Durrës – Kavajë – Peqin – Elbasan, Peqin – Fier, Fier – Berat. Gjatë tërheqjes austriakët i bombarduan urat, shkatërruan lokomotivat dhe vagonët, dhe me kalimin e kohës e gjithë kjo rrugë hekurudhore do të shkatërrohet. Sot komunikacioni në Shqipërinë veriore, dhe veriore me jugoren, bëhet vetëm me kuaj, nëpër rrugë të kuajve. Komunikacioni më i mirë ndërmjet pjesës veriore dhe jugore të Shqipërisë bëhet me anije me avull, për të cilën ekzistojnë katër porte: Santi – Karanta, Vlora, Durrësi, Shën Gjovani di Medua, kurse për avulloret më të vogla dhe gjemitë lumi Bunë në Shkodër. Limani më i bukur natyrisht është ai i Vlorës. Gjiri i saj i quajtur “Pasha Liman” mundëson edhe dibarkimin e anijeve avulluese më të mëdha gjatë stuhive të mëdha. Limani i dytë me madhësi tregtare është ai i Durrësit. Ai ka përballuar çdo stuhi. Limani i dikurshëm i Durrësit, për të cilën më përpara flitej shumë, është i zhytur në baltë.

Të gjitha rrethet dhe qendrat me rrethinat janë të lidhura me telegrafë, kurse qendrat dhe me telefonie. Në kohën e luftës në disa vende ka pasur radiotelegrafë. Tash ka vetëm një në Ambasadën Italiane në Durrës. Shqipëria ka marrëdhënie më Evropën Perëndimore ndërmjet kabllor Vlorë – Brindisi.

Shprehitë, karakteret dhe ritet

Shqipëria është e ndarë në shumë fise, të cilët hyjnë në dy grupe kryesore. Këto dy grupe ndahen gjeografikisht nga lumi Shkumbin, e cila merr ujë nga malet e Mokrës, dhe shkon drejt perëndimit, përmes qytetit të Elbasanit, dhe derdhet në

detin e Adriatikut. Në jug të lumit Shkumbin të gjithë shqiptarët janë nga fisi toskë, kurse në veri fisi gegë. Me shprehitë, karakteret dhe adetet këto dy fise nuk dallohen shumë. Gjuhën e kanë të njëjtë, por paraqiten dy dialekte, për atë shkak për gjuhë të përbashkët letrare është marrë dialekti elbasanas, i cili mbahet si qendror. Dy fiset e mëdha Gege dhe Toske, ndahen edhe në disa gjëra të vogla, të cilët ato të veriut i quajnë bajraktarë, si prej kohëve të lashta udhëheqësit e këtyre bajraqeve, me trashëgim, janë bajraktarët e tyre. Çdo bajrak përfaqëson një shtet me konstitucion të vogël monarkik. Në qendër të fisit ndodhet shtëpia e bajraktarit. Ajo përfaqësohet me një oborr të vogël dhe me një sallon ku bajraktari takohet me njerëzit e tij të parë. Ajo shërben si tavolinë e të gjithëve që vijnë për ta vizituar bajraktarin, dhe për ndonjë nga fis tjetër nga vendet e tjera i cili është në kalim nga ky shtet i vogël. Ky sallon është i përngjashëm si klub. Të gjithë fshatarët kanë të drejtë që të hyjnë në atë shtëpi, nëse janë të uritur që të hanë, medoemos të pinë duhan, të pinë kafe dhe të bisedojnë për mendime të llojllojshme. Kur bajraktari hyn në dhomë, ata të gjithë ngrihen në këmbë, përgjithësisht me respekt të madh dhe shkëmbejnë përshëndetjet. Kjo është përparësia e postit të tij. Më tutje vazhdon me demokraci të plotë si në mënyra ashtu dhe në çfarëdo bisede.

Shpesh këto fise nën shefat e bajraktarëve të tyre luftonin dhe janë vrarë. Ato luftëra më së shumti ishin vetëm për ruajtjen e nderit dhe autoritetit të shtetit të vogël. Ja disa raste që i karakterizojnë luftërat e tyre: një njeri nga i njëjti fis me padashje apo me paramendim sulmon apo rëndon dikë nga fisi tjetër. Menjëherë pasi fillon lufta ndërmjet të dyve, i gjithë fisi i mbërrin për ndihmë. Lufta shndërrohet në një luftë të vërtetë dhe zgjat me dhjetëra vjet. Shembulli i dytë: një bukuroshe me emrin Zymbyle, ishte e fejuar për një djalë po nga i njëjti fshat. Një trim nga një tjetër fis e vret të fejuarin dhe ia merr me dhunë për grua. Fillon lufta. Ajo grua, për disa vite, disa herë ishte e martuar nga njëra dhe nga ana tjetër e fiseve, për të cilën u vranë plot 28 burra. Dhe sot këndohen edhe këngë për të.....

Para se të hyjnë turqit në Shqipëri, Gjergj Kastrioti, ose siç e quajnë shqiptarët Skënderbeu, njëra nga meritat e tij më të mëdha ishte ajo e bashkimit të dy fiseve, të krijojë dashuri dhe lidhje ndërmjet tyre, dhe t'i nxjerrë në luftë përballë armikut të përgjithshëm. Prej atëherë e këndeje, mund të jenë armiqësor ndaj njëri-tjetrit, por kur ka një rrezik të jashtëm pajtohen shpejt dhe së bashku rebelohen kundër armikut të përbashkët. Megjithatë, kjo nuk ka qenë gjithmonë kështu në mes të gegëve dhe toskëve. Pas pushtimit nga turqit në Shqipëri nga e kaluara kanë mësuar dobësitë e tyre gjatë shekujve të tërë i kanë mbajtur në armiqësi. Një shekull më parë, duke e parë si kreu i toskëve Ali Pashë Tepelenën, kurse të gegëve familjen e ashtuquajtur vezirët e Shkodrës. Në mes të dy krerëve të dy fiseve të regjistruar janë beteja goxha të përgjakshme, kështu që urrejtja nuk është zhdukur ende edhe intelektualët ushtrojnë ndikim të madh dhe kujdes të madh për një qetësi të akomoduar si në të kaluarën. Toskët kanë për veshje kombëtare këpucë të mëdha të kthyera në majat, ku mund të admirojnë çorape të bardha, fustanella të bardhë, gunja të zi ose gri, kapelë pambuku të bardhë të thurur dhe rrip shumë të vogël, gegët veshin tirq të bardhë me shumë vija të zeza, opinga të lehta, rrip të madh, xhamadan të bardhë dhe të zi me vija të gjata, kësulë të

bardhë të përpunuar nga leshi. Veshjet e grave e të dy fiseve, veçanërisht të gegëve, janë shumë të dalluara. Secili rreth ka veshje të veçantë.

Me karakter, tosket janë më të etiketuar, por janë më hipokritë. Në tregti kanë më shumë iniciativë dhe kanë një frymë më spekulative. Në luftë janë mjaft alarmues, por dalin si më frikacakë. Toskët e duan shkencën, për atë pjesa më e madhe e inteligjencies del nga ato.

Gegët janë më naivë, por më trima në luftë. E mbajnë fjalën e dhënë, nuk janë shumë pretenciozë, të dëgjueshëm para krerëve të tyre, fundamentalistë të mëdhenj dhe këmbëngulës. Janë të vështirë të merren me tregti. Shumica janë barinj, qiraxhinj, pjesërisht bujq.

Toskët janë të imët dhe të zi, kurse gegët, përveç atyre që jetojnë përreth detit, të gjatë, janë të thatë, biondë apo ngjyrë gështenjë.

Shqiptari përherë jeton në ajër të pastër. Çdo shtëpi është e ngritur në male, veças, veçanërisht tek gegët. Ajo është në mes të fushës apo livadhit të të zotit – pronarit të tokës. Të gjitha pronat, së bashku me shtëpinë, ai i quan “shteti” im. Shtëpia fshatare shqiptare nuk është e keqe për të jetuar. Ajo është e ziduar me mure të trashë dhe i përngjanë kalasë.

Është interesante, se në mes të punëve të tjera gruaja shqiptare i bën edhe këto punë: në ditë pazari, ajo shkon në pazar, e ngarkuar me poçar të mbushur me vaj ose vaj ulliri, kosha me ullinj, shegë dhe pemë të tjera, çon kopenë, patat ose gjelat e detit. Shikim të bukur në ditë pazari ka në Elbasan. Dhjetëra gra, të ngarkuara me poçarë të mëdhenj të mbushura me vaj në kokë, si një pjesë e ushtrisë të radhitura hyjnë në qytet. Çdonjëra e ka të varur fturkun në brez, tjerr lesh ose pambuk ose punon çorape. Burri shkon në pazar vetëm kur ka të shesë bagëtinë ose kur ka të paguajë tatime.

Pavarësisht nga puna e saj, dhe meritat e mëdha të cilat i ka ndaj familjes, ajo nuk ka asnjë të drejtë në familje, duke e merituar respektin nga burri. Shqiptarja kur është në zi, nuk mban veshje të zeza, por në kokë mban pëlhurë të bardhë.

Gegët qofshin të krishterë apo myslimanë, i bëjnë dasmat të dielën. Kureshtare është riti të cilin e kanë myslimanët. Një ditë para dasmës, riti është që nusja të veshë bluzë të kuqe dhe në shtëpinë e saj mblidhen të gjithë gratë e farefisit, shoqet dhe komshiket. Disa rome fillojnë t’u bien dajreve dhe të këndojnë. Mysafirët pasi e shikojnë çejzin (mirazin), ndërmarrin ritin tjetër: marrin një enë, të mbushur me ngjyrë të verdhë të ashtuquajtur këna, e lyejnë dorën e majtë të nuses, dhe më pas i lyejnë të gjithë flokët e tyre. Po atë ditë, burrat mblidhen tek dhëndri, shikojnë dhuratat të cilat ai i ka përgatitur për nusen. Ditën më pas, në ditën e dasmës, nusja vishet me fustan mëndafshi, ia fëlloqin fytyrën me ngjyrë të bardhë dhe i ngjisin pllota mjalti ia mbyllin sytë e saj, dhe siç thonë ata, ajo duhet t’i hapë, pasi hyn në dhomën e fjetjes së burrit. Gjatë gjithë kohës së dasmës, ajo siç është e detyruar, duhet të qajë me zë. Disa javë pas dasmës ajo nuk flet me askënd dhe nuk i përgjigjet askujt. Dasmata në Shqipëri janë që sa më të pasur të jenë njerëzit, aq më shumë do të ketë dasma aheng, jo aq shumë për dasmorët sa për grupin e romëve dhe romeve muzikantë. Romët luajnë me surle, klarinetë dhe daulle, kurse romet u bien dajreve, këndojnë dhe i ledhatojnë dasmorët. Pasi të dehen mirë, do të shihni ndonjë rome të bukur se si u ulet në prehër të njëri apo

tjetrit, të cilët i ngjisin në fytyrë monedha derisa e tërë fytyra t'i mbushet. Në përgjithësi shumica e romëve në Shqipëri janë shumë të bukur dhe të veshur mirë. Ato nuk martohen, kurse si të reja u shërbejnë si dashnore bejlerëve dhe pasanikëve.

Në Tiranë thuhet se Esat pasha e kishte gërmuar një rrugë nëntokësore, nga shtëpia e tij ndërmjet mëhallës së romëve. Një rome e bukur, prej 10 – 12 vjeçe, bëhet pazar se dashnorja e parë e cilit do të bëhet. Pas disa muajve apo vitit të bekuar, ajo shkon tek burri i dytë, në dorë të dytë, pas asaj tek i treti dhe ashtu me radhë derisa përfundojnë në kafene. Kisha rast që të shoh shumicë të burrave, baballarë të familjes, ta kenë për krenari, se e kanë një dashnore rome, të ulur në sirtarin e dyqanit, dhe këmbë mbi këmbë me shallvaret e gjera, thith cigare pas cigares dhe e pi kafenë.

Ministri i ri Ahmet Zogu, duke e pasur parasysh se ahengjet dasmore me ndërmjetësim të romeve, shikohen nga evropianët si një mjet joliberal për ahengje, e ndaloj atë lloj të ahengjeve dhe i burgosi të gjitha romet. Kuzhinën e kanë turke. Hakmarrjet, megjithëse gjykatat janë më moderne, nuk janë ndalur.

Partitë dhe luftërat politike në Shqipëri

Pushtetarët shqiptarë, prej të cilëve shumica ishin të rritur e mësuar me jetën dhe adetet turke, sepse shumica e tyre ishin të familjarizuar me turqit, pasi u kthyen në vendlindje, dolën si parti e re politike dhe të përmalluar nga dëshira që sa më shpejt ta ringjallin këtë vend, pa marrë parasysh traditat, zakonet dhe karakterin e popullit, dhe dëshironin ja ashtu, në dorë të shpejtë një shtet konstitucional – demokratik. Me këtë situatë, si nga dita e parë hynë në luftë mospajtimi me shefat e organizatave të vjetër tradicionale të shtetit – bajraktarët, për atë secili që ka jetuar dhe jeton në Shqipëri, thjesht ndihet si në qetësi para shtrëngatës.

Ministrat e rinj, në një apo në një tjetër mënyrë, filluan t'i injorojnë bajraktarët pa marrë parasysh se ata heronj tradicionalë, të cilët gjatë shekujve, me armë në dorë, e kanë udhëhequr masën e popullit dhe e kanë mbrojtur nga robëria dhe asgjësimi i plotë, me këtë sjellje ministrat e rinj shqiptarë, shkaktuan konflikt me bajraktarët dhe fiset e ndryshme, me të cilët hynë në luftë të hapur.

Sa e njoh këtë vend, besoj, se këto luftëra do të vazhdojnë derisa bajraktarëve u merret e drejta të jenë asisoj, kurse ajo është absolutisht e pamundur, dhe ato shpejtojnë, sepse ende nuk janë zgjedhur dhe të emërtuar, kurse janë trashëgimtarë të një tradite, e cila me shekuj ua jep atë të drejtë ose derisa makina shtetërore është e rregulluar sipas karakterit, traditës dhe nevojat e këtij vendi, dhe jo sipas modës.

Si nga viti 1913, pas çlirimit të Shqipërisë, si zotues i këtij vendi do të zgjidhet Knjaz Vidi. Mirë është të dihet përse ai nuk mund të bashkëngjitet. Dikush e llogarit sepse ai ishte gjerman dhe pajtimin nuk mund ta durojë. Në këtë shikim mendoj se është gabim. Para shpalljes së luftës, ai do ta lëshonte Shqipërinë dhe do të jetonte në anijen me avull në portin e Durrësit. Ai nuk kishte mundësi që ta organizojë shtetin. I kishte dy njerëz të mëdhenj si Prenk Bibë Doda me titullin që nuk ia jepte askujt, Esad pasha, i cili kishte ndërmend që ta marrë shtetin nën duart e tij. Pas vrasjes së Prenk Bibë Dodës, Esad pasha me mbështetjen nga Serbia dhe

marrëveshjen për ta marrë qeverinë në duart e tyre, sepse Shqipëria u okupua nga austriakët, dhe nuk iu dha mundësi për realizimin e planeve, më pas Esad pasha është larguar për në Francë për të jetuar, që të kthehet prapë pas një kohe. Ai do të vritet në Francë nga studenti Avni Rustemi.

Në Shqipërinë më të qetësuar u formuan dy parti politike: popullore dhe nacionaliste. Në një kohë të shkurtë si njeriu më i fortë në Shqipëri doli Ahmet Zogu, i lindur në Mat, nga fshati Zogu, mbiemrin e të cilit e mban ai, shpeshherë e thërrasin edhe Ahmet Mati. Ai është djali i Xhemajl pashës, bajraktari i fisit të Matit, dhe nip i Zija pashës ish divizioner i Turqisë, i cili gjatë luftërave ballkanike e komandonte divizionin përballë ushtrive bullgare në Lozengrad. Ahmeti e ka marrë arsimin në Stamboll, ka jetuar si refugjat në Austri dhe Itali, ku edhe ka filluar të merret me politikë. Si 20 vjeçar ai morri pjesë në luftëra politike në vend dhe me matjanët e tij ka luftuar herë për njërin dhe herë për tjetrën kauzë. Ai është i bukur, me një trup të zhvilluar, çdoherë i buzëqeshur, dhe me të gjitha përvojat e orientalishtit. E njëj shumë mirë shpirtin e shqiptarit, por, duke dëshiruar që së shpejti të bëhet zotuesi i Shqipërisë, me truket e ashpra dhe adoleshente, e humbi besimin nga inteligjencia e lartë, e cila e përqesh, se e ka mbajtur historinë e Napoleonit ndër jastëk.

Kontrollimi përfundimtar i vendit, i cili ende nuk ka vendosur se çfarë lloji do të jetë: monarki apo republikë, është në dorë të katër regjentëve (mëkëmbës), dy myslimanë dhe dy të krishterë, të zgjedhur nga Asambleja e Madhe Kombëtare. Instituti më i lartë në vend është Asambleja Kombëtare e cila zgjidhet nga populli, me sistem të dyfishtë të votës. Parlamenti Shqiptar ka rreth 80 deputetë, kurse në Asamblenë e Madhe Kombëtare të fundit kishte 101 deputetë. Shqipëria ka shtatë ministri, ato janë: Ministria e Drejtësisë, e Punëve të Brendshme, Ushtrisë, Arsimit, Financave, Punëve të Jashtme dhe për Mirëqenie. Më pas ka edhe Drejtori të Bujqësisë, Postës dhe Telegrafit dhe Shëndetit Shoqëror.

Thamë se në Shqipëri ka dy parti politike: popullore, në krye me Ahmet Zogun, dhe nacionaliste, në krye me Gura Kuqin, Rexhep Shalën, Fan Nolin etj. Para zgjedhjeve në partinë popullore kishte mosmarrëveshje me shefin e partisë, dhe si pasojë u ndanë nga partia dhe formuan parti të re, të socialdemokratëve, në krye të së cilës ishte ish- ministri i financave Dr. Seifi dhe Pandeli Vangjeli. Pasi u hap Asambleja e Madhe Kombëtare, u formuan pesë parti politike:

- 1) Partia popullore, në krye me Ahmet Zogun
- 2) Partia nacionaliste, në krye me të lartpërmendurin Gurakuqi etj, në të cilën u bashkëngjithën pjesë e madhe e inteligjencies dhe oficerëve.
- 3) Partia konservatore, në krye me Shefqet Vrilasin, Iljas Vrionin etj.
- 4) Partia e socialdemokratëve, në krye me Dr. Seifin, Pandeli Vangjelin, Eshref Frashanin etj.
- 5) Partia e grekëve, numëronte 6 deputetë.

Menjëherë pasi u hap parlamenti, u pa se ajo nuk është e aftë që të punojë, sepse zërat e opozitës, e cila përbëhej nga nacionalistët dhe socialdemokratët, ishin thuajse të barabartë me koalicionin e populllores, feudalëve dhe grekëve, që e përmbanin qeverinë. Një përparësi kishte opozita, se deputetët inteligjentë dhe oratorët e mirë ishin nga ana e saj.

Rol të madh në jetën politike shqiptare luajti dhe Komiteti i Kosovës, në krye me Bajram Currin. Bajram Curr, njeri plak, shumë trim, i ndershëm dhe nga të gjithë shqiptarët i quajtur baba, në pjesën e tij të jetës në ilegalitet i kishte mbledhur përreth tij të gjithë të pakënaqurit dhe të gjithë shqiptarët e dëbuar nga qeveria serbe dhe shqiptare, paraqitej si një forcë e madhe, e cila në grusht shtetin e fundit ka luajtur një rol të rëndësishëm.

Mirë është që të dihen pjesërisht programet e partive politike shqiptare. Popullorja, socialdemokratët dhe një pjesë e nacionalistëve ishin për një qeveri republikane, kurse feudalët dhe pjesa më e madhe e nacionalistëve ishin për monarki. Populistët ishin pa dallim për miqësi me serbët, kurse nacionalistët donin reforma të thella sociale dhe politike kombëtare të jashtme. Feudalët ishin për t'i mbrojtur pasuritë e tyre.

Sot vështirë është të thuhet se ka një formim të plotë të partive. Ato mbajnë emërtimin e partive politike, por deri më tani nuk kanë pasur asnjë liri për zhvillim dhe aktivitet partiak në vend. Këto parti mund të quhen së shpejti si parti rajonale. Ashtu: nacionalistët mbajtën tërë Shqipërinë veriore, popullorja Shqipërinë e mesme, socialdemokratët vetëm rrethin e Korçës, kurse grekët vetëm Gjirokastrën dhe rrethin. Me marrjen e qeverisë nga partia nacionale, së cilës i përkasin njerëzit e parë të Shqipërisë, me arsim dhe përvojë politike, siç janë Gurakuqi, njeri me shkollë të lartë të mbaruar në Itali, luftëtar i vjetër për pavarësinë e Shqipërisë, punëtor shumëvjeçar në gjimnaz, deputet dhe ministër, Fan Noli - argjipeshkëv ortodoks, me shkollë të lartë, shumë i njohur në Shqipëri. Hasan bej Prishtina, po ashtu me shkollë të lartë, luftëtar i vjetër për pavarësinë e Shqipërisë, i cili së bashku më Bajram Currin disa herë me radhë kanë organizuar kryengritje për lirinë e mëmëdheut të tyre, dhe deputet në parlamentin turk, ish deputet dhe ministër në Shqipëri, Aqif pasha, njëri ndër personat më të njohur në vend, Sulejman Delvina, një njeri solid me shkollë të lartë, ish ministër dhe president, Qazim Kaculi, kapiteni i anijes së famshme "Hamide" gjatë luftës Ballkanike, luftëtar kundër aspiratave italiane, Hil Mosi, Irfan Ohri, Elez Isufi, Maliq Kërçishta, dhe thuajse të gjithë oficerët, në krye me kolonel Rexhep Shalën, Shefqet Korçën, Ramiz Dibrën, Ali Kosturin, Zija Dibrën etj, me këta persona Shqipëria do të mund të përjetojë një jetë të përkryer. Popullariteti i tyre dhe intelegjenca është garancion i madh para çliruesve të mëdhenj, me përkrahjen të cilën do t'ia japë i gjithë populli, do të mund të ballafaqohen me ato të cilët deri më tani u shërbenin kauzave të huaja.

Këta burra të politikës, me përvojë, të cilët në shumë vende e kanë treguar shkathtësinë e tyre, do të mund që t'i rregullojnë koncesionet e tyre para Forcave të Mëdha, qoftë në pyetjen për koncesionet e ndryshme, qoftë për të marrë huazime për ta nxjerrë vendin nga situata e varfër dhe rrëmuja. Ata po ashtu do të mendojnë që të largojnë çdo "fili" apo "fobi" që paraqiten për njërin apo për tjetrin fqinj. Me këtë nuk dua që të them se ata janë një shkop magjik dhe do t'i qetësojnë të gjithë

shpirtrat. Populli shqiptar asnjëherë nuk do të ndalet t'i urrejë serbët, të cilët u kanë shkaktuar vuajtjet më të mëdha, qoftë në kohë të okupacionit në Shqipërinë e sotshme apo qoftë nga pushtimi i tyre në Kosovë. Asnjëherë Serbia nuk është ndalur nga viti 1912 e këtej që të mbajë bashkëpunëtorë shqiptarë, t'u japë rroga oficiale, t'i veshë me uniforma dhe t'i gradojë si oficerë. Askush nuk do të habitet nëse nesër dëgjon se Ahmet Zogu është më gjeneral serb, kurse disa bajraktarë të tij si kolonelë, dhe me të drejtë Ahmeti nuk mund të marrë gradë më të ulët, kur vëllai i tij qëmoti është kolonel serb.

Çka ndodhi në grushtshtetin e fundit?

Për shkak se ngjarja është shumë e freskët dhe u intereson Forcave të Mëdha, veçanërisht fqinjëve, është më mirë të dihen arsyet për grushtshtetin, të cilat janë mjaft instruktive. Përkundrejt qeverisjes së Ahmet Zogut, ajo ofensivë popullore nuk ishte e para. Grushtshteti i parë ndodhi gjatë vitit 1922, në fillim të marsit. Atëherë njerëzit e parë inteligjent në Shqipëri nuk mund ta duronin që në krye të qeverisjes të ishte një i ri pa përvojë dhe fillestar i cili filloi të luajë me mëkëmbësit e tij dhe kushtetutën, dhe më shumë, që popullariteti i tij ishte shumë i dobët dhe njerëzit inteligjentë jepnin nota të dobëta për atë dhe parashikonin ndodhi të këqija në vend. Atëherë për shkarkimin e qeverisë së Ahmetistëve, edhe pa asnjë organizim shtetëror nuk kishte nevojë, Zoti e di se çfarë forcash, dhe më shumë, se qeveria italiane, kundër trupave të cilit ai personalisht luftoi për t'i dëbuar nga Shqipëria, dëshironin largimin e tij. Me forca të vogla dhe jo të organizuara, dy bajraktarët Elez Isufi nga Dibra dhe Bajram Curri nga Kosova, i pari u nis për një takim në Tiranë, kurse i dyti për në Shkodër. Para se Bajram Curri të mbërrinte në Shkodër, Elez Isufi me betejë hyri në Tiranë. Vetë Ahmeti e komandonte ushtrinë dhe xhandarmerinë. Në Tiranë, nuk u ndje i shtypur. Ai veç më ishte i rrëzuar. Për shkaqe të panjohura për ne, në ato minuta kritike për Ahmetin, del në qendër të qytetit përfaqësuesi anglez dhe e takon Elez Isufin me fjalët se qeveria angleze do që qeveria angleze ka dëshirë që Ahmet Zogu të mbetet në qeveri. Bajraktari Elez Isufi, para të cilit përfaqësuesi anglez u paraqit si Zot, mblodhi çetën e vet dhe pa betejë nga Tirana u kthye në Dibër, pa u shqetësuar nga askush. Bajram Curri, pasi dëgjoi për ndodhinë, i ndali operacionet dhe mblodhi çetën dhe u tërhoq diku në bjeshkët e Kosovës, ku dhe ishin deri në grushtshtetin e fundit.

Pas asaj që ndodhi, Ahmet Zogu së shpejti formon ushtri, mblodhi milici dhe filloi që të merret me kundërshtarët e tij. Disa nga ata e lëshuan Shqipërinë dhe u larguan për në Itali, të dytët për Serbi, të tretët në malet e Kosovës tek Bajram Curri, kurse të katërtit më naivët, ishin të kapur, shumica në varëse, kurse të tjerët ishin të vrarë nëpër rrugë. Ajo trimëri e Ahmetit, i cili e di për traditat e gjakmarjes në Shqipëri, me të drejtë quhet çmenduri, sepse të gjithë të larguarit, të gjykuarit më vdekje apo të ekzekutuarit, ishin njerëz të shquar dhe me ndikim.

Pas këtij terrori në Shqipëri, ku populli ishte tejet i frikësuar, shfaqet një qetësi, por e cila nuk u ndje nga të gjithët, sepse është një qetësi para stuhisë. Të gjithë njerëzit e parë ishin të larguar nga postet e larta, të gjithë oficerët e aftë ishin të shkarkuar, të gjithë funksionarët opozitarë çdo ditë e pritnin vdekjen e tyre. Por, pas një kohe, ajo frikë filloi që të largohet, secili filloi që të mendojë për

ardhmërinë, filloi që të pëshpëritet derisa, më në fund, filloi edhe organizimi përballë regjimit. Ora ishte afuar, por opozitarët e mençur, duke u frikësuar nga ndërhyrjet e jashtme, sepse haptazi shihej se si i ndihmohet Ahmetit, shpresat e fundit i lanë për zgjedhjet, të bindur, se populli është me ata. Ata nuk u zhgënjyen. Me të vërtetë populli ishte me ata. Nga 101 deputetë, populistët morën 34, por disa gabime të shefave opozitarë nga partia nacionaliste, i dhanë mundësi që Ahmeti ta mbante qeverinë. Gabimi i parë ishte, se në fshehtësi e mbanin kërkesën për reforma sociale të cilën do ta bënin pas marrjes së qeverisjes, për të cilën feudalët e përmbajtën Ahmetin, partia Greke caku i së cilës ishte mosshërimi i Shqipërisë, po ashtu e përmbajti Ahmetin, kurse socialdemokratët, të cilët të parët u paraqitën si opozitë aktive, gjithashtu mbanin dhe disa poste të ministrave, para frikës nga kanosjet e nacionalistëve “ju jeni po ashtu të fajshëm”, filluan që të luhaten dhe Ahmeti e ktheu prapë kamxhikun.

Djaloshi i ri Abas Veli, xhaxhai i të cilit para viteve ishte vrarë, si i frymëzues, në të cilën u tregua se urdhëruesi ishte Ahmeti, shkoj në parlament dhe i bëri atentat atij. Ahmeti i plagosur për një kohë u tërhoq nga kabineti, gjë e cila e qetësoi opozitën për t’u parapërgatitur. Në atë kohë opozita u tregua shumë pa taktikë që i dha edhe një letër të fortë në dorë. Domethënë ajo donte që kryeqytetin e Shqipërisë ta mbante Shkodra. Qytetarët dhe fshatarët në Tiranë dhe qytetet rreth saj, si Shijaku, Durrësi, Kavaja dhe Elbasani, si dhe të ikurit nga Dibra, të cilët me mijëra mundime u vendosën në Tiranë, pavarësisht të këqijave që bëri Ahmeti ndaj tyre, premtuan se do t’u japin përkrahje ushtarake, e cila ishte lajkatare dhe e shtyu që të bëhet e pagjindshme. Saktësisht gjatë asaj kohe, ndodhi diçka e paparashikuar për opozitën. Vrasësi i Esad pashës, tash deputet në parlament, ishte vrarë në mes të Tiranës nga një plak i cili me vite të tëra kishte shërbyer tek Esad pasha. A kishte Ahmeti gisht në këtë vrasje, për t’i tërhequr feudalët, nuk e di, por opozita njëzëri e gjykoi si inspirues Ahmetin dhe trupi i të vërrit Avni Rustemi i shërbeu opozitës që ta lëshojë Tiranën dhe të gjithë deputetët opozitarë, me pretekst se e mbajnë arkivolin në vendlindjen e tij ”për t’u mbledhur në Vlorë dhe ta shpallin rrëzimin e Ahmetit nga qeveria”.

I gjithë populli nga Shqipëria jugore, me përjashtim të rrethit të Korçës, pjesa më e madhe e së cilës u paraqit si neutrale, dhe të gjithë ushtarët dhe xhandarmeria kanë thënë se janë kundër Qeverisë së Tiranës.

Bajram Curri, i cili me vite qëndronte në bjeshkët e Kosovës, dhe e prite atë ditë, filloi me lëvizje.

Gurakuqi së shpejti udhëton në Shkodër, ku populli me padurim e pret që të tërhiqet në mes të Tiranës, sepse situatën e kishte të patolerueshme. Koloneli Rexhep Shala, komandant i ushtrisë, një ditë nga të gjitha anët e tërhoqi të gjithë ushtrinë në Tiranë....Ahmeti krenar, megjithëse u pa që ishte i braktisur nga të gjithë, ndenji deri në momentin e fundit në Tiranë. Ai tregoi guxim të madh në minutat kur e gjithë Tirana dridhej. Edhe disa minuta do të ishin të mjaftueshme që të bllokohet rreth e qark, Ahmeti hipi në një minare të xhamisë dhe i shikonte forcat revolucionare nën komandën e Rexhep Shalës, vetëm 2 – 3 kilometra larg. Rreth tij kishte 600 veta. Të gjithë qytetarët ishin fshehur në bira të miut. Ai urdhëroi që përmes lajmëtarit të mblidhen të gjithë banorët e gjinisë mashkullore

nga qyteti, në qendrën e qytetit, dhe iu drejtua me këto fjalë: një ndër kujdeset më të mëdha është që ta ruaj Tiranën si kryeqytet të Shqipërisë. Ju banorët e këtij qyteti, që jeni më të interesuar a jeni të gatshëm që të vdesim të gjithë deri në të fundit, për t'u mbrojtur interesat e juaja? Qytetarët e frikësuar, filluan që t'i tregojnë rreziqet e tyre, se shtëpitë e tyre do të shkatërroheshin, familjet do të dëboheshin etj., Ahmeti iu drejtua atyre dhe u tha: "Ju nuk e meritoni gjakun tim. Jeni të lirë, shkoni dhe takoni ata që janë kundër interesave tuaja". Pas asaj ai iu drejtua 600 shokëve të tij, me një buzëqeshje u tha atyre: "Kush dëshiron, le të vijë me mua, të tjerët le të mbesin". E ka marrë pushkën në dorë, dhe i ndjekur vetëm nga 120 veta, u nis për në kufirin me Serbinë. Ashtu mbaroi dhe regjimi i Ahmet Zogut.

Por a mbaroi regjimi i Ahmet Zogut? Në atë temë mundet të thuhet shumë sende, por, me dy pyetje, në të cilat duhet të jemi të qartë që të mund të parashikohen. Njëra deri më tani, politika e jashtme e Shqipërisë, kurse tjetra është me karakter të brendshëm. Do të mundohem që t'i zhvillojë këto dy pyetje, në të shkurtër.

Thashë edhe në vend tjetër, se njëra nga pikat e partisë nacionale e cila mori përsipër qeverinë, është: reformat sociale. Si do të jenë ato. Ajo është puna e legjislacionit kombëtar, por me këtë a do të mundet pjesërisht t'i vendohet fund situatës së deritanishme? Shumë pak. Çdokush mendon se populli banon, si në çdo vend, më shumë në fusha, dhe më dobët në male. Në Shqipëri është e kundërta. Sa më shumë të larta dhe të pakalueshme të jenë malet, aq më shumë janë të banuara, kurse fushat më të mirë janë shumë pak të banuara, të mos themi dhe të shpopulluara. Shqipëria në përgjithësi është e populluar dobët, 900.000 banorë janë në një sipërfaqe prej 40.000 m². Fermat mund të merren nga feudalët, kuptohet, por kush do t'i punojë? Malësorët të zbresin në fushë? Jo! Ata edhe po të dëshironin ta bënin këtë, qeveria duhet ta mënjanojë këtë masë. Në gjendjen e sotme, malësorët do të zbresin së bashku me mezeritë. Në këtë rast, derisa të aklimatizohen gjysma do të vdesin. Për t'u tjetërsuar fermat, pa pasur kujt t'u jepen, do t'u jepeshin atyre që pak punojnë, por nuk ka se kush t'i punojë. Për atë nuk shoh mjete të tjera, përveç asaj të shpopullimit, të popullohet dhe të punësojë njerëz nga rrethi, të cilët kanë punëtorë tepricë dhe kanë bujq të mirë. Më së shumti fuqi punëtoare tepricë dhe më afër Shqipërisë është Italia. Por shqiptari vetëm prej saj frikohet. Në Shqipëri ka serbofobë, grekofobë, por nuk ka italofoobë. Shqiptarët e njohin popullin italian më shumë se që populli italian i njeh shqiptarët. Ata e dinë se populli italian, pavarësisht nga mësimi i ri, nuk mund të bëhet imperialist, dhe për atë sido që të jetë politika e jashtme italiane kundrejt Shqipërisë, ajo nuk i frikon. Por, shqiptarët frikohen nga pushtimi i qetë italian. Italia mund të hedhë në territorin shqiptar nga 300 – 400.000 veta. Vetëm 3 – 4 vjet janë të mjaftueshëm që populli italian të bëhet shumicë në Shqipëri. Atëherë? Ja përse, Asambleja Kombëtare Shqiptare, menjëherë pas luftës nxori ligj për ndalimin e blerjes së patundshmërisë nga shtetas të huaj në Shqipëri.

Shteti nuk duhet të mbajë të pastrehuar, siç janë ata të cilët jetojnë në ferma. Pas tjetërsimit të tokave me ligj – për shkak se tokat e mira shumë pak të banuara, pjesa e vogël e popullsisë mund të kenë pasuri të mirë, dhe kjo pjesë e populluar

disi lehtë, për t'u bërë pronar i tokës, shteti ka mundësi që ta furnizojë me tokë, pa i prekur ato ferma të bejlerëve. E përmenda, se shteti ka fermat shtetërore. Popullata që jeton në fusha të cilët i ceka më lart, shteti duhet t'u japë nga ato toka, nga fermat shtetërore, pa marrë parasysh se kush do të punojë në ato të bejlerëve. Atëherë kush do t'i punojë këto të fundit? Kush do t'i punojë pjesët e mbetura të fermave shtetërore? Kush do t'i punojë livadhet e mëdha, për të cilat theksova se janë si kopsht i parajsës. Zgjidhja e pyetjes është: që shteti t'i mbledhë të gjithë emigrantët, të shpërndarë në vende të ndryshme të Amerikës dhe Evropës, dhe t'i strehojë të gjithë refugjatët nga Kosova, Maqedonia, Epiri dhe Çamëria, por pasi atyre t'u japë tokë, t'u japë edhe pajisje dhe inventar bujqësor, ose fermat t'ua jepte me qira afatgjate buqëve të mirë dhe të provuar, të cilët kanë kapital të mjaftueshëm, me kusht që të gjitha ushqimet e prodhuara t'i shesë në vend dhe tepricën mund ta eksportojë jashtë vendit. Qeveria shqiptare, për përpunimin e tokës, nuk mund të presë fitime të mëdha, që të mund të tërheqin koncesionarë dhe punëtorë të ngjashëm.

Tokat e shtetit dhe vakëfeve të cilat ishin mirë të punuara, i kënaqte personat shqiptarë të pa pronë dhe i shpërblente mirë bujqit e huaj, e gjithë kjo ishte e mjaftueshme që të mos ketë Shqipëria nevojë për ushqime nga jashtë dhe të krijojnë pasuri vetë. Punëtorët e mirë do të punësohen në fermat e bejlerëve, feudalët do të detyrohen pa dhunë nga ana e shtetit, me pa dëshirë t'i përpunojnë ose me punëtorë të sjellë nga jashtë, ose me ato me fëmijët e tyre të varfërohen.... Perspektiva të ngjashme, në kohë të parë, ndoshta jo, por më tutje do t'i shtyjë që t'i përvjelin mëngët dhe të punojnë. Kurse me sjelljen e punëtorëve nga jashtë, do të jenë të detyruar, me dashje apo pa dashje, që t'i investojnë kapitalet e tyre, qoftë për kafshë për lëvrim, qoftë për makina bujqësore. Përndryshe, popullata e sotshme e Shqipërisë, në një situatë të vështirë ekonomike, çfarëdo reforma sociale që të bëhen nuk mund të përfitojë shumë, nga ajo që e ndjen vendi.

Qeveria e re shqiptare duhet që të përfitojë kapitale të huaja. Duhet ta sigurojë rendin e mbrëmshëm. Duhet t'i largojë propagandat e huaja. Duhet t'i qetësojë feudalët, thjesht, duhet të marrë frenat e shtetit. Nuk dyshoj se e gjithë kjo do të gjejë mbështetje tek Forcat e Mëdha, të cilat kontribuuan për pavarësinë e vendit. Qeveria e re, pasi të gjejë kapitale nga jashtë, duhet të sjellë sa më shpejt agronomë dhe veterinerë nga jashtë, sepse vetëm bujqësia dhe blegtoria mund që ta shërojnë ekonomikisht vendin. Ajo duhet të sjellë kafshë të mëdha dhe pjellore nga jashtë që të organizojë dhe të përtërijë kafshët e dështuara. Duhet po ashtu të sjellë bujq dhe makina bujqësore për t'i punuar fushat e mbuluar me bar. Për Shqipërinë patjetër duhet të zhvillohen këto dy prodhime, por është edhe e treta, e cila është më pak tërheqëse. Ajo është shpendaria. Edhe më lart thashë, se zogj prej race të pastër ka në Shqipëri. Shqipëria duhet ta zhvillojë shpendarinë, që të bëhet eksportuesja më e madhe në rajon për pupla. Nëse këtë vit Jugosllavia eksporto i vezë për 500 milionë dinarë, Shqipëria pas 5 vjetëve do të mundet të eksportojë për 100 milionë.

Fatkeqësia e kësaj ane, në të cilën edhe qeveria është në vështirësi të mëdha, është se populli nuk ka tre klasë, por ka vetëm dy. Klasa e parë, e cila paraqet 1% nga populli, dhe klasa e tretë 99%, kurse ajo që mund ta ngrit anën, është më

shumë punë e klasës së mesme, e cila në Shqipëri thuajse nuk ekziston. Ajo duhet të krijohej nga qeveria, kurse ajo mund ta krijojë nëse i ndihmon me një racë të re të bagëtisë për blegtorët e aftë, me bagëti për punimin e tokës dhe makina bujqësore për fermerët të aftë, kurse nga teprica e madhe e oficerëve dhe zyrtarëve të krijojnë tregtarë të suksesshëm, shpendtarë, kultivues të frutave, për të cilat duhet të hapen kurse speciale.

Shqipëria nuk do të kishte vuajtur për ushqime, si tani, kurse do të kishte edhe tepricë. Këtë vit ajo ishte e detyruar që të nxjerrë një pjesë të madhe të arit nga aksionet, për të sjellë ushqim nga jashtë në vend. Ajo nuk do të binte në këtë situatë, nëse qeveritë e mëhershme si ajo e kohës së Mejdi bei Frashërit, sjell në vend të 40 vetëve inxhinierë, të paktën 20 agronomë. Përse i nevojiteshin këta inxhinierë? Vetëm për plane? Plane pa resurse, vetëm në letër të bardhë, ashtu siç mbetën. Vendi i vogël ballkanik Shqipëria duhej të merrte shembull nga shteti ballkanik i porsaçliruar Bullgaria. Mirëqenien e Bullgarisë e krijuan bujqit, blegtorët dhe shpendtarët. Populli i pasuruar pastaj lehtë mund të krijojë punë për inxhinierët. Këta të fundit nuk kanë asgjë nëse vendi nuk ka mjete financiare. Nëse Shqipëria prej viteve e këtej do të kishte agronomë dhe qeveria do të krijonte autoritete serioze, ato do të gjenin mënyrë që bujku shqiptar të ndalet të mbjellë vetëm misër dhe çdo vit pa reshje të shiut ta hedhë atë.

Por t'i lëmë fushat në një anë. Malet shqiptare, pjesa më e madhe nuk janë gurorë. Si nëpër rrafshina, ashtu dhe nëpër kodrina, ka lugje të pasura të mbjella me elb, grurë, thekër etj., të cilat edhe në vitet pa reshje jepnin korrije të mëdha, kurse kodrat shqiptare, të pasura me ujëra, do të japin patate për të ushqyer një popullatë pesë herë më të madhe se ajo shqiptare. Aty ka tokë ku mund të rriten patatet edhe nga 1 – 2 kg për copë.

Makthi i qeverive të deritanishme shqiptare ishte ajo që vendi ka shumë pasuri nëntokësore, në të cilën mbështeten, ajo është vetëm e dëmshme. Ndoshta në Shqipëri mund të ketë minerale më të mëdha nëntokësore, se kushdo mund të sugjerojë. Fjalët e Luigj Gurakuqit, të thëna në parlament: “Na thonë se kemi burime të naftës” me fjalë të sinqerta dhe patriotike, sepse inxhinierët e huaj, të pyetur nga koncesionerë të shumtë, u kanë treguar se kanë burime të naftës.....Ku janë dhe si janë, qeveria shqiptare nuk e di, dhe si mund ta dijë kur nuk ka asnjë inxhinier të aftë për miniera. Por edhe t'i dijë saktë se sa burime të naftës i ka, Shqipëria e vogël, e ngritur mezi në këmbë, forcat e mëdha e shtynë edhe më shumë që të mos dijë dhe të habitet: se çfarë të bëjë dhe kujt t'ia japë? Katër Forcat e Mëdha: Amerika, Anglia, Franca dhe Italia, garojnë se kush do t'i marrë së shpejti këto burime me koncesion.

Deri më tani qeveria shqiptare më së shumti u kushton vëmendje mendimeve të Anglisë dhe Amerikës. Amerikanët e shprehën kërkesat e tyre popullit shqiptar ndërmjet gazetave të tyre në gjuhën shqipe, shumica prej të cilave ishin eksporti i tyre, por qeveria shqiptare duhej që ta zgjedhë njërin nga të dyjat: përfitime të qarta nga amerikanët ose përkrahje politike nga anglezët. Kjo pyetje paraqitet në jetën e shtetit të vogël, aq e madhe dhe e rëndë, që edhe sot, kur ministri i financave, dhe njëri nga njerëzit më të mençur shqiptar z. Luigj Gurakuqi, me

mundim mund ta zgjidhë nëse amerikanët dhe anglezët nuk merren vesh ose nuk e marrin atë së bashku me koncesion.

Si janë ato burime me naftë, çfarë pasurie paraqesin, nuk dimë, siç edhe shqiptarët nuk e dinë, megjithatë ata janë shpëtuesit politikë e këtij vendi të vogël dhe të paafhtë që vetë ta mbrojnë vendin.

Kabineti i ri

Pas grushtshtetit dhe rënies të Ahmet Zogut, kabineti i ri u formua më 17 qershor. Ai është plotësisht homogjen dhe plotësisht del nga partia nacional – liberale. Drejtohet nga mitropoli i krishterë Fan Noli, i cili është po ashtu edhe ministër i Arsimit.

Ministër i Punëve të Jashtme u bë Sulejman Delvina, i Drejtësisë Dr. Stavri Vinjau, i Ushtrisë Qazim Qavesi, ish- toger kolonel në ushtrinë turke dhe luftëtar i madh gjatë përmbysjeve të fundit në vend.

Ministër i Punëve të Brendëshme – Rexhep Shala, ish- toger kolonel nga ushtria turke, shef i kryengritësve në Shqipërinë Veriore. Ministër për Mirëqenie Qazim Kaculi, Ministër i Financave Dr. Luigj Gurakuqi.

Ky kabinet është garancë e plotë për qetësinë në vend, sepse janë marrë në konsideratë edhe religjionet dhe lidhjet e fiseve.

Nga 7 ministrat, tre janë nga fisi i gegëve: Rexhep Shala, Qazim Qavesi, Luigj Gurakuqi. Tre janë toskë: Sulejman Delvina, Qazim Kaculi, Dr. Stavri Vinjau. Edhe sipas religjionit, lart poshtë, proporcioni është ruajtur. Katër janë myslimanë, dy të krishterë dhe një katolik.

Nga e lartpërmendura mund të shihet se çfarë burra shteti ka në qeverinë e re shqiptare, që të krijojë një pasuri në vend, nga e cila varet sukcesi i politikës. Por ajo ka të bëjë edhe me forcat e vogla nacionale, që të luftojë edhe jashtë saj. Ja se çfarë është ajo me vlerë për të ditur në këtë drejtim.

E përmenda, se kabineti i vjetër, me ekipin e vet të madh, u tërhoqën në lindje, në krye me Ahmet Zogun. Thashë se Ahmeti mund të emërtohet për gjeneral serb, kurse shokët e tij për kolonelë. Të gjithë pyeten se si është e mundur ajo me dispozicionin e marrëveshjeve ndërkombëtare, Lidhjen e Kombeve, etj? Faktet flasin, se mundet, këtë e vërteton fjala e vjetër popullore: “Mjerë i dobëti...”

Alil Lleshit, Taf – Kjazin vëllai i Ahmet Zogut, dhe shumë e shumë të tjerë, asgjë nuk i pengon që shumë kohë më parë të jenë kolonelë serbë, me të drejtë që të grabisin dhe të therin nëpër Shqipëri dhe në Maqedoni. Nëse ata, njerëz të pavlerë, mund të jenë kolonelë, përse Ahmeti dhe shokët e tij nuk mund të bëhen gjeneralë? A do të mundet qeveria shqiptare të merret aq lehtë me ata shqiptarë, të shërbimeve serbe? Ajo mund të bëhet lehtësisht, nëse do të ishte Lidhja e Kombeve dhe zotuesi i botës do të ishte drejtësia dhe jo fuqia.....Sot qeveria shqiptare në vend se ta ndërtojë të ardhmen dhe mirëqenien ekonomike të popullit të vet, duhet patjetër të luftojë, me renegatët në ekzil, kufirin nacional, mbështetur me burime dhe materiale nga shoqëria serbe, të veshur më rroba kombëtare shqiptare. Nga kalimi i luftës deri më tani qeveria serbe, qoftë me Alil Lleshin apo me Taf Kjazin, qoftë tash me Ahmet Zogun, nuk është ndalur së luftuari vendin e shkatërruar dhe të protestojë se disa kaçakë shqiptarë apo komitë maqedonas kalojnë gjatë kufirit

shqiptar duke mos u hetuar se, porë disa nga të vrarit apo kaçakët e kapur, janë shqiptarë nga Shqipëria.

A do të mund qeveria shqiptare të rrijë çdoherë në këmbë për të mbështetur trupat e kufirit ,për shkak se Serbia e mban një ekip sulmues të përbërë nga shqiptarët të cilët janë të vendosur dhe pagat i marrin nga shteti serb. A do të mund qeveria e re në këtë gjendje të mbrohet dhe t'i rezistojë presionit? Shumë rëndë. Kjo është një pyetje e ndërlikuar, në të cilën qeveria shqiptare duhet të ketë vëmendje të madhe, që një ditë të mos i shohë njësitë serbe të veshur me rrobe kombëtare shqiptarë në mes të Tiranës...

GIOVANNI ARMILLOTTA

ATJE KU FLUTUROJNË SHQIPONJAT SHQIPËRIA, PUSHTIME DHE LEGJENDA

Shqipëria moderne (“Vendi i Shqiponjave”) nisi të quhet kështu duke filluar nga shekulli XI, së pari nga historianët e Bizantit dhe në vijim, në perëndim të kontinentit tonë. Origjina e emrit, pra, “Albania”, nuk ka domethënie e “regione dell’alba” – “rajoni i agimit”, duke qenë se është pagëzuar nga shkrimtarë që jetonin në lindje të vendit. Latinisti dhe leksikografi Ferruccio Calonghi (1866-1945) i referohet temës joindoeuropiane alb- me vlerën e “malit”, prej nga ka buruar madje edhe termi latin Alpes: Alpet. Dhe në fakt, Shqipëria është një vend me male, i lehtë për t’u mbrojtur dhe i vështirë për t’u pushtuar, siç e kanë treguar edhe përpjekjet e shumta për pushtim gjatë historisë disa mijëra vjeçare të këtij vendi.

Vetë romakët, që përpara ndarjes në dy pjesë të perandorisë, identifikonin tek *Albani*, (Augusti, Plini i Vjetër) banorët e Albania-s, rajon kaukazian në perëndim të Detit Kaspik, sot Shirvan (Azerbajxhan) dhe pjesë e Dagestanit (Federata Ruse). Në po të njëjtën kohë, banorët e Shqipërisë së sotme quheshin Ilirë (Ennio, Livi, Plauti), apo Ilirikë (Ampelio, Ciceroni, Plini i Vjetër), një dëshmi e autoktonisë së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij, e cila është më e lashta e familjes indo-europiane.

Të nesërmen e ndarjes së parë të perandorisë romake (viti 286), Shqipëria e sotme ishte e ndarë në dy pjesë – Praevalitana (mes Kotorit dhe lumit Shkumbin) dhe Epirus Nova (deri në jug të gjirit të Vlorës, në Vlorë). Kjo e fundit kaloi në administrimin direkt të Augustit të Lindjes, iliriani Dioklezian, ndërkohë që pjesa tjetër e Ilirisë (nga Kotori, në Dalmaci deri në veri – i shkonte Augustit të perëndimit, ilirikut Maksimian: dhe situata u konfirmua edhe në ndarjet e mëpasshme perandorake.

Një histori pushtimesh

Nga shekulli V e këtej në pjesën ilirike të Ballkanit pati pushtime të popujve barbarë (gotë, hungarë, bullgarë, avarë) “por sic konfirmon Treccani – më të rrezikshëm nga të gjithë ishin inkursionet sllavë”, që vinin nga stepat e lindjes. Megjithatë “presioni sllav u paralajmërua më rrezikshëm pak më vonë, kur, në vitin 636 serbët u thirrën në rajonet danubianë nga vetë perandori Heraklio, i cili donte t’i kundërvinte me avarët”.

Pas kësaj, Shqipëria u përshkua nga hordhi serbësh, bizantinësh, bullgarësh dhe më pas sërish nga ushtritë e perandorisë romake të Lindjes.

Rreth vitit Një mijë, shteti bizantin – që në treqind vitet e fundit kishte pësuar goditjet, fillimisht të barbarëve longobardë nga verilindje, më pas të persëeve dhe të Islamit nga lindja dhe jugu, e më pas të barbarëve sllavë dhe bullgarë (popull me origjinë mongoliane që mori gjuhën dhe zakonet sllave) nga verilindja, kishte krijuar pesë rajone ushtarake (themata në greqisht; njëjësi thema). Thema Longobardia, i korrespondonte pak a shumë Pulias dhe Bazilikatës së sotme, me Sipontumin e rithemeluar në 1256 nga Mbreti Manfredi me emrin Manfredonia; Barium-Bari dhe Brundisium-Brindizi si qytete kryesorë; Thema Calabria përkonte me rajonin e sotëm, dhe kishte në Consentia një prej qendrave më të rëndësishme. Dy themata u krijuan në fund në Shqipëri: Thema Dyrrachium (me Dyrrachium-Durrësin dhe Antibaris-Bar) dhe Thema Nicopolis (me Aulon Ebellona-Vlorën, Buthrotus-Sarandë dhe Nicopolis-Prevezë), si dhe një të fundit, Thema Cephalenia, që gruponte Korfuzin dhe ishujt jugorë jonianë.

Më pas, dy themata-t shqiptare u bënë baza për ripushtimin e territoreve që ishin pushtuar përkohësisht nga sllavët; në fakt, nga shekulli XI deri XIV, princërit shqiptarë rimorën një pjesë të madhe të rajoneve aktualë shqiptarofonë. Kur venecianët sulmuan Kostandinopojën (12 prill 1204) dhe nënshtruan perandorinë romake të lindjes, Michele I (kushëriri i perandorit bizantin Alessio II Angelo Comneno, 1195-1203) bëri marrëveshje me princërit shqiptarë për të grupuar despotatin e Epirit në funksion antivenecian; ky kufizohej me perandorinë latine, e ngritur pas shtypjes së asaj bizantine gjatë kryqëzatës së katërt të vitit 1204, dalë jashtë qëllimeve të Papës Innocenzo III (1198-1216) dhe manipuluar nga tregtarët e Venecias, të cilët për një kohë të shkurtër kontrollonin Shqipërinë dhe Epirin. Në vitin 1261 familja Paleologu rivendosi perandorinë romake të lindjes, por despotati shqiptar i Epirit ruajti pavarësinë e tij.

“Princi” i parë

Në vitin 1355 forca e madhe ushtarake e serbëve udhëhequr nga mbreti i tyre, Stefan Dushan, mposhti perandorakët në Adrianopolis, duke turpëruar bizantinët dhe duke u përhapur në të gjithë Greqinë. Në ndërkohë, shqiptarët jo vetëm iu kundërvunë serbëve por, në vitin 1358 princi shqiptar Karl Topia mposhti despotin e Epirit, Niqifor II Orsini: Shqipëria forconte kështu limes-in (kufirin) e vet. Karl Topia – historikisht primus albanensis inter pares (disa studiues e quajnë “mbretin e parë të Shqipërisë – ishte biri i Andreas, nga ana e tij bir i Thanasit, që në fundin e shekullit XIII, mposhti serbët në Durrës; më vonë, vetë Karl Topia, në vitin 1368 çliroi Durrësin nga Angioinët napoletanë.

Ditën e San Vitos në 1389, koalicioni i popujve ballkanikë (shqiptarë, boshnjakë, bullgarë, dalmatë, serbë, hungarezë, vllleh) u mposht në Fushë-Kosovë nga Murat Pasha I, sulltan i turqve otomanë: ushtria e pashait ishte e përbërë më shumë nga ushtarë serbë të rekrutuar nga Murati I në Maqedoni se sa nga otomanë, ndërkohë që shqiptarët ishin në krah të princit kristian. Ushitari shqiptar Millosh Kopili vrau sulltanin, ndërkohë që Stefani (biri i mbretit serb llazar, komandant ushtarak i koalicionit) dhe Vuk Branković (vasali serb i Kosovës) kaluan në radhët e turqve. Stefani i dha bijën e tij, Maria Despina, si konkubinë sulltanit të ri, Bajazidit I, u bë gjeneral turk dhe ruajti zotërimet e tij.

Të nesërmen e betejës së Fushë-Kosovës, tre princërit shqiptarë, Balsha Gjergji II dhe Teodor Muzaka II- me në krye Gjergj Kastriotin I (bir i Karl Topisë dhe gjysh i Skënderbeut) – u tërhoqën në kufijtë e tyre dhe, duke iu rezistuar turqve, ishin në gjendje të ndërtonin një entitet kristian shqiptar që shtrihej nga kufijtë jugorë të Raguzës (Dubrovnik) deri në Gjirin e Patras.

Ndërkohë, në vitin 1396, gjenerali i sipërpërmendur Stefan, me 12 mijë ushtarë i dha mbështetje vendimtare Bajazitit I në betejën e Nikopolis (Nikopol, sot në Bullgari), ku me ndihmën serbe, sulltani shpartalloi ushtrinë e francezëve, skandinaveve, gjermanëve, hungarezëve dhe vllahëve, që kish dalë të pengonte ekspansionin islamik në Europën ballkanike dhe juglindore.

Mbetën shqiptarët, të cilët në shekullin XV iu kundërvunë të vetëm turqve, ndërkohë që “është lavdia e Shqipërisë, e cila i ka dhënë në këtë periudhë krishterimit njërin, dhe ndoshta më të madhin e mbrojtësve të tij, Gjergj Kastriotin” (thuhet në Enciklopedinë Italiane, 1929), i quajtur Skënderbeu.

Napoli dhe Venecia, interesa në Ballkan

Pavarësisht gjithçkaje, e ndonëse formalisht nën qeverisjen fillimisht të perandorisë së lindjes e më pas turke, me kalimin e shekujve u formuan në Shqipëri principata lokale që ruanin marrëdhënie shumë të mira me venecianët, napoletanët, amalfitanët. Entitetet ballkanike në gjirin e perandorisë bizantine ishin të interesuar për daljen në Mesdhe, dhe Venecia e Napoli kontrollonin të gjithë bregun lindor të Adriatikut, duke ruajtur marrëdhënie të mira me shqiptarët për motive si tregtare, ashtu edhe gjeopolitike (kanali i Otrantos). Napoletanët synonin marrëdhënie diplomatike me shqiptarët, ndërkohë që Venecia synonte edhe një prani të qëndrueshme strategjike ushtarake. Megjithatë, ishin pikësëpari sovranët napoletanë që konsoliduan një politikë të jashtme me shqiptarët që, me kalimin e kohës forcoi lidhjet politike, ekonomike dhe morale mes vendit të shqiponjave dhe Italisë në tërësinë e saj.

Në vijim, paqëndrueshmëria e mbrojtjes bizantine, pushtimi turk dhe vdekja e Skënderbeut (17 janar 1468), bashkë me rivalitetet e shumtë të brendshëm mes princërve shqiptarë – të cilat heroit kombëtar u përpoq t'i frenojë – sollën zhbërjen e Lidhjes së Lezhës. Në momentin e fitoreve të mëdha të Skënderbeut, Shqipëria shtrihej nga kufijtë e sotëm në Kosovë, Novi Pazar, Metohi, Dibër, Ohër, Janinë dhe Artë. Me ardhjen e pushtimit turk, shumë shqiptarë u strehuan në Venecia dhe në Italinë e jugut, ku ekzistonin tashmë forma të administrimit lokal, të qeverisura nga shqiptarë.

Viktor Emanueli III ishte mbret i Italisë dhe Shqipërisë nga 16 prilli 1939 deri në 25 tetor 1943. Por ka një aspekt pak të njohur që shënon një epokë historike gjatë të cilës një pjesë e territorit italian është qeverisur nga shqiptarë. E nëse do të donim të operonim me metrin e të drejtës aktuale ndërkombëtare, ishte më shqiptare ajo pjesë e Italisë e qeverisur nga shqiptarë në shekullin XV, se sa ka qenë “italiane” Shqipëria e kërkuar nga regjimi fashist. Por të shohim si u zhvilluan ngjarjet, duke analizuar relievin historik dhe strategjik të rajoneve në fjalë.

Monte Sant'Angelo, qendër e madhe e Promontorios së Garganos, i famshëm që në Mesjetën e hershme për faltoren e S. Michele Arcangelo – i vizituar nga

shumë papë, perandorë dhe princër – u bë një prej ndalesave të shenjta të të penduarve që shkonin për pelegrinazh në Tokën e Shenjtë, apo gjatë kryqëzatave. Edhe San Francesco d'Assisi qëndroi aty nga 1216 deri në 1222. Të spikatura, historikisht dhe artistikisht, janë edhe kisha e Shën Pjetrit, i ashtuquajtur "Varri" i mbretit longobard Rotari, kisha e S. Maria Maggiore, si dhe Kështjella Normane, për ndërtimin e të cilave, siç do të shohim, shqiptarët kanë dhënë një kontribut vendimtar.

Qyteti, i ngritur përreth vendit të shenjtë më të vjetër që ka krishterimi, pas Jerusalemit dhe Romës, ka patur një rëndësi shumë të madhe që nga epoka e vonë romake dhe mesjeta e hershme. Për më shumë se një mijëvjeçar u fortifikua në mënyrë të pandërprerë dhe rëndësia e saj taktiko-logjistike është përshkruar shumë mirë në vitin 1500 me fjalët e Markoldit: "Megjithatë, duhet ditur se katër janë pjesët kryesore, për të cilat dyshohet, se turku mund të vërë këmbë në Mbretëri, e që janë Taranto, Bari, Trani dhe Monte Sant'Angelo... Mbetet Monte Sant'Angelo, që duke qenë në krye të të gjithë Pulias rrethon gjashtëdhjetëmijë, me një pjesë mbi det, në një shkëmb shumë të fortë".

"Honor" i Monte Sant'Angelos u krijua në shkurt të 1177 nga Guglielmo II il Buono i Sicilisë (1166-89), si "vend ku ushtrohet një autoritet më i lartë se sa ai feudal" (siç ka shkruajtur historiani Pier Fausto Palumbo; si pranim i prestigjit që kishte vendi i shenjtë.

Ky rajon përfshinte veç kryeqendrës Monte Sant'Angelo, edhe Siponton, Viesten, Lesinan, Peschicin, Carpinon, Cagnanon, Sfilzin, Candelaron, Versentinon, Lanzanon dhe manastirët e S. Giovanni in Lamis, S. Maria di Pulsano, bashkë me zotërimet e tyre. Honor-i iu dha si dhuratë Giovannas, bijë e Henrikut II mbret i Anglisë (1154-89), dhe bashkëshorte e mbretit Gugliemi.

Kur Ferdinandi I i Aragonës, mbret i Napolit (1458-94) u detyrua të strehohet në Barletta, për shkak të sulmit të Angionëve, ai u rrthua në atë qytet dhe u shpëtua prej ndërhyrjes së Skënderbeut. Në shenjë mirënjohjeje mbreti, në vitin 1464 i dha në zotërim princit shqiptar dukatin e Monte Sant'Angelo, që përfshinte edhe San Giovanni Rotondon, apo më saktë l'Honor.

Honor-i i lashtë, me gjithë territorin e vet të gjerë, ndërpreu procesin e tij të shpërbërjes dhe në të hyri një dukat me përmasa shumë të reduktuara dhe juridiksion më të kufizuar, në krahasim me të kaluarën, por më lehtësisht i mbrojtshëm.

Zotërimi i Skënderbeut dhe trashëgimtarëve të tij zgjati afro njëzetë vite. Ferdinandi I kishte dashur t'i demonstronte mirënjohjen e tij princit shqiptar, duke i dhënë, bashkë me feudin, edhe shumë kompetenca dhe të drejta hyrjeje, si privilegji i "marittima"-s, domethënë mbledhjen e taksave për mallrat që ngarkoheshin dhe shkarkoheshin, juridiksionin e drejtpërdrejtë të drejtimit, të drejtën për të eksportuar mallra me çfarëdolloj vlere nga brigjet e Monte Sant'Angelo dhe nga porti i Mattinatas, me përjashtim të të drejtave mbi Manfredonian.

Ndërkohë që Skënderbeu ishte në Shqipëri, duke luftuar kundër turqve në 1467, bashkëshortja e tij erdhi në Monte Sant'Angelo për të marrë Kështjellën dhe për të banuar. Por, pas vetëm pak muajsh iu desh të kthehet në Shqipëri, për t'i

qëndruar pranë bashkëshortit të sëmurë, i cili vdiq në moshën 65 vjeç. E mbetur e ve, Donika, me të birin Gjon Kastrioti shkoi të jetojë në Napoli me të ardhurat që merrte prej dukatit të Monte Sant'Angelo, ku kishte siguruar edhe mbledhjen e taksës mbi kripën.

Koha dhe sulmet e pësuar kishin lënë tashmë shenja mbi Kështjellën Normane dhe muret e saj të fortifikuar. Ferdinandi I, që në 1475 u kthye në Monte Sant'Angelo jo si luftëtar, por si pelegrin, vërejti me sytë e tij domosdoshmërinë e restaurimit të pikave më të rëndësishme të fortifikimeve. Në vitin 1483, ai urdhëroi Gjon Kastriotin që të merrte masat me qëllim që “tokat e bregdetit, të malit, të Viestes, të mos kenë asnjë lloj dobësie ndaj sulmeve të armikut”. Punimet e restaurimit kanë vazhduar me siguri në mënyrë të kënaqshme, përderisa në 1484, mbreti i shkruante “qytetarëve të Monte Sant'Angelo, duke i falënderuar për përkushtimin me të cilin kanë ndjekur fortifikimin dhe restaurimin e mureve të vjetruar të qytetit. Ai u lutet qytetarëve të mbajnë sa më mirë, sado që është i munguar, Gjon Kastriotin, zotërinë e tyre, i cili ka shkuar në tokën e Otrantos të luftojë kundër armiqve” (N. Barone).

Shkëmbimi i Gjonit

Në përfundim të punimeve, në 1493, kështjella e Monte Sant'Angelo siç ndodhi në po të njëjtën kohë edhe për atë të Manfredonias, ishte e përforcuar nga dy kulla të mëdha, përveç se me mure më fortë që u shkonin për shtat nevojave të reja për mbrojtje, që kishin lindur prej përdorimit të artilerive, apo armëve të reja të zjarrit. Mbreti u ndie shumë i kënaqur nga punimet e kryer dhe, në 1492 informoi Giacomo Pontanon dhe të tjerët për masat që ai kishte marrë në rast se “turqit prishnin paqen”, sii dhe kërkoi që në Monte de Sancto Angelo Messer Theodoro të shkonte bashkë me njëqind burra të armatosur. Është kjo periudha kur Ferdinandi I nisi të ngrerë shumë kulla roje kundër saracenëve që, të ndërtuara në pjesën më të madhe gjatë periudhës spanjolle, vërehen edhe sot e kësaj dite përgjatë bregut të Garganos dhe të gjithë Italisë jugore.

Duke iu kthyer çështjeve të feudit shqiptar, Gjon Kastrioti, në 1484, duke mos duruar nervozizmin e demonstruar nga popullsia për taksat e domosdoshme që ishin mbledhur për fortifikimin e zonës, kërkoi dhe siguroi nga mbreti këmbimin e Monte Sant'Angelos dhe San Giovanni Rotondos me tokat e Soletos dhe San Pietro in Galatina, pranë leçes, me titullin e Kontit.

XHEVAT LLOSHI

NGA VEPRIMTARIA PËR SHQIPEN NË MANASTIR

Në kujtesën historike të shqiptarëve emri i qytetit të Manastirit u ngulit në mënyrën më tragjike me masakrën e 500 krerëve shqiptarë më 26 gusht 1830, të organizuar pabesisht nga Mehmed Reshid Pasha. Por më 1908 emri i këtij qyteti u bë pjesë e pandarë e historisë së kulturës shqiptare me Kongresin e Manastirit për alfabetin e shqipes, që mbeti përfundimisht alfabeti i kësaj gjuhe. Sot qyteti quhet Bitola dhe shumë njerëz në Shqipëri nuk e dinë se është fjala pikërisht për Manastirin. Si ka ndodhur kjo luhatje kaq e thellë perceptimi kundrejt po atij vendbanimi?

Heraklea e lynkestëve e mori emrin nga Filipi II i Maqedonisë në mesin e shek. IV para erës së re, sipas gjysmëperëndisë Herakliut ose Herkulit. Në periudhën e hershme bizantine u bë qendër e rëndësishme peshkopale dhe më pas pati shumë kisha e manastire, nga e mori emrin Monastiri sipas greqishtes dhe nga kjo vjen trajta Manastir, sipas rregullave fonetike të turqishtes. Me këtë emër mbeti për shqiptarët. Mendohet se edhe emri i sotëm sllav Bitola vjen nga “obitel” që ka po ashtu kuptimin e manastirit. Ishin pikërisht dyndjet sllave që e shkatërruan në fund të shek. VI, por më pas bullgarët e populluan krahinën dhe cari Samuil ndërtoi kështjellën e tij, e cila u rindërtua më 1015. Tashmë ishte një qendër e rëndësishme ushtarake, politike dhe ekonomike, kur më 1382 e pushtuan osmanët, domethënë shtatë vjet para Betejës së Kosovës. Osmanët e kanë përdorur kurdoherë si bazë ushtarake, nga janë nisur sulmet kundër Skënderbeut, Ali Pashë Tepelenës, Mustafa Pashë Bushatlliut dhe Zenel Gjolekës, sepse ishte në një pikëkalim kyç për në brendësi të Ballkanit.

Pas djegies së Shkupit më 1689, Manastiri mori rëndësi. Sipas E. Çelebiut, kur e vizitoi ai, tashmë kishte 70 xhami dhe 900 dyqane. Në fund të viteve 1830 kishte 35 mijë banorë. Më 1864 u bë qendër e ejaletit të Manastirit, ku bashkë me këtë qytet, bënin pjesë edhe sanxhakët e Dibrës, Elbasanit, Korçës etj. Ndërsa më vonë, politika osmane për të mos e lejuar bashkimin e shqiptarëve në luftën për trevat e veta, i ndau trevat e tyre në 4 vilajete. Njëri vilajet, i krijuar më 1875 dhe që hynte thellë mes tokave shqiptare, e kishte qendrën në Manastir. Pas një periudhe të shkurtër, kur përfshihej nën juridiksionin e Selanikut, mbeti qendër vilajeti deri më 1913. Aty u vendosën 12 konsuj të vendeve europiane, aq sa u mbiquajt “qyteti i konsujve”. Nga fundi i shek. XIX arriti të bëhej qyteti i dytë më i madh në Ballkanin jugor pas Selanikut, me të cilin u lidh me hekurudhë më 1894. Sipas të dhënave të botuara më 1898, Manastiri kishte 45 mijë banorë.

Fillimet e veprimtarisë për shqipen në Manastir lidhen me dy anë: së pari, me familjen Qiriazzi; së dyti, me ardhjen e misioneve protestante dhe të agjentëve të Shoqërisë Biblike.

Pas themelimit të Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja (BFBS) më 1804, ajo shumë shpejt u interesua për përkthimet në gjuhën shqipe dhe arriti më 1824 të botonte të parin ungjill shqip (Mateun) dhe pastaj Dhiatën e re më 1827, të përkthyer nga V. Meksi dhe të redaktuar nga G. Gjirokastriti. Kjo Shoqëri ngrinte depozita në qendra kryesore dhe i shiste botimet me librashitës shëtitës, që ndërmerrnin udhëtime nëpër vend. Në vitin 1861 në krye të degës së BFBS në Stamboll për gjithë Perandorinë Osmane erdhi Aleksandër Tomsoni (1820-1899). Pa kaluar shumë kohë ai vendosi të njihej me viset shqiptare për të parë kushtet për shitjen e librave shqip dhe për nevojat e reja. Në një shkrim pas këtij udhëtimi, ai i ka quajtur shqiptarët “një racë e egër por fisnike”. Pas njëzet vjetësh njohjeje nga afër me këtë popull ai e ka ndryshuar vlerësimin, por duke ruajtur gjithmonë të njëjtin epitet: “Shqiptarët janë një popull fisnik.” (22 shkurt 1884) Ai e pa se botimet toskërisht me alfabetin mbi bazën e shkronjave greke nuk mund të përdoreshin nga popullsia e Shkodrës dhe një vit më pas arriti të lidhej me K. Kristoforidhin për të bërë përkthime edhe gegërisht. Njëkohësisht në Shodër vendosi një gjerman, Hermann Riedel (Ridel) si depozitar, ndërsa në maj 1865 në Janinë vendosi skocezin Aleksandër Davidson. Gjatë udhëtimeve të tyre këta librashitës çuan për herë të parë në Manastir libra shqip: Rideli në fund të vitit 1864, pasuesi i tij Edward von Laer më 1869.

Pas Luftës së Krimesë sulltani u detyrua t’u bënte lëshime fuqive të huaja, pa mbështetjen e të cilave do të ishte mposhtur. Më 1852 ai nxori një ferman, me anën e të cilit e lejonte veprimtarinë e protestantëve. Që më 1810, për të ndihmuar grupet e predikuesve ishte krijuar Bordi Amerikan i Komisionerëve për Misionet e Huaja, sepse ata përndiqeshin. Tashmë me fermanin veprimtaria e tyre ishte më e sigurtë, u zgjerua në pjesë të tjera dhe më 1872 në Stamboll u ngrit Shtëpia e Biblës, në të cilën u vendos edhe BFBS. Pikërisht në verën e atij viti John Baird (Berdi) kishte mbaruar Seminarin protestant të Çikagos dhe në tetor u nis bashkë me dy misionarë të rinj për të punuar në Perandorinë Osmane. U vendosën në Eski Zagra të Bullgarisë. Pas një viti veterani i Luftës Civile amerikane Edward Jenney (Xheni) mbaroi Seminarin Andover të Masaçusetsit dhe në fund të gushtit u nis gjithashtu për në Turqi. Berdi dhe Xheni zgjodhën Manastirin si qendër vilajeti dhe u vendosën aty më 18 tetor 1873. Morën me qira një shtëpi, që ishte prapa shtëpisë së familjes Qiriazzi.

Familja e Qiriazëve u shpërngul në fillim të shek. XIX nga Perasi i Korçës dhe u vendos në Tërnovë afër qytetit të Manastirit. Gjasim Qiriazzi lindi në familjen me shumë fëmijë të Dhimitrit. Ky ishte marrë me tregtinë e lëndës së drurit për ndërtim dhe prandaj u vendos në Manastir, ku hapi një magazinë të madhe. Sipas Skënder Luarasit, ai e ruante frymën e atdheut dhe prandaj kishte në shtëpi abetaren e N. Veqilharxhit e përkthimet shqip të K. Kristoforidhit.¹ Sipas Xh.

¹ Skënder Luarasi, *Gjasim Qiriazzi. Jeta dhe vepra*. NSHB Naim Frashëri, Tiranë, 1962, f. 21.

Kuanrudit,² viti i lindjes së Gjasimit është 1858 dhe jo 1861, siç e kanë pasur S. Luarasi dhe pas tij gjithë botimet shqipe, edhe Historia e Shqipërisë, edhe Fjalori Enciklopedik Shqiptar.

Gjasimi mbaroi shkollën në gjuhën greke dhe pastaj hyri në punë si çirak te një këpucar. Misionarët amerikanë ia dolën që në fund të vitit 1876 të pranin dy vendës në bashkësinë protestante. Njëri prej tyre, Nikolla, ishte shok me Gjasimin dhe arriti të ushtronte ndikim mbi të. Madje Xheni e ndihmoi familjen, kur një herë Sevastia u sëmur nga malaria. Dhe pas kësaj ajo hyri në shkollën amerikane, ndërsa Gjergji ndiqte shkollën e së dielës, duke mësuar nga pak anglisht. Vetë Gjasimi i ri vendosi që të bëhej anëtar i bashkësisë protestante, por hasi kundërshtimin e rreptë të familjes dhe të faretit.³ Në gusht 1877 ai u pranua në bashkësinë protestante. Vitin tjetër ndiqte një kurs te Berdi në gjuhën bullgare për t'u përgatitur që të vijonte mësimet më tej.

Kolegji Teologjik Amerikan i Samokovit ishte hapur në shtator 1872. Aty Gjasimi u pranua në klasën përgatitore më 1878, ndërsa shpenzimet përballoheshin nga Misioni Amerikan. Më pas shkolla u quajt Instituti Teologjik dhe Kolegji Amerikan, por pas Kongresit të Berlinit tashmë Samokovi i përkiste Bullgarisë. Gjasimi e përfundoi shkollën në vitin 1882 dhe mori pjesë në mbledhjen vjetore të Misionit Protestant për Turqinë të Bordit Amerikan në Stamboll. Aty iu caktua që të mbikëqyrte një kongregacion të vogël bullgar në Shkup. U kthye në Manastir, por Bordi Amerikan nuk kishte fonde për ta mbajtur një përfaqësues aty. Atëherë Berdi i rekomandoi që t'i drejtohej A. Tomsonit.

Ndërkohë K. Kristoforidhi jo vetëm kishte botuar një varg përkthimesh shqip, por edhe abetare e broshura të tjera, të cilat kishin qarkulluar me sukses të veçantë në Shqipëri dhe, natyrisht, në vilajetin e Manastirit. Për veprimtarinë e tij të palodhur kam botuar tashmë një vëllim të gjerë, ku janë botuar edhe mbi 200 dokumente përkatëse,⁴ prandaj nuk është e nevojshme të shtjellohet këtu. E vlen të përmendet megjithatë se në Manastir kishte arritur edhe përkthimi i Mateut i vitit 1824, sepse Berdi i ka shkruar Londrës në maj 1875 që të rishikohet përkthimi, meqë sipas mendimit të tij "ai mëson herezi". Në të vërtetë ai nuk e ka kuptuar sistemin e zbatuar për të dalë tekste shqip i kuptueshëm, duke kapërcyer ndryshimet e thella ndërmjet gjuhëve gjatë përkthimit. Emri i Kristoforidhit me Manastirin lidhet edhe në një rast tjetër me peshë. Më 16 korrik 1880 Lordi E. Fitzmaurice, përfaqësuesi i Britanisë në Stamboll në bisedimet e Komisionit Europian për Rumelinë Lindore, që pasuan Kongresin e Berlinit, i ka marrë një intervistë Kristoforidhit (botuar në "Blue Book", vëll I, 1881), i cili mes të tjerash i ka thënë: "Bullgarët, shqiptarët dhe grekët fanatikë të gjithë njësoj kërkojnë Manastirin, Ohrin e Korçën, sikur u përkasin atyre, dhe japin statistika për të vërtetuar pretendimet e tyre, të cilat i dinë se janë të rreme, me shpresën se nuk do të

² Xhon Kuanrud, *Besë, shpresë dhe dashuri. Jeta e Gjasim Qiriazit*. Kartë e Pendë, Tiranë, 1998, f. 32-33.

³ Edwin Jacques & David Joung, *Ungjilli ndër shqiptarët*. Tenda, Prishtinë, 2000, f. 40.

⁴ Xhevat Lloshi, *Kristoforidhi përmes dokumentimit*. Bota Shqiptare, Tiranë, 2005.

demaskohen. Në këtë çështje fajtorët kryesore janë grekët.” Për Kristoforidhin Korça është shqiptare, kurse Ohri dhe Manastiri jo.

Me mbështetjen e A. Tomsonit u botua edhe “Gramatika e gjuhës shqipe” e Kristoforidhit pikërisht po atë vit. Njëkohësisht në korrik 1882 i biri i Tomsonit, Roberti, mori pjesë në mbledhjen vjetore të Misionit Protestant për Turqinë Europiane në Manastir. Kur u kthye në Stamboll, i tregoi të atit për Gjerasimin. Ky u rekomandoi misionarëve të Manastirit (letër e 28 tetorit 1882) që të hapnin një klasë të mbrëmjes shqip, tashmë kur ishin të gjitha materialet e nevojshme shqip. Berdi nga Manastiri i shkroi qendrës së vet, Bordit Amerikan të Bostonit, por ata u përgjigjën se nuk kishin mundësi ta financonin. Që nga kjo kohë u krijua një gjendje e paqëndrueshme për Gjerasimin dhe sidomos një vështirësi, duke u ndodhur ndërmjet dy organizmave: Shoqërisë Biblike të Londrës dhe misioneve amerikane.⁵ Ky rivalitet ka vijuar deri ndërmjet dy luftërave botërore dhe, natyrisht, ka pasur pasqyrime edhe në Manastir.

Më 27 janar 1883 Tomsoni i bëri një ftesë bashkëpunimi Gjerasimit, duke i shprehur dëshirën që fëmijët shqiptarë të kishin mundësinë të ndiqnin shkollën në gjuhën shqipe, vetëkuptohet, për të pasur mundësinë të lexonin librat e shenjtë shqip, të përgatitur nga Kristoforidhi. Synimi i tij ishte të gjente një shqiptar për ta dërguar përfaqësues në Shkodër. Tashmë marrëdhëniet e BFBS me Kristoforidhin ishin ndërprerë, sepse Tomsoni në këtë letër shënon: “Fatkeqësisht, përkthyesi K. Kristoforidhi nuk është një i krishterë aktiv”. Një javë më pas i kërkoi Berdit dhe Xhenit në Manastir (letër e 2 shkurtit 1883) mendimin e tyre për Qiriazin, duke u premtuar se nuk do ta njoftonte pa marrë përgjigje prej tyre. Ndërkaq, Gjerasimi ishte i detyruar të punonte për Misionin Amerikan, i cili i kishte financuar shkollimin. Nga Shkupi, ku ndodhej me atë detyrë, ai i propozoi Tomsonit, që të ndërmernte një udhëtim nëpër Shqipëri bashkë me një librashitës tjetër (letër e Gj. Qiriazit, 15 shkurt 1883).

Ishte viti kur, pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, qeveria osmane ndërmori përndjekjen e gjithçkaje të shkruar shqip, ndaloi qarkullimin e librave në Shqipëri dhe ndaloi madje shtypjen e librave shqip nga BFBS, në kundërshtim me marrëveshjen zyrtare dhe me parimin e lirisë fetare, që kishte pranuar prej kohësh. Megjithatë, është interesante se përndjekjet jo vetëm nuk i stepën shqiptarët, por e shtuan dëshirën e tyre për librin shqip. Është shumë domethënëse ky fakt. Në Raportin vjetor të agjencisë së tij për vitin 1883 A. Tomsoni e ka vënë në dukje me kënaqësi, se shitja e librave shqip ka qenë madje pothuaj dyfish më e madhe se një vit më parë. Në shkurt 1884, pasi përmend se i kanë ardhur kërkesa shumë të

⁵ Tashmë që nga libri i S. Luarasit më 1962 janë botuar mjaft libra të tjerë dhe shkrime kushtuar Gj. Qiriazit e veprimtarisë protestante përgjithësisht në Shqipëri. Secili autor ka ndjekur qëndrimin e vet, duke nxjerrë në pah anët që i interesonin dhe duke i lënë mënjanë të tjerat. Në këtë artikull jam mbështetur kurdoherë në dokumentet, duke sjellë kështu të dhëna të tjera kundrejt autorëve të mëparshëm. Përveç atyre të botuara tashmë, kohët e fundit kam shfrytëzuar edhe disa dokumente të tjera, të përcjella nga Stambolli në Londër sivjet për t’i kaluar në Arkivin e BFBS në Kembrixh. Prej një përkimi të rastit, shumica e tyre janë pikërisht për periudhën 1883-1888 dhe të lidhura me veprimtarinë e Gjerasim Qiriazit.

ngutshme nga popullsia e krishterë e krahinave të ndryshme të Shqipërisë së Jugut për t'ua dërguar Shkrimet e shenja në gjuhën e tyre amtare, ai shton se qarqet fetare greke: “Vazhdimisht nuk kanë pranuar që t'u jepej shqiptarëve arsimit në gjuhën e tyre, sepse kanë dashur t'i greqizojnë dhe kështu të rrisin numrin e vet, që vërtet është i vogël... Kam synuar që të ngrihet ky popull duke nxitur mësimin e gjuhës shqipe, që është e vetmja të cilën e kupton masa e njerëzve... por na duhet të përballojmë kundërshtimin e përhershëm nga ana e qeverisë osmane, e cila përpiqet të ndalojë çdo libër shqip, ndonëse të botuar me lejen e tyre jashtë Shqipërisë.”

Në maj 1883 Gjerasimi mori miratimin e Tomsonit dhe u nis në Manastir, u takua me librashitësin tjetër dhe më 14 maj nisën një udhëtim të gjatë me shumë peripeci nga Korça në Berat e deri në Shkodër e kthim në Manastir në gusht. Gjatë kohës që qëndroi disa muaj në Stamboll (1883-1884) pranë Tomsonit, tërthorazi del se Gjerasimi ka takuar edhe Naim Frashërin, me të cilin ka biseduar dhe i ka parashtruar së pari çështjen për heqjen e ndalimit të vënë nga qeveria për qarkullimin e librave dhe të lejohej botimi i librave shqip.⁶ Gjerasimi që në fillim e kishte shprehur qartë, se nuk e shihte veten të aftë për punën e librashitësit, ndërsa “ka dëshirë të madhe të punojë për bashkatdhetarët e vet në Shqipëri.” (A. Tomson, 22 shkurt 1884) Për këtë qëllim ai mendonte të hapte një dhomë leximi dhe një shkollë të së dielës shqip. Në prill 1884 propozoi që të vendosej në Manastir, ku kishte edhe shtëpinë e prindërve. Sipas tij, në atë kohë në Manastir kishte rreth një mijë familje shqiptare. Tomsoni ia arriti ta caktonte depozitar dhe përgjegjës për librashitësit me vendim të BFBS në Londër (prill 1884). Tashmë kemi edhe deklaratën e tij për kushtet e punësimit, të cilën e quaj të nevojshme ta bashkangjis si shtojcë, meqë është e panjohur.

Rrugës më 8 qershor Gjerasimi mbajti një shërbesë në gjuhën shqipe në Selanik, arriti në Manastir më datë dhjetë dhe më 22 qershor 1884 mbajti shërbesën e parë shqip përpara 36 vetave. Në një shërbesë në fund të shtatorit ka marrë pjesë edhe Tomsoni, që ishte për vizitë në Manastir dhe ka shënuar se merrnin pjesë edhe tri gra, ndërsa Gjerasimi kishte arritur të siguronte respektin e bashkatdhetarëve. Në dërrasën e zezë ishin shkruar edhe disa vargje shqip, të hartuara prej Gjerasimit.⁷

⁶ E kam përmendur edhe në librin për K. Kristoforidhin, se Tomsoni më vonë është takuar herë tjetër me Naim Frashërin. Por tashti del se këto marrëdhënie janë më të hershme. Më 14 shkurt Tomsoni ka shkruar: “Me sugjerimin e një anëtar i Këshillit të Arsimit, unë kam bërë një kërkesë të re, paraqitur Zyrës së Shtypit, për të marrë leje që të shtypen përkthimet toskërisht të disa librave të Dhiatës së vjetër me alfabetin latin e grek të përzier, e gjithashtu të shtypet një katekizëm i vogël gegërisht me alfabet latin.” Edhe në një letër tjetër pas një muaji, më 15 mars, ai e përsërit: “Mund të shtoj se kam pasur biseda të gjata javën e kaluar me një zotëri shqiptar, anëtar i Këshillit të Arsimit, të cilit besoj se ia detyrojmë dhënien e lësaj lejeje. Ai është mysliman, por ai i uron sukses punës sonë si protestantë në Shqipëri. Atij i pëlqejnë përkthimet tona dhe mendon se dialekti që përdorim ne është i kuptueshëm si për gegët, edhe për toskët. Por atij i pëlqen një alfabet tjetër.”

⁷ Krijimet e Gjerasimit u përmbledhën më pas nga i vëllai, Gjergji, dhe u botuan në Shtypshkronjën shqipe të Sofjes më 1902 me titullin *Hristomathi me katër pjesë*.

Tomsoni i ka quajtur këto “shërbesat e para, kur populli shqiptar dëgjon Ungjillin në gjuhën e vet”.⁸ S. Luarasi⁹ ka vënë në dukje, se një italian nga Manastiri, Il Ciulli, ka shkruar më 21 gusht 1884: “Një shqiptar protestant, që bën studime të veçanta në gjuhën e tij, pas së cilës është dhënë me mish e me shpirt, po përpiket të botojë një gramatikë shqipe fare origjinale.” Që kur ishte në Stamboll Gjerasimi kishte punuar për një abetare të re toskërisht. Më vonë, në kujtimet e saj e motra, Sevastia ka shkruar se ishte pikërisht ai që i mësoi shkrimin e këndimin në gjuhën amtare. Ajo sillte në dhomën e leximit shoqet e saj dhe u tregonte librat shqip.

Një ngjarje e rëndë e ndërpreu veprimtarinë e tij. Më 12 nëntor u nis për në Korçë, por ra në duart e bandës së Shahin Matrakut, të cilët e mbajtën peng gjashtë muaj dhe e trajtuan me egërsi.¹⁰ U lirua dhe u kthye në mesin e vitit 1885 në Manastir. Tashti nisi mësimin e shqipes me tri vajza shqiptare, nxënëse të shkollës së vajzave të Misionit Amerikan, si dhe me të motrën, ndërsa një këpucar i ri vinte tri herë në javë. Në dhjetor tashmë ishin bërë 10 nxënës. Këto të dhëna janë me interes për të saktësuar pohimet e bëra deri më sot pa ndonjë mbështetje dokumentare. Në botimet e “Historisë së Shqipërisë”, vëllimi II, është mbajtur ky pohim: “Gjithashtu aty nga viti 1885 Gjerasim Qiriazi kishte hapur në Manastir një shkollë private shqipe për djem dhe për vajza.” Dokumentimi i ri, siç shihet, jep një pamje tjetër, që përputhet me dëshirën e tij të shprehur një vit më parë për një dhomë leximi të Shkrimeve të shenjta dhe një kurs të ditës së diel. Në prill 1886 ka shkruar: “Çdo javë u bëj nga një mësim për historinë e Shqipërisë, materialet për të cilën i mbledh nga libra të ndryshëm.”

Veziri i madh Sait Pasha, i cili e kishte ndaluar punën me gjuhën shqipe, pas humbjes në shtator 1885, kur Turqia u detyrua t’u lëshonte toka bullgatëve, më në fund u shkarkua nga detyra. Gjerasimi rifilloi shërbesat shqip dhe në to merrnin pjesë njerëz, që kishin marrë vesh për predikimet shqip, sidomos ata që vinin për tregti nga Korça. Klerikët ortodoksë e shihnin këtë si një rrezik kërcënues, sepse me përfshirjen e gjuhës shqipe në shërbesat fetare do të kalohej në zhvillimin e një bashkësie të krishterë prej vetë shqiptarëve. Tomsoni e ka vlerësuar kështu mësimin e shqipes: “Shkolla në Manastir është me shumë rëndësi dhe jam i interesuar, që sa më shumë njerëz të mësojnë të lexojnë rrjedhshëm shqip.” (6 nëntor 1886)

Për herë të parë në fund të tetorit 1886 A. Tomsoni i parashtroi Gjerasimit çështjen e alfabetit. Botimet toskërisht të Kristoforidhit ishin me një alfabet të përshtatur me shkronja greke. Këtë e jepte mësim Gjerasimi. Por ishin bërë pesëmbëdhjetë vjet që po përhapej alfabeti i Stambollit. “Do të jetë e nevojshme që për një periudhë jo të shkurtër të jepen mësim të dy alfabetet, edhe në rast se alfabeti i ri do të sanksionohet nga qeveria... Është e dëshirueshme, në rast se do të bëhej e mundur, të kishte vetëm një alfabet për të gjitha gjuhët, ndërsa alfabeti ynë i gegërishtes është pjesë e atij që është propozuar si i tillë nga studiuesi gjerman Lepsius.” Dhe shton më tej: “Jam shumë i kënaqur që i hodhëm hapat e parë në

⁸ Xh. Kuanrud, *vep. cit.*, f. 84.

⁹ S. Luarasi, *vep. cit.*, f. 26.

¹⁰ Gjerasim D. Qiriazi, *Pengu i kaçakëve*. Kartë e Pendë, Tiranë, 1993.

Manastir të shoqëruar nga vëllezërit amerikanë dhe nuk dua të heq dorë nga një qendër e tillë. Por popullsia shqiptare nuk është e shumtë, kurse rruga për Shqipëri është me rreziqe.” Kështu mjaft shpejt u shfaqën shenjat se veprimtaria në Manastir, ndonëse si një fillim i mirë, sidoqoftë do të mbetej e kufizuar, ndërsa do të kishte shtrirje më të madhe në Shkodër për pjesën veriore të vendit, kurse qendra për jugun duhej të ishte në Korçë. Për Gjerasimin dolën kështu dy drejtime të reja: të ndërtonte fillimet e veprimtarisë në Korçë dhe të punonte për kalimin e botimeve të mëparshme në alfabetin e Stambollit.

Nga fundi i vjeshtës 1887 Gjerasimi vizitoi Korçën. Por në javën e fundit të nëntorit 1888 autoritetet osmane të Manastirit i bastisën shtëpinë, ia vulosën gjithë materialet, duke përfshirë edhe dorëshkrimin e Mateut që po e përshtaste. Me nxitjen e klerit grek valiu i Manastirit u betua me këtë rast, se do ta bënte shitjen e librave shqip aq të vështirë dhe të kushtueshme, saqë Shoqëria Biblike të detyrohej të hiqte dorë nga ajo punë. Vetëm në mesin e vitit 1889 Gjerasimi mundi të punonte në Bukuresht për botimet e reja me alfabetin e ndryshuar, madje atje pati si ndihmës Jani Vreton. Ndërkohë Berdi i misionarëve amerikanë kishte nisur të mësonte edhe vetë shqipen, kështu kishte mundësinë të bashkëpunonte me Gjerasimin. Tomsoni ishte i shqetësuar, sepse kishte zbuluar që Kristoforidhi ishte mbështetur në versionin e Septuagintës për Psalmet, prandaj u kërkoi të dyve më 1890 ta ndreqnin botimin e mëparshëm. Tashmë protestantët blenë në Manastir tokën për të ngritur një kishë ungjillore dhe Gjerasimi u dorëzua si ungjilltar në prill. Pas dy javësh u shpërngul në Korçë dhe kështu mori fund puna e tij, bashkë me mësimin e shqipes në Manastir. Vitet e fundit të jetës së tij në shërbim të shkollës shqipe në Korçë janë përshkruar hollësisht në historinë e arsimit shqiptar. Edhe e motra, Sevastia, pas mbarimit të shkollës në Stamboll u kthye në Manastir dhe në tetor 1891 kaloi gjithashtu në Korçë.

Disa atentate u kurdisën kundër Gjerasimit, por edhe atij vetë iu rëndua sëmundja dhe u kthye në Manastir, ku vdiq më 2 janar 1894. Me këtë mbyllet edhe një etapë e punës me shqipen në Manastir. Hauard Shipli, nënkonsull britanik në Manastir, mes të tjerash më 25 mars 1893 i ka shkruar konsullit Blant në Selanik: “Kjo nismë si përpjekje për ndërthurjen e lëvizjes fetare me lëvizjen për qëllime laike që të zhvillohet mësimi i gjuhës shqipe mund të sjellë më shumë të mira se të këqija...” Ky është një përfundim për mëdyshjen e marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy anëve: fetare dhe atdhetare, të përfaqësuara nga veprimtaria e të huajve dhe e atdhetarëve shqiptarë. Nënkonsulli vijon, duke vënë në dukje se përpjekjet e z. Qiriazi, veçanërisht në anën mësimore, gëzojnë përkrahjen e madhe të Misionit Amerikan në Manastir. Për më tepër, edhe shkollat në krahinën e Korçës e të Kolonjës nuk kanë asnjë mbështetje tjetër nga jashtë, veç përkrahjes së Misionit Amerikan të Manastirit, duke mos përjashtuar disa ndihma të pakta nga Komiteti shqiptar i Bukureshtit. Sipas nënkonsullit, Qiriazi dhe miqtë e tij janë përpjekur të fitojnë të drejtën e lirisë së shprehjes së adhurimit fetar në gjuhën shqipe.

Menjëherë Gjerasimin e zëvendësoi i vëllai, Gjergji, si mbikëqyrës i shitjes së librave në fillim në Korçë e më pas në Manastir. Gjergji gjithashtu kishte mbaruar kolegjin e Samokovit dhe ishte ndihmës i Gjerasimit për gjithë punën në Korçë. Nga ana tjetër, Tomsoni kujdesin kryesor e kishte të rishikimet e nevojshme

për botimet e reja. Pikërisht me vdekjen e Gjasimit përmend për herë të parë Thanas Sinën, por në fillim propozoi ta dërgonte librashitës në Manastir nën mbikëqyrjen e Berdit, si një provë për të parë “a mund t’u bënte ballë përndjekjeve nga vali i Manastirit, Faik Pasha.” Sina kishte dhënë mësim tre vjet në shkollën shqipe për djem të Korçës, kishte qenë sekretar i “Vëllazërisë ungjillore” të themeluar nga Gjasimi më 1892 nën mbrojtjen e BFBS dhe prandaj do të bashkëpunonte fare mirë me Gjergjin, duke përtërirë gjurmët e Gjasimit.

Viti 1896 u shënua nga dy ngjarje, të lidhura me temën e këtushme. Sulltani shpalli dekretin “Mbi reformat në vilajetin e Rumelisë”. Në këtë kuadër një vit më pas Shoqëria “Dituria” miratoi një memorandum dërguar Portës së Lartë dhe Fuqive të mëdha në Stamboll, ku mes të tjerash kërkohej që të ngrihej një vilajet i vetëm shqiptar me kryeqytet Manastirin. Me sa duket, kjo ide ka qenë prapa asaj lëvizjeje të shumanshme, e cila orientohej drejt Manastirit në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX. Manastiri ishte kryeqendra e një vilajeti me shumicë shqiptare, pavarësisht se si qytet nuk kishte shumicë të popullsisë shqiptare. Ngjarja tjetër ka qenë dalja në pension po atë vit e A. Tomsonit, i cili u zëvendësua nga T. R. Hodgson (Hoxhsoni). Në një farë mënyre bashkë me të mbyllej faqja e Kristoforidhit dhe e Gjasimit. Është domethënëse që po atë vit Gjergji nisi transkriptimin e dorëshkrimeve të Kristoforidhit në alfabetin e ri.

Konsullata e Austro-Hungarisë në Manastir në fillim merrej edhe me interesat britanikë dhe prandaj nuk është e rastit që Gjergji bashkëpunonte me të (prej 1 marsit 1905 ishte dragoman honorar i saj). Emri që del më dendur në dokumentacionin për Shqipërinë është ai i konsullit A. Kral. Në mesin e vitit 1901 ai dëshmon se Qiriazhi dhe Sina përdornin në shkollën e tyre alfabetin e Stambollit. Pikërisht atij i ra në dorë një kopje e “Gjahut të malësorëve” të Kristoforidhit, të cilën e dërgoi në Vjenë dhe u botua më pas te “Albania” e F. Konicës. Gjergji ndërmori edhe transkriptimin e Fjalorit të K. Kristoforidhit me alfabetin e Stambollit dhe arriti të përfundonte një të tretën e shkronjave. Ai ka marrë pjesë drejtpërdrejt në problemin e madh të botimit të Fjalorit të Kristoforidhit, që u kthye në çështje ndërkombëtare derisa doli nga shtypi në Athinë më 1904. Edhe këtë temë, bashkë me dokumentimin përkatës, e kam trajtuar hollësisht në punimet për Kristoforidhin dhe nuk ka nevojë të rimerret këtu.

Nuk është vendi këtu gjithashtu për të shtjelluar formimin e Komitetit për Lirinë e Shqipërisë më 1905, të ngritur nga Bajo Topulli, ku bënte pjesë edhe Gjergj Qiriazhi. Në statutin e tij përmbahej edhe një pikë “për të ngjallturit e Shqipërisë” duke përhapur udhën e qytetërimit me anë të librave që do të shtypeshin. Ky Komitet nisi të luante rolin e qendrës për të gjitha viset shqiptare, si dhe vendosi marrëdhënie me shoqëritë atdhetare në vendet e huaja. Më pas, nga përndjekjet, qendra u shpërngul në Bukuresht dhe në Manastir mbeti vetëm një komitet lokal.

Ngjarjet e vrullshme të vitit 1908 në Perandorinë Osmane lidheshin drejtpërdrejt me vilajetin e Manastirit. Menjëherë me pranimin e rivendosjes së rendit kushtetues nga sulltani, ditën e fundit të korrikut 1908 u themelua Klubi “Bashkimi” dhe sipas shembullit të tij u ngritën klubet në qytete të tjera të Shqipërisë. Ky Klub u kujdes që mësimi i shqipes të përhapej edhe në Ohër,

Strugë, Dibër. Prej punës së tij bëhet e qartë se veprimtaria për shqipen në Manastir nuk ka qenë e kufizuar, por ka rrezatuar edhe në viset e tjera shqiptare.

Për Kongresin e Manastirit më 1908 ka një literaturë të gjerë, ndërsa me rastin e njëqindvjetorit të tij kam botuar një libër, *Rreth alfabetit të shqipes*, ku kam sjellë trajtime të reja, duke u mbështetur në burime dokumentare të panjohura deri atëherë. Megjithatë, nuk mund të mos përsëritet këtu një fakt me rëndësi parësore: kërkesa imperative për një alfabet të vetëm kombëtar lidhej ngushtë me punën madhore për hapjen e shkollave shqipe dhe për botimin e librave shkollorë. Klubi i Manastirit mori vendimin për ngritjen e një shtypshkronje. U formua “Shoqëria botonjëse letrare”, që të mblidhte të hollat e nevojshme për shtypshkronjën, arkëtar i saj ishte Gjergj Qiriazhi.¹¹ Shtypshkronja e nisi punën më 1 shtator 1909. Tashmë Manastiri u bë qendra e botimit të librave shqip dhe të shtypit shqiptar. Botimi i parë i saj ishte gazeta “Bashkimi i Kombit”. Pastaj e pati radhën Abetarja e Parashqevi Qiriazit, që u pasua nga një varg tekstesh të tjera shkollore. Një vëllim të madh botimi kanë zënë edhe përkthimet fetare tashmë të rishikuara nga Gjergj Qiriazhi dhe Thanas Sina. Ajo u mbyll përkohësisht nga përndjekjet e autoriteteve osmane, por u rihap në fund të vitit 1910. Periudha e punës së shtypshkronjës mund të quhej stina e fryteve të pasura të veprimtarisë për shqipen në Manastir.

Viti 1908 ka qenë jo vetëm viti i ngjarjes së madhe për alfabetin e shqipes, por edhe kulmi i gjithë veprimtarisë shqiptare në Manastir. Megjithatë, rrethanat ndërkombëtare po ndryshonin me shpejtësi. Dihet se vetëm pak vite më vonë do të shpërthenin luftërat ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore. Ato ngjarje tronditëse veçanërisht për Perandorinë Osmane u përgatitën pikërisht pas rivendosjes së kushtetutës osmane. Atdhetarët shqiptarë e ndiqnin me vëmendje të veçantë ndryshimin e skenarit ballkanik. Në këto rrethana, duke punuar për arritjen e pavarësisë së Shqipërisë, te atdhetarët po piquej mendimi, se kryeqyteti i ardhshëm do të ishte Elbasani për shkak të pozitës së tij gjeografike. Rivali tjetër i Manastirit, Korça, po për ato arsye përjashtohej. Një mendim i tillë do të shoqërohej natyrshëm edhe me një varg idesh të tjera, që lidhen me qendrën e një shteti. Për pasojë, roli i Manastirit do të zbehej me shpejtësi. Nuk ishte e rastit që në shtator 1909 u mbajt Kongresi i Elbasanit dhe aty u hap Normalja. Disa nga problemet e Manastirit u shpërngulën në Elbasan. Tashmë ishte Elbasani që ngarkoi Klubin e Manastirit të nxirrte lejen që gjuha shqipe të përfshihej zyrtarisht në të gjitha shkollat e Shqipërisë. Por njëkohësisht Klubit të Manastirit iu caktuan vetëm dy vjet të tjerë për të qenë në krye të lëvizjes. Meqë Shkolla Normale do të bëhej vatra nga do të përhapej varianti i përbashkët i gjuhës së shkruar shqipe, u përvijua e mprehtë çështja e variantit letrar. Për këtë kam mbajtur një kumtesë me rastin e njëqindvjetorit të Normales,¹² por këtu e vlen të theksohen pasojat që patën për Manastirin këto hapje të reja.

Vendimet e Kongresit të Elbasanit dhe zbatimi i tyre në Shkollën Normale e shtrinin në një dritë tjetër vazhdimësinë e botimeve të BFBS. Robert Tomsoni,

¹¹ Nexhat Abazi, *Zhvillimi i arsimit, i shkollave dhe i mendimit pedagogjik shqiptar në Maqedoni (1830-1912)*. BKSH, Tetovë, 1997, f. 208-215.

¹² Xhevat Lloshi, *Shkolla Normale e Elbasanit dhe gjuha letrare shqipe*. Elbasan, 2009.

kryetar i Bordit Amerikan, më 25 prill 1911 nga Selaniku i shkroi T. Hoxhsonit në Stamboll, se tashmë gjuha e botimeve duhej të mbështetej në dialektin e Elbasanit, që do të vihej në bazë të standardit kombëtar. Edhe misionarë të tjerë amerikanë në Shqipëri (i pari ishte Finias Kenedi në Korçë më 1908) e shtruan kërkesën për të folmen e Elbasanit. Në fillim Hoxhsoni i priti këto me këmbët e para si ndërhyrje në punën e gjatë të Shoqërisë së vet. Misionari tjetër amerikan, T. Erikson e sulmoi hapur botimin e Ungjijve në Manastir më 1910, duke shtuar se kishte dëgjuar nga drejtuesit e Normales dhe shqiptarë të tjerë, se flisnin rëndë për përkthimin. Ky konflikt ka vazhduar gjatë, madje me jehona deri edhe në botimet e sotme, ku ndihet një farë pakënaqësie e përkrahësve të BFBS për ndërhyrjet e misionarëve amerikanë.

T. Hoxhsoni u detyrua të bënte një tërheqje të butë. Ai nisi kërkimet për të gjetur një vendës nga Elbasani që do të bashkëpunonte me Thanas Sinën. Por ngjarjet precipituan me shpejtësi. Që në fillim të vitit 1911 Komiteti i fshehtë i Manastirit kishte dhënë udhëzimet për forcimin e çetave të armatosura. Është interesante se ngjarjet në Shqipëri T. Hoxhsoni i ka formuluar me termin që shumë më vonë e ka përdorur historiografia jonë. Më 28 qershor 1912 ai ka shkruar: “Lajmet politike nga Shqipëria janë të këqija dhe duket se vendi është në prag të një *kryengritjeje të organizuar e të përhapur gjerësisht*.” (nënvizimi im – Xh. Ll.)

Me shpërthimin e Luftës Ballkanike në tetor 1912 serbët me shpejtësi e pushtuan Manastirin më 1913. Ai pushoi së qeni kryeqendër vilajeti dhe menjëherë e humbi peshën, gjë për të cilën serbët dhanë gjithë ndihmesën e tyre asimiluese. Njëkohësisht ndodhi edhe një ngjarje tjetër tragjike: Gjergj Qiriazhi vdiq më 1913. Më 1914 familja u shpërngul në Vankuver të Kanadasë, ndërsa e bija, Viktoria, mblodhi dorëshkrimet më të rëndësishme dhe i mori me vete. Ndërmjet tyre Xh. Kuanrudi ka gjetur se janë edhe dy kopje të nënshkruara të dokumentit të Kongresit të Manastirit, të cilat duhen sjellë në Shqipëri. Kështu mori fund etapa e Qiriazëve në Manastir dhe bashkë me të edhe veprimtaria për shqipen.

Thanas Sina kishte marrë pjesë në përgatitjen e dorëshkrimeve për botimet në Manastir. Pas disa ungjijve të veçantë, më 1910 doli Dhiata e re, pastaj disa libra të veçantë nga Dhiata e vjetër deri më 1914. Më 28 maj 1914 T. Hoxhsoni e sheh se me shpalljen e pavarësisë ishte e detyrueshme që ta shpërngulte shtypshkronjën në Korçë dhe në maj 1915 puna u ndërpre. Pas Luftës së Parë Botërore puna për përgatitjen dhe përhapjen e botimeve fetare të përkthyer në gjuhën shqipe u shkëput nga agjencia e BFBS në Stamboll dhe kaloi në varësi të agjencisë në Beograd. Nuk mund të mos citoj një letër të përgjegjësit të atjeshëm, J. W. Wiles, dërguar Londrës më 2 tetor 1920: “Deri më 1912 Manastiri ishte një farë Meke maqedonase, tashti është një qytet i vogël krahinor në Serbinë jugore. Toleranca e plogësht e turqve u largua dhe i ka lënë vendin nacionalizmit serb.” Shtypshkornja ishte shkatërruar, por ai vijon, se edhe po të ishte më këmbë, qeveria serbe kurrë nuk do ta lejonte një punë të tillë, si shtypja e Biblës shqip në Manastir. Madje shton në mbyllje, se ka pasur përleshje të përgjakshme midis serbëve e shqiptarëve kohët e fundit.

Përfundimisht më 29 gusht 1921 Sina vajti në Manastir për të sjellë librat e mbetur dhe depozita u mbyll. Më 1981, pas kërkimeve të gjata, e gjeta në Korçë

familjen, te e cila ishin grumbulluar të gjitha materialet e Shtypshkronjës së Manastirit. Sipas dokumentimit, aty duhej të ishin edhe dorëshkrimet e Kristoforidhit të pabotuara, edhe letra e dorëshkrime të rilindësve të tjerë të shquar. Por familja korçare i kishte shitur të gjitha ato si letër të thjeshtë për të liruar dhomën. Hetova deri te dyqani i blerësit të letrave, dhe ai më pohoi se i kishte ardhur një araba me libra e materiale të tjera, të cilat i kishte blerë sipas çmimit të atëhershëm për një kilogram letër. Prej aty ishin transportuar në Fier për t'u grirë që të ktheheshin në karton.

Në shekullin XXI më në fund u ndreq ndërtesa e Kongresit të Manastirit për ta kthyer në muze të ngjarjes që e mësojnë gjithë nxënësit në shkollë. Ndërkaq, do të ishte e dëshirueshme që ky të mos ishte muze vetëm i një viti, sepse paraqitja e mësipërme dëshmon se puna për shqipen aty ka pasur një histori të gjatë, që gjithashtu e meriton të zërë vendin e saj të nderuar.

Shtojcë.

Deklaratëe Gjerasim Qiriazit,

Stamboll, 19 prill 1884

Duke pranuar emërimin nga BFBS si depozitar dhe përgjegjës i librashitjes në Manastir ose në Korçë, në rast se njëri prej këtyre qyteteve do të quhet i parapëlqyer, po paraqes shpjegimet e mëposhtme lidhur me atë, se çfarë i shoh si detyrat që më takojnë.

1. *Të mbaj Depozitën e Shkrimeve të Shenjta, që do të më besohet për ta pasur në kujdes.*

2. *Të dërgoj librashitës në udhëtime të përgatitura me kujdes, duke i furnizuar me Shkrime dhe me gjërat e tjera të nevojshme, të mbaj llogaritë e tyre dhe t'i raportoj të paktën një herë në muaj përfaqësuesit të Shoqërisë, ndërsa çdo tremujor të shlyej llogaritë e librave.*

3. *T'u bëj vizita njerëzve në Manastir, në veçanti mes popullsisë shqiptare, t'u paraqes atyre kopje të Biblës dhe t'u tregoj për detyrën që të mësojnë e ta kenë Fjalën e Zotit, t'i ftoj për të vizituar Depozitën, në rast se do të jetë në shtëpinë time. Po të vendoset depozita në një dyqan, do të jetë detyra ime të qëndroj atje, të themi dy orë në ditë, për të takuar vizitorët dhe për t'i njohur me kërkesat e mësipërme.*

4. *Të ndërmarr udhëtime sa herë ta shoh të nevojshme, duke u larguar nga Depozita, dhe të shoqëroj librashitësin, pasi gjendja e tanishme e vendit e bën këtë të kërkueshme, në mos po të domosdoshme.*

5. *Të shfrytëzoj çdo mundësi për t'u shpjeguar njerëzve nga të gjitha kombësitë, se në kushtet e tanishme, kur asnjë arsimim për vullnetin e Zotit nuk jepet në kishë, është detyrë e cilitdo që kërkon t'i shërbejë Zotit, të ketë dhe të studiojë me kujdes Fjalën e shkruar, si dhe të mënjanojë të gjitha kundërshtimet e tanishme mes njerëzave kundër Shoqërisë dhe botimeve të saj.*

I marr përsipër këto detyra që t'i plotësoj besnikërisht dhe me ndihmën e fuqisë hyjnore.

Gj. D. Qiriazit.

ARDIAN VEHBIU

SHQIPJA GJUHË E LASHTË

Grequishtja e vjetër është një nga gjuhët indoevropiane më të njohura dhe më të studiuara. Meqë etimologjia është e detyruar të lëvizë nga e njohura drejt së panjohurës, të gjithë ata studiues që u interesuan për etimologjitë e fjalëve shqipe greqishten e vjetër e përdorën si pikë referimi të privilegjuar krahas latinishtes. Me fjalë të tjera, lidhjet e shqipes me greqishten e vjetër janë hulumtuar në gjerësi dhe në thellësi. Kush kërkon t'u kthehet, nuk mund të injorojë rezultatet shpesh voluminoze të punës që kanë bërë të tjerët e që, me gjendjen e sotme të njohurive dhe të metodave krahasuese, kërkojnë shumë mund për t'u çuar përpara. Grequishtja e vjetër, nga ana tjetër, ka një shtresë fjalësh që nuk etimologjizohen dot mirë, sikurse ka në trojet ku flitej ajo gjuhë një numër emrash vendesh që u përkasin paragrekëve. Por nuk di të ketë gjuhëtarë që të kenë vërejtur ndonjë koincidençë të madhe midis izoglosave shqipe-greqishte dhe elementit joindoevropian në greqishten – çka do të ishte me interes të madh për parahistorinë gjuhësore të Ballkanit.

Të tilla bashkëpërkime mund të gjenden lehtë midis shqipes dhe të gjitha gjuhëve indoevropiane – siç edhe janë gjetur prej kohësh. Më interes do të kishin, megjithatë, ato afërsi leksikore që janë ekskluzive për dy ose një grup gjuhësh të familjes indoevropiane.

Izoglosa janë gjetur dhe përshkruar midis shqipes dhe gjuhëve baltike, shqipes dhe gjuhëve sllave, shqipes dhe greqishtes, shqipes dhe armenishtes, shqipes dhe keltishtes. Gjuhëtarët mendojnë se në kohën kur gjuhët indoevropiane ende nuk ishin ndarë më vete, por vetëm ekzistonin si dialekte të gjuhës “mëmë”, gjuhët me izoglosa të pjesshme i përkisnin të njëjtit dialekt indoevropian. Mirëpo në këtë fushë nuk mund të flitet me ndonjë farë sigurie.

Vetë koncepti i “lashtësisë” së një gjuhe duhet shoshitur mirë, meqë gjuha nuk është për shembull kafkë ose statujë. Gjuha riprodhohet në çdo akt komunikimi. Një mbishkrim është objekt, që mund të datohet. Gjuha nuk mund të datohet. “Meshari” i Buzukut mund të datohet. Deri edhe fjalët mund të datohen, kur krijohen nga shkrimtarët ose terminologët. Por jo gjuha si e tillë.

Ka kuptim, megjithatë, të flitet për një gjuhë si “më e vjetër” se një tjetër: bie fjala, latinishtja është më e vjetër se italishtja, ose greqishtja e vjetër më e vjetër sesa greqishtja e re. Do të jeni dakord me mua se ky lloj koncepti për vjetërsinë është banal.

Shqipja, si gjuhë është formuar – mendohet – diku nga Mesjeta e Hershme. Para kësaj datëlindjeje është mirë të flitet për parashqipe ose për protoshqipe. Ky dallim kryesisht imponohet nga të dhënat gramatikore dhe duhet kuptuar kështu: në

lashtësi ekzistonte parashqipja, e cila si pasojë e lëvizjeve të popullsisë, kontakteve dhe përzjerjeve të folësve me popuj dhe gjuhë të tjera, dhe të zhvillimeve historike të turbullta gjatë fundit të antikitetit dhe fillimit të Mesjetës iu nënshtrua një numri shndërrimesh të cilat pak a shumë përfunduan midis shekullit VII-X, kur edhe gjendja demografike në Ballkan filloi të stabilizohej, duke dhënë shqipen, një gjuhë cilësisht të ndryshme nga parashqipja. Në kohën kur në Ballkan flitej greqishtja e vjetër, shqipja siç e njohim ne sot nuk ekzistonte si e tillë. Natyrisht, mund të vendosim të themi shqipja e vjetër dhe shqipja e re, por kjo nuk i ndryshon gjë thelbit të problemit.

E kam fjalën që *shqipja nuk është gjuhë relike, siç kuptohet ndonjëherë gabimisht. Në strukturën e shqipes ka shumë pak gjëra “të vjetra”. Sistemi i rasave është riformuluar krejt, është krijuar tema e shumësit si e dallueshme nga e njëjësit, janë përfutur nyjat e parme, nyja shquese është prapavendosur duke u shkrirë me emrin, e ardhmja është ndërtuar në mënyrë perifrastike, paskajorja është zhdukur ose zëvendësuar nga pjesorja e parafjaluar, e kështu me radhë. Këto ndryshime janë shumë të thella. Në krahasim me gjuhë të tjera, si gjuhët balto-slave, shqipja i është larguar shumë modelit indoevropian.*

Nëse ky argument tingëllon i mërzitshëm, kjo ndodh ngaqë shkenca, në vetvete, është e mërzitshme për jospécialistin. *Pohimi që shqipja është “e lashtë” nuk i përket linguistikës, por një diskursi më tepër të natyrës patriotike-retorike.*

Linguistika e trajton këtë çështje ndryshe. Për shembull, gramatika historike na tregon se një shumës i parregullt i tipit *dorë* -> *duar* është më i vjetër sesa një shumës i tipit *gisht* -> *gishta*; ose që kategoria gramatikore e rasës gjinore është më e vjetër sesa mjetet gramatikore që shqipja përdor sot për ta shprehur këtë rasë; ose që nyja e pasme është më e vjetër se e parme; ose që forma të së kryerës së thjeshtë të foljeve si *pashë, rashë, thashë* janë më të vjetra sesa forma të tipit *punova, krevea, lexova, vendosa, kopsita*. Sikurse çdo gjuhë tjetër, edhe shqipja e sotme ruan në sisteme elemente më të vjetra dhe elemente më të reja, në raport me modelin indoevropian.

* * *

Le të nisemi nga dy skaje: shqipja e sotme, dhe indoevropianishtja siç flitej, të themi, para 5000 vjetëve. Për lehtësi studimi, le të vendosim që këto 7000 vjet mbulohen nga 100 breza, ku B-zero është brezi i parë ose fillestar, dhe B-100 jemi ne të sotmit. B-zero, sipas hipotezave më të pranura, jetonte diku në Ukrainë ose në Poloni ose në Karpatet, dhe fliste gjuhën “mëmë” indoevropiane. B-100 jeton në Tiranë sot dhe flet shqip. Çfarë ndodh pikërisht gjatë kalimit nga B-zero në B-100?

Gjëja më e rëndësishme për t’u pasur parasysh është se, sa kohë që shqipja është gjuhë e familjes indoevropiane, çdo kalim konsektiv (p.sh. B-zero -> B-1, ose B-22 -> B-23) përjetohet si transmetim normal i gjuhës amtare, nga prindët te fëmijët. Me fjalë të tjera, sa kohë që shqipja ekziston, do të gjendet të paktën **një** linjë kalimesh konsektive b-zero B-1 B-2 B-3 e kështu me radhë deri në B-99, B-100, ku prindërit të kenë qenë të sigurt se u kanë transmetuar fëmijëve gjuhën që flisnin ata vetë.

Megjithatë, gjuha ka ndryshuar në mënyrë të tillë, sa indoevropianishtja e para 5000 vjetëve ka dhënë sot një mori gjuhësh të ndryshme nga njëra-tjetra,

aferinë e të cilave mund ta përcaktojnë vetëm analizat. Gjuhësia historike duhet të sqarojë si ndodh që gjuha ndryshon, edhe pse folësit nuk janë të vetëdijshëm për këtë ndryshim.

Në rastin e shqipes të përcjellë nga B-zero në B-100, ka interes të përcaktojmë disa etapa të rëndësishme për historinë e gjuhës. Për shembull, shqipja është dokumentuar me shkrim vetëm duke filluar nga brezi B-90, që koïncidon pak a shumë me periudhën e Skënderbeut. Kontaktet e (proto)shqiptarëve me sllavët u përkasin kryesisht brezave B-60 – B-80. Kontaktet e (para)shqipes me latinishten do të kenë filluar gjatë periudhës B-58 – B-60. Të parët e shqiptarëve duhet të kenë ardhur në Ballkan dikur rreth brezit B-20. Gjatë periudhës midis B-20 dhe B-40, parashqipja ka qenë në kontakte me gjuhë joindoevropiane që fliteshin në Ballkan. Para B-20, parashqiptarët duhet të kenë qenë diku në kontakt me të parët e grekëve, armenëve, ndoshta keltëve. Para B-10, mund të dallohet një afërsi midis parashqipes dhe gjuhëve baltike... Por këtu dalim nga shkenca, për t'u futur në një fushë spekulimesh të kulluara.

Problemi i historianit të gjuhës është që t'u japë një kronologji tipareve të ndryshme gjuhësore, sipas tabelës së brezave ose të shekujve. Për shembull, ai duhet t'u përgjigjet pyetjeve: kur u prapavendos nyja shquese në shqipe? Kur pushoi së vepruari shumësi i tipit plak/pleq? Kur pushoi së vepruari rotacizmi – ose shndërrimi i n-së ndërzanore në r, në toskërishte: rana/rëra, zani/zëri, etj.?

Në familjen e gjuhëve indoevropiane, shqipja përfaqëson një degë të pavarur, nuk ka gjuhë motra – siç janë gjuhët romane, gjuhët gjermanike, gjuhët sllave, gjuhët kelte, etj. Kjo vjen kryesisht ngaqë numri i shqipfolësve ka mbetur gjithnjë i kufizuar, për arsye historike. Nga ana tjetër, shqipja e sotme i është larguar shumë modelit indoevropian, ndryshe nga gjuhë si rusishtja dhe gjuhë të tjera sllave që kanë ruajtur shumë tipare gramatikore arkaïke. Kush e ka studiuar rusishten, do të ketë vënë re sa e ndryshme është gramatikisht nga shqipja – mungesa e nyjave, gramatika e numërorëve ose sistemi i aspektit të foljeve janë disa nga tiparet më të dukshme. Kjo nuk do të thotë që shqipja është gjuhë “e re”, ashtu sikurse nuk do të thotë që rusishtja është gjuhë “e lashtë”.

Për të kuptuar pse nuk ka kuptim të flitet për “lashtësi” të shqipes, mjafton të kemi parasysh se gjatë kalimit nga B-zero në B-100, gjithnjë është ruajtur vetëdija e vijueshmërisë së gjuhës.

Prandaj, shqipja nuk është as e lashtë as e palashtë. Si gjuhë, njihet me siguri që nga shek. XV. Dëshmi të tërthorta, por të sigurta, na lejojnë të themi se shqiptarët dhe parashqiptarët kanë jetuar pak a shumë në trojet e sotme prej të paktën 2500 vjetësh, dhe se kanë pasur kontakte intensive me latinët, rumunët, italianët dhe sllavët, deri diku me grekët dhe, së voni, turqit.

Nga ana tjetër, analizat gjuhësore lejojnë të përcaktohet karakteri indoevropian i shqipes, çka do të thotë se, dikur midis B-zero dhe B-20, të parët e shqiptarëve koïncidonin me të parët e latinëve, sllavëve, keltëve, grekëve, gjermanëve, iranienëve, armenëve, indianëve e kështu me radhë.

Transmetimi vertikal i gjuhës, nga një brez në tjetrin, parakupton riprodhim të rregullave gramatikore dhe të fjalëve vetë. Vetëm nëpërmjet riprodhimit të saktë brezat mund të komunikojnë me njëri-tjetrin. Nga kjo pikëpamje, duket e

çuditshme sesi vetëm brenda 100 brezash e njëjta gjuhë “mëmë” të ketë dhënë bija kaq të ndryshme sa, të themi, shqipja dhe rusishtja.

Me fjalë të tjera, pse ndryshon gjuha?

Këtu nuk është vendi të futemi në arsyetime dhe parashtresa teknike të arsyeve të ndryshimit gjuhësor. Por mund të jepet një ide e përciptë. Një shtysë kryesore për ndryshimin gjuhësor është nevoja për ekonomizim të energjisë së shpenzuar gjatë të folurit. Për shembull, e ardhmja e shqipes standard ka formën *do të vij*, por në të folur të gjithë themi *do vij*, sepse kjo është më e shkurtër si formë, dhe *të-ja* që eliminojmë nuk sjell ndonjë ngatërresë në të kuptuar. Një folje latine si *comunicare* ka dhënë në shqipe *kungoj*; me disa rrokje më pak. Zhdukja e rrokjeve lidhet me nevojën për ekonomizim të energjive në shqiptim, e cila bën që zanoret e patheksuara të shqiptohen gjithnjë e më të dobëta.

Nga ana tjetër, meqë gjuha është një sistem ku pjesët marrin vlerë në raport me njëra-tjetrën dhe tërësinë, atëherë një ndryshim do të ndiqet nga ndryshime të tjera, për hir të riekulibritimit të sistemit. Për shembull, shumësi *plak/pleq* i përket një periudhe kur shqipja e formonte shumësin me prapashtesën *-i* (**plaki*). Përkundrazi, shumësi *disk-disqe* është i ri, dhe i formuar për analogji, meqë fjala *disk* ka hyrë në shqipe shumë kohë pasi *-i* nuk përdorej më për të formuar shumësin. (Njëlloj edhe *miting/mitingje*; ndër shqiptarët e New York City kam dëgjuar edhe të mrekullueshmin *billdingje*).

Një tjetër shkak themelor i ndryshimit gjuhësor është kontakti mes gjuhëve dhe folësve të atyre gjuhëve. Meqë shqiptarët dhe të parët e tyre kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm e shpesh traumatizues me popuj të tjerë, kjo mund të shpjegojë edhe pse shqipja i është larguar kaq shumë modelit indoevropian.

Folësit e gjuhës nuk janë të vetëdijshëm për ndryshimet, meqë këto ndodhin ngadalë dhe gjatë disa brezave. Në mungesë të interferencave, folësit gjithnjë kujtojnë se po e riprodhojnë atë gjuhë që u kanë dhënë prindërit – edhe pse kjo nuk vlen më për shoqëritë moderne, të cilat praktikisht dominohen dhe normalizohen nga mediet.

Nga ana tjetër, ndryshimet mund të prekin vetëm disa zona ku flitet gjuha, çka shpie pastaj në përfitim të dialekteve. Të marrim p.sh. rotacizmin, që është një nga dallimet kryesore midis toskërishtes dhe gegërishtes. Po të krahasohen fjalë të tilla si: *venë/verë*, *emën/emër*, *femën/femër*, *lakën/lakër*, *Vlona/Vlora*, *zani/zëri*, *dimën/dimër*, *gjarpën/gjarpër*, *kunorë/kurorë*, mund të shihet se atje ku gegërishtja ka një *n*, toskërishtja ka, përkundrazi, një *r*.

Krahasimi me gjuhë të tjera tregon se nga këto dy forma, ajo e toskërishtes është më e re. Mund të pyetet se pse ka ndodhur ky ndryshim në toskërishten, në një kohë që ky dialekt e ka ruajtur *n*-në në pozicione të tjera. Ndonjë gjuhëtar e ka shpjeguar këtë me shqiptimin e labërguar të *n*-së ndërzanore nga sillavët e shqiptarizuar në jug të Shkumbinit – por kjo përgjithësisht nuk është pranuar. Megjithatë, është kurioz fakti që ky rotacizëm zakonisht nuk i ka prekur huazimet sillave të shqipes, madje periudha e përfundimit të rotacizmit koïncidon me kohën e kalimit nga parashqipja në shqipen...

Të tjerë autorë rotacizmin së bashku me humbjen e nazalizmit dhe të paskajores e kanë shpjeguar si një efekt të mbivendosjes së trakishtes ndaj ilirishtes

në Shqipëri të Jugut gjatë antikitetit të vonë. Nuk dihet mirë, nga ana tjetër, nëse ka në shqipen e sotme gjurmë të një strukture dialektore të ndryshme nga ajo midis toskërishtes dhe gegërishtes.

I sjell këto shembuj për të ilustruar si gjuhësia historike vërtet merret kryesisht me kronologji relative e ndonjëherë absolute, por gjithnjë nisat nga postulati se gjuha vetë, si e tillë, është e padatueshme.

Për t'iu kthyer edhe një herë të fundit serisë B-zero -> B-100, vijueshmëria në këtë seri nuk ka fare të bëjë me datimet dhe kronologjitë që vendosin gjuhëtarët. Edhe pse thuhet zakonisht që rotacizmi në shqipen përfundoi dikur rreth B-70/B-72, kjo nuk do të thotë që brezat e rinj të asaj periudhe thanë: “këtej e tutje nuk do ta rotacizojmë më n-në ndërzanore”.

Ne që gjuhën e mësojmë në shkollë, e flasim dhe e shkruajmë sipas rregullash të caktuara dhe e kodifikojmë në gramatika e fjalorë, shpesh harrojmë se kjo gjuhë jona është një formë artificiale ose e balsamosur e shqipes, e cila ka për synim, ndër të tjera, t'u rezistojë prirjeve të natyrshme të ndryshimit gjuhësor.

E vërteta është se kur gjuhët fillojnë të shkruhen dhe folësit të alfabetizohen, ndryshimi gjuhësor vjen e ngadalësohet shumë, meqë të shkruarit, si të thuash, e fikson gjuhën.

* * *

Shqipja i ka ruajtur në gramatikë disa tipare indoevropiane themelore. Për shembull, sistemin e lakimit të emrit. Mirëpo ky sistem është transformuar krejt, për shembull duke humbur një pjesë të mirë të mbaresave, duke i shkruar disa rase me njëra-tjetrën dhe, ç'është më e rëndësishmja, duke u dyzuar në lakim të shquar dhe të pashquar.

Gjithashtu, lakimi i shumës në shqipe mbështetet mbi temën e shumës. Kush di pak rusisht ose latinisht, do ta kuptojë se për çfarë e kam fjalën pikërisht – meqë në ato gjuhë mbaresat e lakimit shumë i ngjiten temës së emrit në njëjës. Një tjetër risi në sistemin emëror, është përfitim i nyjes shquese. Nyja në shqipe është mjaft e vjetër, po të kemi parasysh se i është bashkuar temës së emrit – përkundrazi, në gjuhët romane dhe në gjuhët gjermanike mbetet fjalë më vete.

Gjuhë si rusishtja dhe latinishtja nuk kanë nyje. Kur duan të imitojnë në një film amerikan të folurin anglisht të rusëve, aktorët thonë: “Give me book!”.

Të tjera shndërrime në sistemin emëror do të ishin përfitim i dy klasëve të mbiemrave – të nyjshëm dhe të panyjshëm; dhe gjithashtu, humbja e formave rasore të mbiemrave, ose bartja e tyre tek nyja.

Një tipar i çuditshëm i shqipes është lakimi i një rase – dhe pikërisht i gjinorës, meqë këtu nyja e parme lakohet në pajtim me rasën e emrit paraprirës. Kjo është veçori unike, në mos gabohem, ndër gjuhët indoevropiane.

Natyrisht, shqipja nuk i është larguar modelit indoevropian aq shumë sa, të themi, gjuhë si anglishtja ose gjuhët romane, të cilat e kanë humbur krejt sistemin e lakimit; madje anglishtja edhe sistemin foljor e ka thjeshtuar sa s'bëhet më. Anglishtja, tipologjikisht, pothuajse nuk mund të konsiderohet më gjuhë indoevropiane (eptuese).

Në të vërtetë, prirja për thjeshtim të morfologjisë vihet re në të gjitha gjuhët indoevropiane. Morfologjia ka të bëjë me trajtat e ndryshme që merr një fjalë, për të shprehur kuptime gramatikore. Prirja këto 2000 vjet ka qenë që funksionet gramatikore të zhvendosen nga morfologjia në sintaksë.

Për shembull, latinishtja shumësin e shprehte nëpërmjet mbaresave të lakimit shumë (rosae, rosarum etj.), ndërsa frëngjishtja e folur nëpërmjet ndryshimit të nyjes shquese të paravendosur (khs. *la rose, les roses*, ku *s*-ja fundore nuk shqiptohet më).

Po ashtu, rasat po prirën të zëvendësohen nga ndërtime me parafjalë. Mekanizmi në këtë rast është gjithnjë fonetik: për shkak të theksimit të fjalëve dhe të ritmit të folurit, mbaresat rasore vijnë duke u dobësuar dhe zbehur; në ç'rast gjuha fillon t'i përforcojë duke thirrur në ndihmë parafjalët. Me kohë, mbaresat rasore bien krejt, duke ua besuar funksionin parafjalëve.

Mund të mendohet se me kalimin e shekujve parafjalët dhe nyjet shquese do të vijnë duke u shkrirë me ballin e fjalëve, për të ripërfutur njëfarë morfologjie së prapthi.

Ka disa studiues që mendojnë se frëngjishtja moderne tanimë lakohet në ballë të fjalës, në kuptimin që një fjalë si *ami* (mik) lakohet pak a shumë kështu: emërore *lami* (e shkruar: l'ami), gjinore *dlami* (de l'ami), dhanore *alami* (à l'ami), emërore shumë *lezami* (les amis), gjinore shumë *dezami* (des amis), dhanore shumë *ozami* (aux amis) e kështu me radhë.

Nëse frëngjishtja nuk do të njihej e shkruhej prej kohësh, por përkundrazi, të ishte regjistruar nga një antropolog në fund të shekullit XX, forma si *lami, dlami, alami, lezami, dezami, ozamietj.* vështirë të ishin pikasur si të një gjuhe indoevropiane... Me fjalë të tjera, frëngjishtja e shkruar dhe frëngjishtja e folur sot sillen si praktikisht dy gjuhë të ndryshme nga pikëpamja tipologjike, duke qenë e shkruara gjithsesi shumë më afër latinishtes mëmë sesa e folura.

Diçka e ngjashme do të ketë ndodhur në kohë të hershme me shqipen, kur emrave u është prapavendosur nyja shquese. Për fat të keq, format e vjetra të (para)shqipes nuk njihen dhe vetëm mund të rindërtohen me shumë rezerva.

* * *

Dy fjalë, më në fund, për hipotezën e origjinës dako-mize të shqipes, e cila lidhet ngushtë me hipotezën trake. Deri nga gjysma e shekullit XX, besohej se ilirishtja dhe trakishtja ishin të vetmet gjuhë jogreke që fliteshin në Ballkanin paralatin, me ndonjë enklavë kelte ose iranike gjithashtu.

Më pas ishte bullgari Georgiev që hodhi mendimin se dako-mizishtja, ose gjuha që flitej nga para-ardhësit e paromanizuar të rumunëve, ishte një gjuhë e ndryshme nga trakishtja.

Ky mendim mbështetej mbi analizën e emrave të vendeve dhe të njerëzve që kanë mbetur nga ato gjuhë, si dhe nga disa ekstrapolime fonetike shumë të guximshme.

Po Georgievi formuloi hipotezën se shqipja rridhte prej dako-mizishtes. Hipoteza e Georgievit është serioze dhe metoda e tij rigoroze. Megjithatë, të dhënat që disponohen për dako-mizishten janë shumë të pakta.

Siç dihet, shqipja dhe rumanishtja janë shumë të afërta nga struktura. Disa gjuhëtarë mendojnë se këto dy gjuhë kanë të njëjtën bazë gramatikore. Ngjashmëri të madhe ka edhe në leksik dhe në trajtimin fonetik të latinizmave.

Duke u nisur nga këto ngjashmëri, disa gjuhëtarë hodhën mendimin se substrati i rumanishtes dhe parashqipja ishin e njëjta gjuhë. Me substrat, në këtë rast, kihet parasysh gjuha që flisnin paraardhësit e rumunëve para se të romanizoheshin.

Dihet, për shembull, që frëngjishtja ka një substrat kelt; d.m.th. francezët janë keltë të romanizuar. Shenja të substratit kelt në frëngjishte gjenden në fonetikë, në leksik dhe ndoshta në gramatikë. Substrati trak në rumanishten ka lënë edhe ai gjurmë. Këto gjurmë izolohe duke mënjanuar gjithçka që është latine, sllave ose turke në rumanishten. Për analistin, afërsitë e këtij substrati me shqipen janë vërtet impesive.

Rumunët e konsiderojnë veten pasardhës të romanizuar të dakëve. Por dakët janë një popull po aq misterioz sa edhe ilirët, që nuk e kanë shkruar gjuhën e tyre.

Duke u nisur nga afërsitë e shqipes me rumanishten, Gustav Meyer formuloi një hipotezë të kundërt, dhe pikërisht që rumanishtja ka substrat ilir. Me fjalë të tjera: afërsitë shqiptaro-rumune janë fakt, lidhjet e shqipes me ilirishten, përkatësisht trakishten ose dako-mizishten janë hipotetike.

Duhet thënë se hipoteza dako-mize e Georgievit është rreptësisht gjuhësore, nuk merr në konsideratë faktorin historiko-arkelogjik. Përkundrazi, teoria ilire e prejardhjes së shqipes është më e plotë, meqë e shikon çështjen nga shumë anë.

Sa për marrëdhëniet e parashqiptarëve me sllavët në Mesjetën e hershme, këto ende nuk janë ndriçuar mirë, për arsye më tepër politike. Është e vërtetë se në Shqipërinë e Jugut emrat e vendeve janë kryesisht sllave. Kjo nuk do të thotë automatikisht, megjithatë, se ato zona ishin të banuara nga sllavët. Pozicioni i historiografisë zyrtare shqiptare ishte se ato emra u vunë nga administrata bullgare dhe pastaj mbijetuan.

Mua ky pozicion më duket i mbithjeshtuar dhe i pambrojtshëm. Unë vetë besoj se për një periudhë gjatë mesjetës së hershme pas dyndjeve sllave, këta të fundit dhe parashqiptarët bashkëjetuan paqësisht në trojet e Shqipërisë së sotme të Jugut; me parashqiptarët të përqendruar kryesisht në blegtori dhe sllavët në bujqësi.

Më pas këta sllavë u shqiptarizuan.

Historia e leksikut të shqipes tregon se ka një numër të madh huazimesh nga sllavishtja mesjetare në fushën e bujqësisë, në një kohë që fjalori blegtoral nuk është ndikuar nga sllavishtja. Bujqësia, ndryshe nga blegtorja, kërkon një organizim sedentar të jetesës; prandaj edhe vendbanimet u themeluan dhe u emërtuan prej sllavëve. Mund të mendohet edhe që vetë koncepti dhe praktika e fshatit si vendbanim bujqish të jetë sjellë e përforcuar kulturalisht prej sllavëve; në një kohë që parashqiptarët ose jetonin në qytete, ose lëviznin nomadisht me bagëtitë nëpër Ballkan.

Ngulimet sllave në Shqipëri të Jugut nuk janë pa lidhje me vendosjen e sllavëve në trojet kontinentale të Greqisë së sotme, të cilat janë përshkruar mirë prej historianëve. Duhet thënë, gjithashtu, se në gramatikën e dialekteve të toskërishtes nuk ka gjurmë të ndonjë substrati sllav. Nëse ka të tilla në fonetikën

historike të toskërishtes (rotacizmin), siç e kanë vërejtur disa gjuhëtarë, këtë nuk jam në gjendje as ta pohoj, as ta mohoj.

* * *

Termi *parashqipe* për të emërtuar gjuhën që më vonë dha shqipen por që vetë nuk ishte shqipe është një term praktik, ose shkurtore, për t'iu referuar një faze gjuhësore që përndryshe nuk njihet. Nuk rrezikon aspak që ta “çrrënjosë” origjinën e shqipes, sepse origjina e shqipes dihet – gjuhë indoevropiane. Problemi i origjinës së shqipes nuk ka pse të ngatërrohet me problemin e marrëdhënieve të (para)shqipes me gjuhët jogreke që fliteshin në Ballkanin e lashtë, të cilat marrëdhënie janë ende të pasqaruara. Ta quash *parashqipe* gjuhën që flisnin të parët e shqiptarëve në lashtësi është po aq sakrilegj sa të quash *latinishtegjuhën* që flisnin të parët e italianëve të sotëm. Këta doemos flitnin latinishte, sepse kjo njihet mirë, është shkruar dhe lexohet për bukuri. Parashqipja, për fat të keq, është një konstruksion gjuhëtarësh. Fonetika historike, lejon të deduktohet pak a shumë me siguri se shumësi *pleq* i fjalës *plak* rrjedh nga një formë e rindërtuar **plaki* (asterisku tregon se kjo formë nuk është e dokumentuar gjëkund); meqë vetëm një prapashtesë hipotetike shumësi-**i* mund të shpjegojë kalimin *a->e* (të quajtur edhe Umlaut ose metafoini) dhe kalimin *tjetërk->q* (të quajtur palatalizim, ose qiellzorizim). Mirëpo një gjuhë që e formon shumësin e emrave me prapashtesën -**i* nuk mund të jetë e njëjtë me një gjuhë që këtë prapashtesë nuk e përdor më. Që këtë edhe nevoja për të dalluar midis shqipes dhe *parashqipes*.

* * *

Si shqiptarë, ne është mirë të kuptojmë se më shumë sesa kemi qenë të tillë, **jemi bërë** të tillë, në histori e sipër. Historia na ka krijuar ndoshta edhe më shumë sesa e kemi krijuar.

Shqiptaria është një proces që shtjellohet në kohë, jo monument i palëvizshëm, as shkëmb në shtratin e lumit që nuk do t'ia dijë për rrymën e ujit.

A ka pasur shqiptarë në lashtësi? Të pyesësh kështu është njëlloj si të pyesësh nëse ka pasur parizianë para se të themelohej Parisi. Në të dy rastet: natyrisht **jo**.

Mirëpo vetë ekzistenca jonë sot si popull provon se ka pasur një popull ose një fis në lashtësi që nuk ishte as latin e as grek, e që në rrjedhë të shekujve u shndërrua në ne të sotmit.

Stërgjyshët tanë.

Ky popull fliste një gjuhë tek e cila e ka prejardhjen shqipja. Provat për ekzistencën e kësaj gjuhe janë të tërthorta, ose vetëm logjike-deduktive; por gjithsesi të pakundërshtueshme.

Po a mund ta quajmë këtë gjuhë “shqipe”?

Natyrisht, mund ta quajmë si të duam, përderisa duhet t'i vëmë gjithsesi një emër. Por e mira është që emërtimi të na ndihmojë për të rrokur proceset historike të përfuturit të shqiptarisë, jo të na e ndërlikojë vizionin.

Prandaj edhe termi *parashqipe*, për të emërtuar një fazë gjuhësore të ndërmjetme midis indoevropianishtes të origjinave dhe shqipes së kohëve moderne.

Parashqipe do kuptuar si term algjebrik, që e maskon të padukshmen e të panjohurën duke ia ngjitur etiketën e një emri komod.

Gjithçka dimë për të, e kemi deduktuar nga studimi i shqipes së sotme; por raporti i shqipes me parashqipen nuk është i ndryshëm, për shembull, nga raporti i rumanishtes së sotme me latinishten ballkanike.

Që gjuha të funksionojë si mjet komunikimi, kërkohet riprodhim i saktë dhe respektim i rregullave gjuhësore (gramatikë etj.). Kjo i bën jospecialistët ta konceptojnë gjuhën si të ishte një sistem aksiomatik, ose një lojë si shahu, që praktikisht mund të ekzistojë në pavarësi të plotë nga përmasa e kohës.¹

Që këtë, vetëdija e shqiptarëve sot çon në supozimin e vetëdijës së shqiptarëve dje, pardje dhe kështu me radhë. E keqja e këtij iluzioni është se nuk dimë ku të ndalemi.

Me këtë rast, përvoja do të vlente më mirë sesa njëmijë argumente. Merreni një shqiptar nga Peja, Bradasheshi apo Hekali dhe vëreni të flasë me një arbëresh nga Molise apo Ururi. Pesë shekuj na ndajnë prej komuniteteve arbëreshe në Itali, por janë të mjaftueshme për ta quajtur gjuhën e tyre “arbërishte” dhe tonën “shqipe”.

Për ata që do të ma kundërshtojnë këtë argument, kam një sugjerim tjetër: merrni *Milosaon* e De Radës – në origjinal, jo në versionin e përkthyer nga arbërishtja në shqipe prej Shuteriqit – dhe provoni të kuptoni ndonjë gjë.

Vetëm pesë shekuj. Po të krahasohet, bie fjala, Buzuku me një autor arbëresh pak a shumë bashkëkohës të Buzukut, si Matrënga, nuk mund të mos vërehet se këta të dy nuk do të kishin shumë problem të merreshin vesh me njëri-tjetrin.

Kujtoj se ndër arbëreshët as fjala “shqip” nuk ekziston; një provë e mëtejshme se gjuhët dhe vetë identiteti etnik janë procese historike, që ekzistojnë në kohë.

Mendja e njeriut nuk i rrok dot mirë këto procese në specifikën e tyre.

[2006]

¹ Krahasimi është relativ, pse edhe shahu ka ndjekur një proces evolutiv të caktuar – bie fjala, në versione mesjetare të lojës fili lëvizte diagonalisht vetëm dy kuti; por ky proces është rastësor për shahun dhe lojërat e tjera, sa kohë që shahu nuk e ka të nevojshme të ndryshojë rregullat, për të ekzistuar. Ndryshimi i rregullave në shah është aksidental, në gjuhë jo.

QEMAL MURATI

PËR NJË QYTETËRIM GJUHËSOR SHQIPTAR

Krahas qytetërimit kulturor, neve na duhet dhe një qytetërim gjuhësor, sikurse gjithë kombeve të përparuara. Por për qytetërimin tonë gjuhësor duhet të punojmë vetë, nuk është një produkt që mund të na vijë falas nga Europa.

Unë jam gjuha ime

Nga të gjitha thëniet e shumta e të mençura për gjuhën, që kanë krijuar filozofët, gjuhëtarët, letrarët etj., më e goditur na duket të jetë ajo e filozofit gjerman Wittgenstein që shprehet në këtë: *“Unë jam gjuha ime”*. Kjo thënie mjaft e shkurtër, që shprehet vetëm me katër fjalë, thotë shumë. Thotë se njeriu në radhë të parë është gjuhë, është qenie gjuhësore. Pra, në fillim ishte gjuha, fjala. Po deshe ta njohësh njeriun, së pari duhet të njohësh gjuhën që përdor ai në shoqëri, në marrëdhëniet e tij me të tjerët. Pastaj të njohësh dhe qëndrimin a kujdesin që mban për gjuhën. Nuk ka thënë kot një i ditur anonim italian: *“Quaj njeri atë që është zot i gjuhës së vet amtare”*.

“Pas tokës, gjuha është pasuria më e madhe e një vendi dhe ndryshe nga toka që ndonjëherë pushtohet, gjuha mbetet një beden” (Halit Shamata). Por, edhe gjuha mund të shkatërrohet, nëse shkelet e nëpërkëmbet nga folësit e saj dhe nëse nuk mirëmbahet nga institucionet e shtetit. Sidozot që bëjmë ne.

Thuhet se ne shqiptarët jemi kombi që dimë më shumë gjuhë nga çdo komb i Europës, se pëlqejmë dhe respektojmë gjuhën e tjetrit, si vlerën më të lartë komunikuese e civilizuese. Por, kur vjen puna te gjuha shqipe, duhet të pranojmë se i bëjmë buzë gjuhës sonë standarde. E flasim dhe e shkruajmë atë si thoshte Konica *“si të zinj të Afrikës”*. Këtu e njëqind vjet më parë Faik Konica shprehej: *“Duam të flasim e të shkruajmë një shqipe të qëruar; në e trazofshim me greqisht, turqisht, italisht, e me të tjera gjuhë evgjitësh, më mirë ta lëmë fare shqipen, më mirë të mësojmë ndonjë gjuhë të huaj, se ta flasim tonën si të zezët e Afrikës që silleshin qëmoti nga Arabistani për shërbëtorë në ca shtëpi të mëdha të Shqipërisë”*. Këtë sëmundje nuk e kemi kaluar as sot. Shqipja e sotme njëqind vjet pas Konicës është pothuajse në atë gjendje si në kohë të tij, tani e trazuar me anglicizma e me sendërgji për përmbysje standardi e kthim në dialekte. Veçse na mungon një mendje e kthjellët dhe penë e fortë si ajo e Konicës së madh e të papërsëritshëm për t'i fshikulluar mohuesit e kësaj gjuhe.

Standardi i shqipes as e “ka vrrarë gegërishten”, as e “ka ringritur” toskërishten

Dyzet vjet pas formimit të shqipes standarde, sidomos këta dy dhjetëvjeçarët e fundit, një komunitet sigjuhëtarësh nuk kanë lënë pa hedhur gurë e drunj mbi këtë gjuhë, pa i gjetur njëqind behane: përse është marrë për bazë dialekti i toskërishtes e jo ai i gegërishtes, përse shumë fjalë të gegërishtes janë lënë pa u futur në fjalor kur ato janë në përdorim të përditshëm. Të rikthejmë paskajoren etj. Ka dhe të tillë që propagandojnë se problemi i shqipes standarde duhet të fillojë të zgjidhet nga e para, njësoj si pas luftës nacional çlirimtare. Don Kishotët e gjuhës që duan ta bëjnë shqipen standarde secili sipas kutit a midesë së vet, nuk e kuptojnë aspak apo nuk duan ta kuptojnë se standard gjuhësor nuk do të thotë përzierje mekanike e dialekteve, apo unifikimi i të gjitha të folmeve në një dialekt të ndërmjetëm me shumicë popullore a me referendum (i kujt është dialekti më i madh, i atij do të jetë standardi), siç kërkojnë disa, sepse kjo është diçka utopike dhe e pamundur. Por standard do të thotë ngritja e një letrarishteje të përpunuar mbidialektore në variantin e përbashkët për t'i shërbyer gjithë kombit. Kudo në botë gjuhët standarde krijohen kështu, duke ngritur një idiomë më të përpunuar letrare në nivel të përgjithshëm, dhe i mirëmban shteti. E më pas, gjuha standarde është ajo që e mban shtetin e kombin, sepse vetëm kombet e qytetëruara kanë gjuhën e tyre të përbashkët në komunikimit publike të institucioneve shtetërore.

Ç'është në fakt gjuha kombëtare a gjuha standarde pandan gjuhës lokale?

“Gjuha e një kombi që ka krijuar shtetin e vet, është një madhësi që përfshin në gjirin e vet një tërësi variantesh, nga të cilët ai që ka përhapje në shkallë kombëtare dhe që shërben si gjuhë e shtetit dhe e kulturës, është gjuha standarde; kurse variantet e tjera janë të folmet vendore, që kanë shtrirje të kufizuara (në një a disa fshatra ose në një qytet me popullsi homogjene) dhe funksione shumë të kufizuara, duke u përdorur vetëm me gojë në familje dhe në rrethin e ngushtë shoqëror. Për to nuk ka gramatika dhe as fjalorë, sikundër ka për gjuhën standarde, e megjithatë jetojnë gjatë, sikundër tregon shembulli i të folmeve të arbërorëve të Greqisë, të cilat, me gjithë ndalimin zyrtar, vijnë në përdoren brenda familjes. Ndryshe prej të folmeve, që janë degëzime të gjuhës në rrjedhë të kohës, gjuha standarde është një mjet komunikimi i pranuar me marrëveshje nga i gjithë kombi dhe jo i imponuar nga një grup individësh. Ajo nuk është zhvillim i natyrshëm i gjuhës së një kombi, po krijim i vullnetshëm, "inxhinieri gjuhësor", sikundër e kanë quajtur. Duke mos qenë e lindur, ajo ka nevojë për kujdesin e vazhdueshëm të shtetit, sepse, pa kujdesin e tij dhe të institucioneve gjuhësore, mund të venitet, të braktiset nga folësit e të vdesë” (R. Memushaj).

Leksiku është ajo që mund të shprehet, gramatika është ajo që duhet të shprehet

Në sagën e gjuhës shqipe janë bërë e bëhen spekulime të pafund se standardin gjuhësor e ka ngritur diktatura, prandaj me rënien e diktaturës komuniste duhet të

bjerë edhe ngrehina e gjuhës, pa kuptuar aspak se orkestrimet e tilla, po të shprehemi me një fjalë më të butë, janë krejtësisht retrograde e diletanteske.

Kundër këtyre spekulimeve ja si shprehet I. Ajeti: *“Toskërishten letrare nuk e ngriti politika komuniste në të cilën mbizotëronin folësit toskë. Epërsia e saj ndaj gegërishtes së shkruar ishte rezultat i përpjekjeve të sa e sa brezave të tërë shkencorë e kulturorë shqiptarë, të nisura këtu e më se njëqind vjet. Ka të një kategori të vogël intelektualësh një grimë nostalgjie për faktin që në rrethanat e reja në njëfarë mënyre kanë qenë të shtrënguar të heqin dorë nga përdorimi letrar gegë. Edhe ne dhe shumëkush e ndiejmë një mallëngjim, por vetëm kaq! Do ta ketë ndier edhe vetë shkrimtari i madh kroat Miroslav Kërlezha, për çka poezitë më të fuqishme e më të bukura i shkroi në kajkavishte. Por, ndonjë hap në drejtim të tërheqjes nga rruga e gjuhës letrare kroate as që i shkoi ndonjëherë mendja”*.

Për sa i përket çështjes së bazës dialektore aq shumë të diskutueshme të toskërishtes dhe të gegërishtes për formimin e shqipes standarde, se cili dialekt ka “pushtuar” tjetrin e se si do të duhej të zgjidhej çështja e shqipes standarde, përkrahësit e prekjes së standardit të gjuhës i referohen edhe prof. Çabejt, si dhe vetë Kongresit të Drejtshkrimit, kinse edhe ata kanë pasur orientime të tilla për ndërhyrje në standard. Madje, për të na e mbushur mendjen, jo rrallë merren nëpër gojë, citohen e keqinterpretohen edhe gjuhëtarë të huaj si Tullio de Mauro, duke i lexuar qëndrimet e tyre si u vjen për kuti. Ç’është e vërteta, Çabej mbështeste idenë se gjuha mund të pasurohet me lëndë leksikore nga krahinat, ndërsa strukturat gramatikore janë shkencore, nuk mund të ndërhyhet arbitrarisht në to. Ndryshe, ç’kuptim do të kishte formimi i standardit. “Nuk të ndalon njeri që “gënjeshtar” ta thuash “rrenacak”, ose “gudulis” t’i thuash giciloj”, që përdoret në gegërisht” (Dritëro Agolli, *Gjuha të mos preket, duan të ndajnë Veriun me Jugun*, “Panorama”, 23. 5. 2014). Sipas teorisë dhe praktikës gjuhësore të standardit, leksiku është ajo që mund të shprehet, kurse gramatika është ajo që duhet të shprehet. Pra, sistemi gramatikor nuk e lejon përzgjedhjen, ta zëmë të thuhet: *shkoja e shkonja, vija e vinja*. Për ata që nuk e kuptojnë standardin gjuhësor, që më së paku mund të dinë e të jenë kompetentë në fushën e gjuhës, për formimin e shqipes standarde, jep përgjigje të drejtë gjuhëtari Isa Bajçinca kur shprehet:

“Standardi i shqipes as e “ka vlarë gegërishten” dhe as e “ka ringritur” toskërishten. Standardi i shqipes është krijuar drejtpërdrejt në sajë të studimit të vëmendshëm të tipareve dhe të prirjeve zhvillimore që kishin shfaqur dy “ish-variantet letrare”, sepse në kohën kur “njësohej” shqipja, “variantet” letrare të saj kishin arritur një shkallë vërtet të lartë zhvillimi, po patjetër edhe afrimi, “konvergjence” në një shkallë të madhe në shumë hallka, sidomos në fushë të gramatikës dhe të sintaksës detyrimisht (hiq përdorimin e paskajores, e cila edhe në “gegërishten letrare” ishte rrudhur në një masë jo të vogël)”. Kjo është një e vërtetë plauzibile dhe një fakt i pamohueshëm për të gjithë, natyrisht edhe për ata që nuk duan t’i vënë fre imagjinatës së tyre antistandard dhe mohimit të gjithçkaje.

Jo shumësia, por ngurtësia dhe unifikimi i fjalëve është pasuri

Diletantët dhe krahinarët e gjuhës kërkojnë që në shqipen e sotme standarde të mbizotërojë jo njësia, por shumësia, të ketë më shumë trajta dialektore e krahinore, si në periodën e shqipes parastandarde. Paçka se, siç shprehet Ismail

Kadare, gjeniu i letrave shqipe, krijuesi dhe përdoruesi më i përkorë gjuhës shqipe, është e kundërta e kësaj ajo që është më thelbësore:

“Gjuha është nga ato gjëra, ku jo shumësia, por ngurtësia dhe unifikimi i fjalëve është pasuri. Një gjuhë që përdor një fjalë që shpreh shumë gjëra, është shumë më aristokrate se një gjuhë që ka 50 versione për të shprehur një gjë”. Por kjo vlen për ata që kuptojnë nga gjuha e nga gjuhësia.

Në gjuhët standarde gjithmonë kërkohet rritja e kujdesit për zbatimin e normave të gjuhës, jo ndryshimi i drejtshkrimit sa herë të fryjnë erëra të ndryshme politike. Kodi drejtshkrimor kur vendoset një herë si i tillë, ai nuk ka nevojë të ndryshohet sipas stinëve të vitit apo stinëve politike. Sepse në të kundërtën do të krijohej anarki. Për atë që ka të drejtë një këshill akademik a ndërakademik të ndryshojë shkrimin e disa fjalëve, po atë që do të kishin të drejtë edhe këshilla të instituteve e mekanizma të tjerë të vinin dorë në gjuhë e të krijonin rregulla të reja. *“Problemi i shkëlqes së normave të gjuhës nuk zgjidhet duke prekur thellë kodet, po duke forcuar edukimin gjuhësor në shkollë dhe disiplinën për zbatimin e tyre”* (R. Memushaj).

Gjuha standarde vërtetë është dinamike, por ajo ruan gjithmonë rregullsitë. Hapja dhe dinamizmi i standardit nuk nënkupton domosdo përdorimin jokorrekt të shqipes, shkëlqen e normave të saj, siç mendojnë kështu disa shqipfolës. Përkundrazi, standardi i shqipes së sotme kërkon që në zhvillimin modern të gjuhës të ruhet natyra e saj e mëvetësishme nga çdo bastardim. Kështu si po përdoret sot shqipja standarde, ka gjasa të shkojë drejt kerolizimit krahinor, me përzjerje të elementeve të ndryshme substandarde. Shqipja standarde nuk mund dhe nuk duhet të konsiderohet si një "vlerë e kapërcyer", por si vlerë qenësore e së tashmes dhe e së ardhmes, sepse po humbe gjuhën – birresh vetë, s'je askush! *Edhe në fushën e kulturës së gjuhës nuk është problem pse përdorim fjalë të huaja, por pse fjalët tona i nxjerrim nga përdorimi atë që padhembshëm!* Gjuha shqipe në të gjitha fushat e përdorimit të saj vërtet ka nevojë të shkojë me guxim drejt fjalëve të huaja, por gjithashtu ka nevojë dhe t'i kthehet vetvetes, trullit të vet pjellor, ta ruajë natyrën e saj të mëvetësishme, fjalorin, gramatikën, sintaksën, por dhe prozodinë vetjake. Shqipja duhet ta ruajë substancën e vet, petkun e vet, jo të lakohet në dobi të huazimeve të elementit të huaj. Shqipja sot ndodhet në kalvarin e vuajtjeve të mëdha me shpërdoruesit e kësaj gjuhe të quajtur shqipfolës. Fjala shqipe në gojën e tyre gjithnjë e më shumë ndihet si e huaj dhe fjala e huaj ndihet si fjalë vendi. Shqipja e sotme standarde gjithnjë e më shumë shëmbëllen me një shqipe të kombeve të bashkuara (mixte, të përzjer), sesa me një shqipe të kombit shqiptar. Ajo po trazohet shumë jo vetëm me fjalë e me gjedhe të huaja, por edhe me struktura të huaja sintaksore, saqë po e shpërfytyron ndjeshëm natyrën e saj.

Me çështjen e standardit e të pastërtisë gjuhësore lidhet dhe kultura gjuhësore. Kultura e pamjaftueshme gjuhësore tregon për kulturë të pamjaftueshme të përgjithshme të individit. Një njeri me kulturë të mangët a të shfrenuar gjuhësore nuk mund të jetë veçse një njeri me kulturë të mangët e të shfrenuar të përgjithshme.

Nga një shqipe të shëndetshme dhe të pashme, shqipfolësit tanë po krijojnë një shqipe të sëmurë e për kurrkund, të mbushur deng me fjalë të huaja të

panevojshme dhe të sunduar nga fryma e huaj. Parregullsitë gjuhësore thuajse po bëhen normë standarde, të cilat përsëriten vazhdimisht, përkundër faktit se ato janë kritikuar dhe po kritikohen si të tilla. Për kulturën e të shkruarit dhe kulturën e të folurit të gjuhës shqipe, ne të gjithë duhet të jemi të përgjegjshëm, t'i kemi halë në sy gabimet ortoepike dhe ortografike, krijimet e çfarëdoshme artificiale. Të kujdesemi për fjalën, për fjalinë dhe për frazat, për theksin dhe për melodinë e kësaj gjuhe, për normën gjuhësore standarde. Për punë të asaj se si e flasim dhe si e shkruajmë shqipen sot, shqiptarët janë më shumë ndërkombëtarë se sa kombëtarë. E për sa kohë që gjuhën tonë do ta përdorim shpërfillshëm, edhe veten dhe kombin tonë do ta realizojmë shpërfillshëm. Standardi i shqipes së sotme, me ndryshimet e thella shoqërore që kanë ndodhur këto dhjetëvjeçarët e fundi, është mjaft i hapur dhe është dinamizuar ndjeshëm, është pasuruar me modele të reja dhe me vlera të reja, por dhe me prurje e akrobacione linguistike me frymë të huaj, prishëse dhe përjashtuese të natyrës së gjuhës sonë.

Nëse për gjuhën pyeten gazetarët, jo specialistët, atëherë edhe për terapinë nëpër spitale, le të vendosin ata, jo mjekët

Në diskutimet publike për shqipen standarde flasin e shkruajnë gjuhëtarë e sigjuhëtarë, letrarë, publicistë, historianë, filozofë, etj. me kompetencë e pa kompetencë, konstruktohen e dekonstruktohen pikëpamje e teza nga më të çuditshmet. Për të devalvuar edhe atë ç'është arritur në fushën e normëzimit të shqipes, bëhen argumentime për t'i vënë shqipes vetulla, por ia nxjerrin edhe sytë.

1. Në një nga argumentimet e tilla që sillen thuhet se: *"Gjuha nuk është e shtetit. Është e popullit. Atij i përket."* (Bardh Rugova, *A je me mua a je me standardin?*, Gazeta Shqip, 12. 5. 2014). Domethënë populli duhet të bëjë normën. Në fakt, gjuha është e të gjithëve, por jo të gjithë mund të flasin me kompetencë për gjuhën e të vënë rregulla. Se populli nuk mund të bëjë gjuhë standarde, kjo as që diskutohet. *"Për gjuhën shqipe nuk mund të vendosë populli, sepse gjuha standarde askund nuk i kushtohet shtresave me arsimim inferior, por një shtresë të ngritur, që pranon norma dhe krijon një ndërlidhshmëri nacionale. Çdo njeri mund të shkruajë sot në dialektin e vet, por vetëm gjuhëtarët dhe shkrimtarë e mëdhenj duhet të na mësojnë normëzimin e gjuhës. Nëse për gjuhën, për emrin e kombit dhe për historinë, pyeten gazetarët, jo specialistët, atëherë edhe për terapinë nëpër spitale, le të vendosin ata, jo mjekët"* (Naser Aliu).

2. Argumentimi tjetër: *"Tok me anësinë, një shkarje shumë e rrezikshme e interpretimeve të standardit është të konsideruarit e tij si tabu, si diçka që nuk bën të preket, sepse dikur dikush e paska rregulluar njëherë e përgjithmonë. Ne e dimë sot se kush e ka bërë e si e në ç'rrethana dhe sa kanë ditur e sa kanë guxuar të dinin për problemet e standardizimit atëherë (më 1972), por nuk dua të flas për këtë. Kjo është diçka që i takon së shkuarës dhe unë kam qejf të shikoj nga e ardhmja. Të shkuarën nuk mund ta ndryshojmë"* (B. Rugova).

Nëse duam t'u shmangemi paragjyqimeve, nëse duam të kalojmë te një qëndrim më objektiv, atëherë duhet së paku vetë të mos krijojmë paragjyqime e silogjizma të tillë, sepse kurrkush nuk e ka thënë që gjuha është tabu, se është e

paprekshme, *dikur dikush e paska rregulluar njëherë e përgjithmonë*. Gjuha ka zhvillimin e saj, çdo gjë rrjedh, çdo gjë ndryshohet. Por, natyrisht, zhvillimet në gjuhë janë të tjera nga ato shoqërore, nuk nënkuptojnë arbitraritete që kushdo t'i fusë duar në kodet gjuhësore, të bëjë ndryshime për hir të ndryshimeve. Kur të vendoset një herë një kod drejtshkrimor, përse do të duhej të rishikohej e ndryshohej sipas animeve e përkatësive krahinariste?

3. Argumentimi i tretë: *"Ne e dimë sot se kush e ka bërë e si e në ç'rrethana dhe sa kanë ditur e sa kanë guxuar të dinin për problemet e standardizimit atëherë (më 1972)".* Po kush e bëri Standardin e 72-it? E bënë me vizionin, dijet dhe kontributin e tyre mjeshtër të mëdhenj që ka pasur ndonjëherë albanologjia: A. Kostallari, E. Çabej, M. Domi, Sh. Demiraj, I. Ajeti etj. E përpara tyre, e bënë letrarët më të shquar të penës: Naimi, Samiu, Çajupi, Noli, ata që bënë dhe Rilindjen Kombëtare. Nuk dinin dhe s'kanë guxuar të dinin këta korifinj të gjuhësisë, të letërsisë e të kulturës shqiptare? Atëherë ç'është kjo filozofi nihiliste?

4. Argumentimi i katërt: *"Shumë është përmendur edhe njëfarë mbrojtje me ligj e gjuhës, madje në diskutime disa herë më ka rënë të dëgjoj tek zihen në gojë shtete të tjera që kanë (a që paskan) ligje të tilla. Edhe kjo është pjesë e ideologjisë së dominimit të një kategorie kundruall të tjerëve. Së pari, kjo formë ndëshkimi lë të kuptohet se njerëzit janë krijuar për gjuhën dhe duhet t'i shërbejnë asaj. Jo. Gjuha është mjet komunikimi i njerëzve. Ajo është për njerëzit, jo njerëzit për të. Së dyti, duhet të kuptojmë se jetojmë në një sistem, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, ku garantohet liria e të shprehurit. Si mund të ketë shprehje të lirë me kufizim gjuhësor?"* Mbrojtja e gjuhës standarde me ligj edhe mund të jetë ideologji, veçse nuk është ideologji dominimi, por është ideologji më pozitive. Thuhet me të drejtë se gjuha është monument kulture më i rëndësishëm i kombit dhe si e tillë gjithsesi duhet mbrojtur me ligj e me kushtetutë nga shkelësit e saj, ashtu siç mbrohen dhe monumentet e tjera të kulturës. Le të bëjmë një argumentim e t'i drejtohem logjikës. Shprehja e lirë nuk nënkupton shkeljen e rregullave as të gjuhës standarde e as të kodeve të tjera shoqërore. *"Gjuha, ashtu sikurse teshat që veshim, është në kontakt të përditshëm me qindra ndotje dhe ne duhet të kujdesemi për pastërtinë e saj çdo orë, çdo ditë. Gjuha shkallmohet nga zhargoni i rrugës, nga barbaria e medieeve dhe sidomos nga shkrimi i keq letrar"* (Lazër Stani). Atëherë, si të mos mbrohet shqipja standarde me ligj kur deri dhe zyrtarë e titullarë të lartë të institucioneve të shtetit në një fjali a paragraf bëjnë 40 gabime drejtshkrimore. Si të mos mbrohet shqipja me ligj, kur institucionet tona nuk shkruajnë në shqipen standarde, kur në një dokument të lëshuar nga administrata e Kuvendit Komunal në Gjilan shihen së paku 18 gabime drejtshkrimore të gjuhës shqipe! (Drejtorja për Administratë dhe Përsonelet, Lajmërimi dhe Ç'lajmërimi të Vendqëndrimit të Përkohëshëm, Adresa e Vendqëndrimit të Përkohëshëm etj.). Personat e dhe institucionet e tilla nuk komunikojnë me vetveten, as me familjarët e tyre privatisht, por u drejtohen institucioneve të tjera me këtë gjuhë e me këtë shkrim. Ta lëmë kështu gjuhën të nakatosur e të sakatosur, të krijojmë një babiloni gjuhësh e shkrimesh për hir të asaj se u kufizuaka shprehja e lirë, kjo do të ishte gjëja më absurde. Neve, krahas qytetërimit kulturor, na duhet dhe një qytetërim gjuhësor, sikurse gjithë kombeve të përparuara. Por për qytetërimin tonë gjuhësor

duhet të punojmë vetë, nuk është një produkt që mund të na vijë falas nga Europa. Gjuha është si një fidan që duhet ujitur çdo ditë, nëse dëshirojmë të rritet mirë e të japë fruta të ëmbla. Jo t'i thyhen degët dhe nduken gjethet. Gjuha, sikurse fëmija, rritet vetëm me dashuri, duke e mbajtur atë pranë.

Gjuha si kod, nga pikëpamja e shkencave të komunikimit

Në rrafshin e diskutimeve për shqipen standarde dhe dialektet, ka hedhur disa mendime që lidhen me gjuhën si kod komunikimi, nga pikëpamja e shkencave të komunikimit, edhe Artan Fuga. Ky në një shkrim të tij me titull paksa jo të zakonshëm *“Pse ushtrohet represion kundër dialekteve të shqipes?”* (Gazeta “Standard”), përpiket të diskutoj çështjen nëse vërtet ekzistenca e njohur zyrtare ose gjysmëzyrtare e dialekteve e shprish apo jo kombin, e shprish apo jo shtetin.

Fuga në vështrimin e tij filozofik merr të shpjegojë se: *“Dialektet shpallen gati-gati antishtet. Me gegnishten apo pa gegnishten, me toskërishten apo pa toskërishten, mendimi sundues duket se është që duhet një gjuhë zyrtare e shtetit, përndryshe shteti nuk mund të ekzistojë, as kombi. Dialekti i jugut apo i veriut, i Beratit, Korçës, Përmetit, Lushnjës, Fierit, labërishtes, Shijakut, Durrësit, Tiranës, Krujës, Lezhës, Shkodrës, Tropojës, etj. shpallen se po të zyrtarizohen, disi e shkakllmojnë shtetin. Më tepër, hidhet ideja se dialekti kosovar ose duhet zhbërë që të kemi një komb, ose po që se është, atëherë kemi dy kombe”. Dhe më tej, me silogjizmat e tij rreth gjuhës, jep edhe këto konstantime: “Politika na ka imponuar një njësim dhe standardizim të tejskajshëm. Nuk është thjesht puna nëse baza e këtij njësimi është toskërishtja apo gegnishtja, sipas meje, por sepse njësimi na paraqitet si formë më e pasur shprehëse sesa diversifikimi kulturor dhe gjuhësor. Kush është ai i gjithëditur që do të dinte të mbronte pikëpamjen se kalimi nga larushmëria diverse drejt unitarizmit tharës standard është një formë progresi? Me çfarë argumentesh do të mbronte këtë dhe jo të kundërtën. Dy ose tre shekuj më parë, shteti, kuptohej natyrshëm si një kështjellë e mbyllur që centralizon gjithçka, por koha e këtij mentaliteti ka kaluar. Sot në vendimmarrje masat e popullsisë regjionale janë më të shumta sesa elitat qendrore. Periferia është më e shumtë sesa qendra. Demokratizimi i gjuhës kalon nëpërmjet njohjes zyrtare të dialekteve. Si mund ta frustrosh përjetë një fëmijë në moshë shkollore, i cili deri në klasën e parë është rritur dhe edukuar me edukatën e familjes bazuar në dialekt dhe me të ardhur në shkollë i thonë: Ndal! Si është e mundur që përreth shkollës dhe orareve të saj nxënësi të flasë në dialekt, kurse brenda shkollës të ndihet një i burgosur gjuhësor? Si mundet që gojarisht nxënësi të shprehet në dialekt dhe me shkrim në hartim t'i thuhet shkruaj në shqipen zyrtare? A nuk krijojnë këto rrethana vend për deprimimin dhe frustrimin, për karaktere psikologjike skizofrenike?”*

Secili mund të ketë mendimin e tij për gjuhën dhe për dialektet, natyrisht edhe filozofët. Por mendimi në fushën e gjuhësisë, për të qenë i pranueshëm, sikurse dhe në shkencat e tjera, duhet të jetë i argumentuar dhe të ketë kompetencën shkencore. Ç'do të thotë p.sh. *“represion kundër dialekteve”* dhe *“zyrtarizim i dialekteve”* që ngre si çështje Fuga. Për ta shpjeguar çështjen rreth konstatimeve të mësipërme, e do puna të japim këtu një përgjigje. E para, dialektet kurrkush nuk i ka shpallur dhe nuk mund t'i shpallë antishtet; së dyti, nuk është

aspak e vërtetë se politika na ka imponuar një njësim dhe standardizim të tejskajshëm, por standardizimin e gjuhës e imponojnë *politikat gjuhësore*; dhe e treta, në teorinë dhe në praktikën gjuhësore nuk e thotë kurrkush se *njësimi na paraqitet si formë më e pasur shprehëse sesa diversifikimi kulturor dhe gjuhësor*. Dialektet janë ato që janë, të folme popullore regjionale, që i japin ushqim të përditshëm gjuhës letrare a standarde dhe pa të cilat nuk mund të ekzistojë kjo e fundit (standardi). Por dialektet a të folmet lokale nuk mund të derdhen në standard, të flasë e të shkruajë kush si të dojë. Sepse kjo i vjen si ujërat vërshues që përmytin gjithçka. Ndryshe, do të kishim përzierjen e standardit me dialekte, një gjuhë mikste, as standard as dialekt. Është në natyrën e gjuhëve, kudo në botë, që ndryshe flitet në dialekt, ndryshe në standard. Për këtë qëllim krijohet dhe standardi, jo si “formë më e pasur e shprehjes”, si gjuhë më e bukur e më e arrirë në rrafshin linguistik, si gjuhë më e lartë, më e bukur, më e përsosur, por si regjistër, si instrumentarium i përbashkët për të gjithë shqipfolësit, që e bën më të lehtë komunikimin për gjithë kombin. Pra edhe për të huajt që flasin shqip. Ndryshe, si do të komunikonin të huajt me një shqipe të përzier kur ata nuk i njohin dialektet e kësaj gjuhe? Në fakt, gjuha nuk është diçka e unifikuar, e ngurtësuar. Secili nga ne, në vartësi të rrethanave të ndryshme jetësore, flet në mënyra të ndryshme. Ndryshe flet në shtëpi, ndryshe flet me prindërit e vet, me nënën, me babain, ndryshe flet në katedër ose në radio e televizion etj. Do të ishte e panatyrshme që njeriu të fliste në mënyrë të njëjtë. Pra, gjuha në jetën e përditshme manifestohet në forma të ndryshme. Ka formën e saj letrare, formën e shkruar, formën e folur, formën bisedore etj. Në njëfarë mënyre, kjo do të mund të quhej “*demokratizimi i gjuhës*”, kur njeriu flet ndryshe në shtëpi, ndryshe në shkollë, ndryshe në jetën publike dhe institucionet e shtetit. Por nuk mund të ketë “*demokraci në gjuhë*” kur dikush flet një përzierje dialektore në televizion, kur nxënësi flet të folmen e familjes në shkollë. Gjuhëtari i shquar Bllazhe Koneski, për ta shpjeguar më mirë këtë dukuri të performancës gjuhësore të gjuhës letrare a standarde kundruall dialektit, sjell këtë shembull interesant: “*Për njeriun është më mirë të ketë dy kostume, se sa një. Një kostum ta ketë për punët e përditshme, kurse tjetrin për festa. Porse duhet të dijë që kostumi që është për punë nuk vishet për Pashkë, ose nuk vishet për në teatër. Dhe anasjelltas*” (Cane Andreevski, *Razgovori so Koneski*, Kultura, Skopje, 1991, 457).

Apo, me fjalët e gjuhëtares Violeta Nikolovska: “*Për përdorimin e dialekteve, duhet ta zhdukim një paragjykim. Nuk është turp të flitet në dialekt. Përkundrazi, dialektet janë realitete gjuhësore. Ato japin bazën e gjuhës letrare. Duhet vetëm të dimë ku, në cilën situatë duhet ta përdorim gjuhën letrare, e në cilën dialektin. Ashtu sikurse nuk vishemi njësoj për raste të ndryshme, p.sh. për dasmë ose në punë*”.

Të folurit në disa televizione të Kosovës, në RTK, KTV, TV 21 etj., nga moderatorët e emisioneve dhe nga të ftuarit në emision, me një gjuhë të përzier dialektore me standardin, nuk është as “*demokraci në gjuhësi*”, as “*liri e shprehjes*”, por është është kod në komunikim se ne akoma jemi larg *qytetërimit gjuhësor*.

QANI MEMETI

SHQIPJA MIDIS TRADITËS DHE MODERNES

Titulli i këtij punimi duket paksa si shumë letrar, duke pasur parasysh se gjuha është gjuhë dhe nuk mund të ketë ndonjë interpretim tjetër nga interpretimi tradicional i materies së gjuhës. Ndoshta për këtë temë është dashur të mendojnë më tepër metodicientët e gjuhës shqipe, sepse nevoja, raportet dhe vetë paraqitja e lëndës së gjuhës shqipe, kërkon që mësimi të saj, nga të tjerët, në këtë rast joshqipfolësve, të cilët si gjuhë amtare e kanë serbishten, kroatishten, boshnjakishten ose maqedonishten, bullgarishten etj. të sjellin forma dhe mundësi sa më të lehta dhe të pranueshme për mësimin e gjuhës shqipe.

Duke u nisur nga përvoja jonë shumëvjeçare e mësimi të shqipes nga studentë dhe të tjerë, të cilët shqipen nuk e kanë gjuhë amtare, na ka nxitur që t'i paraqesim pikëpamjet tona për mësimin e saj që ajo të jetë sa më afër tyre dhe të mos krijojë hendeqe të mëdha për mësimin e saj si një gjuhë e rëndë dhe e vështirë për ta mësuar.

Nga ana tjetër kjo temë nuk është menduar si ndonjë sugjerim i trajtimit ndryshe teorik – metodik i mësimi të gjuhës shqipe dhe nuk ka për qëllim pretendimi të zgjidhjes praktike për të gjitha disiplinat gjuhësore të cilat ndikojnë, ndjeshëm, në mësimin sa më të mirë dhe sa më të shpejtë të mësimi të gjuhës shqipe, por të prekë disa nga mundësitë e zbërthimit sa më thjeshtë dhe praktik të përvetësimit të formave të emrave, përemrave dhe numërorëve. Pra, kjo temë ka për qëllim vetëm trajtimin e disa problemeve të rëndësishme mësimore, por pse jo edhe metodike, duke pasur parasysh edhe ndikimin e gjuhës bazë, përkatësisht të gjuhës maqedonase (gjuhëve sllave) për ndikimin që kanë pasur gjatë mësimi të gjuhës shqipe.

Duke pasur parasysh faktin se në shumë mjedise të Republikës së Maqedonisë nuk i është kushtuar rëndësi e duhur njohjes ose mësimi të njërës apo të gjuhës tjetër, ka ndikuar që gjuha shqipe të ketë sot një epitete si një gjuhë e vështirë dhe e pa kapshme për ata që si gjuhë amtare e kanë një gjuhë sllave. Kësaj aq më shumë i ka ndihmuar edhe mosmbrojtja e saj institucionale nga vetë sistemi arsimor i shtetit ku gjuha shqipe ka qenë gjuhë e dytë ose vetëm si gjuhë e minoritetit, të cilët nuk kanë pasur të drejtë ta përdorin edhe në institucione të ndryshme shtetërore, porse edhe një numër bukur i mirë i arsimtarëve apo i profesorëve të njërës apo gjuhës tjetër të cilët nuk janë kujdesur me përkushtueshmëri që t'ua mësojnë këtë apo atë gjuhë mirë, drejt dhe shpejt.

Një faktor tjetër plotësues që ka ndikuar në mosnxënien e mësimi të shqipes janë edhe disa zona të thella që nuk kanë interesim ose nuk janë të kualifikuar për dhënien e mësimi të njërës apo të gjuhës tjetër dhe nuk kanë qenë dhe nuk janë në

gjendje t'i përmbushin kërkesat që i ka shtruar dhe i shtron programi, sidomos, rreth zbatimit të metodave efikase në procesin e nxënies së dijes së gjuhës.

Duke i pasur parasysh rrethanat me të cilat ballafaqohet mësimi i gjuhës shqipe nga joshqiptarët, planifikimi i lëndës dhe i metodës (va) duhet t'i ketë parasysh disa çështje me rëndësi dhe të cilat ndikojnë pozitivisht në mësimin e gjuhës shqipe nga joshqiptarët si gjuhë në praktikë dhe me njohjen e disa treguesve dhe rregullave gramatikore me të cilët ndërtohet struktura e gjuhës, e cila për dallim nga gjuha amtare, e tyre, dallon, ose është dalluese. Treguesit dhe rregullat kryesore gramatikore janë:

1. njohja e lëndës gramatikore me të gjitha specifikat që mund t'i ketë njëra apo gjuha tjetër (shqipe dhe maqedonase);
2. njohja e mirë e strukturës së njërës dhe e gjuhës tjetër, përfshirë këtu edhe dallimet e renditjes së grupeve emërore apo të gjymtyrëve kryesore të fjalisë;
3. njohja e leksikut potencial të njërës dhe të gjuhës tjetër (gjallëria e mjeteve fjalëformuese e disa mënyrave e modeleve (gjedheve) të shqipes, sidomos të shqipes së folur etj, por që nuk përbën ndonjë tregues bazë për përvetësimin e rregullave gramatikore, ose të mbaresave të emrave dhe të nyjes para emrave në rasën gjinore, para disa përemrave pronorë dhe mbiemrave të nyjshëm.

Çdo gjuhë është sistem i përbërë nga një numër i dukurive të shumta gjuhësore të cilat midis tyre kanë një lidhshmëri gjuhësore, dhe jo vetëm thjesht elemente të pavarura të cilat e përbëjnë ndërtimin ose komunikimin në një gjuhë ose në gjuhën shqipe. Pikërisht për këtë lidhje gjuhësore zotërim i gjuhës shqipe si gjuhë e huaj (ose e mesit) nuk do të thotë vetëm zotërim ose njohje e elementëve të ndarë të atij sistemi gjuhësor (fonetik, leksik, sintaktik, morfologjik), por, para së gjithash, zotërimi i tërësisë dhe funksionimi i sistemit të tërësishëm gjuhësor dhe themelor për komunikim të drejtë dhe të mirë.

Ky zinxhir, në dukje të parë i ndërlikuar, i shtresimit të lëndës gjuhësore me shumë fusha të cilat e krijojnë një imazh të vetëm komunikimi: tematika, ligjshmëritë gjuhësore, mundësia e ushtrimeve gjuhësore nga tematika, mësimin e gjuhës shqipe, si në të folur edhe në të shkruar, e bën të ndërlikuar dhe të rëndë nëse ky sistem zinxhiror nuk është i mundshëm, preciz, i thjeshtë dhe i kapshëm në planin e kapjes së përvetësimit dhe të kuptuarit e ndërtimeve të formave, që në gramatikat tona jemi mësuar t'i quajmë dhe t'i trajtojmë si mbaresa rasore që i marrin pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Pra, për ta mësuar, një i huaj, gjuhën shqipe duhet ta njohë lëndën gramatikore të gjuhës shqipe.

Në këtë paraqitje tonën po ndalemi vetëm te mënyra e transmetimit (përcjelljes) të treguesve gramatikorë ose të mbaresave rasore të emrave, të disa përemrave mbiemëror pronorë, ditëve të javës, dhe të mbiemrave të nyjshëm.

Në gramatikat e gjuhës shqipe jemi mësuar të lexojmë se emri në fjali përdoret në funksione të ndryshme sintaksore dhe varësisht nga funksioni i tij në fjali ai ndryshon edhe formën e tij. Ky ndryshim i formave në fjali quhen rasa ose forma rasore. Ndërsa tërësia e formave që pëson emri kur përdoret nëpër rasa, quhet *lakim* (*Gramatika e gjuhës shqipe, I f.105 ASHARSH dhe IGJL, Tiranë*).

Kjo rregull e grupimit ose e klasifikimit të emrave të gjuhës shqipe në gjini dhe lakime, gjinia mashkullore, femërore dhe asnjansë; lakimi i parë, i dytë, i tretë dhe lakimi i katërt si rregulla të marrjes së mbasesave të emrave, për lakimet gjegjëse, kur emrat shquhen dhe në rasën emërore marrin mbasesën –i dhe –u për gjininë mashkullore, –a për gjininë femërore dhe mbasesën –t(ë) për gjininë asnjansë, është ose janë tregues gramatikorë që mundësojnë informata të mjaftueshme për një të huaj se si mund ta dallojë gjininë e një emri.

Sa i përket planit praktik të përdorimit të emrave nëpër rasa dhe në formë të shquar dhe të pashquar, treguesit e shquarsisë së emrit janë vetëm tregues rregullash të përdorimit të mbasesave, ndërsa sa i përket përdorimit të mbasesave rasore, shpjegimi i mbasesave rasore të emrave të gjinisë mashkullore janë: për gjinore, dhanore dhe rrjedhore mbasesa-t, ndërsa për emrat e gjinisë femërore mbasesa –s dhe për rasën kallëzore për të dy gjinitë mbasesa –n, paksa ky shpjegim, për të huajt, sidomos për ata që gjuha e tyre nuk i njeh format rasore, është problem t'i përdorin drejt dhe pa gabime, sidomos kur pas një emri në rasën emërore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore përdoret një emër në rasën gjinore ose ndonjë mbiemër i nyjshëm, apo përemër pronor, kur në trajtën e shquar dhe kur në trajtën e pashquar

Si shembull po marrim një emër të lakimit të parë dhe një emër të lakimit të tretë:

<i>djali i mirë</i>	<i>djali i Ilirit</i>	<i>djali i tij</i>
<i>i djalit të mirë</i>	<i>i djalit të Ilirit</i>	<i>i djalit të tij</i>
<i>i them djalit të mirë</i>	<i>i them djalit të Ilirit</i>	<i>i them djalit të tij</i>
<i>e njoh djalin e mirë</i>	<i>e njoh djalin e Ilirit</i>	<i>e njoh djalin e tij</i>
<i>prej djalit të mirë</i>	<i>prej djalit të Ilirit</i>	<i>prej djalit të tij</i>
<i>shoqja e mirë</i>	<i>shoqja e Ilirit</i>	<i>shoqja e tij</i>
<i>e shoqes së mire</i>	<i>e shoqes së Ilirit</i>	<i>e shoqes së tij</i>
<i>i them shoqes së mirë</i>	<i>i them shoqes së Ilirit</i>	<i>i them shoqes së tij</i>
<i>e njoh shoqen e mirë</i>	<i>e njoh shoqen e Ilirit</i>	<i>e njoh shoqen e tij</i>
<i>prej shoqes së mirë</i>	<i>prej shoqes së Ilirit</i>	<i>prej shoqes së tij</i>

Sipas treguesve gramatikorë që dalin emrat e njërit dhe lakimit tjetër, emrat e lakimit të parë dhe të dytë në rasën gjinore, dhanore dhe rrjedhore, dalin ose marrin mbaresën rasore –t, ndërsa emrat e lakimit të tretë po në të njëjtat rasa dalin me mbaresën –s, kurse përcaktori i tyre (emri në rasën gjinore, mbiemri dhe përemri po në ato rasa, për dallim nga rasa emërore, ku përcaktori del me nyjën i dhe e) del me nyjën – të për emrat e gjinisë mashkullore dhe –së për emrat e gjinisë femërore dhe nyjën –e për të tri gjinitë në rasën kallëzore. Po si mund t’ua shpjegojmë këtë rregull të njësuar të përdorimit të emrave nëpër rasa dhe përcaktorët e tyre që dalin me nyjën i për gjininë mashkullore dhe nyjen e për gjininë femërore, ndërsa emrat në rasat tjera dalin me mbaresën –t dhe me nyjën e përcaktorëve të, ndërsa emrat e gjinisë femërore, në gjinore, dhanore dhe rrjedhore me mbaresën – s dhe me nyjën e përcaktorëve së, ndërsa në rasën kallëzore me mbaresën –n dhe nyjën e përcaktorëve e?

qyteti im i qytetit – tim mësuesja ime e,i mësueses sime

qyteti ynë i qytetit – tonë mësuesja jonë e,i mësueses sonë

*qytetin
tonë mësuesen tonë*

ky libër i këtij libri kjo mësuese i, e kësaj mësuese

Si t’ua shpjegojmë dhe t’ua bëjmë më të qartë këto dhe forma tjera të përemrave, emrave në rasën gjinore dhe të mbiemrave? Në shikim të parë duket se është shumë i thjeshtë dhe i kapshëm ky ndryshim i formave të nyjes së emrave në rasën gjinore, të nyjes së mbiemrave të nyjshëm dhe të përemrave pronorë mbiemërorë. Por, duhet pasur para sysh se jo shqiptarët akoma nuk e kanë arritur shkallën apo nivelin e përdorimit të këtyre formave përmes analogjisë mekanike të përdorimit të nyjes dhe të formave të përemrave pronorë, ndërsa për folësit e shqipes të cilët gjuhën shqipe e kanë gjuhë amtare, natyrisht se kjo mund të jetë edhe e thjeshtë dhe nuk ka vend, ndoshta, për diskutim, përkatësisht, për shpjegimin e transformimit të nyjes **i** ose **e** në **të** dhe **së**, ose të përemrit pronorë **ime** në **sime** apo të përemrit dëftor **ky** në **i, e këtij, kjo-i, e kësaj** etj.

Prandaj, mendojmë se forma dhe mundësia më e mirë për t’i kuptuar këto, për ta, ndryshime të nyjave dhe të përemrave pronorë, duhet nisur nga fakti i përdorimit ose i reflektimit të mbasesës rasore të emrit –**t** te nyja **i** në –**të**, e cila mbasesë rasore bartet te nyja e emrit në rasën gjinore apo te mbiemrat e nyjshëm, ndërsa reflektimi i mbasesës rasore të emrit –**s** te nyja **e** në **së**, e cila mbasesë rasore bartet te nyja e emrit dhe e mbiemrave **e** në **së**. Ndërsa sa i përket ndryshimit të formës së përemrit dëftor **ky** në **i, e këtij** dhe **kjo** në **i, e kësaj**, të cilët përemra, për joshqiptarët, dalin me dy rrënjë; njëra për rasën emërore (**ky, kjo**) dhe tjetra rrënjë

për rasat tjera (**i, e këtij, i, e kësaj dhe këtë, atë** për të dyja gjinitë në rasën kallëzore).

Si t'u shpjegohen format e përemrave dëftorë **ky, ai në i këtij, i atij** për gjininë mashkullore njëjës dhe **kjo, ajo në i kësaj, i asaj** për gjininë femërore dhe **këtë, atë** në rasën kallëzore **këtë, atë** për të dyja gjinitë? - Duhet shpjeguar burimi i tyre që dalin nga përngjitja e dy elementëve (**a-** dhe **kë-**, ndërsa elementi i dytë është vetë përemri dëftorë (Kolec Topalli: Evolucioni historik i përemrave të shqipes, f. 68.) apo format me të cilët dalin këta përemra dëftorë, mirëpo po ta shpjegojmë përngjitjen e tyre nga dy elementë, del se elementi i dytë nuk është vetë përemri dëftorë por tema e përemrit pronorë-dëftorë (**i, e**) **tij, (i,e) saj** të cilat i prapavendosen tingullit nistor të përemrave dëftorë. Sipas mendimit tonë format e zhdrejta të përemrave dëftorë, pronorë dhe të emrave në rasën gjinore, por edhe format e tyre në rasën kallëzore, duhet shpjeguar sipas një rregullimi mekanik të formave. Pra, formimi i këtyre formave rasore është një rrugë vetjake e krijimit të këtyre formave të përemrave dhe emrave në rasën gjinore, një rregullim mekanik i formës së emrit në rasën përkatëse me nyjen e emrave, mbiemrave të nyjshëm dhe të përemrave pronorë si dhe të formave të përemrave pronorë; djalit **tim** (djali im); vajzës **sime** (vajza ime); qytetit **tonë** (qyteti ynë); bibliotekës **sonë** (biblioteka jonë) etj.

Në këto dhe raste të tjera ku nyja e emrit, mbiemrit dhe fonema nistore e përemrave pronorë rregullohet në mënyrë mekanike përmes bartjes së mbaresës rasore të emrit te nyja dhe te përemrat pronorë.p.sh: vajza ime, shtëpia e vajzës **sime**; qyteti ynë, plani i qytetit **tonë** etj. Në sintagma të tilla tregues kryesor i formës së nyjës së emrit, mbiemrit dhe i fonemës nistore është bartja e mbaresës rasore të emrit te nyja dhe te pronorët, ndërsa sa i përket formës së nyjës së emrave në rasën gjinore, të mbiemrave, të përemrave pronorë në rasën kallëzore kemi rrafshim të nyjës dhe të formave të përemrave pronorë, sepse të gjithë emrat, pa dallim gjinie dhe lakimi, në rasën kallëzore marrin mbaresën **-n**, ndaj edhe nyja dhe forma e përemrave pronorë i përshtatet atij rregullimi mekanik të sintagmës në gjuhën shqipe, p. sh.: djalit **tim** (djali im); vajzën **time** (vajza ime); qytetin **tonë** (qyteti ynë); bibliotekën **tonë** (biblioteka jonë) etj.

Gjuha shqipe nuk ka forma të veçanta për të gjitha rasat. Kështu, emri në rasën emërore del me të njëjtën formë të rasës kallëzore të *pashquar*, po ashtu edhe dhanorja me rrjedhoren nuk dallohen njëra prej tjetrës, porse formën e rasës dhanore forma e rasës rrjedhore e dallon me parafjalën *prej*. Edhe shumësi i shquar sikurse edhe njëjësi i pashquar del me forma të njëjta; *emërorja del e njëjtë me kallëzoren* sikurse edhe dhanorja me rrjedhoren. Forma e rasës gjinore dallohet nga forma e rasës dhanore dhe rrjedhore jo vetëm në anën kuptimore por edhe nga prania e nyjës. Mirëpo, nëse kihet parasysh se prania e nyjes së rasës gjinore gjithëherë përshtatet me fjalën paraprijëse dhe trajtohet si pjesë përbërëse e fjalës së përcaktuar, ndërsa emri i dytë (i rasës gjinore) si përcaktues mbetet i pandryshuar dhe forma e tij është e njëjtë me format e rasës dhanore dhe rrjedhore, p.sh.: drejtori **i** shkollës “direktorot na u-ili{te”, drejtorit **të** shkollës “na u-ili{niot direktor ose na direktorot na u-ili{teto””; drejtoresha **e** shkollës “direktorkata na u-ili{teto”, drejtoreshës **së** shkollës “na direktorkata na u-ili{teto”, drejtorët e

shkollave “direktorite na u-ili{tata”, drejtoreshat e shkollave “direktorkite na u-ili{tata”. Ngjashmëria funksionale e rasës gjinore është e njëjtë me funksionin e mbiemrit, sepse të dytë shërbejnë si përcaktorë. Dhe nyja e mbiemrit si përcaktor gjithëherë i përshtatet gjinisë, numrit dhe rasës së emrit që e përcakton, sikurse që i përshtatet nyja e rasës gjinore emrit paraprijës në gjini, numër dhe rasë si emër përcaktor i emrit të parë; *drejtori i ri “noviot direktor”, drejtoresha e re “novata direktorka”; drejtorit të ri “na noviot direktor”, drejtoreshës së re “na novata direktorka”; drejtorët e rinj “novite direktori”, drejtoreshat e reja “novite direktorki”* etj.

Nuk mjafton vetëm përshkrimi i formave të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratë duke pasur para sysh se gjuha maqedonase nuk e ka sistemin e rasave, (ose nëse gjuha serbe e ka sistemin e rasave dallon nga shqipja nga shquarsia apo mosquarësia e emrave; Beograd-Beograd: Beograd-Beogradi) prandaj edhe paraqitet problemi i përdorimit të rasës gjinore me përdorimin e rasës kallëzore, kur kihet para sysh se mbaresa rasore e rasës gjinore në gjuhën maqedonase paraqitet si paraafjalë që e shënon përcaktorin, porse me të njëjtën paraafjalë mbulohet edhe nyja e emrave në rasën gjinore:

drejtori i shkollës “direktorot na u-ili{te”, drejtorit të shkollës “na u-ili{niot direktor ose na direktorot na u-ili{teto”.

Kur e përmendim njohjen e mirë të brumit të leksikut dhe të normës së përdorur si njësi strukturore me gjithë lëndën gramatikore i kemi parasysh propozicionet e ashtuquajtura strukturale si shumë të rëndësishme dhe të veçanta dhe duhet kushtuar kujdes të madh, sepse, ndryshe, kuptimi i përkthimit mund ta shmang domethënien burimore për shkak se diferencat e propozicioneve strukturale të dy gjuhëve janë, ose mund të jenë të ndryshme, të theksuara, sa që me rastin e kthimit të një strukture nga një gjuhë në tjetrën, te folësi formohen kuptime të gabuara.

Po theksojmë vetëm diferencën e paraafjalës **vo** dhe **na** me paraafjalën e gjuhës shqipe **në**, e cila për të dyja paraafjalët në gjuhën shqipe është e njëjtë, por që në gjuhën maqedonase ato kanë vendet e tyre të caktuara të përdorimit. Kur tregon drejtim në gjuhën maqedonase:

Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë nesër shkon në Greqi – Ministerot na Nadvorešni raboti na Makedonija utre odi vo Grcija, ndërsa kur ka kuptimin e përcaktorit në maqedonishte, përdoret paraafjala **na** që në gjuhën shqipe i përgjigjen nyjat **i, e, të, së**, varësisht nga forma dhe nga gjinia e emrit;

Në sallën e madhe të Kuvendit të Maqedonisë mbahet një konferencë shtypi për gazetarët e mjeteve të huaja të informimit – Vo golemata sala na Sobranieto na Makedonija (na makedonskoto Sobranie) se odr’uva edna konferencija za pečatot za nadvorešnite (stranskite) novinari na informativnite mediumi.

Për t’iu shmangur këtyre konstrakteve që janë nën ndikimin e strukturës së gjuhës maqedonase lënda gramatikore duhet të planifikohet në atë masë sa atyre do t’ju ndihmojë të ndërtojnë konstrakte të reja, të cilat dallohen nga gjuha amtare dhe të krijojnë një sistem të ri për përvetësimin e mjeteve për komunikim. Pra me planifikim duhet të kuptojmë shpjegimin e detajuar të kategorive gramatikore që janë ose paraqesin karakteristikë për gjuhën maqedonase, që, para së gjithash,

nxënësit, studentët ta përvetësojnë përdorimin e gjuhës shqipe në praktikë dhe jo si njohuri teorike mbi gjuhën shqipe.

P. sh. Qyteti im është i bukur “Mojot **grad** e ubav” dhe

Unë e dua **qytetin** tim “Jas go sakam mojt **grad**”. Në të dyja konstruktet e mëlartë në gjuhën maqedonase emri qytet – **grad** del me formë të njëjtë edhe si kryefjalë edhe si kundrinë, ndërsa në gjuhën shqipe dallon forma **qyteti** nga **qytetin**.

Ose Motra **ime** është studente në vitin e parë të mjekësisë “**Mojata** sestra e studentka vo prva godina vo medicina” dhe

Unë me motrën **time** jemi studente “Jas so **mojata** sestra sme studentki”. Edhe në këtë rast përemri **mojata** në gjuhën maqedonase del homofomë, ndërsa në gjuhën shqipe dallon përdorimi i përemrit në rasën emërore me formën e përemrit të njëjtë në rasën kallëzore.

Për t’i dalluar këto dhe format tjera të emrave, të përemrave pronorë dhe të mbiemrave të nyjshëm në rasën emërore dhe kallëzore, nxënësve/studentëve duhet afuar shembuj dhe modele nga të cilët do të mund ta bëjnë dallimin e emrit në rasën emërore me atë të rasës kallëzore, ose të përemrit pronor në rasën emërore me atë të rasës kallëzore. Për t’ia arritur këtij qëllimi praktik, teksti ose shembujt duhet të jenë të harmonizuar me tematikën e pjesës së leximit ose të kumtimit ku shembujt/tekstet japin një pasqyrë më të qartë të përdorimit të pjesëve të caktuara gramatikore.

Edhe sa u përket kuptimeve kryesore të formave të emrave nëpër rasa themi se emri në rasën emërore shërben si kryefjalë, si pjesë e kallëzuesit emëror, si përcaktor kallëzuesor i kryefjalës, si ndajshim dhe si thirr.

Nata është fort e qetë. *Dhe tani e kishte përpara tij, të shkathët e të gjallë, dhe i bëhej zemra mal.*

Kur përdoret emërorja me parafjalët **nga e te(k)** largohet prej funksionit të saj në rasën emërore dhe afrohet me rasën kallëzore ose rrjedhore. P.sh.: *Iku nga shtëpia. (Iku prej shtëpisë –shkoi në shtëpi).*

Shpeshherë përdorimi i rasës emërore me parafjalë dhe i emrit në rasën rrjedhore me parafjalën **prej** për maqedonasit dalin me forma të rrafshuara; forma e rasës emërore me parafjalën **prej** del e njëjtë me formën e rasës emërore: *Iku nga shtëpia. (Iku prej shtëpia, {një morfologji e parregullt e të huajve gjatë mësimi dhe përvetësimit të gjuhës shqipe/),* ose kur përdoret një emër në rasën rrjedhore me parafjalën **prej** i njëjti emër në rasën emërore me parafjalën **nga** del me formën e rasës rrjedhore, duke e pasur para sysh se në gjuhën maqedonase të dyja parafjalët përkthehen ose përdoren me të njëjtën parafjalë “**od**”, prandaj edhe nuk mund ta bëjnë dallimin e kuptimit të rasës emërore me atë të rasës rrjedhore. Të gjitha këto gabime kanë të bëjnë me njohjen ose mosnjohjen e përdorimit të formës së emrit me një emër ose me një përemër apo mbiemër dhe me përdorimin e mbaresës gjegjëse rasore.

Kujtojmë se derisa nuk arrijnë t’i kuptojnë dallimet e formës së emrave të rasës emërore dhe të rasës kallëzore në strukturën e fjalisë së gjuhës shqipe, e kanë shumë vështirë për t’i dalluar ose për t’i përdorur emrat në rasën gjinore me një emër të rasës emërore apo me një emër të rasës kallëzore, përkatësisht emrin në

rasën emërore me një mbiemër ose emrin në rasën kallëzore me parafjalë apo me mbiemër.

Në garat e qytetit djali doli përpara vajzës; ose:

1. Macja vrapon kulm.

Macja - veprimi (sendi).

kulm - objekti mbi të cilin sillet ose ec, vrapon sendi. Por për ta parë ose për ta bërë dallimin e formës së rasës kallëzore nga rasa emërore domosdo duhet të përcaktohen raportet dalluese (diferencuese) midis veprimit dhe sendit, ndaj edhe ka nevojë për t'u fituar ose për t'u ndërtuar një lidhje e re në fjali ose fjali e re:

1. Macja vrapon mbi kulm.

nën kulm.

në kulm.

(nga) kah kulmi (drejt kulmit).

Format e parregullta ose morfologjia e parregullt është një dukuri e rëndomtë te ata folës joshqiptarë të cilët nuk i kanë përvetësuar format e rregullta të gjuhës shqipe por janë nën ndikimin e normave dhe strukturës së gjuhës amtare (sllave). Këtu do të përmendim specifikën e strukturës së gjuhës shqipe dhe të asaj maqedonase, duke pasur parasysh se në renditjen strukturore të kumtimit këto dy gjuhë ndryshojnë njëra me tjetrën ndaj edhe paraqiten probleme dhe gabime të shumta gjatë mësimi të gjuhës shqipe. P.sh.:

I. gjuha shqipe ka aftësi gjuhësore që mbiemrat të cilët përdoren në gjuhën maqedonase t'i përdorë me emra të rasës gjinore, por nuk e përjashton edhe mundësinë e përdorimit të mbiemrave atje ku nuk prishet struktura e fjalisë.

II. përdorimi i mbiemrave dhe i përemrave (mbiemrave) pronorë para emrave në gjuhën maqedonase, ndërsa në gjuhën shqipe pas emrave.

III. aftësia e shquarsisë së mbiemrave dhe e përemrave në gjuhën maqedonase, ndërsa në gjuhën shqipe shquarsinë e bartin emrat dhe jo mbiemrat dhe përemrat.

IV. ndërtimi i strukturës së fjalisë me foljen **jam** në gjuhën maqedonase, ndërsa në gjuhën shqipe me foljen **kam**.

V. përdorimi i disa foljeve në formën veprorë në njërën gjuhë dhe në gjuhën tjetër në formën joveprorë: **përgjigjem, pëlqen** etj.

VI. përdorimi i trajtave të shkurtra të përemrave vektorë në trup të foljes në mënyrën urdhërore dhe dëshirore që gjuha maqedonase nuk e ka atë aftësi gjuhësore etj.

Profesor Gjovalin Shkurtaj duke folur për ndërtimin e individualitetit dhe konformizmit në gjuhë në veprën e tij Sociolinguistika, thotë: "Shembulli më i mirë që tregon se si fiton konformizmi (apo solidariteti) në gjuhën e bashkësisë në të folurit e çdo individi është fusha e **morfologjisë së parregullt**, p.sh. prania e foljeve të parregullta; po ashtu format e shumësit të emrave me metafoini, palatatizimi etj., si dukuri të gjalla në shqipen (po edhe në gjuhë të huaja). Emri **dash** në shumës e ka formën me metafoini të zanores së temës **desh**. Vëmë re se fëmijët e vegjël, deri në një farë moshe (katër vjeç), e kanë më për mbarë të mos e përdorin këtë "parregullsi" dhe thonë: dy **dasha**, dy **kala**, për kuaj, dy **dera**, dy **fika** (ose **fiqa**) për **fiq**; po kështu dy **djala** për dy **djem** etj" f. 83.

I njëjti ligj gjuhësor vlen edhe për maqedonasit të cilët sapo kanë filluar ta mësojnë gjuhën shqipe në shkollën nëntëvjeçare dhe në Universitetet e Maqedonisë.

Si përfundim, kujtojmë se për t'iu shmangur këtyre gabimeve, duhet pasur kujdes se si t'ua shpjegojmë ato ndryshime ose forma të emrave ose të nyjave në gjuhën shqipe; formën e emrit në funksion të kryefjalës, përcaktorit, kundrinës së drejtë dhe të zhdrejtë, por edhe të përemrave dëftorë e pronorë, sidomos pronorë, të cilët për joshqiptarët përbëjnë, bashkë me nyjet e shqipes, një problem të madh ose një mal formash, që për ta janë të pa kapshme, nëse nuk i qasemi thjesht dhe të zbërthyer mirë e drejtë, pa ato rregulla të stërngarkuara morfologjike dhe sintaksore. Lënda gramatikore duhet të zbërthehet mirë dhe thjeshtë për të pasur mundësi të ndërtojnë konstrukte të veta, të cilat dallohen nga gjuha e tyre amtare dhe të krijojnë një sistem të ri për përvetësimin e mjeteve gramatikore për komunikim. Pra, me planifikim duhet të kuptojmë shpjegimin e detajuar të treguesve gramatikorë të shqipes që janë ose paraqesin karakteristikë për gjuhën maqedonase që, para së gjithash, nxënësit, studentët ta përvetësojnë format e gjuhës shqipe në praktikë dhe jo si njohuri teorike mbi gjuhën shqipe.

IZAIM MURTEZANI

KONCEPTIMI I KOHËS NË POEZINË POPULLORE RITUALE

Përmbledhje e shkurtër: Kategoria e kohës në përmbajtjen e poezisë popullore rituale paraqitet me përmasa të shenjta apo mitike, pasi njeriu me bindje pagane nuk e kishte të zhvilluar vetëdijen e tij aq sa duhet që t'i perceptonte proceset natyrore në mënyrë objektive, apo sipas frymës shkencore. Meqenëse fuqitë e prodhimt në të kaluarën kanë qenë në nivel tejte të ulët, atëherë kjo është reflektuar edhe në formësimin e një numri të madh të besimeve, përfytyrimeve, riteve, narracioneve mitike, etj., me të cilat është tentuar që të shpjegohen enigmat e ndryshme që i ngërthente natyra në brendinë e saj.

Në këtë drejtim, edhe konceptimi i kohës ka qenë me prapavijë mitike, pasi ndryshimi i saj që shkaktonte herë dimrin dhe herë verën perceptohej si një veprim i hyjnive të ndryshme pagane që kishin në duart e tyre fatin e njerëzve të rëndomtë. Këta të fundit detyroheshin t'u nënshtroheshin një numri të madh të riteve dhe praktikave magjike me qëllim që të përfitonin hirin, apo bekimin e këtyre fuqive hyjnore, pasi në të kundërtën mendohej se mund të pësonin keq, apo edhe të rrezikohej ekzistenca e tyre biologjike. Në këtë kontekst, poezia popullore rituale, përkatësisht konceptimi i kohës, brenda strukturës së saj përmbajtjesore, ofron një mundësi të mirë për të depërtuar në fshehtësinë e gjykimit me prapavijë pagane.

Fjalë kyçe: *ritual, mit, folklor, kohë ciklike, kohë lineare, ditë, natë, sinkretizëm, harmoni, kaos, kozmos, etj;*

1. Venerime hyrëse

Letërsia gojore paraqet trajtën më të lashtë dhe njëherësh më jetëgjatë të krijimtarisë artistike gjuhësore. Ajo dallon nga letërsia e shkruar me një numër të caktuar të tipareve, por njëherësh ka edhe elemente përkimi me të. Ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre, tanimë janë vënë në spikamë nga një numër i madh i studiuesve të folklorit. Në këtë kontekst, me të drejtë është theksuar se një ndër veçoritë më të rëndësishme të krijimtarisë gojore, përkatësisht folkloristikës është karakteri sinkretik i saj. Sinkretizmi folklorik në filluesin e tij ka nënkuptuar shkrirjen harmonike të elementeve, formave, mjeteve të ndryshme, si në planin artistik, ashtu edhe në atë joartistik. Folklori në fillimet e tij, duke i pasur parasysh këto elemente, nuk ishte dhe nuk mund të ishte vetëm krijimtari e pastër artistike. Fillesat artistike të tij kanë qenë pjesë përbërëse e përmbushjes së nevojave dhe praktikave utilitare. Pra, sinkretizmi, në kuptimin klasik të fjalës, e ka nismën e tij në pleksjen e vlerave artistike me ato joartistike, apo thënë më mirë me ato

praktiko-utilitare. Nënkuptohej se sinkretizmi si një tipar i rëndësishëm i folklorit s'ka mbetur pa mos pësuar ndryshime në rrugën e zhvillimit të tij historik në kuadër të trajtave të ndryshme folklorike. Duke i pasur parasysh këto konstatime duhet vënë në dukje se dukuria e sinkretizmit, veçmas është e ndërlidhur me poezinë popullore, sidomos me atë të natyrës rituale, si pjesë e rëndësishme e krijimtarisë sonë popullore. Poezia popullore rituale me të drejtë thuhet se nuk posedon vlera të theksuara artistike, pasi në plan të parë, synon të shpalosë vlerat gnoseologjike (njohëse). Kjo poezi si trajtë shumë e lashtë e manifestimit të ndjenjave, sidomos të njeriut pagan, ka qenë bashkim i elementeve të mitologjisë, religjionit, magjisë, etnomjekësisë dhe artit. Sinkretizmi ka qenë tipik për tërë krijimtarinë folklorike, e cila, siç thotë Solomon Marcus, ka parametra artistikë, të brendshëm (intrisekë), tekstori dhe parametra të jashtëm, sociokulturorë, meqë dukuria folklorike parreshtur luhet midis polit "art" dhe polit "kulturë" (sipas Papeleka 1999: 7). Pra, në rastin konkret, poezia popullore rituale, në sferën e saj përmbajtjesore, fsheh një numër të madh të elementeve të etnokulturës sonë të kohërave më të lashta. Në të, kanë gjetur vend fillesa të shumta kulturore që më vonë janë modifikuar dhe transformuar, varësisht nga shkalla e zhvillimit të vetëdijes së shoqërisë nëpër periudha të ndryshme historike.

Ky lloj i poezisë popullore, në të kaluarën, ka zënë një vend të rëndësishëm në sistemin e vlerave kulturore, madje do të thoshim të privilegjuar, pasi nëpërmjet tij, është menduar se veç tjerash, mund të arrihet efekti i dëshiruar në ndjelljen e harmonisë, përkatësisht begatisë në të gjitha fushat e jetës. Teksti i krijimeve të tilla, përkatësisht "fjalët që u drejtoheshin qenieve të mbinatyrshme, forcave të mistershme, gjithsesi duhej të ndryshonin nga ai tip ligjërimi i zakonshëm që përdornin anëtarët e bashkësisë për të folur për veprimet e tyre profane, për gjuetinë, për peshkimin, për punët e blegtorisë e të bujqësisë, për tërë spektrin e marrëdhënieve të tjera ndërnjerëzore. Për atë tip të posaçëm ligjërimi, të shpikur nga njerëzit për të sublimuar gjithçka që i përkiste sferës të së shenjtës, Jean Starobinski ka shkruar: "Ashtu si festat që sakralizojnë për bashkësinë përdorime të kundërta nga përdorimi i përditshëm, "gjuha poetike" - gjuhë e shuguruar-përcakton hapësirën rituale të një feste të ligjërit. Pra, është një ligjërim i ri, i përbashkët që përpunohet larg të folmes mesatare" (Papeleka, 1999: 6). Pra, nga kjo mund të konkludohet se kënga e mirëfilltë rituale fsheh në përmbajtjen e saj gjurmë të një besimi të lashtë njerëzor me prapavijë pagane. Këngët e kësaj natyre, të ekzekutuara me një ritëm specifik, kanë qenë pjesë përbërëse, në shumicën e rasteve, të festave popullore me prapavijë pagane dhe nënkuptohet se kanë qenë të ndërlidhura me rite të ndauarshme. Në përmbajtjen e tyre janë pasqyruar nevojat dhe interesi i bashkësisë së caktuar njerëzore me ç'rast vend të konsiderueshëm kanë zënë përfytyrimet fetare dhe magjike, si rrjedhojë e botëkuptimeve të ndryshme ndaj jetës dhe natyrës.

Poezia popullore rituale, siç theksuam më lartë, veç tjerash, ka qenë e ndërlidhur rreptësisht me ritin si pjesë përbërëse e tij. Ritin si akt të sjelljes religjioze, kanë tentuar ta definojnë një numër i madh i etnologëve, antropologëve dhe hulumtuesve tjerë të historisë së religjionit. Riti i definuar, sipas funksionit strukturalo-komunikativ, perceptohet si një mënyrë e caktuar e sjelljes simbolike që

bartet nëpërmjet traditës me qëllim që të transmetojë mesazh shoqëror, apo thënë ndryshe, riti paraqet pjesë të rëndësishme të sistemit joverbal, por edhe verbal të komunikimit. Çdo veprim me përmbajtje rituale përbëhet nga një numër i caktuar simbolesh që mund të jenë objekte, aktivitete, ndodhi, përkatësisht secili prej tyre, ka dimensionin e vet vizual, verbal, hapësinor dhe kohor që manifestohen njëkohësisht dhe kondensohen në një ngjarje të vetme. Qëllimi i ritit është të tregojë raportin që ekziston mes përvojës fizike, normave shoqërore, parime këto në të cilat bazohen struktura shoqërore dhe sistemi i vlerave nga njëra anë dhe bota e irracionales nga ana tjetër. Besimi se fuqia që konsiderohet si burim i jetës, shëndetit, begatisë është lokalizuar në botën tjetër dhe se është ndikuese edhe te qeniet që e përbëjnë këtë botë, implikon nevojën e aplikimit të lidhjeve mes dy botëve. Antropologu i njohur Edmund Liç thotë se detyra e praktikës religjioze (lexo ritit), është që të vendos urë ndërlidhëse mes kësaj dhe botës tjetër me qëllim që fuqia e hyjnisë të mund të kanalizohet në drejtim të ndihmesës së njerëzve të pafuqishëm (Liç, 1983: 109). Duke pasur parasysh këtë të dhënë, njeriu pagan çdoherë ka ndërmarr një numër të caktuar të aktiviteteve rituale, pikërisht në segmente të caktuara kohore kur është shënuar ndonjë kalim i rëndësishëm, qoftë në planin kalendarik, qoftë në planin antropologjik. Jo rastësisht, një fiksion i riteve për këto ditë të caktuara që shënojnë kalim nga një periudhë kohore në një periudhë tjetër kohore, kanë detyruar etnologun e njohur Arnold Van Gennep që teorikisht të përpunojë skenarin e zhvillimit të këtyre riteve (më gjerësisht, Gennep, 1981).

Siç theksuam më lartë, përmbajtja e poezisë popullore rituale, ka qenë e ndërlidhur kryesisht me festat më të rëndësishme të kalendarit popullor, por edhe me momentet më të rëndësishme të ciklit jetësor, siç janë lindja, martesja dhe vdekja. Nënkuptohej se përveç karakteristikave tjera që mund të dalin nga gjykimi shkencor, një bërthamë të rëndësishme të semantikës së saj, përbën dimensionin i kohës si një kategori shumë e rëndësishme e njeriut, qoftë të atij me botëkuptim pagan, por njëherësh edhe të këtij bashkëkohor. Kategoria e kohës në kontekst të poezisë popullore rituale, do të kundrohet kryesisht nga prizmi i logjikës arkaike e cila ka funksionuar në bazë parametrave mitikë për shkak se njeriu i asaj kohe e ka pasur shumë të vështirë të dallojë objektin nga subjekti, andaj duke u nisur nga vetvetja edhe objektet e natyrës i ka veneruar si subjekte të gjalla që kishin nevojë për një mënyrë të veçantë të komunikimit me të.

2. Koha në kontekst të poezisë rituale popullore

Jo rastësisht thuhet se bota e artit letrar realizohet nëpërmjet lojës që zhvillohet në dimensionin e kohës, përkatësisht ligjësorive që e përcjellin këtë fenomen. Kategoria e kohës si një element shumë i rëndësishëm, perceptohet në mënyra të ndryshme në teorinë dhe praktikën e krijimtarisë letrare, qoftë në kuptimin filozofik, qoftë në kuptimin e saj fizik (matës). Duke pasur parasysh kompleksitetin e definimit të kohës, ndoshta me të drejtë thuhet se ajo paraqet problemin më esencial të antropologjisë, kurse Anri Bergsoni thotë se koha është problemi më madhor i metafizikës. Pra, për kohën, por edhe për hapësirën si dukuri edhe të pandara njëra me tjetrën, veçmas kur shqyrtohen në kuadër të kulturës

popullore, është mjaft vështirë të flitet dhe të jepen gjykime të pakontestuar. Kategoritë e tilla, thotë studiuesi Kasirer, është e nevojshme të venerohen në një kontekst gjegjës kulturor, shoqëror ose rajonal. Koha si kategori, shton ai, është ndër idetë/përfytyrimet fundamentale për strukturimin e marrëdhënieve, për aplikimin e ritmit dhe periudhave: nëpërmjet saj vendoset rendi në dimensionin e jetesës shoqërore dhe kulturore (Kasirer, 1985: 118).

Në kontekst të traditës popullore, në kuptimin e saj më banal, koha ka kuptim pozitiv ose negativ. Kuptimi i saj pozitiv është i ndërlidhur me parimin e jetës, përkatësisht krijimin e konditave të pjellorisë dhe begatisë, qoftë në planin e ndryshimit të kushteve kalendarike, qoftë të atyre antropologjike. Kjo është kohë e kozmosit, përkatësisht harmonisë, krijimit të rendit, logjikës, vlerave të reja në raporte makrokozme dhe mikrokozme. Koha negative është kohë e mbretërimit të kaosit, përkatësisht parimit të vdekjes, pështjellimit, anarkisë, dekonstruksionit, si rrjedhojë e faktit se çdo gjë i nënshtrohet lëvizjes apo ndryshimit duke pasur fillimin dhe fundin e saj. Koha e kundruar në kondita të logjikës arkaike, çdoherë është pjesë e një përfytyrimi me përmasa mitike. Kjo kohë e kornizës mitike, mund të jetë e karakterit *kalendarik (natyror)* dhe *biologjik (jetësor)*. Koha kalendarike përbëhet nga cikli astrologjik – diellor (viti, dita, nata), lunar dhe vegjetativ (koha e rritjes dhe pjekjes së bimëve). Koha kalendarike është e karakterit kozmogonik, pasi çdoherë ndonjë ditë e rëndësishme e saj, sipas logjikës arkaike, identifikohet me krijimin e botës. Konceptimi i tillë i kozmogonisë (krijimit të botës), është rrjedhojë e faktit se njeriu për bazë të organizimit mitik të botës, ka marrë çdoherë funksionimin dhe konstitucionin e tij trupor. Sipas kësaj logjike, sot në shkencën etnologjike dhe antropologjike, si dhe në shkencat tjera shoqërore, është konfirmuar shumë herë teza e *aspektit antropocentrik* në organizimin strukturor të hapësirës dhe kohës, veçmas në kulturën popullore. Se njeriu ka shërbyer si model gjatë krijimit të botës, konfirmon edhe një himn i Rig-Vedave shumë të lashta indiane, sipas të cilit, njeriu i parë Purusha ka qenë i flijuar nga perënditë me qëllim që nga trupi i tij i copëtuar të krijohet bota. Kështu, mes të tjerash, nga këmbët e tij krijohet Toka, kurse nga koka e tij krijohet qielli. Në këtë kontekst, në hartën e botës që është e përbërë nga shtatë pjesë dhe ndodhet në përshkrimin e Hipokratit për numrin shtatë, Toka është treguar si trup i njeriut: koka e saj është Peleponezi, ngushtica e detit i përgjigjet shtyllës kurrizore, kurse Jonia paraqitet si diafragmë, përkatësisht si brendia e organeve, ose “kërthiza e botës” (Kasirer, 1985: 100). Nga kjo që theksuam deri tani, del në shesh e dhëna se njeriu me botëkuptim pagan, ka bërë njëjtësim mes vetes dhe botës duke u nisur çdoherë nga fakti se ai vetë duhet të shërbejë si masë edhe gjatë perceptimit të realitetit objektiv me të cilin ka komunikuar nëpërmjet formave të ndryshme, mes tjerash, edhe përmes ritit.

Koha si një kategori e rëndësishme e kulturës popullore, sipas logjikës së rezonimit arkaik, nëse i referohemi veprës së studiuesit të afirmuar të historisë së religjioneve, Mirça Eliade, ndahet në kohë sakrale (të shenjtë) dhe profane (të përditshme). Dallimi thelbësor mes tyre është se koha e shenjtë sipas natyrës së saj është reverzibile (kthyesë), për shkak se ajo është kohë parake, apo primordiale. Çdo festë religjioze duke përfshirë edhe ato pagane, mëtojnë të riaktualizojnë ndonjë ndodhi të shenjtë që ka ngjarë në të kaluarën mitike, përkatësisht “në fillim”.

Pjesëmarrja në ndonjë festë fetare nënkupton dalje nga koha “e përditshme” dhe inkudrim në kohën mitike që riaktualizohet nëpërmjet festës, gjegjësisht ekzekutimit të riteve të ndryshme. Kësisoj, koha mitike paraqet një përsëritje të amshueshme. Pra, njeriu religjioz jeton me dy lloje të kohës. E para, përkatësisht koha e shenjtë paraqitet si kohë në trajtë të qarkut, përsëritëse dhe reverzibile, në njëfarë mënyre si e tanishme mitike e amshueshme që kohë pas kohe aplikohet nëpërmjet ritit (sipas Eliade, 1986: 88). Njeriu me pikëpamje fetare refuzon të jetojë në kohën që në gjuhën bashkëkohore cilësohet si “e tanishme historike”. Nga kjo rezulton se perceptimi kulturor i kohës ciklike (qarkore) është paraqitur si trajtë e konkretizuar e kthimit të përhershëm të kohës në natyrë: çdo ditë-lëvizja e Tokës rreth boshtit të saj të paramenduar, përkatësisht sipas konceptimit popullor – rruga ditore e diellit, pastaj ajo e hënës – cikli i saj, pamja e diskut të hënës në sfondin qiellor dhe rrotullimi i Tokës rreth diellit për një vit të plotë. Në Egjiptin e lashtë, për shembull, cikli ditor i diellit, lindja e tij dhe perëndimi, janë perceptuar si lindje dhe vdekje e sërishme. Ky cikël i shkurtër, si pjesë, është njëjtësuar me ciklin vjetor të diellit që është kremtuar gjatë çdo Viti të Ri. Çdo ditë, si çdo vjet, dielli lufton me demonët e errësirës dhe vdekjes dhe lind i mëkëmbur, me forca të reja, njësoj siç ka qenë në ditën e parë të krijimit (më gjerë Cairns, 1993: 14). *Koha ciklike* vjen në shprehje me rastin e festave kalendarike popullore kur paraqitet nevoja e aktualizimit të ndonjë ndodhie mitike. Koha e llojit të tillë nga studiues të ndryshëm është paramenduar në trajtën e qarkut të mbyllur ose spirales. Tanimë është e njohur se në filozofinë antike, qarku ka simbolizuar zhvillimin ciklik dhe rrjedhën e kthimit në fillim, çdoherë fillim të ri dhe pleksje të fillimit, mesit dhe fundit. Ideja e Heraklitit për vëllimin e qarkut në të cilin bashkërisht janë fillimi dhe mbarimi në simbolikën gnostike filozofike është paraqitur me gjarprin që e han veten nga bishti. Domethënë, koha ciklike ka pikën fillestare dhe përfundimtare. Ciklet kanë fillimet dhe mbarimet e tyre që përsëriten. Niçeja në veprën e tij të njohur “Kështu fliste Zarathustra” thotë: “gjithçka shkon dhe gjithçka kthehet, në mënyrë të amshueshme rrotullohet rrota e qenies. Gjithçka vdes dhe gjithçka sërish gjelbëron; amshueshëm vrapon përpara viti i qenies. Gjithçka shpenzohet dhe gjithçka sërish bashkohet; amshueshëm ndërtohet shtëpia e njëjtë e qenies. Gjithçka ndahet dhe gjithçka sërish bashkohet; amshueshëm i mbetet besnik vetes unaza e qenies” (Niçe, 1987: 223-234).

Për dallim nga koha qarkore, *koha lineare* është kategori themelore fizike e cila perceptohet si një vijë e pandërprerë që në mënyrë të vazhdueshme dhe të pakthyeshme, ndodh si proces krejtësisht autonom, pavarësisht nga ndjenja, përjetimi dhe perceptimi njerëzor. Koha lineare (historike) në përfytyrimin e njeriut në shumicën e rasteve konkretizohet sipas ngjarjes, përkatësisht jo ndodhisë së ngjarjeve të caktuara. Ndoshta me siguri kur njeriu ka përjetuar realitetin e hidhur të humbjes së më të afërmeve nëpërmjet vdekjes, ka filluar ta njoh kohën përmes konceptit të lëvizjes së vazhdueshme të saj. Me siguri se trajtën më konkrete të kohës lineare, njeriu e njeh duke kaluar vetë ai dhe të gjithë të afërmit e tij nëpër të gjitha fazat e jetës, duke filluar nga lindja e deri në përmbylljen e saj, përkatësisht braktisjen e kësaj bote. Pra, një trajtë më konkrete e njohjes dhe kuptimit të llojit të tillë të kësaj kohe, është jeta e njeriut, përkatësisht momentet vendimtare, siç janë

lindja, martesë dhe vdekja. Vdekjet dhe lindjet e vazhdueshme sjellin ndërrimin e gjeneratave. Kjo gjë shkakton krijimin e ndjenjës për kohën e kaluar, përkatësisht për historinë.

Njohjen e historisë, qoftë familjare, apo më gjerë, njeriu e vë si bazë të koncipimit të identitetit të tij. Kështu, interesi i njeriut për historinë e vet dhe për historinë e bashkësisë më të gjerë, bëhet një ndër themelet në bazë të të cilit e krijon dhe formulon identitetin e vet, e sqaron dhe interpreton të tanishmen, e parashihet dhe koncipon të ardhmen.

2.1. Koha ciklike (qarkore) dhe lineare (historike) në këngët popullore rituale

Në kulturat arkaike, por edhe sot, koha nuk ka koncept homogjen dhe asnjans, së paku në planin aksiologjik, por segmente të saja, çdoherë janë të ngarkuara me ndonjë element të shenjtë. Elementi kryesor që bën një kohë e caktuar të perceptohet si e shenjtë, është padyshim riti, pasi nëpërmjet ekzekutimit të tij, një bashkësi e caktuar njerëzore, vë lidhje me qeniet mbinatyrore duke pandehur se në këtë mënyrë do të mund të përfitojë hirin dhe bekimin e tyre. Në shoqëritë arkaike, konsideron studiuesi Mirça Elia, njerëzit poqese e injorojnë kohën, atëherë fuqia e tyre zhduket, apo zbehet dhe ata do të mund të jetonin në një kohë të tanishme e cila nuk do të kishte segmente ku do të manifestoheshin e shenjtja, por do të ishte kryesisht e njëtrajtshme, përkatësisht e amshueshme (1992: 51-65). Kjo do të krijonte një zbrazëti në strukturën e tyre shpirtërore, pasi do të mungonte identifikimi dhe komunikimi i tërthortë me qeniet hyjnore dhe si rrjedhojë edhe “mungesa” e produkteve të nevojshme jetësore që me sakrificat të mëdha janë siguruar në kohërat e lashta.

Botëkuptimi i njeriut arkaik ndaj kategorisë së kohës, më së miri mund të venerohet nëpërmjet riteve dhe praktikave magjike të natyrës kalendrike apo antropologjike që ndonjëherë kanë depërtuar edhe në përmbajtjen e këngëve popullore. Në këtë drejtim, një karakteristikë e kohës së shenjtë është dukuria e tabuizimit, si një ndër trajtat elementare të religjionit pagan. Tabuizimi si trajtë e lashtë religjioze që është i pranishëm në kohën e shenjtë, e mishëruar nëpërmjet festave kalendrike, por edhe antropologjike, manifestohet në forma të ndryshme. Një formë e manifestimit të tij në kuadër të kohës së shenjtë, është mungesa e aktiviteteve të punës nga bota njerëzore. Kjo buron nga fakti se koha e shenjtë përjashton kohën profane duke krijuar kundërvënje të llojit të vet. Koha e mbarsur me të shenjtën nënkupton edhe sjellje specifike të bashkësisë, pasi krijohet urë komunikimi me qeniet mbinatyrore, andaj çdo mosrespektim i saj nënkupton edhe ndëshkime eventuale. Kjo është kohë e prehjes dhe respektimit të forcave hyjnore. Këtë besëtytni popullore e ka pasqyruar edhe kënga në vazhdim: *Sot o ditë shinxherxhi nuk puonohet, / Aj lule tentene nuk mbarohet, / S'mbarohet tentene se grashajtet, / Sot o ditë motmoti sall shatajtet* (KPLD, 1984: 15). Përndryshe, besimet popullore njohin shumë raste të sanksionimit të atyre të cilët kanë ndërmarr ndonjë aktivitet punues gjatë kohës të zgjatjes së këtyre festave popullore pagane.

Një tjetër karakteristikë që e ka veçuar kohën e shenjtë nga ajo e përditshmërisë është edhe veshmbathja, paksa më e veçantë, apo më mirë thënë,

solemne e subjekteve të ritualizuara. Ata, në ditën e së kremtes, qoftë ajo e karakterit kalendarik, apo atij antropologjik, veshin rrobat më të reja me qëllim që edhe në aspektin formal të shënojnë diskontinuitet prej kohës profane, apo përditshmërisë. Veshja e rrobave më të mira ka për qëllim që “komunikimi” midis qenieve të dy botëve, të jetë sa më i përshtatshëm dhe në funksion, sidomos të respektimit të qenieve të botës hyjnore, të cilat, sipas logjikës së njeriut të lashtë, kërkojnë shenja nënshtrimi dhe adhurimi nga bota njerëzore. Ky “ndërkomunikim” bëhet vetëm me veshmbathje të re dhe të pastër, pasi vetëm në këtë mënyrë mund më lehtë të kihet qasje në botën e qenieve hyjnore. Në kulturat arkaike, ekziston një numër i madh i veprimtarisë ritualeske, praktikave magjike dhe besimeve popullore që bazohen në kundërvënien dyshe, si: *i pastër: i papastër* (më gjerësisht Daglas, 1993). Në këtë kontekst, komunikimi më i suksesshëm mes dy botëve është bërë vetëm në saj të pastërtisë fizike (veshmbathjes së re) dhe dëlirësisë shpirtërore të njeriut në raport me hyjnitë, të cilat, sipas besimit popullor, e kanë në duar fatin e tij.

Në kuadër të këngëve popullore që kanë të bëjnë me ciklin kalendarik, koha e shenjtë (sakrale) e karakterit kozmogonik zë një vend të rëndësishëm. Koha e shenjtë, apo më mirë thënë, koha mitike ka të bëjë me kohën e fillësës, “koha e parë”, ose “parakoha”, që i paraprin kohës profane empirike. Emanacioni i saj, arrin te bartësit e gjallë të mitit, theksojnë njohës të mirë të kësaj lëmie, nëpërmjet ritualeve dhe ëndrrave. Në këtë kontekst, pra ekziston bindja e njeriut arkaik se formimi i kësaj bote është rrjedhojë e ndonjë ngjarjeje të shenjtë që ka ndodhur në ndonjë fillim, (ab origine), po ashtu të shenjtë. Ajo që është interesante në kuadër të temës sonë, është fakti se edhe përkundër ndauarshmërisë së strukturave shoqërore-ekonomike dhe konteksteve të ndryshme kulturore, popujt arkaikë mendojnë se bota patjetër të mëkëmbet për çdo vit dhe se kjo mëkëmbje zhvillohet sipas një modeli: kjo është kozmogonia ose miti për krijimin që ka rol të mitit kozmogonik (Elijade, 1992: 54). Pra, në kuadër të festave popullore kalendarike me rëndësi është konceptimi ciklik i kohës me ç’rast bëhet riaktualizimi i ndonjë ngjarjeje që ka ndodhur në fillim. Ky është, para së gjithash, cikli jetësor (reproduktimi biologjik i njeriut), por këtu janë edhe ritualet, ceremonitë, por para së gjithash, festat kalendarike në të cilat e kaluara replikohet *in ille tempore*. Mirça Elijade ndoshta ka të drejtë kur thotë se festat periodike i kthejnë pjesëmarrësit në kohën primordiale e cila çdoherë është e njëjtë dhe ka të bëjë me amshimin. Në këtë drejtim, ndoshta më indikative janë përmbajtjet e miteve kalendarike të popujve të lashtë ku flitet për asgjësimin dhe ringjalljen e hyjnive të ndryshme. Kjo vdekje dhe ringjallje e tyre, përkon me ndryshimet kalendarike që ndodhin në natyrë. Vdekja përkon me kushtet e liga klimatike, kurse ringjallja me ato të volitshme. Hyjni të kësaj natyre janë Demetra e Persefona, Dionisi, Ozirisi, etj.

Në kontekst të kohës së shenjtë në kuadër të festave tona kalendarike, një e kremte popullore e kësaj natyre ku mund të vërehen elemente të kozmogonisë mitike, është dita e Shëngjergjit ku në mënyrë të qartë vërehet lufta që zhvillohet mes kaosit dhe kozmosit, nënkuptohet nëpërmjet simboleve që i personifikojnë këto dukuri të kundërta mitike. Se Shëngjergji paraqet vijën ndarëse të kohës mitike mes kaosit dhe kozmosit, flet edhe teksa i këngës kalendarike në vazhdim. P. sh. *Të*

falemi, i shën Gjergj, / o nder i math i jetës, / dëshmor i të vërtetës, / i gjarpërit armik. / Të falemi e përdita, / të lutemi tue thënë: “O ndihm’ e horës tënë, / mos lerna në rrezik!” / Klyshedhra aq’ e tmeruarë, / çë ti lavose e preve, la farën, ç’edhe neve, / të zërë po kërkon... / O shëjti thavmasor, / ti ndihma të guxojmë / e vendin të shpëtojmë / nga ajo klëshedhr’ e shkretë. / Të jet’ nga gjindja e lirë, / i falur me haidhi, / i larti perëndi, / nani e për mot’ e jetë! (LP, 1988: 157). Kjo këngë rituale e regjistruar te arbëreshët e Italisë, më konkretisht në Sqeli në vitin 1923, edhe më mirë na jep një pasqyrë mitike të luftës mes kaosit, i mishëruar me figurën e kuçedrës dhe dragoit, përkatësisht Shën Gjergjit, si figurë e mëvonshme e fesë krishtere që personifikon kozmosin. Në këtë drejtim, studiuesi i njohur i folklorit tonë Qemal Haxhihasani duke bërë fjalë për figurën letrare të Gjergj Elez Alisë me të drejtë thekson: “Vënia (në vend të emrit të përgjithshëm mitologjik *dragua*, e një emri njerëzor – *Gjergj Elez Alia* simbolizon kalimin e një koncepti epik nga bota mitologjike në atë të kulturës njerëzore, duke shënuar një pikë nevralgjike, një fazë të parë të kalimit nga bota e përgjithshme e mitologjisë në atë të njerëzve të shoqëruar e të personalizuar. Kemi këtu momentin e parë të lidhjeve të individit si person me bashkësinë e tij epike, por edhe me universin e tij shoqëror e kozmogonik. Nëpërmjet këtij procesi janë përcjellë mendësi tradicionale, konceptimet e hershme mitike të një përfytyrimi mitologjik te një hero personal. Në këtë mënyrë janë shprehur raportet e njeriut me botën që e rrethonte, ndërsa koncepti tradicional i personalizimit është lidhur me përfytyrime të tjera tradicionale epike” (Haxhihasani, 1997: 10). Pra, edhe emri i shenjtorit Shën Gjergji, në kuadër të këngës së lartëpërmendur, është emër që zëvendëson më vonë arketipin e tij parak-figurën e dragoit. Pra, në rastin tonë konkret, dragoi (Shën Gjergji) paraqet personifikim mitik të krijimit të botës, pasi një gjë e tillë ndodh në kohën-kufi, pra në festën e Shëngjergjit kur sipas besimit popullor, bëhet kalimi nga periudha e dimrit në atë të verës. Ndërkaq, kuçedra paraqet personifikim të kaosit (dimrit). Pra, kalimi prej errësirës kah drita ndonjëherë pasqyrohet si rrjedhojë e disfatës së përbindëshit kozmik të cilin e gëlltit dielli, ose me një fjalë - fitores që shënojnë ndriçuesit qiellorë. Ndërkaq, shumë e popullarizuar është lufta kozmogonike me kuçedrën për shkak të mposhtjes së kaosit ujqor. Kuçedra në shumë mitologji është e ndërlidhur me ujin, shumë herë paraqitet si rrëmbyes i tij, ashtu që pastaj kanoset ose me vërshim, ose me thatësi, përkatësisht me cenimin e masës, të “baraspeshës” ujqore. Pasi kozmosi njëjtësohet me rendin dhe me masën, kaosi natyrisht se asocion në cenimin e kësaj mase, përkatësisht rendit dhe harmonisë së krijuar. Pra, kënga e sipërpërmendur, ka regjistruar shumë mirë këtë artefakt kulturor të kohës pagane kur është menduar se çdo ndryshim i kushteve klimatike (kalendarike) i ngjan kozmogonisë, përkatësisht duelit që zhvillohet mes qenieve hyjnore që janë mishërim i dy tendencave të kundërta, përkatësisht rrënimit dhe krijimit. Kjo nuk do të thotë se elemente të një rezonimi të tillë nuk ka edhe në festat tjera kalendarike, pasi edhe gjatë festës popullore të Ditës së Verës, Buzmit apo Krishtlindjeve, ndeshim simbole të kalimit mitik në një periudhë tjetër kohore.

Një element i veçantë që i atribuohet kohës së shenjtë gjatë festave popullore pagane është kundërvënia dyshe në raportin: *heshtje-zhurmë*. Pothuajse në të gjitha ritet me natyrë kozmogonike që shënojnë kthesë në aspektin kohor, në

rastin konkret, ato të ciklit kalendarik, por edhe antropologjik, kemi zhurmën si një element të veçantë sinjifikativ që qëndron në pozicion të kundërt me antipodin e saj-heshtjen. Heshtja është atribut i botës tjetër, përkatësisht kaosit, kurse krijimi i botës, sipas mitologjive kozmogonike, është i ndërlidhur me zhurmën. Këtë dukuri e ka regjistruar edhe kënga, edhe atë në shumicën e rasteve. P. sh. *Bie lodra dum, dum, dum, / u lshofsha gjumt or katun; / bie curla ti, ti, ti, / u lshofsha gjumt shpi për shpi!* (LP, 1988: 92). Zhurma është karakteristike edhe për rite të ciklit jetësor, sidomos me rastin e lindjes dhe dasmës. P. sh. *Krisi pushka, leu djalë, / Mugulloi dushk e barë / Edhe zogu knon në malë* (ALPSH, 2004: 230). Kur jemi këtu duhet theksuar se antropologu i njohur Edmund Liç konsideron se kultura çdoherë e shfrytëzon zhurmën artificiale edhe për shënimin e kufijve, përkatësisht kalimin nga një periudhë kohore në një periudhë tjetër kohore. Zhurma e tupanit dhe e instrumenteve tjera frymore, pastaj armës etj., çdoherë shfrytëzohen si shenja të kufijve kohorë dhe hapësinorë, por kufijtë nuk janë vetëm fizikë, por edhe metaforikë. Së këndejmi, studiuesi Edmund Liç, e parashtrohet kundërvënien e tillë: zhurmë – heshtje = sakrale – profane; edhe pse thekson se kjo kundërvënie mund të jetë edhe e anasjelltë, përkatësisht: heshtje – zhurmë = profane – sakrale (1983: 94-95). Pra, duhet theksuar se zhurma në kontekst të kohës së shenjtë në festat kalendarike, shënon lindjen e re, përkatësisht kohën që po vjen e që është e volitshme për botëkuptimin e njeriut pagan. Në shumë mite të popujve të lashtë, zhurma është shenjë e krijimit të botës, ashtu siç është edhe në ritet e lindjes, përkatësisht qarja e parë e foshnjës, në të vërtetë zhurma që manifestohet nëpërmjet këtij akti është shenja e parë e lindjes së një jete të re. Pra, kemi një përkim mes krijimit në planin makrokozmiq (botës) dhe atij mikrokozmiq (njeriut).

Përkimet e tilla janë të shumta, madje një karakteristikë thelbësore e botëkuptimit arkaik, ka qenë njëjtësimi midis natyrës dhe njeriut. Edhe në këngët rituale të kësaj natyre mund të venerohet një botëkuptim i tillë. P. sh. *Mir' se na gjet / Vera sivjet! / Për shumë vjet! / O ti moj Verë, / o ho ho ho, / del të të sho, / sa e mira je, si nuse e re!* (LP, 1988: 84). Nga kjo rezulton se Dita e Verës si periudhë kur bulëzon toka, krahasohet me nusen e re e cila po ashtu është simbol i pjellorisë. Pra, nëse vera sjell pjellorinë në formë të bulëzimit të vegjetacionit, edhe nusja e re, është me trajtë potenciale të lindjes së fëmijëve. Një specifikë e botëkuptimit mitik ka qenë edhe njëjtësimi midis tokës dhe gruas, përkatësisht nuses së re. Kështu në të kaluarën, dasmat janë preferuar të bëhen në kohën kur natyra është pasive, përkatësisht kur toka pushon apo prehet pas “lindjes” aktive të produkteve të saja bujqësore. Kjo ka ndodhur pas përfundimit të aktivitetëve të korrje-shirjeve kur krijohen kushte të volitshme, përkatësisht kohë e lirë për këtë lloj të aktivitetëve familjare, sidomos gjatë vjeshtës. Ky njëjtësim i ciklit agrar i shprehur përmes kulturave të drithit dhe ciklit antropologjik, i personifikuar me dasmën, ndoshta ka të bëjë me konceptin arkaik sipas të cilit fryti i tokës-kulturat e drithit dhe fryti i martesës-fëmija, kalojnë nëntë muaj në barkun e tyre që pastaj të dalin jashtë dhe të marrin trajtën e caktuar fizike. Ky përkim i kohës, është produkt i rezonimit logjik arkaik që bazohet në unitetin e dukurive të ciklit kalendarik dhe antropologjik. Jo rastësisht edhe Shelingu e konstaton një gjë të tillë duke theksuar: “Universi, si dhe njeriu paraqesin përzjerje të së pavdekshmes me të vdekshmen, përkatësisht jetës

dhe vdekjes (Sheling, 1989: 281). Nga kjo buron se dy parimet kryesore, siç janë jeta dhe vdekja, ndjekin në mënyrë të vazhdueshme definimin e kohës, sidomos të asaj që shënon kthesë, qoftë në natyrë, qoftë në jetën e individit. Në këtë kontekst në vendin e simboleve dhe faraonëve, në Egjiptin e lashtë, nëpërmjet mitit për çiftin hyjnor Oziris dhe Izida, janë përfaqësuar më së miri ndryshimet që kanë përfshirë jetën e natyrës dhe ritmet e kozmosit. Nga kjo rezulton se njeriu arkaik në të kaluarën duke gjykuar përmes kundërvënies themelore mitike, si jetë dhe vdekje, ka dalluar vetëm dy periudha kalendarike, atë të dimrit (vdekje) dhe të verës (jetë). Këtë gjykim të tij e ka regjistruar edhe kënga rituale, si: *Iku dimri erdhi vera*, / *Erdh behari, çeli ferra*, / *Borziloku e trëndafili*. / *Mbani vesh ç'thotë birbili*: (ALPSH, 2004: 55). Ose: *U shkoq njeglla Drinit, shkuen mujt e dimnit*; / *hipi njeglla ferrës, erdhën mujt e verës* (LP, 1988: 77).

Ndërkaq, çështja e kohës ciklike mbetet e hapur kur vihet në përjasje me ritet e ciklit antropologjik, siç janë lindja, martesja dhe vdekja. Një numër i madh i studiuesve e gjejnë kohën ciklike edhe në kuadër të riteve të tilla. Te martesja dikush e vëren kohën ciklike në lëniën e pasardhësve. Ndërkaq, përsëritja e kohës ciklike mbetet çështje e hapur kur ajo vjen në kontakt me konceptin e vdekjes. Kur dikush vdes, fundi i jetës njerëzore individuale dhe relacioni i bashkësisë me të vdekurin, manifestohet nëpërmjet ritualeve, simboleve sociale etj. – sipas një koncepti të tillë, fundi i jetës nuk është absolut (Greenhouse, 1996: 35). Se vdekja nuk është fund, por vetëm një fillim i ri, madje edhe në këtë botë përdëfton praktika zakonore që të porsalindurve t'u jepet ndonjë emër i gjyshit apo stërgjyshit të vdekur. Kjo lë të nënkuptosh se njeriu ka tentuar ta ripërtrijë kohën në trajtë ciklike dhe të mos e pranojë karakterin e saj historik (linear), por ta ripërtrijë atë vazhdimisht. Në të vërtetë, edhe lindja, edhe martesja, por edhe vdekja shënojnë momente ireverzibile dhe kjo i përgjigjet kohës historike apo lineare, pasi individit nuk mund të kthehet prapa në kohë. Këtë situatë e ka regjistruar edhe kënga. P. sh. *Ç'ke djalë që po mejtone*, / *Fytyrën që ma ndryshove?* / *Mos mejto të djalërisë*, / *Se u bëre burr' i shtëpisë*. / *Të kesh mall të flesh me gunë*, / *Djalë më nuk bëresh kurrë*; *Po mejto të plegërisë*, / *Se u bëre burr' i shtëpisë* (MHFSH, 1962: 130). Duhet theksuar se edhe kjo kohë është e mbarsur me elemente të kozmogonisë, pasi edhe këtu shënohet kalim nga një status social inferior-atë të djalërisë në një status tjetër social-atë të burrërisë. Antropologu i njohur Edmund Liç duke u ndalur rreth kësaj çështjeje thekson se çdo diskontinuitet në kohën shoqërore paraqet mbarim të një periudhe kohore dhe fillim të një tjetre dhe kundërvënia lindje-vdekje, përkatësisht kaos-kozmos, i përgjigjet fillimit dhe përfundimit të kohës natyrore (1983: 120). Simbolet që i paraqesin këto parime të kundërta *jetë:vdekje* janë të njëjta edhe në kuadër të riteve dhe praktikave të ciklit jetësor (antropologjik). Edhe këtu, qoftë në lindje, martesë ose vdekje, shënohet kalim në një periudhë të re kohore, andaj është e domosdoshme që e kaluara të jepet me simbole që shënojnë kaosin (vdekjen), kurse e ardhmja me simbole që shënojnë kozmosin, përkatësisht lindjen, apo krijimin.

2.2. Kundërvënia binare *ditë/natë* në poezinë popullore rituale

Kundërvënia binare *ditë/natë* zë një vend të rëndësishëm në kuadër të besimeve popullore e që është reflektuar edhe në poezinë popullore rituale. Koha në trajtën e ditës dhe natës paraqet një segment të rëndësishëm të mitologjisë sonë popullore. Dita me veçoritë e saja të vërteta që i ngërthen në vete, në perceptimin mitik, çdoherë është vlerësuar me attribute pozitive. Ajo është konsideruar si kohë e përshtatshme për të gjitha aktivitetet e njeriut. Dita ka pasur segmente të saja kohore. Përcaktimi i periudhave më të rëndësishme të ditës, në shumicën e rasteve, është bërë në bazë të karakteristikave të dritës, përkatësisht “lëvizjes” së diellit. Dielli është parametri më i rëndësishëm për perceptimin kohor të ditës. Në mitologjinë greke, dielli kishte attribute të shenjta. Kështu, “Apoloni i mbiquajtur Foebus, d.m.th. i shkëlqyeshëm, ishte perëndia e dritës, shpërndante errësirën e natës, vriste përbindëshat të cilët në errësirë përgatisnin fatkeqësinë dhe kurrthet për njerëzit. Kjo lidhet me vrasjen nga Apoloni të përbindëshit të errësirës Piton. Apoloni përfaqësonte vetë diellin. Sapo zbardh agimi, papritur shfaqet Apoloni, hipur mbi një karro të tërhequr nga kuaj të bardhë me fletë. Drita që lëshon ai, sa vjen e bëhet më e fortë dhe flakët e ndritura mbulojnë hapësirën” (Shkurti, 2003: 45). Edhe krijimtaria jonë popullore është e pasur me sekuenca artistike, përkatësisht formula verbale magjike nëpërmjet të cilave kërkohet ndihmë nga dielli. P. sh. *Diell-o, diell-o, / hidhna një thes miell-o* (LP, 1988: 245), ose *Diell-o, diell-o, / ama buk’ e miell-o*, (LP, 1988: 248). Pra, dielli si personifikim i ditës, ka zënë një vend të rëndësishëm në kuadër të mitologjisë sonë popullore. Dita është e ndërlidhur me aspektin mashkullor, apo aktiv, me atë që është e karakterit të hapur dhe të dukshëm. Ajo është e ndriqueshme, është në sipërfaqe, si dhe është e ndërlidhur me vetëdijen. Dita do të thotë aktivitet, punë, organizim, zgjim dhe jetë, kurse nata ndërlidhet me aspektin femëror, apo pasiv dhe nënvetëdijen. Dita çdoherë ka qenë e rezervuar për aktivitete të botës njerëzore. Studiuesi i njohur i mitit, Meletinski thotë se “shndërrimi i kaosit në kozmos manifestohet si kalim prej errësirës kah drita, prej ujit kah sipërfaqja e tokës, prej zbrazëtirës kah materia, prej patrajtësisë kah trajta, prej rrënimit kah krijimi” (2002: 250). Ndërkaq, sipas mitologjisë greke çdo gjë ka lindur nga kaosi i përvetshëm, i pakufishëm dhe i errët. Nga masa e tij e pështjelluar ka dalë edhe Dita, por edhe Gjea (Toka) dhe Erosi që ka gjallëruar çdo gjë (FM, 1988: 130). Pra, nga kjo rrjedh se sipas botëkuptimit mitologjik, parimi i jetës (krijimit) çdoherë e ka burimin në parimin e vdekjes (rrënimit).

Nga shembujt e mësipërm, del në sipërfaqe e dhëna se nata, sipas botëperceptimit mitik, është vlerësuar me attribute të kaosit. Kjo periudhë kohore në mitologjinë greke ishte e mishëruar me hyjneshën Nikte e cila “kalon ngadalë nëpër qiell mbi qerren e saj që e heqin kuaj të zinj. Mbulon tokën me savanin e saj të zi dhe gjithçka vishet në errësirë” (Kun, 2000: 107). Nata e errët në religjionin më të lashtë indoevropian të Vedave është personifikuar si hyjneshë me ngjyrë të zezë me emrin Ratri. Ajo është paramenduar me fustan të zi të cilin nga ajo e zhvesh hyjnesha e agimit Ushas. Nata me atributet e saja që i posedon në vete, çdoherë ka qenë interval kohor që ka qenë e përshtatshme për forcat demoniake të cilat e kanë

shtrirë aktivitetin e tyre kur bota njerëzore ka pushuar. Këtë e ilustron edhe kënga rituale në të cilën nata mishërohet me hënën, kurse bota njerëzore me vashën e re. P. sh. *Hën' e re, vash' e re, / ti në gjum e un' në punë, / ti gërshet e un' shëndet* (LP, 1988: 252). Nata si interval kohor në të cilin shtrihet aktiviteti i forcave ktonike del në shesh edhe në një këngë të ciklit të kreshnikëve në të cilën bëhet fjalë për aktivitetin e qenieve mitike, siç janë, zanat. Në këngën në fjalë, zanat paraqiten si qenie të cilat manifestojnë disponimin e tyre shpirtëror në kronotopin e tyre. P. sh. *mos u ngut, ti mori hanë! / Ujt e fresët tek ka qillue, / si mos kurr flladi po fry', / lshona dritën npr ato biga*, (FSHEL, 1966: 94). Në një kronotop të tillë, ato e lutin diellin që të mos dalë, kurse hëna ta vazhdojë ndriçimin e saj. Pra, nga kjo rezulton se sipas besimit tradicional, nata për shkak të ndërprerjes së aktiviteteve njerëzore, karakterizohet gjithashtu si kohë e *huaj*, interval që u takon qenieve të botës tjetër, përkatësisht botës jonjerëzore. Pra, kundërvënja *ditë:natë* është një veçori e rëndësishme që dallon këtë botë nga ajo botë. Nga faktet në fjalë del se zanat edhe me këto veçori, paraqiten si qenie të sferës lunare. Hëna si atribut i zanave karakterizohet me errësirën e saj dhe qëndron në kundërvënie me diellin, përkatësisht parimin solar. Domethënë, hëna “paraqet anën e errët të natyrës, trajtën e padukshme; llojin shpirtëror të dritës në errësirë; kuptimin e brendshëm; irracionalen, intuitën dhe subjektiven (Kuper, 1978: 104).

Duke u nisur nga kjo, mund të konstatohet se çdo kontakt i botës njerëzore në këtë periudhë kohore me forcat demoniake, sipas besëtytnive popullore, konsiderohet i rrezikshëm, kurse në këtë drejtim është edhe disa herë më i dëmshëm kontakti eventual i personave të ritualizuar, sidomos shtatzënës. Pikërisht për këtë shkak, ajo nuk duhet të dalë jashtë gjatë natës, pasi që mund të rrezikohet jo vetëm ajo, por edhe fryti i saj. Një besim i tillë, është i përhapur, pothuajse në mbarë hapësirën shqiptare, por edhe te popujt tjerë. Ndërkaq, “në Myzeqe, mendohet se natën shtatzënës, mund t’i shfaqet *hija* dhe kështu të dështojë fëmija. Hija mendohej si një figurë fantastike e cila merr formë të ndryshme si të lopës, kaut, njeriut etj. Dhe shfaqej në gjumë duke i shtypur barkun asaj shtatzëne që kishte dalë natën jashtë shtëpisë dhe kishte shkelur hijen, ose kishte djegur hijen, duke derdhë ujë të nxehtë në postrehë të shtëpisë” (Mitrushi, 1972: 110). Nga kjo arrihet në konstatimin se nata është interval kohor në të cilin lëvizin hyjnitë e botës ktonike të cilat, sipas besimit popullor, mund të jenë të disponuara negativisht ndaj botës njerëzore, po qe se ajo cënon kohën dhe hapësirën ku zhvillohet aktiviteti i tyre.

Përndryshe, ditënata ka segmente të saja konkrete dhe të caktuara që dallohen me ngarkesat e tyre magjike, apo mitike. Në këtë kontekst, sidomos të rëndësishme për aktivitete të kësaj natyre janë *muzgu* dhe *agimi*, si dy intervale kohore në të cilët ndodh kalimi nga dita në natë dhe anasjelltas. Sipas logjikës arkaike, pikërisht në këtë kryqëzim të periudhave të kundërta kohore, gjegjësisht kur ndodh kalimi nga një periudhë kohore në një periudhë tjetër kohore, ndodhin aktivitete të caktuara gjatë të cilave kemi një pleksje të qenieve të kësaj dhe asaj bote. Si në perceptimin e hapësirës, po ashtu edhe të kohës, me rëndësi janë kufijtë që shënojnë këto kalime. Kufijtë e tillë, siç cekëm më lartë, janë muzgu, mesnata, agimi, mesdita dhe pikët përgjegjëse të ciklit vjetor dhe lunar që konsiderohen si kohë e rrezikshme, apo kohë e preferueshme.

Muzgu si kohë-kufi që shënon ndarjen mes natës dhe ditës, paraqet një element të rëndësishëm të kohës së ritualizuar, sidomos gjatë festave kalendarike popullore. Një nga praktikat rituale më të njohura në festat tona popullore kalendarike ka qenë ndezja e zjarreve, pikërisht në kohën kur afrohej muzgu. Zjarret bëheshin me dëllinja, kashtë e barëra të thatë dhe ndizeshin në oborre, kopshte, a bregore në mënyrë kolektive, në nivel të lagjes ose fshatit. Ky aktivitet magjik ka ndodhur, sidomos gjatë shënimit të festave pagane të Ditës së Verës, Shëngjergjit, Buzmit, etj. Me këtë rast, pranë zjarrit, subjektet e ritualizuara, brohoritnin edhe këngë që më tepër u ngjanin formulave verbale magjike. P.sh. *Dajlinat e pranverës / marrshi ethet e verës!* (LP,1, 1988: 88). Prania e zjarrit në këto manifestime popullore ka të bëjë me rolin profilaktik apo purifikues të tij. Kërcimi i pjesëmarrësve mbi zjarr mund të interpretohet si akt ngadhënjimtar me të cilin është "kërcyer", është djegur e liga dhe me këtë janë spastruar nga kjo edhe manifestuesit. Loja rreth zjarrit paraqet "qarkullim magjik", qëllimi i të cilit është vendosja e lidhjes magjike me objektin rreth të cilit luhet dhe bartja e fuqisë së zjarrit te manifestuesit. Ndezja e zjarrit në kohën kur bashkohen dita me natën ngërthen në vetvete elementin e dëbimit të forcave të liga, pikërisht në këtë çast kur ato e shtrijnë aktivitetin e tyre të natës. Vetitë e zjarrit për të djegur gjërat e vërtetë, janë bartur, sipas analogjisë, edhe në këtë rit, sipas të cilit bëhet djegia e forcave të liga që pengojnë mbarëvatjen e punëve, si dhe mbrothësinë, në përgjithësi gjatë vitit në vijim. Përmes zjareve të ndezura bëhet edhe spastrimi kolektiv i mbarë fshatit nga shpirtrat e ligë pasi në çdo oborr të çdo shtëpie bëhet ndezja e zjarreve të këtilla rituale. Zjarri, jo vetëm në mitologjinë tonë, por edhe në mitologjinë e popujve të tjerë, paraqet mjet të fuqishëm apotropëik që i mban në distancë demonët dhe e mbron njeriun nga ndikimet e tyre kobzeza. Ithtarët e parë të cilët pranisë së zjarrit ia atribuojnë vetitë e sipërpërmendura apo që ndërtojnë teorinë e ashtuquajtur "spastruese" janë Eduard Uestermaku dhe Eugen Mogu (sipas Frejzerit, 2: 356). Dukuria e etheve që përmenden në vargjet e mësipërme të këngës, me siguri se në të kaluarën është menduar se shkaktohet si rrjedhojë e forcave të liga që depërtojnë në trupin e të sëmurit. Sipas një logjike të tillë, edhe magjistari çdoherë kur shëron ndonjë sëmundje përfytyron se shpirti i tij kalon në botën tjetër dhe atje kupton për aktivitetin e shpirtit të lig që kinse është infiltruar në trupin e individit të sëmurë. Zjarri, në kontekst të festave kalendarike popullore, është edhe atribut i vazhdimësisë së jetës. P. sh. *Or NN i marru, / zjarri juj qenka shu, / qenka shu m'at dinja, / humshi e mo dalshi ma*, (LP, 1, 1988: 89). Në të kaluarën e largët është besuar se zjarri, sidomos i vatrës, nuk është mirë të shuhet për shkak se kjo mund të reflektohet edhe në shuarjen e jetës së anëtarëve të familjes.

Mesnata, sipas besëtytnive popullore, konsiderohet si kohë më e rrezikshme e natës, pasi mendohet se në këtë segment kohor, është më i intensifikuar aktiviteti i forcave demoniake të cilat mund të paraqiten edhe me trajtë të njeriut, kafshëve dhe shpezëve të ndryshme. Karakteristikë themelore e kësaj kohe është fakti se në këtë interval kohor mbretërojnë heshtja dhe qetësia, si kode themelore të parakohës mitike, përkatësisht të mjedisit jashtëkohor dhe jashtëjetësor. Atje ku nuk ka zhurmë, apo më mirë thënë, ku nuk dëgjohet zëri i njeriut, apo zëri i kafshëve dhe shtazëve, veçmas të atyre që konsiderohen si mbrojtës të jetës (gjeli dhe qeni),

mund të konkludohet se edhe nuk ka ekzistencë. Mesnata, duke u karakterizuar me këto veçori, sipas besimit popullor, është kohë e përshtatshme për ushtrimin e riteve magjike, kryesisht të karakterit negativ. Bartëse të aktiviteteve të tilla janë subjekte, paksa më të moshuara, sidomos plakët të cilat në mesnatë, në ndonjë udhëkryq të caktuar, zhvishen lakuriq dhe në funksion të magjisë, detyrohen të hanë edhe jashtëqitjen e tyre. Këto aktivitete magjike nxisin neveritje të forcat demoniake të cilat detyrohen t'i braktisin këto vende dhe t'i lënë të lira magjistaret në ekzekutimin e akteve të tyre magjike. Sipas besimit popullor, konsiderohet se mesnata e Shëngjergjit, është koha më e përshtatshme për ushtrimin e magjive të tilla, pasi kjo natë shënon kalimin nga periudha e dimrit në atë të verës. Në këto kalime, ndodh edhe kozmogonia (rikrijimi i botës), andaj edhe magjistarja duke u nisur nga një logjikë e tillë, ka menduar në të kaluarën se pikërisht kjo kohë është e përshtatshme edhe për “zënien” e magjisë së saj. Nëpërmjet magjive të tilla të zeza, ndillet joproduktiviteti i bagëtisë, por edhe i kulturave bujqësore me qëllim që të dëmtohen ekonomikisht pronarët e tyre. Këto magji, kryesisht janë të orientuara kah ndjellja e shterjes së qumështit të bagëtive që i përkasin ndonjë pronari që urrehet nga magjistarja. Përndryshe, duhet theksuar se mjelja e bagëtisë, sidomos e kopesë së dhenve, fillon nga dita e Shëngjergjit, aktivitet të cilin tenton ta pengojë magjistarja. Besohet se magjistaret e tilla, në funksion të veprimit të tyre magjik, mund ta rrëzojnë edhe hënën në tokë. Ndërkaq, rrëzimi i hënës gjatë këtij operacioni ritual ka të bëjë me atë se hëna me dritën e vet të zbehtë, lindjen e saj pas perëndimit të diellit, lëvizjen e saj nëpër qiell në kohën e heshtjes kur nëpër tokë lëvizin shpirtrat e të vdekurve, kur paraqiten qenie të ndryshme demoniake dhe qenie të tjera mbinatyrore, konsiderohet si hyjni e natës dhe me këto attribute, ajo bart edhe tipare të hyjnisë së vdekjes. Kjo magji tenton që hëna, si simbol i joproduktivitetit, vazhdimisht ta përcjell familjen që i destinohet me qëllim që ajo të varfërohet skajshmërisht, pasi që atribut i kundërt i hënës është dielli për të cilin është i ndërlidhur begatia. Pra, magjitë e këtilla ndjellin joproduktivitet, sipas parimit: e ngjashmja prodhon të ngjashmen. Edhe plakat-magjistare, por edhe hëna janë attribute të shterpësisë, andaj edhe epilogu i veprimit të tillë magjik është në dëm të atij, kundër të cilit është orientuar kjo mënyrë e komunikimit. Magjistaret gjatë akteve të tilla magjike, në raste të caktuara, kanë bartur me vete edhe drugëz, përkatësisht kanë kalëruar mbi të duke pandehur se ashtu siç mbledh fijet e penjve ky mjet, ashtu do të mbledhë edhe bereqeti i arave fqinje i cili tani e tutje do të bartet te ara, pronare e së cilës ka qenë magjistarja. Përndryshe duhet theksuar se udhëkryqet si vende të volitshme për ushtrimin e aktiviteteve magjike, të shumë popuj, konsiderohen si areale të rrezikshme dhe të papastra. Nëpër këto vende tubohen forcat demoniake dhe luajnë nën rrezet e hënës. Të gjitha këto aktivitete zhvillohen gjatë natës e më intensivisht në mesnatë. Nga kjo rrjedh se këto vende kanë kryesisht karakter ktonik. Në mitologji, udhëkryqet konsiderohen si tope të kalimit nga një botë në botën tjetër. Në mitologjinë greke, hyjni e udhëkryqeve ishte Hekata e cila posedonte tri koka dhe tri trupa. Si hyjni e natës, e botës nëntokësore dhe magjisë, Hekata kishte karakter ktonik (FM, 1988: 105). Edhe magjistaret që ushtrojnë aktivitete magjike në mesnatë të Shëngjergjit paraqesin substitute të hyjnisë greke të cilat me faktin se i pushtojnë këto vende, marrin fatin e pjellorisë

dhe shëndetit në duar të tyre duke u shkaktuar dëm atyre kundër të cilëve është orientuar akti magjik.

Agimi si kohë-kufi që shënon fillimin e ditës, po ashtu është një segment i rëndësishëm që është i mbarsur me të shenjtën. Kjo periudhë kohore në të kaluarën e lashtë ka pasur attribute hyjnore. Këtë më së miri e përshkruan në mënyrë poetike autori Albert Kun në librin e tij kushtuar mitologjisë greke duke thënë: “dhe ja hyjnesha e Agimit – gishttrëndafilja Eos – çel portat nga do të kalojë pa u vonuar hyu i shkëlqyer Helios – Diell. Veshur me rroba të verdha gjithë dritë, hyjnesha e Agimit fillon fluturimin e saj, duke shkuar nga një skaj në skajin tjetër të qiellit, ku shpërndahet ngjyra e kuqërremtë e mëngjesit. Nga një shtambë e artë, hyjnesha derdh përmbi tokë brymën dhe freskon barin e lulet me pikat e vesës të ndritshme si diamante. Tani gjithçka mbi tokë mban erë të këndshme e gjithkund tymojnë beharna. Toka u zgjua nga gjumi dhe ngjatjeton me hare hyun që shfaqet në lindje, Heliosin (Kun, 2000: 108). Pra, edhe kësaj pjese të ditës, fantazia popullore, i ka atribuar elemente antropomorfe. Ndërkaq, edhe kënga popullore rituale nuk ka mbetur pa regjistruar aspekte të ndryshme të saj. P. sh. *Boni pata ga, ga, ga, / grajhi, ori nuse, ma; / boni xheli ki, ki, ki, / grajhi, mushni, uj të ri!* (LP, 1988: 91). Këto vargje të këngës, apo më mirë thënë, kjo formulë verbale magjike thuhej në agimin e Ditës së Verës kur shkohej për t’u mbushur “ujë të ri” a “ujë të pafolë” në krua. Kënga e gjelave në mëngjes paraqet orientimin në kohë. Duhet thënë se fillimit zyrtar të ditës që paralajmërohet nga këndimi i gjelave, i paraprin lindja e diellit, si dukuri me të cilën, sipas besimit popullor, merr fund aktiviteti i qenieve demoniake për të filluar aktiviteti i botës njerëzore. Pra, kënga e parë e gjelave shënon kohën kur njerëzit mund lirisht të lëvizin dhe nëse është e nevojshme menjëherë të nisin me aktivitete të punës; pra, agimi është pjesë e kohës kur sipas rregullit, bëhet zgjimi dhe fillohet me aktivitete të rregullta ditore. Gjeli është simbol solar dhe lunar të cilit i jepet rol i rëndësishëm të shumë popuj të botës. Me këngën e tij, ai e ndan kohën e pastër dhe të papastër të natës dhe dëbon fuqitë e liga. Gjeli është simbol i kësaj bote, andaj në disa ninulla në përmbajtjen e të cilave mungon kënga e tij, hapësira e tillë konsiderohet e shkretë, me një fjalë, pa shenja të jetës dhe normalisht kërkohet që atje të shporren të ligat. *T’shkoqshin t’ligat n’mal të shkretë, / Ku s’knon as pulë, as gjel, / Ku s’kullot as ka, as adh, / Ku nuk bin bar i njomë, / Ku nuk bje drapën me korrë!* (Nin., 1982: 33).

Nga kjo që theksuam deri tani rezulton se kundërvënia themelore binare ditë:natë mund të ndërlidhet me një varg nënkundërvëniesh të tjera duke filluar nga ai astronomiko-biologjik që reflektohet me kundërvëniet, si: diell:hënë, dritë:errësirë, ngrohtë:ftohtë, etj. Ndërkaq, sa i përket kodit ontologjik (qenies), kjo kundërvënie mund të manifestohet, si: kjo botë:bota tjetër, joaktivitet demoniak: aktivitet demoniak etj. Po ashtu duhet theksuar se nëse bëjmë njëjtësimin e elementeve kalendarike me ato antropologjike, atëherë duhet thënë se lindja do të mund të identifikohet me fillimin e ditës, dasma do të njëjtësohet me mesditën, kurse vdekja me perëndimin e diellit, apo mbarimin e ditës.

3. Përfundim

Nga e gjithë kjo që theksuam më lartë rezulton se poezia popullore shqiptare, por edhe e shumë popujve tjerë, sidomos ajo e ciklit kalendarik popullor, por pse jo edhe ajo e ciklit jetësor të individit, me siguri se është e ndërlidhur me mitin e lashtë të vdekjes dhe ringjalljes së sërishme të natyrës, kurse si bazë e këtij gjykimi mund të shërbejnë kultet e lashta dedikuar perëndive, si Ozirisi, Adonisi, Atisi, Dionisi, etj. Këto kulte më vonë do të ndikojnë edhe në fenë krishtere, përkatësisht në lindjen e mitit krishter për gozhdimin dhe ringjalljen e Jezu Krishtit.

Kategoria e kohës në kontekst të poezisë popullore rituale, i ka atributet e pleksjes së varësisë reciproke mes botës njerëzore dhe asaj natyrore. Kështu, cikli jetësor i individit është bërë masë dhe simbol i ciklit natyror (kalendarik). Jeta e njeriut është perceptuar si cikël i ndryshimeve në natyrë, kurse cikli natyror ka marr veçori të procesit jetësor të individit. Gërshetimi i botës njerëzore dhe asaj natyrore, vë në spikamë unitetin e realitetit kulturor të praktikës rituale. Njëjtësimi i ciklit jetësor dhe kalendarik paraqet një realitet psikologjik që është prodhuar nga nevoja e kalimit nga një periudhë në një periudhë tjetër kohore, gjendje ose status. Ky kalim bëhet shumë më i lehtë dhe më domethënës vetëm nëpërmjet zbatimit të ritualit si metaforë e rendit, apo mëkëmbjes së natyrës dhe njeriut. Nëpërmjet ritualit, përkatësisht trajtave të tij simbolike, thotë Girc, “bota ekzistuese dhe ajo e imagjinuar shkrihen njëra me tjetrën dhe krijojnë një botë të veçantë (Geertz, 1966: 28). Përndryshe, në kontekst të temës së trajtuar duhet tërhequr vërejtjen se për rikonstrukcionin e kulturës shpirtërore shqiptare dhe studimin e shumë besimeve, përfytyrimeve dhe veprimeve mitologjike dhe sakrale, folklori, përkatësisht në kuptimin konkret të fjalës - poezia popullore rituale, mund të shërbejë si shkallë dytësore e burimit, kurse burimin e vërtetë dhe parësor e paraqesin vetë besëtytnitë popullore me të cilat edhe jemi shërbyer deri diku me qëllim që konstatimet e dhëna të jenë më të plota dhe në funksion të të arritave shkencore në këtë lëmi.

Në kuadër të kulturës popullore të natyrës rituale mund të shpalosen veçori dhe karakteristika që manifestojnë shijen dhe synimin e bashkësisë njerëzore në drejtim të krijimit të trajtave të veçanta estetike që janë fryt i kohës nëpër të cilën është ecur gjatë periudhave të ndryshme historike. Në brendinë e këtij lloji të artit popullor ka zënë vend edhe nevoja objektive e rregullimit të jetës shoqërore përmes normave dhe ritualeve të pranuara kolektive në të cilat në mënyrë autentike reflektohen elemente të moralit dhe përvojës, të drejtës zakonore, forma të shprehjes së gëzimit dhe hidhërimit kolektiv, etj. Pra, riti, si një trajtë e rëndësishme e organizimit të kohës së njeriut pagan, por në raste të caktuara, edhe të atij të sotëm, paraqet një element thelbësor në kuadër të sistemit të vlerave kulturore tradicionale të një shoqërie të caktuar. Duke folur për ritin, një ndër antropologet më të shquara të bashkëkohësisë, Meri Dagllas (1993: 89) thekson se ka gjëra të cilat pa praninë e tij (ritit) nuk mund t’i shijojmë. Ajo, trajtës së ritit i atribuon status ontologjik, duke shtuar se ai (rituali) nuk është as reflektim dytësor i mitit e as trajtë manifestuese e logosit – dijes, por trajtë autonome e shprehjes së një kuptimesie të shpirtit e cila nuk mund të shprehet në asnjë trajtë tjetër. Ritualit si segment i rëndësishëm i

distinkcionit të kohës, paraqet trajtë autonome dhe në sferën shpirtërore, ka *karakter ontologjik*. Ai, si i tillë, edhe duhet studiuar.

Bibliografia dhe shkurtesat:

- ALPSH (2004): *Antologji e lirikës popullore shqiptare*. Përgatitur nga Nuhi Vinca. "Iris". Strugë.
- Cairns, Grace (1968): *Philosophies of History. Meeting of East and West in Cikle-Pattern Theories of History*. Philosophical Library. New York.
- Daglas, Meri (1993): *Čisto i opasno. Analiza pojmova prljavštine i tabua*. "Plato". Beograd
- Елиаде, Мирча (1986): *Свето и профано*. Књижевна заједница Новог Сада. Нови Сад.
- Елијаде, Мирча (1992): *Аспекти на митот*. "Култура". Скопје.
- Frejzer, Džejms (1977): *Zlatna grana 2*. BIGZ. Beograd.
- Gennep, Van, Arnold (1981): *Les rites de passage*. "Picard". Paris.
- Geertz, C., (1966): Religion as a Cultural System. *Anthropological Approaches to the Study of Religion*. 3. Tavistock Publikations. London.
- Greenhouse, C., (1996): *A moment's Notice. Time Politics across Cultures*. Ithaca&London.
- FM (1988): *Fjalor i mitologjisë*. Hartuar nga doc. Todi Dhama. "Rilindja". Prishtinë.
- FSHEL (1966): Folklor shqiptar II. Epika legjendare (Cikli i kreshnikëve). Përgatitur nga Qemal Haxhihasani dhe Zihni Sako. Instituti i folklorit. Tiranë.
- Haxhihasani, Qemal (1997): Gjergj Elez Alia. *Çështje të folklorit shqiptar*. 5. Akademia e Shkencave e RSH. Instituti i Kulturës Popullore. Tiranë.
- Kasirer, Ernst (1985): *Filozofija simboličkih oblika. Mitsko mišljenje*. Drugi deo. Novi Sad.
- KPLD (1984): *Këngë popullore lirike të Dervenit*. Përgatiti Ibrahim Krosi. "Flaka e vëllazërimit". Shkup.
- Kun, Albert (2000): *Mite dhe legjenda të Greqisë së Lashtë*. "Horizont". Tiranë.
- Kuper, Dž. (1986): *Ilustrovana enciklopedija tradicionalnih simbola*. Prosveta-Nolit. Beograd.
- Lič, Edmund (1983): *Kultura i komunikacija. Logika i povezivanja simbola. Uvod u primenu strukturalističke analize u socijalnoj antropologiji*. "Prosveta". Beograd.
- LP (1988): *Lirika popullore. I*. Përgatitur nga Qemal Haxhihasani dhe Kozma Vasili. Akademia e Shkencave e RPSSH. Instituti i Kulturës Popullore. Tiranë.
- Meletinski, E. M. (2002): *Poetika na mitot*. Tabernakul. Skopje.
- Mitrushi, Llambrini (1972): Zakone mbi lindjen e fëmijës ndër lalët e Myzeqesë. *Etnografia shqiptare. Nr. IV*. Tiranë.
- Niče, Fridrih (1987): *Tako je govorio Zaratustra. Knjiga za svakoga i ni za koga*. Beograd.
- Nin. (1982): *Ninulla*. Përgatitur nga Sadri Fetiu. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë.

Papleka, Ndoc (1999): *Kulte, rite, magji në traditën orale*. Botimet Toena. Tiranë.

Šeling, Fridrih (1989): *Filozofija umetnosti*. Beograd.

Shkurti, Timo (2003): *Mitologjia*. Shtëpia e Librit “Ombra GVG”. Tiranë.

KRISTO FRASHËRI

LUFTA ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE E PARË PAS 70 VJETËSH

Vështrimi i ftohtë që na mundëson distanca kohore. Realiteti i vendit në vitin 1939. Cili ishte qëndrimi i faktorëve dhe aktorëve kryesorë, si evoluuan ngjarjet. Komunistët, Fronti antifashist, nacionalistët, Balli Kombëtar dhe Legaliteti. Një udhëtim nëpër të vërtetat e luftës, dhe disa historianë të sotëm

Sot ne kemi mundësi ta vështrojmë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (shkurtimisht: LANÇ-i) jo si dikur nën presionin e saj, por si ngjarje që tashmë ka hyrë në histori. Kjo për arsye se pas 70 vjetësh, kanë ndryshuar rrënjësisht faktorët historikë që vepronin në kohën e saj. Sot, Shqipëria është një vend i lirë dhe i pavarur, një anëtar me të drejta të barabarta në gjirin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Para shqiptarëve nuk ekziston, si atëherë detyra patriotike për të rrëmbyer armët kundër okupatorit të huaj. Partia Komuniste Shqiptare, e cila e udhëhoqi Luftën Nacionalçlirimtare dhe e shfrytëzoi atë si kapital për të siguruar pushtetin politik, nuk ndikon më në opinionin publik shqiptar. Edhe organizatat e djathta si Balli Kombëtar dhe Lëvizja e Legalitetit, të cilat vepruan si kundërshtare politike të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, sot janë rrudhur në organizata anemike. Në ditët tona, fondi i dokumentacionit historik është disa herë më i pasur se në vitet e luftës. Madje, tani ato vijnë nga institucione arkivore aleate dhe kundërshtare të saj. Nga ana tjetër, forcat njerëzore partizane, mbrojtësit më të flaktë të vlerave të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, janë pakësuar së tepërmi. Pra, ata nuk kanë më peshën që kishin 70 vjet më parë në opinionin publik të vendit. Veç kësaj, shumica dërrmuese e shqiptarëve të ditëve tona, meqenëse nuk e kanë përjetuar, për shkak të moshës, Luftën e Dytë Botërore, janë larg ndikimeve politike të ngjarjeve të saj. Për më tepër, opinionin publik shqiptar i ditëve tona ka gati një çerekshekulli që ndodhet në qerthullin e debateve të hapta ndërmjet rrymave të djathta dhe të majta mbi vlerat e LANÇ-it.

Ndonëse parimisht jemi çliruar nga presioni i përlëshjeve që ndodhën gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ne jemi ende nën trysinë e ngjarjeve me pasoja të dhimbshme që pësuan shqiptarët gjatë regjimit komunist 40-vjeçar. Në presionin e tyre, disa historianë e kundrojnë Luftën Nacionalçlirimtare me nota negative. Edhe ky këndvështrim është pa dyshim i gabuar. Shkenca historiografike kërkon që çdo epokë të vlerësohet në ballafaqim me epokën e mëparshme. Më saktë, ajo kërkon të vlerësohet me rezultatet që një epokë ka arritur me zgjidhjen e problemeve politike,

ekonomike, shoqërore të trashëguara nga periudha e mëparshme. Pra, LANÇ-i duhet të ballafaqohet me kontributin që ajo solli në krahësim me statusin politik të mëparshëm të Shqipërisë dhe jo në ballafaqim me rendin shoqëror që u vendos pas luftës. Për këto arsye, ne duhet të heqim gjithashtu dorë nga tezat me ngjyrimë politike, të cilat lulëzuan në periudhën e Luftës së Ftohtë, tepër entuziaste për një palë apo tepër të ashpra për palën tjetër, të cilat vazhdojnë të qarkullojnë aty këtu në ditët tona.

*

Tani le të hyjmë në temën tonë.

Skema politike e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore pati ngjashmëri me skemën politike që u krijua në arenën ndërkombëtare. Gjatë Luftës së Dytë Botërore bota ishte ndarë në dy rreshtime politike opozitare në shkallë planetare. Nga njëra anë qëndronin anëtarët e bllokut të agresorëve gjermano-italo-japonezë, të cilët aspironin të vendosnin me dhunë diktaturën fashiste në mbarë njerëzimin. Anën tjetër e përfaqësonin anëtarët e kampit antifashist anglo-sovjeto-amerikan, të cilët luftonin për mbijetesën e vendeve të tyre dhe në të njëjtën kohë për lirinë dhe pavarësinë e popujve të robëruar. Në ato vite të përgjakshme, edhe Shqipëria ishte ndarë në dy rreshtime opozitare të ngjashme. Nga njëra anë, qëndronin qeveritarët kolaboracionistë, të cilët hynë në shërbim të agresorëve nazifashistë dhe për pasojë, e përfshinë Shqipërinë formalisht në bllokun e tyre. Nga ana tjetër, u radhitën forcat patriotike shqiptare, të cilave u takonte detyra të luftonin për pavarësinë e vendit.

Në marsin e vitit 1939 Henri Valloni, deputet i majtë frëng, vinte në dukje se në mbarë botën qarqet fashiste nacionale vepronin për të zgjeruar kufijtë e shteteve të tyre të pavarura. Vetëm fashistët shqiptarë, theksonte ai, vepronin për ta përfshirë Shqipërinë nën zgjedhën e Italisë fashiste. Kjo u vërtetua një muaj më vonë në Shqipëri. Me pushtimin në prill të vitit 1939 Italia fashiste nuk i shkaktoi Shqipërisë vetëm humbjen e pavarësisë kombëtare. Ajo i krijoi asaj edhe rrezikun e zhdukjes së shqiptarëve si komb. Kjo për arsye të planit që kishte Musolini për ta italianizuar Shqipërinë nëpërmjet kolonizimit të saj me banorë italianë. Mjafton të kujtojmë se deri në fund të vitit 1939, pra brenda tetë muajve të parë të pushtimit ishin vendosur në Shqipëri rreth 52 mijë banorë italianë, pa llogaritur repartet ushtarake. Vetëkuptohet se kolonizimi po të vazhdonte me këtë ritëm, brenda disa dhjetëvjeçarësh Shqipëria do ta humbiste fytyrën e saj etnike.

Rrezikun e kolonizimit italian të Shqipërisë kolaboracionistët nuk e zinin në gojë. Ata mburreshin se Roma dhe Berlioni do t'i ndihmonin shqiptarët për bashkimin e Shqipërisë së paraluftës me trojet e saj etnike, me Kosovën dhe me Çamërinë. Me këtë premtim, qeveritarët kolaboracionistë e solidarizuan Shqipërinë e pushtuar me bllokun agresiv nazifashist. Solidarizimin ata e konkretizuan me dekretin nr. 194 nënshkruar më 9 qershor 1940 nga Viktor Emanueli III, botuar në "Gazeta Zyrtare", nr. 93, Tiranë, 10 qershor 1940. Në bazë të këtij dekreti, Shqipëria do të ishte automatikisht në luftë me çdo shtet me të cilin Italia fashiste do të ishte në konflikt të armatosur. Në mbështetje të këtij dekreti, Qeveria kuislinge e Tiranës, në solidaritet të detyruar me Italinë fashiste, i shpalli luftë pa asnjë motiv më 10 qershor 1940 Anglisë dhe Francës, më 28 tetor 1940 Greqisë,

më 6 prill 1941 Jugosllavisë, më 22 qershor 1941 Bashkimit Sovjetik dhe më 7 dhjetor 1941, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Shqipëria u ndodh kështu pa vullnetin e saj në vorbullën e Luftës së Dytë Botërore.

Si pasojë e këtij vendimi, shqiptarët që dëshironin pavarësinë e atdheut u rreshtuan vetvetiu në kampin e madh antifashist anglo-sovjeto-amerikan, i cili u formua në vjeshtë të vitit 1941. Me formimin e kampit të madh antifashist anglo-sovjeto-amerikan u ndje nevoja e organizimit të rezistencës së armatosur. Hapin e parë e kryen komunistët shqiptarë, me themelimin më 8 nëntor 1941 të partisë së tyre marksiste-leniniste (PKSh). Që ditën e themelimit, PKSh-ja hoqi dorë nga programi i saj politik me karakter ideologjik: nga organizimi i revolucionit socialist dhe nga vendosja e diktaturës së proletariatit. Me porosi të Kominternit, ajo vuri në themel të programit të saj të ri luftën patriotike për të çliruar atdheun nga okupatori fashist italian, për të rimëkëmbur pavarësinë kombëtare të mohuar dhe për të vendosur në Shqipëri demokracinë popullore. Ajo e linte të hapur derën e bashkëpunimit me të gjitha rrymat patriotike që lëvrinin në Shqipëri, të djathta apo të majta, kapitaliste apo punëtore, fetare apo laike.

Nismën për të realizuar bashkimin në shkallë kombëtare të mbarë shqiptarëve në luftë kundër okupatorit të huaj, e mori Partia Komuniste Shqiptare me organizimin prej saj të Konferencës së Pezës, më 16 shtator 1942. Në Pezë komunistët propozuan formimin e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar si organ i përbashkët i luftës çlirimtare pa ngjyrimet politike. Platformën e tyre e përkrahën demokratët e majtë dhe monarkistët e ish-mbretit Zog. Përkundrazi, demokratët nacionalistë të djathtë, të bindur se gëzonin epërsi në opinionin publik, e refuzuan platformën e Pezës me motivacionin se nuk ishin të prirur të bashkëpunonin me faktorët komunistë as në çështjen nacionale.

Organizata e nacionalistëve demokratë të djathtë, Balli Kombëtar, e cila u formua dy muaj më vonë, në nëntor 1942, vendosi jo të hynte menjëherë në luftë pa kompromis kundër okupatorit fashist, siç ishte porosia e koalicionit të madh antifashist, por të qëndronte në pritmëri. Udhëheqësit ballistë llogaritnin të ndërmerrnin veprime luftarake kundër okupatorit kur të shihnin fundin e Luftës së Dytë Botërore dhe kur, sipas parashikimit të tyre, forcat partizane do të ishin shpartalluar nga ballafaqimi me forcat e okupatorit fashist italian. Por, qëndrimi i pritmërisë që mbajtën dy organizatat e djathta nuk qe për ta produktiv. Përkundrazi, angazhimi total pas Konferencës së Pezës i Lëvizjes Nacionalçlirimtare në luftë kundër okupatorit të huaj, solli si rezultat rritjen e prestigjit të saj në dëm të dy organizatave të djathta. Madje, lëvizja e armatosur antifashiste solli në arenën ndërkombëtare një rezultat të rëndësishëm për Shqipërinë. Në dhjetorin e vitit 1942 ministrat e Jashtëm të tre Fuqive të Mëdha të koalicionit antifashist – C. Hull, A. Eden, V. Molotov – deklaruan se e çmonin rezistencën e armatosur të shqiptarëve dhe e njohnin pavarësinë kombëtare të Shqipërisë.

Siç dihet, njëri prej tyre, A. Eden shfaqti më 17 dhjetor 1942 rezervë në lidhje me kufijtë e Shqipërisë, të cilat theksoi ai, do të rishikoheshin pas luftës. Rezerva kishte lidhje me premtimet që Britania e Madhe i kishte dhënë Greqisë për të aneksuar viset e Shqipërisë jugore, të ashtuquajturin “Epiri i Veriut”.

*

Rezerva që mbajti ministri i Jashtëm britanik A. Eden në lidhje me kufijtë e Shqipërisë që një rrezik i paparashikuar për lëvizjen kombëtare shqiptare. Kjo për arsye se kufijtë e Shqipërisë të vendosura përfundimisht nga Fuqitë e Mëdha më 1913 dhe të sanksionuara nga Lidhja e Kombeve më 1921, tani papritur do të rishikoheshin në dobi të kërkesave territoriale greke. Qarqet nacionaliste greke kërkesat e tyre territoriale i justifikonin duke e akuzuar Shqipërinë si fuqi agresore për luftën që qeveria kuislinge e Tiranës e detyruar nga Roma fashiste, i shpalli Greqisë më 1940. Qarqet nacionaliste të djathta shqiptare mendonin se kur të vinte koha do të kundërshtonin me armë lakmitë territoriale greke. Përkundrazi, udhëheqësit e lëvizjes nacionalçlirimtare mendonin se integritetin tokësor të atdheut të tyre duhej ta mbronin jo duke organizuar rezistencën e armatosur kundër shtetit grek, por duke intensifikuar luftën nacionalçlirimtare kundër okupatorit fashist italian, autori i vërtetë i luftës së 28 tetorit 1940. Kjo për arsye se lufta kundër agresorëve fashistë do ta rreshtonte Shqipërinë në radhët e aleatëve të kampit të madh antifashist. Po të pranohej si aleate, Shqipëria nuk mund të dënohej si shtet agresor. Ngjarjet e mëvonshme vërtetuan se vija politike e LANÇ-it ishte e drejtë.

Pas deklaratave të ministrave të Jashtëm të tre aleatëve të mëdhenj të koalicionit antifashist, disa segmente të organizatës balliste, në kundërshtim me krerët e tyre, vendosën t'i jepnin fund pritmërisë dhe të ndërmerrnin veprime të armatosura kundër okupatorit të huaj. Pavarësisht se pesha e tyre në frontin e rezistencës ishte e pakët, veprimet e tyre të armatosura kundër okupatorit nuk mund të injorohen. Fakti është se më 10 korrik 1943 LANÇ-i krijoi ushtrinë nacionalçlirimtare me batalione dhe brigada me në krye një shtab të rregullt ushtarak, ndërsa njësitet e armatosura të Ballit Kombëtar ngelën në stadin e çetave të vogla fshatare. Kur më 25 korrik 1943 pas shkarkimit të Mussolinit si diktator, u duk i afërt kapitullimi i Italisë, Balli Kombëtar pranoi të hynte në koalicion me LANÇ-in në luftë kundër okupatorit fashist, i cili po jepte grahmat e fundit. Kështu, në fillim të gushtit 1943 Balli Kombëtar lidhi në Kuvendin e Mukjes aleancë me PKSh-në, për luftë të përbashkët kundër okupatorit. Por aleanca dështoi. Mollë sherri u bë çështja e Kosovës dhe mosangazhimi i Ballit Kombëtar në luftë kundër okupatorit të ri hitlerian.

Për Ballin Kombëtar bashkimi i Kosovës me Shqipërinë e pushtuar nga Italia fashiste ishte realizim i platformës së Rilindjes Kombëtare. Për këtë arsye, sipas tyre, shqiptarët duhej të luftonin për të mos e lejuar më shpëputjen e Kosovës nga trupi i Shqipërisë. Sipas kësaj platforme, shqiptarët duhej të hiqnin dorë nga lufta kundër okupatorit gjerman, i cili ia kishte "dhuruar" Kosovën Shqipërisë dhe të angazhoheshin në luftë për të kundërshtuar ribashkimin e Kosovës me Jugosllavinë. Nacionalçlirimtarët mendonin ndryshe. Kosova, ishte bashkuar formalisht me vendim të Hitlerit në pranverën e vitit 1941, jo me Shqipërinë, por me administratën kuislinge të Tiranës. Ky ishte një bashkim *de facto* dhe jo *de iure*, i cili kërkonte miratimin e një areopagu ndërkombëtar. Për këtë arsye, bashkimi nuk kishte vlerë juridike ndërkombëtare, aq më tepër që vetë Hitleri kishte deklaruar se kur e donte puna aktet e nënshkruara prej tij i konsideronte letra pa

vlerë. Nuk ka dyshim se bashkimi administrativ i Kosovës me Shqipërinë ishte për kosovarët një lehtësim i zgjedhës së tyre kombëtare dhe për mbarë shqiptarët një vëllazërim i mohuar deri atëherë.

Për vëzhguesit objektivë, bashkimi i Kosovës me administratën kuislinge të Tiranës nuk ishte një çlirim, siç e trumbetonte Balli Kombëtar. Nga ky koncept i gabuar, ballistët nxorrën konkluzionin se për shqiptarët ishte detyrë patriotike të hiqnin dorë nga lufta kundër okupatorëve hitlerianë dhe të kalonin në luftë kundër çetnikëve serbë të Drazha Mihajloviçit dhe të partizanëve jugosllavë të Josif Broz Titos. Krerët ballistë arsyetonin se lufta e shqiptarëve kundër serbëve ishte e justifikuar, përderisa serbët historia i kishte damkosur si autorë të genocidit ndaj shqiptarëve. Ata nuk donin ta kuptonin se në bazë të Kartës së Atlantikut, Kosova, e shkëputur nga Jugosllavia me firmën e Hitlerit, duhej t'i kthehej përsëri Jugosllavisë, e cila qoftë mbretërore, qoftë titiste, ishte aleate e kampit të madh antifashist. E përkthyer shqip, kjo do të thoshte se lufta kundër çetnikëve apo partizanëve jugosllavë i shërbente okupatorëve hitlerianë.

Krerët e LANÇ-it mbajtën një qëndrim të ndryshëm. Kosova nuk mbrohej duke luftuar krah për krah me hordhitë hitleriane kundër forcave antifashiste jugosllave. Lufta kundër forcave antifashiste jugosllave, aleate e kampit të madh antifashist, e stigmatizonte lëvizjen nacionaliste shqiptare si kolaboracionizëm me politikën hitleriane. Për këtë arsye, ajo nuk do të sillte çlirimin e Kosovës, por vazhdimin e vargonjve të robërimit të kosovarëve nën Jugosllavinë. Përkundrazi, sipas *credo*-s nacionalçlirimtare, e cila mbështetej në Kartën e Atlantikut dhe në atë të Kombeve të Bashkuara, kapitali i çmuar që do të ndihmonte kosovarët të fitonin të drejtat e tyre kombëtare, ishte angazhimi i tyre në luftë kundër garnizoneve nazifashiste italo-gjermane, që e mbanin Kosovën nën kthetrat e tyre. Sipas zotimeve të koalicionit antifashist, ky kapital do t'u jepte kosovarëve mundësinë të zgjidhnin ata vetë pas luftës, me votë plebishitare, ardhmërinë e fatit të tyre. Nëse vendimi i Kuvendit të Bujanit për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë nuk u vu në jetë, përgjegjësia nuk ishte e komunistëve shqiptarë, por e titistëve jugosllavë, të cilët i detyruan autorët e rezolutës së Bujanit të hiqnin dorë nga vendimi që kishin marrë në fillim të vitit 1944.

Për mosangazhimin e Ballit Kombëtar në luftë kundër okupatorëve hitlerianë LANÇ-i e denoncoi marrëveshjen e Mukjes. Pas denoncimit të marrëveshjes, rrugët midis partizanëve dhe ballistëve u ndanë përfundimisht. Fronti Nacionalçlirimtar zhvilloi luftë të armatosur kundër ushtrive hitleriane, të cilat u dyndën në Shqipëri më 9 shtator 1943, fill pas shpalljes së kapitullimit të Italisë fashiste. Përkundrazi, Balli Kombëtar hyri që në shtator 1943 në kompromis me qeverinë kuislinge të Tiranës, e cila i lejoi repartet balliste të qarkullonin lirisht në qytetet e vendit me kusht që të mos prekeshin as ushtritë hitleriane, as administrata kuislinge. Për më tepër, gjatë dimrit 1943-1944 repartet balliste bashkëpunuan haptas me ushtritë hitleriane në operacionin ndëshkimor që ato ndërmorën kundër ushtrive nacionalçlirimtare. Përfundimisht, në pranverën e vitit 1944 Fronti Nacionalçlirimtar, doli nga operacioni i dimrit me autoritet të padiskutueshëm, kurse Ballin Kombëtar e pushtoi procesi i shpërbërjes. Edhe Lëvizja e Legalitetit, e cila ndonëse nuk bashkëpunoi me ushtritë hitleriane, por vetëm me administratën kuislinge,

shkoi drejt shpërbërjes. Kështu, Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili i qëndroi besnik luftës patriotike që nga fillimi e deri në fund, ka meritën se më 29 Nëntor 1944 e çliroi përfundimisht Shqipërinë e robëruar dhe rimëkëmbi pavarësinë e Atdheut.

*

Lufta Nacionalçlirimtare e parë në thellësinë e veprimeve të saj, nuk qe vetëm një luftë politike, por edhe një revolucion demokratik. Vizioni që kishin gjatë luftës udhëheqësit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare për shoqërinë shqiptare të Pasluftës, përfshirë dhe udhëheqësit e Partisë Komuniste të Shqipërisë, nuk kishte aspak ngjashmëri me diktaturën e proletariatit ashtu siç ishte zbatuar nga regjimi komunist. Ashtu siç ishte formuluar edhe në programin e Partisë Komuniste, ata synonin që pas luftës të ndërtonin një shoqëri demokratike popullore, me të cilën ata nënkuptonin jo një demokraci të ashtuquajtur borgjeze dhe ca më pak një demokraci aristokratike, por një demokraci të majtë, e cila të mbronte interesat e shtresave të gjera të popullsisë shqiptare. Ajo përmbante në vetvete prirjen për të ndërtuar një Shqipëri më të përparuar se ajo që ekzistonte para pushtimit të 7 prillit 1939. Detyrat që demokracia popullore synonte të zgjidhte në Shqipëri ishin këto: zhdukjen e mbeturinave feudale në fushën e pronësisë bujqësore, mënjanimin e ndikimit që ushtronin bejlerët dhe çifligarët në administratën qeveritare, nxjerrjen përfundimtare të bajraktarëve nga shoqëria malësore, krijimin e organizatave shoqërore që mbronin interesat e punës, barazimin e plotë të gruas me burrin në fushën e të drejtave shoqërore, pjesëmarrjen e gruas njësoj si burri në administratën shtetërore, masivizimin e arsimit deri në zhdukjen e analfabetizmit, zhvillimin e hovshëm të kulturës dhe artit shqiptar, lirinë e plotë të mendimit, të fjalës, të lëvizjes, të vendbanimit, të shtypit, më në fund rreshtimin e pakushtëzuar të Shqipërisë në koalicionin e madh antifashist anglo-sovjeto-amerikan.

Mund të pohojmë pa mëdyshje se asnjë nga këto detyra nuk kishin në përmbajtjen e tyre, karakter komunist. Ato i takonin programit të demokracisë së majtë dhe jo regjimit socialist, mbasi nuk e preknin pronën private.

Meritat dhe gabimet e Kongresit të Përmetit

Faqe e ndritur e Luftës Nacionalçlirimtare ishte pjesëmarrja e grave, në mënyrë të veçantë e vajzave shqiptare në rreshtat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Nuk qenë pak, por rreth pesë mijë gra dhe vajza luftëtare. Nuk kishte parë asnjëherë historia shqiptare formacione ushtarake të udhëhiqeshin nga gra si komandante dhe ca më pak si komisarë politike. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare u thyen deri diku edhe dallimet midis rinisë fshatare dhe qytetare, midis shtetasve të shkolluar dhe të pashkolluar. Lufta partizane ishte një revolucion i vërtetë shoqëror, për faktin se shpartalloi prangat që pengonin martesat midis çifteve me përkatësi të ndryshme fetare.

Ndryshime ndodhën edhe në organizimin e reparteve luftarake. Njësitë partizane trajtoheshin jo vetëm si bashkësi luftarake, por njëkohësisht edhe si bashkësi shoqërore dhe kulturore. Aty ku vullnetarët nuk dinin shkrim e lexim,

organizoheshin kurse për shkollimin e tyre. Në orët e pushimit zhvilloheshin për luftëtarët ligjërata politike dhe kulturore me përmbajtje patriotike. Partizanët patën një respekt të jashtëzakonshëm për dëshmorët e luftës. Dëshmi janë këngët e shumta kushtuar dëshmorëve që ranë si heronj me fjalë të hartuara nga vjershetarë bashkëluftëtarë të tyre dhe me muzikë të kompozuar nga muzikantë të shkolluar, që ndodheshin në rreshtat partizane.

Fronti Nacionalçlirimtar e shpalli veten që kur u krijua aleat jo i Bashkimit Sovjetik, por i koalicionit të madh antifashist, pra i Britanisë së Madhe, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me këto komponente, Lufta Nacionalçlirimtare ishte për historianin një luftë patriotike të cilën e ndërmorën shqiptarët në kushtet e Luftës së Dytë Botërore pa dallime politike, ideologjike, krahinore dhe fetare.

*

Sipas disa historianëve, me emërimin e Enver Hoxhës në Kongresin e Përmetit si kryetar i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar me atributet e qeverisë së përkohshme, u legjitimua vendosja e regjimit komunist në Shqipëri. Ky përcaktim nuk është i saktë. Karakterin politik të një qeverie e përcakton programi politik i saj dhe jo përkatësia partiake e anëtarëve të qeverisë dhe as ajo e kryeministrit të saj. Në Kongresin e Përmetit nuk u trajtua vendosja e regjimit komunist në Shqipëri. Vendimet e Kongresit flasin për një regjim demokratik popullor.

Nuk duhet harruar se Enver Hoxha i Kongresit të Përmetit nuk ishte Enver Hoxha i Kongreseve të Partisë së Punës. Kur u mbledh Kongresi i Përmetit, ai nuk njihet si burrë shteti. Emri i tij ishte shpallur një vit më parë në Labinot si komisar politik i Shtabit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ai nuk kishte në biografinë e vet paudhësi, me të cilat e mbushi më vonë CV-në e vet. Ta stigmatizosh Enver Hoxhën e vitit 1944, siç veprojnë disa gazetarë të ditëve tona, me tiparet që ai krijoi në vitet e regjimit komunist, është logjikë antihistorike. Megjithatë, në Kongresin e Përmetit mund të vihen re edhe të meta. Për shembull, vendimi për të ndaluar hyrjen e Zogut në Shqipëri për shkak të politikës së tij të Paraluftës ndaj Italisë nuk qëndron, përderisa pas 7 prillit 1939 zogistët u pranuan nga komunistët si aleatë në Konferencën e Pezës. E metë tjetër e Kongresit të Përmetit ishte se në atë Kuvend nuk pati opozitë. Mungesa e opozitës nuk ishte përgjegjësi e Partisë Komuniste, mbasi nuk i takonte asaj të krijonte opozitë. Duke mos patur opozitë në Kongres, Partia Komuniste u bë më agresive ndaj kundërshtarëve të saj, ballistë e zogistë, të cilët me bashkëpunimin e tyre me okupatorin hitlerian dhe me administratën kuislinge, e përjashtuan veten nga pjesëmarrja në Kongres. Partnerët jo komunistë që u zgjodhën në organet qendrore të Kongresit nuk krijuan partneritet të organizuar, por mbetën të hallakatur si individë të veçuar. Mosorganizimi i tyre në një parti më vite, e cila pas Çlirimit do të luante rolin e një opozite ose mund ta vinte vetë PKSh-në në opozitë, e bëri Partinë Komuniste arrogante ndaj tyre. Ky është një gabim që bie mbi aleatët e Partisë Komuniste dhe jo mbi Partinë Komuniste.

Nëse ne analizojmë hollë-hollë kritikën që pseudohistorianët i drejtojnë programit që miratoi Kongresi i Përmetit, ne mund të nxjerrim me lehtësi

konkluzionin se kritika e tyre shkon huq. Ajo nuk drejtohet kundër programit komunist, të cilin nuk e shtroi fare Kongresi i Përmetit, por kundër parimeve të demokracisë popullore, të cilën e miratuan të gjithë kongresistët.

Nuk mund të heshtim në këtë referat pa e prekur, natyrisht shkurt, çështjen e ngritur nga disa historianë, nëse në Shqipëri regjimi komunist i Pasluftës i ka rrënjët e veta historike në gjirin e Luftës Nacionalçlirimtare. Ne nuk e pranojmë këtë lidhje gjenetike midis regjimit komunist dhe Luftës Nacionalçlirimtare. Dëshmi kemi faktin se gjatë Luftës së Dytë Botërore luftëra nacionalçlirimtare u zhvilluan në të gjitha vendet e pushtuara të kontinentit. Në luftë kundër okupatorit të huaj morën pjesë, diku të bashkuar, diku të veçuar, të gjithë faktorët patriotikë, të djathtë dhe të majtë. Por, në Shqipëri me qëndrimin që mbajtën gjatë operacionit të dimrit, Balli Kombëtar dhe Lëvizja e Legalitetit e përjashtuan veten e tyre nga pjesëmarrja në Kongresin e Përmetit. Edhe demokratët e krahut të majtë të cilët luftuan krahas komunistëve në gjirin e lëvizjes nacionalçlirimtare nuk janë pa përgjegjësi. Nuk duhet të harrojmë se shumica dërrmuese e partizanëve luftëtarë, po ashtu dhe shumica e komandantëve, me përjashtim të komisarëve politikë, nuk ishin anëtarë të Partisë Komuniste. Sipas të dhënave zyrtare të shpallura herë pas here kur u çlirua Shqipëria, Ushtria Nacionalçlirimtare kishte afërsisht shtatëdhjetë mijë luftëtarë dhe luftëtare, kurse Partia Komuniste, brenda dhe jashtë ushtrisë, dy mijë anëtarë. Kjo do të thotë se Ushtria Nacionalçlirimtare ishte potencialisht armatë e faktorit jo komunist që luftonte si aleate me Partinë Komuniste në lëvizjen nacionalçlirimtare. Por demokratët e majtë merrnin pjesë në radhët e lëvizjes nacionalçlirimtare si elektronë të lirë, në aleancë me komunistët, të cilët ishin të organizuar në një parti militante të stilit bolshevik. Pra, ndonëse në radhët e anëtarëve të frontit gëzonin epërsi numerike, ata ndodheshin në minoritet organizativ përballë Partisë Komuniste. Duket, se personalitetet jo komunistë të këtij rreshtimi, si Omer Nishani apo Myslym Peza, Shefqet Beja apo Riza Dani, Kostandin Boshnjaku apo Kol Kuqali, Dali Ndreu apo Ali Seferi, të cilët gëzonin integritet politik si faktorë jo komunistë, nuk e ndjenin nevojën për një parti më vete, për arsye se programin e tyre demokratik të majtë e mishëronte vetë Fronti Nacionalçlirimtar. Kjo ishte me siguri një verbëri politike, të cilën kur ata e kuptuan dëmin, u ndodhën përpara skuadrës së pushkatimit.

Kundërshtarët e PKSh-së e stigmatizojnë LANÇ-in se ajo nuk ishte një luftë patriotike, por luftë civile midis dy rreshtimeve politike antagoniste shqiptare. Ne kemi mësuar nga historia e përgjithshme se me luftë civile nënkuptohet lufta midis dy rreshtimeve politike të një vendi të lirë, ku secila palë lufton për të siguruar pushtetin politik. Lufta midis rreshtimeve politike për çështjen e pushtetit nuk mund të zhvillohet në kushtet kur vendi është nën zgjedhën e huaj, pasi në këtë rast pushtetin e ka në dorë okupatori i huaj. Si rrjedhim, nuk mund të kemi luftë civile në Shqipëri për sa kohë që ajo ishte e pushtuar nga ushtritë naziste gjermane. Në histori ka ndodhur jo rrallë që në një luftë civile kanë ndërhyrë edhe forca ushtarake të jashtme. Por ato kanë ndërhyrë për të siguruar nën diktimin e interesave të tyre, fitoren e njëres ose të tjetres palë, por jo për të vendosur autoritetin e tyre pushtetor. Kështu ndodhi për shembull me ndërhyrjen e ushtrive anglo-amerikane në luftën civile në Greqi, e cila u zhvillua më 1946, kur ushtritë

hitleriane ishin larguar nga toka greke. Në Shqipëri, gjatë operacionit hitlerian të dimrit 1943-1944 nuk qenë hitlerianët gjermanë që ndihmuan forcat balliste të merrnin pushtetin politik, por qenë forcat balliste ato që u shërbyen si udhërrëfyesa divizioneve hitleriane. Vetëkuptohet se në një kohë kur bota mbarë luftonte kundër agresorëve hitlerianë, rreshtimi i ballistëve krahas hitlerianëve i shndërronte ata në faktorë kolaboracionistë. Për këtë arsye, ne nuk mund të pajtohemi me historianin amerikan Bernd Fischer, i cili ballafaqimin e armatosur midis partizanëve dhe ballistëve që ndodhi gjatë operacionit të dimrit, e cilëson luftë civile. Ne pranojmë arsyetimin që sekretari i Departamentit Amerikan të Shtetit Cordell Hull, quante më 6 tetor 1944 luftë civile vetëm përleshjen e armatosur që parashihej se mund të ndodhte në Shqipëri, midis partizanëve dhe kundërshtarëve të tyre zogistë pas largimit të ushtrive hitleriane nga vendi. Nëse miratojmë tezën e historianit amerikan Bernd Fischer, del se edhe lufta që zhvillonin partizanët kundër milicisë fashiste të Mustafa Krujës ishte një luftë civile.

Është e qartë se cilësimi i Luftës Nacionalçlirimtare si luftë civile bën pjesë në përpjekjet për të shpëtuar Ballin Kombëtar nga turpi i bashkëpunimit me hitlerianët. Për këtë qëllim, ballistët shfrytëzojnë edhe biografinë e kryetarit të tyre, Mithat Frashëri. Ne, e çmojmë kontributin që ai ka dhënë në të kaluarën si nacionalist, si demokrat dhe si antizogist. Por ato nuk mund ta mbulojnë qëndrimin e lëkundur që ai mbajti gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe dëmet që i shkaktoi të ardhmes së Shqipërisë si arkitekti i platformës balliste.

Ne marrim si shembull qëndrimin që mbajti opinioni publik frëng në sintoni me legjislacionin e Francës kundrejt mareshallit Philippe Petain. Mareshalli frëng ishte shpallur Hero i Verdunit për kontributin që dha gjatë Luftës së Parë Botërore në mbrojtjen e Francës kundër invazorëve gjermanë. Përkundrazi, gjatë Luftës së Dytë Botërore ai e mbuloi veten me turp për kapitullimin e tij para invazorëve hitlerianë dhe për bashkëpunimin e tij me Hitlerin, si kryetar i Francës së Vichy-së. Dihet se për këtë qëndrim pas luftës ai u dënua me pushkatim për tradhti të lartë ndaj atdheut, dënim i cili për shkak të moshës 90 e ca vjeçare, u shndërrua në burgim të përjetshëm. Pra, kontributi i tij patriotik nuk e pengoi opinionin publik frëng ta dënonte mareshallin Petain si tradhtar, ashtu si dënim i tij si kolaboracionist nuk ndikoi te opinioni publik që t'ia hiqte atij titullin e heroit të Francës.

*

Këtu lind pyetja: si shpjegohet që PKSh-ja, një organizatë politike pa biografi patriotike, tre vjet pasi u themelua, mori në dorë pushtetin politik, kurse faktorët nacionalistë demokratë me tradita politike pësuan disfatë?

Historia e njerëzimit ka prova jo të pakta, të cilat tregojnë se komponenti me peshë në fitoren e një lufte është kauza e drejtë e luftës. Nuk ka dyshim se kauza që frymëzoi Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare – çlirimi i Shqipërisë dhe rimëkëmbja e pavarësisë së saj – ishte e shenjtë. Edhe ambienti historik ndërkombëtar në të cilin ajo u zhvillua, rreshtimi i saj në kampin antifashist anglo-sovjeto-amerikan – ishte i shëndoshë.

Meqenëse në Shqipëri nuk pati asnjë ndërhyrje ushtarake nga jashtë, as britanike, as amerikane, as sovjetike, nga ky fakt shpjegimi duhet kërkuar te

faktorët e brendshëm. Shpjegimin më bindës duhet ta kërkojmë te qëndrimi thellësisht i gabuar që mbajtën faktorët e djathtë shqiptarë. Në vend që të luftonin kundër okupatorit të huaj hitlerian, ballistët dhe legalistët bashkëpunuan – të parët me okupatorin gjermano-hitlerian, të dytët me qeveritarët kuislingë kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Me këtë qëndrim të gabuar politik, ata i dhanë dorë lëvizjes nacionalçlirimtare dhe PKSh-së, të siguronin monopolin e fitores së luftës patriotike dhe, si rrjedhim, të vendosnin pa vështrirësi regjimin komunist në vend. Dihet se në fillim të Luftës Nacionalçlirimtare, simpatitë e opinionit publik shqiptar anonin në favor të faktorëve demokratë, të cilët konsideroheshin si pasardhës të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe të lëvizjes demokratike parlamentare të Paraluftës. Askush nuk e parashikonte se komunistët shqiptarë, të cilët para luftës nuk ushtronin ndonjë ndikim në jetën politike të vendit, ta përmbysnin brenda dy-tre vjetëve bë favor të tyre barometrin e simpatisë popullore.

Vijmë kështu te pyetja: çfarë ndodhi që u përmbys barometri politik i opinionit publik brenda dy-tre vjetëve? Shpjegimin e jep i njëjti faktor si për fitimtarët ashtu dhe për humbësit – qëndrimin ndaj detyrës themelore që shtrohej para vendit. Devotshmëria me të cilën faktorët e majtë luftuan për zbatimin e kësaj detyre solli rritjen e simpatisë ndaj tyre të opinionit të vendit. Përkundrazi, largimi i partive të djathta nga detyra patriotike solli shpërbërjen e tyre si faktorë politikë. Nëse partitë e djathta po të kishin luftuar si homologët e tyre europianë kundër okupatorëve nazifashistë, nuk do ta linin Partinë Komuniste të monopolizonte fitoren e luftës në duart e saj. Në optikën e këtij procesi, mund të thuhet pa mëdyshje se përgjegjësia e vendosjes së diktaturës puniste, e cila e telendisi popullin shqiptar për 40 vjet, bie pjesërisht mbi Ballin Kombëtar dhe mbi Lëvizjen e Legalitetit.

*

Nuk dëshirojmë të merremi me prirjen që kanë disa fragmente të kufizuara të opinionit publik shqiptar, për ta mohuar vlerën e Luftës Nacionalçlirimtare, mbasi kjo prirje është thellësisht absurde. Të mohosh Luftën Nacionalçlirimtare do të thotë të mohosh kontributin që ajo dha për rivendosjen e Pavarësisë Kombëtare; do të thotë të mohosh atë kapital të çmuar politik që shërbeu për ta shpëtuar Shqipërinë nga copëtimi i saj territorial; do të thotë të mohosh gjakun e atyre mijëra dëshmorëve që ranë në luftë kundër okupatorëve të huaj; do të thotë t'i konsiderosh pa vlerë burgimet, internimet, torturat që pësuan patriotët shqiptarë të bindjeve të ndryshme politike nga okupatorët e huaj fashistë dhe nazistë; do të thotë të mohosh ndihmën pa shpërblim që dhanë qytetarët dhe fshatarët, për ushqimin dhe strehimin e reparteve partizane.

Orvatjet që po dëgjojmë për ta shpëputur Luftën Nacionalçlirimtare nga udhëheqësit e saj, janë antihistorike. Kundërshtarët e LANÇ-it nuk duan të dëgjojnë emrin e Enver Hoxhës. Kjo për arsye të gabimeve që ai kreu me diktaturën komuniste të Pasluftës. Nuk duhet harruar se LANÇ-i nuk qe një fenomen as spontan, as anonim. Ajo qe një ndërmarrje madhështore, të cilën e projektuan, e organizuan dhe e udhëhoqën deri në fitore grupe njerëzore me identitet të përcaktuar politik. Të vlerësosh veprën dhe të injorosh arkitektët, kur ata dihen, është dobësi.

Një popull që pati trimërinë të luftonte pesë vjet me radhë kundër agresorëve fashistë, të armatosur deri në dhëmbë, nuk ka përse të ketë frikë nga emrat e disa njerëzve që nuk jetojnë më dhe që nuk kanë mundësi ta risjellin diktaturën e tyre puniste, tashmë të varrosur. Jezu Krishti në kohën e vet nuk e donte Jul Qezarin. Megjithatë, ai i porosiste besnikët e vet: Jepini Qezarit atë që i takon Qezarit.

Për kontributin që Enver Hoxha dha gjatë luftës, historianët nuk duhet ta gjykojnë atë nëpërmjet prapësive që ai kreu pas luftës, si diktator i regjimit 40-vjeçar komunist. Ashtu si për mareshallin Petain, veprimet e tij duhet të gjykojnë pasi të vëmë në veprim peshoren historike. Veprimet e mbrapshta të kryera në një epokë nuk duhet të mbulojnë veprimet e mbara që një personalitet realizoi në një epokë tjetër. Vetëm pasi t'i japim Qezarit të drejtën që i takon, mund ta kritikojmë atë si të duam dhe sa të duam. Në kohët moderne nuk ka luftë me udhëheqës anonimë. Udhëheqësit kanë emër dhe mbiemër. Pasi të mbarojmë punën e Luftës Nacionalçlirimtare, ejani ta analizojmë bashkërisht veprimtarinë e Enver Hoxhës gjatë regjimit komunist. Nuk ka pra arsye përse gabimet që kreu E. Hoxha pas luftës gjatë regjimit komunist të na pengojnë që të vlerësojmë kontributin që ai dha si një nga udhëheqësit e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Megjithatë, në veprimtarinë që zhvilloi Enver Hoxha gjatë Luftës Nacionalçlirimtare nuk mungojnë gabimet. Një nga gabimet e tij madhore është që ai lejoi të thurej për të aureola e organizatorit dhe udhëheqësit të Luftës Nacionalçlirimtare. Kjo pa dyshim është një legjendë e nxitur prej tij në kundërshtim edhe me parimet e marksizëm-leninizmit, i cili e mohon rolin vendimtar të individit në histori. Enver Hoxha nuk e themeloi Partinë Komuniste. Projekti i Luftës Nacionalçlirimtare nuk ishte vepër e tij. As sukseset e Luftës Nacionalçlirimtare nuk kishin për autor Enver Hoxhën. Ajo u udhëhoq nga një ekip patriotësh, në të cilin bënë pjesë edhe militantët e dënuar me vdekje më vonë nga Enver Hoxha, si armiq të diktaturës puniste. Në të vërtetë, Lufta Nacionalçlirimtare ishte vepër e shtresave të gjera të popullsisë shqiptare, e dashurisë së tyre për lirinë e atdheut, e gatishmërisë së tyre për të dhënë jetën në dobi të çlirimit të vendit dhe për të rimëkëmbur pavarësinë e Shqipërisë. Atë e organizoi Partia Komuniste Shqiptare e veshur jo me kominoshet e proletariat ndërkombëtar, por me fustanellën e lëvizjes patriotike shqiptare. Enver Hoxha u shpall Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Kongresin e Përmetit, kur opinioni nuk kishte dijeni për aftësitë ushtarake të tij, i cili nuk kishte shërbyer asnjë ditë si ushtarak. Sigurisht që ai nuk është pa merita, por jo në atë masë sa është brohoritur për 40 vjet me radhë. Merita e tij qëndron te roli që ai luajti së bashku me militantët komunistë dhe me ushtarakët patriotë në veprën e Partisë Komuniste si organizatore e Luftës Nacionalçlirimtare. Sigurisht që edhe prirja që vihet re për ta fshirë emrin e tij nga historia e Luftës Nacionalçlirimtare është e tepruar.

Në mbyllje po i përgjigjemi pyetjes se çfarë vendi zë në historinë e Shqipërisë Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare. Sipas vlerësimit të historisë botërore, rezultati më i lartë që çdo popull ka arritur gjatë historisë është krijimi i shtetit kombëtar të pavarur. Meqenëse pavarësinë Shqipëria e humbi më 7 prill 1939, si detyrë parësore për mbarë shqiptarët u shtrua përsëri rimëkëmbja e pavarësisë kombëtare të humbur. Pikërisht kjo ishte detyra parësore e Luftës

Nacionalçlirimtare. Orvatjet që ndërmerren për të mbivlerësuar vendosjen e regjimeve të brendshme, përmbi pavarësinë kombëtare, janë thellësisht të gabuara. Regjimet politike venë e vijnë. Ato fitohen me revolucione të brendshme apo me zgjedhje parlamentare. Por, pa pavarësinë kombëtare ato nuk mund të realizohen.

Përfundimisht mund të thuhet se për hir të kontributit që Lufta Nacionalçlirimtare dha, ajo zë pa pikë dyshimi vendin e dytë pas Kuvendit historik të Vlorës më 28 Nëntor 1912.

NAIM HALIMI

MASAKRAT PARTIZANO-ÇETNIKE NË KARADAK NË MBARIM TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Karadaku, i njohur në histori me luftërat për liri, në të kaluarën përjetoi edhe shumë tragjedi, ndarje dhe kufij. Gjendet në lindje të trojeve etnike shqiptare. Përfshin masivin malor, fushat për rreth dhe 7 qytetet, qendra administrative: Shkupin, Kumanovën, Preshevën, Bujanocin, Gjilanin, Ferizajn dhe Kaçanikun. Është një trevë shqiptare (sot, e qeverisur nga republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë dhe Lugina e Preshevës, Serbia), e cila në brendinë e saj ka rreth njëmijë vendbanime me afër gjysmë milioni banorë, prej të cilëve shumica janë shqiptarë. Kjo është e natyrshme, kur të kihet parasysh se populli shqiptar jo vetëm këtu, por edhe në Ballkan e më gjerë është më i hershmi. Duke pasur parasysh këtë dhe faktin tjetër se trojet shqiptare e veçanërisht Karadaku i cili shtrihet në një pozitë të mirë gjeostrategjike, e cila me rrugët që kalonin nëpër të, e lidh vendin me rajonin, si dhe pasuritë dhe bukuritë e shumta natyrore, shumë armiq ia mësynë për ta bërë të vetin, për ta pushtuar. Në këtë histori, Karadaku (nyje kyçe në mesë Serbisë, Bullgarisë dhe trojeve shqiptare, Shqipërisë), u bë kala qëndrese dhe zonë natyrale e kufirit etnik shqiptar. Këtu shqiptarët u konfrontuan dhe luftuan me shumë të huaj të cilët lakmuan tokat e tyre. Ata, ndonëse bënë luftë të drejtë për mbrojtjen e atdheut dhe lirisë tyre, padrejtësisht dhe pabesisht shumë herë u sulmuan dhe u vranë, u masakruan. Kështu ndodhi edhe në mbarim të Luftës së Dytë Botërore.

Lufta e Dytë Botërore, kur po merrte fund, në vjeshtë të vitit 1944, dhe kjo trevë shqiptare po çlirohej nga pushtuesit bullgar, qëndrimi i të cilëve që këtu me pasoja të mëdha për shqiptarët, partizanët komunistë, në radhët e të cilëve kishin depërtuar edhe shumë çetnikë, iu vërsulën trevës së Karadakut, për ta pushtuar, duke i akuzuar banorët e saj shqiptarë armiq dhe bashkëpunëtorë të okupatorit, akuzë e cila ishte e pabazë, sepse shqiptari kurrë nuk ishte bërë me të huajin për ta okupuar vendin e vet. Në fakt qëllimi kryesor i tyre ishte zhdukja në masë e shqiptarëve, hakmarrja kolektive. Këtë qëllim e dëshmojnë dokumente të shumta të kohës të publikuara dhe të pabotuara, si dhe kujtesa e popullit, veçanërisht e atyre që i përjetuan këto ngjarje.

Nga kjo faktografi, shihet se nxitësit kryesorë të këtyre masakrave ishin forcat çetnike, të cilët Udhëheqja e LNÇJ-së (Kryesia e KAÇKJ-së), Tito, i amnistoi, ua fali vrasjen e shqiptarëve, duke i shpërndarë në brigadat e UNÇ-së, pa kurrfarë kriteri, vetëm duke ndërruar kokardën me yllin komunist, e duke ua mundësuar realizimin e qëllimit - likuidimin e shqiptarëve, zhdukjen fizike,

shpërnguljen, pastrimin e terriorit nga shqiptarët, në rastin konkret të Karadakut, vend strategjik dhe historik, pararojë e trojeve etnike shqiptare. Pra, edhe këtu, antishqiptarizmi qe qëllimi kryesor i bashkimit të çetnikëve me partizanët.

Planin gjenocidal ndaj shqiptarëve, si në viset e tjera edhe në Karadak, e kishte hartuar Shtabi Kryesor i UNÇJ-së dhe ai i Serbisë, duke i kyçur edhe ato të Malit të Zi, të Maqedonisë, të Kosovës, madje edhe të Bullgarisë, e duke i manipuluar edhe atë të Shqipërisë, me forcat ushtarake që kishin në disponim, në emër të çlirimit të vendit nga pushtuesit fashistë dhe bashkëpunëtorët e tyre. Këto shtabe ushtarake-politike, eshalonë, në një anë e thërrisnin popullin në rezistencë, kundër nazizmit, kurse në anën tjetër në mënyrë të organizuar bënë masakra kolektive mbi popullatën e pafajshme shqiptare. Ata caktuar kohën, njësitë ushtarake, hordhitë, dhe vendin ku do t'i terrorizonin shqiptarët, edhe në Karadak. Ndonëse ishin bërë marrëveshje, në mes udhëheqësve të Karadakut të cilët luftonin vetëm për ruajtjen e trojeve dhe dinjitetit kombëtar dhe udhëheqësve të këtyre shtabeve, që populli shqiptar të mos preket, të mos dëmtohet në asnjë aspekt, ata partizano-çetnikët nuk i respektuan ato. Trevën shqiptare të Karadakut e sulmuan nga të gjitha anët. Sulmet vrastare për shqiptarët filluan nga shtatori i vitit 1944 dhe vazhduan deri në gjysmën e vitit 1945. Gjatë kësaj periudhe nuk ka familje, lagje, fshat e qytet i Karadakut ku nuk janë bërë keqpërdorime e masakrime nga më të rëndat prej këtyre “çlirimtarëve”, si e quanin ata veten. Është e pabesueshme të besohet, se të gjitha këto krime u bënë pikërisht në kohën kur partizanët e Shqipërisë i kishin Shtabet e tyre në Prizren dhe Shkup, madje edhe njësitë ushtarake siç ishte Brigada e Pestë Shqiptare e udhëhequr nga Shefqet Peçi. Për krime u dalluan sidomos Brigada VIII e Preshevës Brigada XII e Bujanocit, Aradha Partizane e Shkupit, Një Batalion Partizan Bullgar, Brigada XVI, XVII dhe XVIII Maqedonase, Brigada e Bokës, Brigada e Pirotit, disa njësi të Brigadave të Kosovës, (si Batalioni i parë dhe i tretë i Brigadës së tretë të Kosovës e formuar më 21 mars 1944 në Vranjë, vetëm me çetnikë të Vllada Popoviqit), etj. Siç duket, këto njësi luftarake, banda çetniko-komuniste kishin marrë detyra nga lart që popullin shqiptar në këtë zonë ta zhduknin sa më shumë, me qëllim që të mos ketë kush më të luftojë e as t'i kërkojë të drejtat e shqiptarëve që u takonin në rregullimin e ri shoqëror dhe shtetëror, që pritej të bëhej.¹

Mënyra dhe mjetet që përdorën gjatë ekzekutimit këta “çlirimtarë” ishin të ndryshme, nga më e lehta vrasja me plumb e deri te më e rënda, therja dhe preja e gjymtyrëve të trupit, për së gjalli. Më të shpeshta qenë: vrasja me plumb, therja me thikë, prerja me sharrë, përvëlím me ujë valë, ngufatja, gogitje me grusht, shqelma,

¹ AM,F,LNÇ,K-54a,d.6831,f.10-15. Dokumente dhe vendime të AVNOJ-it,Beograd,1965,f.135-137.Dr.Branko Boshkoviq,Narodosllobodillačka borba u Ibarskom bazenu,Prishtina,1968,f.175.Femi Rexhepi,Pse u vendos administrata ushtarake në Kosovë,,Bujku,,20.4.1995.f.13.AM;F,LNÇ;k,54,d.1655.Nnikolla Vidaçiq,Na oballama nerodime,Novi Sad,1967,f.228-230.Zbornik 1,L.15,19,d.123,129,179,f.319,873-878. Dr.Ali Hadri, Lëvizja Nacinalçlirimtare në Kosovë 1941-1945, Prishtinë,1971, 408-412.AIUH.K,1340,n.12-1/3.

kazmë, dru, çekan, kondak, bajonetë, hekur, gurë, me varje në qafë, për këmbë, për ekstremitetesh, prerje të pjesëve të trupit, prerje të organeve gjinitale, tredhje, dhe shumë forma të tjera, që nuk mund të përshkruhen e as të besohen. Këto masakra bëheshin ditën, madje edhe para anëtarëve të familjeve, grave e fëmijëve, e sidomos natën, shpeshherë të përcjellë me muzikë, për të mos u ndier zëri i viktimave. Si rëndom, urdhrat i jepnin proçetnikët e dalluar për antishqiptarizëm, ndërsa ekzekutimin e bënë të shumtën e rasteve disa romë të pamëshirshëm, me ndjenja sadiste.

Në pamundësi për t'i përshkruar të gjitha krimet e bëra në këtë kohë, në Karadak, nga këta zullumqarë, vrastarë, po përmendim në këtë rast vetëm disa prej tyre që ishin më masive dhe më tmerruese.

Masakrat kundër popullatës shqiptare në këtë territor i filluan çetnikët në Xhaminë e Epërme të Preshevës më 17 shtator 1943, të udhëhequra nga malazezi Jagosh Janjeviqi, kolonist nga Reka e Tërnavës, serbobullgar, dhe Zafir Deniqi, me shokë, kur të maskuar hynë në qytet dhe hodhën bomba nga dritarja në Xhami të Poshtme, në kohën deri sa besimtarët falnin taravitë. Në këtë akt gjenocidal vdiqën 4 shqiptarë (Lutë Mehmeti, Rexhep Demi, Ramiz Agushi dhe Tafë Tërnavë), e u plagosën 32 të tjerë. Edhe pse shqiptarët për këtë rast patën mundësi të hakmerren në kënd të donin në minoritetin sllav të Preshevës, ata një gjë të tillë nuk e bënë, nuk u hakmorën në askënd, me çka, si gjithmonë, e ruajtën gjakftohtësinë duke treguar pjekurinë dhe krenarinë. Ata kishin planifikuar edhe një masakër tjetër në Xhami të Epërme të Preshevës, por falë syçelësisë së popullit ajo nuk ndodhi.

Një makër tjetër tmerruese ndaj burrave, pleqve, grave dhe fëmijëve shqiptarë u bë në fshatin Sopot të Kumanovës. Vrasjet nga partizano-çetniko-bullgarët u bënë disa ditë në grupe, ndërsa ploja më e madhe ndodhi më 3 e 4 nëntor 1944.

Bajram Latifi, Liman Limani dhe Xhevaire Limani, dëshmitarë të masakrës, që i shpëtuan vdekjes, kujtojnë se: me këtë rast janë vrarë dhe masakruar në forma të ndryshme çnjerëzore 64 shqiptarë të fshatit Sopot dhe 4 mysafirë të fshatrave tjerë, gjithsej 68, nga fëmija 11 vjeç deri te plaku 95- vjeçar. Këta dhe dëshmitarët tjerë i tregojnë me emër të vrarët dhe vrastarët. Sipas tyre, të vrarët ishin: Ramadan, Bajram, Esat, Edip, Sahit, Shefki e Riza Saliu, Mustafë Memeti, Mejdi, Abdzli, Shabi, Kadri e Haki Agushi, Fejzulla, Jusuf, Azem, Adem, Bajram, Hasip, Osman, Sali, Baki, Ibrahim, Shaip, Faik, Femi, Nazmi, Niazi, Xhemal, Qemal e Orhan Sylejmani, Memedali, Durmish, Munish, Shukri, Ahmet, Aliriza e Ruzhdi Limani, Halim, Murat e Xhavit Ademi, Xhemailk, Selver, Hamzi, Naip e Agush Latifi, Ramadan e Zeqir Emini, Sejdi, Hysen, Ramadan e Rexhep Sejdiu, Halim, Qazim, Rexhep, Halim B., Rexhep Jetimi, Ibrahim Makolli, Sahit, Ramadan, Hajdin e Ramiz Jaka, Nuredin Iseni, Eshtref Esati, Haxh Bakiu, si dhe bariu nga fshati Shtrezoc, Zija Zymberi. Bashkëbiseduesit më tej thonë se po të mos kishte intervenuar Abdulla Presheva, partizan i njohur, sopotasit do të ishin vrarë deri më një, dhe fshati do të ishte djegur me themel. Derisa ndodhi ky intervenim, në fshat u dogjën edhe disa shtëpi, u plaçkitën shumë pasuri, kafshë, ar e argjend, e pati edhe dhunime të femrave. Gjithnjë sipas dëshmitarëve okularë dhe materialit

dokumentar, komandant i kësaj (Brigade të XVII, të themeluar në fillim të tetorit 1944, në fshatin Zheglan, nga partizan e çetnik, serb-malaz-maqedon e bullgar) ploje qe Brank Rula (më parë fetfebell i bullgarëve) nga Kumanova (kryeshef shtabi Ilia Bukoviqi, komesar politik Vanço Svetkovski), me disa fshatarë të Sopotit, Tabanocit, Sushevës, Karabiçanit, etj., si Dragolubi, Milloshi, Luba, Stojani, Sande, Jefta, Nofki i Veliçkit, etj. të cilët i njihnin mirë fshatarët sopotas. Në vitet e demokracisë, sopotasit i mblodhën eshtrat e shqiptarëve të vrarë në këtë masakër, nëpër arat e kësaj ane dhe në shenjë respekti, kujtimi, ngritën një kompleks memorial në fshatin Sopot, ku figurojnë të shkruar emrat e këtyre martirëve të kombit.²

Një tjetër masakër u bë në Bllacë të Shkupit.

Brigada XVI Maqedonase (themeluar më 6 tetor 1944, në Malin e Zi të Shkupit, nga njerëz të brigadës 8-të dhe të XII-të të Preshevës, Bujanocit dhe Vranjës, partizan e çetnikë, serbë, malazez, maqedonas e bullgarë) e komanduar nga Glisha Sharanoviqi, nga tetori deri më 14 nëntor 1944, pasi likuidoi në fshatrat e Shkupit rreth 200 shqiptarë, nën pretekstin se kishin qenë “në shërbim të okupatorit”, rrugës për Kosovë, ia mësyri fshatit Bllacë për ta masakruar. Më 1 nëntor 1944 pasi i tuboi të gjithë fshatarët në mesin e fshatit (e ndihmuar edhe nga partizania e Shkupit, Qefser Hasan Shukri) dhe ua mblodhi armët që kishin për ruajtjen e shtëpive dhe të pasurive nga plaçkitës të ndryshëm, grupe(3), grupe, 120 bllacas të moshave të ndryshme i pushkatoi te Uji i Tharptë, afër Hanit të Elezit. Nga këto grupe i shpëtuan vdekjes falë vetëmohimit, Shefki, Ramiz, Tahir e Misim Ferra dhe Emin Bardhi, të cilët më pastaj do të tregojnë për tmerrin që e kishin parë, dhe për të masakruarit. Sipas tyre, fshatarët pasi u shanë e u rrahën tërë ditën, u vranë nga Mëhalla Koka: Murtezan Hasani, Sami Jahiu, Metush Islami, Halim Avdiu, Junuz e Sylejman Elmazi me djemtë: Xhemailin dhe Deharin, Ziber Sejfullai, Mustaf Alia, Xhavit dhe Qatip Osmani (vëllezër); nga Mëhalla Salihasi: Feriz Salihi, Beram Ramizi, Nezir Miftari, Sabedin Ramadani, Bektesh Rustemi, Latif Jakupi me djemtë: Zenunin dhe Asllanin; nga Mëhalla Ferra: Qamil dhe Xhavit Nuhui (vëllezër), Milaim dhe Brahim Xhaferi (vëllezër), Xhhaferi, Daut Halimi, Idriz Ajeti, Rushit dhe Shukri Avdili (vëllezër); nga “Mëhalla Doçi” Nebiu dhe Avdiu (babë e bir), Muharrem Berami, Shaqir Rexhepi, Haziz dhe Emin Rrahmani, (vëllezër), Islami dhe Asllani (vëllezër); nga Mëhalla Luçi: Sinan, Hamit dhe Sherif Sula (vëllezër); nga Mëhalla Ameti: Memish Limani, Ibish Shabani, Rasim Hamiti, Metush Memeti, Arifi e Halili (babë e bir); nga Mëhalla Doshlaku: Nuredin Zeqiri dhe Rustem Baftiu; nga Mëhalla Tusha: Veli Ismaili dhe Mehmet Velui (vëllezër), Rushit dhe Xhelil Nuredini (vëllezër), Beqiri dhe

² Dokumente dhe vendime të AVNOJ-it, Beograd, 1965, f.135-138. Mr. Ramiz Abdyli, Presheva në Lëvizjen Nacionalçlirimtare 1941-1945, Magjistraturë e mbrojtur në Fakultetin Filozofik të Prishtinës më 1978, f.33. Femi Rexhepi, Pse u vendos administrimi ushtarak në Kosovë, Bujku, 20.4.1995, 13. Tefik Jahiu Masakra serbosllave maqedonase ndaj shqiptarëve në Karadak, Shkup, 2000, f.25-30. Fehmi Rexhepi, Gjenocidi sllav mbi shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, Rilindja, Prishtinë, 18 prill 1995, f.13. Shiko më gjërsisht: Masakra e Sopotit, Bujku, Prishtinë, 2.2.1995. Sevdail Demiri, Flakadani i rezistencës karadakiane, Kumanovë, 2006, f.101-113.

Shukriu (babë e bir), Rasim Hasani, Idriz dhe Ibrahim Ferati (vëllezër), Rufat dhe Musli Aliu (vëllezër), Naip Avdili, Kamer dhe Sinan Hakiki (vëllezër), Islam dhe Sait Saliu (vëllezër), Mustafë Berami me të ëmën (emri nuk i dihet); nga Mëhalla Toçi: Jahi dhe Rushit Qahili (vëllezër), Sabedin Sinani dhe Jonuz Beqiri; nga Mëhalla Kovaçi: Rrahim dhe Ibrahim Ziberi (vëllezër), Ibrahim Rrahmani, Muharrem Berami, Miftar Meta, Qazim dhe Hamdi Hasani (vëllezër); nga Mëhalla Shehu: Tanush dhe Halim Metushi (vëllezër) Minah Dani, Mustafa, Aliu dhe Sefa (pa mbiemër); nga Mëhalla Çajani: Behram Ajeti, Isman dhe Naip Ahmeti (vëllezër), Rrahman Hamiti; nga Mëhalla Imishti: Qamil Haki dhe Shaban Jakupi (vëllezër), Sheref dhe Xhemal Selmani (vëllezër); nga Mëhalla Lusjani: Xhemal Berami, Rushan Isufi, Emin Dervishi, Azem Bislimi, Riza Ilazi, Ismail Hasani, Jahiu, Bislimi dhe Qamili (vëllezër), Haziz dhe Ilaz Shemsu (vëllezër), Shaban, Ramë dhe Hamdi Limani (vëllezër), Qamil, Alush dhe Rufat Jahia (vëllezër).

Hulumtues të kësaj plobe, nga këta përjetues të kësaj tragjedie, mësojnë se të vrarët, fëmija e fshatit i varrosën si dinë dhe mundën, por dikush natën “yrfija” për t’i humb gjurmët e krimit i rrafshon varret, megjithatë masakra nuk mbaroi me kaq, sepse të nesërmen (17 nëntor 1944), banorët sllavë (serb e maqedon) të fshatrave për rreth të pakënaqur me situatën, të armatosur deri në dhëmbë e sulmojnë Bllacën nën udhëheqjen e kriminelit Nikçe dhe Nikodin Urdareviqit, me qëllim që fshatin ta zhdukin nga faqja e dheut. Atë ditë nga dora e tyre vriten: Aziz Doçi me nipin e tij Rizanë, plaku Zyber Koka, e shoqja e Bajram Tushës, digjet me gjithë shtëpinë, pastaj vriten pleqtë: Minah Shehu, Daut Ferra, Myrteza Koka dhe Aze Lusjan, ndërsa Synan Luçi, supozohet se digjet së bashku me shtëpinë. Vlen të përmendet se gjatë kësaj ngjarjeje plaçkitet edhe e tërë pasuria e fshatarëve bllacas, si bagtia dhe çdo gjë që ishte e vlefshme. Populli që arrin të shpëtojë u strehua në male dhe nëpër familjet e tyre në Kosovë, ku qëndroi edhe një kohë deri sa u qetësua situata dhe u kthye në fshat përsëri, ku e filloi jetën prej në zero.³

Për masakrën e Bllacës dhe të disa fshatrave të tjerë të Karadakut, si dhe për keqbërjet e disa njësive të UNÇJ-ës, ndaj shqiptarëve në këtë kohë, njofton edhe Melihate Deda, në një letër dërguar Komitetit Krahinor të Kosovës, në dhjetor të vitit 1944, ku ndër të tjera e njofton këtë Komitet se si Komandantët e disa njësive të UNÇJ-së, që operonin në këtë territor, kishin dhënë urdhër të vrasin së paku 50% të shqiptarëve.

Edhe këtyre martirëve të kombit, populli liridashës i këtij fshati, Bllacës, në vitet e demokracisë i ngriti përmendore për t’i nderuar e kujtuar.

Për realizimin e porosit të dala nga elaboratet antishqiptare të Çubrilloviqit e të njerëzve si ai, vazhdojnë krimet ndaj popullsisë shqiptare në Karadak. Për vrasje

³ AM,F,LNÇ,K-58a,d.9127.Dr.Gjilani me rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore(1941-19450.Prishtinë,1998,f.227.Nga raporti i Shtabit të Brigadës XVI Maqedonase,15 korrig 1945.Qerim Lita,Bllaca në mesë dhembjes dhe krenarisë,Grup Autorësh,Shkup,2004,f.140-145.AIH-Sh,K.70,d.3806,f.4.Adnan Agai,Myhedin Sejfullai,Prishtinë,dhjetor 1990,f.13.AM,F,LNÇ,K-54a,d.6813.Muhijedin Sejfullai,Gjurmëve të masakrit në Blacë,Tribuna-SH,nr.2(I,II,III),Shkup,15 gusht 1993.

edhe më tej dallohet Brigada XVI, XVII dhe XVIII-të, të cilat gjatë muajve nëntor-dhjetor 1944 operuan gjithandej. Ato, herë veçmas e herë të bashkuar, nuk lanë lagje e fshat pa shkuar e pa shkretuar. Morën ç' gjetën të vlefshme, veshmbathje, ar me strajca e thasë, me kope kafshë. Të gjithë malësorët që i takuan: në rrugë, arë, mal, mulli, xhami, shtëpi, etj. i plaçkitën, i rrahën, i vranë ose i morën me vete, të cilët pastaj i masakruan, duke i detyruar që më parë t'i hapnin varret vetë, për vete. Shumë shtëpi i dogjën, banorët i lanë pa kullm mbi kokë, në arrati, me qëllim që të mos kishin më ku të kthehen.

Kështu veproi edhe Brigada XVII Maqedonase, e cila pas masakrës së Sopotit, kaloi në malësinë e Kumanovës. Pasi vrau të gjithë meshkujt që takoi në Runicë (12), në Allashec (16), në Izvor (14), në Bellanoc (3), e kështu me radhë, dhe dogji shumë shtëpi e të tjera pasuri, arrin në fshatin Iseukë të Malësisë së Preshevës, duke e vendosur Shtabin në shtëpinë e Nuhi Memishit, të cilin e shpërblyen me një plumb pushke. Për 12 ditë sa qëndruan aty, këta kësulëzi me yll të kuq në ballë, vranë rreth 100 shqiptarë të moshave të ndryshme, të cilët i varrosën të vdekur e gjysmë të gjallë në dy varre kolektive aty pranë shtëpisë së Zylfi Kamberit, e cila ishte shndërruar në kasaphanë të vërtetë.

Megjithëse për masakrën u hesht një kohë të gjatë, nuk u bisedua, s'u guxua, masakruesit nuk lanë shënime me qëllim që t'i humbin gjurmët e krimit, ndërsa ata që përjetuan masakrën pothuajse kanë vdekur. Hulumtues të kësaj tragjedie, nga të dhënat e disa anëtarëve të familjeve të masakruara, të Ahmet e Qemal Muratit dhe Sadri Sadriut, arritën t'i shënojnë këta emra: Miftar Murati me vëllezërlit Hajdarin, Sherifin dhe Arifin. Ky i fundit shpëtoi i plagosur, por iu vra djali Xhaviti, me të cilin ishte i lidhur me konop, nga fshati Stanec. Nga ky fshat u vranë edhe: Jetulla, Hamdi dhe Jakup Murati, Bektesh Asllani me të vëllanë Sylejmanin e kushëririn Ganiun; Sahit Asllani, Ajvaz Fazliu, me të bijtë Islamin e Eminin, Bajram Rexhepi, Sherif Ramadani e Muharrem Shaqiri nga fshati Lezbali; Isuf Ajeti me djemtë Muharremin e Ajetin nga lagja e Koreçve; Rexhep Lutfiu, Ramiz Arifi me të vëllanë Zenelin, Mehmet Ahmeti, Rashit Saqipi, nga Gruhalia, pastaj Bariu i Xhymës nga Maxheret; ndërsa nga fshati Iseukaj ku u krye masakra, u vranë: Rexhep Avdili me djemtë Rufatin, Mustafën e Ramadanin, si dhe kushërijtë Azemin e Hamzin, pastaj Shaqir Dauti, Murat Avdili, Memish e Qamil Memishi. Këtu u vra edhe Nuhi Caravajka, djali i Hajdar Caravajkës, emri i të cilit nuk u kujtohet bashkëbiseduesve. Aty u vranë edhe këta malësorë nga fshati Sefer: Isa Islami i Canëve, Ramiz Hajdini, Jetish Sylejmani, Sejdi Rexhepi, Rexhep Mehmet Ahmeti, Hajrulla Demiri, Hajredini (14) e Halil (12) Demiri (djem të Kamer Seferit, i pari kishte sytë e nxjerrë dhe një plumb në ballë, i dyti tri thika në shpinë), Shefki Shurdhani, nga Shurdhani, Qayim Veseli e Demir Kurtishi nga Kurbalia, Bajrami i Peçenës, Selimi i Mehajve me djalin Shaqirin, Rustemi dhe vëllai i Ramadanit të Lafetëve, Halit, Rustem, Sejdi e Ali Lutfiu nga Gruhalia etj. Këta janë vetëm disa nga emrat e shënuar nga hulumtuesit tanë, ndërsa të pa shënuar kanë mbetur dhe shumë emra të tjerë, të cilët duhet ndriçuar sa ma parë me qëllim që të mos fshihen nga kujtesa e popullit.

Masakra pati edhe në fshatra të tjerë, jo vetëm të Preshevës, por edhe të Bujanocit e të Gjilanit. Terrori antishqiptar i njësive të UNÇJ-së, e sidomos i

Brigadës XVII, qe aq i madh saqë edhe Miladin Popoviqi i dënoi ato. Në një letër që i dërgoi Titos në nëntor 1944, kërkon prej tij të ndalen masakrat që bëheshin nga Brigada XVII dhe Shtabi i saj të dënohet. Por një gjë e tillë nuk ndodhi, masakrat nuk u ndalën, ato vazhduan në të gjitha anët. Sipas të dhënave të deritanishme, e që mendohet se nuk janë të plota, ana e Preshevës ka pasur 600 viktima, e Bujanocit 500, e Gjilanit 8000, e Ferizajit 1200, e Kaçanikut 800, e Shkupit 1400, dhe e Kumanovës 700 viktima, nga këta “çlirimtarë”, sipas të cilave Gjilani zë vendin e parë. Këto masakra nuk janë të vetme në këto hapësira shqiptare. Mbi popullin e pafajshëm shqiptare, këtu masakra ka pasur edhe më vonë në kohën e Millosheviqit, e dhe më herët në kohën e Serbisë së parë. Për t’i ndriçuar mirëm këto ngjarje, kërkohet një angazhim më i madh, një studim i gjithanshëm dhe profesional, një Projekt Instituti.

EXHLALE DOBRUNA-SALIHU

PAJIMET PERSONALE TË GRUAS NË MONUMENTET MBIVARRORE TË DARDANISË NË KOHËN ROMAKE

Në monumentet mbivarrore të Dardanisë të tipit stele, gjatë periudhës romake, në mesin motiveve të shumta dekorative-simbolike paraqiten edhe motivet e pajimeve personale të gruas. Karakteristike është se ky grup motivesh përbën veçori të pjesës jugore, meqë, pos dy stelave nga pjesa veriore, *Timacum minus*-i (Ravna), hasen vetëm në stelat e arealit të *Scupi*-t (Zllokuqani te Shkupi), si një nga motivet më të zakonshme të objekteve nga fillimi i shek. II deri në kalimin e shk. III në të IV, që edhe është njëri ndër tiparet kryesorë të arealit të kësaj qendre dhe e tërë trevës së Dardanisë.

Të përbëra nga dy lloje të objekteve, përkatësisht mjeteve të përdorimit të përditshëm të gruas: tualetit dhe garderobës*, të cilat janë të pranishme në numër shumë të pabarabartë dhe rrallë herë hasen edhe së bashku, këto pajime paraqiten në një numër bukur të mirë stelash, ku edhe zënë një vend me rëndësi.

* * *

Mjetet e tualetit – pasqyra dhe krehri (*pecten et speculum*) janë të pranishme në numër shumë më të madh stelash. Ato hasen në kombinime të ndryshme dhe gadi gjithherë me motive të tjera: zakonisht këto janë objektet e përdorimit të përditshëm dhe motivet florale, ku një vend të veçantë e zë rozeta; paraqitjet figurative janë të rralla, të përbëra nga bustet e të ndjerëve dhe vetëm një herë nga skena e banketit mortor. Ato zakonisht skaliten në fushën kryesore relievore – më së shumti brenda saj dhe më rrallë në kornizë – ndërsa në raste shumë të rralla gjenden në pjesët tjera të stelës (mesfushë dhe xokol).

Pjesën më të madhe të tyre e përbën paraqitja e pasqyrës dhe e krehrit së bashku, gjithmonë duke zënë vend në fushën kryesore të stelës. Këto stela vijnë vetëm nga pjesa jugore. Te pesë ekzemplarë janë në kombinim me motivet

* Mjetet e punëdorës do të jenë objekt trajtimi në kuadër të një punimi të veçantë.

dekorative-simbolike: te tre sosh¹ – nga Banjani, Draçeva (fig. 1) dhe Mirkovci (fig. 2) – me rozetën; te dy ekzemplarët e tjerë me mjetet e punëdorës së gruas – në stelën tjetër nga Draçeva² (fig. 3) me shportë, kurse në stelën nga Vuçidolli³ me enë dhe një objekt të paqartë, ndoshta boshtin. Vetëm te dy ekzemplarë nga Çuçeri⁴ (fig. 4) dhe Shkupi gjenden pranë portreteve të të ndjerave; në ekzemplarën e Shkupit janë në vendet akroteriale, në mes të të cilave gjendet girlanda⁵.

Në më pak raste paraqitet pasqyra pa krehër. Karakteristike është skalitja e saj në vende të ndryshme të stelës dhe, pos një rasti, po ashtu është në kombinim me motivet dekorative-simbolike. Nga pjesa jugore janë tre ekzemplarë. Te dy sosh është e paraqitur me objektet e natyrës tjetër të përdorimit të përditshëm dhe rozetës në fronton: në stelën nga Mirkovci⁶ (fig. 5) me një vegël gjendet në mesfushë, kurse në stelën nga Llopati⁷ (fig. 6), e cila paraqet ekzemplarën e vetëm të monumentit të këtij areali me skalitje të pajimeve të gruas dhe në përgjithësi të instrumenteve shtëpiake, gjendet në pjesën e sipërme të stelës, në qendër të fushës gjysmërrethore (*lunetta*) në mes ulëses dhe gotës; te ekzemplari i tretë, i cili është nga Shkupi⁸ (fig. 7), gjendet në fushën kryesore pranë skenës së banketit mortor, së bashku po ashtu me ulësen dhe enën. Ekzemplarët tjerë i përbëjnë të dy stelat nga Timak minusi⁹, te të cilat gjendet në xokolin e dekoruar me vazon (enën) nga e cila del hardhia e rrushit; në njërën është me gotën (fig. 8), ndërsa në tjetrën vetëm.

Në raste të rralla, gjithsej tri, është paraqitur krehri pa pasqyrë. Ngjashëm me pasqyrën gjendet në vende të ndryshme të stelës, gjithmonë i kombinuar me objekte të ndryshme të përditshmërisë. Te dy ekzemplarë është skalitur në fushën kryesore relievore me bustet e të ndjerëve: në stelën nga Dimci¹⁰ (fig. 9), të kornizuar me motivin e hardhisë me vile rrushi dhe gjethe urthi, së bashku me dy mjete të punëdorës (boshtin dhe furkën) gjendet në kornizë, ndërsa në stelën nga

¹ Vulić, N., 1931, 202, n. 531, 213-214, n. 569; Čremošnik, I., 1958, 10, fig. 4; Dragojević-Josifovska, B., 1982, 123, n. 122, 138, n. 146; Dobruna-Saliu, E., 2003-2005, 632, n. 7, T. 4, fig. 7, 658-659, nn. 53-54, T. 29, figg. 47, 48.

² Dragojević-Josifovska, B., 1982, 128, n. 131; Dobruna-Saliu, E., 2003-2005, 660, n. 55, T. 27, fig. 49.

³ Vulić, N., 1931, 209, n. 554; Dobruna-Saliu, E., 2003-2005, 661, n. 56.

⁴ Vulić, N., 1931, 216, n. 580; Dragojević-Josifovska, B., 105-106, n. 92; Dobruna-Saliu, E., 2003-2005, 666-667, n. 67, T. 32, fig. 60..

⁵ Dragojević-Josifovska, B., 1982, 125, n. 125; Dobruna-Saliu, E., 2003-2005, 716, n. 142, T. 73, fig. 133.

⁶ Vulić, N., 1931, 214, n. 570; Čremošnik, I., 1958, 10; Dobruna-Saliu, E., 2003-2005, 679, n. 83, T. 41, fig. 75.

⁷ Dragojević-Josifovska, B., 1982, 172-173, n. 225; Dobruna-Saliu, E., 2003-2005, 752, n. 198, T. 96, fig. 178.

⁸ Vulić, N., 1941-48, 217, n. 429; Dragojević-Josifovska, B., 1982, 121, n. 118; Dobruna-Saliu, E., 2003-2005, 762, n. 218, T. 105, fig. 192.

⁹ Vulić, N., 1909, 159 C; Petrović, P., 1995, 117-118, n. 81; 127, n. 97; Dobruna-Saliu, E., 2003-2005, 776-777, n. 250, T. 115, fig. 218, 782, n. 261

¹⁰ Čremošnik, I., 1958, 8, fig. 2; Dragojević-Josifovska, B., 1982, 144, n. 158.

Shkupi¹¹ (fig. 10), në kornizën e së cilës janë paraqitur veglat, është skalitur brenda fushës së bashku me sandale. Kurse në ekzemplarën e tretë, stelën e fragmentuar nga Bardovci¹², së bashku me grykën e një ene dhe ndoshta boshtin gjendet në xokol.

Objektet e garderobës – sandalet (*calceus*) përbëjnë të vetmin element. Deri më tash ato hasen vetëm në stelën e cekur nga Shkupi në kombinim me krehrin¹³.

Përkitazi me mënyrën e punimit të këtyre motiveve të të dy llojeve të pajimeve, mund të konstatojmë se shumica e tyre është punë e mjeshtërve jo të shkathët, meqë në të shumtën e rasteve janë mjaft të skematizuara dhe të stilizuara, si dhe në reliev tejet të cekët, i cili nganjëherë duket si gravurë e vërtetë (fig. 3, 10). Pasqyra zakonisht është e përmasave të mëdha, ku në ekzemplarët nga Llopati dhe Shkupi (fig. 6, 7) është e ekzagjeruar, duke marrë edhe pamje jo të natyrshme. Mirëpo në mesin e këtyre ekzemplarëve mund të gjenden edhe sish që me trajtimin e tyre dallojnë, ku sidomos veçohen dy stela: nga Draçeva (fig. 1) dhe Mirkovci (fig. 2), të cilat pasqyra me krehrin janë punura mjaft bukur dhe natyrshëm me dimensione reale, që flasin për dorën e mjeshtrit të talentuar i cili u ka kushtuar mjaft kujdes. Kurse sandalet janë të përmasave shumë të vogla, miniaturale.

Në trevat fqinje të Dardanisë stelat dhe tipat e tjerë të monumenteve mbivarrore me këto motive janë mjaft të rralla; diçka më të vërejtura janë po ashtu ato të mjeteve të tualetit, të cilat herë-herë hasen së bashku me sandale. Përrjashtim bën vetëm pjesa perëndimore e provincës së Maqedonisë dhe pjesa veriore e provincës së Epirit – territori i Ilirisë së lashtë të Jugut (Shqipëria e sotme), ku monumentet me paraqitje të pasqyrës, krehrin, mjeteve tjera të tualetit dhe objekteve të garderobës (sandale dhe çanta) janë të pranishme si në qendrat e njohura bregdetare, *Dyrrhachium* dhe *Apolloni*¹⁴, ashtu edhe në prapatokë, në mjedisin rural gjatë antikitetit të vonë, në të cilat sandalet janë mjaft glomaze¹⁵. Nga Dyrrahu kemi edhe dy ekzemplarë të stelave figurative të cilat e ndjera në dorën e ngritur lart mban pasqyrën¹⁶. Përkundrazi në pjesën veriore të Maqedonisë¹⁷ dhe në trevën tjetër ilire të provincës së Dalmacisë paraqitet e tilla janë shumë pak të njohura. Nga pjesa bregdetare e kësaj të fundit, deri tash, dy monumente vijnë nga Salona; në frizin e njëres stelë janë paraqitur mjete të

¹¹ Dragojević-Josifovska, B., 1982, 116, n. 110.

¹² Vulić, N., 1931, 206, n. 543.

¹³ Sandalet në trevën dardane janë të pranishme edhe në një monument të një kategorie tjetër të monumenteve nga pjesa qendrore (Kosova), të gjetur në Kamenicë, ku janë paraqitur në kuadër të një skene të ritualit mortor të një mashkulli, khr. Dobruna-Salihi, E., 2005, 200, fig. 1. Ato këtu sa mund të jenë të lidhura me dedikanten, aq mund të jenë të lidhura me të ndjerin në shenjë të pavdeksisë (përjetësisë). Për simbolizmin e sandaleve në këtë kontekst khr. Baldrian, F., 1987, 792.

¹⁴ Ceka, N., 1982, 142 me foto; Koch, G., 1989, 155, fig. 6; Tartari, F., 1997, 248-249, T. 4, figs. 21, 25, T. 5, fig. 28, T. 6, fig. 36.

¹⁵ Komata, D., 1989, 221-222, figs. 2 b, 4.

¹⁶ Toçi, V., 1962, 116-117, fig. 59; Tartari, F., 1997, 245, T. 2, fig. 3, 8.

¹⁷ Vulić, N., 1931, 27-28, n. 53.

ndryshme të tualetit dhe objekte të natyrës tjetër të përditshmërisë së gruas, kurse në një sarkofag figurativ të importuar nga Azia e Vogël është paraqitur një pasqyrë¹⁸. Nga provincat e tjera fqinje, në atë të Mezisë së Epërme, jashtë Dardanisë, po ashtu kemi gjithsej dy stela ku janë paraqitur në fronton: njëra nga *Singidunum*-i (Beogradi) me pasqyrë, arkë për këto pajime dhe sandale, dhe tjetra nga *Ratiaria* (Arçari) me pasqyrë në qendër të kurores¹⁹. Pasqyra pa krehër është paraqitur edhe në dy stela nga Dakia e Poshtme²⁰, ndërsa diçka më e shpeshtë është në Mezi të Poshtme, ku në qendrat bregdetare, kolonitë e dikurshme greke, është paraqitur së bashku me krehër në skenën e banketit mortor²¹. Nga trevat e largëta do veçuar stelën nga *Pisa* (Piza) në Italinë e Veriut, në të cilën së bashku janë paraqitur pasqyra, krehri, disa mjete tjera të tualetit dhe sandalet²². Po në këtë rajon të Italisë, në Akuile²³, dhe në provincat e Norikut²⁴ dhe të Galisë²⁵ shumë herë janë dëshmuar ekzemplarë stelash me paraqitje të grave me pasqyrë.

Përkundrazi, në Lindje, në Azi të Vogël, posaçërisht në Frigji, kjo mënyrë e dekorimit të monumenteve mbivarrorë gjatë shek. II dhe III është shumë e zakonshme; të gjitha ato motive që janë të njohura në stelat tona paraqiten këtu, por shumë më të pasura, në kombinime të ndryshme dhe në pjesë të ndryshme të stelës, vetëm – siç zakonisht i hasim te stelat në trajtë të dyerve – ose me portrete, kurse më rrallë me banketin mortor, ku disa herë gjejmë edhe analogji të drejtpërdrejta me ekzemplarët tanë. Te mjetet e tualetit, pasqyra dhe krehri rrallëherë janë vetëm²⁶, kurse më shpesh në kombinim me objektet e tjera, ku një vend i veçantë u takon pajimeve të punëdores – me të gjitha objektet së bashku, ose veçmas²⁷ nga të cilët te dy ekzemplarë, ngjashëm me ekzemplarin tonë nga Draçeva (fig. 3), janë paraqitur vetëm me shportën²⁸. Në disa raste me krehrin dhe pasqyrën paraqiten

¹⁸ Rinaldi Tufi, S., 1971, 114, n. 46, Pl. 12, fig. 2; Cambi, N. – Marović, I. – Nikolanci, M. – Rapanić, Ž., 1973, 10-13, n. 14, T. 3, 16, n. 19.

¹⁹ Dimitrov, D. P., 1942, 30, T. 1, fig. 2/31 (nga *Ratiaria*); Kondić, V., 1968, 272-275, 273, fig. 3 (nga *Singiduni*).

²⁰ Florescu, Gr., 1942, 22, fig. 7, 26, fig. 11.

²¹ Dimitrov, D. P., 1942, 42, T. 2, fig. 5/70, 50, T. 14, fig. 51/107, 27, T. 15, figs. 54/20, 55/21, 49, T. 29, fig. 101; Bordenache, G., 1965, 276, fig. 26; Pfuhl, E. – Möbius, H., 1979, T. 254, fig. 1759.

²² Dimitrov, D. P., 1942a, 362, fig. 18.

²³ Scrinari, V. S. M., 1972, 129, fig. 368.

²⁴ Piccottini, G., 1977, 20-22, T. 5, figs. 187-190, 24-25, T. 7, figs. 194-197.

²⁵ Espérandieu, E., 1908, 178, n. 1160; Braemer, F., 1959, T. 6, figs. 20, 22, 48, 49.

²⁶ MAMA 6, 1939, T. 49, fig. 276; Pfuhl, E. – Möbius, H., 1977, T. 77, fig. 275; idem, 1979, T. 171, fig. 1138. Në dy ekzemplarët e fundit gjendet në xokol, kurse mbi, në edikulë, janë paraqitur figurat çiftit bashkëshortr në këmbë.

²⁷ Keil, J. – Premierstein, v. A., 1911, 139, figs. 84-86 (nga Lidia); Miltner, F., 1937, 54-56, n. 60, fig. 33, 58-62, n. 63, fig. 37; MAMA 6, T. 49, figs. 277-279, T. 51, figs. 284, 288, T. 64, fig. 368; Pfuhl, E. – Möbius, H., 1977, T. 71, fig. 427, idem, 1979, T. 172, fig. 1136 (nga Frigja).

²⁸ Buckler, W. H. – Calder, W. M. – Cox, C. W. M., 1925, 145-146, n. 128, fig. 66 (nga Frigja); Pfuhl – Möbius, 1979, T. 292, fig. 2018 (nga Bitinia).

edhe sandalet dhe objektet e tjera të përditshme që i përkasin gruas²⁹. Mirëpo, në të shumtën e rasteve pasqyra paraqitet pa krehër, por shumë rrallë vetëm³⁰, e më shpesh me objekte të tjera të tualetit dhe atyre të natyrës tjetër, sidomos të punëdorës³¹, siç mund të jetë e paraqitur edhe vetëm me boshtin dhe furkën, ose vetëm me shportën³². Krehëri shumë rrallë haset pa pasqyrë, ku në dy raste, ngjashëm me stelën nga Dimci (fig. 9) gjendet së bashku me boshtin dhe furkën, por me dallim të paraqitjes së tyre si dekorim i vetëm në një pjesë të caktuar të stelës³³. Megjithatë, në mesin e të gjithë ekzemplarëve me paraqitje të mjeteve të tualetit dy stela janë shumë të ngjashme me stelën nga Shkupi (fig. 7): në njërën nga *Hierapolis*-i (Pamukkale) (shek. III) pranë skenës së banketit mortor është paraqitur pasqyra vetëm në këndin e sipërm të djathtë³⁴, kurse në stelën tjetër nga *Cyzic*-u (Bandirma), të njëkohshme me ekzemplarin tonë, pranë skenës së banketit mortor është paraqitur shërbëtorja me pasqyrë, ndërsa pranë Klinës një grua e ulur në një ulëse të ngjashme me atë të stelës sonë³⁵. Është karakteristike që së bashku me objektet e tualetit dhe të gardërobës së gruas në disa raste janë paraqitur edhe veglat e punës, shumë shpesh kosorja³⁶, ngjashëm me ekzemplarin tomë nga Shkupi (fig. 10), kurse shumë rrallë llojet e tjera³⁷.

Prototipin e këtyre motiveve në monumentet mbivarrore në përgjithësi do kërkuar në Greqi, ku gra me pasqyrë paraqiten në stelat atike të kohës klasike³⁸. Prandaj, mund të themi se, paraqitja e pasqyrës dhe në përgjithësi e pajimeve të tualetit dhe të gardërobës e ka origjinën në Greqi, ku ishte e lidhur ngushtë me të ndjerën. Mirëpo, në formën që këto motive paraqiten në kohën romake janë karakteristike vetëm për Azi të Vogël, sidomos Frigji, ku konsiderohen vetëm të natyrës dekorative, Kështu prejardhjen e paraqitjeve të tyre edhe në stelat e Dardanisë do kërkuar pra në Azi të Vogël, padyshim nëpërmjet të ardhurve nga ky territor, të cilët kanë luajtur një rol si në bartjen e tipit të stelës me nishe

²⁹ MAMA 5, 1937, T. 21, fig. 41 (1), 42, T. 22, fig. 44 (1).

³⁰ MAMA 5, 1937, T. 6, fig. 24. Këtu gjendet në mes të portreteve të çiftit bashkëshortor.

³¹ Mendel, G., 1909, 324, fig. 37; Miltner, F., 1937, 52-53, n. 56, fig. 30, 56-57, n. 60, fig. 34; Buckler, W. H. – Calder, W. M. – Cox, C. W. M., 1925, 174-175, n. 168, fig. 93; MAMA 5, 1937, T. 21, fig. 40 (1), T. 58, fig. 282; Pfuhl, E. – Möbius, H., 1979, T. 307, fig. 2146, T. 323, figs. 2287, 2289.

³² MAMA 6, 1939, T. 63, fig. 362 (me shportë); Pfuhl, E. – Möbius, H., 1977, T. 86, fig. 548 (me bosht dhe furkë).

³³ Miltner, F., 1937, 55, n. 60, fig. 33 (në pjesën e sipërme të shtyllës së stelës figurative); MAMA 6, 1939, T. 61, fig. 355 (në frontonin e stelës në trajtë të dymve).

³⁴ Pfuhl, E. – Möbius, H., 1979, T. 258, fig. 1787.

³⁵ Pfuhl, E., – Möbius, H., 1979, T. 172, fig. 1142.

³⁶ Keil, J. – Premierstein, v. A., 1911, 139, fig. 86 (nga Lidia); MAMA 5, 1937, T. 22, fig. 44 (1); MAMA 6, 1939, fig. 277; Pfuhl, E. – Möbius, H., 1979, T. 172, fig. 1136 (nga Frigjia).

³⁷ Miltner, F., 1937, 60-63, n. 64, fig. 38; MAMA 6, 1939, T. 49, fig. 278.

³⁸ Conze, A., 1893, T. 48, n. 157, T. 76, fig. 310 e tutje; Johansen Friis, K., 1951, 38, fig. 19.

pesëkëndëshe³⁹, ashtu edhe në bartjen e motiveve tjera. Megjithëse legjionet kishin një ndikim mbizotërues, sidomos legjioni VII i Klaudit, qoftë ushtarët aktivë, qoftë veteranët e vendosur, një rol mjaft të rëndësishëm e kanë pasur edhe civilët e ardhur – tregtarët dhe skllevërit, siç dëshmojnë dedikantët në ekzemplarët tanë, nga të cilët bashkëshorti i së ndjerës në stelën nga Draçeva (fig. 3) i takonte klasës së të liruarve.

Duke marrë parasysh që të gjithë ekzemplarët e stelave me këto motive u janë përkushtuar grave, ndërsa vetëm në dy raste bashkëshortëve (fig. 3, 10) të cilat në rastin e ekzemplarëve nga Draçeva (fig. 1) dhe Shkupi janë të liruara, si dhe ka indikacione edhe në rastin e stelës nga Llopati⁴⁰, mund të thuhet se ato ishin të lidhura me të ndjerat. Të njëjtën gjë e dëshmojnë edhe stelat e cekura të përkushtuara grave në ambientin rural të Shqipërisë së sotme⁴¹, e që, sidomos, të gjithë këta ekzemplarë i ilustron stela e cekur nga Pisa me atributet e ndara të gruas (objektet e tualetit e te garderobes) dhe të burrit (veglat). Prandaj, në rastin tonë, si mjetet e tualetit, ashtu edhe ai i gardërobës – sandalet, gjithsesi kanë domethënie simbolike.

Përkitazi me etnitetin e personave të këtyre monumenteve, antroponima e tyre është e ndryshme: greke, latine dhe vendëse. Megjithëse përkatësia gjuhësore e emrit nuk do të thotë se e përcakton gjithmonë entitetin e bartësit të tij⁴², këta më së shumti ishin persona nga Lindja, qoftë me emra grekë, qoftë latinë, ndërsa dukshëm më pak vendës, siç e dëshmojnë stelat nga Shkupi dhe Dimci (fig. 7, 9) dhe mund të bëhet edhe dy stelat nga Draçeva (fig. 1, 3)⁴³.

* * *

Nga kjo që trajtuam këtu mund të konkludojmë se paraqitjet e pajimeve personale të gruas në monumentet mbivarrore të Dardanisë, sidomos të pjesës qendrore – përkundër gjetjeve të mjeteve të tualetit që herët në kontekstin e varrimit (inventar i varreve), siç është zbulimi i dorezës në formë të figurës së femrës lakuriqe të pasqyrës së bronzit në Kosovë nga gjysma e dytë e shk. 5 para Kr., (fig. 11)⁴⁴ e cila dëshmoi përdorimin e hershëm të pasqyrës në trevën dardane – nuk gjetën aplikim të gjerë te popullsia vendase, që flet për konservatizmin e madh të saj. Kjo në të vërtetë ishte edhe arsyeja e koncentrimit të tyre kryesisht në koloninë e Skupit.

³⁹ Khr. Čremošnik, I., 1958, 10-12; Dobruna-Salihu, E., 2003-2005, 87.

⁴⁰ Khr. Dragojević-Josifovska, B., 1982, 173.

⁴¹ Khr. shën. 15.

⁴² Alföldy, G., 1969, 17.

⁴³ Dobruna-Salihu, E., 2006, 54-55.

⁴⁴ Khr. Popović, Lj., 1956, 1-13, T. 1, 2.

SHKURTESAT

IMS by F.	Inscriptions de la Mésie Supérieure, ed. Papazoglou, Beograd
MAMA ed.	Monumenta Asiae Minoris Antiqua, 1-8, by W. M. Calder, Manchester University
Press Spomenik SKA, SANU nauka	Spomenik Srpske (kraljevske) akademije i umetnosti, Beograd

LITERATURA

- Alföldy, G., 1969 – *Die Personennamen in der römischen Provinz Dalmatia*, Heidelberg.
- Baldrian, F., 1987 – *Taoism*, Encyclopedia of Religion, New York
- Bordenache, G., 1965 – *Temi e motive della plastica funeraria di età Romana nella Moesia Superior*, Dacia, 9, București, 253-281.
- Buckler, W. H. - Calder, W. M. - Cox, C. W. M., 1925 – *Asia Minor 1924*. 2. Monuments from Cotiaum, Journal of Roman Studies 15, London, 141-175.
- Braemer F, 1959 - *Les stèles funéraires à personnages de Bordeaux I-III siècles*, Paris.
- Cambi, N. - Marović, I. - Nikolanci, M. - Rapanić, Ž., 1973 – *Vodič Arheološkog muzeja u Splitu*, Split.
- Ceka, N., 1982 – *Apolonia e Ilirisë*, Tiranë.
- Conze, A., 1893 – *Die attischen Grabreliefs*, 1, Berlin-Leipzig.
- Čremošnik, I., 1958 – *Na granici kulture Rima i Grčke, Antički spomenici sjeverne Makedonije*, Tkalčićev Zbornik, 2, Zagreb, 7-16.
- Dimitrov, D. P., 1942 – *Nadgrobnite ploči ot rimsko vreme v Severoistočna Makedonija*, Sofija.
- Dimitrov, D. P., 1942a – *Belomorski pregled*, 1, Sofia 362.
- Dobruna-Salihu, E., 2003-2005 – *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake. Sepulkrale dhe e kultit*, Prishtinë.
- Dobruna-Salihu, E., 2005 – *Newly discovered funerary monuments in Kosova presenting the funeral ritual among the Dardanians in the Roman period*, Illyrica antiqua – Ob honorem Duje Rendić-Miočević, Zagreb, 199-209.
- Dobruna-Salihu, E., 2006 – *Prikaz ženskog pribora i orudja na nadgrobnim spomenicima rimskog doba u Dardaniji*, Histria Antiqua 14, Pula, 49-62.
- Dragojević-Josifovska, B., 1982 – *Scupi et la région de Kumanovo*, IMS, 6.
- Espérandieu, E., 1908, 1911 – *Recueil general des bas-reliefs, statues et bustes de la gaule romaine*, 2, 3, Paris et Bruxelles.
- Florescu, Gr., 1942 – *I monumenti funerari romani della Dacia Inferior*, București.

- Johansen Friis, K., 1951 – *The attic Grave-Reliefs of the Classical Period*, Copenhagen.
- Keil, J. - Premerstein, A. von., 1911 – *Bericht über eine zweite Reise in Lydien*, Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften – Philozophisch-historische Classe 54, Wien.
- Koch, G., 1989 – *Grabdenkmäler der römischen kaiserzeit in Albanien*, Iliria, 2, Tiranë, 151-159.
- Komata, D., 1989 – *Veprat e artit provincial ilir në ekspozitën e Hildeshajmit*, Iliria, 2, Tiranë, 219-228.
- Kondić, V., 1968 – *Novi podaci o orijentalnom elementu u Singidunumu*, Živa antika 18/2, Skopje, 267-277.
- MAMA 5 1937.
- MAMA 6 1939.
- Mendel, G., 1909 – *Catalogue des monuments grecques, romaines et Byzantines du Musée Impérial Ottoman de Brousse*, Bulletin de correspondance hellénique 33, Athenes-Paris, 245-435.
- Miltner, F., 1937 – *Epigraphische Nachlese in Ankara*, Jahreshefte des Österreichischen Archäologischen Instituts, Bb, 30, Wien, 8-65.
- Petrović, P., 1995 – *Timacum minus et la vallée du Timok*, IMS, 3/2.
- Phful, E. – Möbius, H., 1977-1979 – *Die östgriechischen Grabreliefs*, 1-2, Mainz.
- Piccottini, G., 1977 – *Die Dienerinnen und Dienerreliefs des Stadtgebietes von Virunum*, Corpus Signorum Imperii Romani 2/3, Österreich.
- Popović, Lj., 1956 – *Jedna antička replika sa Kosova*, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije I, Prishtinë, 1-13.
- Rinaldi Tufi, S., 1971 – *Stele funerarie con ritrati di età romana nel Museo Archeologico di Spalato. Saggio di una tipologia strutturale*, Atti della Accademia Nazionale dei Lincei-Memorie, 318/8, 16, 3, Roma,
- Scrinari, V. S. M., 1972 – *Catalogo delle sculture romane, Museo archeologico di Aquileia*, Roma.
- Tartari, F., 1997 – *Monumente funerare të shekujve I-IV të e.s sonë nga Durrësi*, Iliria, 1-2, Tiranë, 243-268.
- Toçi, V., 1962 – *Mbishkrime e relieve nga nekropoli i Dyrrahit*, Buletin i Univerzitetit shtetëror të Tiranës - Seria shkencat shoqërore 2 (16), Tiranë 70-136.
- Vulić, N., 1909 – *Antički spomenici u Srbiji*, Spomenik SKA 47 (39), 109-191.
- Vulić, N., 1931 – *Antički spomenici naše zemlje*, Spomenik SKA 71 (55).
- Vulić, N., 1941-1948 – *Antički spomenici naše zemlje*, Spomenik SANU 89 (77).



Fig. 1



Fig. 2



Fig. 3



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7




Fig. 8



Fig. 9



Fig. 10




Fig. 11

NURIDIN AHMETI

FEJA DHE PRIJËSIT FETARË NË LËVIZJEN KOMBËTARE SHQIPTARE SIPAS GAZETËS “SHKUPI” (1911–1912)

“Nji millet pa nji Fee, edhe nuk o duk permi faqe t’okes, e nuk e di se si kish me ken, me ja nis na; prandej un kishem me dasht me than pa Hoxhallar e Priften t’mir, mos na le, o Zot”¹.

Hyrje

Në fazën më dinamike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, numrit të gazetave të publicistikës sonë do t’i shtohet edhe një gazetë e njohur me emrin e njërës nga kryeqendrat e shqiptareve “Shkupi”, e cila, përveç tjerash, në faqet e saj vinte në pah edhe rolin e prijësve fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Pikërisht kjo tematikë e gazetës “Shkupi” përbën edhe subjektin e punimit tonë.

Janë disa arsyeje pse ne e kemi trajtuar këtë problematikë:

E para – është njëra prej gazetave të kësaj periudhe që më së shumti i kushtoi kujdes dhe i dha hapësirë unitetit fetar të shqiptarëve.

E dyta – një pjesë e konsiderueshme e gazetave të kohës në gjuhën shqipe, thënies së Pashko Vasës “*Feja e shqiptarit është shqiptaria*”, i dhanë konotacion negativ, duke shkruar negativisht për veprimtarinë e klerikëve, pa dallim feje, duke anashkaluar edhe ato figura të njohura tanimë për veprimtarinë e tyre shpirtërore e kombëtare.²

E treta - në kohën e sistemi monist në Shqipëri u botuan dy vëllime për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, me përmbledhje artikujsh nga shtypi, duke përzgjedhur vetëm ata artikuj që kishin të bënin kundër fesë dhe prijësve tanë fetarë, dhe u anashkaluan ata artikuj të gazetave, ku trajtohej objektivisht roli i fesë dhe prijësve tanë fetarë.

E katërta – për dallim prej disa gazetave të tjera që shkruanin kundër disa prijësve fetarë dhe fesë, në gazetën “Shkupi” nuk do të gjejmë asnjë artikull të

¹ “Shkupi”, nr. 8, 22 tetor, Uskup, 1911, f. 2.

² Për shkrimet e gazetave shqiptare të kohës kundër krerëve fetarë, myslimanë, katolikë, ortodoksë, shih: *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Vëllimi I (1879-1908), Universiteti i Tiranës – Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, (Përgatiti: Zihni Haskaj), Tiranë, 1971, f. 305 - 329; *Mendimi politiko-shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Vëllimi II (1908-1910), Akademia e Shkencave e RP së Shqipërisë – Instituti i Historisë, (Përgatiti: Zihni Haskaj), Tiranë, 1976, f. 495 – 552

shkruar kundër tyre, por çështjen fetare të shqiptarët kjo gazetë e sheh si të domosdoshme në shoqërinë tonë dhe kontributin e prijësve fetarë në çështjen kombëtare si mjaft domethënës.

E pesta – kjo gazetë me së miri pasqyron rolin e fesë dhe kontributin e prijësve tanë fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.

E gjashta – një propagandë e tillë kundër prijësve fetarë, për mendimin tonë, edhe pse kanë kaluar më shumë se njëqind vjet qëkur janë botuar këto shkrime, është aktuale edhe sot.

Dy fjalë për gazetën "Shkupi"

Numri i parë i gazetës "Shkupi" botohet më 29 gusht të vitit 1911. Gjithsej kanë dalë 34 numra. Deri në vitin 1912, gazeta botohej në Shkup dhe drejtues ishte Jashar Erbara,³ kurse vendimi për daljen e kësaj gazete u mor në Kongresin e Dytë të Manastirit më 2 prill të vitit 1910, si propozim i Rexhep Mitrovicës.⁴

Kjo gazetë botohej në dy gjuhë: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën turke. Ishte gazetë javore dhe botohej në katër faqe, vëllim ky i zakonshëm për kohën kur dilnin këto gazeta. Ajo trajtoi problematika të ndryshe të kohës, sidomos ato që lidheshin me fatin e popullit shqiptar. Kjo dëshmohej edhe nga motoja që në numrin e parë, të vendosur nga drejtuesit e gazetës duke treguar se gazeta "*Prun interesat e kombit*"⁵. Drejtuesit i qëndruan besnikë kësaj motoje deri në numrin e fundit.

Që në numrin e parë drejtuesit e gazetës i bëjnë të ditura qëllimet e tyre përmes një shkrimi të titulluar: "*Epame me udhë ti thomi kto pake fiale si parathënie*"⁶.

Drejtuesit e gazetës, të drejtat e tyre të realizueshme i shihnin vetëm në bashkërendim me Perandorinë Osmane: "Po me shpirt e trupe të pa ndamune nga mretëria t'on e lumtur, ku ka mbi se 500 vjete që rojme dhe të miren e të keqen e kemi nda dhe dot a ndajme sot e tutje ma mire me shpres të Perendisë"⁷.

Ata, përmes gazetës, në forma të ndryshme ia bëjnë me dije Perandorisë Osmane në këtë kohë se të drejtat e tyre për gjuhën shqipe duhet të merren

³ Jashar Erbara (1872 – 1953) – veprimtar i arsimit dhe kulturës kombëtare, organizator i shoqërive, klubeve e komiteteve patriotike, publicist. Mësimet e para për gjuhën shqipe i mori privatisht nga atdhetari S. Najdeni, mbaroi gjimnazin e Manastirit dhe më pas ndoqi mësimet në shkollën normale "Drita" në Bukuresht. Ishte njëri nga nismëtarët e shoqërisë "Drita" të Bukureshtit, ku botoi një numër librash në gjuhën shqipe. Së bashku me Dervish Himen botoi gazetën "Pavarësia e Shqipnisë" (1900) dhe "Biblioteka Zëri i Shqipërisë", "Albania", e cila ka dalë në Beograd gjatë viteve 1902 – 1906. Themeloi Klubin shqiptar të Kumanovës më 1909. Përgatiti një abetare me titull: "Për një javë, shqipen e mëson". Në vitin 1924 – 1939 ishte deputet në Parlamentin shqiptar. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 1*, ASHAK, Tiranë, 2009, f. 610.

⁴ 100 vjetori i gazetës "Shkupi" (dokumente), Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Shkup, 2011, f. 6.

⁵ "Shkupi", nr. 1, 29 gusht, Uskup, 1911, f. 1.

⁶ Po aty.

⁷ Po aty.

parasysh me qëllim që “të kthehet prape ajo armonia e vjeter ne mes t’one..., se ndryshe do na haja morteja tu dyve, se fqine te “ beses qi kemi” reth e rotulle, ku gjalmat i bojne litar, prej pamareveshjes ne mest t’one”⁸.

Dhe krejt në fund të këtij vështrimi, redaksia shpreh dëshirat e shqiptarëve se këta janë për: “Dituni – mesim në gjuhen e vet, se kjo eshte ma e shkurta ruge perme u bo njeres sivilize dhe me kuptu interesin e vertet te dy palezet, qi veç se me kretinin t’on Osmanli s’ka rojtje sod ndryshe”⁹.

Gazeta kishte një numër të konsiderueshëm të bashkëpunëtorëve, përmes shkrimeve, kontribuonin për një mbarëvajtje sa më të mirë, një pjesë e tyre shkruan edhe me pseudonime. Por, ajo që duhet veçuar, është se kjo gazetë që “publikimi i parë periodik në gjuhën shqipe në Kosovë”¹⁰.

Feja dhe prijësit fetarë

Në kuadër të botimeve që janë publikuar për historinë e shtypit tek shqiptarët, autorët si: Sherafedin Hoxha¹¹, Blendi Feziu¹², Hamit Boriçi – Mark Marku¹³, nuk kanë lënë pa e përmendur edhe këtë gazetë dhe për të janë botuar edhe materiale përmbledhëse¹⁴, por studimin më gjithëpërfshirës për të e ka shkruar Muhamet Pirraku.¹⁵

Në studimet e lartcekura, për trajtimin që kjo gazetë i bënë fesë, si një element i çmuar te shqiptarët, duhet veçuar botimi i autorëve Hamit Boriçi – Mark Marku¹⁶, derisa autorët e tjerë nuk e përmendin fare, pavarësisht se në faqet e kësaj gazete gjejmë shkrime të tilla.

Pothuajse, nga numrat e parë të daljes së kësaj gazetë hasim shkrime, të cilat mundohen të japin mesazhe për mosndarje fetare te shqiptarët dhe tendencat e disave që pjesëtarët e fesë islame në Shqipëri t’i quajnë si turq, katolikët si latinë dhe ortodoksët si grekë, iu përgjigjet përmes një artikulli: “Muhamedan e tyrk, katolik e llatin, ortodoks e shqja”, duke sjellë argumente të mjaftueshme se shqiptarët “te ton, sikurse edhe Muhmedant e Shqipniis, njashtu edhe katolikt, jon Shçyptar”¹⁷.

⁸ *Po aty*, f. 1 - 2.

⁹ “Shkupi”, nr. 1, 29 gusht, Uskup, 1911, f. 2.

¹⁰ Sherafedin Hoxha, *Shtypi i kombeve dhe kombësive të Kosovës 1871 – 1983*, Rilindja, Prishtinë, 1987, f. 67.

¹¹ *Po aty*, f. 67 – 69.

¹² Blendi Feziu, *Histori e shtypit shqiptar 1848 – 2005*, Onufri, Tiranë, 2005, f. 161.

¹³ Hamit Boriçi – Mark Marku, *Histori e shtypit shqiptar I*, UFO – Press, Tiranë, 2007, f. 111- 116; Hamit Boriçi – Mark Marku, *Histori e shtypit shqiptar na fillimet deri në ditët tona*, SHBLU, Tiranë, 2010, f. 57 – 60.

¹⁴ *100-vjetori i gazetës “Shkupi” (dokumente)*, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Shkup, 2011, f. 6.

¹⁵ Muhamet Pirraku, *Gazeta “Shkupi” (Disa kategori të mendimit politik e shoqëror të saj)*, në: Gjurmime albanologjike – Seria e shkencave historike, nr. 19, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1990, f. 159 – 191.

¹⁶ Hamit Boriçi – Mark Marku, *Vep. e cit.*, f. 112 – 113.

¹⁷ “Shkupi”, nr. 4, 19 Shtatuer, Uskup, 1911, f. 1 - 2.

Ndasive fetare te shqiptarët, që po mudohej dikush t'i mbillte në atë kohë, gazeta u kushtoi rëndësi duke u bërë apel se këto ndasi, qofshin fetare apo krahinore nuk janë në dobinë e shqiptarëve, ato duhet gjetur forma për t'u tejkaluar, duke apeluar se ndasitë e tilla nuk janë në traditën tonë, përkitazi me këtë drejtuesit e gazetës shkruajnë artikullin "Bashkimi a pështimi", duke u bërë thirrje se ndarjet në mes nesh janë qëllime të armiqve tanë "Armiqu e ton mir e din se bashkimi i jon a pështimi i jon; prandej ne të tona mënyrt kqyrin me na prish, me na daa, me na shti flaken mermiet vedi".¹⁸ Në këtë artikull drejtuesit e gazetës ndalen edhe te ndasitë fetare të shqiptarët duke u bërë thirrje që të mos lejojnë një gjë e tillë të ndodhë, se kombet që janë grindur në mes veti për çështje fetare e kanë pësuar keq, duke u treguar se "nji komb qi grihet ner vedi ksi soit, edhe ky gjaa n'drit ska me qit: kush dahet për pun t' Fees, ska me u bashkue as per pun t'kombit, e keshtu ka me hup".¹⁹

Në disa numra të gazetës, hasim artikuj që u drejtohen lexuesve, për t'ua bërë me dije se drejtuesit e saj janë "pro besimeve dhe besimtarëve, por kundërshton ata që shfrytëzojnë besimet për t'i përçarë e tërhequr ata nga lëvizja kombëtare".²⁰

Duke e parë se propaganda për përçarje fetare të shqiptarëve dita-ditës po shtohet, nga qarqe të ndryshme, dhe në anën tjetër disa individ me shkurt pamësinë e tyre, botonin ndonjë artikull në disa gazeta shqiptare të kohës, kundër fesë dhe prijësve fetarë, duke anashkaluar plotësisht figurat e ndritura fetare të kohës, disa prej të cilëve jetonin ende, si: Hoxhë Tahsini, Hoxhë Popova, Ndoc Nikaj, Kristo Harrallambi etj. Një qasje e tillë e disa drejtuesve të gazetave të tjera mund të ndikonte në përçarjen e fetare të shqiptarëve, drejtuesit e gazetës "Shkupi" botojnë një artikull me titullin "*Hoxh e Prift*"²¹, duke ua bërë me dije disa individëve që flisnin dhe shkruanin kundër kësaj shtrese të popullsisë shqiptare, se kontributi i prijësve fetarë ka qenë dhe vazhdon të jetë domethënës në qëllimet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe kjo shtresë nuk ka qëndruar indiferent ndaj zhvillimeve politiko-shoqërore te shqiptarët, por ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë përbërëse në këtë shoqëri.

Ky artikull është më i ploti i botuar në mbrojtje të vlerave të mirëfillta fetare dhe prijësve fetarë te shqiptarët, andaj fokusimi ynë në këtë punim është kryesisht te ky artikull.

Që në fillim, autori i shkrimit ua bën me dije lexuesve se nuk është as hoxhë e as prift, por nuk mund të pajtohej më të pavërtetën që po u vishej prijësve tanë fetarë të kohës. Sipas gazetës, prijësit tanë fetarë janë persona, të cilët punët e tyre i kryejnë me përpikëri dhe punë parësore e tyre është feja, por në momente vendimtare, për fatin e kombit të tyre, çështjen fetare duhet ta kanalizojnë në dobi të kombit të tyre "puna ma e paar e tyne ashtë Feeja, due me than me ju gjet kombit

¹⁸ "Shkupi", nr. 6, 8 Tetuer, Uskup, 1911, f. 1 - 2.

¹⁹ "Shkupi", nr. 6, 8 Tetuer, Uskup, 1911, f. 2.

²⁰ Hamit Boriçi – Mark Marku, *Histori e shtypit shqiptar 1*, UFO – Press, Tiranë, 2007, f. 113.

²¹ "Shkupi", nr. 8, 22 Tetuer, Uskup, 1911, f. 2.

me njëjto pun qi mundet me pas nevoj per kah ana e Fees, e per kah ana e shpirtit”²².

Edhe në qoftë se ka ndonjë nga prijësit fetarë që nuk ka dhënë ndonjë kontribut kombëtar në momente të caktuara, për fatin e kombit, drejtuesit e gazetës sqarojnë se nuk duhet të fajësohen të gjithë prijësit fetarë, duke bërë me dije se në çdo shoqëri apo komunitet ka njerëz të mirë dhe të këqij, duke mos hezituar të sjellin edhe argumente logjike, për t’ua bërë më të qartë lexuesve atë që e thonë: “Pse noi nja asht i keq, do me than belda se t’ton jan të kqii? Pse një moll ashtë e kalb, s’do me than se t’tana jan t’kqija; pse edhe ner ne ka gjind t’Kqii, s’do me than se të ton jemi te Kqii. E ne i kqyrshih punt e veta, na ma shum s’un lypim prej tyne. Madie due me than e masi po i kryikan detyret e veta, jan edhe atdhetare t’mir”.²³

Një element me rëndësi të prijësit tanë fetarë, që e vë në pah ky artikull, është edhe shërbimet e tyre në dobi të popullit. Në këtë artikull, drejtuesit e gazetës, as që e vënë në dyshim këtë cilësi të prijësve tanë fetarë, ata janë të bindur se kjo cilësi ekziston te figurat tona fetare dhe ata e kultivojnë këtë, përndryshe, sipas artikullit, kombi nuk do t’i respektonte për të tillë në qoftë se nuk do ta kultivonin altruizmin në vetveten e tyre: “Natyra e punes tyne ma t’pares, asht me i këyr tirt, me u mundue per tier, e ditme kah ana e Fees: Prift e Hoxh kurkush s’asht per vedi, por per tier. Mos me pas dasht me e marr ket baarr, edhe ato kishin muit me jetue n’dynja si na. Pra nuk munden me thon, se Hoxha e Prifti po kqyrin veç per vedi: me ken, ksi soit, s’kishin me muit me ken maa Priften e Hoxhallar, masi puna vet e lyp me ken per tier e kombit vet nuk e kishte mait per Hoxhallar e Priften me ken se nuk ju kqyrin punen e tyne per kah ana e Fees”.²⁴

Për disa fjalë të dëgjura nga drejtuesit e gazetës se “prijësit tanë fetarë na kanë lënë në terr”, në këtë artikull, autori mundohet t’ua japë edhe këtë përgjigje, duke u thënë se edhe kjo pak dritë të cilën ne e posedojmë sot është meritë e prijësve tanë fetarë dhe të gjithë ata njerëz që sot dinë të shkruajnë e të lexojnë, bazat e para të shkrimit të tyre i kanë marrë nga kjo shtresë. Drejtuesit e gazetës, për t’u përgjigjur në këtë thashetheme të kohës, fillimisht vënë në pah kontributin e ulemave tanë, si Hafiz Ali Korça²⁵, Seid Najdeni²⁶, Hoxhë Tahsini²⁷, Hoxhë

²² *Po aty*

²³ *Po aty*

²⁴ *Po aty*

²⁵ *Hafiz Ali Korça* - (5 prill 1873 në Korçë -31 dhjetor 1956 në Kavajë). Hafëz, luftëtar për liri, poet, përkthyes, shkrimtar, atdhetar, mësues, myderriz, profesor, islamolog, hartues tekstesh mësimore-shkollore. U shkollua në vendlindje dhe Stamboll. Disa nga veprat e Tij janë: Treqind e tri fjalët e Imam Aliut, Historija e shenjt dhe katër halifet, Mevludi shqip, Jusufi me Zelihanë, Abetare, Alfabeti arabisht, Muslimanija, Gramatika dhe syntaksa Shqip-Arabisht, Shtat ëndrrat e Shqipërisë, Bolshevizma çkatrim i njerëzimit, Kur’ani i Madhënueshëm e thelbi tij, Gjylistani (Trëndafilishtja), e Sa’adiut, Rubaijjati (Katrorret) e Umer Khajjamit. Shih: *Hafiz Ali Korça*, Vepra 1 - 12, Logos A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2006.

²⁶ *Said Najdeni* - (1864 në Dibër të Madhe - 21 nëntor 1903 në Dibër). Patriot, mësues, myderriz, veprimtar në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, u shkolluan në Dibër dhe në

Popova²⁸ e Hoxhë Viladani²⁹: “Në Shqypnii kush di me shkruet e me knuet, qi s’a msue pei Tyne a sebeb ata? Mir e jan demela e kush punoi ma shum se ato? Hafuz Haxhi Aliu, nji hoxh na i kthei shqyp 303 fialt e Hasreti Aliis. Hafuz Seid Dibra, shkruiti Fee – rre – fenjsen; Hoxha Tahsini disa pun ka bo per atdhen, Hoxh Popova e shkruiti Mevlutin shqip, Hoxhe Vildani qi punon sot e sa t’tjere ku dhe n’ment s’na bien”.³⁰

Duke vazhduar me prijës fetarë katolikë, si Bardhin, Bogdanin, Gjergj Fishtë, Ndoc Nikjan etj. dhe me priftin ortodoks Kristo Harallambin.

Në fund të artikullit, drejtuesit e gazetës bëjnë apel se pas argumenteve të ofruara, le të gjykojnë vetë lexuesit se çfarë shtrese e shoqërisë na qenkan prijësit tanë fetare dhe se në të mirë të shoqërisë tonë është që ta duam më shumë njëri-tjetrin, t’i dalim zot njëri-tjetrit dhe të mos merremi me sharje e ofendime duke apeluar: “Shqiptart jan te ton nji me zember e me mend”.³¹

Duke e parë shtjellimin interesant që u bëhet prijësve fetarë në këtë artikull, kemi menduar që pa asnjë ndërhyrje, t’ua sjellim edhe lexuesve.

Stamboll, bashkëpunoi me patriotët e kohës, ndërroi jetë më 21 nëntor 1903, në moshën 39-vjeçare. Në vitin 1900, tri vjet pa ndërruar jetë, hoxha Said Najdeni jo vetëm që e hapi shkollë shqipe në Dibër për herë të tretë, por i botoi dy libra në gjuhën shqipe: “Fe rrëfenjësa e myslimanëve”, botue në Sofie, 1900; “Abetare e gjuhës shqipe ndë të folë gegënisht”, Sofie, 1900. Mahmud Hysa, *Studime 6 – Said Najdeni – Hoxhë Voka & Hafiz Sherif Langu*, ITKSHSH, Shkup, 2013, f. 15 – 205.

²⁷ *Hoxhë Hasan Tahsini* - (1811 në Çamëri -1881 në Stamboll), Hoxhë, shkencëtar, doktor i shkencave, i shkolluar, në vendlindje, Stamboll e Paris. Pas vetes ka lënë një mori veprash dorëshkrim në fusha të ndryshme shkencore e shpirtërore. Veprimtar i Rilindjes Kombëtare, dijetar shqiptar që më shumë jetoj në Stamboll. Bëri studime të shumta në psikologji, astronomi etj. Bëri një projekt të alfabetit të gjuhës shqipe me 8 zanore dhe 30 bashkëtingëllore në fillimin e viteve 70 të shek. XIX. Pjesëmarrës i komisionit që hartoi alfabetin e Stambollit. Shih: Laurant Bica, *Profesor Hasan Tahsini*, V. 1 - 3, West Prinit, Tiranë, 2009.

²⁸ *Hoxhë Popova* – (1856 – 1949), Lindi në Vushtrri dhe mori arsim islam në Stamboll, ku kreu medresenë dhe shkollën e lartë. Punoi si arsimtar në Novi Pazar e Beranë. Vitet e fundit i kaloi në Tiranë. Njihet si autor i një mevludi, që mbahet si më i përhapuri ndër shqiptarët sidomos në Kosovë. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 3*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009, f. 2066-2067.

²⁹ *Hoxhë Viladan Dibra* – Lindi në Rekë të Dibrës, edhe pse për vitin e lindjes nuk dihet saktësisht. Mësimet e para dhe ato të mesme i mori në vendlindje, kurse studimet e larta i kreu në Stamboll. Ishte ndër themeluesit e “Shoqërisë së shtypurit shkronja në Stamboll”. Përkrahës i alfabetit shqip me shkronja latine, i dërguari i shoqërisë së lartcekur në Kongresin e Manastirit në vitin 1908, Nuridin Ahmeti, *Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në Vilajetin e Kosovës (1878 – 1912)*, IAP, Prishtinë, 2011, f. 104 – 106; Dr. Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, ISHMQI, Tiranë, 2002, f. 278 -280

³⁰ “Shkupi”, nr. 8, 22 Tetuer, Uskup, 1911, f. 2.

³¹ *Po aty*.

“ Hoxh e Prift...

Hoxh e Prift! Sa emna t'kqii! Nuk jan atdhetar t'mir, madie jan amniç të Shqypniis. Njishtiu m'ka qillue shum her me ndie.

Por nuk e di a jon kuitue nopak permi fjal qi flasin, a vexh flasin pse njashtu ju teket me fol.

S'jam Prift as Hoxh, por sod m'uka tek me e kqyr pakëz kët pun, veç pse jam dashamir i të vërtetes e më kandet me i gjikue punt saa ma dreit të mui.

Nji njeri ashtë i keq, kur nuk i kryë detyret(borxhet) e veta, e per me dit a i kryen kto detyra, mas parit duhet me e dit se cillat jan, nryshei a rezik me e kap, po bie fjalla, me nji gazetaxhii, pse nuk shkon me livrue. Te tana punt s'mundet kush me i krye, por se cilli t'veten: katunari me livrue e askeri me lifte, a kuitoi se mundet me ken hem nieri i mir, hem atëdhetar i mir, si askeri tui lifte, si katunari tui livrue. Per me muit pra me e da punen e Priftneve e t'Hoxhallareve, due me than, a jan gjind t'kqii a të mir, atdhetar të nxet, a amniç, t'kqyrim nji her cillat jan detyrat e tyne e si i kryin. Puna ma e paar e tyne ashtë Feeja, due me than me ju gjet kombit me njimto pun qi mundet me pas nevoj per kah ana e Fees, e per kah ana e shpirtit. Por shka si unë, kto pun i kryin Hoxhallart e Prifinit, e fort rall kam ndie gjind tui u ankue n'ket made. Madie edhe n'kioft nokush ner to qi nuk i maron kto pun, shka do me than?

Pse noi nja asht i keq, do me than belda se t'ton jan të kqii? Pse nji moll ashtë e kalb, s'do me than se t'tana jan t'kqija; pse edhe ner ne ka gjind t'Kqii, s'do me than se të ton jemi te Kqii. E ne i kqyrshih punt e veta, na ma shum s'un lypim prej tyne. Madie due me than e masi po i kryikan detyret e veta, jan edhe atdhetare t'mir: Hoxha e haxhi e tietër send s'mund me ken, e tietër pun s'i shkon per dor: te tona punt deri sod ska muit kush me i krye: mjaft asht ne e kqyrt secili punen e vetë. Na thomi: shka skie zanat, mos prek me dor, e zanati e puna e Hoxhallareve e t'Priftneve s'asht tjetër veç se me ju giet kombit n'pun Fees.

Thot dikush: Hoxhallart e Priftnit po kqyrin veç per vedi.

Mir: por per me gjku mir n'ket pun ta pvesim nji her zembren ton. Na kur po kqyrim per tier! Sicilli po mundohet per vedi. Edhe atyne ju ka dhon Zoti nji me hanger e nji shtat me vesh: ti kishte pas fol pa nevoj me hanger e me u vesh, ma mir kishte ken, por qe Perendia nuk deshti keshtu. Ne mram, prap po thom, kur ta kryin detyren e vet me ju gjet tireve per kah ana e Fees, na prei, tyne s'un lypin ma shum. Nji tieter send edhe duhet me kuitue: bash natyra e punes tyne ma t'pares, asht me i kqyr turet, me u mundue per tier, e ditme kah ana e Fees: Prift e Hoxh kurkush s'asht per vedi, por per tier. Mos me pas dasht me e marr ket baarr, edhe ato kishin muit me jetue n'dynja si na. Pra nuk mundena me thon, se Hoxha e Prifti po kqyrin veç per vedi: me ken, ksi soit, s'kishin me muit me ken maa Priften e Hoxhallar, masi puna vet e lyp me ken per tier e kombit vet nuk e kishte mait per Hoxhallar e Priften me ken se nuk ju kqyrin punen e tyne per kah ana e Fees.

Prifitinit e Hoxhallart na hupen: vyn me i verr te tan n'nji konop. – Edhe ket e kam ndie nji her.

Kollai me fol, por zor me diftue. Si na hupen? Qysh? Kush? Pe noi nja belda aty ketu asht i keq, s'mundena me i ba te tan t'kqii. Nji milet pa nji Fee, edhe nuk o

duk permi fage t'okes, e nuk e di se si kish me ken, me ja nis na; prandej un kishem me dasht me than pa Hoxhallar e Priften t'mir, mos na le, o Zot.

Hoxhallart e Priftnit na lan n'terr me demelii t'vet.

Mir: po qa jo pak driit qi po na shkelqen, pei kui e kemi? Në Shqypnii kush di me shkruie e me knue, qi s'a msue pei Tyne a sebeb ata? Mir e jan demela e kush punoi ma shum se ato? Hafuz Haxhi Aliu, një hoxh na i kthei shqyp 303 fialt e Hasreti Aliis. Hafuz Seid Dibra, shkruiti Fee – rre – fenjsen; Hoxha Tahsini disa pun ka bo per atdhen, Hoxh Popova e shkruiti Mevlutin shqip, Hoxhe Vildani qi punon sot e sa t'tjere ku dhe n'ment s'na bien.

Nji fare Barleci³² na la t'shkrueme një historii t'bukur t'Skender Begut, e Barleci kie një Prift. Nji ner libra ma t'vjetra qi kemi, asht libri, Bogdanit³³ e Bogdani kie një Ipeshkev (Despot katolik). Nji far Zarishi na la do beita t'mira, Zarishi kie një Prift. Ma i vjeter “Fjaluer” Shqyp – Llatinxhe kie shkume prei një far Budit³⁴, e Budi kie një Prift. Eill Radoja³⁵, një Prift, shkruiti tre libra Feejet per katolik. Nji histori t' “Lixhes Moxhme” kemi: kie hrue pei Pashko Bahit e Pashko kahi kie një Prift. Nji far Jak Jung-u, ne qeto viet e mrama qiti një fialuer t'vogel, e disa libra tier e jak Jung-u kie një jesiut (Kallugjer katolik). Nji historii t'Shqypniis e kemi: e ka shkruie Ndoc Nikai³⁶ e Ndoc Nikai asht një Prift. “Shoqnija Bashkimi”

³² *Marin Barleti* – (rreth. 1450 – 1512), Prift, historian, i njohur si Marius Barletius mendohet të ketë lindur në Shkodër, ku ai përjetoi rrethimin e dytë të qytetit të Shkodrës nga osmanët më 1478, ku bie edhe Shkodra, më pas Barleti largohet për Itali dhe në Padovë u bë rektor i famulisë së Shën Stefanit. Disa nga veprat e tij janë: Rrethimi i Shkodrës, Vendik, 1504, Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut, princit të Epirit, Romë, rreth, 1508 – 1510 etj. Shih: Robert Elsie, *Fjalori historik i Shqipërisë*, Uegen, Tiranë, 2011, f. 101 – 102.

³³ *Pjetër Bogdani* - (Gurit të Hasit të Prizrenit Rreth. V. 1630- 1689 në Prishtinë), Klerik i lartë katolik. Kreu Kolegjin e Loretos në Itali. Më 1656 doktoroi në Kolegjin e propaganda Fide në Romë. Ishte peshkop i Tivarit 1685. Më 1677 emërohet kryepeshkop i Shkupit. Autor i veprës Çeta e profetëve. Mori pjesë në luftërat austro- turke, në anën e austro-hungarezëve në vitin 1689. Shih: *Historia e letërsisë shqipe I-II*, (Grup autorësh) Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1975, f. 177-178.

³⁴ *Pjetër Budi* - (Gur të Bardhë të Matit 1566- 1622), Shkrimtar i letërsisë së vjetër shqiptare, klerik i lartë katolik. Shërbeu për shumë vjet si famullitar në kishat katolike në Kosovë. Më 1615 shkon në Romë për t'u interesuar për botimin e veprave të tij dhe për të kërkuar ndihmë kundër osmanëve. Ai shkroi edhe këto vepra: Doktrina e kërshenë (1618), Paqyra e t'rrëfyemit (1621) dhe “Rituali roman (1621). Shih: *Fjalor Enciklopedik Shqiptar I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 316.

³⁵ *Engjëll Radoja* – (Shkodër 1820 – 1880), Autor kishtar, klerik, i shkolluar në Romë, shërbeu si famullitar në vendlindje, drejtues i shkollave françeskane të Shkodrës. Disa nga veprat e Tij janë: Konkilli i Dheut Shqypnis, Romë, 1872; Doktrina e Kërshene, Shkodër, 1876. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar 3*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009, f. 2198.

³⁶ *Dom Ndoc Nikaj* - (Shkodër – 08. 03. 1864 – 14. 10. 1951), Prift, prozator, botues, veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, u shkollua në Kolegjin Papnor të jezuitëve në Shkodër. Disa nga veprat e Tij janë: Marzia e ksctenimi n'filles t'vet, Shkodër, 1892; Fejesa

qiti një “ Fjaluer t’ri” e do libra per shkoll, e n’ket shoqni kiene t’ton Priften e Freten (kallugjer katolik). Do beita shum t’bukura na kan dal ne qeto dit: P. Gjergj Fishta³⁷ i ka qit, e P.G. Fishta asht një frat. Një liber i vogël ” Agimi i Gjytetnis” por shkrum shum bukur, na ka dal tash shpeit: një frat, emnin P. C. Gjekov, e ka qit. Një Grammatik, kreit shqyp, e kemi një Jezuit, emnit P. Zaunoni, e ka qit. Te tan librat e shkolles ç i perdoroin fmija e katolikve, i kan cit Priftinit. Çe dy mui na ka dal një Fjalur i rii gadi 1200 faqesh e ket fjaluer e ka çit një Jesuit, emnit P. Ndue Buseti.

Emnin e Hristo Harallambit³⁸ na te ton e dim e si e maroi jeten tui dek per gjuh, e Hristo Harallambi kie një prift ortodoks. Pra bash leit demela..., nuk ken kan Prifnit e Hoxhallart...,puna vet po flet. S’po due me thon ç ska pas shkrimtar pas Priftneve e Hoxhallarve, jo: por sod masi per ta po flas, veç kta po i permendi e jo tiert. Një tieter her, kur t’na vin shteku, kemi me fol edhe per tier ç jan mundue per gjuh e per atdhe.

Vllazen Shqiptar: ktu po maroi: tash une menden t’m e diftova e ju vet gjykoni e jan amniq t’Shqipës e Shqipniis Prifnit e Hoxhallart a jo. Merami i im ske me e sha kend, ja: madie shkrova qi mos t’shaet kush, n’dasht t’jen Hoxh, n’dasht mos t’jen, pot të tan t’mahena si vëllazen t’mir, t’duhena, ti dalim zot shoqi shoqit, mos t’ndihet kurr e kurkun ç një shqypitar t’flasin keq, per një tieter vllaa, por t’thohet per nee: “ Shqiptart jan te ton një me zember e me mend” Pra, Rrnoft Vlleznia e Shqiptarve”.³⁹

Përfundim

Duke shfletuar materialet e lartcekura, mund të përfundojmë se gazeta “Shkupi” iu kundërvu me sukses propagandës kundër fesë dhe kundër prijësve fetarë të kohës, e cila zhvillohej përmes disa individëve dhe gazetave të caktuara. Drejtuesit e “Shkupit” u përballën suksesshëm me problemin fetar brenda mundësive që i kishin.

Gazeta, opinionit të një mase të caktuar dhe fjalëve të cilat i dëgjonte më së shumti në popull kundër fesë dhe prijësve fetarë, bëri përpjekje t’u përgjigjej me shembuj praktikë nga puna e tyre, duke e nxjerrë në pah kontributin e tyre për çështjen fetare e kombëtare, duke i potencuar edhe me emra.

n’djep a se Ulqini i marrun, Shkodër, 1913; Shkodra e rrethuese, Shkodër, 1913. Shih: Robert Elsie, *Fjalori historik i Shqipërisë*, Uegen, Tiranë, 2011, f. 432 – 433.

³⁷ *At Gjergj Fishta* – (Fishtë, Zadrimë – 23. 10. 1871 – 30. 12. 1940 Shkodër), Figurë fetare dhe politike, poet shkrimtar, u shkollua në vendlindje dhe Bosnjë. Disa nga veprat e tij janë: Lahuta e Malcis, Shkodër, 1937; Mirizi i zanave, Shkodër, 1913; Gomari i Babatsit, Shkodër, 1923; Vallja e Parizit, Shkodër, 1925. Shih: Gjergj Fishta, *Vepra I- 5*, Rilindja, Prishtinë, 1997.

³⁸ *Papa Kristo Negovani* – (Negovan 1875 – 12. 2. 1905), Prift ortodoksë shqiptar, shkrimtar, arsimtar, luftëtar i shqiptarizimit të kishës ortodokse. U shkollua në vendlindje dhe Rumani. Për bindjet e tij kombëtare në moshën 30-vjeçare masakrohet nga bandat greke. Shih: Robert Elsie, *Fjalori historik i Shqipërisë*, Uegen, Tiranë, 2011, f. 429 – 430.

³⁹ “Shkupi”, nr. 8, 22 Tetuer, Uskup, 1911, f. 2.

Prijësit fetarë dhe fenë të shqiptarët, kjo gazetë nuk i shihte si një element përjashtues prej proceseve në të cilat po kalonte populli shqiptar, për dallim prej disa gazetave të tjera. Përkundrazi, gazeta “Shkupi” fenë dhe prijësit fetarë i shihte si një element të rëndësishëm për mbarrëvajtjen e Lëvizjes Kombëtare, gjithmonë duke dalë në mbrojtje të tyre, duke e vënë në pah kontributin e tyre, si në aspektin shkrimor, po ashtu edhe në atë organizativ. Me një fjalë, për gazetën “Shkupi” feja dhe prijësit fetarë të shqiptarët ishin shtyllë e fortë e shoqërisë shqiptare dhe kontributi i tyre në të mirë të vendit dhe shoqërisë, është po aq i madh sa edhe i shtresave të tjera në shoqërinë shqiptare të kohës.

Drejtuesi i gazetës, Jashar Erabara, nuk kishte mundësi t’i mbyllte sytë dhe veshët përballë propagandës që zhvillohej kundër fesë dhe prijësve fetarë, kur dihet se ky ishte një nga studentët/talebet e Hoxhë Vokës dhe nga afër kishte pasur fatin t’i shihte disa nga aktivitetet e mësuesit të tij në dobi të fesë dhe të kombit.

Ky prezantim i kontributit të krerëve fetarë, nga ana e drejtuesve të gazetës “Shkupi”, njëherësh na ofron edhe një pasqyrë të asaj që e quajmë mirëkuptim ndërfetarë tek ne, duke e prezantuar secilën fe të shqiptarët me kontribuuesit e tyre.

SHPEND AVDIU**REFLEKSIONE TË SHTYPIT SHQIPTAR MBI
QEVERISJEN SHQIPTARE 1912-1914**

Përmbajtje e shkurtër: *Me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dolën gazetat e para brenda shtetit shqiptar, duke filluar nga gazeta e parë që ishte organ i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës “Përlindja e Shqipëniës”, e cila u pasua nga gazeta dhe revista të tjera. Këto gazeta kanë pasur vetëm ndikim shumë të kufizuar lokal, pa mundur të krijojnë një opinion publik brendakombëtar dhe gjithëshqiptar. Është me shumë rëndësi se ato në faqet e veta regjistruan ngjarjet kryesore të kohës, duke filluar nga akti i Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, botuan materialet e Kuvendit të Vlorës, materiale nga “Kanuni i Përtashëm i Administratës Civile të Shqipërisë”, pasqyruan gjendjen e kohës në Shqipëri, idealet, synimet, por edhe kundërshtitë e krerëve dhe intelektualëve shqiptarë. Regjistruan dorëheqjen e Ismail Qemalit dhe zëvendësimin e tij nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK). Shtypi shqiptar i ka kushtuar një vëmendje të madhe zhvillimit ekonomik, arsimor dhe kulturor. Gjithashtu shkrimet e shtypit të kohës kanë trajtuar edhe çështjen caktimit të kryeqytetit të ardhshëm të Shqipërisë.*

1. Qeverisja e Ismail Qemalit sipas shtypit shqiptar 1912-1914

Qeveria e parë shqiptare filloi punën në rrethana jo të zakonshme, kur po zhvilloheshin luftërat ballkanike, kur Shqipëria ishte shndërruar në arenë lufte nga aleanca Ballkanike dhe Perandoria Osmane.¹ Në Shkodër vazhdonin luftimet me Malin e Zi, Serbia kishte pushtuar Durrësin dhe Elbasanin, ndërsa trupat greke kishin pushtuar jugun edhe kishin bllokuar bregdetin shqiptar, në këtë situatë ishte Shpallur Pavarësia e Shqipërisë.² Kuvendi i Vlorës më 30 nëntor zgjodhi Qeverinë e Përkohshme dhe një organ këshillues e legjislativ, i cili quhej Pleqësi, që nënkuptonte Senatin, si organ ndihmës i Qeverisë. Pleqësia përbehej prej 18 anëtarëve edhe kryetar i saj u zgjodh Haxhi Vehbi Agolli.³

Më 4 dhjetor u formua kabineti i parë i Qeverisë së përkohshme. Qeveria e parë shqiptare ishte me këtë përbërje:⁴

1. Ismail Qemali - Kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme;
2. Dom Nikollë Kaçorri – Zëvendëskryeministër;
3. Petro Panga – Ministër i Drejtësisë;
4. Myfit Libohova- Ministër i Punëve të Brendshme;

¹ Zgjimi, 15 janar 1914.

² Po aty.

³ Kristo Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, Tiranë 2008, f. 98.

⁴ *Atdheu*, 22 Vjeshtë’ e III-ë 1912.

5. Abdi Toptani- Ministër i Financave
6. Pandeli Cale Ministër i Bujqësisë;
7. Luigj Gurakuqi - Ministër i Arsimit;
8. Mit'hat Frashëri - Ministër i Punëve Botore;
9. Mehmet Dëralla- Ministër i Mbrojtjes;
10. Lef Nosi - Ministër i Postë – Telegrafës.⁵

Të gjithë nëpunësit në çdo degë të administratës duhej ta dinë mirë gjuhën shqipe në të shkruar dhe në të lexuar, dhe kërkohej që të gjithë ata që dëshirojnë të punojnë në administratën shqiptare duhet ta dinë gjuhën shqipe, ndërsa për ata që punonin në administratë më herët duhet t'i shtroheshin një testi për gjuhën shqipe, ose ta mësonin nëse dëshironin të punonin për qeverinë e parë shqiptare.⁶

Kjo qeveri i dha një rëndësi të veçantë arsimit shqip, të gjitha shkollat që do të hapeshin në Shqipëri duhej të merrnin leje nga Ministria e Arsimit dhe kjo ministri kërkonte që çdo shkollë që hapej mësimi të zhvillohej në gjuhën shqipe. Programet, librat, diplomat e mësimdhënësve të certifikoheshin prej Ministrisë së Arsimit, dhe këto shkolla duhet t'u nënshtroheshin ligjeve të shtetit të sapoformuar shqiptar.⁷

Qeveria e Përkohëshme Shqiptare

Ministra e Arsimit

Urdhërim

Shkollat filltare shqiptare do të hapen më 16 të Vjeshtës së parë e do të jenë të detyrueshme për gjith nxënësit e Shqipërisë.

Shkollat e veçanta do të jenë të detyruara dhe do të veprojnë lirisht në qoftë se do t'u shtrohen këtyre konditave (sharte).

1.-a Të marin lejë zyrtare nga Qeveria .

2.-a Të përdorin gjuhën shqipe si gjuhë mësimi.

3.-a Të kenë programat, librat dhe dhiplomat e mësonjësvet të veshtruara dhe të vërtetuara nga Ministria e Arsimit

4.-a T'u shronen në çdo pikëpamje të gjithë kanuneve të Shtetit.

Shkollat e tjera ç' do lloj që të jenë nuk do të munt të hapen në qoftë se drejtorët e tyre nuk do të mbarojnë detyrat e kanunit.

Vlorë 31 gusht 1913.

Ministri i Arsimit: L. GURAKUQI.⁸

Edhe pse qeveria i dha rëndësi të veçantë arsimit shqip, gazeta “Besa Shqiptare” raportonte se si në Shkodër mjerisht me gjithë ata misionarë që gjenden, gjuha shqipe është e “lanun” pas dore. Si myslimanët ashtu dhe te krishterët më shumë i dhanë rëndësi që fëmijët e tyre të mësojnë në gjuhë të huaja

⁵ K. Frashëri, *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë...* vep.e perm., f. 99.

⁶ *Perlindja e Shqipëniës*, 28/10 Vjesht' e I 1913.

⁷ *Perlindja e Shqipëniës*, 19/4 marc 1914.

⁸ *Xgjimi*, dhjetor 1913.

se sa në gjuhën shqipe. Në Shkodër, në atë kohë kishte shumë misionarë austriakë dhe italianë.⁹ Për të njëjtin problem shkruante “*Perlindja e Shqipëniës*” e datës 19 mars 1914: Ku nga despoti i Beratit kërkohej që të çelëshin shkolla ortodokse dhe të mësohej në greqishte dhe funksionimi i tyre të ishte si në kohën e Perandorisë Osmane.¹⁰ Krerët fetarë të ndikuar nga propaganda e vendeve të huaja, dhanë një kontribut të dëmshëm lidhur me hapjen e shkollave shqipe, dhe propagandonin në emër të fesë për shkolla, turke, greke e italiane. Propaganda më madhe ishte nga prijësit fetarë të ritit ortodoks në kohën kur do të liroheshin viset e jugut të Shqipëria nga Greqia.¹¹

Organi i Qeverisë së Përkohshme “*Perlindja e Shqipëniës*” shkruante: “*Gjitha shpresat tona do të jenë në arsim e ne dituri. Kombi shqiptar po nuk mësojë , ... idipendencën tonë veq ditunise tjetër gjë se shpetonë. T’ orvatem i të vem i pas diturisë dhe të zgjohemi me dituni, me arësim se koha ma spret*”.¹² Ky organ shkruante se qeveria tani duhet të tregojë vepra të dobishme të ndërtoj rrugë, të hapë shkolla shqipe, të organizonte një polici e xhandarmeri, të krijonte një sistem financiar, dhe një sistem të drejtësisë si në vendet evropiane para se të vinte Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit.¹³

Shqetësimi i parë i qeverisë së përkohshme ishte të organizojë forcat e armatosura për t’u mbrojtur nga sulmet e vendeve fqinjë. Kryeministri Ismail Qemal bej Vlora i bëri thirrje komandës osmane në Berat që Ushtria Osmane që tashmë ishte para disfatës, të çarmatosej dhe armët t’ia dorëzojë Qeverisë së Përkohshme dhe me këtë armatim ta bëjë organizimin e ushtrisë shqiptare.¹⁴

Për organizimin e brendshëm shtetëror hedhin dritë jo vetëm dokumentet vendase, siç ishte organi “*Perlindja e Shqipëniës*”, po për këtë çështje edhe konsullata austro-hungareze që ndodhej në Vlorë raportonte për organizimin e administratës shqiptare. Konsulli austro-hungarez raportonte që ish- nënpunësit e administratës së P. Osmane dëshironin të punonin për qeverinë e re shqiptare.

⁹ *Besa Shqiptare, 18 nanduer 1913*; Duhet t’a marrin vesh Shqyparet se fimit e tyne nuk kan më muitë, kshtu kendi, me hi n’punë qeveritare e nder zyre t’Shqipnis veç se tui njoftë guhen e vet.

Nuk ka për t’i viefte as Tedeshkia as Italishtia as tier giuhë per pa ditë mirë Shqypen e se tierat janë veç per ndihmë e dorë e dytë.

Njemend se aty ku shkon kushi n’ tryez t’ huej nuk mundet me lypë veç se kashaten qi t’i qesin para zoti I shpis, por arrsyeya e lypë qi do t’kerkohet tryeza ku shuta epet ma e mireë e ma per dobi...

¹⁰ *Perlindja e Shqipëniës*, 19/4 marc 1914;.. Sh. e tij dhespoti ardhi vehtë në Vlonë e kerkoi përsëri me gojë, që të ipej leje të hapen shkollat ku mesohet greqisht gjithashtu me ato të drejta si I kanë qenë ma para. Sikundër dihet edhe ky kerkim vajti kot, sepse drejtori I arësimit një kerkimit të këtillë i dha përgjegjgijen që duhëj dhanë. I tha se sh.e tij si Shqipëtar, gjan se nuk ban mirë me duke bërë disa kërike, të cilat veç se ne dame, Shqipëniës nuk’ munt t’i sjellin gjë tjetër...

¹¹ *Perlindja e Shqipëniës*, 15/28 shkurt 1914.

¹² *Perlindja e Shqipëniës*, 8/21 shkurt 1914.

¹³ *Perlindja e Shqipëniës*, 28/10., Vjesht’ e I 1913.

¹⁴ Grup autorësh, *Historia e Popullit Shqiptar, III*, ASHSH, Tiranë, 2007 , f. 40.

Qeveria e re nuk ngutej që t'i pranonte menjëherë në punë, por priste që shqiptarët që ndodheshin jashtë Shqipërisë që kishin arsim teknik të shërbenin për këtë qeveri.

¹⁵ Vullnetin për të ndërtuar një shtet dhe për t'i venë bazat e shtetit shqiptar, Qeveria e Përkohshme e kishte bërë organizimin e administratës, përmes një kornize kushtetuse që quhej “Kanuni i Përtashëm i Administratës Civile të Shqipërisë”, e cila është botuar në gazetën “Perlindja e Shqipëniës” nga numri 25 gjer te numri 30 gjatë vjeshtës së vitit 1913.¹⁶

Ky model i ligjeve (forma e parë e Kushtetutës Shqiptare) ishte model zviceran, i cili e kanonizonte Shqipërinë, rrethanat në të cilat ishin bërë këto ligje ishte koha kur Qeveria e Përkohshme e kontrollonte një pjesë të vogël të vendit. Por, ky model nuk ishte i përshtatshëm për Shqipërinë, e cila kishte nevojë më shumë se kurrë të ishte e bashkuar, problemet të cilat i sillte ndarja administrative, ku secili vend do të kishte një qeverisje të veçantë, do ta thellonte ndasinë e vendit, ndryshimet veri-jug dhe ndasitë fetare.¹⁷

Ky kanun i administratës shqiptare trajtonte kompetencat e administratës shtetërore, por nuk merrej me organet e larta të shtetit, ajo nuk trajtonte format e qeverisjes.¹⁸ Mirëpo sipas rrethanave politike të vitit 1913 forma e qeverisjes së shtetit shqiptar do të ishte Monarki e udhëhequr nga një princ i huaj.¹⁹

Një princ joshqiptar në krye të Shqipërisë, dhe oficerë nga vendet evropiane për organizimin e forcave të rendit ishin lëshim të cilat Qeveria e Përkohshme u detyrua t'i pranonte për shkak të rrethanave politike jo të favorshme të saj. Edhe shtetet fqinje dalin me teza se shqiptarët nuk ishin të aftë të vetëqeveriseshin.²⁰ Pjesëmarrja e faktorit ndërkombëtar në administratën e Shqipërisë shihej si një garanci e Fuqive të Mëdha, por shqiptarët si brenda vendit ashtu edhe jashtë kishin frikën se të huajt mund të mbesin të huaj. Gazeta “Liri e Shqipërisë” që botohej në Sofje të Bullgarisë, në korrik të vitit 1913 shkruante : “Pa dyshim, do të marrim shumë ndihmesë nga jashtë ,se dëshirojmë të përparoi vendi, të forcohet ekonomisht , moralisht dhe politikisht. Por keta njerz nuk duam që të mbesin “të huaj”,...duam që të jenë njëzë e qeverisë shqiptare në sherbim të Shqipërisë”.²¹ Shtypi shqiptar jep një varg të dhënash për themelimin e Bankës Kombëtare Shqiptare, për gjendjen ekonomik edhe infrastrukturën.

Shqipëria ishte në rrethana emergjente, Qeveria e Përkohshme u mundua të merrte edhe disa masa të karakterit ekonomik. Por, Qeveria e Përkohshme ndeshej me prapambetjen e trashëguar nga Perandoria Osmane edhe me shkatërrimet që kishin shkaktuar luftërat ballkanike.²²

¹⁵ Po aty.,f. 39.

¹⁶ *Perlindja e Shqipëniës*, Vje sht' e III 1913-nr -25-30.

¹⁷ Historia e Popullit Shqiptar,III..vep cit,f,41.

¹⁸ *Perlindja e Shqipëniës*, 23/6 Vjeshtë e III 1913; *Historia e Popullit Shqiptar,III..vep. e pëm., f,41.*

¹⁹ *Besa Shqyptare*, 8 qershor 1913.

²⁰ *Historia e Popullit Shqiptar,III..vep. e pëme., f. 41.*

²¹ Po aty.

²² Po aty.

Banka Kombëtare Shqiptare u themelua më 4 tetor 1913 me një marrëveshje mes Qeverisë së Përkohshme edhe nga Wner Bank-Verein me seli në Vjenë, që përfaqësohej nga Baron Karol Pinter dhe Oskar Pollak, si dhe Commercial Italia që kishte selinë në Milano që përfaqësohej nga Pietro Fenodilo e Guido Ansbacher me kapital austro-italian, dhe ky koncesion jepej për një periudhë 60-et vjeçare²³.

Banka do të administrohej nga një këshill administrimi prej përfaqësuesve të dy palëve, bankave austro-italiane dhe Qeverisë së Përkohshme Shqiptare.²⁴

Veprimtaria e Bankës Kombëtare do të vazhdonte sipas ligjeve të shtetit shqiptar. Shteti shqiptar kishte të drejtë të kontrollonte shtypjen e biletave të cilat dilnin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën frënge. Banka do të duhej të mbajë në arkën e sajë ar sa 1/3 e biletave që ishin në qarkullim.²⁵ Banka do të përkujdesej në nxjerrjen e monedhave të shtetit vetëm ajo, për llogarinë e Qeverisë. Kurse qeveria shqiptare e merrte përsipër që të mos nxjerr asnjë farë kartëmonedhe²⁶. Të gjitha të drejtat mbi thesarin e shtetit i mbante “Banka Kombëtare” dhe asnjë tjetër bankë. Banka do të ketë barrën e shërbimit të thesarit të Qeverisë dhe të gjitha veprimet që ishin të lidhura me të dhe qeveria ishte e detyruar që të gjitha të ardhurat e shtetit t’i derdhte në arkën e Bankës.²⁷ Kapitali i bankës ishte 10 milion franga²⁸. Ndërsa I. Qemali shprehej se ky institucion do t’i shërbente shtetit të sapo krijuar shqiptar, si në aspektin e jashtëm ashtu dhe atë të brendshëm²⁹.

Një pjesë e shqiptarëve u shqetësuan nga kjo marrëveshje, sepse banka autorizohet që të investonte në prona të patundshme, dhe një vend i varfër si Shqipëria, pjesa më e madhe e pronave të patundshme, në planin e parë pronat tokësore të ishin në duar të vendeve të huaja.³⁰ Kundër koncesioneve bankare ishin edhe shtetet e Antantës të cilat e quajtën si monopol kundër interesave të tyre, vendet e Antantës i bënë të njohur qeverisë se ato do ti njohin vetëm ato vendime që do të merreshin nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit.³¹ Gazeta Taraboshi shkruante: “*Bëjmë me dije që edhe me u pa bër më të qajtunën Banka Shqiptare në kontratë shumë ma mirë ne nuk do ta kishim pranuar.*”³²

Ndërsa gazeta tjetër shkodrane “*Shqypnia e Re*” shkruante: “*Ne Austrisë e Italisë i jemi shumë mirënjohës për shërbimet që i sollën çështjes sonë. Këto dy fuqi na ndihmuan për formimin e një Shqipërie të pavarur, por nuk do të thotë që ne tash duhet të jemi nën zgjedhën e tyre.*”³³ Këto reagime ishin nga Hil Mosi dhe Mihail Grameno. Gazeta “*Dielli*” për këto reagime shkruante: “*Nuk dyshonim fare*

²³ *Perlindja e Shqipëniës*, 20/3 Vjesht’ e III 1913

²⁴ Po aty; *Historia e Popullit Shqiptar, III.* vep. e pëm., f. 42.

²⁵ *Perlindja e Shqipëniës*, 20/3 Vjesht’ e III 1913.

²⁶ Po aty.

²⁷ *Perlindja e Shqipëniës*, 23/6 Vjesht’ e III 1913.

²⁸ *Historia e Popullit Shqiptar, III.* vep. e parm., f. 42.

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty.

³² *Taraboshi*, 14 t’etorit 1913.

³³ *Dielli*, 7 Vjeshtë III 1913.

*atdhesin e shkrimtarve të gazetës shkodrane, , por na vjen çudi pse të heshtej gjer në këtë ditë”.*³⁴

Shtypi shqiptar raportonte edhe për mungesën e infrastrukturës rrugore dhe për një varg problemesh në të cilat ndodhej Qeveria e Përkohshme e Vlorës. Të ardhurat financiare të Qeverisë së Përkohshme ishin të vogla, qeveria shqiptare kishte në dorë fondin e administratës osmane në Vlorë, të regjisë së duhanit, të ardhurat nga kripa, të cilat shkonin në llogari të borxheve që Perandoria Osmane ju kishte disa vendeve evropiane dhe vendosi nën kontroll doganën³⁵.

Një ndër plagët më të mëdha që ka lënë gjer më sot Shqipërinë në një shtet të prapambetur, që ka mbajtur popullin shqiptar larg përparimit dhe qytetërimit në krahasim me vendet e Evropës ishte mungesa e infrastrukturës rrugore³⁶. Shqipëria në atë periudhë kishte nevojë të madhe për infrastrukturë rrugore që ti lidhte qytetet në mes veti, që të zhvillohej tregtia me lehtë. Qeveria e Përkohshme Shqiptare nuk bëri asgjë në këtë aspekte, edhe pse mundësitë ishin shumë të vogla që qeveria të investonte në rregullimin e rrugëve³⁷. Ajo kishte paraparë ndërtimin e një rrjeti të komunikacionit rrugor, i cili mund të realizohej përmes koncesioneve. Ismail Qemali dëshironte që këto koncesione t’u jepeshin disa Fuqive të Mëdha. Të parët që u interesuan ishin shoqëritë austro-hungareze dhe ato italiane, të cilat bënë oferta konkrete. Ndër koncesionet më të rëndësishme ishin ato të ndërtimit të porteve dhe të një hekurudhe Vlorë-Durrës-Shkodër³⁸.

Gazeta “Përlindja e Shqipëniës “ kështu e përshkruan gjendjen ekonomike të vendit: *Shqipëria si vendi ma i bukur e ma i mirë i Gadishullit Ballkanik, që përbën në gjirinë e vetë vrasre të pa njohura që gjer më sot dora e shqiptarit s’ka ditur mi nxjerrë frytin dhe dobitë e tyre. Më një pozitë të mirë e të rëndësishme, pranë kombeve të qytetëruara, pasuritë e sajë kanë mbetur të panjohura dhe të pa prekura”.*³⁹

Kjo gazetë ndër të tjera shkruante: *“Po ti hedhim një vështrim Shqipërisë, do të shohim të gjitha veprat që do të duhej t’i ketë një që do ta zhvillonin e qytetëronin një mbretëri i mungojnë dhe janë të pa njohura për popullin shqiptar. Po të ta shohim bujqësinë ajo ende punohet me mjetë shume primitive. Ta leme më një anë së nuk kemi çka të folim për industrinë e cila ishte e pa njohur për popullin shqiptar të asaj kohe”*⁴⁰.

Shqipëria ishte një vend që nuk kishte industri dhe 90 për qind e popullsisë merrej me bujqësi, me mbetje të në një shoqërie feudale edhe me një bujqësi të prapambetur, e cila nuk mundte të mos ndeshej me një reformë agrare më kërkesa për zgjidhjen e sajë. Kjo reformë fillojë të zgjidhej vetëm në vitet e tridhjeta në

³⁴ Po aty.

³⁵ *Historia e Shqipërisë, II, USHT, Tiranë, 1965, f. 371.*

³⁶ *Përlindja e Shqipëniës, 15/28 Kalënduar 1914*

³⁷ Po aty.

³⁸ *Historia e Popullit Shqiptar, III..vep. e pëm., f.43.*

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty.

kohën e Mbretërisë Shqiptare të cilën e udhëhiqte Ahmet Zogu⁴¹. Ky organ morri shembull Vlorën si një ndër qytetet më të zhvilluara të Shqipërisë e sidomos në kultivimin e ullirit, i cili ende punohej me metoda të vjetra dhe primitive, që për fat të keq ulliri transportohej dhe nuk përpunohej në Shqipëri, vendi nuk kishte një industri për përpunimin e vajit, i cili do ti sillte përfitime shtetit të sa po krijuar shqiptar⁴². Qeveria e Përkohshme nuk kishte mundësi në ato rrethana në të cilat ndodhej të bënte më shumë, si në infrastrukturë, si në ekonomi dhe në mirëqenien e përgjithshme.

Qeveria e Përkohshme e Vlorës edhe pse kishte ndërmarrë disa masa, veprimtaria e saj duhet vlerësuar vetëm në rrafshin e ideve dhe aspiratave e cila nuk e kishte as përkrahjen e Fuqive të Mëdha, ndërsa Ismail Qemali i cili nuk kishte pasuri të madhe vetjake, gjë që nuk kishte influencë të madhe në Shqipërinë. Ai ishte një diplomat i përmasave evropiane dhe dëshira e tij ishte që Shqipëria të qeverisej në mënyrë moderne dhe perëndimore⁴³. Një ndër problemet më të mëdha të Shqipërisë ia sollën bejlerët, lëvizja e Esat Pashës e cila ishte e vendosur në Shqipërinë e mesme, i cili ngriti një administratë të veçantë për t'iu kundërvu Qeverisë së Vlorës dhe rreth tij ishin grumbulluar bejlerët⁴⁴. Gazeta "Dielli" për këtë çështje shkruante: *"Një problem i zgjidhur te i cili mvaret një pjesë e përparimit kombëtar, është edhe sjellja e bejlerëve tanë...se lipset së ne humbëm Janinën dhe më të madhen pjesë të Toskërisë dhe fajin se kanë as grekomanët po bejlerët tanë, ato dinasti barbare që më shturjën e tyre një pjesë të popullsisë e shtynë të mohaninë kombësinë e tyre"*.⁴⁵ Ndër të tjera kjo gazetë shkruante: *"Levizja e Esat Toptanit na thonë që gjoja ka mbledhur 3000 ushtarë dhe do të kryengritje kundër qeverise. Zoti na ruajtë se mos e coptojnë këtë çike atdhe që na e fali Evropa"*.⁴⁶

2. Dorëheqja e Ismail Qemalit dhe kalimi i pushtetit te Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit sipas shtypit shqiptar 1914

Shtypi shqiptar i kohës i ka kushtuar një vëmendje të veçantë kalimit të pushtetit nga Qeveria e Përkohshme te Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Kalimi i pushtetit te Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit ndodhi sepse dyshohej se Qeveria e përkohshme ishte marrë vesh për planet paraprake të xhon turqve për Shqipërinë, dhe këtë rast nuk e la pa e përdorë KNK dhe i bëri presion Ismail Qemalit që të largohej nga skena politike⁴⁷. Në fillim të janarit, Ismail Qemali kishte deklaruar para Qeverisë dhe para përfaqësuesve të KNK se ishte i gatshëm ta

⁴¹ Historia e Popullit Shqiptar, III...vep cit, f. 43; Nina Smirnova, *Historia e Shqiprisë Pergjat Shekullit XX*, Tiranë, 2004, f. 185.

⁴² *Perlindja e Shqipëniës*, 15/28 Kalënduar 1914.

⁴³ *Historia e Popullit Shqiptar, III...vep. e përm., f. 46*; J. Bourcard, *Shqipëria dhe...vep. e përm., f. 100*.

⁴⁴ *Historia e Popullit Shqiptar, III...vep. e përm., f. 46*.

⁴⁵ *Dielli*, 2 Shtator 1913.

⁴⁶ *Dielli*, 11 nëntor 1913.

⁴⁷ *Historia e Popullit Shqiptar, III... vep. e parme., f. 56*; Taraboshi, 21 kallnuer 1914.

kalonte gjithë pushtetin te Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit. Më 22 janar u bë dhe formalisht dorëzimi i pushtetit nga Qeveria e Përkohshme te KNK⁴⁸. Organi i Qeverisë së Përkohshme *“Perlindja e Shqipëniës”* për këtë ngjarje shkruante: *“Mbasi ngatërrimet në Shqipëri, po shtoheshin ditë për ditë, e mbasi një gjendje e tillë po sillte pengime të mëdha, sidomos tani që po afrohej koha e ardhjes së Princit, e liritë të viseve të jugut nga ana e ushtrisë greke, Kryetari i Qeverisë së Përkohshme bashkë me këshillin e ministrave, që Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit t’vë në dorë qeverisjen e Shqipërisë para ardhjes së Princit”*.⁴⁹

Shtypi që dilte në Shqipërinë e veriut dhe në Shqipërinë e Mesme e quante si të domosdoshme largimin e I. Qemalit nga politika. Gazeta *“Taraboshi”* shkruante: *“Ishte koha që ti jepim zemër vendit edhe ti tregojmë botës se Ismail Qemali nuk e paraqiste shpirtin kombëtar.”*⁵⁰ Bashkpunuesit e tij kanë me pas kohën e mënyrë që deshmojnë se nuk kanë pas dorë në komplotin në të cilin është synuar me ja marrë jetën atdheut”. Kjo gazetë më tej shkruante se populli shqiptar ka njerz të zotë të qeverisinë Shqipërinë si kah puna ashu edhe nga mendja.⁵¹

Ndërsa gazeta *“Ushtimi i Krujës”* që dilte në Durrës dhe kontrollohej nga Esat Pasha shkruante: *“Qeveria e Vlorës mori një fund të keq, mori një fund të cilin nuk e prisin as kundërshtarët më të rrept të saj. Fundi që mori Qeveria e Vlorës nuk ishte aspak i natyrshëm, shkaqet pse bie një qeveri janë të ndryshme, arsye pse e detyroi Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit të heq dorë nga qeveria ishte, se donte të prishte atë që dëshironte ta bënte Evropa”*.⁵² Po e njëjta gazetë shkruante: *“Po ti hedhim një sy në veprat e ish qeverisë së Vlorës, do të kuptojmë se nuk ben as një gjë që do të duhej të bënte s’u bë, përkundrazi u bënë ato që s’duheshin të bëheshin. Për fat të keq qeveria e Vlorës nuk ka të na tregoj as ndonjë veper qeverimi”*.⁵³

Gazeta *“Dielli”* për këtë çështje shkruante : *“Para pak kohësh vjen në Vlorë njëfarë Beqir aga, merret vesh me të gjithë shqiptarët po thuaj, në konak të krytarit të Qeverisë së Përkohshme; këmben e ç’këmben vizita dhe telegrame dhe ishte për një marrëveshje turko-shqiptare. Pas nja tri dite vjen një vapor prej Austrie dhe kërkon të zbrazej nja 300 veta të ardhur nga Stambolli”*.⁵⁴ *“Pas këtyre ngjarjeve Qeveria e Përkohshme shpall shtetrrethimin, mban vaporin peng ,xhandarmeria hyn në vapor e marrin një pjesë të tyre dhe i dërgojnë në burg. Pas një kontrolli të vaporit i lirojnë të gjithë.”*⁵⁵ *Por pas pak kohe prapë kthehet Beqir aga dhe burgoset”*.⁵⁶ Administrata e Vlorës fillimisht nga ana e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit u kthye në atë të tipit “vendor”, me ç’rast edhe qeveria

⁴⁸ *Historia e Popullit Shqiptar, III.. vep. e parme., f. 56; Perlindja e Shqipëniës, 11/24, Kalënduar 1914.*

⁴⁹ *Perlindja e Shqipëniës, 11/24 Kalënduar 1914.*

⁵⁰ *Taraboshi, 22 kallnuer 1914.*

⁵¹ Po aty.

⁵² *Ushtimi i Krujës, 30 janar 1914.*

⁵³ Po aty.

⁵⁴ *Dielli, 10 shkurt 1914.*

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ Po aty.

u suprimua, në vend të ministrive u krijua një drejtori e cila përbëhej nga pesë degë.⁵⁷ Administrata e Shqipërisë u nda në tri degë: Administrimi i brendshëm, drejtësia edhe financat. Administrimin e brendshëm e udhëhiqte Petroviç, delegat i Austro-Hungarisë, ndërsa delegatët e Gjermanisë, Italisë dhe delegati i Rusisë e udhëhiqnin dikasterin e drejtësisë, ndërsa delegatët e Francës dhe të Anglisë udhëheqnin me financat⁵⁸. Fuqia e administratës e KNK nuk do të shtrihej vetëm në trevat që i kishte Qeveria e Përkohshme, ajo do ti qeverisë edhe teritoret e Shqipërisë së Mesme dhe veriun e Shqipërisë. Në këtë mënyrë, Shqipëria për herë të parë do të qeverisej vetëm prej një qendre⁵⁹. Ky ndryshim ishte kyçi i të gjitha çështjeve në të mirë të Shqipërisë, largimi i forcave greke nga viset e jugut të Shqipërisë, dhe grekët nuk do të mundnin t'i shtrëngonin më vendasit që të deklaroheshin se kishin frikë nga qeveria shqiptare, nuk do të mund të sillnin me turbullira për arsye se tani Qeveria e Shqipërisë ishte Evropa vetë⁶⁰. Dorëheqja e Isamil Qemali lehtësoi ardhjen e Princ Vedit, edhe Esat Pasha më në fund pranoi zgjedhjen e Evropës⁶¹.

3. Kryeqyteti i Shqipërisë sipas shtypit të kohës

Shtypi shqiptar trajton gjerë e gjatë çështjen e kryeqytetit, se cili qytet duhet të jetë kryeqyteti i ardhshëm i Shqipërisë. Kryeqyteti i parë i Shqipërisë ka qenë Vlora, që pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, e tërë administrata ishte e përqendruar në Vlorë. Pas ardhjes së Princ Vedit, kryeqendra shqiptare u vendos në Durrës dhe pas Kongresit të Lushnjes kryeqyteti i Shqipërisë u zgjodh Tirana⁶². Pas vendimeve përfundimtare të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, Shkodra do t'i bashkohej Shqipërisë, dhe kështu qarqet intelektuale shkodrane, bënë thirrje që Shkodra të bëhej kryeqendra e Shqipërisë⁶³. Një ndër më të zëshmit për këtë çështje ishte edhe Atë Gjergj Fishta, i cili në revistën “*Hylli i Dritës*”, propagandoi dhe argumentoi pse Shkodra duhej të jetë kryeqyteti i shtetit shqiptar. Argumentet kryesore ishin dhe bazoheshin në historinë dhe në kontributin që njerëzit e Shkodrës kishin dhënë në periudha të caktuara në të mirë të kombit.⁶⁴

Gazeta “*Dielli*” e datës 18 korrik 1913 shkruante: “*Pasi Shqipëria u njoh nga Fuqitë e Mëdha, besoj se çdo njeri që kupton politikën, e di se zemra e çdo mbretërie është kryeqyteti, prej nga jepen urdhërat, rrjedhin punët e mëdha dhe*

⁵⁷ *Historia e Popullit Shqiptar, III.* vep. e përm, f. 46.

⁵⁸ *Perlindja e Shqipëniës*, 18/31 Kalënduar 1914.

⁵⁹ *Perlindja e Shqipëniës*, 11/24 Kalënduar 1914.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ Jacques Bourcard, *Shqipëria dhe Shqiptartët*, Tiranë, 2007, f. f. 103; *Perlindja e Shqipëniës*, 11/24 Kalënduar 1914.

⁶² Enriketa Papa-Gentiana Kera, *Shkodra ose Tirana? Në kërkim të kryeqytetit të Shqipërisë së Pavarur në: Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shekullit XX (Përmbledhje studimesh)*, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë, Tiranë, 2008, f. 285-287.

⁶³ *Po aty*, f. 286.

⁶⁴ *Po aty*.

është qendër rreth së cilës grumbullohen qytetet më të largëta⁶⁵. Për këtë çështje është folur shumë në atë periudhë, disa duan që Shkodra për shkak të qëndresës së sajë, edhe përkrahjes nga Austro-Hungaria. Rrethe të caktuara donin që Vlora të ishte kryeqyteti, për arsye të shpalljes së Pavarësisë në Vlorë, ndërsa një pjesë mendonte që zgjedhja më mirë ishte Elbasani, dhe argumentojë se është kërthiza e Shqipërisë dhe flitet gjuha më pastër shqipe⁶⁶. Përveç këtyre ideve se cili qytet e meritonte të ishte kryeqendra e Shqipërisë, kishe ide që të krijohet një qytet i ri dhe t'i vendosej një emër i cili do të tingëllonte bukur për veshin e shqiptarit dhe të zgjidhej një vend i përshtatshëm afër një lumi dhe mos të ishte larg nga qendrat e mëdha të Shqipërisë por dhe as larg detit⁶⁷.

Kurse princi Vid propozonte të ishte Durrësi si vend më i sigurt për të. Shtypi i huaj shkruante se Durrësi nuk ishte më i sigurt për Princin, të sigurt ishte Vlora ose Shkodra ku ka një prani të madhe të ndërkombëtarëve. Durrësin e përshkruan si bastion të Esat Pashës edhe i cili nuk mendonte të hiqte dorë nga pushteti i tij që përbëhej prej ushtarëve që kanë mbetur nga ushtria turke⁶⁸. Gazeta italiane “*Corriere d'Italia*”, shkrimet e së cilës transmetoheshin në shtypin shqiptar, duke folur mbi këtë çështje shkruante se për kryeqytet të Shqipërisë është zgjedhur Shkodra⁶⁹. Por gazeta “*Perlindja e Shqipëniës*” shkruante se shtypi austriak raporton se Italia nuk e dëshironte Shkodrën për kryeqytet⁷⁰. Interesat e Italisë ishin që Vlora të mbetej kryeqendra shqiptare, për shkak të pozitës së mirë gjeografike që kishte Vlora me rrethinë, dhe marrëdhëniet e saj që kishte me brigjet e Puljes, por kundër këtyre synimeve ishte Austro-Hungaria. Kështu, u afruan me qëndrime këto dy fuqi që, kryeqyteti i ardhshëm i Shqipërisë të ishte Shkodra.⁷¹

Në atë kohë Shkodra shihej edhe për disa faktorë të tjerë: Ishte një ndër qendrat më të zhvilluara si në aspektin infrastrukturor, ekonomik dhe ish një ndër vendet që arkitektura e saj ishte më pak orientale se sa në qytetet tjera të Shqipërisë.⁷² Shkodra shihej si kryeqendër e mundshme edhe për disa faktorë të tjerë: Do të ishte nën kontrollin e përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha; do ta largonte influencën e vendeve të huaja nga Shqipëria e veriut; do të shuheshin shpresat e Mali të Zi që ta pushtonte Shkodrën me rrethinë⁷³.

Pas ardhjes së Princit Vid më 7 mars, kryeqytet i Shqipërisë u bë Durrësi dhe administrata e shtetit shqiptar u vendos aty edhe pse në krahasim me qytetet tjera, Durrësi nuk kishte infrastrukturën e nevojshme, mungonin godinat, hotelet etj.⁷⁴

⁶⁵ Dielli, 18 korrik 1913.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ *Perlindja e Shqipëniës*, 25/7 dhjetor 1913.

⁶⁹ Po aty.

⁷⁰ *Perlindja e Shqipëniës*, 11/24 Kalënduar 1914.

⁷¹ Po aty.

⁷² *Perlindja e Shqipëniës*, 5/18 mars 1914.

⁷³ Po aty.

⁷⁴ *Ushtimi i Krujës*, 31-13 shkurt 1914.

PATRICK MODIANO

DËSHIRA PËR TË SHKRUAR

Dua vetëm t'ju them sa i lumtur ndihem këtu mes jush dhe sa i mallëngjyer nga nderi që më keni bërë duke më dhënë çmimin “Nobel” për letërsinë.

Është hera e parë që duhet të mbaj një fjalim para kaq shumë njerëzve dhe ndiej njëfarë frike. Mund të mendohet se një ushtrim i tillë është diçka e natyrshme dhe e lehtë për një shkrimtar. Por një shkrimtar - ose të paktën një romancier - ka shpesh marrëdhënie të vështira me fjalën. Dhe nëse kujtojmë ndarjen që bëhet në shkollë midis “me shkrim” dhe “me gojë”, një romancier ka më tepër dhunti me shkrim se me gojë. Ai e ka për zakon të heshtë nëse dëshiron të përshkohet nga një atmosferë, ai duhet të shkrihet me turmën. Dëgjon bisedat pa rënë në sy, dhe nëse ndërhyr në këto të fundit, kjo ndodh për të bërë disa pyetje të matura me qëllim për të kuptuar më mirë burrat dhe gratë që e rrethojnë. Fjala e tij është ngurruese, për shkak të zakonit të tij për të korrigjuar shkrimet. Sigurisht, pas shumë korrigjimesh, stili i tij duket i pastër. Por kur merr fjalën, ai nuk ka më mundësi të korrigjojë ngurrimet e tij.

Përveç kësaj, unë i përkas një brezi ku fëmijët nuk lejoheshin të flisnin, me përjashtim të disa rasteve të rralla dhe me kusht që të kërkonin leje. Por askush nuk ua vinte veshin dhe shumë shpesh u ndërpritej fjala. Ja përse disa prej nesh kanë vështirësi në të shprehur, herë ngurrojnë, herë flasin shumë shpejt, a thua se kanë frikë mos i ndërpresin. Sigurisht, prej këtej vjen dëshira për të shkruar, që edhe mua, si shumë të tjerë, më ka kapluar në të dalë të fëmijërisë. Ju shpresoni që të rriturit t'ju lexojnë. Kështu, ata do të jenë të detyruar t'ju dëgjojnë pa ju ndërprerë dhe do të marrin vesh një herë e mirë gjithçka mbani brenda.

Një romancier nuk mund të jetë kurrë lexues i vetes

Lajmi për këtë çmim m'u duk ireal dhe kisha nevojë të ngutshme të kuptoja përse më keni zgjedhur. Atë ditë, kurrë më parë nuk kisha kuptuar aq qartë se sa i verbër është një romancier karshi librave të tij dhe se lexuesit e tij dinë shumë më tepër se ai rreth asaj që ka shkruar. Një romancier nuk mund të jetë kurrë lexues i vetes, vetëm në rastet kur korrigjon në dorëshkrim gabimet e sintaksës, përsëritjet, apo kur heq një paragraf të tepërt. Ai ka një përfytyrim konfuz dhe të paplotë të librave të tij, ashtu si një piktor që pikturon një afresk në tavan, i shtrirë mbi skelë, punon detajet nga fare afër, pa patur një ide të së tërës.

Punë e çuditshme dhe vetmitare kjo e të shkruarit. Ju përjetoni momente shkurajimi kur shkruani faqet e para të një romani. Çdo ditë keni përshtypjen se jeni në rrugë të gabuar. Dhe në këtë moment është i madh tundimi për t'u kthyer mbrapsht dhe për të marrë një rrugë tjetër. Nuk duhet rënë pre e këtij tundimi, por

duhet vazhduar rruga. Është pak si të jesh në timonin e një makine, në dimër, në një rrugë me akull, ku nuk duket asgjë. Ju nuk keni zgjidhje tjetër, nuk mund të ktheheni pas, duhet të vazhdoni t'i jepni para duke menduar se rruga do të përmirësohet dhe mjegulla do të shpërndahet.

Afër fundit të një libri, ju duket sikur ai fillon të shkëputet nga ju dhe po merr tashmë frymë i lirë, ashtu si fëmijët në shkollë, ditën e fundit para pushimeve verore. Të shpërqendruar dhe të zhurmshëm nuk e dëgjojnë më mësuesin. Madje do të thosha që në momentin kur po shkruani paragrafët e fundit, libri iu shfaq njëfarë armiqësie, aq ngutet për t'u liruar nga ju.

Dhe ja, me të shkruar fjalën e fundit, ai largohet. Mori fund, ai nuk ka më nevojë për ju, ju ka harruar tashmë. Tani e tutje janë lexuesit që do ta bëjnë të jetojë. Në këtë moment, ju ndieni një zbrazëti të madhe dhe ndjesinë se ju kanë braktisur. Dhe gjithashtu pakënaqësi për këtë lidhje mes librit dhe jush, që u këput shumë shpejt. Pakënaqësia dhe ndjesia se diçka ka mbetur pa u bërë, ju shtynë të shkruani librin tjetër, për të rivendosur ekuilibrin, pa e arritur kurrë atë. Sa më shumë kalojnë vitet, librat ndjekin njëri-tjetrin dhe lexuesit këtë do "ta quajnë vepër". Por ju vetë keni ndjesinë se ishte vetëm një ikje e gjatë nga diçka.

Po, lexuesi di më tepër rreth një libri se vetë autori. Mes romanit dhe lexuesit të tij, ndodh diçka e ngjashme me procesin e larjes së fotografive, ashtu si kryhej para erës digjitale. Në momentin e larjes në dhomën e errët, fotografia qartësohej pak nga pak. Gjatë leximit të një romani, zhvillohet i njëjti proces kimik. Por që të ekzistojë një marrëdhënie e tillë mes autorit dhe lexuesit të tij, duhet që romancieri të mos e sforcojë kurrë lexuesin - në kuptimin që thuhet për një këngëtar kur sforcon zërin e tij - por ta tërheqë pa u ndier dhe t'i lërë kohën e mjaftueshme që libri ta depërtojë pak nga pak, dhe kjo nëpërmjet një arti që ngjan me akupunkturën, ku mjafton të shpohen me gjilpërë disa vende të caktuara dhe rryma shpërhapet në sistemin nervor.

Çdo libër, gjatë kohës kur shkruhet, e fshin të mëparshmin

Kjo marrëdhënie intime dhe plotësuese mes romancierit dhe lexuesit të tij, besoj se ekziston edhe në botën muzikore. Unë gjithmonë kam menduar se të shkruarit është afër me muzikën, por shumë më pak i pastër se ajo, dhe gjithmonë i kam patur zili muzikantët, të cilët më dukeshin se merreshin me një art të epërm ndaj romanit - dhe poetët që janë më afër muzikantëve se romancierët. Kam shkruar poezi në fëmijërinë time dhe, me shumë gjasë, falë kësaj kam kuptuar këtë thënie të lexuar diku: "*Prozatorët e mirë dalin nga poetët e këqij*". Dhe në lidhje me muzikën, një romancier duhet të tërheqë pas vetes të gjithë njerëzit, peizazhet, rrugët që ka vërejtur në një partiturë muzikore ku ndodhen të njëjtat fragmente melodike nga një libër në tjetrin, por kjo partiturë muzikore atij do t'i duket e papërkryer. Një romancieri i mbetet gjithmonë peng që nuk është bërë muzikant "puro" dhe nuk ka kompozuar *Nokturnet* e Shopenit.

Mungesa e kthjelltësisë dhe e vështirimit kritik të një romancierit ndaj veprës së tij lidhet edhe me një dukuri tjetër që e kam vënë re në rastin tim dhe në shumë të tjerë: çdo libër i ri, gjatë kohës kur shkruhet, e fshin të mëparshmin, aq sa më

krijohet përshtypja se e kam harruar. Unë kujtoja se i kisha shkruar njëri pas tjetrit të shkëputur, shoqëruar me harresa të njëpasnjëshme, por shpesh të njëjtat fytyra, të njëjtët emra, të njëjtët vende, të njëjtat fjali venë e vijnë, si motive të një tapicerie që kemi endur në gjendje gjysmë fjetje. Gjendje gjysmë fjetje apo një ëndërr me sy hapur. Një romancier është shpesh somnambul, aq shumë është i pushtuar nga ajo që do të shkruajë, e trembemi se mos e shtypin makinat kur kalon rrugën. Por harrojmë saktësinë e jashtëzakonshme të somnambulëve, ata ecin mbi çati pa u rrëzuar kurrë.

Në deklaratën që shoqëroi dhënien e çmimit “Nobel”, mbajta mend këtë fjali që ishte aludim për luftën e fundit botërore: “*Ai ka shpalosur botën e Okupacionit*”. Unë, si gjithë ata dhe ato që lindën në vitin 1945, jam një fëmijë i luftës dhe, më saktësisht, meqë kam lindur në Paris, një fëmijë që ia detyron lindjen e tij Parisit gjatë Okupacionit. Ata që kanë jetuar në Paris në atë kohë, kanë dashur ta harrojnë, ose, le të themi, kanë dashur të mbajnë mend vetëm vogëlsira të jetës së përditshme, nga ato që krijonin iluzionin se ishte një jetë e zakonshme, jo fort e ndryshme nga ajo që kishin patur në kohë normale. Kur më vonë, fëmijët e tyre i pyesnin rreth asaj *kohe* dhe rreth atij *Parisi*, përgjigjet e tyre ishin evazive. Ose ata heshtnin, sikur të donin të fshinin nga kujtesa ato vite të errëta dhe sikur na mbanin një të fshehtë. Por të ndodhur përballë heshtjes së prindërve tanë, ne morëm me mend gjithçka kishte ndodhur, njëlloj sikur ta kishim jetuar vetë.

Parisi gjatë “Pushtimit”, një qytet që dukej “si hije e vetes”

Qytet i çuditshëm, Parisi gjatë Pushtimit. Në dukje, jeta vazhdonte “si më parë”: teatrot, kinematë, sallat e koncerteve ishin hapur. Dëgjoheshin këngë në radio. Madje në kinema dhe teatër kishte më tepër njerëz se para luftës, a thua se këto vende ishin strehime kur njerëzit mblidheshin dhe shtrëngoheshin njëri pas tjetrit për t’u ndier më të sigurt. Por detaje të pazakonta dëshmonin se Parisi nuk ishte më ai i dikurshmi. Mungesa e makinave e bënte një qytet të heshtur - një heshtje ku dëgjohej shushurima e pemëve, kërcitja e thundrave të kuajve, zhurma e hapave të turmës në bulevard, zhaurima e zërave. Në heshtjen e rrugëve dhe të errësirës që pllakoste në dimër rreth orës 5⁰⁰ të mbrëmjes dhe gjatë së cilës ndalohej edhe ndriçimi më i vogullt në dritare, ky qytet dukej si hije e vetes - qyteti “pa vështrim”, si thoshin pushtuesit nazistë. Të rriturit dhe fëmijët mund të zhdukeshin nga një moment në tjetrin, pa lënë gjurmë, madje edhe mes miqsh, flisnim nën zë dhe bisedat nuk ishin asnjëherë të singerta, sepse ndihej rreziku në ajër.

Në këtë Paris makthi, ku rrezikoje të ishe viktimë e një denoncimi apo e një arrestimi në të dalë të metrosë, ndodhnin takime të rastësishme midis personash që nuk do të ishin ndeshur kurrë në kohë paqeje, dashuri kalimtare lulëzonin gjatë orëve të shtettrrethimit, pa e ditur nëse do të takoheshin më ditët më pas. Pikërisht pas takimesh të tilla pa të nesërme, dhe ndonjëherë takime të gabuara, lindën më vonë fëmijë. Ja përse Parisi gjatë pushtimit ka qenë gjithmonë për mua si një natë e zanafillës. Po të mos ishte ai, nuk do të kisha lindur kurrë. Ky Paris nuk më është ndarë kurrë dhe drita e tij e veshur depërton ndonjëherë nëpër librat e mi.

Kjo është edhe prova se te një shkrimtar data e lindjes dhe epoka e tij lë gjurmë të pashlyeshme tek ai, edhe nëse nuk është përfshirë drejtpërdrejt në

politikë, edhe nëse krijon përshtypjen e të vetmuarit, i mbyllur në atë që quhet “kulla e fildishtë”. Edhe nëse shkruan poema, ato janë pasqyrimi i kohës ku jeton, dhe nuk mund të ishin shkruar në një kohë tjetër.

Ja për shembull poema e Yats-it, ky shkrimtar i madh irlandez, që më prek gjithmonë kur e lexoj: Mjellmat e egra në Coole... Në një park, Yats-i sodit mjellmat që rrëshqasin mbi ujë.

*Vjeshta e nëntëmbëdhjetë ka zbritur mbi mua
Që kur i numërova për herë të parë;
I pashë, para se të përfundoja numërimin,
Të ngriheshin papritur
Dhe gugatnin gëzueshëm duke ardhur rrotull në gjysmë rrathë
Me flatrat e tyre zhurmëmëdha,
Por tani vozitin të qeta mbi ujë,
Madhështore dhe bukurishumë.
Në cilat kallamishte do ndërtojnë fole,
Në breg të ç'ligeni, ç'pellgu vallë?
Do të magjepsin të tjerë sy, kur të mitë të hap një ditë,
Dhe ato të kenë fluturuar?*

Mjellmat shfaqen shpesh në poezinë e shekullit XIX - te Bodleri ose Mallarme. Por kjo poemë e Yeats-it nuk mund të ishte shkruar në shekullin XIX. Me ritmin e saj të veçantë dhe melankolinë, i përket shekullit XX, madje vitit kur është shkruar.

Por ndodh edhe që një shkrimtar i shekullit XXI të ndihet, me raste, i burgosur i kohës së tij dhe leximi i romancierëve të mëdhenj të shekullit XIX - Balzak, Dickens, Tolstoi, Dostojevski - t'i ngjallë njëfarë nostalgjie. Në atë epokë, koha rridhte më ngadalë dhe kjo i shkonte për shtat punës së një romancieri sepse ai e përqendronte më mirë energjinë dhe vëmendjen. Që atëherë, koha është përshpejtuar, çka shpjegon dallimin e madh ndërmjet monumenteve romaneske të së shkuarës, të ndërtuar si katedrale, me veprat pa vazhdimësi dhe të copëzuara të sotme. Nga ky këndvështrim, unë i përkas brezit të ndërmjetëm, dhe jam kureshtar të di se në ç'mënyrë brezat e ardhshëm që janë lindur me internetin, celularin, e-mail-et, twitter-at, do ta shprehin në letërsi këtë botë ku secili është “i lidhur” gjithë kohën dhe ku “rrjetet sociale” cenojnë intimitetin dhe sekretin tonë, që na përkisnin ende deri para pak kohe - sekretit që u jepte thellësi njerëzve dhe mund të shndërrohej në temë të madhe romani. Por dua të mbetem optimist për të ardhmen e letërsisë dhe jam i bindur se shkrimtarët e të ardhmes do ta vazhdojnë misionin, ashtu si çdo brez që prej Homerit...

Për më tepër, një shkrimtar, ashtu si çdo artist tjetër, sado i lidhur qoftë me epokën e tij, aq ngushtë sa të mos i shpëtojë dot, sa edhe ajrin që thith e quajmë “ajri i kohës”, ai, prapëseprapë, shpreh në veprat e tij diçka të pakohë. Në vëniet në skenë të veprave të Racine-s apo Shekspir-it, pak rëndësi ka nëse personazhet janë të veshur sipas kohës antike apo regjisori ka vendosur t'i veshë me bluxhins dhe xhup lëkure. Janë hollësi pa rëndësi. Kur lexojmë Tolstoin, harrojmë që Ana Karenina mbante fustane të vitit 1870, aq e afërt na duket edhe pas një shekulli e

gjysmë. Dhe pastaj, disa shkrimtarë si Edgar Poe, Melville apo Stendal, janë kuptuar më mirë 200 vjet pas vdekjes, sesa nga bashkëkohësit.

Tolstoi shkrihej me qiellin dhe peizazhin që përshkruante

Përfundimisht, cila është distanca e duhur ku duhet të qëndrojë një romancier? Anash jetës, për ta përshkruar atë, sepse nëse jeni brenda saj - në veprim - do të keni një imazh të turbullt. Por kjo distancë e vogël nuk e pengon fuqinë e tij për t'u identifikuar me personazhet dhe me ata apo ato që e kanë frymëzuar në jetën reale. Floberi ka thënë: "*Zonja Bovari jam unë*". Dhe Tolstoi u identifikua menjëherë me atë që e pa të hidhej në shinat e trenit një natë, në një stacion të Rosisë. Kjo dhunti për t'u identifikuar shkonte aq larg, sa që Tolstoi shkrihej me qiellin dhe peizazhin që përshkruante dhe që ai e përthithte të tërin, deri dhe përplasjen më të lehtë të qerpikëve të Ana Kareninës. Kjo gjendje e dytë është e kundërta e narcizmit, sepse kërkon harrimin e vetes dhe përqendrim të madh në të njëjtën kohë, me qëllim që të ngacmohesh nga detaji më i vogël. Kjo kërkon gjithashtu njëfarë vetmie. Ajo nuk është mbyllje në vetvete, por falë asaj arrin një shkallë të tillë përqendrimi dhe largpamësie ndaj botës që të rrethon, që të mund ta zhvendosësh në roman.

Kam besuar gjithmonë se poeti dhe romancieri i veshin me mister qenie që duken të zaptuara nga jeta e përditshme, gjëra në dukje të zakonshme - dhe kjo si pasojë e vëzhgimit të vëmendshëm dhe në një mënyrë pothuaj hipnotike. Nën vështrimin e tyre, jeta e zakonshme mbështillet me mister dhe merr një lloj fosforeshence që nuk e kishte në pamje të parë, por e kishte të fshehur në thellësi. Roli i poetit dhe romancierit, por edhe i piktorit, është të shpalosë këtë mister dhe fosforeshencë të fshehur te çdo njeri.

Më shkon mendja te kushëriri im i largët, piktori Amedeo Modigliani, punimet më prekëse të të cilit janë ato për të cilat ka zgjedhur modele anonime, fëmijë dhe vajza endacake, shërbëtore, fshatarë, shegertë. Ai i ka pikturuar me penel të mprehtë, çka të kujton traditën e shquar toskane, Botticelli-n dhe piktorët sienezë të Quattrocento-s. Kështu ai u ka dhënë - ose më saktë ka zbuluar - gjithë hijeshinë dhe fisnikërinë që ndodhej pas pamjes së tyre të përlur. Puna e romancierit duhet të shkojë në këtë drejtim. Imagjinata e tij nuk duhet ta shformojë realitetin, duhet ta përshkojë në thellësi dhe ta vendosë këtë realitet para vetes së tij, me forcën e rrezeve infra të kuqe apo ultraviolette për të gjetur atë që fshihet pas dukjes. Dhe unë gati-gati besoj se në rastin më të mirë, romancieri është një lloj fallxhori, madje edhe vizionari. Dhe gjithashtu sizmograf, gati për të regjistruar lëvizjet më të paperceptueshme.

Gjithmonë kam ngurrar para leximit të biografisë së këtij apo atij shkrimtari që kam admiruar. Biografët shpesh merren me hollësi, dëshmi jo gjithmonë të sakta, me tipare karakteri që shkaktajnë hutim ose zhgënjim, dhe kjo më sjell ndër mend zhurmimet në disa emisione në radio që i bëjnë të padëgjueshme muzikën dhe zërat. Vetëm leximi i librave të tij na hap derën për në intimitetin e shkrimtarit, dhe vetëm aty ai është në formën e tij të plotë dhe na flet me zë të ulët pa patur asnjë zhurmues parazit aty rrotull.

Por duke lexuar biografinë e një shkrimtari, zbulojmë ndonjë ngjarje që ka lënë gjurmë në fëmijërinë e tij dhe është bërë matricë e veprës së tij të ardhshme,

edhe pse ai mund të mos jetë gjithmonë i vetëdijshëm për këtë, kjo ngjarje, në forma të ndryshme, nuk u ndahet librave të tij. Sot, sjell në mend Alfred Hitchcock, ai nuk ishte shkrimtar, por megjithatë filmat e tij kanë forcën dhe kohezionin e një veprë romaneske. Kur i biri ishte pesë vjeç, babai i Hitchcock-ut e dërgoi t'i çonte një letër një miku të tij, komisar policie. Djali çoi letrën, polici e mbylli në një qeli nga ato ku mbahen gjatë natës kriminelë të ndryshëm. Fëmija, i trembur deri në palcë, kishte qëndruar aty një orë, pastaj komisar i kishte liruar duke i thënë: "Ti e di tashmë atë që të pret, nëse do të bësh diçka të keqe në jetë". Ky komisar policie, me parime të çuditshme edukimi, është pa dyshim në origjinë të atmosferës së lënë pezull dhe ankthit që gjendet në të gjithë filmat e Alfred Hitchcock-ut.

Vetëm kohë më vonë, fëmijëria ime më është dukur enigmatike

Nuk dua t'ju bezdis me rastin tim personal, por besoj se disa ngjarje nga fëmijëria ime kanë shërbyer më vonë si matricë e librave të mi. Shumë shpesh ndodhesha larg prindërve të mi, më çonin te miq të tyre për të cilët unë nuk dija asgjë, dhe nëpër vende e banesa të ndryshme. Për momentin, një fëmijë nuk habitet nga asgjë, edhe në u ndodhtë në situata të çuditshme, atij i duket normale. Vetëm kohë më vonë fëmijëria ime m'u duk enigmatike dhe u përpoqa të merrja vesh më tepër për njerëzit te të cilët më kishin lënë prindërit dhe për vendet e ndryshme ku kam jetuar. Por nuk ia kam dalë të identifikoj pjesën më të madhe të këtyre njerëzve, as të gjej me saktësi topografike të gjitha vendet dhe shtëpitë e të shkuarës. Kjo dëshirë për të zgjidhur enigmat, pa ia arritur vërtet, dhe për të zbuluar misterin, më ka ngjallur dëshirën për të shkruar, a thua se e shkruara dhe imagjinaria do të më ndihmonin të zgjidhja, më në fund, enigmat dhe misteret.

Dhe meqë jemi te "misteret", unë sjell në mend një roman francez të shekullit XIX: *Misteret e Parisit*. Qyteti i madh, pra Parisi, qyteti im i lindjes, lidhet me përshtypjet e mia të para të fëmijërisë dhe këto përshtypje ishin aq të forta, saqë prej atëherë nuk kam reshtur së eksploruari "misteret e Parisit". Rreth moshës 9 a 10 vjeç, më ndodhte të shëtisja vetëm dhe, me gjithë frikën se mos humbisja, shkoja larg nëpër lagje që nuk i njihja, në të djathtë të lumit Senë. Por ishte ditë dhe kjo më qetësonte. Në fillim të adoleshencës, përpiqesha të mposhtja frikën time dhe të bridhja natën me metro, në lagje edhe më të largëta. Kështu e mësojmë qytetin, dhe në lidhje me këtë, kam ndjekur shembullin e shumë romancierëve që admirojnë dhe për të cilët, që prej shekullit XIX, qytetet e mëdha - Paris, Londër, Shën Petersburg, Stockholm - kanë qenë dekor dhe temë kryesore e librave të tyre.

Edgar Poe në novelën "Njeriu i turmave" ka qenë ndër të parët që ka shkruar për ato valë njerëzore që sodiste pas xhamave të kafesë dhe që rrëshqisnin pa reshtur në trotuare. Ai vë re një burrë të moshuar me pamje të çuditshme dhe e ndjek pas gjatë natës në lagje të ndryshme të Londrës për të marrë vesh më shumë për të. Por i panjohuri është "njeriu i turmës" dhe është e kotë ta ndjekësh, sepse ai do të mbetet gjithmonë anonim dhe nuk do të dimë kurrë ndonjë gjë për të. Ai nuk ka ekzistencë individuale, ai thjesht bën pjesë në këtë masë kalimtarësh që ecin ose shtynë njëri-tjetrin dhe humbin nëpër rrugë.

Falë topografisë së një qyteti, ju kujtohet gjithë jeta juaj

Më kujtohet edhe një ngjarje nga rinia e poetit Thomas de Quincey, që e shënjoj për jetë. Në Londër, në turmën e *Oxford Street*, ai u lidh me një vajzë të re,

një nga ato takime rastësore në qytetet e mëdha. Ai kaloi shumë ditë në shoqërinë e saj por iu desh të largohej nga Londra për ca kohë. Kishin rënë dakord që pas një jave ajo ta priste çdo mbrëmje në të njëjtën orë, në cep të *Tichfield Street*. Por ata të dy nuk u takuan kurrë më. “*Sigurisht, ne e kemi kërkuar shumë herë njëri-tjetrin në të njëjtën kohë, në labirintin e madh Londër; ndoshta kemi qenë vetëm 18 metra larg - nuk duhen më tepër për të pësuar një ndarje të përjetshme.*”

Për ata që kanë lindur dhe kanë jetuar në të njëjtin qytet, me kalimin e viteve, çdo lagje, çdo rrugë e qytetit, të sjell në mend një kujtim, një takim, një hidhërim, një çast lumturie. Shpesh, e njëjta rrugë ju kujton ngjarje të ndryshme, në mënyrë të tillë që falë topografisë së një qyteti, na kujtohet e gjithë jeta, shtresë pas shtrese, sikur mund të deshifroni shkrimet e mbivendosura të një palimpsesti. Dhe gjithashtu jetën e të tjerëve, të mijëra të panjohurve, të hasur nëpër rrugë apo në korridoret e metrove në orët e pikut.

Kështu, kur isha i ri, përpiqesha të gjeja numërorë të vjetër të Parisit, për të ndihmuar veten për të shkruar, sidomos ato që emrat ishin vendosur sipas rrugëve ose sipas numrit të banesave. Më dukej sikur faqe pas faqeje, kisha para syve një radiografi të qytetit, por të një qyteti të përpirë, si Atlantida, dhe sikur thithja aromë kohe. Ngaqë kishin kaluar vite, e vetmja gjurmë që kishin lënë ata mijëra të panjohur, ishin emrat, adresat dhe numrat e telefonit. Ndonjëherë, një emër zhdukej nga një vit në tjetrin. Kishte diçka marramendëse teksa shfletoja ato numërorë të vjetër duke menduar se tash e tutje numrat e telefonit nuk përgjigjeshin. Kohë më vonë, më pataksën vargjet e një poeme të Ossip Mandelstam-it:

*U ktheva përsëri në qytetin tim, familjar deri në ofshamë,
Deri në gungat e fëmijërisë, deri në nervat nën lëkurë,
Shën Petërburg!
Të telefonave tim, numrat ke ti,
Shën Petërburg! Kam adresat e dikurshme,
I njoh nga zëri të vdekurit.*

Po, më duket se shfletimi i numërorëve të vjetër të Parisit më ngjali dëshirën për të shkruar librat e mi të parë. Mjaftonte të nënvizoja me laps emrin e një të panjohuri, adresën, numrin e telefonit, dhe të përfytyroja si kishte qenë jeta e tij ndër ata qindra mijëra njerëz.

Mund të humbësh ose të zhdukesh në një qytet të madh. Mund të ndryshosh identitetet dhe të jetosh një jetë të re. Mund t’i futesh një hetimi të gjatë për të gjetur gjurmët e dikujt, duke patur si fillim vetëm një a dy adresa në një lagje të humbur. *Banesa e fundit e njohur*. Ky shënim i shkurtër që figuron në skedën e kërkimit, më ka bërë gjithmonë efekt të çuditshëm. Temat e zhdukjes, të identitetit, të kohës që kalon, janë të lidhura gjithmonë me topografinë e qyteteve të mëdha. Ja përse, që prej shekullit XIX kanë qenë shpesh fusha të romancierëve dhe disa prej më të mëdhenjve janë të lidhur me një qytet: Balzaku dhe Parisi, Dickens dhe Londra, Dostojevski dhe Shën Petërburgu, Nagai Kafû dhe Tokio, Hjalmar Söderberg dhe Stokholm.

I përkas një brezi që është ndikuar nga këta romancierë dhe ka dashur edhe ai të eksplorojë atë që Bodleri e quante “palat e dredhëzuara të kryeqyteteve të mëdha”. Sigurisht, këto kanë ndryshuar që prej 50 vjetësh, pra që prej epokës kur adoleshentët e moshës sime përjetonin ndjesi të forta duke zbuluar qytetin e tyre. Disa qytete, në Amerikë dhe në atë që quhej bota e tretë, janë kthyer në “megapole” me përmasa shqetësuese. Banorët e tyre janë ngujuar në lagje shpesh të braktisura dhe në klimë lufte sociale. Getot janë shtuar dhe janë bërë gjithnjë e më tentakulare. Deri në shekullin XX, romancierët ruanin një vizion deri diku “romantik” për qytetin, jo shumë i ndryshëm nga ai i Dikensit apo Bodlerit. Dhe pikërisht për këtë arsye do të doja të dija se si romancierët e ardhshëm do t’i trajtojnë këto përqendrimet urbane gjiganteske në veprat e tyre.

Të lindurit në vitin 1945 “më ka bërë më të ndjeshëm ndaj temës së kujtesës dhe harrimit”

Ju patët mirësinë të shpreheni për librat e mi se karakterizohen nga “arti i kujtesës me të cilin përshkruhen fate njerëzore nga më të pakapshmit”. Por një kompliment i tillë shkon përtej personit tim. Kjo kujtesë e veçantë që përpiket të mbledhë disa grimca të së kaluarës dhe ato pak gjurmë që kanë lënë mbi tokë anonimë dhe të panjohur, është gjithashtu e lidhur me datën time të lindjes: 1945. Të lindësh në vitin 1945, pasi u shkatërruan qytete dhe u zhdukën popullsi të tëra, më ka bërë mua, dhe ata ta brezit tim, më të ndjeshëm ndaj temave të kujtesës dhe harrimit.

Fatkeqësisht, më duket se kërkimi i kohës së humbur nuk mund të bëhet më me forcën dhe çiltërsinë e Marsel Prustit. Shoqëria që ai përshkruante ishte ende e qëndrueshme, shoqëri e shekullit XIX. Kujtesa e Prustit bën të dalë në sipërfaqe e kaluara me të gjitha detajet e saj, si një tablo e gjallë. Sot kam përshtypjen se kujtesa është shumë më e pasigurt dhe duhet të luftojë pareshtur kundër amnezisë dhe harrimit. Për shkak të kësaj shtrese, të kësaj mase harrimi që mbulon gjithçka, arrijmë të kapim vetëm fragmente nga e kaluara, gjurmë të ndërprera, fate njerëzore të përvjedhura dhe pothuaj të pakapshme.

Por është, pa dyshim, talenti i romancierit që, mbi faqen e bardhë të harresës, nxjerr në dritë fjalë gjysmë të fshira, si ato ajsbergët e humbur që dalin në sipërfaqe të oqeanit.

(Fjalimi i fituesit të “Nobelit” për letërsi pas marrjes së çmimit. Marrë nga “Le Monde” Përktheu: Blerta Hyska)

SHEFQET ZEKOLLI

JOSIF BAGERI - KRIJUES I PARË I LETËRSISË SHQIPE PËR FËMIJË NË MAQEDONI

Gjysma e dytë e shekullit të nëntëmbëdhjetë për ne shqiptarët ishte në shenjë e organizimeve më të theksuara në të gjitha fushat e mundshme të veprimit, qoftë intelektual a konkret në teren për çlirimin definitiv prej pushtuesit otoman. Ky organizim dhe kjo lëvizje e emëruar si rilindje kombëtare dhe e shtrirë në të gjitha trojet e Ballkanit ku shqiptarët përbënin shumicë të popullsisë, nuk bënte diferencime klanore e krahinore, dallime të përkatësisë fetare a sociale, gjithmonë kur bëhet fjalë për atdhetarët dhe intelektualët e vërtetë. Intelektualët të cilët ishin në numër të vogël dhe të cilët ne i njohim edhe si ndër krijuesit e parë letrarë të ne, ishin ata të cilët e bartën barrën kryesore të sensibilizimit të masave më të gjëra të popullit dhe të ndërgjegjësimit të tyre për tejkalimin e ndasive të cilat ishin ngulitur prej pushtuesve të njëpasnjëshëm. Kë të sensibilizim dhe këtë ndërgjegjësim ata e bënë nëpërmjet të veprimit propagandistik në teren, nëpërmjet të shkrimit të pamfleteve të ndryshme, botimit të gazetave, revistave, teksteve shkollore dhe librave artistik të cila, meqenëse ishin ndër të parat të ne, bënë bujë të madhe dhe mësoheshin përmendësh. Këtë veprimtari ata ishin të detyruar ta bënin, në të shumtën e rasteve nga jashtë, në qendrat e ndryshme të shteteve të Ballkanit e më gjerë ku ata, të detyruar nga gjendja e rëndë ekonomike, vepronin me përkushtimin e patriotëve të vërtetë.

Ndër personalitetet më të shquara të këtyre anëve dhe gjithsesi krijuesi i parë për fëmijë i pjesës lindore të Shqipërisë së atëhershme, është Josif Bageri. Megjithëse i lindur dhe i rritur në kushte tepër të rënda sociale e ekonomike, Josif Bageri, falë edhe të atit të tij Jovanit, që në fëmijërinë e hershme u brumos me një kulturë të gjerë atdhedashurie, me idenë e një njeriu të ndërgjegjshëm se gjuha, vendi e kombi janë ndër elementet kryesore që iu japin kuptim jetës dhe të qenit i lirë dhe i ngritur. Nga ana tjetër, krijimtaria e llojllojshme dhe shumë e pasur gojore e krijuar ndër shekuj në këto anë, doket, zakonet dhe traditat e mira të vetë popullit të Rekës të cilat mësonin se nderi, dashuria ndaj njerëzve, besa e dhënë dhe cilësi tjera pozitive duhet ruajtur e kultivuar prej brezi në brez, duke bërë kështu diferencimin prej të gjitha vetive tjera të ardhura dhunshëm nga jashtë dhe të cilat rrezikonin të nguliteshin edhe në këto anë dhe te populli shqiptar.

Megjithëse zyrtarisht është shënuar se Josif Jovan Bageri lindi në vitin 1870, prapë se prapë besohet, edhe në bazë të disa shkrimeve të tij se ai lindi në vitin

1868.¹ Vendlindja e tij, Nistrova, atëherë nën juridiksionin e Dibrës ndërsa tani bie në Komunën e Gostivarit, është një fshat i vjetër të cilin e gjejmë të regjistruar në defterët e vjetër. Banorët e Nistrovës, të konfesionit ortodoks e ruajtën identitetin e tyre edhe fetar edhe kombëtar, me gjithë presionet e dhunën e ushtruar në mënyrë të vazhdueshme. Ai sikur edhe bashkëfshatarët tjerë të Nistrovës, ngjashëm sikur edhe pothuajse të gjithë shqiptarët e asaj kohe, i shin të varfër por të vendosur për t'i përballuar të gjitha të këqijat që sillte koha. Dashuria e madhe për vendin e lindjes e shtëpinë që shpesh herë identifikohen me atdheun a “atëninë” si’q e quan Bageri, e inspiruan atë që të shkruaj vjershën “Shtëpia ime”:

Sa e bukur kja shtëpia,
Ku un u kom lind;
Për mu kjo asht atënia,
Gjith ktu u kom gjind.

Gjith kujë ku i ka ra kryet,
I asht atëni;
Mos’ kujtojn se asht gënjyet,
Se bukur e di.

Për shkak të varfërisë së madhe, gjyshi i tij Nikolla, sikur edhe i ati Jovani, ushtronin zanatin e mbathësve të kuajve, zanatin e nallbanit, për të mbajtur familjen. Edhe vetë Josifi i ri, për shkak të këtyre kushteve, detyrohet të shpërngulet në Sofje ku ushtron zanatin e këpucëtarit. Krahas kësaj pune, Josif Bageri në Sofje shumë herët inkadrohet në lëvizjen e shqiptarëve duke themeluar në vitin 1893 shoqërinë “Dëshira” rreth së cilës u mblodhën patriotë dhe intelektual të kohës. Atje, në Sofje Bageri do të qojë një jetë të vështirë, së bashku me të shoqen Vasiliken dhe katër fëmijët e vegjël. Kjo gjendje e rëndë, i varfër dhe i sëmurë, e mundonte poetin andaj këto emocione ai i shpreh nëpërmjet vargjeve shumë pikëlluese, në vjershën “Dëshira ime”. Disponimi i keq i poetit, i krijuar prej kësaj gjendje, e shtynë atë të mendoj të kthehet në “atni”, duke shpresuar se atje do të gjej prehje dhe shpëtim:

O, sa shum sot jom i s’mun!
Në shtrat dergjem si kërcun;
Un i ngrati keq rrënkuj,
Dhe bar s’di se ku t’kërkoj!

Ah, sa keq uni sot ndodhem,
Dhe tuj mendue shum lodhem!
Po qysh t’ja boj me pes fëmi,
A mundi me shku n’Atni?

¹ Shqypeja e Shqypenis”, Sofje 1909

Keq dhe keq m'u ka mërzit;
 Mjekës me thirr do vizit;
 Pa t'holla s'të kqyr me sy-
 Dhe mu zembra keq m'u ndry...

Gjatë gjithë qëndrimit të tij në Sofje dhe më vonë në Durrës, deri sa vdiq në Prishtinë, në të kthyer në Sofje, në vitin 1915, Josif Bageri nuk rreshti së punuari për çështjen kombëtare nëpërmjet të bashkëpunimit me shtypin e kohës ku ai botonte artikuj të ndryshëm, kryesisht me motive politike si ishte rasti me gazetën “*Shpnesa e Shqypnisë*” gjatë viteve 1905-1907 e cila shtypej në Dubrovnik nën drejtimin e Nikollë Ivanajt, pastaj me hapjen e një shkolle shqipe në vendlindje në vitin 1908, botimin e gazetës “*Shqypeja e Shqypnisë*” në vitin 1910 në Sofje, redaktimin e revistës “*Ushtima e Krujës*” të cilën e financonte vetë qeveria si dhe nëpërmjet të shumë formave dhe mënyrave tjera të veprimit në funksion të çështjes shqiptare. Në vitin 1910 Josif Bageri boton vëllimin me vjersha e tregime “*Kopësht malësori*”. Edhe në revistat dhe gazetat e kohës kishte botuar një numër të madh artikujsh të ndryshëm, tregime të shkurta, vjersha dhe krijime tjera në vargje.

Josif Bageri njihet si shkrimtari dhe poeti i parë për fëmijë i këtyre anëve, poeti i Rekës. Karakteristikë e gjithë veprimtarisë së Josif Bagerit, qoftë kjo e shkruar për fëmijë a për të rritur por që për shkak të përmbajtjeve që ka dhe porosive që sjell ka hyrë në fondin e letërsisë për fëmijë a për të rinj, është angazhimi i tij për një organizim më të ngjeshur për t'u çliruar prej pushtuesve, ngritja e vetëdijes së shqiptarëve, posaçërisht të rinjve për ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kombëtar dhe arsimimi i brezave të rinj. Kë të e dëshmon edhe aktiviteti i tij në fushën e botimit të artikujve të ndryshëm sensibilizues e propagandistik për këtë çështje si dhe hapja e shkollës së parë shqipe në fshatin e tij të lindjes në vitin 1908. Megjithatë dëshirën e Bagerit për shkollimin dhe edukimin e gjeneratave të reja më së miri e gjejmë te vjersha “*Eni të gjith në mësimtore*”:

Eni fëmi dor për dore!
 Na të shkojm në mësimtore;
 Gjuhën holl e mir t'a msojm:
 Amë e atë na të nderojm...

Eni djema dhe ju cika,
 Se s'asht koh tash për ashika!
 Po të shkojm dhe të msojm;
 Gjuhën shqype t'pasunojm...

Eni gjith tash, o fëmi!
 Në mësimtore t'shkojm me mijë,
 Se gjuhën e vet dot, msojm!
 Jo te tjera, që s'kuptojm...

Eni gjith ju me nxitim,

Gjuhën tën të msojm me gzim!
Dhe të kjemi urtësi,
Se kjo siell mirësi.

Edhe vjershat tjera të Bagerit kushtuar fëmijëve bartin këtë porosi, këshillë dhe dëshirë të tij; arsimimin e drejtë në gjuhën e nënës. Vetë nënat shqiptare, sipas poetit janë ato të cilat i shtyjnë, këshillojnë e motivojnë fëmijët e tyre për të mësuar në gjuhën shqipe, për të mësuar historinë kombëtare, duke theksuar gjithë të mirat dhe përparësitë që sjell mësimi. Njëra prej vjershave më të mira të cilat janë shumë motivuese dhe me porosi edukative është “E ama dhe i biri”:

Nxito bir ti nxito!
Dhe në msonjëtoje shko;
Shtrëngohu shpejt të mbrish,
Po dhe urt atje të rrish.

Atje e mira të thret,
Ja dhe shoku ku të pret;
Shpejt sa je ti i ri,
Të msojsh shqyp istori!

Ja kumbona rrehën!
Ti ma s’je për n’prehën,
Po për në msimtoje;
Ze shokun për dore.

Nxito mos vonohesh,
Dhe bukur të msohesh!...
Fort mir ti ven roe,
Dhe msojsin ndëgjoe!...

Vjersha tjetër “*Ata i mir dhe i biri*” është shumë domethënëse dhe edukative. Përkundër dëshirë së madhe të birit të tij për të shkuar me të atin në arë për të shikuar si ai lëvron, babai, i vetëdijshëm për vlerën e shkollimit dhe dëshirën që i biri i tij mos të mbetet i pa arsimuar, e këshillon atë të shkojë në “msimtoje”, atje ku e ka vendin:

“...-E tani – ti – në mësimitore,
Dit perdit, atje të shkojsh;
Po shko dejt, e jo terthore...
Dhe tjuhën e vet të msojsh.”

Të gjitha vjershat e Josif Bagerit kanë këto përmbajtje dhe janë të motivuara nga jeta e vështirë e shqiptarëve, e ndikuar kjo nga jeta e vështirë e vetë poetit, malli për vendlindjen e atdheun, dëshira për të jetuar të lirë dhe në paqe, dëshira

për arsimim,apostrofimi i bukurive të natyrës dhe shumë elemente tjera të cilat i edukojnë fëmijët dhe i motivojnë ata për të mësuar dhe edukuar në frymën e atdhetarizmit shqiptar. Dëshira e poetit për të mësuar në gjuhën shqipe e shtyjnë atë kah dëshira për t'u kthyer në rininë e tij, për mbrujtur me njohuri të reja duke kujtuar edhe këngët e djepit e të trimërisë për burrat e dheut që luftuan për vendin dhe kombin. Këto më së miri i gjejmë te vjersha *“Ditët fletyrojn”*.

Më shkoj koha, kotë në kotina!
 Fleturuen dit të arta shumë;
 Në një moshje un të mesme mbrrina,
 Po më shkoj të riit mu, ah! në lum!
 Ngushllime dhe shpesa të xbrasta
 Vall, a mundin me pas kaq fuqi?
 Për me m'kthye mu, ah! dhe njëherë:
 Në at' lumni, ah! në djalëni!...
 Të shtërngohem në mësim si duhet,
 Për me msue gjuhën e vet mir:
 Ta leciti dhe ashtu si shkruhet,-
 Më një t'madhe, ah! shpres e dëshir.
 Si stërgjyshët me pushk të bekuet:
 Tokën me mpru, se mbeta e ngrat!”
 Cila zembër, mundën me durue!
 Kur e ndien kënkën e trimnis?
 C'ka këndue, mbi gjept' ajo grue,-
 Tuj përkundun, trimat e Shqypnis!
 Po për kohën, kot që na ka shkue;
 Kuj s'i dhimbet, vall! se s'kthehet dot!...
 Përande, ah! orën me fitue...
 Ah! dhe gjuhën, se kështu do sot.

Ndasitë të cilat ishin evidente në atë kohë, për shkak të interesave personale a krahinore pastaj për shkak të interesave të huaja a për shkak të dallimeve fetare, ishin një breng e madhe e poetit. Ai angazhohet që të tejkalohen këto mosmarrëveshje, për interes të vendit dhe kombit. Me gjasë poeti ishte në dijen për rrezikun që këto dallime iu kanoseshin shqiptarëve dhe posaçërisht rekasve, gjë që u dëshmuua më vonë si rrezik real i cili ka lënë pasoja të mëdha. Këto shqetësime poeti i përcjell të vjersha e gjatë *“Vajtim e mallkim”*.

O, shqypni për ty mejtoj!
 Për ty, po qajë e vajtoj,
 Se djemt e tu keq jon da
 Dhe po vriten vlla me vlla!...

.....

Nipal thon: jemi taljan”!
Disa: tyrq, grek e sllavjan”!
Tjerët mbahen shumë të menciëm,
Si do fmi e përkdhelcëm.

.....

O, ame, Rekas, bijt e tu,
Ma shumë se t’gjith jon hutu!
Dërgojn para n’patrikhon,-
Thon se sllaf ne kemi kjon!

.....

Disa mbahen shumë azgon,
Se paskan emnin Osmon!
Kta i bien vllait kres...
Për të shkretën and të fes....”

Njëra prej vjershave më të bukura për fëmijë të Josfi Bagerit është gjithsesi “Djali dhe bilbili”. Vjersha është e ndarë në tri pjesë dhe trajton motivin e vjetër të bilbilit të mbyllur në kafaz dhe dëshirën e tij për të jetuar i lirë, në natyrë. Djali, si bashkëbisedues i bilbilit, është shembull i mirësisë dhe i dashurisë për zogun në kafaz. Ai është kujdesur t’i bëjë atij një kafaz të bukur ndërsa e ushqen rregullisht. Megjithatë, bilbili është i pikëlluar dhe rri gjithmonë në mendime. Por edhe vetë djali është i pikëlluar për disponimin e keq të bilbilit.

-Pse kështu, o shpez e malit?
C’po mendohesh, O bilbil?
Pse kështu e ki mvjerr kryet?!

Në të bukurin Kundill!

Kqyr sa bukur asht i thurun:
Ky kundili me argjënd!
Jo si ferri yt i cthurun;
Ku ki droe ti gjith kond...

Ktu je mburun, s’të nget fmia,
Si përjashta ku t’kom zonë!-
Ja dhe gjithnjë t’ap thërmia...
Kurri unët s’të kom lonë.

Ngre pak kryet e kqyr botën,-
Se si gzohet në këtë jet;
Fletyro dhe lëkund rrotën!-
Shtall dhe shkundi ato flet.

Nise kënkën, at, të gjatën!...
 Mos mendo e mos' ki frig;
 Dridhja bukur, pac uratën-
 Dhe mos ki për as' gjë brig.

Ja kundilin t'a pastrova:
 Dhe të shtiva mel e grun;
 Kurri uni s'të harrova!...
 E ti s'po këndon nëpërdhun...

Bilbili përgjigjet

Ah! or' djal, ti do me ngjuet;
 Kënkën t'ime shumë të gjat!...
 Ja dhe un' i përvëluet...
 Nisi t'këndo, por tuj qajt.

Keq më vjen or' djal i mitun,
 Se jom msue n'vend të gjënd;
 Ktu s'më duket kurri bukur!...
 Në kundilin e argjënd.

T'falem – nderit për ushqimin,
 Për të mirat që m'ke bo;
 Po s'e gjej ktu ngushllimin!...
 Në këtë kundil, në këtë gjë.

Përande uni të lutem,-
 Të m'lëshojsh, se shumë më dhemb!...
 Për at'vandin që jom lindun:
 Ku kërcenja rremb më rremb.

Ah, tëm' lëshojsh për me shkue,
 Se ktu un jom; si n'skëter!...
 Me vrap kishja fleturue:
 Tuj këndue, ferr më ferr.

Lëshom, t'lutem! prej kundilit;
 O, i bukuri djalosh!-
 Të shkoj atje ku jom lindun,
 Se jom xbardh e bo larosh!...

Kur tëm' shohën të mallzuet!
 Gjith ata shokët e mi:

Eh, sa shum u kishin gzuët!...
Se un jom ma në liri...

Djali

Ah! ndëgjova kënkën tënde,
Po në mal ti paske dash?
N'ata pyj e nëpër kronde;
Atje t'rrojsh, atje të hash?...

Ke të drejt, se Fisikia,
Kështu e do, gjith si kush;
Asht krihue kah Perndia:
Mos me e ngushtu kurkush!...

Përande, o'shepez e malit,
S'e pëlqen kundiln e rgjënd!...
Dhe ato shum ngushullime,
Po do mal dhe fush të gjënd!...

Ja un derën e kundilit:
Po t'a celi të shpëtojsh!...
Udh e mbar, o shepez e malit;
Në vendin e vet të shkojsh!...

-Fërk! bilbili, prej kundilit!
Me vrap! befas! fleturoj!...
Tuj thon djalit: "*lamtumir*"!
Prej robnie ky shpëtoj!...

Sendërtimi krijues, profilizimi si poet lirik që një vëmendje të veçantë në krijimet e tij ia kushton vendlindjes dhe atdheut në përgjithësi si dhe diferencimi i Josif Bagerit prej krijuesve tjerë si një poet i popullit dhe posaçërisht interesimi i tij për krijimet për fëmijë, është ndër karakteristikat të cilat atë dhe rrugën e tij krijuese do ta përcjellin deri në fund të jetës. Krijimtaria e tij letrare kështu do të jetë shumëdimensionale; ajo edukon fëmijët nëpërmjet porosive që përcjell dhe i sensibilizon e motivon për një punë më të ngjeshur për ruajtjen e kultivimin e dashurisë ndaj gjuhës shqipe dhe kombit në përgjithësi duke i luftuar dukuritë negative siç janë ndasitë në baza konfesionale nga njëra anë dhe nga ana tjetër vjershat e Josif Bagerit fëmijëve iu ofrojnë njohuri të reja për natyrën dhe fenomenet e saj si dhe për origjinën e shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe. Përveq kësaj, në mungesë të teksteve shkollore, vetë vjershat e Bagerit do të shërbejnë si libra shkollorë, duke zëvendësuar dhe plotësuar kështu boshllëkun që ishte krijuar në këtë fushë. Vjershat e Josif Bagerit "i mësojnë fëmijët që t'u shmangen vetive të këqija, dobësive njerëzore, megalomanisë, smirës dhe të fëmijët mbolli ndjenjën

e atdhedashurisë, dashurinë ndaj prindërve, shkollës, dijes, punëve të mira drejt veprave fisnike. Edhe sot vjershat e Bagerit për fëmijët apo thënë ndryshe për të rinjtë ruajnë ndikimin e një frymëzimi pozitiv”.² Krijimtaria letrare e Josif Bagerit, posaçërisht vjershat e krijuara për fëmijë, thënë në përgjithësi është e përshtatshme me një gjuhë burimore të Rekës së Gostivarit, një krahine e cila me veçantitë e veta, kulturën e pasur popullore, koloritin e veshjeve kombëtare, traditën e theksuar të përballjes me rrebeshet që sillte koha dhe me një sërë veçorish tjera karakteristike për këto anë, u brumos dhe u zhvillua në një krijimtari letrare e publicistike shumë të rëndësishme dhe domethënëse, një krijimtari e cila shërbeu si model për krijuesit e ardhshëm të cilët ditën ta vlerësojnë lart angazhimin e panjohur deri atëherë të një poeti të përvuajtur po që nuk diti të dorëzohej kurrë.³

² Dr. Ejup Ajdini, Letërsia shqipe për fëmijë në Maqedoni, Shtëpia botuese “Menada”, Tetovë 2008, faqe 59

³ Vjershat e Josif Bagerit të prezentuara këtu janë marrë nga vëllimi “Kopësht Malësori” dhe “Letërkëmbime”, botuar nga Shtëpia botuese “Vatra”, Shkup 2012

LULJETA BORA (BEJLERI)

POEZIA SHQIPE E VITEVE '80 MES TRADITËS DHE RISISË

Abstrakt

Poezia shqipe e viteve '80 është periudha e ndërmjetme e zhvillimit të poezisë shqipe mes traditës dhe risisë. Themi kështu, sepse ndonëse nuk kemi të bëjmë me një periudhë kohore të konsiderueshme në vite, në këta 10 vjet, poezia shfaq dukuri të ndjeshme lëvizjeje, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Ndërkohë që pena të tilla të poezisë si Kadare, Arapi, Agolli ishin bërë tashtë modernë klasikë (që prej risive që kërkuan me ngulm në vitin '60) dhe poetë të tjerë si Moikom Zeqo, Bardhyl Londo, Xhevahir Spahiu po afirmoheshin, poetë të tjerë të rinj po ndiqnin rrugën e poezisë. Ishin pikërisht zëra të tillë si Ndoc Gjetja, Ndoc Papeleka, Preç Zogaj, Mark Marku, Ervin Hatibi, Mimoza Ahmeti që do sillnin frymë të re në poezinë shqipe. Po të ndjekim botimet në periodikët letrarë më të rëndësishëm të kohës (gazeta "Drita", revista "Nëntori", gazeta "Zëri i rinisë") vëmë re këto dukuri:

Poezia shqipe '80 e deri në '85 dallohet për frymën e të madhërishmes, e cila vjen si reminiscencë e poezisë së traditës. Karakteristikë e kësaj poezie janë shkrimi për një tematikë të caktuar, vargëzimet sipas modelit popullor, toni i lartë. Mitet historike dhe heronjtë e ditës janë pjesë e kësaj poezie, por ka poetë që lëvrojnë në mënyrë origjinale mitin e jetës, vdekjes, të tokës etj duke i parë në mënyrë heroike, historike, apo edhe erotike.

Dukuria e dytë është lëvrimi i poezisë industriale e cila përpigjet të kontrollohet nga ideologjia e sistemit të kohës. Ky tip poezie i kushtohet atdheut dhe merr përsipër të pasqyrojë ndryshimet që ndodhin në të. Në vargje mbizotëron patosi që sjellin aspiratat për një të ardhme të lumtur e më të ndritur. Kjo bën që poezi të tilla të përcaktohen mes një romantizmi të vonë, një romantizëm të realizmit socialist. Entuziazmi fals është pjesë e kësaj poezie.

Tendenca e ideologjisë së kohës për ta bërë artin "pronë të masave", bën që "lumenj poezie" jo cilësore të botohen në periodikët letrarë të kohës. Shumë emra poetësh që sot nuk na thonë sot asgjë, e mbi të gjitha shumë poetë-punëtorë, ushtarë, studentë botojnë poezitë e tyre. Duket sikur çdokush mund të botojë. Poezisë i humb individualiteti, nervi dhe origjinaliteti kombëtar. "Sëmundja" e poezisë bëhet aq e dukshme. Ajo bëhet "ffalamane" Duke synuar t'i thotë të gjitha rrëshqet drejt thjeshtëzimit si rëndomësi dhe degradon formën. Pena të pa kualifikuara mendojnë se mund të vargëzohet lehtësisht në varg të lirë duke shpërfillur kështu ritmin e brendshëm që vjen nga kadencat, lirizmi, imazhet, loja me kuptimësinë e fjalës dhe emocioni që sjell fjala.

Pas vitit '85 dhe sidomos në vitin '88 ndjehet era e ndryshimit. Kritikë e poetë të talentuar shqetësohen për të ardhmen e poezisë. Tashmë botohen më pak poezi dhe ato janë më cilësore. Poezia ka një prirje pozitive ku heroi lirik vjen më i emancipuar dhe kjo nuk duket vetëm në shkallën e informacionit, por edhe në pasurimin e ideve dhe mjeteve shprehëse. Poezia shfaq prirje të dukshme për t'u larguar nga manifestimet e jashtme agjitative, deklarativizmi dhe moralizimi i jashtëm. Dukuri të tilla si ankthi, trishtimi, vdekja, koha etj zënë tashmë vend në përjetimet e një brezi të ri poetësh. Me pak fjalë merita më e madhe e poezive të viteve '80, është se ajo filloi ta dallojë veten nga poezia e mëparshme në vëmendjen ndaj dukurive të tilla si dhimbja, vdekja, trishtimi, vuajtja etj ..duke e larguar nga vëmendja himnizimin dhe duke larguar nga qendra figura të tilla si bujku, kooperativisti, vjelësja etj. Dallojnë tipe risi të poezisë si: poezia personale, poezia me në qendër unin lirik, poezia si imazh pa domethënie në dukje, etj.

Fjalë kyçe: periudhë poetike, traditë poetike, risi poetike, strukturë poetike.

Të trajtosh një periudhë dhjetë –vjeçare të jetës së poezisë së një kombi, mund të jetë po aq interesante sa një trajtim shekullor i jetës së lëvrimit të saj dhe kërkon po aq mund, sa në depërtimin e strukturave të brendshme të zhvillimi të poezisë, aq edhe në zbulimin e raporteve vetjake që ndërtojnë poetët me traditën poetike, apo dukuritë e përditshmërisë që ndërkëmbehen duke mos e lejuar asnjëherë të tashmen të qëndrojë përgjithmonë.

Është shkruar jo pak për vlerat tona letrare kombëtare, pjesë e universit letrar dhe artistik që nuk ka kufij, por gjithmonë ngelet diçka për të thënë për të shkruarën. Prandaj ky artikull përpiket të qëmtojë dobësi e vlera, mbresa e emocione të harruara të poezisë shqipe që presin të dalin në dritë.

“Flaka e vjetër”

Së pari poezia shqipe e viteve '80 (kemi parasysh këtu vetëm poezinë brenda kufijve politikë të Shqipërisë) shfaq dukuri kontinuiteti me poezinë e traditës.

“Flaka e vjetër”; Dritëro Agolli-Ismail Kadare- Fatos Arapi, tre poetët që në vitet '60 kërkuan me ngulm largimin nga tema e madhe (historike-himnizuese), dhe vëmendje ndaj motiveve të përditshmërisë, drejt motiveve të industrializimit, janë bërë tashmë modernë-klasikë. Dritëro Agolli (poet i tokës) e pas tij Fatos Arapi (poet i dallgëve e shkëmbinjve të Jonit) hasen më shpesh të botojnë poezinë e tyre lirike në periodikët letrarë më të rëndësishëm të kohës(gazeta”Drita”, revista”Nëntori”), ndërkohë që Ismail Kadare boton më rrallë duke i qëndruar besnik konceptit të tij aristokratik për krijimin e poezisë; ajo është si floçka e ujërave, tmerrësisht e bukur shfaqet rrallë (por të mos anashkalojmë këtu edhe censurën ndaj botimeve të tyre).

Poetë të tjerë si Moikom Zeqo, Frederik Rreshpja, Bardhyl Londo, Xhevahir Spahiu po afirmohen, ndërkohë që një sërë poetësh të rinj nisin rrugën e poezisë: Beatrice Balliçi, Preç Zogaj, Rudolf Marku, Ndoc Gjetja, Ndoc Papleka, Mimoza Ahmeti, Natasha Lako, Luljeta Denaj.

Iluzioni i fjalës, apo poezia e entuziazmit fals?

Si periudhë kohore vitet '80, përkojnë me krijimtarinë e drejtimit socrealist, aq të përfolur tashmë për kanonet e veta mes të cilave detyrimisht duhej të kanalizohesh arti që përcaktohej si shërbyes i shoqërisë dhe poeti, misionar i kësaj shoqërie. Poezia e viteve '80, sidomos në fillimvitet e saj, dallohet akoma për frymën e të madhërishmes e cila vjen si reminishencë e tradicionalizmit. Karakteristikë e kësaj poezie janë shkrimi për një tematikë të caktuar, vargu i matur (6-8 dhe 10 rrokësh sipas modelit popullor) dhe toni i ngritur. Tema e luftës dhe ajo historike e kthyer tashmë në mit, kërkohet me këmbëngulje nga redaktorët e periodikëve letrarë dhe ato të shtëpisë botuese më të rëndësishme të kohës, "Naim Frashëri". Një situatë e tillë na kujton thënien e dramaturgut B. Breht " *Epokat e shtypjes së madhe janë përgjithësisht epokat në të cilën bëhet më shumë fjalë për madhështinë dhe idealet*".

Vrapoja
me gjyshin,
stërgjyshin
Në konturet e kombit fiksuar ishin

Midis meje dhe teje...

Mbretër të shitur,
dimra pushtimi,
Të rrosh a të mos rrosh belbëzonte manushaqja
netëve

Po unë kam qenë shpata që jam ngritur
për t'u hakmarrë për gjith hamletët

Midis meje e teje
kërpurdha katedralesh
pyje xhamishë,
vetë kullën e Babilonit na ngritën ardhës të
huaj në shteg
Po unë kam qenë ajo dallëndyshja që drejt jete
kam vrapuar
me dy thërrime baltë mëmëdheu në sqep

(*Si farë jete*, B.Londo "Drita", 8.1.1984,)

(...)

Duket sikur poeti lodhet për ta kërkuar poezinë. Glorifikimi dhe përpjekjet për të treguar devotshmëri janë të panevojshme. Ndërkaq, pena të tjera, intuited artistike i shtyn të trajtojnë me origjinalitet e ndjeshmëri të veçantë jo vetëm temën historike, por edhe lëndën folklorike e cila duket sikur pikon emocion.

Pranë Ajkunës mjeron gjaku
anës gjakut qan Ajkuna
Qaj moj qyqe bar mos mbijë
vdekjes vetë t'i dridhet buza
(...)

(“Drita”, 17.06.1984, f 8-9, *Anës gjakut qan Ajkuna*, XH.Spahiu)

Poetët, (përfshi këtu edhe mjaft poetë të mirë) krijojnë poezi të cilat i kushtohen atdheut dhe ndryshimeve që ndodhin në të, si rezultat i kërkesës së vazhdueshme për të paraqitur me realizëm jetën në dialektikën e saj revolucionare, duke ndërtuar kështu “poezinë realiste”, “lirikën industriale”, që i bën jehonë proceseve të përparimit të vendit. “Optimizëm me çdo kusht” është një nga kërkesat e përmbajtjes së artit, e stimuluar nga politika shtetërore (“e sotmja e bukur, e ardhmja e ndritur”, e cila shihet si atribut i Partisë në pushtet dhe vetëm i saj), por mjaft poezi dëshmojnë se nuk ka realizëm, por iluzion të fjalës.

Ja Azotiku, Superfosfati, Metalurgjiku
Mbi supet e punëtorëve ngrihet poezia
Si përmbi skela të sigurta
Të kapë pikat e diellit në gusht
(...)

(*Rini e jetës*, Kudret Isai, “Drita”, 8 qershor 1986, f 8-9)

Figura të njerëzve të thjeshtë; ajo e punëtorit, muratorit, tornitorit, montatorit, mjelëses, kooperativistes gjenden rëndom në këtë poezi. Udhëzimet për të qenë afër njeriut të punës dhe për të kërkuar poetikën edhe aty ku s’ka, bën që trajtimi i mjaft motiveve të mos bëhet natyrshëm, gjuha poetike të jetë artificiale dhe imazhet të njëtrajtshme. Madje, edhe figura e nënës shpesh trajtohet me mungesë besueshmërie. Ajo del si mendimtare e kualifikuar, apo patjetër nëna “e dikushit” duke iu larguar imazhit human fillestar. Në poezi të tilla, uni lirik flet pothuaj gjithmonë në vetën e parë, madje dallohet edhe prirja për të përfshirë mes vargjeve të poezisë emrin e vetë poetit (Ndoc Gjetja, Ndoc Papeleka e Preç Zogaj).

Poezia dënon dukuri negative, dhe këto i gjen tek figura e burokratit, konformistit e karrieristit. Motivi i nderimit të punës dhe jetesës me djersë e mundim haset gjithashtu i lëvruar rëndom duke rënë ndonjëherë në banalitet. Dhe nga ana tjetër përveç disa poetëve si (P. Zogaj, R. Marku, XH. Spahiu, N. Paleka, N. Gjetja, Ll. Rusi e ndonjë tjetri) poetët e tjerë jo vetëm mbeten indiferentë ndaj traditave të letërsisë botërore, por edhe nuk e njohin atë. Letërsia po lodhet me këtë tip poezie. Historia e poezisë shqiptare, nga viti ’84-’87 (duke përjashtuar një pakicë poetësh që po afirmohen tashmë mes krijimit të një profili original) i ngjan një fluske që shkëlqen në rrezet e diellit e duket si top me ngjyra.

Tek fjala e mbajtur me rastin e 50-vjetorit të vdekjes së Migjenit, Dritëro Agolli thotë që “Shkrimtari duhet të thotë atë që të tjerët nuk e thonë, paçka se makina shtetërore mund të japë alarmin ajror me sirenat e saj, siç dha më 1936 për ndalimin e vëllimi të Migjenit “Vargjet e lira”. Intuita poetike i jep Agollit lirinë

të arrijë drejt një përfundimi që përfshin një të vërtetë të cilën mund ta paguante shtrënjtë në kushtet kur gjallonte një sistem totalitar.

Ndërkaq, poezi të caktuara, janë plotësimi i përcaktimit se poezia e vërtetë është dhimbje dhe dashuri. Ka poezi të cilat ndonëse të thjeshta në dukje, me gjetje çasti, dëshmojnë jo vetëm për talentin, por edhe për përkushtim, pse jo edhe për mundimin e bukur të shkrimtarit.

Modele të tilla hasen tek poezitë ku spikat kulti i atdheut, i vendlindjes e i tokës, duke i dhënë atyre shpesh trajta bukolike. Janë pikërisht ato poezi ku realiteti konkret shndërrohet në realitet artistik mes një melodike të veçantë të përsëritjes së tingujve të fjalës(aliteracioneve) e përfytyrimeve të detajeve të jetësorë.

Fshati im i vogël
valë –valë shirat
tufa-tufa rrezet
Ai po atje!

Ikën bijtë larg
ikën dhe u kthyen
mbi një kalë malli
Ai prapë atje!

Nën një faqe mali
mbi një buzë lumi
me veriga yjesh
mbi veriga rrushi
Fshati im i vogël sa një pikë gjaku
Fshati im i madh
Afër edhe larg.....

(Malindi, Xh.Spahiu, "Drita", 8 maj 83, f8-9)

Vargjet e mësipërm spikasin lirizëm. Poeti si një magjistar krijon emocione mes ngjyrave e imazheve të thjeshta, epiteteve, hiperbolave e litotave që pranë vendosën duke krijuar emocionin e të kundërtave. Në fakt, kjo tendencë paraqitet edhe tek poetët arbëreshë që botojnë në periodikët e kohës, duke na kujtuar lirizmin, tonin e ngritur dhe patosin e ndjenjës të hasur tek Bajroni në Udhëtimet e Çajld Haroldit (*kënga "Shqipëria dhe shqiptarët"*)

Male të ëndërruara të Shqipërisë
Janë ende të paprekura
Krenare si atëherë
Prej ku në dimër zbret era
Për të kujtuar besën
Për të më ftuar ëndrrave historie

Vizita, Vorea Ujko,, Drita/ 17.07.'83, f 10

Poezia kronikë

Poezia kronikë është tipi i veçantë i poezisë së kohës në fjalë e cila merr shkas nga përditshmëria dhe përfshin në vargje fakte të tipit: dukuri, vende, apo emra njerëzish të verifikueshëm të ditës duke synuar frikshëm të përmbushë modelin sovjetik të "arti pronë e masave". Në këtë lloj poezie, dallon veçanërisht ajo ku figurat janë njerëz të thjeshtë të punës, trajtuar mes ngjyrave e detajeve të ngrohta ku ndjehet optimizmi për jetën.

Po këtu mund të përfshihet edhe poezia që trajton mitet historikë e politikë mes hiperboleve e figurave të sforcuara. Por nga ana tjetër, talenti i padiskutueshëm i drejton poetë të caktuar në mënyra të tjera individuale të trajtimit të miteve kombëtare, duke sjellë në të tashmen në mënyrë origjinale mesazhet filozofike të të shkuarës. Trajta të tilla të lëndës poetike e moderojnë frymën heroike e konkrete të poezisë. Kemi parasysh këtu ato poezi që ritrajojnë në mënyrë të moderuar mitet kombëtare; të jetës, të vdekjes, të tokës, në raporte individuale historike, erotike, filozofike.

Por, në mjaft poezi, në trajtimin e figurave të heronjve të punës, poeti nuk ndalet aq tek madhështia e aktit se sa tek madhështia e fjalës, pasi poetika e jetës në trajtime të tilla shihet jo me natyrshmëri, por me artificialitet.

Ligjërimi poetik ndaj të thjeshtës dhe "thjeshtëzimi"

Një veçori që do ta shihnim si modernitet të poezisë së viteve '80, është vëmendja ndaj të thjeshtës së jetës. Një pemë qershie që mbushet me lule, një dritë dhome e ndezur diku, aroma e mirë e tokës në mbrëmje, e qara e një fëmije që sapo vjen në jetë, gruri që lëkundet nga era e duket si një dallgë e stërmadhe e blertë, retë që lëvizin në qiell etj, etj, njëmijë gjëra të vogla që në dukje nuk vlejnë për art, bëhen pjesë e një sërë lirikave intime të ndjera të kohës. Poezi të thjeshta e të thella, ruajnë freskinë e të natyrshmes, e njerëzores. Autorët e tyre sjellin me inteligjencë emocione të vëzhgimit, admirimit, ngazëllimit, harmoninë e muzikën e përditshmërisë të cilën e përthyejnë në skuta të errëta të shpirtit për të përcjellë ndjesitë. Lind kështu një prirje tjetër e poezisë, lirika personale.

Në qiell retë rendin
Largohen e mblidhen
Pastaj befas nxihen

Bari midis gurësh
Prej erës përkulet
Si ti përngja unë

Nga mali zbret lumi
E nxiton drejt fushës
Si unë drejt teje
(...)

Përpjekja e tokës
 Për të prekur qiellin
 Jeton tek ky mal
 Dhe malli i diellit
 Për ne dhe për fushën
 Retë po përhap

Tek unë e tek ti
 Është mali dhe dallga
 Dhe rrezja e diellit

(*Akuarele*, Demir Gjergji, “Drita”, 28.10.1984, f 8-9)

Mirëpo paralelisht me tipin cilësor të lirikave që botohen, lëvrohet një lloj tjetër poezie *tejet përshkruese*. Kjo poezi *synon frikshëm konkretësinë* duke mos e njohur trajtën eliptike të shprehjes e duke synuar t’i thotë të gjitha me një gjuhë të thjeshtëzuar. Dukuria e përsëritjes së motiveve dhe figurave të cilat mund t’i hasësh nga njëri poet tek tjetri është evidente, pasi motive të tilla si: nëna, stinët, atdheu, trajtohen në të njëjtin këndvështrim

Duke ndier trysninë e sloganit “arti pronë e masave”, redaktorët lejojnë të botohen në periodikë të rëndësishëm letrarë poezi pa vlera të cilat s’na thonë asgjë sot. Sidomos në vitet ’83-’86 lumenj poezish rrjedhin në faqet e periodikëve, sa të krijohet përshtypja, se gjithkush mund të botojë, mjaft që të vargëzojë një motiv të pranuar tashmë (për punën, kooperativën, minatorin, atdheun etj).

Tipari më i dukshëm i kësaj poezie pa cilësi është *deklarativja*. Ka poezi që thjeshtëzohen deri në atë pikë sa nuk mund t’i ndash nga një fragment proze që tregon pa vlerë diçka nga jeta. Mungesa e talentit dhe njohurive për të vargëzuar ka si produkt poezitë pa ritëm të brendshëm, pa imagjinatë poetike, pa imazhe origjinale, të varfra në shprehje poetike.

Po të gjykosh vetëm nga ajo që sheh të botuar në periodikët letrarë, të duket se poezia humb stilin, humb nervin dhe origjinalitetin kombëtar. “Sëmundja e poezisë” bëhet aq evidente sa edhe vetë redaktorët që i nënshtroheshin politikës së kohës (vitet ’86-’87), kuptojnë që arti i vargëzimit po degradon në krijime punëtorësh, studentësh, oficerësh, ushtarësh e të tjerë të kategorisë së shumtë të diletantëve. Poezia në fjalë nuk ka sinqeritet, nuk ka timbrikë origjinale, vihet re intuitë artistike e dobët dhe kjo flet për mungesë talenti. Prozaizmi që, në rastin e poezisë shqipe përcaktohet si shmangie e dukshme nga tradita, dhe drejtimin për nga poezia reflektive, tek kjo poezi diletante nuk është vlerë.

Qëndrimi i vetëkënaqur i kritikës së kohës që trumbetonte politikën shtetërore për artin dhe ndonjëherë edhe i vetë shkrimtarëve që ndiqnin zhvillimin e letërsisë me euforizëm, ishte një tjetër problem që shoqëroi rrugën e poezisë së viteve ’80.

Figura të njohura të kritikës ideologjike si Dallan Shaplo, e Razi Brahimi shprehen optimistë në rrugën e lëvrimin të poezisë dhe pasurimet e mëtejshme poetike nga talentet të reja nga zona të ndryshme të vendit, duke e cilësuar si

përvojë të pashfrytëzuar më parë. Ata tërheqin vëmendje për trajtimin në vazhdimësi të temave historike, apo të lëvrimit të poemës, e cila nuk është më lloji i poezisë që parapëlqehet të lëvrohet nga poetët (Artikulli “Poema dhe kritika për të” *Drita*, 6.03.1986, f7) Por, po të ndjekësh botimet, gjatë viteve ’84-’85, kuptohet se ndonëse nuk është formë përfaqësuese e lëvrimit të poezisë, poema lëvrohet. Mëse 40 poema (“Vajza e vogël me jetë të madhe”-B. Londo, “Kasollja e Galigatit”-H. Milloshi, “Këngë dashurie për vendlindjen”-R. Marku, “Bisedë intime me vendlindjen” Qazim Shemaj, “Në kulm të diellit ”Izet Duraku, “Komunistët” Agim Gjakova, “Hysni Kapo komisari” Agim Shehu, “Rekuiem për Statujën e Lirisë” Moikom Zeqo etj, etj i afrohen lexuesit, ndonëse, një pjesë e tyre janë thjesht vjersha të gjata të shkruara pa bosht organizues duke dalluar nga cilësia e poemave të poetëve të shquar të viteve ’60- ’70 (Siliqi, Kadare, Agolli, Arapi)

Në faqet e gazetës *Drita*, redaktorët, hapin rubrikën “Dialogë”(22.02.87) ku ngrihet si shqetësim lëvrimi i pakët i poemës. Poetë të kohës japin mendimet e tyre. Poeti Moikom Zeqo mendon se poema lëvrohet pak dhe jo më me cilësinë e poemës së viteve ’60, ndërkohë që redaktori Skënder Buçpapaj mendon, se poema nuk po i përgjigjet kërkesave të kohës; cilësia e saj dhe format e lëvrimit e kanë çuar në fragmentarizëm, apo në deskeptivizëm. Poeti Ndoc Gjetja mendon se rezultat i kësaj gjendjeje janë kërkimet e pakta dhe matja me cilësitë e poemës së viteve ’60

Nga shkrime të tjera, vetë poetët vërejnë se është krijuar një raport më i drejtë mes tematikës historike dhe temave të përditshme, por, të metat e poezisë, në vitet ’84-’87 bëhen aq evidente, kur shihet të botohen poezi ku botës shpirtërore të njeriut, i kanë zënë vendin makineritë dhe peizazhet e e kantierëve. Kjo çoi në shfaqjen e skematizmit dhe cektësisë. Kështu, krijimet e sforcuara, nuk e zbulojnë ngarkesën reale poetike të dukurive të reja dhe ngecin tek ana e jashtme, duke mos arritur të depërtojnë dot tek thelbi poetikisht. Faktet e zakonshme paraqiten si të jashtëzakonshme dhe dukuritë episodike fitojnë më tepër vend nga ç’e meritojnë. Rendja gjithmonë pas të njëjtave motive, përsëritja e mjeteve shprehëse pa kriter, përsëritja e të njëjtit simbol, mosvlerësimi i rregullave të organizimit ritmik, trajtimi i motiveve të nënës, veteranit, punëtorit ku ka mungesë besueshmërie, ku këndvështrimi dhe detajet janë të njëjta, pasqyrojnë varfërim të poezisë.

Shtëpia e vjelësës së pambukut

Vjelësja Vasë
 ka një shtëpi të bukur
 Një verandë plot hije e dritë
 një korridor të çlirët
 shtruar me pllaka me motive
 Në kuzhinë
 një tryezë e shtruar me kujdes
 televizori Iliria mbi një komodinë
 është mbuluar me një copë të thjeshtë
 qëndisur nga Vasa vetë
 Vjelësja vjen nga mesi i fushave

dhe çlodhet me fëmijët në divan
shfleton një libër ngadalë
mer një sy gjumë

(Gazeta "Drita", 24 shkurt '85, Xhaferr Xhaferri)

Vargjet më sipër nuk bëjnë gjë tjetër veçse glorifikojnë thjeshtësinë e jetës së lodhshme të këtyre njerëzve të vegjël. Kjo poezi bëhet dëshmi e jetës së varfër sidomos të fshatarit. Ajo i ngre himn jetës së thjeshtë të njeriut të punës që lodhet shumë dhe kënaqet me pak. Era e shtëpisë së korrtarit, era e shtëpisë së kooperativistit është ajo e barit dhe e luleve, vjelësja Vasë sa vjen nga puna ulet në divan dhe hap një libër duke u argëtuar njëkohësisht edhe me fëmijët e saj. Vargjeve të poezive të tilla i mungon energjia e fjalës. Gjuha poetike është përshkruese dhe imazhet janë monotone. Ka një lloj lidhje të shtirur me këto motive dhe këto figura dhe qëndrim infantil me formën e poezisë, apo me konceptin sesi bëhet ajo. Estetikja e artit dobësohet dhe estetika vihet re kollaj. Në këtë pikë, nuk mbetet të themi për cilësinë e poezisë "ashtu ishte koha". Ç'na mbetet të themi pastaj për poezinë e Migjenit, Poradecit, Kadaresë, Arapit ?

Fjala poetike e këtyre krijuesve të shumë dekadave më parë, provokon tek lexuesi ndjenja edhe sot.

Gjatë vitit '87 artikuj të shumtë (sidomos poetët që kanë formuar një profil tashmë) marrin në shqyrtim fjalomaninë dhe probleme të tjera evidente që shfaq poezia e botuar nëpër periodikë (Krisaq Jorgo "Librat u botuan po ç' thotë lexuesi dhe botuesit e tyre?" (25.01/f5), Ndoc Gjetja "Dukuri dhe risi të ligjërimit të poezisë" (22.03/f11), Dalan Shaplllo "Mendim dhe ndjenjë të thellë në larminë e stileve" (12.04/f 6), Skënder Buçpapaj "Varg i lirë, apo dorë e lirë" (17.05/f5), Ndoc Gjetja "Mungesa e gjendjes poetike nuk mbushet dot me fjalë", "Poezia ç'po sjell dhe ç'kërkohet prej saj?" (14.06/f1-3), Rudolf Marku "Poezia bashkëkohore" (27/09/f8-9), Xhezair Abazi "Dukuri frenuese në zhvillimin poetik", Ndoc Gjetja "Hijet e sasisë mbi cilësinë" (8.11/f 5), Skënder Buçpapaj "Lidhjet me jetën e kultura poetike rritin cilësinë e poezisë", "Duke diskutuar për poezinë" (përmbledhje diskutimesh që u mbajtën në Plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve) 29.11/f10, Analiza të vëllimeve me poezi të poetëve Natasha Lako, Xhevahir Spahiu, Agim Isaku, Preç Zogaj etj, etj

Çështjet që trajtohen në Plenumin e lidhjes janë Cilësia e poezisë (kjo mbetet pikë nevralgji, ashtu sikurse, paraqitja skematike e jetës, mungesa e emocionit dhe, edhe pse nuk thuhet, sasia e lartë e dogmatizmit në poezi. Kërkesat mëshojnë në lëvrimin e lirë të poezisë

Gjithë kjo vjen edhe nga vizioni teorik i cunguar i kritikës, apo mosdëshira për të vepruar ndryshe. Kritika zyrtare e artit shqiptar për kaq shumë kohë ngeli sistematikisht brenda kritikës marksiste leniniste dhe demagogjisë së rregullave të ngurta të artit socialist duke luajtur kështu një rol denigrues për krijimin e hapësirave të nevojshme të zhvillimit të tij.

Në Plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve, veç kritikut Dalan Shaplllo, i cili mes gjuhës së sloganeve lëvdoi arritjet e poezisë, figura të poezisë si: Llazar Siliqi, Dhori Qiriazzi, Kadare shfaqën si shqetësim uniformitetin e poezisë dhe paaftësinë e saj për të shprehur e për t'u thelluar artistikisht. Madje Ismail Kadare hodhi si shqetësim kulturën poetike jo të mjaftueshme duke dhënë shembull për këtë numrin e lartë të poezive që shkruheshin përditë, gjë që sipas tij sjell zhvlerësimin e poezisë. Kritikët Gjergj Zheji e Bashkim Kuçuku, mbështetën mendimin e Kadaresë duke pohuar një eufori artificiale të arritjeve të poezisë.

Ndërkohë që poetët: Moikom Zeqo e Preç Zogaj pohuan se poezia duhet të thellojë raportet me jetën, të vendosë kodet e bashkëbisedimit me lexuesin dhe të përcjellë tek ai të vërtetën jetësore në mënyrë artistike. Arritje shihet vetëm në lëvrimin e poezisë së dashurisë, ndërkohë, që kryeredaktori i revistës “Nëntori”, Kiço Blushi, mendon se çlirimi i vargut nga rima e ritmi bën të mendosh se poetët e quajnë të lehtë vargëzimin në varg të lirë, duke hedhur nëntekstin e dukurisë së injorancës poetike. Prozaizmi si dukuri risi, tek ta, e shkatërron poezinë.

Poezia ka probleme me rregullat ritmike e metrike dhe kjo ndjehet si shqetësim edhe nga kritikët e asaj kohe, duket te artikujt dhe analizat që bëhen, ndërkohë që gazeta letrare “Drita” në vitin '87, hap rubrikën “*Cili është autori?*”, apo “Poezi me temën e punës, presim mendimin e lexuesit” për të provuar njohjen e stilit të fragmeneteve, kaq e dukshme u bënë të metat e poezive që botoheshin rëndom.

Gjithë debatet e poetëve e kritikëve për lëvrimin e poezisë dhanë frytet e tyre dhe pas vitit '87 ndjehet era e ndryshimit. Tashmë botohen më pak poezi dhe ato janë më cilësore. Poezia shfaq një prirje pozitive ku heroi lirik vjen më i emancipuar dhe kjo nuk duket vetëm në shkallën e informacionit, por edhe në pasurimin e ideve dhe mjeteve shprehëse dhe, ajo që është më pozitivja, poezia shfaq dukshëm tendencë për t'u larguar nga manifestimet e jashtme agjitative, deklarativizmi dhe moralizimi i jashtëm.

Poezia personale e reflektive si prirje risi

Kjo shfaqet si dukuri më tepër tek poetët që po afirmohen në artin e tyre tashmë. Ndikuar edhe nga ngjarjet që shoqëruan shembjen e sistemin komunist në gjithë Europën Lindore, apo i ashtuquajturin “kampi komunist”, shkëndijë fillestare e të cilit ishte shembja e Murit të Berlinit, edhe në Shqipëri (shteti i fundit në Evropë që bëhej gati ta shembte komunizmin) u ndje si frymë aspirata për hapësira. Poezia e re cilësore që po lind përpiket të bëjë autopsinë e shpirtit njerëzor, apo gjendjeve të ndryshme emocionale si: pesimizmi, dëshpërimi, apo merr në analizë dukuri kolektive shoqërore si indiferenca, apo frika ndaj të panjohurës, përfshi edhe vdekjen si më e keqja e më e shëmtuara dukuri e jetës, shkatërruese e njeriut në planin material (fizik) e moral.

Poezia me në qendër unin lirik është tipi më i përhapur i poezisë që shkruhet. Ajo vë në peshorë vlerat poetike që kanë sjellë deri tani një varg poetësh, krijimtaria e të cilëve deri në vitet '88 ka arritur në vëllimin e 4-tërt, si: Adem

Istrefi, Agim Gjakova, Koçi Petriti, N. Pappleka, N. Lako, A. Isaku, R. Marku, M. Zeqo.

Në krahasim me 10-15 vjet më parë, tani në poezi vërehet më pak deklarativizëm, përshkrime të thata, ndërkohë që poezia përpiqet të rrezatojë edhe më tepër heroin lirik në çaste meditimi ndaj dukurive të jetës, në vend që ta përshkruajë, sipërfaqet e dukshme. Eksklamacionet naive, pseudodinamizmi brohoritës, e të tjera dukuri denigruese për poezinë nuk shihen më, ndërkohë që poetët ndikohen dhe bëjnë pjesë të poezisë së tyre Uitmanin, Elyarin, Nerudën, Brehtin, Lorkën, Ricosin aq sa disave iu kushtojnë edhe vjersha. Ndërkohë, poetët që janë afirmuar, apo po afirmohen, tashmë ndikohen nga poetët e ashtuquajtur të traditës (vitet '60). Kështu kur lexon poezinë e B. Mustafajit të kujtohet F. Arapi, Ilirian Zhupa na kujton kryesisht Agollin, por edhe Kadarenë si dhe poezinë popullore të jugut, ndërsa tek Teodor Keko duket tërheqja ndaj Agollit. Mendojmë që është një dukuri pozitive që këta krijues ia kujtojnë lexuesit autorët e afirmuar. Kjo do të thotë se krijimtaria e tyre mbështetet te tradita, në kërkim të individualitetit.

Ndërkaq, poezia e N. Gjetjes shpesh herë ka natyrë psikologjike ndonëse në dukje është e thjeshtë dhe pa befasinë në formë. Por edhe Ndoc Pappleka shquhet për zbulime origjinale reflektive, ndonëse tek ky i fundit vihen re edhe teprime figurative, apo përdorime figurash që nuk qëndrojnë, apo ndonjëherë mungesë gjallërie të çasteve, apo tablo që thyejnë njëra-tjetrën pa krijuar lidhje organike, por gjithsesi poezia e tij, vjen e mbrujtur me shqetësimet e kohës dhe e organizuar në një strukturë poetike funksionale mes së cilës sjell edhe mesazhet filozofike.

Bardhyl Londo po i shtohet tashmë radhës së modernëve klasikë. I prirur drejt lirikës, tek ai vazhdon jetën e poezisë së tij mes një patosi të brendshëm dhe përjetimeve që vijnë nga meditimi.

Monologu shihet të jetë karakteristikë e poezisë në këtë kohë. Shkrirja e njeriut me natyrën, poetizim i saj, ndërfitje në lidhjet e fshehta të sendeve e dukurive të natyrës me botën e njeriut janë tipare të kësaj poezie. Preç Zogaj, i cili të kujton ndonjëherë Agollin me motivet e tij të tokës e të vendlindjes, bën objekt të vargut të tij vendlindjen dhe sidomos peizazhet e saj natyrore. Tek ai miti i tokës shihet i trajtuar mes ndijesave erotike ku pasthirrmat e përdorura të kujtojnë për shfrytëzimin që i bën fonetikës popullore.

Përtej erotizmit

Poezia erotike e lëvruar brishtësisht që nga vitet '80, shfaqet si e parapëlqyer tek poetë që nga fillsat e veta të tillë si Rudol Marku, P.Zogaj, ajo shihet mes përpjekjeve për të modernizuar vargun dhe për t'iu larguar temave të kohës, e tendencën drejt heroit pozitiv që kërkohej rëndom në poezi.

Dëborërat e dimrit u shkrinë tani
Ecën lumi me ujëra i mbushur
Dhe prapë se si më kujtohesh ti

Ti ke vetë emrin e stinës, R. Marku, 27.07. 1980/f8

Mirëpo, kjo poezi zë një vend të dukshëm si e trajtuar te të ashtuquajturit "poetë arbëreshë" që shihen të botojnë në organe letrare të kohës. Vorea Ujko, Xhuzepe Skiroi Di Maxhio, Paskal Renda, Xhuzepe Skiroi Di Modika, Karmine Abate, Xhino Kielino, Karmel Kandeve, Agoszin Jordani (Buzëdhëlpri), Mario Becili, Kate Cukaro etj ku shfaqen dy tipe të poezisë erotike veç asaj të dashurisë e mallit të atdheu që botohet si e kërkuar nga redaktorët. Tipi i parë është tipi i poezisë ku dominon subjektivizmi, poeti-njëherësh un lirik duket sikur nuk e mendon lexuesin si pjesëmarrës, dhe tipi i dytë i poezisë erotike, ku erotizmi zhytet në melankoli e patetizëm. Megjithatë detajet e ngrohta erotike, jo trumbetuese, intime e ndjellëse janë pjesë e të dyjave dhe shndrisin në kënde të ndryshme. Në poezinë më poshtë figura e dashur sjell në parafytyrimin e lexuesit plotshmërinë e tablosë mes nëntekstin se jeta është e bukur. Detajet e ngrohta e sensuale kanë si bosht figurën mashkullore ku lind dhe përmbillet emocioni

Emocioni është bjë copë kaltërsi
që më qëndron në krye
një drithmë drite
që m'i mer sytë
(...)
Emocioni është një buzëqeshje
që më ngroh zemrën
një vështrim zhbirues
një përkëdhelje e ëmbël
emocion është dashuria
për të qenë aty ku je ti
(...)

Emocioni, Matilde Ferraro, Drita, 14.06.1981

Erotizmi i thellë në poezi nuk ka qenë kurrë i përfshirë në qerthullin e motiveve të parapëlqyera për redaktorët e kohës, kështu që edhe motivet erotike kanë qenë të trajtuara pak, apo në mynyrë të fshehur mes trajtimit me detaje e simbole erotike të motiveve të ndryshme (qoftë edhe të miteve), apo në rrugë të tërthorta, mes mjeteve e eksperimentimeve në formë e lojërave me kuptimësinë e fjalës, apo në tipin e poezisë si imazh pa domethënie, e tipit si fotografi pa qëllimshmëri (në dukje pasi domethëniet në fakt janë të fshehura)

Ajër i tejdukshëm, i lehtë
yje në shkëlqim të ftohtë
koha i hapet vjeshtës
si hapet një hulli në tokë
(...)

(Në park, Jerina Zaloshnja, "Drita" 24.06.84, f8-9)

Ndërkaq, botohen poezi erotike të Lasgushit shoqëruar me fjalë shoqëruese nderuese nga Kadare. Kjo tregon se edhe pse i harruar për sistemin, për poetët ai mbetet një model, një kulminacion i poezisë erotike.

Por lëvrohet edhe një poezi me detaje specifike nga poetja Mimoza Ahmeti, e cila i kalon caqet e poezisë të ashtuquajtur femërore të lëvruar nga poetja Natasha Lako, Feride Papleka, Silvana Gjebrea, Jerina Zaloshnja e ndonjë tjetër poete, duke i dhënë një trajtë të thellë meditative - erotike. Poezia e M. Ahmetit kalon nga trajtat e poezisë si imazh pa domethënie që lëvronte në fillimet e veta, në poezinë ku spikat qartë jo vetëm erotizmi, por edhe ambiguiteti. Poetja i këndon njeriu, erotizmit, lektisjes shpirtërore që përjetohet si një përpëlitje fizike, pa pasur parasysh përkatësi lloji.

Ndërkohë poezia erotike përgjithësisht trajton motivin e ndarjes. Dashuriua tek uni lirik është një dhembje që rezonon gjatë.

Zëre s'e s'i hapëm dyer e dritare
Dhe loton krejt pa shkak të vërtetë
loton duke qeshur
Hajt pra lotojmë duke qeshur!
...Po një pikë lot s'e nxirja dot. Isha djalosh
pa asnjë dhimbje në gjoks
veç sot e asaj dite më thahet fytyra për ty,
e gjora ime...

Brishtësi e ndjenjës dhe dhimbje e fundosur prej kaq kohësh që ngre kokën herë pas here te uni lirik . Figura e dashur është e largët dhe e veshur me një imazh pozitiv të dëshirueshëm.

Në përfundim

Kur flasim për poezinë shqipe të periudhës në fjalë, si studiues, vihem para përgjegjësisë të gjykimit të një arti që i takon një kohe të shkuar tashmë. Poezia shqipe e viteve '80, mbetet mes tipareve të poezisë së traditës dhe prurjeve risi. Ajo njeh dobësi dhe arritje. Megjithëse kemi të bëjmë me poezi të realizmit socialist dhe duhet ta shohim poezinë jo jashtë kontekstit të kohës, sipas një logjike të thjeshtë, çdo kohë e zbulon poetin (shembujt e figurave të shquara të poezisë e dëshmojnë këtë). Kështu, në relievin e poezisë shqiptare dhe specifikisht asaj të viteve '80, ka ngjyra të spikatura të cilat ndërfiten në zbehtësinë e ngjyrave të tjera. Duke iu drejtuar nga e sotmja, ne s'bëjmë gjë tjetër veçse rikujtojmë në prizmin e vlerave të së shkuarës që janë njëkohësisht pika referimi e reminishenca, prandaj përmendja e tyre do të përbënte nderim dhe do të përcaktohej si shenjë e thellë objektiviteti. Ne do të vlerësojmë gjithçka të bukur që sjell çdo cëpëz e të shkuarës sonë, shkëputur nga mosha e poezisë shqiptare. Pasioni misionar dhe urtësia e fjalës çmohen edhe tani. Çiltërsia e ndjenjës, ftohtësia, e stoicizmi i kombit dhe historis, dashuria për jetën, ironizimi i antivlerave të shoqërisë çmohen edhe tani.

Shumë vargje të autorëve bëhen zëdhënës të përparimit edhe sot. Ka vargje që akoma të trondisin. Ata janë të besueshëm dhe marrin vlerë gjithkohore

Nga ana tjetër shumë vargje, qoftë këto edhe të letrarëve të rinj bëhen zëdhënës të dhe kryeëndrrës njerëzore, dëshirës fisnike të njeriut për jetën dhe lirinë.

BIBLIOGRAFI

Vinca Agim, *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe(1945-1980)*, Prishtinë, 1997

Hamiti Sabri, *Poetika Shqipe(1.Bioletra, 2.Tematologjia, 3.Albanizma, Sh.b “55”, Tiranë, 2010*

Qosja Rexhep, *Shkrimtarë dhe periudha*, “Akademia e Shkencave e Shqipërisë”, Tiranë 2005

Llotman Jurij, *Kultura dhe bumi*, Tiranë, 2004

Dado Floresha, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, “Onufri”, Tiranë, 2006

Sinani Shaban, *Letërsia në totalitarizëm dhe “Dossier K”, “Naimi” Tiranë, 2011*

Faye Eric, *Tri biseda me Kadarenë*, “Onufri”, Tiranë, 2007

Sinani Shaban, *Njerëzit e krisur të Dritëro Agollit*, “Naimi”, 2012

Jeferson Ann, Roby David, *Teoria letrare moderne- një paraqitje krahasuese*, “Albas”, Tiranë 2006

Wellek Rene, Worren Ostin, *Teoria e letërsisë*, “Shbe”, Tiranë, 1993

Hamiti Sabri, *Letërsia moderne shqipe*, UET-Press, Tiranë, 2009

Dado Floresha, *Sfida teorike të historiografisë letrare*, “Bota shqiptare”, Tiranë, 2009

Dado Floresha, *Letërsi e painterpretuar-qasje teorike ndaj Realizmit Socialist*, “Bota shqiptare”, Tiranë 2010.

Cika-Kelmendi Mimoza, *Kadare ndryshe*, “Naimi”, Tiranë, 2009

Topçiu Luan, *Tradita Moderne në letrat shqipe*, “Zenit”, Tiranë, 2010

Çiraku Ymer, *Shqyrtime kritike nga Historia e letërsisë shqipe*, Albas, Tiranë, 2011

Xhiku Ali, *Letërsia shqipe si polifoni*, “Dituria”, Tiranë 2004

Pia Pozzato Maria, *Semiotika e tekstit*, “UET/Press”, Tiranë, 2001

Çaushi Tefik, *Fjalor i estetikës*, Ombra GVG, Tiranë, 2005

GAZETA REVISTA

Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1980

Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1981

Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1982

Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1983

Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1984

Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1985

Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1986

Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1987

Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1988
Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1989
Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e vitit 1990
Revista “Nëntori”, gjithë numrat e vitit 1980
Revista “Nëntori”, gjithë numrat e vitit 1981
Revista “Nëntori”, gjithë numrat e vitit 1982
Revista “Nëntori”, gjithë numrat e vitit 1983
Revista “Nëntori”, gjithë numrat e vitit 1984
Revista “Nëntori”, gjithë numrat e vitit 1985
Revista “Nëntori”, gjithë numrat e vitit 1986
Revista “Nëntori”, gjithë numrat e vitit 1987
Revista “Nëntori”, gjithë numrat e vitit 1988
Revista “Nëntori”, gjithë numrat e vitit 1989

LAURE CAMBAU

VARGJE PËR NJË BURRË SI KALESHI

*Laure Cambau / Poetja franceze, vargje për pikturat e Omer Kaleshit.
Simboli i kokave në telajot që të kujtojnë Ballkanin në zemër të Parisit*

“Nëse je vetëm, je i tëri, nëse je me dikë tjetër, je gjysma, nëse ke pranë dy ose tre të tjerë, atëherë nuk ekziston.” Omer Kaleshi ka zgjedhur këtë shprehje të Leonardo da Vincit si moto për jetën e tij. Në atelie në Paris, ai është mësuar të komunikojë me tablotë e mëdha apo ndjesinë që i jep ajri që vjen përtej dritareve të studios. Nëse kupton vetminë dhe ti të jetosh me të, atëherë nuk do të kesh më frikë. Gjatë periudhës së studimeve në Stamboll, ai e ndjeu se vetëm atëherë kur do të mund të gjente komunikimin me vetminë, do të mund të pikturonte. Laure Cambau, poetë franceze dhe pianiste, do të donte shumë të shihte piktorin që e kishte tërhequr me tablotë e mëdha, ku kokat e njerëzve i dukeshin si vargjet më të ndiera që kishte lexuar. Teksa ecte nga një tablo në tjetrën, Laure, që e njeh mirë gjuhën e muzikës (ajo është pianiste), ndiente se po ecte në një kompozim që dukej sikur kishte dalë nga partiturat e shekullit XIX, por që s’mund t’i vinte emër. Ajo donte ta shihte burrin me flokët e pushpuritur dhe vështrim e paqtë, teksa rrëmbente penelat dhe u jepte jetë telajove. Por Omer Kaleshi nuk mund të pikturojë kur dikush tjetër është në studion e tij. Ai asnjëherë nuk ka pikturuar në grup. Kur dikush vjen në studion e tij, ai do të bisedojë për artin, duke pirë çaj a verë franceze. Përveçse një piktor i mirë, Omer Kaleshi është dhe një mik i madh. Jacques Lacarrière, Alain Bosquet, Kaya Ozsezgin, Nedim Gursel, Luan Starova, Jordan Plevnesh, Luan Rama, Klara Buda, Ozdemir Ince, Gil Jouanard etj., janë vizitorë të studios së tij. Gazetarëve francezë u pëlqen të kalojnë orë të tëra duke biseduar me këtë shqiptar, që me stilin e tij të jetës u kujton Pikason.

“Kur i pashë për herë të parë pikturat e piktorit Kaleshi, mbeta e befasuar. Dukej sikur kisha vizituar studion e një psikologu. Më pas u riktheva shpesh për t’i parë ato piktura, për të kuptuar gjuhën dhe teknikën e veçantë, me atë të së cilës ai i ndërtonte ato», thotë Laure. Kaleshi nuk ka nevojë për modele. Pikturat e tij lindin nga përfytyrimet apo imazhe që i ka parë diku dhe i ka ruajtur thellë në mendje. Raporti me kujtesën është aq perfekt dhe ndihet dhe te pikturat e tij. Një njohës i mirë i pikturës do të shprehej se tablotë e Omerit kanë nevojë për një kod. Por, Laure Cambau ka gjetur mënyrën e saj për të deshifruar këtë shqiptar të çuditshëm, të cilin pëlqen ta vizitojë shpesh në Paris. Kur kthehej nga takimet me të, ajo ndihej aq e frymëzuar sa ulej e hidhte në letër vargje, të cilat janë ndoshta studimi më i mirë që mund t’i jetë bërë pikturës së Kaleshit. Vargje që vinin natyrshëm nga brenda saj, për t’u hedhur më pas në letër, si një nevojë për të treguar gjithë atë

emocion që ato piktura kishin sjellë te kjo grua. “Kur kokat e lira takojnë në bulevard / kokat e prera / një kuvendim ndodh mes tyre / njëra kullon gjak / tjetra jo / nga atelieri te podiumi i ngritur / nga kavaleti te gijotina / nuk i ndan veçse një hap / dhe rojet e burgut / rojet që nuk ruajnë asgjë / vështrojnë gjetiu / në anën tjetër të ujit mbi kalldrëm / të ujit gri nga gjaku i vjetër i ndryshkur / rojet që nuk ruajnë më asgjë / shënojnë fjalët e kokave ...”, shkruan ajo në poezinë kokat. Omer Kaleshi duket se e ka marrë me vete Ballkanin në Paris. Historitë që ai tregon në telajo, simboli i kokave duket sikur vjen nga larg, shumë larg e ulet në këtë cep të studios së tij. Njeriu nuk mund t’i shmanget asnjëherë historisë së tij sado larg të shkojë. “Nga vijnë këto koka, ç’kërkojnë ... të largët, si të pjella nga një kujtesë tejhistorike, shtillen njëra pas tjetrës, me atë ndriçim që e kanë thithur përbrenda”, do të shkruante për pikturat e Kaleshit, shkrimtari Ismail Kadare. Mimoza Ahmeti do të shprehej pas vizitës në studion e tij se: “Po kthehesha nga studioja-banesë e Omer Kaleshit, edhe tani siluetën e tij dua në vend të tij: s’më kish bërë vaki t’i dashuroj njeriu siluetën, ndërsa vetë të zotin ta shoh si mbushje të saj ...”.

Laure e ndien këtë, teksa shkruan se “kokat e lira dhe të pastra / kokat shëtitëse / dervish e barinj / pikëtakojnë kokat e shkëputura / e të përgjakura të Avril dhe Lacenaire / e lodhur koka e banditit të shkolluar / që vendoset mbi një trung të sëmure / Omeri kalon si një engjëll piktor / dhe me një të rënë spatula / na kthen kokat e trungjeve / na kthen trungjet e kokave / u kthen drejtësinë dervishëve dhe keqbërësve / rakia bie nga qielli dhe përzihet me absintin / një përzierje lëngu ballkanik e parisian / rrjedh nga goja më gojë / nga gryka në trung mbi bulevard / njëra kullon gjak / tjetra jo ...”. “Kokat e mia janë të gjallë”, do të shprehej Kaleshi. Imazhet për të pikturuar koka, nisi tek ai që në pikturat e para. Kur miku i tij, piktori Eduard Pinjini i tha se pikturat e tij i ngjasonin si piktura të prera, ai vendosi t’i vishte ato. “Kokat nuk janë portrete, sepse nuk kanë model. Janë të pavarura nga trupi, por s’janë të prera, janë të gjalla. Njerëzit kur shohin një kokë, mendojnë që është e prerë. Por në të vërtetë kokat e mia s’janë të tilla, aty s’ka gjak, pasi janë të gjalla”, shprehet piktori. Gjithçka ndodh në mendje, sipas Kaleshit. Një njeri mund ta kuptosh nga vështrimi apo lëvizja e buzëve, pa ia parë trupin. Trupi shpesh është çfarë është mendja. Ndonjëherë këto piktura janë vetëm një mendim. Piktorit mund t’i ndodhë që teksa ecën në rrugët e Parisit, të orvatë në mendje një mendim, dhe kur ndodhet vetëm në atelienë e madhe, ta hedhë në telajo. Ajo merr portretin e një njeriu, që rri i vetëm në hapësirën e madhe të bardhë të telajos. E bardha është një ngjyrë që atij i pëlqen ta vendosë në pikturë, si një zbutje që i bën shpesh shqetësimit që japin këto piktura. Për Laure-n e bardha është si një poezi. “Është si një fletë e bardhë bosh ku mund të hedhësh mendimet e tua”, thotë Laure. Kaleshi e ka bërë poeten të hedhë vështrimin larg nga Shqipëria dhe ta vizitojë shpesh kohët e fundit, duke mësuar më shumë nga historia dhe kultura e këtij vendi, që prodhon artistë të tillë. Por nëse sheh me kujdes pikturat e Kaleshit, gjen në to shenjat e përshtypjeve të tij të para, nga arti që ndikoi në karrierën e tij. Ashtu si Henri Moore, artisti i dimensioneve të mëdha që merret me njeriun, dhe Kaleshi në pikturat e tij merret me qenien njerëzore. Henri Moore është si një totem për të. Nëse skulptori i njohur nuk do të kishte vizituar Beogradin në vitin 1955,

ndoshta dhe Omeri nuk do të ishte bërë piktor. Duket sikur Moore shkoi në Beograd për t'i dhënë një shenjë, djaloshit 23-vjeçar nga Shkupi, se e ardhmja e tij nuk ishte profesioni i elektrikistit që bënte deri në atë moment, por arti. Skulpturat e Moore ishin vendosur në pika të rëndësishme të trashëgimisë nëpër Serbi. Kur Omeri pa për herë të parë skulpturat në hamamin e Daut Pashës, do të kalonte muaj të tërë duke sjellë në mendje ato skulptura. Duket se rruga e tij drejt artit, nisi pikërisht atë mbrëmje, teksa shihte njerëzit që shtyheshin për të parë punët e Moore. “Kavaleti i tij shpon zinkun / gudulis qiellin parisian / dhe retë bien / në formë kokash / me aromën e së kuqes dhe ngrohtësinë / e ajrit të qytetit / kavaleti / me këmbët në shtratin e lumit të Bièvre-s / ngulur si një pemë në lartësitë e thella të bulevardit...”, shkruan Laure. Poetët nuk ndryshojnë shumë nga piktorët. Nëse të parët përpiqen të depërtojnë te shpirti përmes vargjeve, piktorët e bëjnë përmes ngjyrave. Nëse Omer Kaleshi depërton përmes telajos si një mjeshtër i subjekteve që zgjedh, subjekti i Laure-s për të depërtuar është pikërisht ai, piktori që mbështillet nga një tis misteri sa herë ajo e viziton në studio. Me aftësinë që kanë poetët, ajo duket sikur ka zbërthyer kodin e pathyeshëm mes tij dhe pikturës te poezia me titullin “Spatula”, duke zbuluar dhe sekretin e Kaleshit. / Mjeshtri yt të tha / zgjidh dhe ti një mjeshtër / zgjidh një ngjyrë / ti zgjodhe të kuqen / dhe e përzier me dyqind e pesëdhjetë tonë / nga spatula tënde / një ditë të bukur ajo erdhi / në dorën tënde / ti nuk e di se kur dhe ku / dhe që prej pesëdhjetë vjetësh / nuk e ke ndarë më nga vetja / ti nuk zgjodhe thikën / sepse ti nuk doje t'i vrisje kokat e tua / por veç vendosje në telajo / penelat kalojnë spatula mbetet / e fuqishme dhe me gjurmën e gishtit të piktorit / dhe në të kuqet e përziera / imagjinojmë gjurmën / e magjistarit që na zbulon kokat ...” Laure ka gjetur vendin e tij të lindjes, historinë që e ka zbuluar dalëngadalë në libra në pikturat e Kaleshit. Në to është historia e një vendi gjithnjë në përpjekje për t'ia dalë, i sjellë keq nga historia. Ajo ka parë në ato piktura, djaloshin e lindur në Sërbicë, pranë Kërçovës, udhëtimin e tij bashkë me familjen në Stamboll, e më pas Parisin ... Këtu djaloshi gjeti paqen dhe futi në këtë atelie të shkuarën, duke e ngjallur telajo pas telajo, përmes këtyre kokave, që të kujtojnë ujërat e trazuara në Ballkan. Laure e ndien se nëse Ballkani vijon të jetë një burim frymëzimi për Kaleshin, për të, ky burim që i fsheh aq mirë vitet dhe pse i ka kaluar të 80-at, është një poezi që merr trajtë në vargje të ndryshme që i lindin natyrshëm sa herë e sheh ... Omer Kaleshi lindi më 1932, në Kërçovë të Maqedonisë. Omer Kaleshi pas shumë udhëtimesh, pikturimesh dhe ekspozimesh në Stamboll, Romë, Vjenë, Munihi, Londër, Selanik, Beograd, Hagë etj., në vitin 1956 vendoset përfundimisht në Paris, ku vazhdon të krijojë, ekspozojë dhe të jetë vazhdimisht i kërkuar për tablotë e tij.

Njëra kullon gjak tjetra jo

Kur kokat e lira takojnë në bulevard

kokat e prera

një kuvendim ndodh mes tyre

njëra kullon gjak
tjetra jo
nga atelieri tek podiumi i ngritur
nga kavaleti tek gijotina
nuk i ndan veçse një hap
dhe rojet e burgut
rojet që nuk ruajnë asgjë
vështrojnë gjetiu
në anën tjetër të ujit mbi kalldrëm
të ujit gri nga gjaku i vjetër i ndryshkur
rojet që nuk ruajnë më asgjë
shënojnë fjalët e kokave
një dialog i shfrenuar kokë më kokë
kokat e lira dhe të pastra
kokat shëtitëse
dervish e barinj
pikëtojnë kokat e shkëputura
e të përgjakura të Avril dhe Lacenaire
e lodhur koka e banditit të shkolluar
që vendoset mbi një trung të sëmurë

Omeri kalon
si një ëngjëll piktor
dhe me një të rënë spatule
na kthen kokat e trungjeve
na kthen trungjet e kokave
u kthen drejtësinë dervishëve dhe keqbërësve
rakia bie nga qielli dhe përziehet me absintin

një përzierje lëngu ballkanik e parizian
rrjedh nga goja më gojë
nga gryka në trung mbi bulevard
njëra kullon gjak
tjetra jo

KUJTIM BUZA**SABRI FETAHU (BERKEL) NDËR
THEMELUESIT E ARTIT MODERN TURK**

(1907 Shkup – 1993 Stamboll)

Piktori madh shqiptaro-turk SABRI FETAHU (BERKEL) është ndër themeluesit e artit modern turk, i pari post-kubist shqiptar në Stamboll, figurë e shquar pedagogjike-artistike në formimin e talenteve të reja në Akademinë e Arteve të Bukura “Mimar Sinan” të Stambollit, organizator dhe kurator, i pari afreskist dhe mozaicist në Turqi, grafist i përkryer dhe njohës i shkëlqyer i artit tradicional vendas.

*

* *

Për Sabri Fetahun si një piktor të madh (Unlu Turk Reassa-Piktor Famos Turk) kisha dëgjuar qysh i vogël. Babai më kish treguar për një shok në Shkup me të cilin shoqërohej, luante dhe shëtiste rrugëve të kalldrëmta të Bit-Pazarit, zvarritej te Ura e Gurit dhe shihnin me kureshtje xhamat me ngjyrë, të thyer copë-copë, në sokakun pranë Sahat-Kullës ku banonte. ”Vizatonim tinës dhe zhgaravisnim muret përreth xhamisë duke hyrë në gjynah. Unë isha më i shkathët, zevzek dhe sherret – tregonte im atë. Sapo më kishte vdekur nëna Esmë dhe dy motrat, Sanije dhe Myzejen. Me Sabriun shkonim në varrezat e Gazi-Babës. Ai qante, unë jo. Ktheheshim në magazinë e miellit, ku futej treni dhe mësonim biçikletën. Pastaj rrafshonim me duar pak miell dhe vizatonim mbi të me gishtat e vegjël. Më duket se unë vizatoja më me lehtësi figura dhe skena lufte”.

Erdhi momenti i ndarjes. Abdurrahimi mbetur jetim, bashkë me vëllanë Qemalin, u kthye në Gjakovë, ndërsa Sabriu vazhdoi shkollat në Shkup.

*

* *

Sabri Fetahu lindi në Shkup më 1907 në familjen e Hajrullah Fetahut, library në Shkup, i njohur nga nxënësit kosovarë, që studionin nëpër shkollat turke të këtij qyteti. Familja e gjyshit të tij, Fetahut, kishte ardhur nga Peja dhe banonte në rrethinat e Shkupit, në Jabuçishtë. Ata kishin çifligjet në Qypërlë, Buzallakovë dhe në Shkup dhe merreshin me duhanin. Gjyshja, Zejnepja, deri sa vdiq, në moshën 89 vjeçe, vishej me rroba fshatare shqiptare të krahinës së Pejës dhe fliste shqip, ndërsa turqishten e përdorte çalë. Varri i saj dhe i hajrullahut janë në fshatin Buzallakovë, afër Qypërlisë. I ati vdiq në fshat, aty ku kaloi pleqërinë. Ai nuk shkoi në Turqi, ku të dy djemtë, Sabriu dhe Avniu, kishin filluar jetën në Stamboll. Edhe

nëna, Xhevahirja, kështu bëri ndonëse malli për dy djemtë e dogji dhe e përvëloi pa masë. Ndryshe bëri xhaxhai i tyre, Dauti, që vdiq në vitin 1978 në Izmir te e motra, familja Hava Tanëku.

Në vitin 1927 Sabriu mbaroi shkollën serbo-franceze të Shkupit, ku u shqua për talentin e tij për piktor, prandaj ndjek Akademinë e Arteve të Bukura të Beogradit, duke marrë diplomën në Kursin përgatitor (1927 – 28), për të vazhduar më tutje me bursë shqiptare në Akademinë e Arteve të Bukura të Firencës (1929 – 35) në studion e Felice Karenës, Galileo Chinit dhe Celestioni. *“Ka qenë I habitshëm takimi me Sabriun ,-tegonte im atë.-Pas kaq vitesh takoheshim në një shkollë, në një Akademi, në një kur, në një atelie, me të njëjtët profesorë dhe kolegë, që u bënë artistë të shquar, italianë dhe të huaj, si Ahmed Osman, ish-rektor i Akademisë së Kajros etj. Ky ishte takimi i dytë me Sabriun, tashti shokun e dashur dhe të respektuar, që kishte shpërthyer me talentin e tij shkolluar pranë mjeshtrash të shquar.*

Nga Karena mësuam pikturën me vaj, Galileo Chini na mesoi pikturën monumentale, afreskun dhe mozaikun, ndërsa nga Celestioni Celestini në dy vjetët, deri më 1935 Sabriu mësoi teknikat e grafikës së librit, gdhendjeve në bakër dhe zink, akuafortin dhe akualintën.”

Vitet në shkollë kanë qenë për Sabri Fetahun kohëra pune të vrullshme, studimi skrupuloz të natyrës, modeleve nudo, femër apo mashkull, zbërthyer në laboratorin e artistit, që çmonte vizatimin linear dhe planin e gjerë, njollën grafike në harmoni të plotë me karakterin e figurës në lëvizje. Thëkset grafike të tij në prioritetet dhe natyrat e qeta, kompozimet figurale dhe interesimi i jashtëzakonshëm për mjeshtrit e mëdhenj të Rilindjes italiane nga mësoi teknikat e magjishme të pikturës monumentale dhe e bëri artistin shembullor në mes shokëve. Ishte shumë serioz, studionte historinë e arteve dhe vizatonte çdo muze, kishë apo “qoshe” te artit florentin. Ai eksperimentonte dhe manifestonte disa shfaqje, që kapërcenin detyrat e shkollës, mënyrën tradicionale të programeve dhe kerkesave. Pedagogët ishin tolerantë dhe nuk pengonin iniciativat vetiake, origjinalitetin, përkundrazi ata përkrahnin formimin e individualiteteteve artistike në atelie. Këto bënë që Sabri Fetahu të dalë nga shkolla i formuar për të përballuar sfidat që e prisnin. Në vitin 1935 ai kthehet në Turqi dhe në tetor të këtij viti të hapë ekspozitë në Sallonin e katit të dytë të Galerisë së Arteve të Bukura të Stambollit.

Tashmë Sabri Fetahu, pas studimit çoi në Turqi elemente të artit modern të shekullit XX. Vizatimin linear ai e palcon me ndjenjën e volumit konstruktiv, vlerat e traditës-Rilindjes italiane t’i sjellë në kohë përmes një qëndrimi krejt vetjak, me mjete të reja artistike modern e bashkëkohore.

Duke u njohur me punimet e para, në ekspozitën e Stambollit si dhe të tjera vepra, piktori i vjetër i Turqisë Qemaliste Arif Dino në revistën *“La Turqie Kamaliste”* që dilte në Ankara, botuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Zyrës së Shtypit në Ministrinë e Brendshme, pati shkruar, mes të tjerash: *“Qoftë partisan i abstraksionit ose i respektit të formave ky artist, që na sjell mesazhin e një paseisme të re të ndryshme të kubismës dhe di të palcojë në vetëhe të tij të vjetrën dhe të renë, përfaqëson një vlerë plot të ardhme në udhën e përparimit të padyshtuar drejt artit në të cilin gjendemi”.*

A. Dino vazhdon më tej: *"Nga GIOTTO-ja Sabri Fetahu asimiloi cilësitë e volumit dhe knstruksionit; nga MASACCIO fitoi frymën e lirisë në art; nga FRA ANGELICO mori pamjet e thella mistike; më në fund nga ANDREA DEL CASTAGNO dhe nga GIRLA NDAIO mësoi teknikën, domethënë të gjitha nuancat e të gjitha vështirësitë e artit të afreskut; për MICHELANGELO-n pat qenë dhe, mbeti për të një burim hyjnor fuqie dhe zotësie të përjetshme, një ideal i pathyer dhe një simbol i bukur i përjetësisë së Artit"*(ARIF DINO; "Përpyjekja shqiptare", Nr.4,5,6 1036-'37).

Sabri Fetahu në fillim caktohet si mësues vizatimi në Ankara dhe Stamboll, ndërsa në vitin 1939, me kërkesën e Leopard Levy caktohet asistent në studion e gravurave të Akademisë së Arteve të Bukura të Stambollit. Këtë vit, si anëtar i Lidhjes së përbashkët të piktorëve dhe skulptorëve të Turqisë, merr pjesë me 16 vepra në Ekspozitën e Parë Shtetërore të Pikturës dhe Skulpturës. Pastaj vazhdon me Ekspozitën e dytë Shtetërore (1940) me 21 punime dhe një vit më vonë, më 25 janar 1941 në ekspozitën e "Grupit D", hapur në Akademinë e arteve të Stambollit. Më 21 prill-11 maj në Shoqatën e Filarmonike të Stambollit hap ekspozitën e dytë personale me 100 vepra (vizatime, gravura, piktura me vaj) për të vazhduar më tej me pjesëmarrje në ekspozitat shtetërore, ato të "Grupit D", të tjerat vetjake etj.

Në vitin 1946 Sabri Fetahu merr pjesë në Paris në Ekspozitën e Artit të Vjetër dhe Bashkëkohor turk dhe një vit më vonë shkon përsëri në Paris për t'u specializuar (kërkime dhe studime) në shtypshkronjat ku botohen "libra luksi". Bën vizita studimi në Angli, Itali dhe Spanjë. Pra, menjëherë pas studimeve bën një jetë shumë aktive krijuese dhe njohëse, kërkuese dhe eksperimentuese. Pas kthimit nga Parisi, i ndikuar nga piktura brilante e mjeshtërve Tashistë (njollistë) realizon peizazhe dhe natyra të qeta me njolla të forta ngjyrash dhe merr pjesë në Ekspozitën e Artit Modern Turk, që hapet në Amsterdam.

Nga viti 1949-'50 artisti Sabri Fetahu (Berkeli) realizon natyra të qeta me një konceptim post-kubist.

Nga viti 1949-1974 ai është Profesor në degën e arteve dekorative të Akademisë në Stamboll.

Me punimet "Kubat I,II" dhe "Macja" fillon pikturën abstrakte. Ndërsa me punimet "Shitësi i kosit", "Shitësi i simiteve" dhe "Arkitekt Sinani" (1952), si dhe shumë vepra të Ekspozitës së tretë personale (16prill-9maj 1953) çmohen si punime të mirëfillta postkubiste dhe abstrakte gjeometrike. Merr pjesë në Bienalet e Venecias (1956), San Paolos, Tokios, Luganos, etj.

Ndonëse u specializua edhe në lëmin e pikturës monumentale e dekorative, të afreskut dhe mozaikut, shumë vonë, rreth viteve '60-të provon të marrë përsipër vepra të këtij karakteri. Janë disa mozaikë dhe një kompozim bile me bojëra vaji, jo në teknikën e afreskut, në Pallatin Xhemal Okçudhu në Stamboll (1958) si dhe në Pavionin turk në Ekspozitën ndërkombëtare të Brukselit.

Aktivizohet në grafikë dhe merr pjesë në ekspozitën "Artet grafike turke" në Vjenë (1960). Në Vjenë ai hap gjithashtu të parën ekspozitë personale jashtë shtetit, me vizatime, incizime origjinale, ngjyra vaji (31tetor-10nëntor 1962).

Sabri Fetahu vazhdon jetën e gjallë artistike. Merr pjesë në ekspozitat e artist turk në Paris, Bruksel, Berlin, Vjenë, Romë, Teheran, Sofje, Shkup, Budapest, San Paolo, Buenos-Aires, etj.

Më 1977 caktohet drejtor i Muzeut të Pikturës dhe Skulpturës në Stamboll. Ai që nga viti 1939 e deri më 1969 ka dhënë mësim në studion e gravurës në Akademinë e Stambollit dhe qysh nga 1969 deri sa doli në pension ka qenë Kryetar i Studiove të Arteve të Aplikuara, ku jepte lënë e kompozimit (projekttimeve themelore).

Në vitin 1982 Sabri Fetahu vjen në Shqipëri me disa piktorë të tjerë dhe ekspozitën e përbashkët të pikturës moderne turke, ku ai përfaqësohej me një pikturë tipike kubiste. Mbaj mend, kur u futën në kufi nga Qafa e Thanës, duke udhëtuar maleve, Sabriu nuk fliste, vetëm shikonte me kureshtje peizazhin dhe thoshte i habitur: “Vaj, vaj, Vatan, Vatan!”. Ditët që kaloi në Atdhe kanë qenë mbresëlënëse. Takoi kolegë, bashkëmoshatarë, vizitoi studio dhe muzeume, u njoh me krijimtarinë e artistëve dhe bisedoi me ta përزمërsisht. Takimi me Abdurrahimin ishte i përmallshëm dhe shumë vëllazëror. *“Është e treat herë që takohemi. Në fëmijëri në Shkup, rini në Firencë dhe tani në pleqëri këtu ne Vatan. Inshalla apet”*. Qëndruan bashkë ato ditë dhe kujtuan sa shqip e sa turqisht, duke sjellë në retrospektivë momente të ndryshme të jetës, kujtuan të afërm dhe aktivitetet artistike. Sabriu ishte tepër serioz dhe i matur, veshur me kujdes, admironte mbi çdo gjë artin, respektonte tjetrin dhe fliste me shumë politesë. Duke vizituar Galerinë tonë të arteve shprehu habinë për shtratin e çmuar të traditës realiste, qëndroi me admirim përpara autorëve dhe veprave të veçanta. *“Muzeu I Skënderbeut është një ide dhe ndërtim ekstraordiner, një botë e madhe, forcë e artist shqiptar, unë besoj se, pas shumë vitesh, kjo vepër do të gjykohet si Rilindje e artist shqiptar. Pikturat janë të mahnitshme”*, - pat thënë për të Sabri Fetahu.

Në vitin 2000, nga 2-30 mars, në Galerinë AXA OYAI të Stambollit u hap një ekspozitë me 17 vepra të rëndësishme të tij në përkujtim të këtij kolosi të pikturës modern turke, me origjinë shqiptare. Unë qëllova ditën e mbylljes. Organizatorë ishin kolegët e tij pedagogë të Akademisë së Arteve “Mimar Sinani” të Stambollit, të cilët e patën njohur në vitin 1980, kur u hap Ekspozita Shqiptare e Pikturës dhe Skulpturës sonë. Ky ishte një takim pa Sabriun, por me veprën e çmuar të tij, perla të artist- vlerë e padiskutueshme, plot respekt.

*

*

*

Sabri Fetahu thoshte: *“Artisti është një njeri i lirë. Shoqëria e bën artistin të interesohet për çështje të ndryshme, në rrugë të ndryshme. Kjo ndryshon sipas karakterit të çdo artisti. Dikush mbetet në konceptin e pastër estetik. Dikush u drejtohet problemeve sociale. Një tjetër kërkon rrugë të reja, një tjetër ndeshet me të kaluarën, ndërsa një tjetër thur ëndrra për të ardhmen.”*

“Po u ngule në një vend do të thotë të ngecësh në art. Arti nuk është një drejtim, ai ka edhe do të ketë me mijëra.”

“Për çdo artist ka një art të bërë më parë dhe një art për t’u bërë në të ardhmen.”

Këto dhe të tjera thënie të tij rrahin aty ku ai kërkonte shpirtin novator të artistit, ecjen përpara përmes përpjekjesh eksperimentuese, natyrshëm dhe rezultat i kulturës, njohjes dhe mjeshtërisë profesionale. Sabri Fetahu e filloi pikturën përmes një vështrimi realist, me vizë të mprehtë dhe të ashpër. *“Në portretet e fillimit të tij jepen edhe bebet e syrit, edhe qimet. Tani u ka rruar dhe mjekrën, edhe mustaqet portreteve të tij, u ka nxjerrë rrënjët peizazheve dhe figurave”*

Sabri Fetahu kaloi gjatë rrugës së vështirë të artit, në “shpatet e thepisur” të tij, i pajisur me një bagazh të madh artistik e kulturor. Njohu traditat Rilindase, kulturën popullore dhe artizanatin, të gjitha rrymat dhe drejtimet modern, kaligrafinë dhe arabeskat. Ai kaloi nga realizimi në konstruktivizëm, kubizëm, abstraksionizëm gjeometrik, shpërthime të lira jo figurative. *“Eksperimentet e para abstrakte në pikturën turke filluan me punimet e Berkelit të vitit 1947. Vepra “Sheshi Taksim” e paraqitur në ekspozitën e fundit të “Grupit D” në konsullatën franceze, në Taksim ishte shembulli i parë, që pasqyronte largimin e piktorit nga natyra, afrimin e tij në botën abstrakte të formave, vijave, ngjyrave”, – ka thënë për të mjeshtri i madh turk NURULLAH BERK.*

Krenohemi me vlerat e SABRI FETAHUT BERKELIT, shqiptaro-turkut, kolosit të artit modern turk, Buyuk Usta SABRI! Të madhit akademik, ndër të parët mjeshtër me Akademi arti studiuar në perëndim, bashkëkohës, kolegët, shok dhe të afërm me Abdurahim Buzën (1905 Shkup-1986Tiranë).

ALBERT RAMAJ**DOM ZEF RAMAJ (1882-1914) - FAMULLITAR,
MËSUES NË SHKUP DHE PAGËZUES I GONXHE
BOJAXHIUT****Me rastin e 100- vjetorit të vdekjes së tij**

Për fëmijërinë e Dom Zef Ramaj kemi shumë pak informata. Dom Zefi lindi më 08.01.1882 në Stubëll të Epërme (Komuna Vit) dhe vdiq më 25.12.1914 në Shkup. Prindërit e tij, i ati Pali dhe e ëma Çila, kishin 6 djem dhe dy vajza. Zefi ishte fëmija i pestë i tyre. Në vitin kur lindi Dom Zef Ramaj, Stublla e Epërme kishte 24 shtëpi dhe 149 shpirtra (banorë), shumica katolikë shqiptarë, përveç 2 shtëpive që ishin kritpokatolikë me 10 shpirtra. Stublla i përkiste në këtë kohë famullisë së Cërangorës - Letnica apo siç quhej Montenegro di Scopia. Zefi duhet të kishte vizituar vitet e para të shkollës në Prizren. Kurse 9 vite të tjera vizitoi në Shkodër, 5 vite të shollës normale dhe 4 vite tjera në kolegjin Ksaverian filozofi dhe teologji, deri në vitin 1905.

Kërkesës së Imzot Trokshit, që kandidatët e Ipeshkvisë së Shkupit të shkolloheshin, të studionin në Innsbruck, Austro-Hungaria iu përgjigj pozitivisht. Në këtë universitet studiuan dhe studentë të tjerë nga të gjitha trojet shqiptare. Njëri nga ta ishte edhe Zef Ramaj. Ky, më 26.09.1905, bashkë me katër shqiptarë të tjerë, nën përcjelljen e Dom Nikollë Ashtës, arriti në Innsbruck. Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit i kishte paguar Austria. Studentët, përveç rrobave në trup, nuk kishin gjë tjetër me vete kur arritën në Innsbruck. Vendi prej nga vjen Dom Zef Ramaj shënohet "*Albaniae*". Ndër studentët shqiptarë që kishin studiuar atje janë edhe Martin Berisha nga Peja, Françesk Karma nga Tivari, Shtjefën Kurti nga Prizreni, Marjan Glasnović nga Janjeva, Lazër Shantoja nga Shkodra etj. Këtu do të shënojmë edhe disa nga dokumentet që gjenden në arkivin shtetëror e që kanë të bëjnë me studentin e atëhershëm, Zef Ramaj nga Stublla.

Më 24 prill 1906, rektori i konviktit P. Michael Hofmann, informon për katër studentët shqiptarë: Berishën, Gjergji, Ramajn dhe Karmën. Ai thotë se këta po përparojnë jo vetëm në gjuhën gjermane, por edhe në studime.

Rektori i seminarit në Innsbruck, P. Michael Hofmann S. J, datë 25 korrik 1907, njofton se tashmë Berisha, Karma, Ramaj e Gjergji i kishin përfunduar studimet dhe se ishin kthyer në Prizren ku dhe do shugurohen për meshtarë. Më tej, rektori flet për ndarjen, që siç thotë, ishte e rëndë për ta, por që shpreson të mos shpëpusin lidhjet dhe për raporte të mira të të sapokthyerve me përfaqësuesit austro-hungarezë në vendlindjen e tyre. Rektori kishte paguar shpenzimet e

udhëtimit për kthimin e tyre në vendlindje, sikundër edhe për gjërat e nevojshme për meshë të parë për katër kandidatët për gjëra të tjera që kishin kërkuar vetë studentët shqiptarë.

Një dokument që kemi marrën nga arkivi i konviktit teologjik „Canisianum“ të Innbruck shënohet se nga aty dom Zef Ramaj kishte shkuar në Prizren më 8 korrik 1907. Më tej, shkruhet për të se ishte „*shumë i gjallë, fisnik*“. Sipas të njëjtit burim, mësojmë se dom Zefi ishte shuguruar për meshtar në Prizren në muajin korrik 1907. Konsullata austriake në Prizren, përmes zëvendëskonsullit Prochaska, më 29 korrik 1907, njofton se Imzot Trokshi i kishte shuguruar Dom Zef Ramaj nga Stublla e Dom Martin Berishën nga Peja dhe informon edhe për caktimin e dom Zef Ramaj-t „*Cooperator*“ në famullinë e Shkupit, pra, ndihmës i famullitarit të atëhershëm (të Shkupit), Dom Ndue Bytyqit.

Sipas burimeve austriake, dom Zefi fillimisht ishte emëruar „cooperator“ (ndihmës famullitar), e më vonë famullitar i Shkupit. Ai ishte edhe mësues në shkollën shqipe pranë famullisë së Shkupit, sikundër edhe në shkollën e *Hekurudhës* (një shkollë elitare për kohën, ku mësonin edhe fëmijët e diplomatëve të huaj).

Shkolla shqipe (për meshkuj dhe femra), pranë kishës katolike në Shkup, kishte ekzistuar qysh para vitit 1889. Prej vitit 1893, me kërkesën e Gjon Kajtazit, mësues i kësaj shkolle, atë e ka përkrahur financiarisht Austro-Hungaria, me një shumë vjetore prej 500 frangash. Mësues në këtë shkollë ishin: Gjon Kajtazi, Nikollë Rrota, Mate Logoreci, një mësues për gjuhën turke, Gaspër Beltoja, Gapsër Mikeli, dom Zef Ramaj, dy motra, murgesha nga Zagrebi, njëra prej të cilave ishte Protegjena Bekes (Bekaj) nga Stublla (Protegjena Bekaj është teza e babait të autorit të këtyre rreshtave).

Më 31 janar 1911, konsullata austriake e Shkupit njofton se një grup ortodoksësh nga Maqedonia, më saktë nga Kumanova, kishin shkuar tek argjipeskvi Lazër Mejda, tek Dom Pashk Krasniqi, famullitari në Ferizaj, por edhe tek Dom Zef Ramaj në Shkup, për t’iu treguar se dëshironin të kalonin në katolicizëm dhe se për këtë kërkonin mbështetjen dhe ndihmën e tyre. Të sqarojmë se fjala është për besimtarë ortodoksë maqedonas dhe jo për komunitetin katolik të ritit bizantin, i cili jeton edhe sot e kësaj dite në territorin e Maqedonisë (sidomos në Jug të Maqedonisë, në Strumicë). Në raportin e datës 24.03.1911, konsulli Heimroth njofton se dom Zefin e kishte vizituar një nëpunës për t’u informuar nëse pas kërkesës së ortodoksëve maqedonas për konvertim në katolicizëm fshihej ndonjë interes a përfitim material. Më 8 mars 1914, kishin shkruar edhe një letër shumë interesante në gjuhën italiane lidhur me rastin e konvertimit të 60 familjeve ortodokse maqedonase në katolicizëm.

Më 1 dhjetor 1913, raportohet për problemet që kishin besimtarët katolikë në Shkup, e sidomos ata që ishin në Kryesi të Këshillit të Kishës. Kështu, Rrok Prenk Berishën, një arpunues, pasi e kishin dënuar me shumë të mëdha në të holla, organet lokale serbe e kishin kërcënuar që ta lëshonte vendin, përndryshe do ta burgosnin. Këtë e bënin nën pretekstin kinse të aktivitetit e të intrigave politike të Rrok Berishës. Do thënë se Rrok Berisha (i një familjeje 14 anëtarësh), besimtar i Dom Zefit, atëbotë ishte një figurë në zë në Shkup. Po ashtu, ai kishte miqësi dhe

bashkëpunim edhe me Alandro Kastriotin, pretenduesin e fronit shqiptar të asaj kohe, që jetonte në Paris. Me deportimin e Rrok Berishës dhe të njerëzve në zë, siç njofton konsullata e Austro-Hungarisë, organet serbe dëshironin dobësimin e elementit katolik shqiptar në Shkup. Famullitari, Dom Zef Ramaj informon konsullatën se Rrok Berisha, me familjen vet 14 anëtarësh, do të largohet së shpejti nga Shkupi në drejtim të Durrësit.

Më 3 prill 1914, konsullata austro-hungareze raporton për vizitën që iu kishte bërë dom Zef Ramaj, në fakt ai po këshillohej me ta për gjendjen e re politike. Konsulli njofton edhe për interesimin e dom Zefit se si duhej të vepronin shqiptarët katolikë për çështjen e shtetësisë e të shërbimit ushtarak, meqë besimtarët e tij do të ballafaqoheshin me kërkesën e organeve zyrtare për t'u deklaruar nëse përcaktohen për shtetësi turke apo serbe. Konsulli i shpjegon dom Zefit se me Marrëveshjen e paqes mes Serbisë e Turqisë, të datës 9 mars, nuk ishin të rregulluara çështjet në fjalë për shqiptarët katolikë, por vetëm për myslimanët (të cilët nuk obligohen për të shkuar në shërbimin ushtarak serb). Dom Zef Ramaj, njofton se shumica e shqiptarëve katolikë të Shkupit, të gjendur në këto rrethana, po e mendojnë largimin nga vendi i tyre.

Më 11 prill 1914, konsullata austriake informon për marrjen peng të trenit të linjës Prizren-Shkup. Në këtë tren kishte qëlluar edhe dom Zef Ramaj (që po kthehej nga Prizreni), i cili dëshmon për vrasjen e një personi. Sipas dom Zefit, në tren ndodhej edhe inspektori i policisë, Cerovic (i njohur për kohën), i cili pyetjes së Dom Zefit se pse ndodhej në këtë tren, Cerovic ishte përgjigjen: "Rastësisht". Dom Zefi njofton se për ngjarjen në fjalë i ngarkuan shqiptarët, më saktë Jusuf Tabian nga Tetova me njerëzit e tij dhe se organet e shtetit kishin dërguar 200 xhandarë për t'u marrë me rastin. Meqë Dom Zefi kishte udhëtuar me këtë tren, për konsullatën e Austro-Hungarisë ishte krejt e qartë se kush e kishte bërë rrëmbimin e trenit. Më vonë, pikërisht ky inspektor Cerevic kishte kërcënuar dom Zef Ramaj dhe disa meshtarë tjerë për shumë gjëra, bile edhe largimin e dom Zef Ramaj nga Shkupi.

Konsulli i Austro-Hungarisë në Shkup lajmëron se kishte marrë pjesë në festën e *Korpit e të Gjakut të Krishtit në Ferizaj*. Meshën, me urdhër të ipeshkvit Lazër Mjeda, e kishte udhëhequr Dom Zef Ramaj, në koocelebrim me Atë Zadrimën. Konsulli kishte marrë pjesë me uniformë zyrtare në meshë, të cilën e cilëson shumë të denjë, sikundër edhe pjesëmarrjen dhe paraqitjen e popullatës shqiptare katolike.

Dom Zef Ramaj kishte shërbyer në Shkup prej vitit 1907 deri më 25 dhjetor të vitit 1914, kur dhe kaloi në amshim. Kishte jetuar dhe vepruar në Shkup, në një kohë shumë të vështirë, në kohën e Perandorisë Osmane, me të cilën kishte probleme jo vetëm administrative, sidomos më 1910, kur organet lokale dëshironin që në pronën e kishës katolike të ndërtonin rrugën. Pas rënies së Perandorisë Osmane, problemet vazhdojnë me serbët, gjatë luftërave ballkanike, kur gjendja e shqiptarëve, sidomos e atyre katolikë në Shkup, ku kishte shërbyer si meshtar e mësues, ishte tej mase e rëndë.

Organet lokale turke provonin ndërtimin e një rruge në Shkup, e cila po u ndërtua, prek dhe një pjesë të oborrit të kishës. Dom Zefi i kishte shprehur

shqetësimin dhe i kishte kërkuar ndihmë për këtë rast edhe konsullatës së Austro-Hungarisë. Dom Zefi, më 20.06.1910, kishte parashtruar ankesë edhe pranë organeve turke, që rruga të mos ndërtohej siç kishin planifikuar ata, meqë rruga prekte edhe diku 570 metra katror të Kishës, ndërkohë që autoritetet lokale turke nuk kishin paraparë ndonjë kompensim. Konsullata e Austro-Hungarisë e sheh të arsyeshme kompensimin e pronës së kishës nga ana a organeve lokale turke.

Argjipeshkvia e Shkupit kishte fat të madh me emërimin e Imzot Mjedës në krye të saj. Ai ishte një prijës i vërtetë shpirtëror në kohëra mjaft të vështira për popullin e Argjipeshkvinë, siç ishin Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike, si dhe Lufta e Parë Botërore. Gëzimin e madh për emërimin e Mjedës në krye të Argjipeshkvisë Shkup-Prizren e tregon edhe një shkrim i Dom Zef Ramaj, botuar në *Elçija e Zemres s' Krishtit më 1910*, ku shkruan ndër të tjera edhe këtë: „*Ishte një vjet e gjysë qi kishim mbetë paa Barii, pa Priis, e sakt qi fort t'vshtirshme kiene per nee kto dit vorfnimit. Por i Lumi Zot ne e mram na ngushlloi, tui na zgjedhë per Argjipeshkëv një njeri qi e kishte per zemer, e i cili prandej s'muite mos me ken edhe per zemer t'onë. Po, i Lumi Zot na ngushlloi tui na çue per Argjipeshkëv Emzot Lazer Mieden. Veç na diim se saa kemi dishrue me pasë një Barii, e saa na u knaq zemra kuer ndieme se ky do t'ishte Emzot Lazer Miedia e me saa dishiir e kemi pritë! Te tan Meshtarija me popull mbarë a gzue kuer kaa ndije se njimend do t'na vite. Famullija e Shkupit e pat nafak me kenë e para me e pritë ket Zotnii çuemun prei Zotit per me na rregullue, e kio famullii tui ja diit Zotit per nderë u mundue me e pritë saa maa mirë qi t'muite. Prei Sarajevet i Shndritshmi Zotnii me tel na baike me diitë ditën qi do t'mriite, e at herë, një ditë perpara t'ardhunit, me pushtlla t'posaçme u dha fiala t'tanve shpii per shpii` si shqypstarve si t'hujeve, (t'tan bashkë janë 140 shpii) se me 4 ndanorit kishte per t'ja mrii Argjipeshkvi i rii Emzot Lazer Miedia, e qi t'urdhnoishin me dalë me u pritë n`Stacion t'udhes hekrit. Njimend burrnimi mar duel; graat e fmija ishin mledhë n'oborr t`Kishës.*“

I Nderueshmi Zotni D. Nikoll Mazreku, Prifti i famuliis t'Pezrendit, bashkë me D. Pashko Krasniqin, kishin dalë me e pritë n`Kumnov, per me i thanë n`emen te tanve : “Mirë se po t'bie Zoti” I nderushmi Zotnii D. Nikoll Glaznoviç, D. Mikel Glaznoviç, Viçe-Korçlla i Nemces (Zotni Korçlla nuk ishte ktu), Gjergj Adamkievitz, Viçe-Korçlla i Italies Zotni Galanti, Viçe-Korçlla i Frances, bashkë me popullin mbarë, sikuer thaçë, ishin mledhë n`Stacion t'udhes hekrit. Qe ja mrrini ai ças i bardh, n't`cillin i Shndritshmi Argjipeshvi i rii do t'shelte n`Arkidoçez t`vet. Mbasi t'tanë ja murne doren, gjithmbarë u ndisne kah Kisha, ku kumont i baishin me diit gjytetit mar se katolikt kishin një gzim t'posaçem. Prej deres t'oborrit deri n`derë t`Kishes ishte stolisë me bush, me lule e me bairaqe e para ders t`Kishes një qemer i bukur e n`të shyti (stemma) i perndritshmit Zotnii Emzot Lazer Miedes...

Luftërat ballkanike, më 1912 e 1913, për popullatën shqiptare në Maqedoni dhe Kosovë ishin shumë të rënda. Kjo gjendje e rëndë pasohet me Luftën e Parë Botërore, më 1914. Popullata shqiptare në Kosovë e Maqedoni kishte mbetur më shumë nën mëshirën e shteteve evropiane dhe të personave të caktuar sesa në diçka tjetër. Në këto rrethana, një rol shumë pozitiv (për këtë popullatë) e ka luajtur dom

Zef Ramaj dhe kleri katolik shqiptar i Argjipeshkvisë së Shkupit në krye me Imzot Lazër Mjedën.

Një rol të rëndësishëm për “shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë” do të luante edhe argjipeshkvi i Shkupit, Imzot Lazër Mjeda, bashkë me dom Zef Ramaj

Para nisjes për në Vlorë, Ismail Qemali ndodhej në Vjenë. I gjendur pa para në xhep, më saktë me një çek bankar të pavlefshëm (asnjë nga bankat vjeneze nuk e merrte parasysh), I. Qemli s’kishte se si të udhëtonte për në Vlorë për të shpallur pavarësinë e Shqipërisë. I njohur me situatën, Imzot Mjeda mobilizoi miqtë që kishte pranë qeverisë së Austro-Hungarisë, dhe i mundësoi I. Qemalit që me një anije ekstra të financuar nga Vjena, të arrinte në Durrës. Mjeda duhej të merrte po ashtu pjesë në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë. Nëpunësi austriak i konsullatës në Shkup, më 29 nëntor 1912 i dërgon një letër qendrës me çka njofton se mësuesi i shkollës së famullisë katolike vendore, Logoreci, bashkë me famullitarin dom Zef Ramaj, e kanë informuar se Logoreci dhe argjipeshkvi Imzot Mjeda sot kishin pranuar një letër nga Durrësi, dërguar prej të deleguarve shqiptarë të Kosovës Veriore. Atyre u kërkohej që të dërgonin një delegat nga Shkupi, për mbledhjen e planifikuar në Vlorë, të organizuar nga krerët (paria) e gjitha anëve të Shqipërisë, që kishte të bënte me shpalljen e autonomisë së Shqipërisë. Ata do të konsultohen edhe për marrjen e masave eventuale varësisht prej situatës që do krijohet pas shpalljes së autonomisë së Shqipërisë.

Nga Logoreci kërkohet që, në rast se i deleguari nuk mund të udhëtojë, të paktën për këtë çështje të dërgojë një letër përkrahëse në emër të shqiptarëve të këtushëm, të ndërmjetësuar nëpërmjet entit të këtushëm konsullor të monarkisë. Në lidhje me këtë, Heimroth thotë se u ka shpjeguar (Logoreci dhe dom Ramaj) se për momentin nuk është i sigurt nëse ka mundësinë për një gjë të tillë. Nga një telegram i konsullit austro-hungarez në Shkup dërguar Vjenës, në nëntor 1912, mësojmë se delegatët shqiptarë kishin lutur argjipeshkvin L. Mjeda, famullitarin e Shkupit dom Zef Ramaj dhe mësuesin Logoreci që të përbënin një delegacion për pjesëmarrje në Vlorë, për të biseduar për gjendjen e shqiptarëve dhe mundësisht edhe të shpallet “autonomia” e Shqipërisë.

Nganjëherë thuhet se shkrimet e dërguara nëpër gazeta të atëhershme austriake janë të Lazër Mjedës. Do thënë se disa nga informacionet për gjendjen e popullatës shqiptare ishin dërguar edhe nga Dom Zef Ramaj e Dom Pashk Krasniqi, siç njofton vetë L. Mjeda, kur i shkruan Vatikanit (më 24 janar 1913) letrën e njohur për gjendjen në Argjipeshkvi. Në këtë letër shihet shumë qartë se Dom Zef Ramaj e dom Pashk Krasniqi raportnin sidomos për ato vende që ishin afër famullisë së tyre. Dom Zefi, raportonte për gjendjen në rajonin e Shkupit, Kumanovës, Kisela Vodës, Tetovës (Kalkandele) e Gostivarit, kurse Dom Pashk Krasniqi raportonte për Prizrenin, Pejën e vende të tjera përreth.

Do thënë se Dom Zefi kishte informacione të mira edhe për Karadakun në Kosovë, meqë vinte nga ajo pjesë, nga Stublla. Një raport i konsullit austriak në Shkup, informon për tmerret e masakrat ndaj popullatës (shqiptare pa dallim religjioni) të zonës së Karadakut. Raporti njofton mbi bazën e informacioneve që konsullit ia kishte dhënë Dom Zefi, e këtij të fundit Mitat Aga nga Gjilani.

Heimrot, konsull austriak në Shkup, i përmend ministrit austro-hungarez, Leopold Berchtold, më 9 shkurt 1913, një letër të Mjedës dhe shton se informacionet (që përmbante ajo) ishin dhënë nga Dom Zef Ramaj. Se Dom Zef Ramaj kishte raportuar vendet evropiane për gjendjen e shqiptarëve, tregon edhe botimi i letrave private të teologëve shqiptarë (të universitetit të Innsbruck-ut) në gazetën austriake *“Allgemeiner Tiroler Anzeiger”* të datës 28 mars 1913, mandej se vendi prej nga vinin shkrimet ishte Shkupi, ku tashmë, Dom Zefi ishte me shërbim, ku shkruan ndër të tjera kështu: *“Për momentin nuk kam mundësi që t’ju dërgoj një raport të detajuar. Ju duhet të keni parasysh se gjendemi në gjendje lufte.... nuk mund të paramendoni atë se çka është mëkatuar ndaj bashkatdhetarëve tanë në këtë luftë.... zemra ime është përplot, për atë se çfarë mund t’ju shkruaj më tutje. Më mirë do të vdisja se Shqipërinë ta shihja në këtë gjendje, në të cilën gjendet”*.

Në artikullin e gazetës *Reichspost* jepen në detaje masakrat e bëra ndaj popullatës shqiptare (pa dallim feje) në territorin e Kosovës e Maqedonisë, duke filluar prej Shkupit, Kalkandeles, Ferizajt, Prishtinës, Prizrenit, Gjeneral Jankoviçit, Tërstenikut, Pejës etj. Reichspost i jep rëndësi kësaj dosjeje dhe shkuan 3 faqe, në numrin e 17 janarit 1913. Në këtë shkrim ceket se dosja është autentike dhe nga një personalitet shqiptar dhe se ka dëshmitar për gjithë atë çfarë ka ndodhur në Shkup. E ky, pa dyshim, është Dom Zefi, famullitar në Shkup, ndërkohë që Imzot Mjeda gjendej në Vjenë, në kontakt me qarqet diplomatike të atjeshme, por edhe me media, për çështjen shqiptare në Kosovë e Maqedoni dhe se Leo Freundlich, në librin e tij *Golgota shqiptare* përshkruan vrasjet në rajonin e Karadakut, si në Lubishtë, Smirë, Komogllavë, Shashare – të gjitha këto vende në afërsi të Stubllës, vendlindjes së Dom Zefit, të cilën ky i fundit e vizitonte shpesh edhe për të qenë mirë i informuar me gjendjen e përgjithshme. Ngjarjet e paraqitura në libër, autori i kishte marrë prej gazetës së sipërpërmendur, të datës 17.01.1913. Në raportet e 24 janarit 1913, Mjeda tregon se informacionet e dhëna aty për gjendjen e shqiptarëve, i kishte nga Dom Zefi e Dom Pashk Krasniqi. Më 9 shkurt të vitit 1913, konsulli austro-hungarez në Shkup, Heimroth, i shkruan Vjenës zyrtare se Imzot Mjeda raportonte duke u thirrur në informacionet e Dom Zefit. Edhe vetë Heimroth, në një rast shkruan: *“Ashtu siç shkruan Mjeda në letrën mbi tmerret (ndaj shqiptarëve) më kanë ardhur edhe mua në vesh. Famullitari i Shkupit, Dom Ramaj më tregoi se ai ishte dëshmitar dhe përmend një ushtar serb me emrin Ciceric. Konsulli vazhdon tutje duke thënë se këto gjëra i kishte parë edhe murgesha katolike që vepronte në spitalin e Shkupit e që ishte edhe mësuese e subvencionuar nga Austro-Hungaria. Fjala është për murgeshën Protegjena Bekes nga Stublla, bashkëvendëse e Dom Zefit. Ajo kishte parë shumë kufoma të shqiptarëve myslimanë në lumin vardar. Më vonë, konsulli shkruan se burim informacioni i Dom Zefit, ishte edhe Luigi Neraci që njihej shumë mirë me Dom Zef Ramaj. Konsulli në këtë raport përmend jo më pak se shtatë herë emrin e Dom Zefit për grumbullimin e informacioneve mbi masakrat ndaj shqiptarëve.*

Edhe vicekonsulli anglez, W. D. Peckham, njofton Londrën zyrtare për tmerret ndaj shqiptarëve. Ai shkruan se raporti është i bazuar në të dhënat që kishte ofruar famullitari i Shkupit, Dom Zef Ramaj.


Të dhënat që jep ky raport përkojnë plotësisht edhe me ato informata që kishte dhënë edhe konsulli Heimroth, ato përkojnë saktësisht edhe me kohën e publikimi të të dhënave në shtypin austriak (të cekur dhe më lart), datë 28 shkurt 1913 *Memorandumi* i famullitarit të Shkupit, që Peckham i kishte dërguar Londrës, titulluar „*Memorandum on Massacres of Albanians-Statements of Catholic Cure of Uskub*“

Dom Zef Ramaj, familja Bojaxhiu dhe pagëzimi i Nënë Terezës

Falë përkushtimit të Nënë Terezës për më të varfrit e botës, familja Bojaxhiu u bë e njohur në botë. Gonxhe Bojaxhiu lindi në Shkup më 26 gusht 1910, ndërsa një ditë më vonë (më 27 gusht) u pagëzua, të cilën e pagëzoi Dom Zef Ramaj.

Siç duket, familja Bojaxhiu ishte shpërngulur nga Prizreni në Shkup, para vitit 1903. Në një foto të bërë, me rastin e shugurimit të katedrales së *Zemrës së Krishtit* në Shkup, më 1903, e shohim edhe Kolë Bojaxhiun. Familja Bojaxhiu ishte një ndër familjet e vjetra të Prizrenit, siç dëshmojnë disa nga dokumentet e arkivit të famullisë së Prizrenit. Edhe në arkivin shtetëror në Luzern, ruhen dokumente të shumta për këtë familje. Vetë Lazër Bojaxhiu i kishte dërguar zviceranit Eugen Vogt të dhëna, ndër të tjera, për babin Kolë e nënën Dranë.

Dom Zef Ramaj jep disa të dhëna mbi familjen Bojaxhiu, të jetës së tyre në Shkup, siç njoftojnë burimet austriake. Në Arkivin Shtetëror të Austrisë ruhen dokumente mbi figurën e Kolë Bojaxhiut. Këtu po cekim njërin nga dokumentet që posedojmë: Më 26 korrik 1911 konsullata e Austro-Hungarisë në Shkup, konkretisht zëvendëskonsulli Lejhanec, ndër të tjera, qeverisë së tij i shkruan: “*Siç njoftojnë njëzëri famullitari i këtushëm, Dom Zef Ramaj, dhe jezuiti patër Genovizzi, disa katolikë të këtushëm – në krye me Luigj Naracin dhe Kolë Bojaxhiun, që janë të njohur si miq të italianëve – këto ditë iu kanë drejtuar me një kërkesë Konsullatës italiane, ku e lusin që të ndërtojnë një shkollë të veçantë italo-shqiptare. Si arsye ata theksojnë, se shkolla famullitare (pranë Kishës Katolike, vër. ime) për shkak të mungesës së kuadrit mësimdhënës funksionon në mënyrë të pamjaftueshme dhe nuk mund t’iu ofrojë nxënësve një shkollim të nevojshëm...*” Më tutje në këtë dokument thuhet se këta të dy (Luigji dhe Kola) do të tubojnë nënshkrime nga popullata vendore katolike. Duke u mbështetur në burimin në fjalë, përveç asaj se Kolë Bojaxhiu dëshironte ngritjen e një shkolle të veçantë, një shkollë që do të financohej nga qeveria (e atëhershme) italiane, e jo nga ajo austro-hungareze (si ajo pranë famullisë së Shkupit), vërtetohet se Kolë Bojaxhiu ishte katolik dhe njëkohësisht i angazhuar shumë për shkollimin e popullatës shqiptare në Shkup. Shkupi në atë kohë nuk ishte vetëm një qendër tregtare më e madhe se Prizreni, por ishte edhe një qendër e kulturës shqiptare.



BEGZAD BALIU

MARRËDHËNIET ARSIMORE DHE SHKENCORE JUGOSLLAVO-SHQIPTARE NË PRAG TË DEMONSTRATAVE TË VITIT 1981

Rezyme: *Në prag të demonstratave të vitit 1981, marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare ishin në kulmin e tyre, sado jo në ato përmasa që kishin qenë para prishjes së tyre prej dy dekadash në vitin e largët 1948. Pas vitit 1966, si dhe pas disa protokolleve të nënshkruara mbi këmbimin e përvojës dhe të kapaciteteve profesionale, për nevoja kryesisht të Universitetit të Prishtinës, në dhjetor të vitit 1979 dhe tetor 1980 u bënë dy vizita të dyanshme, në shkallë ministrash të arsimit shkencës dhe kulturës. Vizitat e tyre, dokumentet e nënshkruara, protokollet, dokumentet e pabotuara dhe dokumentet tepër sekret a ato rezervat, të dala nga këto aktivitete, ndërmjet viteve 1979-1980, do të jenë objekt i kësaj kumtese.*

Fjalët kyçe: *Kosova, Shqipëria, Jugosllavia, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Universiteti i Prishtinës, Tefta Camin, Ymer Jaka, arsimi, shkenca, kultura, demonstratat e vitit 1981.*

Hyrje

Në fund të viteve '70, marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare, shënonin majat e marrëdhënieve politike të tyre. Në të vërtetë, marrëdhënie të mira në shkallë të muajit të mjalit, kur Enver Hoxha dekorohet me urdhër të lartë jugosllav, ishin shënuar menjëherë pas Luftës së Dytës Botërore, por për ne, në këtë rast, këto marrëdhënie nuk paraqesin ndonjë veçori të caktuar për faktin se bëheshin duke i tejkaluar interesat e 'vogla' të Kosovës e madje edhe të ndonjë rëndësie më të veçantë të gjendjes së popullit shqiptar në ish-jugosllavi, e kjo do të thotë mbi disa parametra ideologjik të Bllokut socialist dhe mbi disa parametra të tjera vëllazërore mes dy vendeve fqinje.

Ishte bërë më shumë se një dekadë kur Shqipëria kishte dalë nga *Pakti i Varshavës*, ndërsa Kosova nga një kryqëzatë e përndjekjeve të përhershme dhe të drejtpërdrejta të Klanit Rankoviqist. Në ndërkohë Shqipëria kishte mbyllur edhe marrëdhëniet të pashembullta me Lindjen (Bashkimin Sovjetik dhe Kinën) dhe kërkonte miq në zonën Qendrore të Europës, ndërsa Kosova ishte avancuar me përmbajtje juridike dhe qëndronte mes brezit të politikanëve të moderuar dhe

Lëvizjes ilegale, si mes kullës e çekanit, duke bërë përpjekje që të bënte avancimin e saj politik, juridik dhe pragmatik njëkohësisht.

Në këtë rrjedhë shënohet edhe një avancim i veçantë i marrëdhënieve me Shqipërinë. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të Kosovës Ymer Jaka, me ftesë të ministres së Arsimit e të Kulturës të RPS të Shqipërisë, Tefta Camit, prej datës 25 deri më 30 dhjetor të vitit 1979 i bën një vizitë pune RPS të Shqipërisë, ndërsa nga data 6 deri më 10 tetor 1980, ministresha e Arsimit dhe Kulturës të RPS të Shqipërisë Tefta Cami, i bëri një vizitë kthimi Kosovës.

Sot nga prizmi i pamjes së largët të këtyre marrëdhënieve mund të shtrohet pyetja: vizitat e ndërsjella, ishin një vazhdimësi e marrëdhënieve të vjetra jugosllavo-shqiptare, një nismë e re e këtyre marrëdhënieve fqinjësore, apo një koncept pragmatik i qeverisë shqiptare ndaj Kosovës. Cilat ishin platformat e këtyre bisedimeve, në nivel të realizimit të tyre nga partnerët e Kosovës, cili ishte vlerësimi i politikës jugosllave dhe cila ishte prapaskena e këtyre marrëdhënieve, sipas dokumenteve të proveniencës kosovare dhe ish-jugosllave.

Kërkesat e gjëra dhe përmbajtja e rrudhur e dokumentit të Kosovës

Shikuar nga përmbajtja e dokumenteve për bisedime, atyre që janë diskutuar në institucionet e Kosovës dhe atyre që janë paraqitur gjatë bisedime në Tiranë, nuk është vështirë të shihet numri shumë i madh dhe shumpërbërës i kërkesave për bashkëpunim ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë dhe numri modest dhe përgjithësues i paraqitjeve të tyre në Tiranë, në dokumentin zyrtar. Dysia e dokumenteve jozyrtare dhe zyrtare të Qeverisë së Kosovës, do të mund të shihej edhe nga aspekti politik. Dokumenti jozyrtar i Përfaqësuesit të Kosovës kishte edhe disa përbërës politik dhe ideologjik që kishin të bënin me emrin e Titos, politiken e të painkuadruarve dhe madje vërejtjet në marginë për disa deklarata të Ministres Shqiptare mbi gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi, si dhe të sjelljes së ambasadorit shqiptarë në Beograd, ndërsa dokumenti zyrtar përbërësit e tillë i mënjanon në bisedime, por i rishfaqë në dokumentin tepër sekret të *Diskutimit* në Beograd.

Bashkëpunimi kulturor, arsimor dhe shkencor midis institucioneve të KSAK me ato të RPS të Shqipërisë po zhvillohet me kontinuitet që nga viti 1968, thuhet në fillim të këtij dokumenti¹. Ky bashkëpunim është pjesë integrale e marrëdhënieve të vendit tonë me RPS të Shqipërisë. Bashkëpunimit me vendet fqinje i kemi kushtuar gjithnjë vëmendje të posaçme, prandaj vendi ynë në këtë drejtim është angazhuar vazhdimisht. Krahina Socialiste Autonome e Kosovës bashkëpunimit në fushën e arsimit e të kulturës me RPS të Shqipërisë i ka dhënë dhe i jep rëndësi të posaçme për shumë arsye. Në suazat e marrëdhënieve të

¹ *Platforma e bisedimeve* të delegacionit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSK të Kosovës me Ministren e Arsimit e të Kulturës të RPS të Shqipërisë. Varianti i parë i tekstit të diskutuar. Botohet për herë të parë.

përgjithshme të KSAK me RPSSH, bashkëpunimi në fushën e kulturës, të shkencës, të arsimit dhe të kulturës fizike zë një vend të veçantë. Këto marrëdhënie kanë shënuar një tendencë të vazhdueshme zgjerimi, thellimi dhe diversifikimi. Gjatë dy viteve të fundit bashkëpunimi ka shënuar një intensifikim të dukshëm. Me iniciativat e të dyja palëve janë kërkuar vazhdimisht forma të reja bashkëpunimi, janë bërë përpjekje për përsosjen e trajtave të bashkëpunimit të vazhdueshëm në disa fusha veprimtarie dhe në nxitjen e iniciativave të reja në të mirë të të dyja palëve. (...) Format e ndryshme të bashkëpunimit janë zhvilluar nëpërmjet të kontakteve të institucioneve tona kulturore, arsimore, shkencore dhe të edukatës fizike e sportit në institucionet gjegjëse të RPS të Shqipërisë. Si rrjedhim i intensifikimit të marrëdhënieve midis një pjese të institucioneve respektive është ndjerë nevoja e lidhjes së marrëveshjeve dhe protokolleve të bashkëpunimit reciprok. Deri tani janë nënshkruar pesë marrëveshje të këtilla:

Marrëveshja ndërmjet Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit Shtetëror të Tiranës

Në fushën e arsimit e të kulturës, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar midis Universitetit të Tiranës dhe atij të Prishtinës, në bazë të protokolleve të nënshkruara për çdo vit shkollor, janë këmbyer një numër i caktuar profesorësh, asistentësh dhe bashkëpunëtorësh nga të dyja palët për mbajtjen e leksioneve, për kërkime shkencore dhe për mbajtjen e ligjëratave nga lëmenj të ndryshëm të specializimeve përkatëse.

Punonjësit e të dyja universiteteve kanë bërë edhe një varg ekspeditash në terren për studimin e gjuhës e të folklorit nga studiues madje jo vetëm të profesorëve të Universitetit të Prishtinës po edhe të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Instituti Albanologjik të Prishtinës, Institutit të Historisë së Kosovës etj. Një kontribut të konsiderueshëm për zhvillimin e Universitetit tonë e kanë dhënë punonjësit e Universitetit të Tiranës për ato fakultete tona, të cilat nuk i kanë pas kuadrot e duhura, sidomos në fushën e shkencave ekzakto, siç janë fakultetet e teknikës e të medicinës, si edhe për studimet pasuniversitare në Fakultetin Filozofik në degët e albanologjisë e të historisë. Kush nuk e kujton sot ligjëratat e profesorëve të shquar Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Aleks Buda etj, të cilat nuk i ndiqnin vetëm studentët e kurseve po edhe qytetarët e fushave të tjera të dijes: mjekë, inxhinierë, kulturologë dhe intelektualë të tjerë. Analistë dhe njohës të tjerë të historisë diplomatike hapjen e dyerve studiuesve dhe profesorëve nga Tiranë, e kanë shpjeguar këtë si një përpjekje të politikës jugosllave për të krijuar një imazh të saj brenda shoqërisë shqiptare, për gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi, por ndodhi e kundërta. E para, në Kosovë kurrë nuk ishin shuar dashuria dhe respekti për Shqipërinë dhe shqiptarët si një tërësi, pavarësisht gjendjes ideologjike dhe përkatësisë politike; dhe e dyta, Profesorët që vinin në Kosovë, më parë se sa të sillnin simbole ideologjike të proveniencës komuniste shqiptare, rininë shqiptare e ushqenin me simbole të karakterit historik dhe nacional shqiptar.

Marrëveshja ndërmjet Redaksisë së Botimeve të “Rilindjes” në Prishtinë me Ndërmarrjen e Librit e të Filmit të RPSSH, në Tiranë

Pas vitit 1968, kur filloi shkëmbimi i parë i botimeve mes Shqipërisë dhe Kosovës, në Prishtinë janë botuar vepra të autorëve bashkëkohës shqiptarë, të cilat madje nuk botoheshin as në Shqipëri. Në Kosovë botoheshin edhe vepra si “Nga jeta në jetë – Pse?!”², e cila nuk shënohej as në bibliografinë e Sterio Spasses, kompleti i veprave në dhjetë vëllime të Petro Markos, i cili në Tiranë ishte zyrtarisht gjysmë i ndaluar, botimi ekskluziv i veprave të Eqrem Çabejt, të cilat për nga vlera dhe cilësia i tejkalonte botimet ekskluzive të botimit, reklamimit dhe vlerësimit në shtypin e kohës edhe në krahasim me veprat e shefit të shtetit²; një situatë të cilën nuk e gjejmë në të njëjtën kohë në Shqipëri, botime kritike dhe projekte shkencore të institucioneve shkencore, arsimore dhe letrare (për Sterjo Spassen, Petro Markon, Eqrem Çabejn, Dritero Agollin, Fatos Arapin, Ismail Kadarenë etj), të cilët as përafërsisht nuk e gëzonin këtë përkushtim në institucionet arsimore, shkencore dhe kulturore të Tiranës, ndonëse shumë prej tyre konsideroheshin bartës të politikave kulturore, shkollave shkencore, apo edhe koncepteve ideologjike brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

Ndryshe ndodhte me botimet e shkrimtarëve, studiuesve, kritikëve dhe përfaqësuesve të krijimtarisë letrare të Kosovës në Shqipëri. Numri i vogël i vëllimeve të botuara, si dhe përfaqësuesit dhe tekstet e tyre në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë mendimin shkencor, historik, letrar dhe krijues e kulturor të horizontit më të lartë që arrihej në Prishtinë. Ndonëse në revistën e përmuajshme “Nëntori”, që në vitet ’60, ishte krijuar një kaptinë me vete me krijime të zgjedhura të shkrimtarëve kosovarë, botimi i autorëve të zgjedhur dhe vëllimeve me krijime e studime filloi të botohet në shkallë modeste vetëm në vitin 1970, kur u botuan dy antologjitë e para të poetëve dhe prozatorëve kosovar dhe romani “Malësorja” i Nazmi Rrahmanit, si dhe nga viti 1972 kur u botuan tri përmbledhjet e para me poezi me autorë Azem Shkreli, Din Mehmeti dhe Ali Podrimja, për të vazhduar çdo vit me nga një antologji dhe me vëllime të zgjedhura nga Rrahman Dedaj, Agim Vinca, Enver Gjerqeku, Fahredin Gunga, Rexhep Hoxha, Vehbi Kikaj, Qerim Ujkani, Edi Shukriu, Daut Demaku, Hivzi Sulejmani, Ramiz Kelmendi, Murat Isaku, Arif Demolli, Rifat Kukaj, Josip Rela dhe Ekrem Kryeziut.

Është për të theksuar se nëse poezia është zgjedhur me përkushtim më të madh, ndërsa proza në mënyrë të kufizuar, kritika, sigurisht për shkak të metodës që përjashtonte realizmin socialist, ishte përjashtuar plotësisht. Sikur dihet, letërsia në Kosovë, përgjithësisht, me kohë e kishte përjashtuar konceptin ideologjik të realizmit socialist, ndërsa shkolla e atjeshme, përkundrazi po përpiqej edhe më tej të avanconte shkollën teorike të saj, prandaj është e kuptueshme pse nuk botoheshin veprat më të mira të letërsisë që krijohej në Kosovë, por disa autorët

² Shih veç tjerash kronikën e gazetarit Mehmet Kraja nga Panairi i Beogradit, «**Prezentim i sasisë dhe i cilësisë**». *Rilindja*, Prishtinë, 27. 10. 1978, f. 11. *Mbititull*: NGBG «Rilindja» në Panairin Ndërkombëtar në Beograd. *Nëntitull*: Vepra e Titos, kompleti i veprave të Çabejt dhe kompleti i Migjenit ndër librat më reprezentativ të panairit.

dhe botimet modeste në fushë të prozës (Anton Pashku, Zejnullah Rrahmani, Jusuf Buxhovi, Mehmet Kraja, Teki Dervishi etj.) dhe sidomos kritikës (Rexhep Qosja, Ali Aliu, Agim Vinca, Sabri Hamit, Ibrahim Rugova, Sefedin Fetiu etj.).

Shembull i ndrojtjes politike ndaj mendimit ‘nacionalist’ dhe ‘modern’ të shqiptarëve në ish-Jugosllavi nuk është vetëm mosbotimi i veprave të Idriz Ajetit, Rexhep Qosjes, Ali Hadrit dhe brezit të tij e të pasardhësve të tyre që gjithashtu kishin bërë emër në këtë kohë, por është botimi i censuruar i veprës së etnologut Mark Krasniqi, *Gjurmë e gjurmime* (1978). Ndryshe nga botimi i Prishtinës, që me gjithë kritikën i kishte qëndruar mendimit të tij, vepra e tij në Tiranë censurohej, siç me thoshte një mik në Tiranë, “për të mos nxitur keqkuptimet me jugosllavët”. Po këtë përgjigje kam marrë nga kolegët në Tiranë, që në vitin 1992, në pyetjen: pas vitit 1981 dy vjet me radhë mungonin botimet e serisë *Shkrimtarë kosovarë*³. Në këtë rrjedhë më duket edhe sot absurde një fakt: si është e mundur që gjatë gjithë kësaj kohe nuk u botua as edhe një vepër e vetme e Adem Demaçit. Me jetën, me veprën dhe me konceptet politike atdhetare, e po të duhej ridimensionuar edhe ideologjike, Adem Demaçi qëndronte pranë Shqipërisë. I burgosur politik, ideologjikisht i përcaktuar me fytyrë nga Tirana, kombtarisht i vendosur për të luftuar deri në vdekje, intelektualisht i përgatitur dhe i vetëdijshëm plotësisht për sakrificën e tij, autor i një romani dhe i një korpusi tregimesh që gjithashtu bënin një vëllim serioz, në mos më serioz se shumë romane dhe vepra tregimesh të realizmit socialist, nuk botohej dhe nuk u botua në Tiranë deri në fund të rënies së sistemit komunist; Adem Demaçi, i burgosur politik dhe personalitet i njohur në qarqet jugosllave, biografinë dhe veprimtarinë e të cilit me kohë mund ta gjeje në tekstet e botuara nga shtypi ilegal i Kosovës dhe nga Lëvizja Ilegale përgjithësisht në Kosovë dhe diasporë; Adem Demaçi, jetëshkrimi i të cilit shquhej dhe

³ **Antologjitë:** *Për ty*, poezi nga Kosova, përmbledhi dhe redaktoi Pandeli Koçi, 1970, f. 124; *Rrëfimi i njeriut me samar*, tregime nga Kosova, 1970; *E di një fjalë prej guri*, poezi nga Kosova, redaktuar nga Pandeli Koçi, 1972, f. 264; *Toka e përgjakur*, shkrimtar nga Kosova, tregime, 1972; *Letrat dhe gjethet*, tregime nga shkrimtarë të Kosovës, 1976; *Heshtja e një kohe*, poezi nga Kosova, 1976; *Vendlindja ime*, vjersha të poetëve nga Kosova, 1980, f. 135.

Vëllimet me poezi: Ali Podrimja, *Thirrje*, 1972; Din Mehmeti, *Mallkimi i gjakut*, 1972; Azem Shkreli, *Poezi*, 1972; Rrahman Dedaj, *Nuk e kam thirrur shiun*, 1975, f. 94; Agim Vinca, *Në vend të biografsë*, 1977, 95 f; Enver Gjerqeku, *Gjurmëve të jetës*, 1972; Fahredin Gunga, *Flaka e fjalës*, 1976; Rexhep Hoxha, *Lulet le të dalin*, 1975; Vehbi Kikaj, *Gurra*, 1977, f. 57; Qerim Ujkani, *Gjaku im*, 1980; Edi Shukriu, *Poezi*, 1980.

Vëllimet me prozë: Nazmi Rrahmani, *Malsorja*, 1970, f. 256; *Toka e përgjakur*, 1975, f. 422; *Rruga e shtëpisë sime*, 1980, f. 356; Daut Demaku, *Plisat e kuq*, 1971, f. 104; Hivzi Sulejmani, *Njerëzit*, 1973, f. 328; *Fëmijët e lumit tim*, 1972, f. 213; Ramiz Kelmendi, *Heshtja e armëve*, 1973, f. 183; Murat Isaku, *Rreckajt, Plagët*; Arif Demolli, *Ballkonet e një qyteze*, 1980, f. 134; *Pëllumbat e kujtimeve*, 1984, f. 113; Rifat Kukaj, *Minaku i përhimët*, 1975, f. 108; *Shkrepi i diellit*, 1977, f. 108;

Drama: Josip Rela, *Nita*, 1973, f. 95; Ekrem Kryeziu, *Epoka para gjyqit*, dramatizim.

Studimet: Mark Krasniqi, *Gjurmë e gjurmime*, 1978.

respektohej madje nga e majta dhe nga e djathta e shqiptarëve në Europë dhe Amerikë, në Tiranë bëhej i paqenë; Adem Demaçi, që me veprën e tij kishte prekur dy nga plagët më të rënda historike - kombëtare: gjakmarrjen dhe shpërnguljen, në vend se të botohej, të botohej në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, në Tiranë heshte!

Ndonëse edhe më parë kishte një marrëveshje mes Rilindjes së Prishtinës dhe Ndërmarrjes së Librit dhe Filmit në Tiranë për importimin e një sasive librash mes Tiranës dhe Prishtinës, gjatë qëndrimit të delegacionit të Kosovës në Tiranë, pikërisht në këtë temë paraqiten fërkime të thella.

Gjatë qëndrimit tonë në Tiranë, thuhet në raportin tepër sekret të delegacionit të Kosovës për Qeverinë e Kosovës dhe Qeverinë Federale, u ngrit çështja e kthimit të librave që institucionet e ndryshme ua kishin dërguar pa porosi individëve dhe institucioneve të KSAK. Këtë çështje së pari e kishte ngritur Aleks Buda gjatë vizitës në Akademisë së Shkencave. Pastaj në formë më të ashpër, thuhet në Raport, e ngriti Anastas Kondo gjatë udhëtimit jashtë Tiranës, ndërsa në formë edhe më të ashpër e ngriti Tefta Cami, në darkën lamtumirëse, në bisedë me Dr. Ymer Jakën. Po në këtë darkë këtë çështje ia ka hapur Abdurrahim Pajazitit kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë Dritëro Agolli.

Lidhur me këtë çështje Dr. Ymer Jaka ishte përgjigjur se “për ne është e pakuptueshme praktika që t’u dërgohen libra të paporositura institucioneve dhe individëve. Mbasi pala shqiptare insistonte në qëndrimin se kjo praktikë është normale, Dr. Ymer Jaka shtoi se shkak i kthimit të librave mund të gjendet lehtë edhe në strukturën e tyre, mbasi për ne është e papranueshme të na dërgohen vepra me karakter propagandistik, madje edhe të tilla që e fyejnë rëndë sistemin tonë të vetëqeverisjes socialiste që e shtrembërojnë realitetin tonë dhe që përmbajnë fyerje brutale kundër kryetarit tonë të Republikës dhe të LKJ, shokut Tito. Tefta Cami ishte kategorike në pohimin se libra të tilla nuk janë dërguar, ndërsa Dr. Ymer Jaka u përgjigj se kemi prova të pamohueshme se midis librave të dërguara ka edhe të tilla për të cilat u bë fjalë më lartë”.

Jo për të mbrojtur ministrin e atëhershëm të arsimit të Kosovës dr. Ymer Jaka, po për të thënë një të vërtetë shkencore, dua të theksoj këtu se gjatë kësaj kohe, pikërisht përmes adresave individuale të kërkuesve në Kosovë dhe të dërguesve në Tiranë depërtonte jo vetëm shtypi e veprat kryesisht letrare po edhe veprat politike të drejtuesve politikë e institucioneve shtetërore të Tiranës. Duke iu referuar letërkëmbimit të pasur ndërmjet studiuesve nga Tirana dhe disa prej studiuesve dhe intelektualëve të Kosovës, që në një mënyrë apo një tjetër ishin përfshirë në Lëvizjen Ilegale të Kosovës, nuk është vështirë të kuptohet edhe roli i disa prej studiuesve të njohur në Tiranë që në pakon e veprave të tyre, revistave shkencore, romaneve, poezive, dramave, veprave historike dhe etnografike, vëllimeve me krijimtari popullore etj., shtinin edhe veprat e Enver Hoxhës, të Partisë së Punës, vëllimet e Kongreseve etj. Kërkues të tyre ishin veprimtarë të Lëvizjes Ilegale Kombëtare në Kosovë dhe shpërndarja e tyre, mund të thuhet se bëhej në shkallë gjysmilegealiteti; ndërsa dërgues të këtyre veprave, shtypit dhe

pamfleteve partiake e ideologjike, nuk ishin vetëm zyrtarët e shtypit e të propagandës në Tiranë po edhe personalitetet e shquara të mendimit shkencor: shkencëtarë, shkrimtarë, artistë, sportistë etj.

Marrëveshja ndërmjet Radio Televizionit të Prishtinës me Radiotelevizionin e Shqipërisë

Në dokumentet e Qeverisë së Kosovës në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet Radio Televizionit të Prishtinës dhe Radiotelevizionin e Shqipërisë, përfshiheshin edhe aspekte të bashkëpunimit të filmit dhe teatrove në të dy vendet. “Janë shfaqur pjesë teatrale të teatrove profesionale. Për realizimin e disa pjesëve teatrale në Teatrin Krahinor në Prishtinë kanë marrë pjesë regjisorët, scenografët dhe koreografët nga RPS e Shqipërisë. Një bashkëpunim i frytshëm është zhvilluar dhe midis Radiotelevizionit të Prishtinës dhe atij të Tiranës. Është bërë këmbimi i një vargu të tërë emisionesh, serish e filmash. Disa nga këto emisione, veçanërisht filat artistikë, RTV i Prishtinës i ka shfaqur për tërë rrjetin jugosllav”. Në të vërtetë në fushë të bashkëpunimit mes teatrove do të kujtohet gjatë realizimi i veprës së Ismail Kadaresë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” me regjisor nga Teatri Kombëtar i Tiranës dhe realizimi i dramës së Ekrem Kryeziut, *Epoka para gjyqit*, e cila qe pritur shumë mirë jo vetëm në Tiranë po edhe në Prishtinë. Gjatë këtyre viteve shikuesit në Kosovë kanë përcjellë me interesim të shtuar programet e Radio Tiranës “Heroizimi i popullit tonë në shekuj” dhe emisionin për “bashkatdhetarët”, si dhe programet televizive për Festalet e folklorit shqiptar, Teatrin në ekran (të premteve), ndërsa Televizioni i Prishtinës pothuajse kishte emisione të rregullta me muzikë nga TVSH (të mërkurën) dhe nga fonoteka e filmit shqiptar (të premten).

Le të theksojmë se emisionet televizive, kryesisht ato të filmit dhe të teatrit përcilleshin edhe me vlerësime profesionale nga shtypi i përditshëm i Prishtinës, ndërsa programet e zgjedhura dubloheshin edhe për shikuesit në gjuhën serbokroate.

Marrëveshja ndërmjet Akademisë së Shkencës e të Arteve të Kosovës me Akademinë e Shkencave të RPSSH

Se marrëdhëniet shkencore mes Kosovës dhe Shqipërisë kishin shënuar majat e bashkëpunimit dëshmon edhe numri i madh i projekteve të nënshkruara ndërmjet Akademisë së Shkencës e të Arteve të Kosovës me Akademinë e Shkencave të RPS të Shqipërisë.

Më 16. VI. 1979 në Prishtinë u nënshkrua *Protokoll* për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor midis Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë për vitin 1979 dhe 1980. Ky Protokoll përfshinte aktivitete të ndryshme në pesë fusha të dijes akademike dhe projekte të veçanta:

- e para kishte të bënte me shkëmbim përvoja dhe konsultime, e kjo nënkuptonte hulumtimin në terren për projektet *Atlasit dialektologjik i gjuhës shqipe*, dhe *Korpusit të veshjeve popullore*, të cilët hartoheshin nga Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, si përgatitjen profesionale të ekspertëve në fushë të mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve të kulturës, të arkeologjisë, të etnografisë dhe të antropologjisë;
- e dyta kishte të bënte me *Kërkime arkivale bibliografike*, e kjo do të thoshte me këmbimin e punonjësve për kërkime disa javësh në fushë të bibliografisë;
- e treta kishte të bënte me Ekspedita shkencore, e kjo do të thoshte me kërkimet në terren në fushë të gjuhës dhe të antropologjisë, në fushën e së drejtës zakonore dhe të gjuhës;
- e katërta me *Ligjëratat*, e kjo do të thoshte me dërgimin nga Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë të shtatë punonjësve shkencorë për të mbajtur referime shkencore për arritjet e fundit “në fushën e shkencave historike, te gjuhësisë, të letërsisë, të arkeologjisë, të studimeve ekonomike, të gjeografisë dhe të hidrometeorologjisë, si dhe për t’u njohur nga afër me arritjet e reja të shkencës dhe për të këmbyer mendime me punonjësit shkencorë në KSA të Kosovës”, dhe
- e pesta, me *Shkëmbim i literaturës shkencore*, sipas të cilës Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë marrin përsipër t’i dërgojnë njëra-tjetrës rregullisht revistat dhe botimet e tyre të tjera shkencore, kopje të mikrofilmuara ose të fotokopjuara të botimeve të rralla dhe të dorëshkrimeve me interes shkencor, të informojnë njëra tjetrën për botimet shkencore që kanë dalë dhe dalin në RSF të Jugosllavisë dhe në RPS të Shqipërisë, në fusha të ndryshme të shkencave albanologjike dhe ballkanologjike.

Fryt i këtij bashkëpunimi sigurisht do të realizohen dy projekte të mëdha: Konferenca për 500-vjetorin e Skënderbeut (19680 dhe konferenca për 100 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 91978).

Marrëveshja e bashkëpunimit midis Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë dhe Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës

Në dokumentin e Qeverisë së Kosovës për bashkëpunim me Shqipërinë, ndër të tjera thuhet: “Grupe shkrimtarësh kanë marrë pjesë në manifestime të ndryshme në RPS të Shqipërisë dhe në Kosovë. Janë botuar veprat e një numri të konsiderueshëm shkrimtarësh kosovarë në Shqipëri, ashtu si janë botuar te një numër i madh veprash të shkrimtarëve shqiptarë, duke përfshirë këtu edhe veprat komplete të një vargu autorësh. Janë këmbye mjaft grupe që kanë shfaqur programe kulturore-artistike, prej ansamblesh amatore deri te ato profesionale. Janë organizuar ekspozita të ndryshme të arteve figurative dhe aplikative. Grupe artistësh e shkrimtarësh kanë bërë qëndrime studiuese dhe kanë marrë pjesë në manifestime të ndryshme. Janë shfaqur pjesë teatrale të teatrove profesionale. Për realizimin e disa pjesëve teatrale në Teatrin Krahinor në Prishtinë kanë marrë pjesë

regjisorët, skenografët dhe koreografët nga RPS e Shqipërisë. Një bashkëpunim i frytshëm është zhvilluar dhe midis Radiotelevizionit të Prishtinës dhe atij të Tiranës. Është bërë këmbimi i një vargu të tërë emisionesh, serish e filmash. Disa nga këto emisione, veçanërisht filat artistikë, RTV i Prishtinës i ka shfaqur për tërë rrjetin jugosllav”.

Në të vërtetë lexuesit, artistët dhe shkrimtarët në Prishtinë, do të kujtojnë numrin e madh të shkrimtarëve të Shqipërisë që vizitonin Prishtinën, duke marrë pjesë pothuajse në të gjitha manifestimet laterale të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, por edhe një numër më të kufizuar të shkrimtarëve të Kosovës në Tiranë. Mbështetur në të dhënat e të përditshmes “Rilindja”, të përjavshmes “Zëri i rinisë” dhe sidomos të përdyjavshmes “Fjala” e të revistës letrare “Jeta e re”, gjatë këtyre viteve do të jetë ekspozita e artistëve të Shqipërisë në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Prishtinës dhe në fushë të botimeve: kompleti i veprave të plota të Ismail Kadaresë. Le të thuhet më në fund se shkrimtarët shqiptarë të kësaj kohe nga brezi sidomos studentor i viteve ’70 pritëshin si heronj të vërtetë.

Platforma e delegacionit të Kosovës

Në dokumentet e delegacionit të Kosovës të paraqitura në bisedë me delegacionin mikpritës të Tiranës janë paraparë një numër i madhe propozimesh përgjithësuese dhe konkrete. Ato fillojnë me temat për bashkëpunim ndëruniversitar, shkencor, arsimor, kulturor e fizik, për ekspeditat e përbashkëta kërkimore, për projektet e përbashkëta shkencore, për ligjëruesit mysafir ndëruniversitar, për tekstet shkollore, për planprogramet shkollore, për këmbimin e literaturës shkollore dhe universitare, për shfaqjen e filmave, për hapje e ekspozitave etj., për të përfunduar me një ftesë jo edhe të zakonshme në rrethana të tilla: Do të propozojmë që një grup arsimtarësh, pionierësh të arsimit nga RPSSH që kanë punuar në Kosovë, t’i ftojme ta vizitojnë Krahinën tonë, thuhet në Platformën e Delegacionit të Kosovës, për të përfunduar me një propozim që nuk del që në versionin e parë të *Platformës*, dhe mendoj se ky propozim vjen nga qarqet e larta shtetërore jugosllave. Fjala është për propozimin që, citoj: në qoftë se pala shqiptare është e interesuar, jemi të gatshëm të aktualizojmë çështjen e nënshkrimit të Konventës së bashkëpunimit kulturor midis RSF të Jugosllavisë dhe RPS të Shqipërisë. Fjala është për Konventën e bashkëpunimit kulturor midis RSF të Jugosllavisë dhe RPS të Shqipërisë, nënshkruar në vitin e largët 1947.

Cilat ishin propozimet dhe vlerësimet e udhëheqjes së Kosovës. Në raportin me siglën tepër rezervë, për Qeverinë e atëhershme krahinore thuhet:

1. Është vlerësuar pozitivisht bashkëpunimi i zhvilluar deri tani në fushën e kulturës, arsimit, shkencës dhe të kulturës fizike. Ky bashkëpunim paraqet një kontribut që forcon marrëdhëniet midis dy vendeve tona dhe thellon besimin midis popujve tanë.

2. Konsiderojmë se ekzistojnë mundësitë për zgjerimin, thellimin dhe pasurimin e këtij bashkëpunimi. Për këtë qëllim duhet të angazhohemi të ngritën

iniciativa të reja, duhet të përfshihen edhe ato fusha të kulturës, arsimit, shkencës dhe të kulturës fizike për të cilat konsiderohet se ekziston interesimi nga të dy palët.

3. T'i kushtohet kujdes i duhur programimit të bashkëpunimit. Kjo gjë mund të arrihet me zgjerimin e numrit të marrëveshjeve midis institucioneve dhe asociacioneve përkatëse. Ndërkaq, mbasi të gjitha fushat e bashkëpunimit nuk mund të përfshihen në marrëveshje programet e vizitave të grupeve kulturo-artistike, të ekipeve sportive dhe të grupeve të tjera të parashihen me kohë, të bëhen përgatitjet e duhura për realizimin e tyre dhe të merren të gjitha masat për arritjen e qëllimit të plotë të këtyre formave të bashkëpunimit.

4. Duke u mbështetur në praktikën e deritanishme, me qëllim të evitimit të papreciziteteve në obligimet që marrin përsipër subjektet që marrin pjesë në bashkëpunim, mendojmë se do të ishte mirë që ta zhvillojmë dhe përparojmë informimin reciprok. Realizimin e këtij synimi mund ta ndihmojë edhe konfirmimi me shkrim i obligimeve të marra nga subjektet përkatëse.

5. Na kemi interes për vazhdimin e bashkëpunimit, të thellimit dhe të pasurimit të tij.

6. Në fushën e arsimit e të shkencës, përpos ngritjes kualitative të nivelit të bashkëpunimit konsiderojmë se ai mund të zgjerohet në disa drejtime:

a) në realizimin konsekuent dhe zgjerimin e bashkëpunimit midis dy universiteteve. Ky zgjerim mund të zhvillohet me intensifikimin e pjesëmarrjes në komisionet për përgatitjen dhe mbrojtjen e punimeve të magistraturës dhe të disertacioneve të doktoratës.

b) në një pjesëmarrje më të gjerë në tubimet shkencore, kongrese, simpoziume e të tjera. Pjesëmarrja nuk duhet të kufizohet vetëm në tubimet reprezentative, ose në ato me karakter ndërkombëtar, por duhet të shtrihet edhe në ato me karakter pune, siç janë sesionet shkencore të Institutit Albanologjik dhe tubime të tjera të ngjashme.

c) në një bashkëpunim më intensiv të punonjësve shkencorë të njëjës palë me publikimet shkencore të palës tjetër.

d) në lidhjen e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit midis institucioneve dhe shoqatave të ndryshme siç janë, fjala vjen shoqatat e kompozitorëve, të artistëve figurativë e të tjera.

e) në përparimin e bashkëpunimit në lëmin e letërsisë, duke i kushtuar përfaqësimit të mbarë letërsisë shqiptare në historinë e letërsisë, antologjitë e ndryshme dhe në botime të tjera.

7. Punonjësve shkencorë të Kosovës, projektet e punës së të cilëve i financon Bashkësia Krahinore e Punës Shkencore t'u bëhet e mundshme që t'i shfrytëzojnë bursat e kësaj Bashkësie për kërkime në institucionet përkatëse të RPS të Shqipërisë.

8. Përpos ekspozitave kolektive të arteve figurative ose aplikative, të organizohen edhe ekspozita individuale. Nga ana tjetër, përpos koncerteve dhe programeve artistike të ansambleve ose grupeve, të organizohen edhe koncerte solistike.

9. Bashkëpunimi midis Radio-televizionit të Prishtinës dhe atij të Tiranës nuk duhet të reduktohet vetëm në këmbimin e emisioneve e të filmave. Ai mund të zgjerohet në bashkëpunimin e realizimit të projekteve të ndryshme, në këmbimin e regjisorëve dhe të bashkëpunëtorëve të tjerë.

10. Mendojmë se ka mundësi për vendosjen e bashkëpunimit midis “Kosova-filmit” dhe Kino-studios “Shqipëria e Re” në realizimin e projekteve të filmave dokumentarë dhe artistikë me tematikë me interes të përbashkët.

11. Konstatojmë se gjatë vitit 1979 kemi pritur një frekuencë më të madhe në bashkëpunimin në fushën e kulturës fizike e të sporteve. Për zhvillimin e bashkëpunimit në këto fusha pandehin se mund të ndihmojë nënshkrimi i marrëveshjes midis Lidhjes së Organizatave të Kulturës Fizike të Kosovës dhe Komitetit të Kulturës Fizike dhe të Sporteve të RPS të Shqipërisë.

12. Është i pranishëm interesimi për këmbimin e vizitave të arsimtarëve. Propozojmë që këto vizita të bëhen në formë të organizuar, duke i planifikuar me kohë dhe duke i informuar organet kompetente të arsimit.

13. Mendojmë se bashkëpunimi mund të zgjerohet edhe në disa fusha siç janë:

a) nevoja për këmbimin e përvojave në konceptimin e planeve e të programeve të gjuhës e të letërsisë shqiptare,

b) këmbimin e përvojave për konceptimin e teksteve shkollore,

c) këmbimin e 1 ose 2 gazetarëve për studimin e çështjeve të zhvillimit të arsimit, shkencës e kulturës.

14. Do të propozojmë që një grup arsimtarësh, pionierësh të arsimit nga RPSSH që kanë punuar në Kosovë, t’i ftojme ta vizitojnë Krahinën tonë.

15. Do t’i propozojmë palës shqiptare që bashkërisht t’ua ngrisim përmendoren dëshmorëve të rënë në kampin e përqendrimit fashist të Prishtinës. Njëherësh propozojmë që të xhirojmë një film ose në një mënyrë tjetër të shënojmë qëndrimin e pjesëmarrësve të Luftës Nacionalçlirimtare nga Jugosllavia në burgun e Tiranës.

16. Në qoftë se pala shqiptare është e interesuar, jemi të gatshëm të aktualizojmë çështjen e nënshkrimit të Konventës së bashkëpunimit kulturor midis RSF të Jugosllavisë dhe RPS të Shqipërisë⁴.

⁴ Një propozim, si version tjetër për pikën 17 është i shkruar me dorë me këtë përmbajtje: Delegacioni ynë duhet të analizojë çështjen e nënshkrimit të konventës duke pasur parasysh edhe interesin e RPSSH.

Pjesë më vete në marginë janë shënuar me gjasë edhe disa porosi që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e subjekteve të barabarta brenda shteteve, nivelin e vetëdijes politike të bartësve të bashkëpunimit, deklaratën e Tefta Camajt, e cila, siç duket, më parë kishte folur për “diskriminimin e shqiptarëve në pikëpamje gjuhësore, kulturore e arsimore”, rolin e ambasadorit shqiptar, nacionalizmin si proces të lirimit të vetë kombit, nacional e klasor, platformat e ndryshme antikomuniste e antishqiptare etj.

Interesimi nationalist i qeverisë shqiptare për bashkëpunim me Jugosllavinë

Paragrafët hyrës të raportit nga Tirana, të shoqëruara me rezultate dhe suksese të ministrit Ymer Jaka, nuk nënkuptojnë edhe mungesën e fërkimeve gjatë këtyre bisedimeve. Pas respektimit të dyanshëm të dokumenteve ndërshtetërore, të cilat shquhen zakonisht në komunikimin diplomatik, raporti sekret dhe mjaft i hollësishëm i delegacionit të Kosovës për nevoja të brendshme dëshmon për fërkimet e dyanshme pikërisht për ato tema, të cilat në parim brenda dokumenteve të proveniencës jugosllave duken formale, ndërsa këtu dalin mjaft të rezervuara.

Qëllimi i vizitës, thuhet në raportin tepër sekret të delegacionit të Kosovës, - ka qenë trajtimi i bashkëpunimit në sferën e kulturës, të arsimit, të shkencës dhe të kulturës fizike midis KSA të Kosovës dhe RPS të Shqipërisë dhe përparimi, thellimi e pasurimi i këtij bashkëpunimi, në suaza të zhvillimit dhe të përparimit të marrëdhënieve të gjithëmbarshme midis RSF të Jugosllavisë me RPS të Shqipërisë.

Porse, thuhet më tej, Tefta Cami, ministre e Arsimit Shkencës dhe Kulturës, nënvizoi interesimin për bashkëpunimin në fushën e kulturës, të arsimit e të shkencës të RPS të Shqipërisë me RSF të Jugosllavisë, posaçërisht me KSAK dhe viset e tjera të vendit tonë, të banuara nga kombësia shqiptare. Duke e shfrytëzuar praninë e ambasadorit Komatina në këto biseda, ajo shprehu dëshirën për një bashkëpunim më intensiv me vendet e banuara nga shqiptarët në republikat tona socialiste të Maqedonisë dhe të Malit të Zi.

Duke dashur të shquaj rëndësinë e bashkëpunimit gjithëpërfshirës me të gjitha republikat dhe krahinat e ish-Jugosllavisë, ministri Jaka theksoi interesimin e të gjitha republikave dhe të krahinave socialiste të vendit tonë dhe si ilustrim të këtij interesimi përmendëm suksesin që ka shënuar ekspozita e arteve figurative e RPSSH në Prishtinë, Beograd, e Shkup më 1979 dhe përkthimin e romaneve të I. Kadaresë në gjuhën serbokroate, maqedonase e sllovene. Kjo është arsyeja pse delegacioni i Kosovës vjen në përfundim se pala shqiptare shpreh interesim të posaçëm për bashkëpunim me ato bashkësi tona politiko-shoqërore ku jeton kombësia shqiptare. Për këtë arsye përshtypja jonë është se nga pala shqiptare nuk duhet pritur shumë iniciativa për zgjerimin e bashkëpunimit me ato bashkësi tona politiko-shoqërore ku nuk jeton kombësia shqiptare, thuhet në fund të raportit.

Platforma e bashkëpunimit jugosllavo-shqiptar brenda paradigmave kombëtare

Pas vizitës së dyanshme të ministrave të Kosovës dhe të Shqipërisë u organizuan disa takime strukturash diplomatike, politike, të sigurisë e të tjera. Mbledhjet e tilla në të vërtetë ishin mbajtur menjëherë pas vizitës së Titos në Kosovë, i cili i kishte dhënë dritë të gjelbër bashkëpunimit, përkatësisht avancimit të marrëdhënieve jugosllavo-shqiptare, e kjo do të thotë marrëdhënieve mes Kosovës dhe Shqipërisë në veçanti. Sigurisht kjo është arsyeja pse ende pa e vizituar ministri kosovar Tiranën dhe ministri shqiptar Prishtinë, në Shkup, më 13 mars 1979 qe mbajtur takimi i kryetarit të Kryesisë së RS të Serbisë, RS të Maqedonisë, të RS të Malit të Zi dhe KSA të Kosovës me përfaqësuesit e Sekretariatit federativ për punë të jashtme.

Po në këtë rrjedhë, më 9 qershor 1980, në Prishtinë qe organizuar edhe një mbledhje konsultative mbi marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me RPS të Shqipërisë në sferën e arsimit, shkencës, kulturës dhe sportit⁵ ndërmjet përfaqësuesve të punëve të jashtme në nivel të federatës dhe republikave e krahinave, në të cilin mungonin pa përjashtim përfaqësuesit e delegacioneve të Kroacisë dhe Sllovenisë.

Qëllimi kryesor i mbledhjes të mbajtur më 9 qershor 1980, në Prishtinë, ishte që nga këndi i marrëdhënieve të drejtpërdrejta fqinjësore të vlerësohen marrëdhëniet tona me RPS të Shqipërisë në sferën e arsimit, shkencës, kulturës dhe sportit, si dhe të sigurohet një shkallë më e lartë e marrëveshjes dhe koordinimit të organeve republikane, përkatësisht krahinore, dhe organizatave të punës së bashkuar në këtë fushë në qasjen ndaj RPS të Shqipërisë.

Në diskutim u konstatua së për dallim nga marrëdhëniet ekonomike, bashkëpunimi me RPS të Shqipërisë në sferën e arsimit, shkencës, kulturës dhe sportit zhvillohet i organizuar, edhe pse me përmasa dhe karakteristika të ndryshme, kryesisht me RS të Malit të Zi, me RS të Maqedonisë dhe me KSA të Kosovës, ku me shumicë jeton kombësia shqiptare në vendin tonë, (...) Është, pra e natyrshme, që bashkëpunimi në sferën e arsimit, shkencës, kulturës dhe sportit, me RS të Malit të Zi, të Maqedonisë dhe me KSA të Kosovës janë më të zhvilluara. Sepse kombësia shqiptare në RSF të Jugosllavisë është subjekt aktiv i bashkësisë shumë nacionale jugosllave, në të cilën i realizon dhe afirmon interesat e veta, kulturën autoktone dhe vlerat artistike.

Në mbledhje tërhiqej vërejtje se në këto marrëdhënie duhet përjashtuar “çdo formë e bashkëpunimit po qe se ka elemente të nacionalizmit, paternalizmit, irredentizmit etj., nga ana shqiptare është e huaj dhe e papranueshme për bashkëpunimin e mëtutjeshëm dhe rrezikon seriozisht çdo formë bashkëpunimi ndërmjet RSF të Jugosllavisë dhe RPS të Shqipërisë.

Po në këtë takim ritheksohet propozimi i palës jugosllave, për palën shqiptare, për rikthimin, përkatësisht ridimensionimin e Konventës për

⁵Botohet për herë të parë. Përktheu nga serbokroatishtja Merxhan Avdyli.

bashkëpunimin kulturor ndërmjet RSF të Jugosllavisë dhe RPS të Shqipërisë, e cila ishte nënshkruar në vitin e largët 1947.

Ky takim gjithashtu nxjerr në pah disa zhvillime të dekadës së fundit ndërmjet dy vendeve, si dhe mungesën e tolerancës serbe në këto zhvillime, ku mes tjerash theksohej edhe “sjellja e palejueshme e personelit të ambasadës shqiptare në Beograd, e cila, sipas tyre anashkalon organet federative, republikane dhe krahinore dhe kontakton drejtpërdrejt institucionet të cilat janë bartëse të formave të veçanta të bashkëpunimit”.

Rezyme

Duke u mbështetur në shtypin ditor të kohës, dokumentet e publikuara (kryesisht *Marrëveshjet*), dokumentet jozyrtare të Institucioneve politike të Kosovës, dokumentet rezervë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të ish-Jugosllavisë dhe dokumenteve tepër sekret të Diplomacisë jugosllave, nuk është vështirë të shihet se këto vizita tejkalonin aktivitetet e dy ministrave të kohës në shkallë të Shqipërisë dhe Kosovës. Dokumentet, sidomos ato tepër sekretë dëshmojnë gjithë përpjekjet e diplomacisë jugosllave që t’i hapë rrugë bashkëpunimit të Shqipërisë me Kosovën, duke orientuar synimet e saj për përtëritjen e këtij bashkëpunimi në rrjedhën e atyre viteve të mjaltit, pas Luftës së Dytë Botërore, duke përfshirë këtu edhe Konventën e vitit 1947.

Po këto dokumente flasin qartë edhe për synimet e diplomacisë shqiptare që të hapë bashkëpunimin me Kosovën dhe madje, sikur thuhet me gjithë hapësirën e banuar me shqiptarë në ish-Jugosllavi, por jo më shumë, një shembull ekzemplarë i tejkalimit të politikave shqiptare të kohës në marrëdhëniet e saj me ish-Jugosllavinë, nga koncepti i partnerit ideologjik, në konceptin e marrëdhënieve fqinjësore pragmatike. Apo, sikur thuhet në njërin prej dokumenteve jugosllave të kohës: Shqipëria, në aspektin arsimor, shkencor, kulturor dhe sportiv, është më e gatshme të bashkëpunoj me një fshat të banuar me shqiptarë kudo në Jugosllavi, se sa me një republikë a krahinë jugosllave ku nuk ka popullsi shqiptare.

ETHEM ÇEKU

KOSOVA NË ZHVILLIMET POLITIKE NË JUGOSLLAVI NË VITET '70

Abstrakt

Kosova në zhvillimet politike në Jugosllavi në vitet '70 të shekullit të kaluar është në qendër të trajtimit në këtë punim. Vitet '70 në politikën jugosllave, ndonëse në dukje të parë ishin paksa më shtensionuese në aspektin politik, meqë ishte koha kur ishte miratuar akti i ri më i lartë shtetëror i njohur si Kushtetuta e vitit 1974, megjithatë kundërthëniet nuk ishin zbutur, madje ato në brendi ato vlonin gjithnjë e më tepër, sepse orekset hegjemoniste serbe vinin duke u rritur gjithnjë e më tepër, natyrisht më së shumti në dëm të Kosovës dhe shqiptarëve.

Vitet '70 paraqesin vitet e lëvizjeve të mëdha politike nacionale që përfshinin tërë Jugosllavinë. Pjesët e udhëheqjes jugosllave, që vinin nga republikat, pothuajse ishin barrikaduar në mbrojtje të interesave të republikave të tyre, kurse federata kishte mbetur një strukturë të cilën e përdornin për realizmin e interesave të tyre politike.

Në këtë dritë udhëheqja kosovare nuk kishte mbështetje, por ajo as nuk ishte e përkushtuar për të këmbëngulur në mbrojtjen e interesave të Kosovës. Kosova edhe më tutje kishte mbetur pjesa më e pazhvilluar në kuadër të federatës.

Megjithatë, duke i shfrytëzuar rrethanat e krijuara udhëheqja politike kosovare kishte arritur të shfrytëzonte kontradiktat e brendshme në federatën jugosllave, për të bërë disa ndryshime pozitive në drejtim të zhvillimit ekonomik, kulturor, arsimor të Kosovës.

Kështu në vitet '70 arriti të shfrytëzojë situatën për të krijuar marrëdhënie të mira, sidomos në aspektin kulturor dhe arsimor me Shqipërinë. Është ky një segment që do të trajtohet në këtë punim, i cili do të fokusohet edhe në krijimin e raporteve dhe bashkëpunimit të Prishtinës me Tiranën, në art, kulturë, shkencë etj. Në këtë frymë në Kosovë zhvillohej klasa e re politike, e cila ishte e gatshme të përballej me sfidat e reja për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

Në aspekt tjetër që do të trajtohet në këtë punim është edhe kriza e përgjithshme që kishte kapluar Jugosllavinë në vitet '70, e cila ishte futur në një situatë të kaosit të plotë ekonomik, politik dhe të raporteve mes republikave dhe krahinave. Stabiliteti i shtetit lidhej me udhëheqjen personale të Titos dhe çështja

kryesore që shtrohej ishte se çka do të bëhet pas vdekjes së tij, sepse Tito ishte alfa dhe omega në krijimin dhe zbatimin e politikës jugosllave.

Fjalët çelës

Kosova, Jugosllavia, federata, vitet '70, çështja e Kosovës, Tito, Rankoviçi, kundërthëniet, raportet, kushtetuta, hegjemonizmi, nacionalizmi, universiteti, politika, shqiptarët, serbët, jugosllavët, Kroacia, Sllovenia, arsimi, ekonomia, kultura, pozita, lufta, kërkesat, interesat, republika, krahina, situata, udhëheqja etj.

1. Raportet dhe kundërthëniet brenda federatës jugosllave

Kushtetuta e vitit 1974, nuk arriti t'i zbusë kundërthëniet mes sferave të interesit të republikave dhe popujve që përbënin federatën jugosllave. Kjo kushtetutë, e cila më tepër kishte elemente të një konfederate sesa federate, solli ndryshime të mëdha në strukturën organizative të shtetit jugosllav, por thelloi ndasitë, sidomos mes kroatëve dhe serbëve, ndasi të cilat ishin të trashëguara që nga Lufta e Dytë Botërore.¹ Këto ndasi, në rrethanat e ndryshme kishin tentuar të mbuloheshin herë pas here në emër të luftës së përbashkët kundër fashizmit,² ndërsa më vonë në emër vëllazërim-bashkimit, pastaj ishin ngulfatur me mjete administrative të pushtetit, siç është e njohur periudha centraliste-etatiste.³

Por, këto kundërthënie morën dimensione të mëdha në fund të viteve '60 dhe në fillim të viteve '70 dhe këto kundërthënie erdhën në pah në mars të vitit 1967, pas më se 20 vjetësh, kur shpërtheu konflikti i parë serioz ndërmjet serbëve dhe kroatëve.⁴ Këto vite paraqesin vitet e krizave në marrëdhëniet e republikave, posaçërisht mes Kroacisë dhe Serbisë. Tani secila republikë luftonte për të fuqizuar pozitën e vet dhe pozitën e kombit vet, brenda federatës jugosllave.⁵

Serbët kishin arritur të dominonin në federatën jugosllave për një kohë të gjatë pas Luftës së Dytë Botërore. Ata dominonin në strukturat e udhëheqjes qendrore, në ushtri dhe në polici, sepse këto poste të rëndësishme shtetërore i mbanin serbët. Në periudhën e sundimit të Aleksandër Rankoviçit kjo tendencë e dominimit ishte shfaqur shumë hapur dhe tejmasë. Kroatët dhe sllovenët nuk ishin të gatshëm t'i pranonin këto situata të krijuara në federatën jugosllave, përkatësisht këtë supremacion të serbëve ndaj tyre. Ndasi të ishin shfaqur në të gjitha lëmitë e jetës politike, ekonomike dhe kulturore. Intelektualët e shquar kroatë botuan deklaratën për emrin dhe pozitën e gjuhës kroate, që hidhte poshtë marrëveshjen e

¹ Dušan Bilandžić, *Historija Socijalističke Federativne Republike Jugoslavije*, Glavni procesi 1918-1985, Školska Knjiga, Zagreb, 1985.

² Vladimir Dedijer, *Novi prilozi za biografiju Josip Broz Tita*, 1, 2, 3, RAD, Beograd, 1984, f. 525-542.

³ Dušan Bilandžić, vep. e cit.

⁴ Dejan Jović, *Jugoslavija država koja odumrla*, (Prometej, Zagreb, 2008), f. 205.

⁵ Po aty.

Novi Sadit të vitit 1954, me të cilën qe rregulluar çështja e gjuhës letrare serbo-kroate ose kroato-serbe.⁶ Një ndikim të madh në këtë konflikt e pati shkrimtari i shquar kroat Miroslav Kërlezha, duke e mbrojtur gjuhën kroate. Në këto kundërshtime të krijuara, që kishin marrë dimensione të gjera në shoqërinë jugosllave, ishte dashur të ndërhynte edhe vetë Titoja, i cili e kishte ftuar Kërlezhën, në vilën e tij për të biseduar që të hiqte dorë nga përkrahja që i jepte ajo lëvizjes kroate. Është për t'u theksuar se ky intelektual kroat nuk pranoi ta tërhiqte mbështetjen dhe dha dorëheqje nga të gjitha funksionet partiake.⁷

Duke i parë këto kundërtënie që u shfaqën disa vjet pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, shohim se teoria e vëllazërim-bashkimit, e lansuar me pompozitet nga strukturat partiake dhe shtetërore të Beogradit nuk kishte arritur as në popujt që e përbënin bazën shtetformuese të federatës jugosllave të pranoheshin.

Duke e analizuar situatën në Serbi, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë, në Mal të Zi, nga perspektiva e dokumenteve të sjella nga biografi i Titos, Vladimir Dedijer, nga komunikimet e bëra mes shtabeve të kundërshtarëve politikë dhe ushtarakë, nga numri i popullsisë së vrarë nga ushtritë e këtyre vendeve gjatë Luftës së Dytë Botërore, rezulton se Jugosllavia e asaj kohe ishte e mbërthyer nga një luftë e ashpër kryesisht mbi baza nacionale.⁸

Këto kontradikta të thella që morën përmasa tragjike gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, pas vitit 1945, dukej se ishin tejkaluar, por tejkalimi ishte vetëm dhe i përkohshëm, sepse kontradiktat rishfaqeshin, varësisht nga amplitudat e zhvillimeve politike, jo vetëm brenda federatës jugosllave, por edhe në Ballkan dhe në Evropë. Lidhur me këtë historiani kroat Dushan Billanxhiq, thekson: "Menjëherë pas luftës opozita borgjeze, sidomos në Serbi, hapur është ngritur kundër ekzistimit të Malit të Zi federal dhe hapur e ka mohuar ekzistimin e kombit maqedonas, ndërsa luftonte, sikurse edhe borgjezia kroate, për hegjemoninë mbi Bosnjë e Hercegovinë."⁹ Sa i përket çështjes së Kosovës të gjitha rrymat politike në Serbi mbetën tradicionaliste. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitet '60, kursi politik i Serbisë nuk kishte ndryshuar. Ai ndryshoi pjesërisht vetëm në raport me republikat e tjera. Duke folur rreth këtyre ndryshimeve Bilanxhiqi theksonte: "Me thyerjen e koncepcioneve të tilla, më tepër për shkak të trashëgimit të vetëdijes së vjetër sesa në raportet reale të forcave më 1945, ishte e mundur me bashkimin e forcave të të gjithë popujve të Jugosllavisë, që është e natyrshme, forconte fuqinë e qendrës së federatës dhe shpinte në ngufatjen e të gjitha nacionalizmave, qoftë edhe me masa administrative."¹⁰

Titoja, në këtë fazë, me mjeshtri e përdori ministrin e Punëve të Brendshme, Aleksandër Rankoviqin dhe strukturën e tij policore për të shuar çdo lëvizje, që mund të bënte ndonjë rezistencë ndaj politikës së Titos. Më 1957 shpërthyen grevat e para në Jugosllavi, në minierën e Tërbovles, në Slloveni. Titoja dha urdhër për ta

⁶ Misha Glenny, *Historia e Ballkanit, 1804-1999*, Toena, Tiranë, 2007, f. 585.

⁷ Po aty.

⁸ Vladimir Dedijer, *Novi prilozi za biografiju Josip Broz Tita*, II tom, f. 527-568.

⁹ Dušan Bilandžić, vep. e cit., f. 261.

¹⁰ Po aty.

shtypur këtë revoltë të minatorëve.¹¹ Po ashtu kjo formë e veprimit përmes Aleksandër Rankoviqit kishte marrë dimensione të fuqishme në Kosovë në këto vite, duke montuar se shqiptarët po përgatitnin një kryengritje dhe kërkoi të bëheshin bastisje për mbledhjen e armëve.¹² Regjimi i terrorit shtetëror i Rankoviqit në Kosovë në periudhën e pasluftës u karakterizua me ndryshime dramatike në jetën politike të Kosovës, në përkeqësimin e mëtejshëm të pozitës së shqiptarëve nën Jugosllavi. Marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, kanë një histori më të gjatë dhune se çfarëdo marrëdhënie tjetër në ish-Jugosllavi. Serbët, kroatët dhe boshnjakët shkonin deri diku mirë në periudhën titiste, kurse në Kosovë dhuna kurrë nuk ka qenë larg shpërthimit.¹³ Kështu shprehej autori i librit “Historia e Ballkanit”, Misha Gleni, rreth marrëdhënieve ndërnacionale në periudhën e etatizmit shtetëror.

Jugosllavia socialiste në fazën e parë hartoi dhe shpalli dy kushtetuta – më 1946 dhe më 1963, si dhe Ligjin kushtetues më 1958, të ndërtuara mbi bazën etatiste, të cilat sipas Kardelit meqë ishin kopje e modelit sovjetik ishin krijuar rrethanat që të ndryshohen dispozitat kushtetuese, për t’u funksionalizuar një shoqëri më demokratike dhe një sistem shumë më demokratik.¹⁴

Në vitet ’60 ekonomia jugosllave u gjend në një situatë tepër të vështirë, grevat dhe inflacioni ngjallën panik tek elita politike jugosllave. Vladimir Bakariqi këmbëngulte për një rishikim rrënjësor të ekonomisë dhe për zbatimin tërësor të vetadministrimit, me decentralizim të plotë. Kroatët dhe sllovenët, posaçërisht ata nga vija politike liberale, kërkonin të administrojnë më shumë të hyrat e tyre buxhetore, ndërsa Beogradi kërkonte t’i mbante këto të hyra në favorin e politikave të veta investuese, prandaj debatet morën karakterin e një kundërshtie të madhe.¹⁵ Konflikti ishte shtrirë, sidomos mes Titos dhe Rankoviqit dhe ky konflikt kishte marrë dimensione të kundërshtive në baza nacionale. Me eliminimin e klanit hegjemonist serb në krye me Aleksandër Rankoviqin ishte menduar se po hyhej në një fazë të ndërtimit të raporteve të reja mes popujve që e përbënin federatën. Duke folur për Plenumin e III dhe të IV të Komitetit Qendror të LKJ-së, më 1966, Svetozar Vukmanović Tempo thoshte se “kur kemi parë afrimin me Titos dhe Rankoviqit në Plenumin e III me jemi gëzuar, kemi menduar se më në fund janë tejkaluar mosmarrëveshjet mes tyre.”¹⁶ Ndërkaq, duke folur për luftën e madhe të brendshme politike, që ndodhte në Lidhjen Komuniste të Serbisë dhe ndikimet që kishte bërë rënia e Rankoviqit, Tempoja jepte këtë pasqyrë: “Todoroviqi, i cili njëherë ishte shprehur për Rankoviqin se ai e kishte bërë partinë komuniste në Serbi të pastër si loti, pas rënies së tij ishte deklaruar se partisë i nevojiten

¹¹ Misha Glenny, vep. e cit., f. 579.

¹² Arkivi i Kosovës, Informacija Okružnog Javnog Tužilaštva u Prizrenu o krivičnom progonu radnika unutrašnjih postova u vezi sa deformacijama, Prizren. (Prokurori Publik Rezak Shala); Misha Glenny, vep. e cit. f. 579.

¹³ Misha Glenny, vep. e cit., f. 580.

¹⁴ Edvard Kardel, *Sistemi politik i vetëqeverisjes socialiste*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 215.

¹⁵ Misha Glenny, vep. e cit., f. 581.

¹⁶ Svetozar Vukmanović - Tempo, *Memoari I, II 1966-1969 - Neslaganja*, Narodna Knjiga Beograd - Naprijed, Zagreb, 1985. 20.

reforma.”¹⁷ Nga kjo shihet se lufta mes Titos dhe Rankoviçit kishte marrë dimensione të gjëra, jo vetëm në një fushë, por Rankoviç kishte shprehur hapur tendencën e tij, për ta kontrolluar dhe për ta marrë rolin e udhëheqësit jugosllav në atë kohë, duke rënë hapur në konflikt me Titon, të cilin e humbi në Plenumin e IV të Brioneve, më 1 korrik 1966.¹⁸

Qysh me kushtetutën e vitit 1963 në qarqet politike të Jugosllavisë ishte hapur diskutimi se kush mund ta zëvendësonte Titon. Në fakt Aleksandër Rankoviç, ishte ngjitur shumë lartë në hierarkinë politike dhe shtetërore jugosllave dhe pothuajse kishte ndërtuar logjikën se ai do ta trashëgonte Titon. Por, Plenumi Brioneve më 1966, e pamundësoi që ai të jetë zëvendësues i tij, prandaj vitet '70 dhe diskutimet për ndërrimet kushtetuese rihapën çështje e zëvendësimit të Titos. Historiani kroat Dushan Bilanxhiq, duke folur për këtë periudhë, shprehte opinionin: “Çështja e trashëgimitarit të Titos, pra, në baza juridiko-kushtetuese dhe praktiko-politike nuk ishte zgjidhur, por për shkak të viteve të shtyra të kryetarit Tito, për çdo ditë bëhej gjithnjë e më aktuale.”¹⁹ Prandaj, duke u gjendur para një situatë të tillë, sipas Bilanxhiqit, “Josip Broz Tito në Kongresin e IX të LKJ-së, në mars të vitit 1969, futi një tip të udhëheqjes kolektive... me 14 anëtarë, sipas parimit të paritetit - nga dy anëtarë, nga secila republikë dhe nga një nga krahinat.”²⁰

Duke vendosur një udhëheqje të tillë kolektive problemet vetëm sa dolën më shumë në sipërfaqe, posaçërisht tani, mes republikave dhe federatës. Ja siç e shpjegon këtë Dushan Bilanxhiq: “Problemi i pozitës, rolit dhe strukturës së udhëheqjes së lartë partiake ishte më i komplikuar sesa problemi i udhëheqjes së lartë shtetërore, fillimisht për shkak të dallimeve në legjitimitetin e atyre trupave. Përbërja e kryesisë u legjitimua me parimet e sovranitetit të anëtarëve të federatës, të bazuara në zgjidhjen jugosllave të çështjes nacionale. ... Kjo hapi problemin e marrëdhënieve ndërmjet “federatës së shfederalizuar” në të cilin vendimet kryesore bihen me konsensus, çka do të thotë se aty nuk ka organizata të mëvetësishme republikane sikurse edhe në strukturën federative të shtetit.”²¹

2. Kosova, lëvizjet nacionale dhe konfliktet brenda federatës jugosllave në vitet '70

Situata e krijuar gjatë këtyre viteve dhe papajtueshmëria e shfaqur gjatë këtyre viteve mes republikave dhe lëvizjet e mëdha politike që ndodhën në të gjitha republikat e federatës jugosllave bënë që kreu i shtetit jugosllav Titoja ta marrë situatën nën kontroll dhe të fillojë një luftë të ashpër kundër rrymave nacionale të paraqitura, posaçërisht në Kroaci, në Slloveni, në Serbi. Pas ngjarjeve në Kroaci

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Historia e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, f. 500.

¹⁹ Dušan Bilandžić, vep. e cit., f. 468.

²⁰ Po aty, f. 469.

²¹ Po aty, f. 470.

tani Titos iu kishte krijuar hapësira e eliminimit të të gjitha atyre forcave, të cilat paraqiteshin si pengesë në zbatimin e politikë së tij.²²

Tito, duke hapur mbledhjen e 21 të kryesisë së LKJ-së, të mbajtur më 1 dhe 2 dhjetor 1971, kërkoi të diskutohet situata politike në Kroaci, e cila po përhapej në tërë Jugosllavinë dhe se në të gjitha republikat, diku më shumë e diku më pak kishte probleme të njëjta. Titoja e vlerësoi që në Kroaci ishte formuar lëvizja nacionaliste prapa së cilës qëndrojnë grupet kundërrevolucionare, ku po ashtu greva e studentëve të Zagrebit është pjesë e këtij grupi, të cilën udhëheqja komuniste e Kroacisë nuk e kishte luftuar.²³ Po në këtë takim kryetari i Komiteti Qendror të Bosnjë e Hercegovinës, Branko Mikuliq, në mënyrë shumë të ashpër e kishte kritikuar nacionalizmin në Kroaci. Po ashtu kryetari nga Maqedonia, Angel Çemerski theksoi se “ne të gjitha republikat ka paraqitje të nacionalizmit dhe shovinizmit”²⁴, kurse kryetari i Serbisë Marko Nikeziqi ka theksuar se “nacionalizmi dhe mosmarrëveshjet e kanë lëkundur Jugosllavinë dhe LKJ-në.”²⁵ Ndërkaq, Edvard Kardeli e ka mbështetur vendimin e guximshëm të Titos, i cili kishte thënë se “nacionalizmi është duke rrezikuar revolucionin”²⁶, ndërsa Fadil Hoxha ka tërhequr vërejtjen e “lidhjeve të ngjarjeve në mënyrë zinxhirore si demonstratat e Beogradit të vitit 1968, demonstratat e Prishtinës dhe Tetovës, afëra e rrugëve në Slloveni, greva e studentëve në Zagreb, të gjitha këto kërkojnë që të gjithë të luftojmë nacionalizmin në mjedisin e vet.”²⁷ Duke përmbyllur seancën e 21 Titoja theksoi se “arsye kryesore të deformimeve në Kroaci dhe në gjithë Jugosllavinë janë tek kriza ideore që ka kapluar Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, krizë, e cila nuk është paraqitur vetëm gjatë ndryshimeve kushtetuese, por shumë më herët.”²⁸ Ai theksonte se “kryesia LKJ-së ka të drejtë që të ndërhyjë në punët e republikave e cila nuk do ta zvogëlojë sovranitetin e tyre dhe janë ngritur tone kritike kundër Serbisë e cila kishte lansuar tani idenë se askush nuk ka të drejtë të përzihej në punët e saj.”²⁹

Pas mbledhjes së 21 të kryesisë LKJ-së, kryesia ka ardhur deri në përfundim se shovinizmi ka marrë përmasa të mëdha, duke mbledhur forcat antivetëqeverisëse dhe antikomuniste, posaçërisht ato teknoburokratike, të cilat duhet t'i pamundësojmë me të gjitha forcat.³⁰

Po kështu, pas kësaj mbledhjeje, janë mbajtur edhe një varg mbledhjesh të komiteteve qendrore të LK të republikave, ku si rrjedhojë e vendimeve politike nga mbledhja e lartpërmendur janë bërë ndryshime të mëdha në udhëheqjen e

²² Arkivi Qendror i Jugosllavisë, Fondi LKJ, Diskusija druga Josipa Broza Tita na sednici Izvrnog Biroja Presednistva SKJ, od 16-18. 3. 1970 na Brionima.

²³ Dušan Bilandžić, vep. e cit., f. 427.

²⁴ Po aty.

²⁵ Po aty, f. 428.

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty.

²⁸ Po aty, f. 429.

²⁹ Po aty.

³⁰ Branko Petranović, Momčilo Zečević, vep. e cit., f. 992-1004; Dušan Bilandžić, vep. e cit., f. 429.

republikave të asaj kohe, duke filluar nga Kroacia. Kështu në mbledhjen e 23 Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Kroacisë, kishte paraqitur dorëheqje kryetarja Savka Dabčević-Kugar dhe Mika Tripallo dhe njëkohësisht nga Lidhja Komuniste janë larguan 741 anëtarë dhe ndërruan shumë udhëheqës partiakë dhe republikanë të Kroacisë, me ç'rast lëvizja politike kroate mori goditje mjaft të rëndë.³¹

Pas thyerjes së opozitës në Kroaci qendër tjetër e rezistencës mbeti Serbia, konkretisht Beogradi, ku udhëheqësit e KQ e LK të Serbisë filluan të bëjnë rezistencë vendimeve politike të mbledhjes 21 të kryesisë së LKJ-së. Kryesia e ngushtë nuk i pranoi vendimet qenësore të kryesisë, kështu hyri hapur në konfrontim, me çka filloi procesi i diferencimit në Lidhjen Komuniste në Serbi e posaçërisht në kryesi.³² Në këto rrethana të krijuara, pas thyerjeve politike që ndodhën në Kroaci dhe ngjarjet që ishin në Plenumin e Brioneve, në Serbi klasa politike e asaj kohe i rezistoi për më se dy vite konkluzioneve të nxjerra nga Mbledhja e 21 e KQ të LKJ-së.³³

Më në fund ishte detyruar vetë kreu i shtetit jugosllav të ndërhynte që të vendos politika që kanë të bëjnë me vendimet e mbledhjes së 21 të KQ të LKJ-së, kur një pjesë e udhëheqjes serbe ishte detyruar të paraqiste dorëheqje. Çështja kryesore që u diskutua në këtë kohë ishte se a është LK e Serbisë në harmoni me Lidhjen komuniste të Jugosllavisë. Kështu, më 21 tetor 1972 Marko Nikeziq, Latinka Peroviqi, Boro Pavloviqi paraqitën dorëheqje dhe po ashtu në fund të vitit 1972 u detyrua të japë dorëheqje edhe përfaqësuesit nga Vojvodina, kryetari dhe sekretari i Lidhjes Komuniste të Vojvodinës Mirko Čandanoviç dhe Milosh Radojčin.³⁴

Prandaj, kriza jugosllave që kishte përfshirë periudhat e viteve '60 dhe '70 kishte marrë dimensionet e saj më të theksuara në Kroaci dhe në Serbi. Mirëpo, nuk kishin mbetur pa u larguar nga skena politike edhe përfaqësuesit sllovenë, ata boshnjakë dhe maqedonas. Kështu, vitet 1970-1973 paraqesin largimin e të gjithë kundërshtarëve politikë të Titos.³⁵

Prandaj, vitet '70 paraqesin vitet e lëvizjeve të mëdha politike nacionale që përfshin tërë Jugosllavinë. Në fjalimin e kryetarit të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, Josip Broz Tito, para udhëheqësve të aktivitetit shoqëroro-politik të Serbisë, të mbajtur mes 9 dhe 16 tetorit 1972, kishte theksuar: "Amendamentet e fundit të kushtetutës janë miratuar dhe janë afirmuar politikisht, por në një masë të

³¹ Branko Petranović, Momčilo Zečević, vep. e cit. f. 982-991; Dušan Bilandžić, vep. e cit., f. 429.

³² Dušan Bilandžić, vep. e cit., f. 1985, 430

³³ Slavoljub Djukic, *Slom srpskih liberala – Tehnologija političkih obračuna Josipa Broza*, ("Filip Višnjić", Beograd, 1990), 137-146.

³⁴ Po aty, f. 434.

³⁵ Arkivi Qendror i Jugosllavisë, Fondi LKJ, Diskusija druga Josipa Broza Tita na sednici Izvrnog Biroja Predsednistva SKJ, od 16-18. 3. 1970 na Brionima; Dzon R. Lempi, vep. e cit., f. 265-293.

madhe janë mbitheksuar ato të cilat flasin për mëvetësinë, sovranitetin e republikave dhe pozitën e tyre në federatë.”³⁶

Ndërkaq, në anën tjetër Edvard Kardeli, si udhëheqësi i grupit për hartimin e kushtetutës së vitit 1974, duke paraqitur qëndrimin për Republikën e Sllovenisë, theksonte: “Jugosllavia e sotme nuk zhvillohet, nuk forcohet si supershtet hegjemonist, por si bashkësi socialiste dhe vetëqeverisëse e popujve të barabartë.”³⁷ Pjesët e udhëheqjes jugosllave, që vinin nga republikat, mbronin me fanatizëm interesat e republikave të tyre, kurse federata paraqitej vetëm si një strukturë të cilën e përdornin për realizimin e interesave të tyre. Në anën tjetër udhëheqja kosovare nuk kishte mbështetje dhe përkushtim të duhur për të këmbëngulur në mbrojtjen e interesave të Kosovës. Posaçërisht kjo vinte në shprehje në strukturën e investimeve nga fondi i federatës për mbështetjen e Kosovës si pjesa më e pazhvilluar e federatës. Duke folur për pozitën e Sllovenisë në federatën jugosllave Kardeli theksonte: “Edhe Sllovenia nuk është më provincë dhe nuk dëshiron të jetë provincë e çfarëdolloj imperializmit ose hegjemonizmi, por organizëm komplet kombëtar, që dëshiron të jetojë në bashkësi me popujt e tjerë, e sidomos me popujt jugosllavë. Duhet theksuar se ajo bashkësi, e cila mban emrin e vjetruar federatë është gjithashtu pjesë e shtetësisë dhe e sovranitetit tonë slloven, ashtu sikur që shtetësia sllovene është pjesë e shtetësisë jugosllave.”³⁸ Udhëheqësi i komunistëve sllovenë France Popit, duke folur për kohezionin e federatës u deklarua për “principin e ‘llogarive të pastra’ mes republikave, në mënyrë që të mos ia imponojnë njëra-tjetër politikën e vet, duke theksuar se sidomos sllovenët janë tepër të ndjeshëm ndaj unitarizmit, centralizmit dhe hegjemonizmit.”³⁹ Gjithnjë lidhur me këtë çështje udhëheqësi i komunistëve të Maqedonisë, Krste Crvenkovski, shprehej se “republika ka të drejtë të paraqes qëndrimet e veta, por që të jetë e gatshme që qëndrimin e saj të mos e kuptojë si një rrugë të vetme të cilën duhet të ndjekin të gjithë”.⁴⁰ Përfaqësuesi tjetër maqedonas Kiro Gligorov, tërhiqte vërejtjen që “marrëdhëniet serbo-kroate kishin një rëndësi shumë të madhe, posaçërisht në raport me Bosnje e Hercegovinë, Maqedoninë dhe për të gjithë anëtarët e tjerë të federatës dhe se asnjë problem nuk mund të zgjidhet në relacionin Beograd –Zagreb, sepse Jugosllavia është vend i 6 republikave dhe i 2 krahinave.”⁴¹ Ndërkaq, për përfaqësuesin serb, Lidhja Komuniste e Serbisë ishte kundër marrëveshjeve bilaterale dhe e orientuar në krijimin e “qëndrimeve të veta se ajo nuk pretendon kthimin në gjendjen e vjetër, kur konsiderohej se sipas përcaktimeve Serbia dhe Jugosllavia kishin qëndrime të njëjta.”⁴²

Konflikti brenda federatës jugosllave kishte marrë përmasa të mëdha, sidomos rreth kompetencave të federatës në raport me republikat, e në veçanti në

³⁶ Branko Petranović, Čedomir Štrbac, *Istorija socijalističke Jugosllavie*, (Radnička štampa, Beograd, 1977), f. 116.

³⁷ Edvard Kardel, vep. e cit., f. 453.

³⁸ Po aty.

³⁹ Dušan Bilandžić, vep. e cit., f. 370.

⁴⁰ Po aty, f. 371.

⁴¹ Po aty.

⁴² Po aty.

raportet mes federatës jugosllave dhe Kosovës, si dhe Republikës së Serbisë dhe Kosovës. Edhe sipas kushtetutës, me elemente konfederaliste, të vitit 1974, Jugosllavia nuk arriti të stabilizonte situatën në raportet mes republikave, sidomos kur ishte në pyetje çështja e ndarjeve buxhetore, kompetencat e ushtrisë jugosllave, si dhe raportet e republikave me institucionet ndërkombëtare.⁴³

Se çfarë kalkulimesh politike bëheshin në raportet mes republikave dëshmon edhe revolta e sllovenëve, e cila kishte të bëjë me përdorimin e fondit për ndërtimin e rrugëve. Sllovenët ishin përgatitur që fondet e marra nga bankat ndërkombëtare t'i orientonin në ndërtimin e rrugës Nova Gorica-Lubjanë, që nënkuptonte afrimin e plotë me tregun italian. Kurse në anën tjetër kroatët e serbët kërkonin që ato fonde t'i përdorin për nevojat e tyre.⁴⁴ Për Edvard Kardelin, si njeri i afërt i Titos, i cili në të shumtën e rasteve kishte ndihmuar për të zgjidhur shumë probleme që ishte ballafaquar Tito gjatë periudhës së vet të pushtetit ishte i papranueshëm afrimi mes kroatëve dhe serbëve, i cili mund të rrezikonte pozitën e tij, prandaj doli hapur kundër këtyre kërkesave.⁴⁵

Historiani serb Branko Petranović, në librin e tij "Historia e Jugosllavisë 1918-1978", duke folur për vitet '70 thekson se "udhëheqja partiake ka gjykuar "federalizmin" dhe "dezintegrimin" e LKJ-së, si rrezikun më të madh për unitetin e saj dhe si sulm në themelet e saj".⁴⁶ Duke u gjendur në një krizë të tillë federata jugosllave, Tito kishte kërkuar nga Edvard Kardeli që të fillojë përgatitjet për ndryshimet kushtetuese, me të cilat do të mundësohej hartimi dhe miratimi i kushtetutës së re dhe gjetjen e zgjidhjeve për konceptcionet e reja vetëqeverisëse të bazuar në punën e bashkuar, për të siguruar zhvillimin më dinamik marrëdhënieve shoqërore-ekonomike.⁴⁷ Orientimet themelore për zhvillimin e ardhshëm të federatës jugosllave, mbi këto baza, për të cilat një rol kyç e kishte luajtur Edvard Kardel, janë paraqitur në platformën për përgatitjen e qëndrimeve dhe të vendimeve të Kongresit të X të LKJ-së, në qershor të vitit 1973. Konceptcionin vetëqeverisës të punës së bashkuar e kishte pranuar edhe Kushtetuta e vitit 1974 dhe Kongresi i X i LKJ-së.⁴⁸

Kushtetuta e vitit 1974 ishte strukturuar për të bërë reforma të mëdha dhe për të eliminuar kontradiktat e thella të paraqitura posaçërisht pas Plenumit të Brionëve, ngjarjeve në Kroaci, në Slloveni dhe në Serbi. Kërkesat gjithnjë e më të fuqishme nga republikat dhe krahinat, sidomos nga Kroacia, Sllovenia e Maqedonia, për zgjidhjen e çështjeve sistimore morën edhe formë të ndryshme të presionit mbi "administratën federative" dhe mbi konfrontimet të udhëheqësve të

⁴³ Dzon R. Lempi, *Jugosllavija kao istorija- Bila dva put jedna zemlja*, Dan Graf, Beograd, 2004, f. 265-293.

⁴⁴ Kjo është e njohur si "cestna afera", nga sllovenishtja "afere e rrugëve", e vitit 1969, e cila në një masë të madhe kishte lëkundur raportet brenda federatës jugosllave, përkatësisht raportet serbo-sllovene.

⁴⁵ Misha Glenny, vep. e cit., f. 587.

⁴⁶ Branko Petranović, *Istorija Jugoslavije 1918-1978*, Nolit, Beograd, 1980, f. 595.

⁴⁷ Po aty, f. 596-597.

⁴⁸ Po aty.

republikave me organet federative.⁴⁹ Lufta mes forcave etatiste dhe atyre liberale as në Kongresin e IX të LKJ-së (11-15 mars 1969)⁵⁰ e as në Kongresin e X të LKJ-së (27-30 maj 1974),⁵¹ nuk arriti të zbutej, sepse depërtimi i nacionalizmit kishte marrë përmasa të mëdha dhe përfaqësuesit e secilës njësi federale prezantonte dhe mbronte interesat e veta.⁵² Prandaj, misioni i kushtetutës së vitit 1974 për të bërë reforma ekonomike për ndërtimin e raporteve të reja mes federatës dhe republikave, për eliminimin e forcave nacionaliste opozitare,⁵³ nuk dha rezultate të pritura, sepse vetëm disa vite më vonë të gjitha këto kompromise të bëra do të eskalojnë në lëvizje të mëdha politike antifederaliste dhe antijugosllave. Gjigantet ekonomike të cilat ishin ndërtuar nëpër republika si në Kroaci e posaçërisht në Serbi në fund të viteve të '70, gëlltitën pothuajse të gjitha të hyrat devizore dhe kreditë e mëdha të marra nga perëndimi. Borxhet e jashtme të Jugosllavisë në periudhën 1968-1972 ishin afër 4 miliardë dollarë, ndërsa në vitin 1976 ajo shumë ishte dyfishuar, për të arritur shumë prej afro 20 miliardë dollarësh në vitin 1982.⁵⁴

Në këto rrethana të krijuara, udhëheqja politike kosovare arriti të shfrytëzojë këto kontradikta të brendshme dhe liberalizmin politik në federatën jugosllave, që shfaqej në këtë periudhë, për të bërë disa ndryshime pozitive në zhvillimin ekonomik, kulturor, arsimor të Kosovës.⁵⁵ Struktura e investimeve në këto vite në Kosovë filloi të shkojë në favorin e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Nga niveli i federatës Kosova i shfrytëzoi disa burime të cilat në periudhën etatiste nuk kishte mundur t'i realizonte. Në aspektin e zhvillimit kulturor këto vite paraqesin njërën nga periudhat më progresive pas Luftës së Dytë Botërore, ndërsa në zhvillimin e arsimit kjo periudhë paraqet një iluminizëm të llojit të vet në Kosovë.

Rreth kësaj periudhe është folur dhe është shkruar mjaft. Historiografia serbe këtë periudhë e paraqet si periudhën në të cilën Republika e Serbisë mbështeti me të gjitha potencialet e saj zhvillimin ekonomik të Kosovës, duke tentuar t'i paraqes këtë ndryshime si rrjedhojë e investime të saj.⁵⁶

Historiani Noel Malkolm, në librin e tij *"Kosova një histori e shkurtër"*, duke folur për fazën e liberalizimit të jetës politike në Jugosllavi në vitet '70 shprehet se me zhvillimin e një klase të re shqiptarësh të shkolluar, një klasë që tejkalon numrin e vendeve ekzistuese për një personel të tillë në sistemin ekonomik ende të pazhvilluar të Kosovës, pabarazia etnike në disa fusha të jetës publike u korrigjua pjesërisht.⁵⁷

⁴⁹ *Historia e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë*, Rilindja, Prishtinë, 1985, f. 509.

⁵⁰ Po aty, f. 506.

⁵¹ Po aty, f. 522.

⁵² Po aty, f. 510.

⁵³ Po aty, f. 514.

⁵⁴ Dzon R. Lempj, vep. e cit., f. 285.

⁵⁵ Noel Malkolm, *Kosova, një histori e shkurtër*, Koha & Shtëpia e librit, Prishtinë-Tiranë, 2001, f. 340; Jens Rojters, *Shqiptarët në Jugosllavi*, Botimpex, Tiranë, 2004.

⁵⁶ Spasoje Djaković, *Sukobi na Kosovu*, (Narodna knjiga, Beograd, 1984); Miloš Mišović, vep. e cit; Dragoslav Draža Marković, *Zivit u politici*, 1967-1978, (RAD, Beograd, 1987).

⁵⁷ Noel Malkolm, vep. e cit f. 340.

Duke shfrytëzuar liberalizimin e jetës politike në federatën jugosllave, Kosova në vitet '70 arriti të shfrytëzojë situatën për të krijuar marrëdhënie të mira, sidomos në aspektin kulturor dhe arsimor me Shqipërinë. Në këtë kohë u nënshkruan shumë marrëveshje të bashkëpunimit⁵⁸ dhe u mbajtën një mori simpoziumesh të përbashkëta shkencore në Prishtinë dhe në Tiranë.⁵⁹ që më vonë do të shihej se kishin arritur të jepnin rezultate të jashtëzakonshme në përgatitjen e klasës së re politike të Kosovës për t'u përballur me sfidat e reja për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Në vitin 1971 u nënshkrua Protokoll i bashkëpunimit në mes të Universitetit të Tiranë dhe Universitetit të Prishtinës.⁶⁰ Në frymën e shtendosjeve të raporteve zyrtare Kosovë-Serbi dhe të atyre Shqipëri-Jugosllavi për periudhën disaveçare në të dy anët e kufirit pati shkëmbime të mëdha në fushat e arsimit dhe kulturës. Shqipëria i dha një shtysë të madhe bashkëpunimit dhe financimit të fushave, të cilat ishin në favorin e çështjes nacionale.⁶¹

3. Kosova dhe takimi i Karagjorgjevës

Kriza politike, ekonomike, kishte kapluar sistemin federativ jugosllav, prandaj fundi i viteve '70 Jugosllavinë e gjeti në një situatë të kaosit të plotë ekonomik, politik dhe të raporteve mes republikave dhe krahinave.⁶² Kjo situatë e krijuar, moshë e shtyrë e udhëheqësit jugosllav Titos, bënë të nevojshme që të takohen udhëheqësit politikë të kohës, sidomos ata ushtarakë për të diskutuar për gjendjen e sigurisë së Jugosllavisë, në fund të viteve '70. Një takim i tillë sipas Josip Kopiniçit, njërit nga bashkëpunëtorët e tij më të besueshëm dhe njëri nga ata që, sipas Dedijerit, kishte mbajtur arkivin personal të Titos,⁶³ është mbajtur në Beograd, më 21, 22, 27 dhe 28 dhjetor të vitit 1979, i njohur si takimi i Karagjorgjevës,⁶⁴ ku një nga temat kryesore të cilën e kishte shtjelluar Titoja, ishte

⁵⁸ AQSH, fondi 10/11, viti 1968, d. 30, f. 1.

⁵⁹ Po aty, f. 4.

⁶⁰ Po aty, f. 2.

⁶¹ Po aty, f. 7.

⁶² Dejan Jović, *Jugoslavija država koja odumrla*, Prometej, Zagreb, 2008.

⁶³ Sipas Vlladimir Dedijerit Josip Kopiniçi posedon materiale të shumta për Titon. Sipas dëshmisë së tij, Kopiniçi gjatë kohës së luftës, nëpërmjet Moskës, kishte dërguar mbi 1400 radiograme politike të Titos me përmbajtje ushtarake. Mirëpo Dedijeri thotë se kur e kam dërguar hulumtuesin Vjençesllav Cençiq, në Moskë, ai më ka ofruar të dhënë autentike që atje gjenden rreth 6 mijë depeshe të ndryshme, si nga Titoja dërguar Kominternit ashtu edhe nga Kominterni dërguar Titos. Sipas Dedijeri Kopiniçi gjithashtu i posedon edhe me një numër të letrave personale të Titos, nga të cilat Titoja jep vlerësimet për karakteret personale të bashkëpunëtorëve të tij më të afërt. (Vladimir Dedijer, vep. e cit., f. 56-57.)

⁶⁴ Rreth stenogramit të nxjerrë nga ky takim nga Josip Kopiniçi i cili është publikuar më 14.1. 1988, nga Arkivi i posaçëm i Josip Broz Tito DSNO Beograd, më vonë i botuar në librin me titull "Rrëfimet e fundit të Titos" nga autori Vjençesllav Cençiq (Orfelin, Beograd, 2001), ka pasur reagime se nga ky takim nuk kishte pasur stenogram. Një reagim të tillë e ka shfaqur edhe Shoqata për të vërtetën e luftës antifashiste nacionalçlirimtare në Jugosllavi, 1941-1945. Ndërsa një reagim tjetër që e ka mohuar stenogramin e ka paraqitur edhe gjenerali jugosllav Kosta Nagj, te libri "Takimet e fundit me Titon" (Globus-Delo,

edhe situata politike dhe e sigurisë në Kosovë pas shpalljes së kushtetutës së vitit 1974.

Tito këtë takim e kishte nisur duke u shprehur: “Unë nuk ju kam ftuar që ta festojmë ditën e ushtrisë, por të bisedojmë rreth situatës aktuale dhe për të ardhmen e ushtrisë dhe të Jugosllavisë... Unë kam marrë informacione të cilat m’i ka sjellë gjenerali Lubiçiq dhe duke lexuar këto informacione jam i shokuar për situatën politike në vend. Po ashtu e di që situata e sigurisë në Kosovë është e keqe, por edhe ajo mes republikave ka rënë në nivelin më të ulët...”⁶⁵ Gjatë vizitës së fundit të Titos në Kosovë, në vitin 1979, është biseduar edhe për problemet që Titoja i ngriti në takimin e Karagjorgjevs.⁶⁶ Më pas Tito kishte vazhduar: “Armata Popullore Jugosllave sipas kushtetutës ka marrë kompetencat për të ruajtur integritetin e Jugosllavisë... Thashë se situata politike dhe e sigurisë në Kosovë është çdo ditë e më e keqe. Është krijuar një ndarje dhe një mosdurim mes kuadrove serbe dhe atyre shqiptare.”⁶⁷

Në vazhdim të këtij takimi Tito kishte theksuar mundësinë që kishte fituar Kosova me ndryshimet e reja kushtetuese. Tani ishte krijuar një hapësirë shumë më e mirë për udhëheqjen jugosllave, që problemin shqiptar ta sheh më ndryshe, sepse pozitat e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare ishin stabilizuar. Ishte tejkaluar rreziku i ndërhyrjes ushtarake nga Pakti i Varshavës. Blloku i perëndimit kishte shfaqur hapur interesat e tij për ta ruajtur stabilitetin politik dhe ekonomik të shtetit jugosllav, duke shprehur një simpati ndaj vetë Titos. Këtë shohim nga qëndrimi i Henri Kisinxherit, i cili thotë: “Tito do të ishte njeri i madh, edhe po të mos kishte pushtet”.⁶⁸ Prandaj, Tito kishte arritur të dominonte tërësisht mbi lëvizjet politike nacionale dhe përmes kushtetutës së vitit 1974, kishte marrë të gjitha funksionet esenciale të partisë dhe të shtetit, duke u shndërruar në udhëheqës politik me mandat të pakufizuar.⁶⁹

Duke folur për kushtetutën e vitit 1974 dhe mundësinë që ia kishte dhënë kjo kushtetutë Kosovës, Tito është shprehur: “Kuadrat shqiptare të Kosovës mendojnë

Zagreb-Lubjanë, f. 128). Ndërsa, biografi i Titos, Vlladmir Dedijeri, është shprehur se Josip Kopiniçi ishte njeriu më i afërt i Titos dhe posedonte tërë arkivin e Titos dhe sipas tij del se Kopiniçi ka mundur ta ketë këtë stenogram, sepse ishte pothuajse takimi i fundit i Titos me udhëheqës ushtarakë dhe politikë, ishte dita e armatës jugosllave ndërsa Titoja ishte në moshë të shtyrë dhe duke parë konfliktet e brendshme bënte përpjekje të jepte vizionin e tij për disa probleme që kishin të bënin me të ardhmen e Jugosllavisë. Në këtë mënyrë nga të gjitha dokumentet dhe materialet e kohës të trajtuar na rezulton se mund të bazohemi në këtë stenogram.

⁶⁵ Stenogram Titovog govora u Karadjordjevu, f. 19; Vjenčeslav Cenčić, *Titova poslednja ispovijest*, Grafos, Beograd, 2001.

⁶⁶ Arkivi i Kosovës, fondi LKJ, Fjala e Titos në mbledhjen e përbashkët të kryesisë së KK të LK të Kosovës dhe të kryesisë së KSA të Kosovës, më 16 tetor 1979; *Tito përsëri në Kosovë*, Rilindja, 1980.

⁶⁷ Stenogram Titovog govora u Karadjordjevu, f. 19; Vjenčeslav Cenčić, vep. e cit.

⁶⁸ Cituar sipas Vladimir Dedijer, vep. e cit., f. 39.

⁶⁹ Më 16 maj 1974 Titoja zgjedhet udhëheqës i Jugosllavisë, me mandat të pakufizuar. (Tito u Skupstinu Socijalistické Jugoslavije, 1942-1977, BIGZ, Beograd, 1978).

se meqë sipas Kushtetutës së vitit 1974 kanë fituar më shumë të drejta, e pjesërisht edhe shtetësinë, ndërkaq unë theksoj se kam qenë kundër asaj kushtetute që të munden vetë t'i kryejnë aktivitetet shtetërore. Kështu që është e palejueshme që pa Serbinë, a edhe pa Jugosllavinë, të behën biseda shtetërore me Shqipërinë.”⁷⁰ Kurse gjatë vizitës së fundit të tij në Kosovë, rreth ndikimit të Kosovës në ngritjen e marrëdhënieve Jugosllav-Shqipëri, ishte shprehur: “Faktor me rëndësi dhe aktiv në bashkëpunimin tonë edhe në marrëdhëniet e tërësishme me Shqipërinë është e kombësia shqiptare në Jugosllavi, veçmas këtu në Kosovë.”⁷¹

Duke folur për hapësirën që kishte krijuar kushtetuta e vitit 1974 dhe përdorimin e kësaj kushtetute nga shqiptarët, për t'i realizuar interesat e tyre, Tito theksonte: “Nuk e ka paralajmëruar rastësisht Kardeli udhëheqjen kosovare se me politikën e tillë janë duke *mbjellë erën e do ta korrin furtunën*”,⁷² për të vazhduar mendimin e tij për ‘privilegjet’ që i kishte fituar Kosova me kushtetutën e vitit 1974, duke u shprehur: “Edhe më herët, e posaçërisht prej vitit 1974 dhe me shpalljen e Kushtetutës së re të krahinave, veçanërisht në Kosovë, por edhe në Novi Sad, ‘pushtetarët’ thonë: Ne nuk kemi interesa të përbashkëta në problemet e jashtme dhe të tjera shtetërore me Serbinë”.⁷³ Me këto qëndrime të tij, Titoja edhe njëherë tregonte se Kosova nuk mund të dilte jashtë orbitës politike dhe juridike të Serbisë dhe lidhur më këtë ai shprehej: “Të kujt janë ato krahina, pos republikës së Serbisë? Një politikë të tillë urgjentisht duhet ndërprerë. Pra, të mos e përsëris në Kosovë kanë ‘importuar’ profesorë nga Tirana, të cilët kanë bërë ‘thyerje’ historike në Prishtinë, ndërkaq në politikën e jashtme shprehen: Ne jemi krahinë e cila kemi të drejtë të ratifikojmë marrëveshjet ndërshtetërore. Këtë ‘privilegj’ shokë nuk e ka asnjë republikë në Jugosllavi, a edhe në Prishtinë edhe në Novi Sad, ata e kanë marrë këtë të drejtë, të cilën e ka vetëm Federata.”⁷⁴

Po ashtu pala serbe kishte reaguar në shumicën e mbledhjeve që ishin mbajtur gjatë periudhës së ndryshimeve kushtetuese, sidomos për krijimin e raporteve të reja dhe të afërta mes Kosovës dhe Shqipërisë, posaçërisht në lëmin e arsimit dhe sidomos angazhimit të profesorëve nga Tirana në Universitetin e Prishtinës.⁷⁵

Duke folur për rrethanat e aprovimit të kushtetutës së vitit 1974, posaçërisht në raport me Kosovën, Tito theksonte: “Shokë, duhet thënë se kur është në pyetje Kosova të gjithë ata që kanë votuar për Kushtetutën e vitit 1974 do të jenë fajtorë për fatin e Jugosllavisë. I vetmi, i cili kishte kurajë që hapur të votojë kundër Kushtetutës ishte heroi i popullit, Radenko Mandiq, i cili tha se një kushtetutë e

⁷⁰ Stenogram Titovog govora u Karadjordjevu, f. 21, Vjenčeslav Cenčić, *Titova poslednja ispovijest*.

⁷¹ Arkivi i Kosovës, fondi LKJ, Fjala e Titos në mbledhjen e përbashkët të kryesisë së KK të LK të Kosovës dhe të kryesisë së KSA të Kosovës, më 16 tetor 1979; *Tito përsëri në Kosovë*, Rilindja, 1980, f. 86.

⁷² Stenogram Titovog govora u Karadjordjevu, f. 21, Vjenčeslav Cenčić, *Titova poslednja ispovijest*.

⁷³ Po aty.

⁷⁴ Po aty.

⁷⁵ Miloš Mišović, vep. e cit.

tillë është kundër parimeve të KAÇKJ-së... Shikoni, tash kur e kemi një Kushtetutë të tillë dhe ajo na e pamundëson kontrollin, veçanërisht në potezat politike në republika dhe krahina, po shpërthen nacionalizmi si në Kosovë. Atëherë edhe sfera e interesit të nacionalizmit do të ndikojë edhe në APJ-në, a kjo është më e rrezikshmja për integritetin e Jugosllavisë.”⁷⁶ Duke folur për shtrirjen e nacionalizmit në të gjitha strukturat e federatës, Tito thoshte: “Kam ndjenjën, dëshiroj ta kem gabim, se edhe në APJ ka, si në vitin 1971 elemente, të cilat janë të helmuara nga nacionalizmi. I përcjell, pos në Kosovë, ngjarjet edhe në Slloveni dhe në Kroaci dhe këtu nuk janë gjërat e pastra. Po e përsëris, dua të jem gabim. Unë në tetor të këtij viti i kam thënë hapur për të gjitha këto çështje udhëheqjes kosovare, por nuk ka sukses.”⁷⁷

Gjatë vizitës së fundit që Tito i kishte bërë Kosovës, më 15 tetor 1979, në fjalën e tij në mbledhjen e përbashkët të kryesisë së KK të LK të Kosovës dhe të kryesisë së KSA të Kosovës, që e mbajti më 16 tetor 1979 në Prishtinë, duke folur për raportet ndërnacionale në Kosovë, në mes të tjerash theksonte: “Kosova po ballafaqohet me veprimtarinë e forcuar të nacionalistëve, irredentistëve, të pjesës armiqësore të klerit dhe të kundërshtarëve të tjerë ideorë.”⁷⁸ Fjala e tij në Prishtinë është në akord me qëndrimet e tij në takimin e Karagjorgjevës, lidhur me Kosovë, ku shtonte: “Pra nacionalistët dhe irredenta në Kosovë po e shfrytëzojnë jounitetin në Jugosllavi rreth zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Sllovenia dhe Kroacia kanë disa vështirime të paqarta për problemin e Kosovës.”⁷⁹

Lidhur me mundësinë e vendosjes apo jo të masave administrative ushtarake në Kosovë, në atë takim, Tito theksonte: “Po, tash kur i kujtoj ndodhitë e tilla shumë më pyesin pse edhe tash nuk e vendosim administratën ushtarake në atë krahinë. Kam menduar edhe për atë solucion, por në këtë, këtu edhe Vlado, më janë përgjigjur ai dhe Edo Bevc (Edvard Kardel - nënvizim E. Ç). Unë e di se kjo që po ndodhë në Kosovë, nuk është vetëm veprimtari antijugosllave, por ky është edhe akt antishtetëror dhe këtë duhet ta ndalojmë me urgjencë. Kështu më nuk mundet. Po të ishte Bevc gjallë do të kisha dërguar tash në Prishtinë, jo ta shuan zjarrin, por ta shuajë stihinë e zjarrit e cila e ka kapluar tërë Kosovën.”⁸⁰ Po kështu sipas Misha Glenit, lideri jugosllav, Josip Broz Tito, saherë që ishte në situatë të vështira politike kërkonte ndërhyrjen e Kardelit.⁸¹ Në takim e Karagjorgjevës, duke vënë në dyshim veprimet e udhëheqjes së Kosovës, përkatësisht bashkëpunimin e tyre me udhëheqjen republikane dhe atë federative thoshte: “Madje, kam dëgjuar se Hoxha, Hasani, Bakalli dhe shokët nuk duan të bisedojnë me udhëheqjen republikane në Beograd, por edhe ne në federatë, pa përjashtim, nuk iu interesojmë.”⁸² Duke theksuar se ishte kundër zgjidhjeve kushtetuese të vitit 1974 për krahinat, Titoja,

⁷⁶ Stenogram Titovog govora u Karadjordjevu, f. 21-22; Vjenčeslav Cenčić, vep. e cit.

⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ *Tito përsëri në Kosovë*, (Rilindja, 1980), f. 68-70.

⁷⁹ Stenogram Titovog govora u Karadjordjevu, f. 21-22; Vjenčeslav Cenčić, vep. e cit.

⁸⁰ Stenogram Titovog govora u Karadjordjevu, f. 23; Vjenčeslav Cenčić, vep. e cit.

⁸¹ Misha Glenny, vep. e cit, f. 579.

⁸² Stenogram Titovog govora u Karadjordjevu, f. 23; Vjenčeslav Cenčić, vep. e cit.

shprehej: “Kur në vitin 1974 isha kundër dhënies së mëvetësisë së tillë krahinave, Kosovës dhe Vojvodinës, a këtu është edhe Vlado, dhe do ta vërtetojë këtë, atëherë Bevc më ishte përgjigjur se jam “i tmerruar” nga zgjimi i ndjenjave nacionale në ato republika por që nuk do të mund të përsëritet viti 1968 ose viti 1971.”⁸³

Një brengosje që e kishte shfaqur në këtë takim ishte se çfarë masash duhet të përdorte për ta shuar lëvizjen politike dhe kombëtare të shqiptarëve në Kosovë, a duhet vepruar edhe menjëherë siç kishte vepruar në vitin 1945 apo duhet të ndërmernte hapa të tjerë politikë. Për këtë shprehet: “Por, tash kur duhet të digjemi nga stihia e zjarrit nacionalist në Kosovë, por edhe të autonomashëve në Vojvodinë, është vështirë të jesh i mençur për të ditur se si të veprosh. A duhet të vendoset administratë ushtarake apo të përpiqemi edhe tutje ta parandalojmë këtë me veprime politike.”⁸⁴

Në këtë kohë ngjarjet nuk mund të zhvilloheshin sikur u zhvilluan në vitin 1945, sepse gjatë kësaj kohe në Kosovë ishin prezentë shumë nga institucionet ndërkombëtare, si grupe të shumta të gazetarëve të huaj, që vizitonin Kosovën,⁸⁵ Titoja, me çdo kusht dëshironte ta ruajë imazhin e njeriut të paqes, njeriut demokrat, prandaj ishte në dilemë se si do të reflektohej ndonjë ndërhyrje më e dhunshme në Kosovë. Prandaj ai më tepër preferonte që në mënyrë të heshtur të vinte deri te qëllimi i tij politik. Ja se si shprehet ai në raport me refleksionet që kishin të bënin me perëndimin në rast të ndonjë ndërhyrjeje me forcë në Kosovë: “Disa në Perëndim mendojnë se tash është koha ‘të futen’ gishtërinjtë në Jugosllavi. Thonë se duhet të jemi të gatshëm për ditën ‘D’... unë jam përgjegjës për të gjithë popujt e këtij vendi për integritetin e tij, për stabilitetin, por nëse nuk jeni ju, Armata e jonë, çka do të mund të bëjë unë në situatën çfarë është tash në Kosovë.”⁸⁶ Jugosllavia e krijuar si bashkësi e popujve asnjëherë nuk mund t’i tejkalonte antagonizmat e brendshme dhe ajo gjithë kohën paraqitej si një vend jostabil në qarqet ndërkombëtare. Shumë nga strukturat e shteteve të perëndimit parashihnin se pas vdekjes së Titos mund të kishte çrregullime të mëdha politike në Jugosllavi. Ndërsa, duke folur për Kosovën dhe situatën politike në të, pas vizitës së tij në Kosovë, Tito theksonte: “Paramendoni të vërtetën që udhëheqja e Prishtinës, a veçanërisht veprimtarët ilegalë janë mirë të informuar për strategjinë e perëndimit. Për këtë dhe për këtë temë, Fadil Hoxha ka biseduar, siç jam i informuar, me Stane Dolancin a edhe Sinan Hasani me Llazën me një kujdes, që të mos fyhen ‘bashkëpunëtorët e perëndimit’, ka treguar për numrin e shtuar të perëndimorëve, të cilët e vizitojnë Prishtinën dhe për bisedat të cilat zhvillohen.”⁸⁷

Kontradiktat në federatën jugosllave në nivelin e republikave kishin marrë dimensione mjaft të mëdha. Stabiliteti i Jugosllavisë ishte i lidhur kryesisht me

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Po aty.

⁸⁵ Arkivi i Kosovës, Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste, 25 mars 1970, ekzemplari nr. 18. Detyrat ideore e politike të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës në luftë kundër disa dukunive dhe formave të veprimtarisë anti-vetëqeverisëse dhe antisocialiste, f. 6.

⁸⁶ Stenogram Titovog govora u Karadjordjevu, f. 24; Vjenčeslav Cenčić, vep. e cit.

⁸⁷ Po aty.

udhëheqjen personale të Titos dhe çështja kryesore që shtrohej ishte se si do të rridhte situata pas vdekjes së tij. Po ashtu shtrohej një çështje shumë e rëndësishme për strukturat politike jugosllave të kohës, ishte se si ta krijonin një stabilitet politik dhe një raport të qëndrueshëm mes republikave dhe federatës, si të eliminonin vatrat e konflikteve të mundshme në federatën jugosllave. Të gjitha vendimet e mëdha që janë marrë që nga viti 1945 e deri në vitin 1980, Titoja ishte aktori kyç dhe vendimmarrës, i të gjitha proceseve. Edhe kur kemi të bëjmë me vendosjen e masave ushtarake në Kosovë, në vitin 1945, sikurse edhe për ngjarjet e tjetra që pasuan

Prandaj, diskutimi për të vendosur masat administrative dhe ushtarake në Kosovës në vitin 1979, nuk duhet parë diçka si të pamundshme, pavarësisht se a është biseduar kjo apo jo në takimin e fundit me udhëheqësit ushtarakë, sepse kjo do të ndodhë vetëm një vit e disa muaj më vonë në Kosovë, me rastin e ngjarjeve të vitit 1981.

Përfundim

Kriza politike, ekonomike, kishte përfshirë sistemin federativ jugosllav, prandaj fundi i viteve '70 Jugosllavinë e gjeti në një situatë të kaosit të plotë ekonomik, politik dhe të raporteve mes republikave dhe krahinave, me tendenca për dezintegrimin e plotë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë.

Lëvizja nacionaliste në Kroaci, ajo teknokratike në Slloveni dhe ajo liberale në Serbi, karakterizojnë zhvillimet politike në Jugosllavi në vitet '70 dhe përpjekjen e Titos për t'u gjendur në këto zhvillimeve dhe për t'i mbajtur nën kontroll. Jugosllavia në këto vite hyri si një federatë, e cila ishte kapluar nga kontradiktat e mëdha nacionale.

Vizita e Titos në Kosovë, në muajin tetor të vitin 1979, i parapriu diskutimeve për të vendosur masat administrative dhe ushtarake në Kosovë, në takimin e Karagjorgjevës, në dhjetor të po atij viti. Kjo do të ndodhë vetëm një vit e disa muaj më vonë në Kosovë, me rastin e ngjarjeve të vitit 1981.

Kosova hyri në këto zhvillime e përcjellë me disa ngjarje të mëdha: demonstratat e vitit 1968; amendamentet kushtetuese; universiteti i Prishtinës; raportet e mira me Tiranën; kushtetuta e vitit 1974; konsolidimi i lëvizjes ilegale. Ndërkaq, "Libri i kaltër" edhe takimi i Karagjorgjevës kanë një konkluzion të përbashkët: rishikimin e pozicionit kushtetues-juridik të Kosovës në federatën jugosllave, përkatësisht rivendosjen e saj nën juridiksionin e plotë të Republikës së Serbisë. Të gjitha këto zhvillime ndikuan që të vinte deri te demonstratat e vitit 1981.

BURIMET DHE LITERATURA**B U R I M E T****Burimet arkivore**

USNA - United States National Archives

NARA -National Archives and Record Adminsitration of USA

FRUS - Foreign Relationn of United States

RGANI - Rossiskij Gosudarstvenij Arhiv Novejsej Istoriji

RGASPI - Rosijski Gosudarstvenij Arhiv Socialno Politiceskoj Istoriji

AQSH - Arkivi Qendror i Shqipërisë

AMPJSH - Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë

AK - Arkivi i Kosovës

AJ - Arkivi i Jugosllavisë

Burimet e botuara

- *Dokumenti 1948, I, II, III*, RAD, Beograd, 1979. Përgatitur nga Vlladimir Dedijer.
- *Dokumente historike për t'i shërbyer historisë sonë kombëtare*, Elbasan, 1924-1925.
- *Miscarriage of justice - The Corfu Channel case (Keqpërdorimi i drejtësisë, Rasti i Kanalit të Korfuzit)* Published by The Albanian Society 26 Kambridge Road, Ilfor Essex.
- *Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse*, Toena, Tiranë, 2006. Përgatitur nga Dr. Islam Lauka dhe Prof. Dr. Eshref Ymeri,
- *Jugosllavija 1918-1984, Zbirka dokumenata*, RAD, Beograd, 1985. Përgatitur nga Branko Petranović dhe Momčilo Zečević.
- *Jugoslovenski federalizam – Ideje e stvarnost, 1943-1986*, Prosveta, Beograd, 1987. Përgatitur nga Branko Petranović dhe Momčilo Zečević
- *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948 – Dokumente*, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë, 1996. Përgatitur nga Ndreqi Plasari dhe Luan Malltezi.
- *Tito u Skupštini Socijalističke Jugoslavije, 1942-1977*, BIGZ, Beograd 1978. Përgatitën: mr. Lilana Djurin, Liljana Janjetović, mr. Lubinka Suković, Branislav Ilić.
- *Od deformacija SDB do maspoka i leberalizma*, Moji stenografski zapisi 1966-1972 godine, Narodna Knjiga, Beograd. Përgatiti: Zdravko Vuković.
- *Enver Hoxha: Ditar për çështje ndërkombëtare, 1958 – 1981, 13 vëllime, (për përdorim të brendshëm), “8 Nëntori”, Tiranë.*

Gazetat dhe revistat

Zëri i popullit (Tiranë) 1945-1982
Bashkimi (Tiranë) 1955-1982
Liria (Zvicër) 1979-1980
Bashkimi (Zvicër) 1979
Rilindja (Prishtinë) 1945-1981
Jedinstvo (Prishtinë) 1945-1981
Zëri i Kosovës (Zvicër – Prishtinë) 1980
Zëri i Rinisë (Prishtinë) 1945-1968
Besa (Stamboll) 1954-1974
Alternativa (Lubjanë) 1989-1991
Lajmëtari i Lirisë (RF e Gjermanisë) 1981
Vjetari, Arkivi Kombëtar i Kosovës, Prishtinë
Kosova, Instituti i Historisë, Prishtinë

Libra

1. Bajrami, Hakif, *Dosja Demaçi*, (Brezi '81, Prishtinë, 2005).
2. Bilandžić, Dušan, *Historija Socijalističke Federativne Republike Jugoslavije, Glavni procesi 1918-1985*, Školska Knjiga, Zagreb, 1985.
3. Çeku, Ethem, *Shekulli i ilegales*, Brezi '81, Prishtinë, 2004.
4. Çeku, Ethem, *Struktura politike e ilegales së Kosovës*, Brezi '81, Prishtinë, 2006.
5. Çeku, Mr. Ethem, *Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945-1981*, Brezi '81, Prishtinë, 2004.
6. Čenčić, Vjenčeslav, *Titova poslednja ispovijest*, Grafos, Beograd, 2001.
7. Čosić, Dobrica, *Kosovo 1956-1995*, (Novosti AD, Beograd, 2004).
8. Dedijer, Vladimir, *Novi prilozi za biografiju Josip Broz Tita, 1, 2, 3*, RAD, Beograd, 1984.
9. Djaković, Spasoje, *Sukobi na Kosovu*, (Narodna knjiga, Beograd, 1984).
10. Djaković, Spasoje, *Sukobi na Kosovu*, (Narodna knjiga, Beograd, 1984).
11. Djukic, Slavoljub, *Slom srpskih liberala – Tehnologija političkih obračuna Josipa Broza*, "Filip Višnjić", Beograd, 1990.
12. Dragosavac, Dusan, *Aspekte aktuale të çështjes kombëtare në Jugosllavi*, (Rilindja, Prishtinë, 1985).
13. Glenney, Misha, *Historia e Ballkanit, 1804-1999*, Toena, Tiranë, 2007.
14. Grup autorësh *Historia e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë*, (Rilindja, Prishtinë, 1985).
15. Grup autorësh *Jugosllavija i njeni povijesničari*, (Srendja Europa, Zagreb, 2005).
16. Hadri, Ali, *Marrëdhëniet shqiptare-jugosllave*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2003).
17. Hasani, Sinan, *Kosova, të vërtetat dhe mashtrimet*, Rilindja, Prishtinë, 1986.
18. *Historia e Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë*, Rilindja, Prishtinë, 1985.

19. Horvat, Branko, *Kosovsko pitanje*, (Globus, Zagreb, 1987).
20. Hoxha, Hajredin, *Proces nacionalne afirmacije albanske nacionalnost u Jugoslaviju*, disertacion i doktoratës, i mbrojtur në Fakultetin Filozofik më 1973 (dorëshkrim).
21. Jović, Dejan, *Jugoslavija država koja odumrla*, Prometej, Zagreb, 2008.
22. Kardel, Edvard, *Sistemi politik i vetëqeverisjes socialiste*, Rilindja, Prishtinë, 1982.
23. Lalaj, Ana, *Kosova, rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1948-1981*, Mësonjëtorja e parë, Tiranë, 2000.
24. Lempi, Dzon R., *Jugosllavija kao istorija- Bila dva put jedna zemlja*, Dan Graf, Beograd, 2004.
25. Malkolm, Noel, *Kosova, një histori e shkurtër*, Koha & Shtëpia e librit, Prishtinë-Tiranë, 2001.
26. Marković, Dragoslav-Draža, *Zivot u politici, 1967-1978*, RAD, Beograd, 1987.
27. Mišovic, Miloš, *Ko je tražio republiku*, Narodna knjiga, Beograd, 1987.
28. Novosella, Selatin, *Kosova '75*, Prishtinë, 1995.
29. Petranović, Branko - Čedomir Štrbac, *Istorija socijalističke Jugoslavije, 1, 2, 3*, (Radnička štampa, Beograd, 1977).
30. Petranović, Branko, *Istorija Jugoslavije 1918-1978*, Nolit, Beograd, 1980.
31. Rojters, Jens, *Shqiptarët në Jugosllavi*, Botimpex, Tiranë, 2004.
32. Salihu, Kurtesh, *Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të KSA të Kosovës në Jugosllavinë socialiste*, (ETMM i KSA të Kosovës, Prishtinë, 1984).
33. Smirnova, Nina, *Historia e Shqipërisë gjatë shekullit XX*, Ideart, Tiranë, 2004.
34. *Tito përsëri në Kosovë*, Rilindja, 1980.
35. Verli, Marenglen, *Kosova në vargonjtë e politikës jugosllave 1945-1988*, Tiranë, 2000.
36. Verli, Marenglen, *Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Botimpex, Tiranë, 2007.
37. Vukmanović - Tempo, Svetozar *Memoari I, II 1966-1969 - Neslaganja*, Narodna Knjiga Beograd - Naprijed, Zagreb, 1985.

ESILDA LUKU

PASQYRIMI I DEMONSTRATAVE TË VITIT 1981 NË KOSOVË NË TEKSTET SHKOLLORE TË HISTORISË NË SHQIPËRI

Demonstratat e mars-prillit të vitit 1981 shënojnë një ngjarje me rëndësi të veçantë për perspektivën historike dhe politike të popullit shqiptar të Kosovës në ish-Jugosllavi. Kjo lëvizje demokratike ishte rrjedhojë e shfrytëzimit ekonomik, padrejtësive social-kulturore e shtypjes nacionale, me qëllim çlirimin nga kolonializmi serb. Ajo përbën vetëm njerën nga hallkat, në zinxhirin e gjatë të përpjekjeve të shqiptarëve të Kosovës, për garantimin e lirisë dhe pavarësisë kombëtare, të mohuar ndër shekuj.

Ngjarjet e pranverës së '81-shit ndikuan në rritjen e nacionalizmit dhe thellimin e vetëdijes shtetformuese, pra në rizgjim kombëtar të popullit shqiptar të Kosovës.¹ Ata kërkonin me insistim të drejtën legjitime të kombit shqiptar për të siguruar një pozitë të barabartë dhe status të njëjtë me popujt e tjerë në Federatën Jugosllave. Ky aktivizim politik mbarë popullor i shqiptarëve të Kosovës shënoi fillimin e shkëputjes përfundimtare nga RSFJ-së.

Për këtë arsye, demonstratat e vitit 1981 u regjistruan jo vetëm në memorien kolektive të bashkëkohësve, por zënë një vend të posaçëm edhe në planprogramet dhe tekstet e historisë së ciklit shkollor 8-të e 9-të vjeçar dhe të arsimit të mesëm të përgjithshëm në Shqipëri. Pasi, “historia, e zhvilluar si lëndë mësimore, synon të edukojë qëndrime pozitive në mjedis, të kontribuojë në një mirëkuptim më të madh të ndërsjellë midis komuniteteve në konflikt, të ndikojë në formimin e qytetarit të ardhshëm, të denjë për një shoqëri demokratike”.² Në këtë kuptim, “historia në thelbin e vet është një mësuese, - “më e madhe e mësuesve” e quan Polibi, - që nuk synon t’i shërbejë as pushtetit, as përkatësisë, as identitetit apo krenarisë, por njohjes prej nga vijmë për të kuptuar më mirë se ku jemi, në mënyrë që të ndërtojmë më me mençuri të ardhmen”.³

Ky mision civilizues i historisë si disiplinë nuk u realizua plotësisht në përmbajtjen e librave shkollorë të historisë, të dy cikleve të para të studimit, gjatë periudhës së sistemit socialist. Kjo për faktin se partia-shtet synonte të përçonte

¹ Halil Matoshi, “30 vjet nga Pranvera ’81: Revolucioni”, www.gazetatema.net/web/?p=12923

² Vilson Kuri, Roland Gjini. *Bazat teorike dhe praktikat e të mësuarit të historisë*. Tiranë: SHBLU, 2008, f. 81

³ Fatos Lubonja, “Memoria dhe historia”, *Korrieri*, nr. 259, E enjte, 25 shtator 2007, f. 7

ideologjinë dhe politikën komuniste zyrtare nëpërmjet lëndës së historisë. Për rrjedhojë, edhe pasqyrimi i demonstratave të mars-prillit 1981, të organizuara nga populli shqiptar i Kosovës, iu nënshtroa këtij kriteri joshkencor.

Në regjimin komunist, tekstet shkollore të historisë u emërtuan “Histori e Shqipërisë” dhe jo “Histori e popullit shqiptar”, që u përdor pas viteve 1990, çka tregon së pari, hapësirën e kufizuar të paraqitjes së ngjarjeve të pranverës ’81, dhe së dyti, mënyrën e trajtimit të tyre në kuadër të politikës së jashtme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (RPSSH). Konkretisht, demonstratat e vitit 1981 përmenden në çështjen me titull “Politika e jashtme e RPSSH – politikë e drejtë, parimore, internacionaliste” tek mësimi numër 80, “Politika e jashtme e RPSSH”, në Kapitullin XVII “Ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste”.⁴

Në tematikën e mësipërme të teksteve të “Historisë së Shqipërisë” së dekadës së fundit të udhëheqjes komuniste, pasqyrimi i demonstratave të ’81-shit, të organizuara në KSA të Kosovës, është pjesë e shkëputur nga Raporti i Enver Hoxhës, i mbajtur gjatë zhvillimit të punimeve të Kongresit të 8-të të PPSH-së, më 1-7 nëntor 1981. Citoj: “Problemi i shqiptarëve që jetojnë në tokat e tyre në Jugosllavi nuk është problem i një “minoriteti”, të ardhur ose të vendosur dikur në një zonë të zbrazët, për çfarëdo arsyeje qoftë. Shqiptarët në Jugosllavi përbëjnë një popull të formuar në shekuj, që ka historinë, gjuhën, kulturën e vet, një popull autokton, të cilin e copëtuan dhe e shkëputën nga mëmëdheu i vet, Fuqitë e Mëdha imperialiste dhe ia aneksuan Jugosllavisë”.⁵ Përmbajtja me nota ideologjike dhe nacionaliste e fjalimit të liderit komunist “shembi murin e heshtjes” në qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj problemit të Kosovës. Për më tepër, udhëheqja shqiptare deklaroi se marrëdhëniet me RSFJ-së do të kushtëzoheshin nga trajtimi që do t’i bëhej popullit shqiptar të Kosovës dhe të viseve të tjera në Jugosllavi.

Elita politike shqiptare e legjitimoi valën e demonstratave, të mars-prillit të vitit 1981, me kushtet e rënda ekonomiko-shoqërore dhe mohimin kombëtar e shtypjen politike të shqiptarëve në Kosovë. “Kërkesat e punëtorëve, të studentëve, të mësuesve, të profesorëve dhe të të gjithë popullit të Kosovës ishin kërkesa ekonomike dhe politike. Ato ishin të ligjshme, brenda kushtetutës jugosllave. Të drejtat e shqiptarëve ishin shtypur dhe ishin marrë nëpër këmbë, vazhdonte diskriminimi ekonomik dhe politika nën petkun e vetadministrimit, gjë që në realitet siguronte administrimin dhe shfrytëzimin ekonomik e politik të Kosovës nga RS e Serbisë dhe republikat e tjera dhe jo nga vetë kosovarët.”⁶ Në këtë situatë pakënaqësie të përgjithshme shpërthyen lëvizjet popullore, politike e demokratike të pranverës së vitit 1981.

Qeveria e Shqipërisë i cilësoi të drejta dhe të ligjshme kërkesat e përsëritura të demonstruesve shqiptarë të Kosovës “që t’i jepej fund pabarazisë, diskriminimit

⁴ Kristo Frashëri, Stefanaq Pollo. *Historia e Shqipërisë: për shkollat e mesme*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1982, f. 270

⁵ Raporti i shokut Enver Hoxha. Kongresi i 8-të i Partisë së Punës së Shqipërisë, *Bashkimi*, nr.262, E hënë, 2 nëntor 1981, f.13 ose Kristo Frashëri, Stefanaq Pollo. *Historia e Shqipërisë: për shkollat e mesme*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1987, f. 268

⁶ Enver Hoxha. *Kosova është Shqipëri: nga ditari politik*. Tiranë: Neraida, 1999, f. 245-246

e shfrytëzimit ekonomik, politik e shoqëror, që Kosovës t'i jepej statusi i republikës brenda Federatës Jugosllave”.⁷ Mbështetja publike e shtetit shqiptar kishte rëndësi të madhe për pjesëmarrësit në kryengritje. Madje kishte edhe kuptimin e gatishmërisë për të rrezikuar. Vendimi i Tiranës për të hyrë në polemikë me shtetin jugosllav për fatin e Kosovës ishte inkurajim për të shkuar më tej në rrugën e rezistencës së shqiptarëve në ish-Jugosllavi.⁸

Në ngjarjet politike të mars-prillit 1981 mbizotëroi parulla “Kosova-Republikë”, e cila u përkrah me argumente historike, etnike dhe demografike nga Partia Komuniste në pushtet. Sipas saj, “popullsia shqiptare, e cila për nga numri zë vendin e tretë në Jugosllavi, duhet të gëzojë të gjitha të drejtat që gëzojnë dhe kombësitë e tjera në kuadrin e kushtetutës jugosllave. Shqiptarët në Jugosllavi vazhdimisht kanë kërkuar që gjendja e tyre kushtetuese, ekonomike dhe shoqërore-kulturore të ndreqej duke u vënë në një pozitë të barabartë me popujt e tjerë që hyjnë në përbërjen e Federatës Jugosllave”.⁹ Nga ana tjetër, udhëheqja komuniste shqiptare demaskoi politikën jo të drejtë e parimore të KQ të LKJ, që deklaronte se “Kosova nuk do të bëhet kurrë republikë”, pse një gjë e tillë nuk është në interesin e Serbisë, se, po të shpallet ajo republikë, “shkatërrohet Federata” etj.”¹⁰

Qeveria shqiptare e kohës mbajti një qëndrim të moderuar, duke mbështetur si zgjidhjen më të pranueshme politike krijimin e Republikës së Kosovës, në kuadër të Federatës Jugosllave. Referuar orientimit të Seksionit të Kosovës, të krijuar më 1978, pjesë e aparatit të Komitetit Qendror të PPSH-së, “i gjithë potenciali politik ishte përqendruar për realizimin e kërkesës “Kosova Republikë” dhe bënim gjithçka që kjo të kuptohej dhe materializohej. Ne bazoheshim në pikëpamjen që Jugosllavia Federative nuk mund të vazhdonte shumë gjatë si Federatë e bashkuar. Ajo do shpërbëhej, prandaj përpjekja jonë për të ndryshuar statusin e Kosovës nga krahinë autonome në një republikë të barabartë me të gjitha republikat e tjera jugosllave, ishte imediate.”¹¹

Me pozicionimin në favor të Kosovës-Republikë, shteti shqiptar nuk përkrahu as versionin e shkëputjes nga Federata dhe as atë të bashkimit kombëtar. “Shqipëria nuk ka bërë ndonjëherë rivendikime tokësore ndaj Jugosllavisë, asnjë kërkesë për rektifikim kufijsh nuk gjen në dokumentet tona.”¹² Kështu, qeveria socialiste mohonte çdo akuzë për ndërhyrje në punët e brendshme të Federatës Jugosllave. Por, ajo deklaroi se do të mbronte “deri në fund të drejtat që u takojnë vëllezërve tanë shqiptarë që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi, brenda ligjeve dhe normave ndërkombëtare”.¹³

⁷ K. Frashëri & S. Pollo, *vepër e përmendur*, 1982, f. 265

⁸ Shaban Sinani. *Kosova gjeopolitikë: studime, analizë politike, publicistikë, shkrime për ngjarjet në Kosovë prej fillimit të vitit 1998, me një vështrim retrospektiv (1981) dhe një tjetër perspektiv*. Tiranë: Didëro, 1998, f. 6

⁹ K. Frashëri & S. Pollo, *vepër e përmendur*, 1987, f. 268-269

¹⁰ E. Hoxha, *vepër e përmendur*, f. 227

¹¹ Agim Popoçi. “Shteti shqiptar nuk i organizoi demonstratat”, <http://www.zeri.info/artikulli/1/2/22064/shqiperia-nuk-i-organizoi-demonstratat/>

¹² Luan Dode. *Kosova në qëndrimet e Enver Hoxhës*. Tiranë: Medaur, 2006, f. 241

¹³ K. Frashëri & S. Pollo, *vepër e përmendur*, 1982, f. 264

Mirëpo, kërkesave të ligjshme të shqiptarëve të Kosovës “iu dha një grusht i rëndë e i përgjakshëm nga ana e shovinistëve serbomëdhenj të Beogradit dhe tani ndaj tyre po ushtrohet një terror i pashembullt, që ka si qëllim të shkombëtarizojë e të zhdukë popullsinë shqiptare në Jugosllavi”.¹⁴ Tirana zyrtare e dënoi politikën e dhunës dhe të gjenocidit të ndjekur nga autoritetet jugosllave. Sipas saj, “nuk është as në nderin dhe as në interesin e Jugosllavisë që të derdhen mbi Kosovë gjysma e policisë serbe dhe e milicisë së Beogradit, të armatosura deri në dhëmbë, të rrethojnë qytetet e Kosovës me tanke, të mbulojnë qiejt me avionë dhe të mbushin aerodromet me parashutistë. Çdo propozim, çdo kërkesë, çdo pretendim i drejtë i shqiptarëve, që jetojnë në Jugosllavi, por që nuk u pëlqejnë dhe u prishin rehatinë udhëheqjes federale dhe asaj krahinore, kualifikohen pa hezitim “armiçësore, shoviniste shqiptare, irredentiste”.¹⁵ Këto etiketime u përdorën me qëllimin e vetëm për të përligjur fushatën e terrorit ndaj demonstruesve shqiptarë.

Për sa trajtuam më sipër rezulton se, në tekstet shkollore të historisë në Shqipëri të viteve 1980, pasqyrimi i demonstratave të mars-prillit 1981 në Kosovë u përshkrua nga orientimi ideologjik i partisë në pushtet, që shërbente si instrument i propagandës politike. Megjithatë diskursi nacionalist dhe qëndrimi koniunktural, në mbështetje të kërkesës së ligjshme për Kosovën – Republikë, ridimensionoi politikën e jashtme të RPSSH-së kundrejt popullit shqiptar të Kosovës në ish-Jugosllavi.

Pas viteve '90, reforma arsimore në Shqipëri kishte për qëllim zhveshjen nga politizimi dhe ideologjizimi i teksteve shkollore të historisë dhe modifikimin e tyre në formë dhe në përmbajtje. Në to gjendja e shqiptarëve etnikë trajtohet në kapituj të veçantë, në përputhje me kriteret shkencore të shkrimit të historisë. Konkretisht, demonstratat e mars-prillit 1981 gjenden të integruara p.sh., në tekstin “Historia 9” për klasën e nëntë të shkollës 9-vjeçare, në Kreun XIII “Shqiptarët në Jugosllavi e botë pas Luftës së Dytë Botërore”, mësimi me titull “Rrënimi i autonomisë së Kosovës (1981-1990), në çështjen “Demonstratat masive në Kosovë në pranverë të vitit 1981”¹⁶; në librin “Historia e popullit shqiptar” për vitin e katërt të arsimit të mesëm të përgjithshëm, në Kreun XXII “Shqiptarët jashtë kufijve shtetërorë (1945-1990)”, me temë “Autonomia e Kosovës përballë shtetit jugosllav (1981-1990)”, në çështjen “Demonstratat e pranverës së vitit 1981”¹⁷; në tekstin “Historia e popullit shqiptar 12” për klasën e katërt të shkollës së mesme, në Kreun XXI “Shqipëria dhe viset e tjera shqiptare në vitet 1980”, në mësimin nr.21.3 “Rrënimi i autonomisë së Kosovës dhe kufizimi i të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni, në

¹⁴ *Ibid.*, f. 265

¹⁵ E.Hoxha, *vepër e përmendur*, f. 176

¹⁶ Myzafer Korkuti, Xhelal Xheçovi, Agron Gani. *Historia 9. Për klasën e nëntë të shkollës 9-vjeçare*. Tiranë: Morava, 2008, f. 199

¹⁷ Myzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli, Gazmend Shpuza, Fatmira Rama, Xhelal Gjeçovi, Dilaver Sadikaj, Ana Lalaj. *Historia e popullit shqiptar. Për klasën e katërt të shkollës së mesme të përgjithshme*. Tiranë: SHBLSH, 1999, f. 347

Malin e Zi dhe në Serbi”, çështja me titull “Demonstratat e shqiptarëve më 1981 dhe forcimi i represionit jugosllav”¹⁸ etj.

Demonstratat e mars-prillit 1981 përbëjnë një hallkë të rëndësishme në përpjekjet e vazhdueshme të popullit shqiptar të Kosovës për të fituar të drejtat kombëtare dhe politike në kuadër të Federatës Jugosllave. “Që nga gjysma e dytë e viteve ’60 dhe gjatë viteve ’70, shqiptarët e Kosovës në të gjitha rastet e mundshme i paraqitën hapur pushtetit kërkesën që t’u njihej statusi i kombit dhe i republikës. Jo vetëm për demonstratat e vitit 1968, por edhe në revoltat e viteve 1971, 1975 dhe 1979, ata, përmes kërkesës së përsëritur, dëshmuuan se nuk do t’i reshtnin përpjekjet për t’u pavarësuar nga Serbia. Demonstratat masive të pranverës së vitit 1981, të nisura fillimisht nga studentët, më 11 mars, në Prishtinë, dhe të vazhduara nga të gjithë shtresat e popullit shqiptar, ishin vazhdë e këtij procesi”.¹⁹ “Më 26 mars studentët organizuan në Prishtinë një demonstratë të re. Më 30 mars pati demonstratë edhe në Obiliq (Kastriot). Një nga demonstratat më masive është ajo që u organizua në Prishtinë më 1 prill, ku morën pjesë disa mijëra vetë nga të gjitha shtresat e popullsisë shqiptare. Sipas të dhënave zyrtare, gjatë kësaj demonstrate pati 9 qytetarë të vrarë dhe 15 të plagosur, ndërsa nga forcat e policisë serbe u vranë 2 veta dhe 17 u plagosën. ...më 2 prill në Prishtinë vazhduan tërë ditën demonstratat masive shqiptare. Po atë ditë demonstrata u organizuan edhe në Podujevë, në Gjilan, në Vushtrri (Vuçitërnë), në Lipjan, në Glllogovc, në Gjakovë etj., kurse më 3 prill në Ferizaj, në Viti, në Vushtrri e në Mitrovicë, më 30 prill në Deçan e në Istog. Në këtë vazhdë, më 18 maj 1981, rreth 1000 studentë demonstuan për një orë e gjysmë në Qendrën e Studentëve në Prishtinë”.²⁰

Siç prezantuam më sipër, në tekstet e historisë së ciklit shkollor 8-të e 9-të vjeçar dhe të arsimit të mesëm, demonstratat e pranverës së 81-shit në Kosovë janë paraqitur në mënyrë të detajuar në kohë dhe në hapësirë. Mbizotëron stili narrativ në vend të interpretimit të ngjarjeve dhe fakteve historike. Megjithatë respektohet parimi i historicizmit, që nënkupton zhvillimin e shoqërisë njerëzore në mënyrë kronologjike dhe konkrete.²¹ “Të respektosh kronologjinë, nuk mjafton thjesht ta trajtosh procesin sipas rrjedhës së tij historike, por duhen zbuluar dhe trajtuar edhe lidhjet ndërmjet tyre. Kurse të respektosh nocionin e kohës, do të thotë të kuptosh kompleksitetin e fakteve, të ngjarjeve, të fenomeneve dhe dukurive historike që janë vendosur në një kohë dhe në një hapësirë të caktuar”.²²

¹⁸ Beqir Meta, Muharrem Dezhgiu, Xhevair Lleshi. *Historia e popullit shqiptar 12: drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm*. Tiranë: Uegen, 2009, f. 6

¹⁹ Myzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli, Gazmend Shpuza, Fatmira Rama, Xhelal Gjeçovi, Marenglen Verli, Hamit Kaba. *Historia 4: profili natyror. Për klasën e 12-të të arsimit të mesëm të profilizuar*. Tiranë: Pegi, 2010, f. 181

²⁰ B. Meta, M. Dezhgiu & Xh. Lleshi, *vepër e përmendur*, f. 349

²¹ Qazim Xhelili. *Didaktika e historisë*. Tiranë: SHBLU, 2001, f. 29

²² Bektash Mema. *Njohuri për kërkimin shkencor në fushën e historisë*. Tiranë: SHBLU, 2005, f. 23

Në këtë kontekst i kushtohet vëmendje dikotomisë konceptuale komb dhe kombësi²³ për përcaktimin shqiptarëve të Kosovës në ish-Jugosllavi, fakt që kushtëzoi pamundësinë e konstituimit politiko-juridik të tyre. Dallimi midis kategorive “komb e kombësi nuk mund të jetë shkak i përhershëm për t’ua mohuar shqiptarëve të Kosovës veçoritë që i karakterizojnë si komb. Deri në vitin 1913 ata kanë pasur të njëjtin zhvillim historik gjatë shekujsh me bashkëkombasit e vet, që aktualisht konsiderohen komb në shtetin shqiptar. Kanë me ta të njëjtën ecure ekonomike e politike, konstitucion shpirtëror të njëjtë, një gjuhë, një kulturë, një histori, janë të vendosur në një territor kompakt e të dallueshëm nga ai i Serbisë, janë popullsi e konsiderueshme në numër, e shpesh më shumë se disa popuj që janë konstituar si shtet-komb. Pikërisht për këta shqiptarë e drejta e kombit gjatë gjithë këtij shekulli është mohuar. Ata janë konstituar si kombësi, sepse si kriter përcaktues në mënyrë të njëanshme është marrë raporti i tyre me pushtetin serb. Mirëpo, pavarësisht nga ky kriter në thelb politik, i përkohshëm, e vërteta mbi ekzistencën e një kombi të vetëm, por të ndarë shqiptarë”, është e pamohueshme.

Për t’i dhënë fund padrejtësive historike, shqiptarët e Kosovës sintetizuan kërkesat e tyre të drejta dhe legjitime në parullat e demonstratave, edhe të mars-prillit 1981, si: “Jemi shqiptarë e jo jugosllavë”, “Mjaft më me shfrytëzimin e Trepçës e të Obiliqit”, “Trepça punon. Beogradi ndërton”, “Kosova-kosovarëve”, ku dominonte parulla “Kosova-Republikë”.²⁵ Kjo e fundit përfaqësonte zgjidhjen më të arsyeshme për statusin e shqiptarëve të Kosovës brenda Federatës Jugosllave, dhe jo republikë të pavarur apo bashkim me Shqipërinë, si alternativën që nuk krijonte ndërlikime ndërkombëtare lidhur me kufijtë shtetërorë.²⁶ Por udhëheqësit serbë e shihnin të ardhmen e Federatës Jugosllave jo tek federalizmi i mëtejshëm i saj, jo tek liria e barazia e popujve e qytetarëve të saj, por tek dora e fortë e Serbisë e tek centralizmi. Sipas udhëheqësve serbë “Republika e Kosovës jo vetëm do të reduktonte kufijtë e Serbisë, por do të bëhej qendër tërheqjeje edhe për pjesët e tjera të Jugosllavisë të banuara nga shqiptarë, gjë që do të sillte çrregullime në ndarjet e brendshme të republikave jugosllave”.²⁷

Nisur nga kjo pikëpamje, lëvizjet popullore dhe demokratike të shqiptarëve, të vitit 1981, në Krahinën Autonome të Kosovës, iu nënshtuan regjimit ushtarak të

²³ Fehmi Agani. “Vështrim kritik lidhur me diskursin politik për Kosovën dhe shqiptarët”, *Ç’thonë dhe ç’kërkojnë kosovarët*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1989, f. 94

²⁴ Ana Lalaj. “E drejta e vetëvendosjes dhe shqiptarët e Kosovës” *Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike 30-2000*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2003, f. 25

²⁵ Muzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli, Gamend Shpuza, Fatmira Rama, Xhelal Gjeçovi, Ana Lalaj. *Historia 4: profili shoqëror, për klasën e 12-të të arsimit të mesëm të profilizuar*. Tiranë: Pegi, 2010, f. 297

²⁶ Ana Lalaj. *Kosova- rruga e gjatë drejt vetëvendosjes (1948-1981)*. Tiranë: “Mësonjëtorja e parë”, 2000, f. 389

²⁷ Ana Lalaj. “Kosova në dy dekadat e fundit të shekullit XX”, *Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave historike 28-29, 1998-1999*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2002, f. 21

autoriteteve jugosllave, që zbatuan “një inkuizicion të vërtetë juridik dhe policor”.²⁸ “Ndjekjet e shqiptarëve, arrestimet, dënimet, burgosjet etj., u vunë në rendin e ditës. Në një hark kohor 3-4 vjeçar, rreth 4 mijë persona, shumica të rinj, studentë dhe punonjës të arsimit, u dënuan nga gjyqe të posaçme me afate të gjata burgimi. ... Brenda 10 vjetëve, rreth 700 mijë shqiptarë kishin kaluar nëpër duart e organeve të policisë, mbi 100 mijë u dënuan për kundërvajtje politike, mbi 3500 morën dënime që shkonin në disa vjet burg, kurse 183 persona, ndër të cilët 16 të mitur, u vranë në raste të ndryshme. Në të njëjtën periudhë ishin dënuar edhe 1346 ushtarë shqiptarë, kurse 63 ushtarë u vranë nëpër kazerma, duke i paraqitur rastet si vetëvrasje”.²⁹

Përpos fushatës së dhunës dhe terrorit, filloi “procesi i diferencimit” që u shoqërua me një spastrim rrënjësor vertikal dhe horizontal në organizatat shoqëro-politike, në organet e administratës, në forumet përfaqësuese, në organizatat ekonomike, në mjetet e informacionit publik, institucionet shkencore etj. Me një larje të tillë hesapësh, të paparë që nga çlirimi i vendit e këtej, u shkatërrua e tërë struktura e kuadrove për t’u ngritur një e ashtuquajtur e re.³⁰ Procesi i diferencimit që vërtet nevojitej, një diferencim i kujdesshëm i shkaqeve të ndryshme politiko-ekonomiko-shoqërore të protestuesve, nuk u bë askurrë”.³¹

Diferencimi ideologjik e politik “synonte t’i vinte shqiptarët kundër njeri-tjetrit. U izoluan për një periudhë 1-3 mujore në qelitë e arrestit mbi 300 intelektualë të shquar. ... U ndërpre çdo marrëdhënie e Universitetit të Prishtinës me Universitetin e Tiranës. Tekstet e marra nga Shqipëria u hoqën nga përdorimi. Si në Kosovë, edhe në Maqedoni ndryshuan plan-programet mësimore. Në Maqedoni nxënësit e shkollave të mesme u detyruan të mësonin vetëm gjuhën maqedonase. Pedagogë dhe nxënës u pushuan nga puna dhe u përjashtuan nga shkolla.”³²

Organet e larta të Federatës Jugosllave i “shpallën luftë të hapur ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve”.³³ Universiteti i Prishtinës u quajt “kështjella e nacionalizmit shqiptar” dhe u kufizua numri i pranimit të studentëve të rinj.³⁴ Çdo kërkesë dhe lëvizje politike e kombëtare e shqiptarëve të Kosovës cilësohej si nacionalizëm dhe separatizëm shqiptar, përfshi këtu edhe të drejtën për t’u arsimuar në gjuhën amtare. “Ndërkaq nacionalizmi vetjak pajiset me letërnjoftimin e “së

²⁸ Dashamir Uruçi. *Kosova dhe e drejta e vetëvendosjes*. Shkodër: Shtjefni, 2001, f. 34

²⁹ M. Korkuti, P. Thëngjilli, G. Shpuza etj., *Historia 4: profili natyror ...*, f. 180-181

³⁰ Dr. Zekeria Cana. “Fshesa e çeliktë nuk kursen askënd”, *Ç’thonë dhe ç’kërkojnë kosovarët*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1989, f. 176

³¹ Noel Malcolm. *Kosova: një histori e shkurtër*. Prishtinë: Koha, 2001, f. 351

³² Myzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli, Gazmend Shpuza, Fatmira Rama, Xhelal Gjeçovi, Dilaver Sadikaj, Ana Lalaj. *Historia e popullit shqiptar. Për klasën e katërt të shkollës së mesme të përgjithshme*. Tiranë: SHBLSH, 2002, f. 337

³³ A. Lalaj, *Kosova- rruga e gjatë drejt ...*, f. 393

³⁴ Myzafer Korkuti, Petrika Thëngjilli, Gazmend Shpuza, Fatmira Rama, Xhelal Gjeçovi, Ajet Shahu, Ana Lalaj. *Historia e popullit shqiptar 8*. Tiranë: SHBLSH, 2002, f. 228

mirës së përgjithshme”, “të interesit të përgjithshëm” ose “të reagimit të arsyeshëm” ndaj nacionalizmit të të tjerëve, sidomos shqiptarëve”.³⁵

Në emër të çështjes kombëtare, një kontribut të rëndësishëm dha lëvizja ilegale, e cila lartësoi ndjenjat nacionale dhe organizoi veprimtarinë patriotike për realizimin e kërkesave të ligjshme të popullit shqiptar të Kosovës për liri, barazi dhe të drejtën e vetëvendosjes. “Sa i përket vlerësimit se të gjitha organizatat dhe grupet ilegale që vepronin në Kosovë në këtë periudhë kanë pasur orientime marksiste-leniniste, duhet të kihet parasysh rrethanat konkrete të kohës si dhe fakti se në Shqipëri sundonte një regjim i tillë. Andaj, këtyre organizatave në Kosovë u nevojitej një mbështetje e natyrshme në një aleat të qëndrueshëm e të pranueshëm. Sigurisht që po të mos kishin një orientim majtist ato do të rrezikonin për të mbetur pa përkrahjen e Shqipërisë së asaj kohe”.³⁶ Megjithatë orientimi ideologjik i ilegales nuk pengoi përpjekjet për përmbytjen e idealit për çlirim dhe bashkim kombëtar.

Konkretisht, “në vitet ’80 numri i grupeve dhe i organizatave ilegale, që vepronin në Kosovë dhe në emigracion, ishte mjaft i madh. Ndër to ishin: Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, Fronti për Republikën e Kosovës, Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi, Fronti i Kuq Popullor, Lëvizja për Çlirim Kombëtar të Kosovës etj. Veprimtarët e kësaj lëvizjeje ndiqeshin, burgoseshin dhe likuidoheshin nga UDB-ja jugosllave, si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Pjesëtarë të grupeve të ndryshme ilegale dënoheshin shpesh në Kosovë me burgime shumëvjeçare ose likuidoheshin fare. Një nga rastet më të rënda ka qenë ai i 17 janarit 1982, kur UDB-ja jugosllave vrau në Shtutgard të Gjermanisë 3 nga udhëheqësit kryesorë të lëvizjes ilegale shqiptare, vëllezërit Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zekën. Kurse 2 vjet më vonë, më 11 janar 1984, në Prishtinë ranë heroikisht duke luftuar me forca të mëdha ushtarake dhe policore, Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha. Më 1986 vdiq nga torturat çnjerëzore të UDB-së jugosllave Metush Krasniqi, simboli i qëndresës dhe i papërkulshmërisë shqiptare, kurse në vitin 1989, pas qëndresës së tyre heroike, u vranë në Prishtinë Afrim Zhitia dhe Fahri Fasliu”.³⁷

Një politikë e tillë gjenocidi fizik, kulturor dhe moral, e ndjekur nga “makina shtetërore jugosllave” preku çdo grupmoshë dhe shtresë të popullsisë shqiptare, në të gjitha fushat e jetës. Në RSFJ-së “filloi një propagandë e fuqishme e institucionalizuar për të vërtetuar se shqiptarët kishin trashëguar genet e së keqes, genet e njerëzve me karakter të dobët ose pa karakter.”³⁸ Kjo retorikë denigruese e autoriteteve jugosllave e serbe ndërpriste çdo “urë komunikimi” ndërnacional. Pasi, “qëndrimi injorues dhe nihilist ndaj një kombi tjetër, mohimi i vazhdueshëm,

³⁵ Zenun Çelaj. “Me pohime e dyshime nuk ngrihen ura”, *Ç’thonë dhe ç’kërkojnë kosovarët*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1989, f. 147

³⁶ Sabile Keçmezi – Basha. “Karakter i kombëtar i Lëvizjes ilegale shqiptare në Kosovë 1945-1990”, *1 Uluslararası Balkanlarda Tarih ve Kültür Kongresi, Bildiler Kitabı*, Prishtinë, maj 2009, f. 950

³⁷ B. Meta, M. Dezhgiu & Xh. Lleshi, *vepër e përmendur*, f. 350-351

³⁸ A. Lalaj, *Kosova- rruga e gjatë drejt ...*, f. 394

sistematik dhe në forma të ndryshme i tij, i qenies dhe identitetit historik, shoqëror dhe kulturor të tij është një anakronizëm. ...Problematizimi i vazhdueshëm dhe sistematik i së kaluarës dhe i së tashmes së tij, vënia në dyshim dhe rezervimi i përhershëm ndaj gjithçkaje që i përket dhe vjen prej tjetrit, sikur të vinte “ex partibus infideliam” [“nga tokat e të pabesëve” – E.L.], veshja atij e vullnetit dhe e qëllimeve të këqija, të gjitha këto përbëjnë një pengesë për njohjen e ndërsjellë, për kapërcimin e distancave ndërnacionale, për afrimin dhe bashkëpunimin”.³⁹

Por, hendeuku ndërnacional u thellua më tej me ligjërimin politik të pushtetarëve jugosllavë e serbë, që nuk kurseu as “dënimin e demonstratave si “armiqësore” e “reaksionare”, megjithëse shqiptarët kërkuan thjesht të drejtën e tyre për vetëvendosje, të drejtën për të qenë të barabartë me kombet e tjera të Federatës Jugosllave”.⁴⁰ Me qëllimin e vetëm për t’i paraqitur të padrejta dhe jo të ligjshme kërkesat e shqiptarëve për Kosovën-Republikë u intensifikua propaganda antishqiptare. Përdorimi i nocioneve “shqiptarizim”, “kundërrevolucion”, “genocid”, “armik”, ...për nga rëndësia e përhapjes dhe e përdorimit arbitrar të tyre ato ngjallin me sukses pasigurinë, frikën dhe urrejtjen të të gjitha kombësitë. Përcaktimi i gjendjes që mbështetet në këto nocione nuk është një përcaktim i thjeshtë, i përkrahur nga institucionet e fuqishme, ai është pjesë e procesit të krijimit të një atmosfere të caktuar politike dhe jetësore, të marrëdhënieve të caktuara që i karakterizojnë mosbesimi, frika dhe urrejtja. Brenda një kuadri të tillë politik likuidohen të gjitha përpjekjet për zhvillim në çdo sferë të jetës shoqërore”.⁴¹

Ky ishte objektivi kryesor i qarqeve serbe, të cilët i konsideronin lëvizjet popullore e demokratike të shqiptarëve të Kosovës një rrezik potencial për politikën e tyre centralizuese dhe të ardhmen e Federatës Jugosllave. Ata deklaruan se: “në pranverë të vitit 1981 popullit serb iu shpall një luftë civile e vërtetë speciale, e hapur dhe totale, e përgatitur në periudha të ndryshme administrative, politike dhe shtetërore-juridike. E zhvilluar me metoda dhe taktika të ndryshme të shkathëta, me role të ndarë, me një mbështetje jo vetëm pasive por edhe aktive dhe pak të maskuar të qendrave të veçanta politike brenda vendit - më dërmuese edhe nga ajo e ardhur nga fqinji - një luftë e hapur, e cila akoma edhe sot nuk shikohet drejt në sy dhe nuk quhet me emrin e saj të vërtetë”.⁴² Kjo retorikë politike i shërbente përligjjes së synimeve hegjemoniste të autoriteteve serbe në ish-Jugosllavi.

Ngjarjet politike të mars-prillit 1981 në Krahinën Autonome të Kosovës u shoqëruan me indiferencën e faktorit ndërkombëtar, qëndrim ky i kushtëzuar nga sistemi bipolar i ndarjes në blloqe ekonomike, politike e ushtarake dhe renditja e

³⁹ F. Agani, *artikull i përmendur*, f. 96

⁴⁰ M. Korkuti, P. Thëngjilli, G. Shpuza etj., *Historia e popullit shqiptar. Për klasën e katërt* ..., 1999, f. 337

⁴¹ Muhamedin Kullashi. “Kriza kosovare dhe kriza e Jugosllavisë”, *Ç’thonë dhe ç’kërkojnë kosovarët*, Tiranë: “8 Nëntori”, 1989, f. 62

⁴² Marenglen Verli. *Kosova – sfida shqiptare në historinë e një shekulli*. Tiranë: BotimPex, 2007, f. 336-337

RSFJ-së përkrah vendeve të paangazhuara në Luftën e Ftohtë. Nga ana tjetër, mbështetja e status-quos-së së Federatës Jugosllave shmangte çdo precedent për shpërthimin e konflikteve nacionale, që do të destabilizonin situatën në rajon. Në fakt, “reagimi i shqiptarëve në vitin 1981 pati jehonë jo të pakët edhe në Europë, e cila u vu në provë lidhur me respektimin e parimit të së drejtës së barazisë së vetëvendosjes së popujve e kombeve”⁴³. Por, në atë kohë, shtetet evropiane e shihnin Jugosllavinë si zonë të ekuilibrit të interesave ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit dhe nuk pranonin asnjë ndryshim që mund ta rrezikonte këtë ekuilibër.⁴⁴

Për Perëndimin Jugosllavia ishte zonë e erozionit të ndikimit rus, kurse për Lindjen ishte një model i socializmit human në botë. Të dyja palët preferonin të kishin një shtet jugosllav të vetëm dhe të mos hapnin dritën jeshile për lëvizjet e tjera kombëtare jo vetëm në Jugosllavi, por edhe në Ballkan dhe në Evropë. Prandaj, shtetet evropiane e injoruan me mospërfillje çështjen e Kosovës.⁴⁵

Me gjithë indiferencën e faktorit ndërkombëtar, demonstratat e mars-prillit të vitit 1981 në Kosovë sensibilizuan mbarë opinionin se federalizmi jugosllav kishte dështuar në zgjidhjen e çështjes nacionale. Në këtë kontekst, lëvizjet popullore, politike e demokratike të shqiptarëve të Kosovës synonin të institucionalizonin kërkesat e tyre të drejta dhe të ligjshme, për të siguruar një pozitë të barabartë dhe status të njëjtë me kombet e tjera në kuadër të RSFJ-së. Ngjarjet e pranverës së vitit 1981 shënuan një etapë të rëndësishme në realizimin e idealit për liri dhe pavarësi kombëtare, të kurorëzuar më 17 shkurt 2008.

Për sa i përket respektimit të kriterëve shkencorë, në përmbajtjen e teksteve shkollore të “Historisë së Shqipërisë”, të periudhës së sistemit socialist, vërehet “monizmi metodologjik”, që nuk e percepton historinë si rezultante shumëfaktoriale, por si mjet indoktrinimi në përputhje me vijën ideologjike në pushtet. Për rrjedhojë, këtyre teksteve u mungon objektiviteti shkencor. Ndërsa, librat mësimorë të “Historisë së popullit shqiptar”, të pas viteve ’90, karakterizohen nga përzgjedhja e metodës së duhur historike, që “nënkupton një sistem procedurash të sakta për të përfutur të vërtetën historike”.⁴⁶ Rëndësi të veçantë mbart përdorimi i një gjuhe të përshtatshme me terminologjinë përkatëse të momentit historik.

Përfundime

Demonstratat e pranverës së vitit 1981 shënojnë një moment të rëndësishëm historik dhe politik për shqiptarët e Kosovës, të cilët kërkuar garantimin e statusit të kombit dhe të republikës brenda Federatës Jugosllave. Këto zhvillime u pasqyruan në tekstet e historisë së ciklit shkollor 8-të dhe 9-të vjeçar dhe të arsimit të mesëm të përgjithshëm në Shqipëri.

⁴³ Marenglen Verli. “Demonstratat e ’81-shit”, *Shenja*, mars-prill 2011, f. 62

⁴⁴ M. Korkuti, P. Thëngjilli, G. Shpuza etj., *Historia 4: profili shoqëror, për klasën e 12-të*, 2010, f. 297

⁴⁵ Ana Lalaj. “E drejta e vetëvendosjes ...”, f. 29

⁴⁶ Ilira Çausli. *Metodologjia e historisë*. Tiranë: SHBLU, 2003, f. 86

Konkretisht, në librat e “Historisë së Shqipërisë” të dekadës së fundit të sistemit socialist, demonstratat e mars-prillit 1981 në Kosovë trajtohen në kuadër të politikës së jashtme të RPSSH-së, të shkëputura nga ligjërimi politik i udhëheqësit Enver Hoxha, të mbajtur gjatë Kongresit të 8-të të PPSH-së. Në të prezantohet qëndrimi zyrtar i shtetit shqiptar në mbështetje të kërkesave të drejta e të ligjshme të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, veçanërisht për Kosovën-Republikë, në përputhje me orientimin ideologjik të partisë-shtet.

Ndërsa, në tekstet e “Historisë së popullit shqiptar”, të periudhës së pas viteve 1990, ngjarjet politike të pranverës së 81-shit paraqiten në tërësinë e aktorëve dhe faktorëve, pjesëmarrës aktiv ose pasiv, të brendshëm apo të jashtëm, që përkrahën statusin e Republikës për Kosovën në Federatën Jugosllave.

Demonstratat e mars-prillit të vitit 1981 shënuan një kthesë vendimtare në luftën për liri të popullit shqiptar të Kosovës, që u kurorëzua me shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008. Fakt që dikton trajtimin me objektivitet shkencor të këtyre ngjarjeve, pasi lënda e historisë në kurrikulën shkollore synon që e kaluara të kuptohet në funksion të së sotmes, dijet historike të shërbejnë për të përgatitur qytetarin e ardhshëm si pjesëtar aktiv i shoqërisë demokratike.

SADIK V. KRASNIQI

ÇËSHTJE NGA TRASHËGIMIA MUZEORE DHE FUSHA E MUZEOLOGJISË

Fjalët muze, muzeor, muzeografi dhe muzeologji janë shprehje (terma) që i hasim më së shumti në fushën e trashëgimisë muzeore (muzeologjisë). Fjala muze është institucion që mbledh, ruan dhe paraqet (në ekspozita e krijime të ndryshme të artit e të teknikës) sende, objekte e materiale me vlerë historike e shkencore për qëllime mësimi e studimi. Muzeu mund të jetë i profileve të ndryshëm si: (historik, arkeologjik, etnografik, botanik, zoologjik, gjeologjik, etj), muzeu në rang qendror muzeu i qytetit, fshatit, shtëpi, dhomë, etj. Ndërkaq fjala muzeor lidhet me muzeun, që i përket muzeut dhe që ruhet për vlerën historike e shkencore që shërben si muze. Në këtë kuadër hyjnë fjalët dokumente, materiale, objekte muzeore, gjithashtu specifikon emërtimet si: kënd muzeor, institucion muzeor, pikë muzeore. Fjala muzë që në mitologjinë greke paraqet nëntë hyjneshat, bijat e Zeusit, përkrahnin degë të ndryshme të artit dhe të shkencës. Muzat ishin perëndeshat dhe mbrojtëset e të mësuarit të shkathtësive artistike në poezi, muzikë, komedi dhe tragjedi.¹ Fjala *museum* është me origjinë nga greqishtja – *museion* apo nga latinishtja *museum*. Tek popujt e vjetër ilir, romak dhe grek ishte vendi-tempulli i dedikuar muzeve. Nga periudha e Rilindjes është vendi ku ruhet thesari i koleksioneve (objekteve), lëndëve historike, artistike, etnografike, teknike, etj. Gjatë periudhës së Rilindjes nëpër këto vende u ruajtën libra të ndryshëm, revista shkencore, buletine, etj. Fjala muzeografi rrjedh nga gjuha greke – *museion- grafia* që në shqip ka kuptimin përshkrim ose të përshkruarit e thesarit historik, artistik, natyror dhe riteve të tyre. Dhe fjala muzeologji e cila rrjedh nga gjuha greke *museion-logia*, që në gjuhën shqipe ka kuptimin e të folurit, aftësia e të menduarit, mendja dhe të perceptuarit, është shkenca apo udhëzimi që shërben për ndërlidhjen dhe mirëmbajtjen e thesarit artistik dhe të historisë së natyrës.²

Substanca e trashëgimisë muzeore qëndron në varësi të plotë nga botëkuptimet e qëllimeve të vetëkzistimit të muzeve. Muzetë paraqesin botëkuptime shumë të vlefshme për të kaluarën dhe krijimtarinë materiale e shpirtërore të njerëzve. Muzetë janë dëshmia më e mirë dhe më bindëse që e ruan kontinuitetin e njerëzimit. Karakteri thelbësor i tyre është përpjekja (rezistenca)

¹ Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë & Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, “Fjalor i gjuhës së

sotme Shqipe”, Tiranë, 1980, f. 1190.

² Dr. Fejz Drançolli, Prof. në UP, Ligjëratë e mbajtur në lëndën e Muzeologjisë, më 24.03. 2010, Prishtinë

kundër shkatërrimit, kundër zhbërjes së trashëgimisë muzeore, sepse me studimin, grumbullimin, ruajtjen, prezantimin dhe publikimin e tyre, ruhen dhe trashëgohen nga një kohë në tjetrën (nga një gjeneratë në tjetrën) vlerat materiale dhe shpirtërore të civilizimit njerëzor, botëror që nga lashtësia e deri më sot dhe vijon edhe në të ardhmen.

Konceptet e gabuara mbi muzetë dhe Muzeologjinë në përgjithësi vijnë në shprehje për shkak se qëllimi i Muzeologjisë nuk është vetëm Muzeu, ai është vetëm mjet për arritjen e principeve dhe metodës së re rreth gjetjes dhe ruajtjes së lëndës muzeore. Muzetë grumbullojnë eksponate të lëvizshme që për shkaqe të ndryshme praktike dhe me qëllim të mbrojtjes së tyre duhet të ndërrojnë mjedisin e mëhershëm.

Për dallim prej atyre statike të palëvizshme që nuk e ndërrojnë vendin e mëparshëm. Në këtë veprimtari ekziston një numër i madh i detyrave praktike, por realizimet dhe afrimet në punën muzeore janë të natyrës teorike dhe të interpretimit shkencor.³

Fusha e trashëgimisë muzeore (muzeologjisë) për objekt studimi dhe prezantimi e ka eksponatin (objektin), i cili mund të ketë domethënie të ndryshme me karakter nga shoqëria dhe natyra. Objekti muzeor është dokument i karakterit specifik, objekt i njohjes, objekt studimi dhe nga ky kontekst valorizohet vlera thelbësore e tij. Objektin muzeor apo eksponatin duhet ti kushtohet vëmendje e theksuar për shkak se ai është determinanca kryesore që e kushtëzon gjithë strukturën e metodologjisë së punëve në muze. Gjithashtu ngërthen një varg detyrash që lidhen me qëndrimin ndaj eksponatit muzeor si dëshmi. Kërkimi, studimi, ruajtja dhe prezantimi i këtyre dëshmive autentike konsiderohet dokument shkencor i këtij procesi.⁴

Zhvillimi i idesë për lindjen e muzeut u paraqit shumë herët që në mileniumin e dytë para Krishtit në vendin e quajtur Larsa të Mesopotamisë. Që në atë kohë në këtë vend u reprodukuan kopje të mbishkrimeve që përdoreshin nëpër shkollat e atëhershme për qëllime edukative. Shënimet arkeologjike prej shekullit të VI para Krishtit na çojnë tek të dhënat se mbretërit si Nebuchadrezzar dhe Nabonidus kishin koleksionuar antikitetë duke krijuar dhoma të tëra me muzealitete. Këta shembuj ndryshe konsideroheshin “Muze”. Dhuratat e kushtëzuara të vendosura në tempuj që në raste të shpeshta ishin thesare, ishin të hapura për publikun. Në to përfshiheshin kuriozitete natyrore, vepra arti dhe gjëra ekzotike të sjella nga viset e largëta të perandorisë. Këto mjete të mbledhura kontrolloheshin nga autoritetet religjioze.⁵ Ndërrimi i periudhave historike dhe personaliteteve të saj në vendet orientale çuan drejt koleksionimit të objekteve

³ Po aty

⁴ Antun Bauer, Muzeologija, nastupno predavanje za kolegij Muzeologije na postdiplomskom studiju, Muzeologija 6, Zagreb, 1967, f. 13

⁵ Geoffry Lewis, Kryetar i Komitetit për etikë në ICOM, “Roli i muzeve dhe kodeve etike profesionale”,

Running a Museum: A Practical Handbook, 2004, ICOM, f. 1

muzeale. Ndërkaq, në Evropën mesdhetare koleksionet krijoheshin nga kisha dhe pushteti mbretëror. Në shek. XVII në Evropë u shqua koleksioni i familjes Medici nga Florenca, që iu la trashëgim shtetit në vitin 1743. Koleksione mbretërore dhe fisnike u mblodhën në shumë vende evropiane. Në shekujt XVII-XVIII u rrit interesimi edhe më shumë për njerëzimin, përkatësisht për historinë e natyrës, prandaj u krijuan shumë koleksione të specializuara nga intelektualët e kohës. Kjo ishte koha kur u zhvilluan shoqëritë e para shkencore. Ndër koleksionet më të njohura të kësaj kohe ishin: Academia del Cimento në Florencë (1657), Royal Society of London (1660) dhe Academic des Sciences në Paris (1666). Koleksionet gjatë kësaj kohe i radhitën koleksionet e tyre mbi bazën e klasifikimeve sistematike për botën natyrore dhe artificiale.

Kjo tregon edhe shpirtin e sistemit, kërkimin racional dhe përqsasjen enciklopedike ndaj diturisë që po përhapej në gjithë Evropën. Muzetë kudo që janë, kujdesen për pasurinë kulturore në botë dhe për interpretimin e saj te publiku. Kjo pasuri nuk është e zakonshme, por ka një statut special në ligjet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Thesaret e pasurisë kulturore dhe natyrore janë gjithashtu komponente vendimtare në definimin e identitetit kulturor kombëtar dhe ndërkombëtar. Koleksionimi i muzealeve bëhet për arsye se ato kanë lidhje direkte me individët apo me kolektivin që nga antikiteti i lashtë.⁶

Pavarësisht nga lëmi i koleksionimit, si koleksioni i mineraleve, koleksioni i veprave të artit, koleksioni i gjuetisë, koleksioni i llojeve të ndryshme të objekteve, koleksioni i numizmatikës, e deri tek koleksionet e relikteve historike dhe dokumentare që lidhen me një lokalitet të caktuar, janë mbledhur dhe mblidhen nga koleksionues të ndryshëm të cilët mendojnë se çdo objekt i në atë koleksion është subjekt në vete, apo objekt për plotësimin e tërësisë së një koleksioni. Shumë nga muzetë ekzistues janë krijuar nga koleksione të tilla. Këto koleksione janë krijuar si rezultat i aktiviteteve dhe pasioneve të individëve të caktuar. Në disa raste kur koleksioni nuk ka përmbajtje të bazuar mbi ndonjë plan, temë apo sistem të caktuar, ndodh që ende të mos quhet koleksion muzeor.⁷ Nga ana tjetër, vështruar nga aspekti i muzeologjisë bashkëkohore, nocioni i koleksionit muzeor duhet të jetë i përqendruar në një tematikë të caktuar të muzeve përkatës i cili duhet të mblidhet sipas një plani dhe qëllimi të caktuar, që konsiston në funksion të muzeut dhe koleksionit. Puna kërkimore në terren duhet t'i paraprijë planit sistematik në plotësimin e një koleksioni muzeor. Tashmë është e qartë se nevojat që kanë rrjedhur nga vetë koleksionet kanë qenë shkas për zhvillimin e konceptit për muzetë që në esencë nënkupton muzeun bashkëkohor, i cili sot i ka të standardizuara parimet dhe mënyrat e punës dhe të veprimtarisë së vet. Niveli i koleksionimit sot, nëpër muzetë qendrorë dhe lokalë, e kanë tejkaluar periudhën kritike të zhvillimit dhe janë ngritur në një rang (standard) më të lartë të aspekteve profesionale. Shumë objekte e koleksione me vlera të mëdha bazike në botë janë mbledhur, por asnjëherë nuk duhet ta konsiderojmë si punë të kryer, ngase me

⁶ Po aty

⁷ Antun Bauer, vep. e cit., f. 14

rrjedhat dhe me zhvillimet që ndodhin nëpër fusha interdisiplinare çojnë drejt plotësismit, zhvillimit dhe hapjes të muzeve të rinj. Me fjalë të tjera, muzetë duhet t'i kemi çdokund ku zhvillohet jeta bashkëkohore dhe të ecim në hap me zhvillimin e muzeologjisë moderne botërore.⁸

Në shumë qarqe të botës sot dominon mendimi se në historinë e muzeve, shek. XX është “shekulli i muzeve”. Nëse i hedhim një sy zhvillimit historik të muzeve, shohim se në gjysmën e parë të shek. XX edhe përkundër zhvillimit të dy luftërave të tmerrshme, janë krijuar shumë muze në krahasim me gjithë periudhën e disa shekujve më parë. Ky realitet ka shtruar nevojën për përshpejtimin e punëve në muze dhe studim teorik dhe praktik të një varg çështjesh që kanë të bëjnë me veprimtarinë e këtyre institucioneve.

Gjeneza e muzeut bashkëkohor ka kaluar nëpër disa epoka të zhvillimit siç janë: koleksioni i vlerave dhe kujtimeve, thesari i vlerave, koleksion i kurioziteteve dhe i galerive, koleksion i antikiteteve të vlefshme, koleksione shkencore për degë të caktuara të artit, shkencës dhe natyrës, koleksione historike për lëmenj dhe lokalitete të caktuara e kështu me radhë deri te muzetë e konceptuar të tipit bashkëkohor që paraqesin qendrat specifike dokumentare për fushëveprimin e tyre në lëmenj të caktuar, në periudhë kohore të caktuar, në rajon të caktuar gjeografik apo të një lokaliteti. Në rend të parë Muzeu është institucion i cili ruan thesarin kulturor që ka për detyrë hulumtimin shkencor të koleksioneve të lëmit të veprimtarisë së vet dhe në mënyrë permanente luan rolin e institucionit kulturor, edukativ dhe arsimor. Njëra nga detyrat më kryesore është koleksionimi. Pika kyçe dhe fillestare që kushtëzon ekzistencën e Muzeut është përqendruar në koleksionimin muzeor, në dokumentacionin me objekte muzeore. Në këtë kuadër edhe ekspozitat muzeore ndërlidhen me këtë detyrë parësore. Ligjet për muzetë në shkallë vendi dhe ndërkombëtar (me ndonjë ndryshim të vogël) parasheh si detyrë kryesore dhe thelbësore të muzeve “grumbullimin, ruajtjen, sistemimin, përpunimin shkencor, studimin dhe ekspozimin e materialeve muzeore (objekteve) të rëndësishme për shkencën, kulturën dhe arsimin. Kjo detyrë kryesore determinon edhe të gjitha detyrat tjera që i kryen një muze përkatës. Muzetë në vijimësi duhet të mbledhin materialet muzeore mbi bazën e një projekti sistematik të studiuar dhe të përpunuar mirë.

Koleksioni muzeor arrin vlerën shkencore dhe konsiderohet i plotë vetëm atëherë kur është i kompletuar dokumentacioni adekuat që shërben si garanci për ekzistencën e tij. Ruajtja e koleksionit përfshin edhe sigurimin e dokumentacionit profesional dhe juridik. Dhe vetëm kështu çdo objekti ia ruajmë vlerën e tij historike dhe burimore në mënyrë që objekti përkatës të mbetet dëshmi e çmueshme për tematikën e vet.⁹ Inventari muzeor profesional që përmban të gjitha të dhënat profesionale e shkencore për çdo eksponat në muze është kruciale për ruajtjen e koleksionit të një muzeu. Me mbrojtjen e objekteve muzeore ndërlidhen edhe një varg çështjesh të tjera si hapësira, restaurimi, konservimi, dizenfektimi, dizenklimi laboratorik, teknik, klimatik, elektrik, etj. Sistemimi i koleksioneve

⁸ Po aty

⁹ Po aty, f.6-15

muzeore në depo, studimi i tyre dhe hapja (aranzhimi) e ekspozitave janë detyra shumë të rëndësishme që kërkojnë angazhim profesional në Muze. Kartotekat në Muze janë probleme akute që lidhen me rregullimin e koleksioneve muzeore, të cilat edhe kur marrin zgjidhje prapëseprapë në parim gjithnjë mbeten ta papërfunduara ngase për çdoherë duhet përsosur edhe më shumë.¹⁰ Duke filluar që nga plani ideor e deri te vendosja e objekteve nëpër salla ekspozimi, renditen një varg problemesh të cilat përpiqen t'i zgjidhin muzetë qendrorë dhe lokalë në përputhje të plotë me parimet dhe kriteret e muzeologjisë bashkëkohore. Së këndejmi e tërë gama e punëve në Muze që nga nocioni i hapësirës për ekspozita të përhershme në Muze, nocioni i ekspozitave tematike muzeore, lidhur me këto nocioni i katalogut muzeor, i katalogut të ekspozateve, e deri te nocioni i publikimeve janë problem që duhet zgjidhur profesionalisht, në mënyrë që të arrihen rezultate që janë në përputhje me rolin e Muzeut si institucion.¹¹

Në lidhje me rolin dhe detyrat profesionale që kryhen në Muze gjithandej organizohen konferenca të ndryshme në vend, rajon dhe në botë, të cilat kanë për qëllim trajtimin profesional e shkencor të çështjeve muzeore. Një kontribut të madh në këtë drejtim ka dhënë dhe po e jep edhe ICOM (International Council of Museum), e cila veç të tjerash po përpiket që të gjitha çështjet me karakter nga muzeologjia t'i zhvillojë, t'i avancojë dhe t'i ngrejë në standardet më të larta që kërkon kjo fushë.¹²

Mungesa e literaturës profesionale e kuadrit profesional dhe mungesa e përvojës nga muzetë e shteteve më të avancuara e pengon punën në muzetë tona të cilët zhvillohen shumë ngadalë. Nisur nga këto analiza konstatojmë se në fushën e muzeologjisë në krahasim me vendet tjera ne jemi mbrapa, kjo vlen sidomos për muzetë lokalë të cilët shpesh në mungesë të profesionalizmit nuk dinë si të punojnë. Prandaj është nevojë emergjente që muzetë qendrorë të ofrojnë ndihmë profesionale muzeve rajonale, komunale, të fshatit, shtëpive përkujtimore, etj. Kjo ngecje në fushën e muzeologjisë vjen nga vetë fakti se tradita e muzeve tona nuk kanë jetë të gjatë. Të gjithë muzetë tona e kanë gjenezën në vitet e 50-ta pas Luftës së Dytë Botërore, por edhe pse të vonshëm iu nënshtruan një izolimi në të cilët shumë pak mbledhje, ruhej dhe ekspozohej kultura dhe historia e popullit të Kosovës. Ndërkaq, në vitin 1999, pas përfundimit të luftës në Kosovë, në rrethana të reja çlirimi u përshpejtua dinamika e punës muzeore dhe u hapën një varg muzesh kryesisht lokalë (komunalë). Po që se e bëjmë një kalkulim del se muzetë në Kosovë praktikisht ekzistojnë që 60 vjet. Ky është edhe faktori kryesor që zhvillimi i muzeve është në nivele të ulëta.¹³ Andaj konsiderojmë se ndër detyrat themelore dhe aktuale të muzeologjisë sot është t'i përcaktojë qartë strategjinë e

¹⁰ Të dhëna nga raportet vjetore të punës profesionale në Muzeun e Kosovës

¹¹ Po aty

¹² [www.icom.org/http://icom.museum/resources/publications-database/ Key Concepts of Museology](http://www.icom.org/http://icom.museum/resources/publications-database/Key%20Concepts%20of%20Museology),

(parë për herë të fundit me 15.06.2012)

¹³ Sadik Krasniqi, Muzeologjia si disiplinë, botuar në gazetën mujore "Çlirimi", me 15.04.2002, Prishtinë

politikave zhvillimore (në radhë të parë nga institucionet shtetërore dhe nga kuadri profesional) dhe t'i orientojë muzetë tanë në drejtimin e duhur, në mënyrë që këta muze të bëhen bashkëkohorë, kështu që të jenë në gjendje ta kryejnë funksionin e vet ashtu si e kërkon shoqëria.¹⁴

¹⁴ Po aty

ETNOKULTURĚ

BUKURIE MUSTAFA

MBI DISA LEKSEMA POPULLORE ARTIZANALE

Shoqëria shqiptare gjithandej është zhvilluar njëlloj në aspekt të mendësisë që diktohen nga marrëdhëniet e raportet brenda familjes, e cila detyrimisht është reflektuar në dallimet gjuhësore, të cilat lidhen me mënyrën e jetesës dhe të veprimit duke formuar kështu leksematikën profesionale. Në këtë hierarki shoqërore, ndarja e punëve në të gruas e të burrit, ka ndikuar në të krijuarit e leksikut të veçantë të së folmes e përqendruar në një temë e fushë të caktuar veprimi dhe në të ashtuquajturit gjuhë e grave. Kështu, *gjuha e grave*, si ligjërim i dalluar e i veçantë ka të bëjë drejtpërsëdrejti me jetën dhe punën e tyre, duke mos kaluar përkufizimin lokal të përdorimit, e cila reflektohet në shtresimin gjuhësor¹. Fjalori dhe gjuha e saj lidhet ngushtë me sektorë terminologjikë, ku përfshihen leksema që kanë të bëjnë me punë të caktuara e që i kryejnë vetëm gratë, duke i cilësuar shpeshherë si punë grash. Këtu bëhet fjalë për leksema që përfshihen në të a.q. *punë dore*, në krijimin e veshjeve popullore, ku vjen në shprehje profesionalizmi artistik e ndjesia estetike, e cila dikur ka pasur edhe dimensionin magjik e besëtytnor. Si të këtilla, ato u takojnë leksikografisë e terminologjisë popullore mjaft të hershme, kur gratë kanë punuar vetë veshjen dhe komunikimi është zhvilluar brenda një rrethi të përkufizuar gjuhësor. Këto janë të lidhura me veprimin e krijimit të veshjes dhe të zbulimit të tyre, duke krijuar emërtime si *zanatlije*, *zanatçore* për grua, e cila e punon veshjen dhe është mjeshtre në ushtrimin e këtij zanati.

Pjesët e veshjes dhe emërtimet kanë krijuar fjalor etnografik të pasur të njohur brenda një areali jo vetëm gjuhësor, por edhe të ligjërit të veçantë të grave të grave². Kështu, emërtime të ndryshme të gjërave të punuara në dorë, modele etj., ka kaluar në një formë komunikimi dhe shprehje ekskluzive të gjuhës së grave dhe të sferës leksikore terminologjike apo të profesionalizmave. Këto

¹ “Në të gjitha krahinat shqiptare, në qytete dhe veçanërisht nëpër katunde, ndarja tradicionale e punës ka qenë njëherësh edhe një farë ndarjeje shoqërore e të folurit, e mënyrave të shprehjes, e pasurisë më të madhe (përkatësisht më të vogël) të një sfare terminologjike ndaj një tjetre edhe sipas seksit”. Gj. Shkurtaj, Sociolingustikë e shqipes, Tiranë, 2009, f. 365.

² Në një intervistë dhe përpjekje për të mbledhur sa më shumë të dhëna për veshjen popullore, burrat kishin informacione, por pa hyrë në hollësira të punimit, duke thënë se këto punë i dinë më mirë gratë: “*kta sën i bonje sikush. Kta ma mir e japin fjalën grat n'katund*”. Istref Beqirin (1928, f. Patishkë). Intervist e relizuar më 15.1.2012.

emërtime dalin si sajesa të vetë grave, për të vendosur lidhjen mes sendit dhe kuptimit, formës dhe përmbajtjes dhe si të këtilla përbëjnë një fond të veçantë leksikor, të mbështetur në një traditë të lidhur ngushtë me të folmen popullore. Kështu, gratë e fshatit Patishka Rekë e kanë lehtë të të kuptojnë se për çfarë lloj punimi a modeli bëhet fjalë kur përmendin emërtimet si: *çul Kate, çula dhëndorsh, çorap pallash* etj.

Mënyrat se si formohen këto emërtime është e kuptueshme se e japin vetë gratë në komunikimin dhe marrëveshjen e tyre dhe zakonisht emri personal i një gruaje apo i thirrjes sipas emrit të burrit bëhet emërtim i njohur i një punimi a një modeli të caktuar, që përdoret në tërë fshatin; kështu p.sh. *irneki Saficës, irneki Jusuficës*, janë të kuptueshme për gjithë gratë e f. Cërnivor, ashtu si: *çul Kate, çuli i Nifes, çuli i Nuravicës* janë modele të njohura çorapësh të grave të Patishka Rekës. Sidomos, punimi i çorapeve dhe ai i shijeve estetike e kreative të grave, vjen në shprehje në shumëllojshmërinë e modeleve dhe motiveve, që reflektohet me nevojën e emërtimeve të ndryshme, si: *yrnek mojsevec, skepavec, skepavec me kryq, skepavec me pikë, pendurush, maxhir, nez, çorap me tri kollca* etj. (të gjitha këto emërtime janë nga Patishka).

Këto shpesh udhëhiqen nga aftësia e ndërlidhjes dhe e asociacionit, por edhe të tendencës të kërkimit të ngjashmërisë të një tipari nga i cili dalin emërtime artizanale dhe motive flore a faune, si p.sh. *komë pule, kariz (kurriz) peshku, skutaçja gjylipemta me tela, kmish e sharitun me lule dhe kmish e sharitun me trandafila; baçarka me lul, baçark me trendafila; vestulka me duda (rrethi i baçarkës), kallani me roza me bgjer (i gjerë), kallani me lule, kallani me trandafila; çulka me lul, skepka me roza* etj. Apo emërtime që nuk gjejnë kuptim në realitet, por janë të mbështetura në elemente besëtytnore a mitologjike, si p.sh.: *(brekë) me një sy, me tre sy, kryeshtrebun*, apo motive tjera, si: *kalaç, stomavec, baçark me bajrak çulka me sheqerka çulk pallash, çulka t'pçetna* etj. Punimet përbëhen nga detaje, të cilat po ashtu vendosen në gjuhë specifike, si: *thiksa* – e punuar me *koka e resavicë; paftalie* (punimi në formë rombi te përparëset e veshjeve të f. Çiflik), por edhe *kitka, grdelka, gajtani, tentene, zavojka, shiraze* (shirita të ngushtë me vija të lakuara), *shami/korpa me oja me çoshe, oja me gajtan, oja me pçyska, ojat me netlla, oja me kuklla; me parveshka* (monedha të vogla argjendi); *zemra* (sumbulla, të punuara me pe argjendi dhe pulla në formë zemre); *rryp me zemra, rryp me kollca; punimi hajmali, punimi vestulkë* etj.

Kreativiteti i grave për emërtimet e punimeve të tyre është i theksuar. Kështu, sipas modelit të veçantë të punimit të pjesëve të caktuara të veshjes, dalin edhe emërtimet si: *brekë stomevecë, fjetavec* (brekë nusesh me punime lulesh), *kmajsha katliqe; kmish me skepa; kmajsha e jelekit; kmojsha tjetërsoj, yrneku bisht ballone* (prerja e këmishës në veshje nusesh të Strugës); apo emërtime sipas materialit punues: *brjek atllasi, brjek tjeli, skutaçja me vija teli, çorapet me sormë/pa sorm/sërma, çulka me gajtan, çulka me tel, anteri selimie (sërmi), anteri pa burma, anteri me burma* etj. Në këto veshje, po ashtu theksohet ngjyra, e cila bëhet pjesë e emërtimeve, si: *skutaçe me teli verdh dhe skutaçe me teli bardh, brez i sharitun, shami/korpa t'sharitna* etj. Po ngjyra është ajo që dallon modelet e shumëllojshmërinë e pjesëve të ndryshme të veshjes, sipas të cilave marrin edhe

emrat, siç janë: *anteri e verdhë* (e punuar e tëra me pe ngjyrë ari), *anteri sharofk*, *anteri t'zez*, *anteri e kushe* (e kuqe), *anteri varzhond* (var+zhond, me vargje/vija të gjëra), *anteri vari* (me vija të ngushta); *shami e kushe*; po edhe: *baščark e bardh* dhe *baščark pllofk* etj.³ Këto udhëhiqen nga ndjenja e së bukurës dhe estetikës, ashtu që leksema “e zbukuruar/e teleisun” dhe “e mirë” bëhet emërtim shoqëruar, siç janë: *çorap teleisun*; *brjezi i bardh i mëjr*; *shirita pi t'mirit*; *anterioria e mir me burma*, por edhe: *rake t'mira*, për veshje të nuseve, duke dalluar nga veshje të vajzërisë *rake t'babës*, si edhe ... *petka/rake katundi* ... për veshje të përditshme.

Këto leksema kanë të bëjnë edhe me tipat e ndryshëm të veshjeve, të cilat nuk mund të vështrohen jashtë përkufizimit lokal, kështu p.sh. *kmish me momshtona* dhe *çintjanet/çitjanet* (me vija vertikale të verdha në material të kuq dhe shirita të verdhë), të quajtura *jallane* janë emërtime të njohura vetëm për gratë e f. Cernivor; ndërkaq emërtimi *shalie*, dimi me ngjyrë të zezë e me lule, ishte e njohur për gjithë gratë e rajonit të Likovës, të cilat dikur vetë i kishin mbajtur. Kjo vjen nga fakti i veshjes popullore dhe uniforme të lidhura me rajone të caktuara.

Segmenti e dimensionit sociolinguistikë, përveç identifikimit kulturor krahinor a lokal, zgjerohet edhe në emërtime tjera, të cilat japin informacion të përkatësisë fetare, ashtu si edhe shtrirjes gjuhësore. Kështu, emërtimi *çul Kate*, që përmban një emër personal e që nuk është i përkatësisë myslimane, është i njohur si model edhe për banorët e Patishkës edhe për ato të Nistrovës së Rekës së Epërme, që të jep indikacione se po ashtu duhet të jetë edhe i vjetër, për dallim nga emërtimet tjera ku identifikohet përmes emrave si: *çul i Nifes*, *çul i Nuravicës* etj.

Në kuadrin e një riti të posaçëm të rregullimit të flokëve te nuset, gjatë përshkrimit të një mjeshtërie të rregullimit të flokëve, subjekti shprehet: ... *fjokët i kan pçetit kërstage* ... (e ka fjalën për gërshetat) dhe ndarjen e flokëve në mes e quan *putec*⁴, që i gjejmë edhe në mënyrën e rregullimit edhe të emërtimit edhe në f. Patishkë edhe në Nistrovë.

Lëvizje kuptimore apo shtrirje të kuptimit të emërtimeve të caktuara, ndryshojnë nga vendi në vend, nga katundi në katund etj., kështu p.sh. *oja* e cila ka kuptim thurje, prerje a qëndisje ndryshon nga *hoja* (Kërçovë), pjesë e veshjes së nuses, shirit zbukurues anësh bishtave, duke rënë anëve të fytyrës; *peta* – dy shiritat e punuar të mbërthyer te krahët në veshje të nuses; *peshterkë* - përparëse e leshit e ngjyrës, së zezë, për raste solemne përkundër asaj të punës *peshtemallit/peshtamall* (Strugë) dhe *peshterkë* – përparëse e kuqe e nuseve dikur, e palosur (Shutovë- Kërçovë).

Leksemat e këtylla kanë vlerën në pasurimin e leksematikës së përgjithshme popullore, përveç të tipizimit e përhapjes dialektore; kështu p.sh. material leshi për punimin e tirqve, shfaqet me emërtime të ndryshme: *kashnik/kashnjak*, *çazhnje*, po edhe *zhgunë*; apo lidhëzat e çorapeve të bëra nga leshi në disa vende janë të quajtura *ndorta*, e njëjta lidhëz në vende tjera e njohin me emërtimin *amçanik*; apo edhe emërtime sinonimike, si: *pshtallakë/boščarkë/bofsha/skutaçe/përparse* etj.

³ Qerime Zeqiri, 57 vjeçe, f. Patishka Rekë; Zejnep Mazllami 20 vjeçe, Gurguricë.

⁴ Lepa Spasenoska Mlladenovska, 81 vjeçe, f. Nistrov–Reka e Epërme.

Shamia e kokës shpreh dhe vlera tjera semiologjike: ... *si nuk e kie kryet mluet, ashtu thomi na, si s'kie burr;...; ... si e kie kryet shtruet* ...— se nuk e ke burrin, (... *burri t'mba, burri t'pultën, burri t'sosën, burri t'gjitha*; që nuk ka kush të të mbrojë, në komunikim të grave, në të drejtuarit grua gruas)⁵. Apo ai i *kapuçit* për djalin, si p.sh.: *Shëndosh djalin, kapuç plot*, zakonisht përdoret kur pritet të lidhet miqësia me dikë dhe nuk ndodh kjo.

Kjo mënyrë e emërtimeve dhe të veprimtarisë artizanale nuk ka përfunduar dhe nuk është ndërprerë, duke pasur parasysh përdorimin dhe punimin e mëtejshëm të veshjeve popullore, të cilat modifikohen e avancohen edhe në kohët moderne, mirëpo kanë vetëm kuptimin e njohjes dhe të dallimit të modelit, duke u përhapur gjithandej dhe jo të reflektimit gjuhësor e kulturor të një rajoni a një të folme, duke humbur edhe vlerat etnokulturore e etnolinguistike. Kështu punimet e reja të kaftanëve, si veshje e huaj, por që përdoret kryesisht në rajonin tonë, njihen me emërtime si: *Loti i Prizrenit, Loti me lule, Lule Prizreni, Lule me yll, Kaftani me ojna* apo edhe *Krokodilli* etj.

Në këtë trajtim janë përfshirë emërtime artizanale të përpunimit të veshjeve dhe të punimeve nga disa fshatra: Patishka Rekë, Cernivor, Gurgurnicë, Çiflik, fshatra të Likovës, Shutovë të Kërçovës dhe Veleshtë të Strugës, ka edhe shumë emërtime të tjera që nuk janë përmbledhur e që vërtet janë një pasuri sociolinguistike e etnolinguistike të shqipes.

⁵ Lepa Spasenoska Mlladenovska, 81 vjeçe, f. Nistrov—Reka e Epërme.

VASO NAÇO

TRADITA E VERËS NË POGRADEC

Fshati im siç e quan Mitrush Kuteli tek “Fshati im e pi rakinë”, ka pasur një traditë të trashëguar brez pas brezi, në kultivimin e vreshtarisë, në bërjen e verës dhe të rakisë. Jemi pasardhës të enkelejve thoshin të vjetrit, që pinin verë e luftonin me trimëri si askush tjetër

(e shkrojtur me një toskërishte të këtyre anëve)

Qysh në krye të herës, ky fshati im siç e quan Mitrush Kuteli tek “Fshati im e pi rakinë”, ka pasur një traditë të trashëguar brez pas brezi, s’dihet se qysh e kur, por traditë aman, traditë të lashtë në kultivimin e vreshtarisë, në bërjen e verës dhe të rakisë. Jemi pasardhës të enkelejve thoshin të vjetrit, që pinin verë e luftonin me trimëri si askush tjetër, po të betohej Bardhyli dhe trimat e tij për verë, nuk kishte romak, grek, maqedonas, e ku di se çfarë që t’u prishte betimin, se vera ishte e shenjtë. Se edhe Justiniani prandaj e ndërtoi pallatin mbretëror në Lin, thoshte xhaxhi Mihallaqi, se kishin verë të mirë në këto anë, madje edhe pjesë e zbukurimeve të pallatit ishin rrushi e poçat me verë. Po domosdo, kjo traditë ka ardhur se ky fshati im jo vetëm di ta bëjë, por di edhe ta pijë verën e rakinë, dhe mirë madje, këtë e thonë gjithë pogradecarët, na e thotë edhe Kuteli: “Jo se më shket mëndja të ngrihem e të them se fshatrat e tjera nuk e pinë rakinë, po si e pi ky fshati im, s’ka fshat në botë. Në fshatin tim, o të lumtë goja, i vogli e pi kupën barabar me të madhin: as dridhet, as shembet, as shëmtohet”. Pogradecarët e vjetër tregojnë se të mëdhenj e të vegjël në vend të qumështit, për vakt mëngjesi kishin përseshin me verë, por e thënë sot është e vështirë të besohet.

Në Pogradec të gjithë bënin verë dhe e kishin të paktën një but në shtëpi, kush një e kush shumë, kush të madh e kush të vogël, por aman vera nuk mungonte, qoftë derë e pasur apo derë e varfër. Interesante është se si të gjithë kishin një but me verë, se mirë ata që ishin në gjendje e kishin prona e vreshta, po ata që s’kishin, të varfrit? Ja që tradita e donte verën në shtëpi, dhe të pasurit me vreshta e bodrume të mëdhenj, bënin verë të mirë e jo shumë të mirë, se kishte rrush nga çdo lloj. Edhe të varfrit siç e donte tradita, shkonin e punonin në vreshtat e atyre që ishin më në gjendje, e në fund të ditës nuk merrnin lek për punën që bënin se kjo nuk ishte traditë, por merrnin dy – tri këllbra (enë prej druri, e ngushtë poshtë dhe e gjerë lart, me rrathë hekuri, pak si plloçake, përdorej për të mbajtur rrushin) me rrush, se domosdo, duhej bërë verë, se përndryshe nuk ishte pogradecar, e nuk të shikonin me sy te mirë.

Vera në Pogradec bëhej sipas traditës që kishin mësuar nga gjysh, stërgjysh, brez pas brezi. Pasi mblidhej rrushi në shtator ose tetor, shtypej dhe hidhej në bute druri. Lihej për një kohë, rreth dyzet ditë, por në varësi të motit, dhe të ëmbëlsisë së rrushit edhe më shumë ose më pak kohë derisa lëngu i shtypur i rrushit të fermentohej e të bëhej verë. Në Pogradec bërsitë (lëvoret e rrushit) nuk ndaheshin nga lëngu dhe vera dilte e fortë me aromë por edhe pak tanike (e athët). Gjatë kohës së fermentimit (javët e para) pihej mushti që është lëng rrushi i ëmbël, pa u bërë verë.

Çdo shtëpi pogradecare e kishte patjetër një bodrum, në mos një bodrum një vend të errët e me temperaturë konstante, në verë të freskët e në dimër jo të ftohtë, se para se të mendonin për dhomën e tyre, mendonin për verën, që t'i krijonin kushte sa më të mira, se pa të nuk jetonin dot, e ja u kishin lënë amanet të parët. Në shtëpi, vendi më i rëndësishëm bodrumi ishte, e po të të vinte ndonjë mik, në fillim para se ti shtroje tavolinën, në bodrum do e çoje, se s'do mend, duhej respektuar miku. Po të hyje në bodrum vështirë të dilje, se do i provoje të gjitha ç'kishte i zoti i shtëpisë, provo gëmsin, provo muskatin, provo perlën, provo pamidin, provo rieslingun, provo tokain, e ndonjë shishe të vjetër që e kanë zënë merimangat, e provonte miku, se miku duhej kënaqur e duhej nderuar, se bëheshe gazi i gjithë fshatit pastaj.

Në Pogradec nuk të pyeste njeri si ke qenë, ata të shtëpisë si i ke, por nga shtatori, tetori, hë bre si t'u bë ay rrushi, është ndonjëçikë i ëmbël apo hiç, nga nëntori, dhjetori e në vazhdim, hë bre si t'u bë ajo vera, është ndonjëçikë e fortë, bërë ca verë sivjet, se si do e kalojmë dimrin, se është i ftohtë ky i uruar dimër e netët pa verë nuk ngrysen e gëdhihen, nga marsi e prilli, hë bre e mbarove verën, e zjeve rakinë, sa raki nxore, e pastaj e punove vreshtin, e stërkite, e krastite... Për verën flitej më shumë se për çdo gjë tjetër në Pogradec. Po të dëgjoje hallet e pogradecarëve, po hallet e mëdha aman, vetëm për verën ishin: lere bre lere, se mu thartua një but këtë vit, e një më ka ngelur, çdo bëj unë i shkreti me një but, ai s'më del as për vete pa le për miq e për vizita, po le atë, po turp bre, si të më thartohej. Lere bre se mua më ngeli i ëmbël ai buti që kisha shtënë me muskat kanellë, Ç'thoni bre ju, unë i gjori si do ja bëj, këtë vit nuk nxora fare raki, vetëm ca më ka ngelur nga viti i kaluar, vit i mallkuar.

Po të dëgjoje bisedat e pogradecarëve, mburrjet dhe lavdet, të gjitha për verë ishin: kam bërë një verë këtë vit, po lere bre, s'ka bërë ndonjëherë Pogradeci si kjo. Unë këtë vit kisha një rrush të ëmbël, po ç'të të them bre, 26 gradë ma tregoi ëmbëlsinë mushtometri, do më nxjerrë një raki që të çuditë të gjithë.

Pogradecarët e kishin zakon, kur bëhej vera, dhe netët e dimrit kishin orë plot, mblidheshin në shtëpitë e njëri – tjetrit kush gatuante peshkun e freskët të gjolit, apo mishin e derrit, kush sillte verën e kuqe apo të bardhë, se muhabeti i tavolinës rreth saj vërtitej, një natë te njëri, një natë te tjetri kështu shtyhej dimri i gjatë e i acartë. Ushqimi dhe vera ishin me bollëk, po vera që çohet te miku nuk kthehej më, o pihej aty e gjitha, o nga e pira e shumë dush me verë bëhej, vetëm shtëpinë nga kish dalë nuk e shikonte më.

Kur mbarohet vera, bërsitë dhe ai pak lëng që mund të mbetë, bëheshin raki. Se çdo shtëpi siç kishte butin, kishte edhe kazanin e rakisë, dhe shumë mirë këtë traditë na i tregon Kuteli: “Po na u bë kësaj dite, o shok, ky fshati im plot kazanë. Kazan e shtëpi, shtëpi e kazan! Se ai që ka një kazan, është mbret më vete e të shikon që lart, si hipur më tartivan, sa mezi ta kthen mirmëngjesin. Mund të kesh ti ara sa të mundësh, gështenja sa të lodhesh e tregti të rëndë, me dengje, puna jote, po s’pate kazan numërohesh fundi i fshatit e pa nder. Ti mund të jesh aty në fshat den – baba – den, nga gjyshi e stërgjyshi e më tutje, po gjith i huaj je për defter e fshatit”.

Kur vihej kazani për të bërë rakinë, te i zoti i shtëpisë shkonin miq e shokë, e rakia pihej aty në vend, e fortë, e jo me kupa, po me poça e qypa, pinin e këndonin, gra e burra, i madh e i vogël, se kishte festë kur ziehej rakia.

Po sot...

Sot në Pogradec vazhdon, por e cunguar, dhe jo e plotë, tradita e vjetër e të bërit verë, ose më saktë, sot mundohen të bëjnë verë, ose gënjejnë mendjen se bëjnë verë apo më mirë të themi, bëjnë lëng rrushi me alkool, por larg asaj traditës së të parëve. Megjithëse sot mund të ketë më shumë kushte dhe mundësi, tradita për fat të keq është shtrembëruar dhe janë futur elementë negativë që po e prishin atë. Sot shumë njerëz kanë zëvendësuar butet e drurit me bute plastike, ndoshta për lehtësi, ndoshta për kosto më të vogla, por kjo e prish traditën. Sot shumë shtëpi me bodrume të vegjël a të mëdhenj, por që kishin kushtet minimale për verën janë prishur e janë bërë pallate, e njerëzit kanë filluar të mbajnë kadet plastike nëpër ballkone e terraca, epo dreji ta marrë, vera me diellin, të ftohtin, erën, zhurmën dhe dritën nuk jeton dot. Sot gjithçka po bëhet komerciale dhe sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, këtyre kadeve plastike nëpër ballkone ku hidhet rrushi ju shtohet edhe sheqer, se na duhet verë e raki shumë, e na rroftë sasia se cilësia...

Çdo vit zhvillohet festa e verës dhe kjo është diçka shumë e mirë, që ndihmon në motivimin dhe zhvillimin e prodhimit të verës familjare sipas traditës, por vetëm diçka duhet të ndryshojë edhe në këtë festë që ngjall kaq shumë shpresë, duhet që festa dhe konkursi të mbrojnë traditën, të mos lejojnë lëngje rrushi të bërë nëpër kade plastike, të sheqerosura e ku di se çfarë. Ky është minimumi që mund të bëhet për të mbrojtur verën, për të mos e kthyer atë siç thonë pogradecarët e vjetër në “shollomotkë”, verë e thartë, e turbull, me shije të keqe.

E pra sot gjithë ajo trashëgimi e ruajtur dhe e transmetuar brez pas brezi po humbet, po transformohet, po shtrembërohet. “Gjyshi im, një banor i “fshatit të Mitrushit” thoshte: “biro nuk bëhet shaka me verën, se është si fëmija dhe do kujdes, që të bëhet e mirë dhe të rrojë gjatë.”

*MILTIADH MUÇI***THESARE NGA FOLKLORI DHE ETNOGRAFIA
E HARRUAR E LEKLIT TË TEPELENËS**

George Hahn, albanologu që me studimet e tij ka pasur prioritet për vendin tonë në shekullin XIX, kur ndodhej konsull i Austro-Hungarisë në Janinë, në veçanti ka shkruar për zakonet familjare të Rrëzës së Tepelenës, ku nuk bënte përjashtim Leklin. Duke dashur të argumentoi lashtësinë e shqiptarëve me trojet e tyre, bënte krahasim dhe dallonte zakonet e tyre me të grekëve e romakëve të lashtë. Për këtë studim u mbështet kryesisht në përshkrimin dhe studimin e zakoneve të banorëve të fshatrave të Rrëzës, zonë e pastër nga pikëpamja etnografike. Nga Hahn do përshkruhet gjithçka që ka lidhje me Leklin dhe lekëljet.

Në Rrëzë të Tepelenës hyjnë fshatrat: Lekël, Kodër, Peshtan, Labovë e Zhapës, etj. Të 11 fshatrat e Rrëzës duken si një tërësi e bashkuar, me zakone të njëjta dhe ushtrojnë profesione të njëjta, për më tepër lidhen martesë midis tyre, do të shkruajë Hahn. Fshatrat në krahun e djathtë të lumit Drinos, para bashkimit me Vjosën, janë përzgjedhur si të pastra nga pikëpamja etnografike, larg ndikimeve greke, sllave dhe aq më shumë turke, do të shtonte ai. Le të shohim në mënyrë të përmblëdhur, disa prej zakoneve të përshkruara:

Martesa - i ati është ai që marton djemtë, pa i pyetur nëse ju pëlqen ose jo nusja. Ky zakon rridhte nga që martesat bëheshin në moshë të vogël. Dita e hënë njihet si dita e fillimit të dasmës dhe quhej “e hëna e miellit”, sepse dërgohej gruri në mulli, për ta bluar dhe përgatitur bukët e dasmës. Ndërsa e enjtja ishte e druve të dasmës, që i prisnin djemtë e familjeve pjesëmarrëse në dasmë. Të premtën ishte pushim.

Të shtunën - në shtëpinë e dhëndrit vijnë njerëzit e afërt, të cilët secili do të sillte nga një dash. Ata priteshin me këngë nga zonjat që merrnin dhuratat, me fjalët: “Ta paçim hua zotëri”.

Të dielën - në shtëpinë e dhëndrit vijnë farefisi dhe miqtë, dy deri në tre për familje. Pjesëmarrja e të gjithëve bëhej mbi 100 vetë. Çdo familje do sillte një bukë, një enë druri me verë, pak të holla. Në orën e caktuar, nga shtëpia e dhëndrit niseshin krushqit për të marrë nusen.

Mes burrave ndodhej dhëndëri i hipur në kalë, edhe nëse shtëpitë ishin afër njëra-tjetrës. Atë e shoqërojnë nuse të stolisura, të hipura në kalë. Vjehrra pret dhëndrin tek dera e shtëpisë, që i puth dorën, ndërsa me një tufë lulesh ajo e spërkat me ujë. Burrat që e shoqërojnë hyjnë në dhomën e veçantë, ku ulen këmbëkryq. Pinë e ngrënë shëndete për çiftin: “Rrofshin, qofshin u trashëgofshin”. Në dhomën e nuses hyjnë gratë, e cila puth dorën të gjithave. Pranë ndodhet një grua që e shoqëron.

Në fundin e ceremonisë, në shtëpinë e nuses, vëllami shkon tek nusja e puth në faqe ose buzë, i vesh këpucët, ku brenda ka hedhur oriz dhe para, si shenjë për t'u shtuar. Kthehet tek burrat, dhe bën lëvdata për bukurinë e nuses. Kur të gjithë bëhen gatitë largohen, vëllami "vjedh" dy lugë, po kështu dhe njerëzit e dhëndrit që më pas i kthejnë. Nusen e hipin në kalë, pasi t'u ketë puthur dorën prindërve dhe fisit të saj. Pasi bënë një pjesë rruge në këmbë, e hipur në kalë niset me krushqit për në shtëpinë e dhëndrit, e mbuluar me duvak. Gjatë rrugës, të zotët e shtëpive ku nusja kalonte, qerasnin krushqit me verë. Shtëpia që nuk nxirrte verë, kuptohej se ka armiqësi me dhëndrin. Në momentin e mbërritjes, mbi një vend të ngritur, vjehrra hedh kokrra orizi mbi çiftin dhe gjithë të tjerët, njëkohësisht bënë urimet e rastit. Orizi është shenja e pjellorisë dhe pasurisë. Sapo nusja hyn në shtëpi, vëllami i heq duvakun, nis bëhet kurorëzimi. Nuni mbanë dy kurorat mbi kokat e çiftit, i cili nderohet shumë, se mallkimi i tij është tepër i rëndë, më i rëndë dhe se i babait. Pas këtij riti, dasmorët hanë bukë, nusja qëndron në anë të dhomës me duart e vendosura kryq. Dhëndëri ngrihet atëherë kur ngrihet shëndeti i çiftit, por pa folur. Është vëllami që e shoqëron e kthen përgjigje.

Dita e diel tek dhëndëri kalon me gosti, dolli, këngë e valle, të cilën e hap ai duke qenë në krye.

Ndërkohë gratë do vallëzojnë me nusen që rri në mes të grave, ku zakonisht këndohet:

Mori korbi një thëllëzë.

Ç'e do korbatë thëllëzë?

Të loz e të qesh me tëzë.

Të shkoj jetën me të.

Natën vonë, mbasi miqtë darovisin nusen do të largohen, ajo ju puth dorën. Atë mbrëmje, nusja fle me gratë, dhëndëri me shokë të tij. Të hënën - në mëngjes, çiftin e fusin në një dhomë të veçantë, me bukë të lyer me mjaltë që e kafshojnë secili nga tre herë. Nuk mbaron gjithçka këtu. Të martën - dhëndri shkon në dhomë për të fjetur dhe pas një ore dërgojnë me zor nusen, e cila tërë naze do të hyjë brenda.

Të mërkurën - pasi nusja ka fjetur natën e parë me dhëndrin, nis punët e shtëpisë me larjen e rrobave. Zakonisht, vitin e parë të martesës, ajo nuk bën punë të tjera. Deri sa të lindin fëmijë, nuk mund të flasë me burrin në prani të të tjerëve, bile nuk duhet t'i flasë në emër. Ajo të bëj kujdes jo vetëm me prindërit e burrit, por dhe me farefisin e tij.

Familja - ku fuqinë e ka babai, të cilin e nderojnë dhe e respektojnë të gjithë fëmijët. Deri sa jeton mbetet kryefamiljari, dhe kjo e bën të fuqishëm bashkimin e familjes. Fëmijët nuk kanë pasuri të tyre, por punojnë për shtëpinë, dhe nëse nga puna njëri ka të ardhura më shumë se tjetri, kryefamiljari i administron njësoj. Vëllezërit bashkëjetojnë edhe pas babait, ndërsa janë fëmijët ata që kur rriten dhe martohen ndahen nga prindërit. Lindja - e fëmijës do të njoftohet menjëherë tek farefisi, që vijnë dhe e vizitojnë, duke sjellë me vete gjellë. Në ditën e tretë të lindjes, mbrëmja e saj quhet "poganiku i djalit apo i vajzës". Në këtë mbrëmje vjen farefisi që secili sjell lakrorin, një bukë dhe një shishe me verë, që i hanë bashkërisht në sofër, dhe duke uruar për foshnjën do të thonë:

Poganiku dhe djali burrë,

Ta dërgojmë për masurë.

Të na bjerë para shumë.

Poganiku dhe vajza grua,

Ta dërgojmë në përrua.

Të na bjerë ujë shumë.

Pas këtij riti do të kryhen veprime të tjera.

Rrugëtimi – kur dikush nisej për rrugë të largët, para pragut të shtëpisë vihej një enë me ujë të pafolur, e zbukuruar me gjethe dhe brenda vathë floriri ose sermi. Udhëtari e prek me këmbë dhe ena derdhet, ndërsa ai merr disa gjethe me vathët që ia kthen shtëpisë.

Ujë e pafolur - mbushet në burim, pa folur gjatë rrugës që e çon atë në shtëpi.

Zjarri – në vatër ka fuqi shëruese, prandaj mbahet ndezur gjithë natën, pasi më parë është kryer një ceremoni e madhe, bile dhe në verë. Ai rri i ndezur për 40 ditë në dhomën e lehonës, nëse shuhet do konsiderohet shenjë e keqe.

Hahn: Shënime për kalendarin e Rrëzës

Në botimin ”Studime shqiptare”, në pjesën II me titull ”Përshkrim i zakoneve”, Hahn shkruan edhe për kalendarin e Rrëzës së Tepelenës, që për çdo rrëzjot sot përbën një kuriozitet:

Shtatori – është dita e parë e fillimit të vitit të ri, prandaj çdo ngjarje e kësaj dite paragjykohej, si paralajmërim për të gjithë vitin.

Tetori – në javën e parë nuk shkohej në arë, nuk mbillej në gjithë muajin, dhe gruri duhet të mbillet para tetorit, sepse pas tij nuk do të mbinte. Nëntori – prej datës 15 deri në 6 janar, janë kërshtëndellat, ndërsa në 6 janar është dita e ujit të bekuar.

Dhjetori – në datën 24 është dita e krishtlindjeve dhe e kolendrave. E para e kolendrave është e qeve dhe varej në murin e dhomës për t’i prurë mbarësi shtëpisë. Kur fillonte lëvrimi i arave, fshatari e thyen atë tek balli i qeve dhe ja u jep ta hanë.

Janari – është darka e Shën Vasilit ku zjarri ri i ndezur për gjithë natën, e ruan një grua me barë, me shpresë për të pasur një lindje të lehtë. Ditën e motit të ri, në mëngjes venë rekush hyn i pari në shtëpi. Shkurti –dita e parë është e Shën Trifonit, ndërsa në 2 shkurt është dita e Shën Mërisë, ku në kusi do ziejnë gjithfarë kokrrash fasule, qiqra, misër, grurë, elb , etj., dhe kjo gjellë quhet ”karkashina”. Marsi – ditën e parë hidhnin në zjarr gjethe rrushkulli (shkulja e luleshtrydhës). Nëse kjo bënte shumë zhurmë, ishte shenjë e mirë për personin që u përmend, ndryshe është e ligë. Në këtë mbrëmje ngjeshin dhe një plis dheu me bar qumështor pas portës, që lopët të japin më shumë qumësht. Në 23 mars, ditën e Shën Gjergjit, dilet shëtitje, dhe në kokë vihet një kurorë me lule. Prilli – në ditën e parë thuhet fjalët:

Doli marsi, hyri prilli.

Me ferman këndon bilbili.

Maj – burra dhe gra ngrihen sa më herët në mëngjes, hanë shpejtë një kokërr hudhër pa dëgjuar gomarin kur pëllet, me barkun bosh. Sepse kush e dëgjon për herë të parë nuk i shkon puna mbarë. Në këtë ditë të parë, i madh dhe i vogël mbledhin lule dhe zbukurojnë dyert.

Qershori – nuk shkojnë në vresht që mos dëmtohet nga insektet, ndërsa për t'i luftuar në tri të diela hedhin hi. Në darkën e Shën Gjonit ndezin zjarr e mbi të kalojnë gjithë moshat.

Korriku – kur mbarojnë të mbjellat, bujku i kthen shpinën parmendës, me duar mbulon një pjesë të saj me dhe, që arrën të mos e dëmtojnë derrat e egër. Gusht – në 12 ditët e para shikohet si do të jetë moti në 12 muajt e ardhshëm.

MATERIALE LEKSIKORE

BEXHET ASANI**FJALË TË RRALLA NGA TREVA E STRUGËS**

(Nga fshatrat geqe dhe toske)

Aliguli *m.* gjel deti. *Aliguli nuk ishte në kotec.***Ambull/ë, -a** *f.* ara e mbjellë me grurë, elb, tërshërë etj., pasi të korret gruri. *Fig. Mori ambullave ai! Kur dikush flet gjëra të kota, nuk është në temë fare (Str.).***Bare** *f.* tokmak. Mjet prej druri, në formë të çekiçit, që përdoret për të thyer plisa në arë.**Bars** *f.* Lopa u ndërzye. *Lopa është bars. Lopa është bars në muajin e tetë.***Bëzë, -a** *f.* sh. -t plis që ngre parmenda a plugu gjatë lërimit të tokës; plis me bar. *Shumë bëza dolën në livadh kur e laruam. Duhet të thyhen bëzat në arë sepse nuk do të mbijë asnjë kokërr misër. Thyej bëza.***Blat/ë, -a** *f.* vend moçalik, kënetë.**Bofçallëk, -u** *m.* lloj shamie. Plaça të mbledhura e të lidhura tok në bofçallëk. *Bofçallëku i nuses.* Teshat që i çohen nuses nga ana e burrit, për festat e motmotit si dhe për festat fetare.**Botë, -a** *f.* lloj balte, argjile, për përgatitjen e çerepëve, shtambave, poçave dhe të gjitha enëve të tjera prej balte (Str.).**Buc/ë, -a** *f.* femra e qenit. Bushtër, kudër. Lidhe bucën. *Sa këlyshë ka pjellur buca?***Bulashk/ë, -a** *f.* ashkël. Copat që dalin nga druri i gdhendur. Ashkël e madhe që del nga sëpata, nga zdrukthi etj., kur presim a gdhendim një dru ose një metal. *Bluashkë druri. Bluashkë metali. Copa bluashkash. Mbledh bluashka. Ndez zjarr me bluashka (Str.T.).***Bymbeskë, -a** *f.* Sythi. *Sa bymbeska kishin mollat!***Cingëlthi** *ndajf.* Luaj cingëlthi: luaj shkop e cingël. Luaj cingëlthi me dikë luaj cingël. *Hajde të luajmë cingla. Bëmë një cingël.***Çakall, -i** *m.* stërdhëmb. Dhëmb çakall. *Dhëmbët i paska çakall (Str.).***Çoçk/ë, -a** *f.* arrë me lëvoren jeshile. *Arrat ende janë çoçka, të presim që të piquen, t' u bien çoçkat.***Çupallk/ë, -a** *f.* lloj kungulli (pocërk në Kosovë) me bisht, kur thahen e përdornin në vend të safkës, enës për tu larë në banjë. *Të gjitha çupallkat u thyen? S' ka mbetur asnjë çupallkë. Ma sill çupallkën.***Dane** *f.* kokërr. *S' plasi dane sivjet. Mblidhi danet. Kjo është danja e vetme (Str.).***Bostak, -u** *m.* top rrushi. Merr ndonjë bostak rrush në vresht. *Sa i madh qenka ky bostaku i rrushit (Str.).***Dardali** Bie shi pareshtur.

Dardhushk/ë, -a *f.* dardhë e vogël. *Kanë mbetur dardhushka. Dardhë është kjo, kjo është dardhushkë* (Str.T.).

Divan *m.* Nderim, do të rri në këmbë gatitu, do ta nderoj.

Drak/ë, -a *f.* Gjemb i gjatë mbi 5 centimetra. Gjemb, drakë që rritet në kumbullë, bagrem të egër e të butë etj. I hyri një drakë në këmbë, mezi e nxori. *Mos sjkol aty se ka draka. Sa të gjata këto draka. Sa shumë draka paska.*

Dullak, -u *m.* Duvaku i nuses. *Hoqi dullakun. Vuri dullakun.*

Fakefak *ndajf.* Menjëherë; shumë shpejt, pa humbur kohë. *Fak e fak. E bëri fak diçka. E piu fak. E rregulloi fak.*

Fulaçe *f.* kërcelli i misrit kur thahet, te vendi ku ka qenë kalliri vihet një guriçkë dhe hidhet në një largësi të caktuar. Kush e hedh gurin më shumë me fulaçe. *Fulaçe misri. Mu prish fulaça.*

Fuqk/ë, -a *f.* lloj kërpudhe e bardhë sa një kokërr arre rritet nëpër livadhe me lagështi. Pasi thahet brenda ka pluhur ngjyrë kafeje, kur e ngjesh del në formë të tymit fuqkë. *Në livadh ka shumë fuqka. Më bëri me fuqkë - më ndyu.*

Fenduce *f.* lloj kërpudhe e bardhë sa një kokërr arre rritet nëpër livadhe me lagështi. Pasi thahet brenda ka pluhur ngjyrë kafeje, kur e ngjesh del në formë të tymit fenduce. Më bëri me fenduce, më ndyu. (fshatrat geqe)

Bar derri *bot.* Bimë barishtore me kërcell të trashë e të ashpër, me gjethe të gjata, të ngushta e me majë të mprehtë, që rritet zakonisht nëpër kënetë. **Lule lëmi** *bot.* Bimë shumëvjeçare me kërcell sa kërcelli i misrit, rritet gjer më dy metra. Me lule të kuqe, Çel gjatë korrije shirjeve korrik-gusht. Me këtë lule pasi përfundon shirja e grurit, elbit, thekrës etj., stoliset strumbullari. Lidhi lulet e lëmit në majë të strumbullarit.

Furr grumbullim. *Ç' janë furr ata atje? Ç' janë grumbulluar? Shihe si janë furr.*

Furrore *f.* bukë e pjekur në furrë dhe jo në çerep. në shtëpi. *Hëngra një çerek furrore. Bli furrore kur do të shkosh në qytet* (Str.).

Drakë, -a *f.* gjemb i madh mbi pesë centimetra. Draka të tillë ka kumbulla, bagremi i egër etj. *Më hyri një drakë në këmbë. Kujdes do të shkelësh në drakë.*

Gërboç, -m. gjysma e shtambës së thyer, fundi. Zakonisht në të kaluarën e mbanin brumin, tharmin për të zënë bukën. Fig. Njeri i shkurtër, fatkeq. *Është bërë si gërboç. Gërboç derri! Ik mor gërboç!*

Gomaric/ë, -a *f.* kumbull e egër, jo e rrumbullakët siç janë të gjitha kumbullat, por është më e madhe dhe plloçake. *O sa gomarica paska te kjo kumbullë! Kape atë gomaricën sepse nuk mund ta mbërrij* (Str.).

Grezhde *f.* top rrushi. *Grezhde rrushi. Sa e madhe qenka kjo grezhde* (Str.).

Tërllaçk/ë, -a *f.* ashkël. Copat që dalin nga druri i gdhendur. *Sa tërllaçka paskan bërë këtu. Po, mor, tërllaçkat janë të thata. S' paska asnjë tërllaçkë këtu. Merr ca tërllaçka për ta ndezur zjarrin* (Str.T.).

Gung/ë, -a Arrë gungë. Arrë që nuk i del lehtë thelbi ose nuk i del fare. Ajo arra i ka gunga.

Gjoke *ndajf.* *Cingla ra gjoke, mbarë.* Kur bie gjoke ka mundësi të ngrihet më mirë në një lartësi të caktuar për t'i rënë me shkop - mashuk.

Mashuk *m.* lloj shkopi për t'i rënë cinglës. Lloj shkopi deri gjashtëdhjetë cm., për ta gjuajtur cinglën. *Do të më bësh një mashuk sepse mu thye.*
Nenjë, -a f. nyjë. Lak në një litar ose në një fill, i tërhequr fort e i shtrënguar; vendi ku lidhen si xhungë dy skaje të një filli a të një rripi. Nyjë e litarit (e spangos, e perit). Nyjë e kravatës (e fjongos). Lidh nyjë. Bëj nyjë. Zgjidh nyjën. *Zgidhe nenjën.*

Kali i qyqes: *Është bërë si kali i qyqes* - është shëmtuar. *O mor, kali i qyqes* - i mjerë (Str.T.).

Kalo, kalua mb. keq. Budalla është ai. *Kalo është ai më mirë mos kesh punë me të.* *Ë ë erdhi kalua* - i padurueshëm. *Lëre atë se kalo është ai.* Ti je kalo, mor!

Katoj fol. Katoj një letër. Katoj më dysh letrën.

Kllaçk/ë, -a f. kllaçkë. Pula kur bie për të nxjerrë zogj dhe gjatë kohës që i rrit. *Zogjtë e kllaçkës. Si zogjtë rreth kllaçkës. Ra pula kllaçkë* - qëndron pula një farë kohe mbi vezë për të nxjerrë zogj. *Shtroj kllaçkën* - i vë pulës vezët për t'i ngrohur (Str.T.).

Kllapush, -i f. veshmadh. Njeri me veshë të mëdhenj. *Fig. Lëre, mor, se ai është kllapush!* (Str.).

Koçkë, -a f. Ka kuptimin e drurit plot me nyja, por dikur prej bazës së poshtme të drurit sidomos verrinit - *Alnus glutinosa* L. dilnin disa nyja si gunga. Barinjtë merrnin prej tyre dhe organizonin lojën e cila quhej koçkë. Loja ishte shumë interesante se merrnin pjesë dy tre e më shumë vetë në grupe dhe luanin koçkë. Por ajo lojë luhej me shkopinj prej thane të trashë në pjesën e poshtme kishin po ashtu një gungë të ngjashme e cila quhej *damarrung*.

Koçkor, -i m. Dru me nyja. Dru i fortë. *Shumë koçkor është ai dru* (Str.).

Golltakë, -e f. Dru pa gjethe e pa degë të vogla. Dru që rrëzohen dimrit nga dëborë dhe mbliiden verës si dru të thatë. Në atë shpat të malit ka golltakë, por edhe golltake. *E paske ngarkuar gomarin (mushkën, kalin) me golltake.*
Shakull, -i m. Mbështjellësi i kokrave të groshës. *Kishin plasur shakuajt, gjithë grosha kishte rënë përdhe. E shkele shakullin. Groshën do ta mbledhim me shakuajt. Shakull jeshil, pa pjekur.*

Kojre f. koriye. Pylli i gështenjave. *Të shkojmë në kojre të mbledhim gështenja. Kojre më kojre mbliidhte gështenja si në mall të babës të vet. E kishin prerë gjithë kojren.*

Kokomark/ë, -a f. gështenjë kokërrmadhe. *Merre atë kokomarkën. Sa kokomarka i paska kjo gështenja!* Fjalë e urtë: Gështenja është buka e fukarenjve (Str.).

Kopil/ë, -a Filizat që dalin nga rrënja e pemës. *Kopilkat e misrit etj.*

Krunde f. Zbokth. Ka krunde. I kanë rënë krunde në jakë. Kishte shumë krunde.

Kalavesh, -i m. bigaçja e llastikave (për të gjuajtur zogj). Do të më bësh një palë llastiqe me kalavesh.

Kryps, -i m. vendi ku mbahet kripa, enë prej druri apo prej dërrase.

Kryqashk/ë, -a f. fundi i shportës bëhet me kryqashka, purtekat, thuprat vihen në formë të kryqit. *Shumë të trasha i ke vënë kryqashkat* - thuprat. Në ndërtimtari përdoret fjala kryqashkë: *veri një kryqashkë perit dhe shtrëngoje* (Str.).

Lofra *f.* lëkura e groshës kur zihet, ndahet nga thelbi. Grosha ka *qenë pa vaditur prandaj është gjithë lofra*. *S'hahet* kjo groshë, gjith lofra është (Str.).

Luçk/ë, -a *f.* lugë e vogël për kafe. Përzie xhezven me luçkë.

Luks, -i *f.* lukthi. *Më dhemb luksi*. *Se ç'kam këtu në luks* (Str.).

Luks, -i *m.* vendi ku mbahen lugët, enë prej druri apo prej dërrase.

Llastiqe *f.* emërtim për bigaçen e llastikave. E vrava një rabeckë (harabel) me llastiqe. M' u këputën llastiqet.

Mbathja *fol.* ik, shko. *Mbathja mos të shoh*. *Ia mbathi prej frikës*. *Ia mbathi* - iku (Str.). Therja. *Therja pelës* – ik (Kos.).

Melakuq, -i *m.* lloj bime që rritet sa misri, me fara të kuqe, me kashtën e saj bujqit bënin fshesa. E preva melakuqin.

Mëjsk, -a *f.* pulë deti, misëroke. Vezë miske (Str.T.).

Misarok, -u *m.* gjel deti. *Sa misarokë janë?* *Do të mbajmë vetëm një misarok për mbarë*.

Miskë, -a *f.* femra e gjelit të detit. *Vezë miske*. *Miska ka rënë kllloçkë*. *Sa vezë ka bërë miska?* *Miskën nuk e pash në qymez*. *Fig. Ajo vajzë është si miskë deti*. E bukur, e pastër.

Ngajdera. Nevojtoje, Wc-e , tualeti. *Dole ngajdera?* *Mbete ngajdera!*? (Kur ndonjë është kaps).

Ngjishepiq- lloj buke me një aromë dhe shije të shkëlqyer. Rrallë ndonjë grua që e bën sot.

Njime ndajf. tani. Njime do të nisem. *Njime e pash, këtu ishte*. *Njime të shkosh*.

Lënk/ë, -a *f.* lehonë. Grua që sapo ka lindur fëmijë, gruaja gjatë disa ditëve menjëherë pasi ka lindur fëmijën. *Është lënkë*. *E ka gruan lënkë*. *Kujdesi për lënkën*.

Puliçk/ë, -a *f.* pulkë, gështenjë e zier e pastruar nga lëkura dhe nga cipa e hollë. *Shihe e bëra gështenjën puliçkë*.

Oçe, -ja *f.* i vogli i buallicës. *Oçja kullot në livadh me bullicën*.

Paltoj *f.* palos. E bëj me dysh a në shumë palë një pëlhurë, një rrobë, një letër etj. *Paltoj plaçkat*.

Pëshe, -ja *f.* mëz, i vogli i pelës. *Pëshja nuk pin te pela*. *Shko merre pëshen*. *Fig. Ai është pësh, i papjekur* (Str.).

Piklë, -a *f.* gështenjë e dalë nga mbështjellësi me gjemba, sharku. Sa pikla kanë rënë nga era. *Te këmbët e ke një piklë mos e shkil*. *Gështenjat ishin shtruar me pikla*. *Mblidhi vetëm piklat* (Str.).

Pitaçk/ë, -a *f.* lloj gështenje e pazhvilluar në formë të luçkës së kafesë, nga bishti i shtien një deçkë të fortë sa bishti i lugës dhe hanë gjellë sepse ka formën e lugës. *Kjo gështenjë s'i ka të mira, gjithë pitaçka i ka* (Str.).

Plënc, -i *m.* plëndës. Pjesë e të brendshmeve te kafshët ripërtypëse, që është si trastë, pala-pala nga brenda dhe shërben për tretjen e ushqimeve; stomaku i përtypësve. Por edhe gjithë barku i kafshëve ku tretet bari. *Si plënc është ai, i rëndë*.

Plit/ë, -a *f.* tullë e papjekur në furrë. Shtëpi me plita (Str.).

Ploçak, -u m. lloj gështenje për të pjekur e cila qërohet lehtë, bëhet pulkë (Str.).
Pulk/ë, -a f. gështenjë që i është hequr lëkura, cipa a lëvozhga. Gështenjë e qëruar, e cila është gati për të ngrënë qoftë e pjekur apo e zier. *E qërova e bëra pulkë gështenjën* (Str.).

Potoreshk/ë, -a f. perime që mblidhet në pranverë zakonisht në muajin mars kur toka lëvrohet e bëhet ugar. Plugu ndonjëren e ndan përgjysmë, në brazdë gjysma duket e bardhë pasi e qërojnë ia heqin lëkurën e cila i del si petë e hahet. Ka shije të ëmbël dhe një erë karakteristike. Kërcyelli mund të rritet gjer në 50 cm. Lartësi, me lule ngjyrë të kuqe me aromë. *Sa e mirë kjo potoreshka. Shihe si e ka prerë pllugu potoreshkën* (Str.T.).

Prasht/ë, -a f. një copë litari gjashëdhjetë- tetëdhjetë cm., i gjatë në fund lidhet në formë të një rrotulle të vogël, te rrotulla vihet guri dhe pas disa rrotullimeve hidhet. Kush do ta hedhë gurin më shumë me prashtë. Kush di të më bëjë një prashtë?

Pysqyl, -i f. lulet e misrit. Kur misri është i pazhvilluar mirë, në mungesë të ujit thuhet: *misri do të mbesë jallofka ka lëshuar pysqyl* (Str.).

Pysqyl, -i f. lulet e misrit. Kur misri është i pazhvilluar mirë, në mungesë të ujit thuhet: *misri do të mbesë jallofka ka lëshuar pysqyl*.

Qyqyr m. vullkan pasiv në fshatin Kosel të Ohrit apo siç është e njohur si sulfurorja e Ohrit. Qyqyr, gaz me erë të keqe, që nxjerr njeriu a kafsha nga poshtë pa zhurmë. Besohet se në qyqyr shërohet majasëlli, hemoroidet.

Radake, -ja f. Nuk ia pret radakja (mendja). *S' ka radake ai për atë punë.*

Rriball/ë, -i m. Bimë shumëvjeçare e lartë. Mëe lartë se bimët tjera. Rri përballë bimëve tjera.

Rroke f. gështenjë e cila qërohet lehtë dhe hahet pa e pjekur dhe pa e zier. *Ai hante rroke. Merr prej asaj gështenje ajo bëhet rroke. Gështenjë rroke* (Str.T.).

Vrazhg/ë, -a f. vizë-a. *Ma bëri fletoren gjithë vrazhda* - ma bëri fletoren gjithë vija. *Nuk i kishte bërë detyrat si duhet dhe mësuesja i hoqi një vrazhdë* (Str.T.).

Sixhim ndajf. u lëshua sixhim. Iku me të shpejtë. Sixhim të shkosh, sixhim të kthehesh. Me të shpejtë të shkosh, me të shpejtë të kthehesh. Shkonte sixhim. Shkonte me të nxituar (Str.T.).

Spënc/ë, -a f. veri fundit të shportës spëncat dhe ngrii lart dhe bashkoi majat e purtekave dhe fillo ta thurësh shportën. *Zgjidhi spëncat e shportës më të gjata. Fig. I futi spënca atij. Mos fut spënca. Mos hidh benzinë në zjarr.*

Zhapk/ë, -a f. bretkosë. *Këndojnë zhapkat do të bjerë shi. E shkeli zhapkën.*

Karthick/ë, -a f. arra pa lëvoren jeshile. *Arrë karthickë. Gjithë karthicka qenkan.*

Shur, -i m. rëra, zalli. *Më sill një traktor me shur. Shuri nuk është i imët. Dua shur më të trashë.*

Stopk/ë, -a f. pengesë. *I vuri stopkën (këmbën) dhe e rrëzoi. Ma vuri stopkën - më pengoi.*

Shallak, -u m. Bimë shumëvjeçare që rritet nëpër vende moçalike, hendeqe etj. Bimë e ngjashme me shavarin, anët e gjetheve të shallakut janë të mprehta dhe presin si me brisk. *Korr shallak. Dua ja shallaku. U preva me shallak. Kujdes mos e presësh dorën me shallak.*

Shirit, -i m. buka e misrit kur piqet në çerep, meqë brumi është i trashë fundi i bukës nuk piqet mirë, pesë milimetra dhe thuhet: Buka ka zënë shirit (Str.T.).

Zemër cuce f. bot. Lloj lule shumëvjeçare me ngjyrë të bardhë në sheqerlie me katër petale më të gjera në formë të zemrës dhe dy më të ngushta, me gjethe të gjelbra të theksuar dhe të lëmuara. Rritet në saksi, zakonisht kultivohet brenda në dhomë apo në ballkon. *Do të më japësh një (lule) zemër cuce?* (Str.T.).

Tat/ë, -a f. tatë thirret motra e madhe ose ndonjë grua më e madhe në shenjë respekti. Përdoret nga fëmijët, zakonisht para një emri të përveçëm, për të thirrur me nderim një grua. *Tata Mixhja! Oj ta. Thërrite tata Besimen që të vijë* (Str.T.).

Tolls m. pjesa e barkut. *I ra në tolls, gjesh ia mori frymën. E tollur* (Str.).

Turillk/ë, -a f. Shkop i gjatë me një dërrasë rrumbullake në fund sa gryka e ftirit, dybekut. *E tundi ftirin(kosin) me turillkë. E theu turillkën* etj.

Ullau: *Ka mbetur ullau* - ka mbetur vetëm si qyq. *Mbetën të dy pleqtë llau* (Str.T.).

Vërdho fol. vrapo, nxito, thonë në Tatesh.

Ymell, -i m. lloj kanceri i gështenjave që del në degët e saj dhe ajo degë thahet. Degë në degën e gështenjës me kokrra të verdha sa një rruazë të mbushura me lëng. *Shumë ymell i kishte rënë gështenjave. Thye atë yvëllin* (Str.).

Zheleg, -u m. qengj deri njëvjeçar. Kape zhelegun me kërrabë. Zheleg është, nuk është dash. Në fshatrat e Strugës, me banim të shqiptarëve të cilët flasin dialektin gegë, thuhet xheleke. Bariu thotë unë kam një tufë dhensh e cila përbëhet prej 100 dele, 15 rrunza dhe 9 xheleke.

Zhomk/ ë, -a f. mbështjellësja me gjemba e gështenjave.

RECENSIONE

RILINDËSIT SHQIPTARË NË NJË TABLO TË RE

(Rreth librit "Rilindësit shqiptarë", të autores Gordana Sinadinovska, Shkup, 2014)

Rilindja Kombëtare Shqiptare, e shtrirë kryesisht në shekullin e 19-të, dhe në fillim të shekullit 20-të, përbën një nga periudhat më të lavdishme të popullit tonë. Ajo karakterizohet me një rizgjim të mirëfilltë kombëtar në të gjitha nivelet e zhvillimit të shqiptarëve si komb, në kërkim të pavarësisë politike nga pushtimet e huaja mijërvjeçare. Rilindësit tanë morën shembullin e veprimtarëve dhe intelektualëve më të mirë të kohës, që vepruan nëpër shumë qendra të rëndësishme politike, ekonomike e kulturore, duke hyjnizuar Atdheun e tyre, dhe duke sintetizuar idetë përparimtare për një zhvillim të gjithëmbarshtëm. Këto ide madhore, të hedhura në shumë faqe librash e gazetash shqipe, të botuara kryesisht jashtë trojeve shqiptare, u kurorëzuan me krijimin e një shteti të pavarur shqiptar 102 vjet më parë.

Libri më i ri i profesoreshës Gordana Sinadinovska me titull "*Rilindësit shqiptarë*", i botuar në dy gjuhë – shqip dhe maqedonisht, është një freski e këndshme që na dhurohet në këtë 28 Nëntor. Poezitë e Naimit, Bagerit, Serembes, De Radës, Çajupit, Mjedës, Asdrenit, Migjenit, Nolit e Poradecit, na vijnë në këtë festë më ndryshe se herëve të tjera. Këto poezi na simbolizojnë një rilindje të dytë të një pjese shumë të rëndësishme të popullit tonë, siç janë ortodoksët shqiptarë të anës së Rekës, të cilët gati se pas një shekulli sjellin xixat e para të një rilindjeje autentike shqiptare, në atë që kanë qenë kaheerë, me farë e me fis. Urojmë që kjo rilindje, sado pak e vonuar, të trokasë në ndërgjegjen e pastër të çdo shqiptari ortodoks të kësaj ane, i cili nëpër vite e dekada, është tjetërsuar, qoftë për shkak të dhunës, shtypjes e terrorit nga ana e sistemit antishqiptar të kohës, apo edhe joshjes me privilegje të natyrave të ndryshme.

Libri "*Rilindësit shqiptarë*", ka një metodologji të thjeshtë të mbarështimit të lëndës: fillon me parathënie koncize, vazhdon me prezantimin e 10 rilindësve më të njohur shqiptarë, për të cilët jep nga një biografi të shkurtër dhe disa poezi, më pas në mënyrë përmbledhëse paraqet shkurtimisht edhe rilindësit e tjerë, për të përfunduar me një rezyme, fotografitë e rilindësve dhe literaturën e shfrytëzuar.

Rilindësi shqiptar i cili radhitet i dyti në këtë libër, pas kolosit të madh të letrave shqipe, Naim Frashërit, është Josif Bageri. Për shkak të prejardhjes së tij nga Nistrova e Rekës së Dibrës, e cila territorialisht sot gjendet brenda Republikës së Maqedonisë, kjo figurë letrare, kulturore e historike, zë një vend të veçantë për të gjithë ne. Siç do të shohim edhe gjatë leximit të këtij libri, rilindësi Josif Bageri, pjesën më të madhe të veprimtarisë letrare e publicistike, dhe tërë qenien e tij intelektuale e fizike, e kishte të angazhuar në funksion të rilindjes së Shqipërisë dhe popullit shqiptar, të cilit i këndonte me shumë zjarr e krenari. Nga shumica e poezive të tij të botuara, shihet qartë se ai me përkushtimin më të madh i qasej

atdheut të tij, Shqipërisë, ku i shihte edhe ëndrrat, edhe shpresat për të ardhmen. Ai asnjëherë, dhe për asnjë çast, nuk do ta harronte vendlindjen e tij aq të dashur, Rekën, për të cilën shkruante se është *“kërthiza e Shqipërisë”*, madje edhe duke e glorifikuar me disa nga vargjet e tij më të bukura:

*“Reka, ti je zemra e Shqipërisë!
Ti je vendi i trimërisë...”*

Kështu, duke përthithur pjesë nga veprimtaritë më të bukura letrare të rilindësve tanë, edhe atë në dy gjuhët më të mëdha që fliten në vend, ky libër bëhet fare i lehtë dhe intrigues për lexuesin e cilësdo moshe apo përgatitjeje arsimore.

Prandaj, me plot bindje mund të konstatojmë, se libri *“Rilindësit shqiptarë”*, sa është i rëndësishëm për lexuesin shqiptar, shumëfish më tepër është i rëndësishëm për lexuesin maqedonas, i cili ka rastin që në mënyrë të përmbledhur, të njihet me perlat e letërsisë së Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Libri posaçërisht është i rëndësishëm për shqiptarët ortodoksë të Maqedonisë, me identitet të mohuar. Ky është edhe shans më tepër për ta, për t’iu rikthyer vetvetes dhe të vërtetës.

Autorët Gordana dhe Branko Sinadinovski, me botimin e veprave të tyre në dy gjuhë – shqip dhe maqedonisht, po bëjnë punë shumë fisnike në drejtim të afrimit ndërmjet këtyre dy popujve, si dhe për mundësinë e ofruar që secili të gjejë vetveten, aty ku peshon më së rëndi.

Sevdail DEMIRI

BALLKANI DJE DHE SOT SIPAS NJË STUDIUESEJE BALLKANASE

(*“Ballkani imagjinar” i M. Todorova*)

Për ne si banorë të Gadishullit Ballkanik, njëherazi dhe evropianë, interesimi për historinë e përbashkët, për problemet e përbashkëta, për fatet e përbashkëta dhe për gjithçka që shkruhet për Ballkanin është më se i natyrshëm. Vërejmë se për asnjë zonë tjetër të Evropës nuk është shkruar aq shumë sa për Ballkanin. Bibliografia për të përfshin mijëra vepra, studime, shkrime, udhërrëfime e të tjera, që nga kohët më të hershme e deri në ditë tona. Ngjarjet që ndodhën në këto dy dekadat e fundit me shpërbërjen e Jugosllavisë e ngritën edhe një herë Ballkanin në krye të agjendës të politikës dhe medias ndërkombëtare. Prej vitesh thënia për Ballkanin “fuçi baruti” është konsideruar një metaforë për një trevë plot konflikte dhe mistere, ku realja pleksej me imagjinaren. Por erdhi një ditë, që ngjarjet, luftërat, realiteti i tmerrshëm ia shkarkuan ngarkesën emocionale kësaj metafore dhe e nxorën atë në dritën e vërtetë, ashtu siç është; i gatshëm të ndezë zjarre, me paranoja dhe urrejtje etnike patologjike, sidomos në se përdoret për këtë qëllim ose lejohet.

Për shkak të ndodhjeve të 20 viteve të fundit disa nga librat për Ballkanin janë aq të ngjashme sa duken sikur përsërisin njeri - tjetrin. Madje, shpesh injorohet aktualiteti dhe për të nxjerrë deduksione, për t'u dhënë përgjigje dhe zgjidhje e deri justifikim problemeve të koklavitura të të sotmes, sipas interesave politike, perifrazohen vepra të një apo dy shekujve më parë për Ballkanin që, natyrisht, janë të vjetruara dhe aspak realiste.

Libri “Ballkani Imagjinar” i historianes me origjinë bullgare Maria Todorova, profesor në universitetin e Ilinoisit në Sh B A, botuar nga Instituti i Dialogut dhe Komunikimit dhe i përkthyer nga Bashkim Shehu, paraqet një model tjetër të konceptimit të historisë bashkëkohore të Ballkanit, të studimit të saj, jo vetëm duke e parë me këndvështrimin e ngjarjeve historike me rëndësi por, sidomos, edhe në aspektin socio-psikologjik, të konstitucionit shpirtëror të banorëve të tij, të larmisë së etnive, dhe religjioneve, të traditave letrare, artistike dhe kulturore.

Vepra, për karakterin e saj, kërkon vëmendje të veçantë sepse është tepër e ngjeshur me ide dhe interpretime origjinale duke polemizuar me shumë historianë dhe studiues perëndimorë të epokave të ndryshme, por më shumë me të sotëm, një vepër që ngjall diskutim dhe debat shkencor.

Konfliktualitetin në Ballkan Todorova e shikon në zanafillë, qysh në formimin e shteteve ballkanike nga Fuqitë e Mëdha të kohës gjatë procesit të shpërbërjes së Perandorisë Osmane për të vazhduar me Kongresin e Berlinit (1878), Konferencën e Londrës (1913), Konferencën e Paqes së Parisit (1919) dhe së fundi me Jaltën (1946). Kjo është dhe arsyeja pse prej afro një

shekulli problemet e Ballkanit mbetën po ato. Fuqitë e Mëdha i krijuan shtetet e Ballkanit sipas interesave të politikës dhe rivaliteteve të tyre të momentit. Përzien etni, u dhanë territore që nuk u takonin etnive të tjera, dhe e bënë, unë do

dëshiroja ta përsëris, e bënë Ballkanin burim të vazhdueshëm konfliktesh pikërisht për shkak të këtyre padrejtësive. Popujt e tij, siç thotë poeti ynë kombëtar Fishta, për më se një shekull “jetuan në mërinë e njeri-tjetrit”. Çdo komb ballkanik, në një periudhë apo në një tjetër, kanë qenë kombe të përkëdhelura të Fuqive të Mëdha evropiane. Sigurisht në vend të parë, në saj të historisë së tyre, kanë qenë grekët.

Pastaj vijnë me radhë rumunët, serbët, bullgarët dhe së fundit shqiptarët, që krijuan shtetin e tyre por të cinguar, për të favorizuar padrejtësisht të tjerët. Për pozicionin historik të bashkatdhetarëve të saj Todorova citon me objektivitet studiuesin rus Venelin, i cili thotë se bullgarët në Perandorinë Osmane konsideroheshin nga turqit osman si raja shumë e bindur, “si delja për njeriun... Është keq për bullgarët pse janë zejtarët më të mirë të Turqisë. Sundimi turk në Evropë mbështetet më shumë te bullgarët. Moldavët dhe vllehtë kanë qenë gjithmonë gjysmë të lirë... Shqiptarët gjithmonë kanë qenë gjysmë të pavarur, duke qenë nga natyra luftëtarë krenarë që u kanë shërbyer turqve vetëm për të përfituar, ose me pagesë. Malet madhështore i kanë mbrojtur në atë qoshen e tyre të vogël”. Pavarësisht nga ky konstatim, autorja citon edhe diplomatë e studiues të cilët të gjitha kombet ballkanike i kanë paraqitur si më praktikë, më diplomatë dhe më të mprehtë, se kombe të tjera evropiane dhe më të zhvilluar në shumë aspekte. Veçanërisht historiania nënvizon prirjen e ballkanasve “për të punuar që ta bëjnë jetën më të mire, të krahasueshme me klasat e larta, dominimi i shpirtit tregtar mbi

idealizmin, por njëkohësisht nga mangësia e stërholimit të ndjenjave dhe mungesa e mendimit të sofistikuar”. E megjithatë njerëzit, në Evropë dhe në Amerikë, u ndjenë të befasuar nga nacionalizmi agresiv, nga shpërthimi i dhunës dhe i luftërave barbare në ish- Jugosllavi, lufta që përmbyllën shekullin më gjakatar të historisë njerëzore, shekullin XX: Krimet e përbindshme, urrejtjet racore patologjike deri në gjenocid. Dhe kjo vinte sepse Evropa kishte krijuar stereotipin e vet për Ballkanin, nisur që nga Mesjeta, kryqëzatat, koha e romantizmit evropian, “zbulimi” i letërsisë antike greke, i monumenteve të kulturës dhe ndikimin e madh që patën ato në zhvillimin e gjithanshëm të shoqërisë evropiane. Ballkani u bë vendi i pelegrinazhit për shumë shkrimtarë, studiues, historianë, arkeologë e të tjerë, që me veprat e tyre krijuan një Ballkan imagjinar, me qytetërim oriental ku absurdja pleksej me realen, ku oksidenti përplasej me orientin.

Pikërisht për këtë Ballkan bën fjalë dhe “Ballkani Imagjinar” që konsiderohet gjerësisht si libri më i mirë i shkruar ndonjëherë për Ballkanin, për mënyrën se si ka ndryshuar historikisht perceptimi (përgjithësisht negativ) që ka Evropa për të, si “I paqytetëruar”, apo dhe ideja e ultësisë që popujt e Gadishullit shpesh ushqejnë për vetveten.” Ai është një libër thellësisht shkencor, shkruar me nerv polemizues ndaj atij Ballkani të përbuzur dhe të injoruar, produkt i gazetarisë mediokre; i shënimeve të udhëtimit, i eseve, i pseudostudimeve dhe librave që përsëritnin njeri-tjetrin, me fakte dhe analiza të pambështetura.

Vepra është konceptuar në një mënyrë krejt të veçantë dhe ka një pikësynim: të japë Ballkanin e vërtetë dhe jo të sajuar sipas interesave të politikës së momentit, fantazive të vizitorëve, studiuesve, shkrimtarëve, diplomatëve, që kërkonin një kontinent të ri brenda kontinentit të vjetër që “po bastardohej nga qytetërimi i zvetënuar”. Por në të vërtetë Ballkani ishte vetëm një hap larg vendeve të

vetëquajtura moderne. Diferencimin e bën zhvillimi i tyre më i madh ekonomik, e bën teknologjia. Prandaj, për studiuesen më tepër se ngjarjet dhe rreshtimi i tyre, betejat, luftërat për tokë dhe territore kanë rëndësi realitetet konkrete të Ballkanit në kohë të ndryshme, mendësitë e popujve të tij, me ato që i bashkojnë dhe që i ndajnë. P. sh. pushtimi osman, ndonëse ishte unik në të gjithë Ballkanin, përsëri reflektimi te popujt ishte i ndryshëm. Gjithsesi ata arritën të ruanin identitetin, gjuhën dhe kulturën. “Një nga gjërat më të bukura të kombeve ballkanike, arrin në përfundim historiana, por gjithashtu mallkimi i tyre, është se kanë histori jashtëzakonisht të pasur dhe të dendur, por që më së tepërmi janë të mbyllur në vetvete”. Ia vlen të kujtojmë se shumica e popujve të sotëm të Ballkanit kanë jetuar për 2000 vite në të njëjtat perandori shumëkombëshe – Romake, Bizantine dhe Osmane, që pas viteve të para të dhunës ndaj rezistencës e luftës për liri u përfshinë në jetën e perandorisë (ky është fati historik i popujve të vegjël). Ishin gjithashtu shekuj këmbimesh ndërmjet popujve të ndryshëm, këmbime kulturore, gjuhësore dhe njerëzore, por edhe ndeshjesh ndërmjet tyre dhe ndaj perandorive sa herë që shtohesh dhuna apo shtetet feudale që krijoheshin ose rikrijoheshin sulmonin njëri-tjetrin. Kjo ndodhi sidomos kur u shpërbë Bizanti e më vonë Turqia, pra kur krijoheshin shtete nacionale. Me këtë optikë objektive autorja shpjegon dhe krizën jugosllave, pra jo me terma fantazmash ballkanike, armiqësish të moçme, trazirash proverbiale ndryshimesh religjioze dhe kulturore, por me kriteret racionale; parimet e vetëvendosjes të pakushtëzuar sipas etnive, kundër status quo-së së paprekshme, të drejtat e minoriteteve etj., parime që i shpalli për herë të parë presidenti amerikan Willson, në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919, por që po mundohen të bëhen realitet vetëm sot, në kohën e zhvillimeve të vrullshme dhe të integritimeve të mëdha.

Si hyrje të studimit të saj autorja i ka dhënë përgjigje një pyetje të thjeshtë në dukje, por që është orientuese, është një çelës për t'i hapur dyert njëra pas tjetrës: “Ballkanizmi dhe orientalizmi : A janë kategori të ndryshme?” Këto dy terma analizohen gjerësisht në plan krahasues me autorë të tjerë dhe nuk kemi pse zgjatemi për to, por ne nënvizojmë shpjegimin që i jep historiana “irredentizmave ballkanase i cili nuk buron nga feja, por nga nacionalizmi agresiv” që edhe sot e mban pezull rajonin dhe që bota e qytetëruar duhet ta zgjidhë një herë e mirë. Vetëm kështu Ballkani do të evropianizohet plotësisht, një proces që ka nisur prej kohësh në sfera të ndryshme dhe në rajone të veçanta të tij, por që kërkon kohë të realizohet, dhe pengesa më e vështirë nuk janë standardet, që aq shumë trumbetohen, por prapambetja ekonomike dhe izolimi nga Evropa.

Duke u marrë me emërtimin e emrit “Ballkan” në pjesën e dytë kemi një ekskursion interesant në historinë e vjetër dhe mesjetare të kësaj treve që më shumë se çdo gjë ka “prodhuar” ngjarje, mite dhe legjenda. Janë dhjetëra autorë që i nënshtrohen analizës krahasuese dhe që meritojnë vëmendje të posaçme. Duhet të nënvizojmë faktin interesant se emri i gadishullit tonë është tepër i ri, i gjysmës së dytë të shekullit XIX. Në përgjithësi, përkufizimi i Ballkanit tashmë shihet si sinonim i Evropës Juglindore, përkufizim që është arritur sipas kriteresh gjeografike, politike, historike, fetare, ekonomike etj, pra një përzierje kriteresh. Autorja sqaron edhe derivatin e termit Ballkan, d.m.th “ballkanizim”, që shfaqet

për herë të parë të nesërmen e Luftës së Parë Botërore : artikulli i parë me këtë term është ai i 20 dhjetorit 1918, botuar në New York Times, një intervistë me Rutenau, kreun e industrisë së madhe gjermane. Me “Ballkanizim” ai kuptonte copëzimin e vendeve dhe të shteteve. Në fjalorin e sotëm politik dhe kulturor ku term e ka zgjeruar shumë fushën semantike duke emërtuar një seri fenomenesh të pakëndshme dhe të padëshirueshme.

Me këtë Gur Sizifi mbi kurriz, në pamje të parë, të krijohet përshtypja se ballkanasit i ndjejnë shumë deformimet e peshës dhe studiuesja rreket gjatë ta shpjegojë këtë me parametra dhe optikë perëndimore. Por krahas “perceptimit të jashtëm” ekziston edhe të “vetëndjerët”, d.m.th: Si mendojnë ballkanasit për vetveten? Ky është “shqetësim” vetëm i një pjese të elitës së arsimuar në Perëndim, sepse pjesa e tjetër as që do t’ia dijë, as që merr mundimin ta analizojë. Si pragmatike ajo vështron më shumë përpara. Për të ka më rëndësi e sotmja se sa e kaluara. Nacioni Homo Balkanicus për ta është i huaj dhe perëndimorët më tepër e njohin nëpërmjet heronjve të letërsisë se sa realisht. Prandaj na duket se qëndrimi ndaj Ballkanit është shumë më kompleks se sa tipat dhe karakteret e qëmtuara nga letërsia dhe folklori. Ai pasqyron vetëm interesa rajonale, religjioze, ideologjike dhe ekonomike të vendeve të mëdha evropiane. Kjo u vu re në këto vite të përgjakshme të shpërbërjes së Jugosllavisë. Me ndodhitë e viteve të fundit Ballkani ka ndryshuar për mirë, vende të tij janë anëtarësuar në BE dhe Ballkani imagjinar, primitiv dhe agresiv u varros njëherë e përgjithmonë. Tashmë evropianizimi i tij është një proces i pandalshëm dhe po humb peshë në vendimmarrje qëndrimi i vendeve të veçanta evropiane dhe sidomos po tregohet vendimtar qëndrimi amerikan. Është me interes të vërejmë se dora dorës që vende të veçanta ballkanike po hyjnë në Bashkimin Evropian dhe të tjerët janë nisur kësaj rruge, po fiton qytetari termi Evropa-Juglindore, ndërsa për ne të tjerët termi Ballkani Perëndimor, duke veçuar ato vende ku Serbia krijoi probleme, ndaj të cilave duket se do të ketë trajtim e qëndrim të përafërt apo të njëjtë. Pikërisht në këtë aspekt arsyetimet që bën autorja për përkatësinë e Ballkanit si zonë e Evropës Jugore apo Qendrore të prapambetur, tashmë na duken të kapërcyera. Kohët moderne kanë shkurtuar distancat dhe kanë shumëfishuar lëvizjen e lire të ballkanasve. Prapambetjen sot e gjen edhe në kryeqytet më të mëdha të Evropës. Prandaj duket ta vështrojmë Ballkanin me sytë e së nesërmes ku ai po shkon dhe jo si antiqytetërim. Çdo ditë që kalon ai po integrohet gjithnjë e më shumë në bashkësinë evropiane. Pikërisht këtë tendencë duhet të kishte nënvizuar më shumë historiania. E kaluara evokohet për t’i shërbyer të sotmes, për të nxjerrë mësim nga ajo dhe jo si qëllim në vetvete. Sepse nuk mund të shpjegohet prapambetja e ballkanasve vetë sepse ata kanë qenë të pushtuar nga Bizanti dhe më pas nga turqit osmanë. Trashëgimia osmane prej më se një shekulli është daravitur. Që këtë del edhe konkluzion i autores se trashëgimitë nuk janë të përhershme, por fenomene historike të kalueshme. Çdo fetishizim i tyre është propagandë vulgare ideologjike, për të justifikuar prapambetjen. Braktisjen e kësaj teze të parët e kanë bërë vetë turqit, që janë trashëgimtarë të drejtpërdrejtë të Perandorisë Osmane.

Vetëm kur mbyll fagen fundit të këtij libri, që e ke mbajtur për një kohë të gjatë në dorë e kupton se atë nuk e ke lexuar si shumicën e librave historikë, për të

shuar kureshtjen. Ai kërkon përqendrim, kërkon arsyetim, është një vepër me peshë të rëndë specifike. Ndonëse mund të mos jesh dakord me disa përfundime, përsëri vepra të mëson si duhen analizuar faktet dhe ngjarje, lidhjet shkakore midis tyre. Vepra është rezultat i një pune të madhe selektive, për një kohë të gjatë. Në duart e Todorovës ka kaluar pjesa më e madhe e veprave të shkruara për Ballkanin që nga Mesjeta e Hershme e deri në ditët tona. Por në suksesin e saj përveç erudicionit të madh në formimin si historiane ka ndikuar edhe përkatësia bullgare dhe, më pas, plotësimi i studimeve në ShBA. Atje ajo ka pasur mundësi dhe kushte optimale të njohë deri në imtësi jo vetëm historinë e vendit të vet, por të gjithë rajonit. Mbarimi i Luftës së Ftohtë, rënia e Murit të Berlinit, janë ngjarje të jashtëzakonshme historike me pasoja mbarëbotërore, që krijuan një reaksion zinxhir. Për Ballkanin këto dy ngjarje rezervuan edhe konfliktin e armatosur të shpërbërjes së shtetit fiktiv jugosllav.

Kur flasim për prapambetje të popujve të Ballkanit duhet ta kuptojmë këtë si një dukuri relative që po zhduket me kohë dhe punë. Kështu, nuk duhet harruar se gjatë historisë ka pasur dhe shekuj të errët për Evropën Perëndimore, me dukuri dhe më negative se ato që u vërejtën në vendet ballkanike në shekullin e kaluar. Ajo që vlen është fakti pozitiv i dëshirës për përparim dhe integrim me dinjitet në familjen evropiane. Por në Evropë nuk pranohesh me bagazhin e miteve të së shkuarës dhe me dëshirën për të sunduar popuj të tjerë, duke bartur tek të tjerët kriza dhe pengesa për zhvillimin e të gjithëve. Përfshirja individuale apo me grupe e vendeve të të quajturit Ballkani Perëndimor në BE është synimi edhe i vetë bashkësisë evropiane, e cila, së bashku me ShBA-në po përpiqet për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës, pavarësia e së cilës do sjellë një përmirësim të dukshëm të klimës në marrëdhëniet ndëretnike në rajon dhe ulje të tensioneve. Çdo zgjidhje tjetër jo vetëm që është e papranueshme për shqiptarët, por dhe e padobishme për stabilitetin e rajonit, një pengesë për integrimin e tyre në BE. Stabiliteti në të quajturin Ballkani Perëndimor do t'i japë një shtysë dhe zhvillimit ekonomik në rajon, premisë për integrimin e tyre në BE. Me integrimin në Bashkimin Evropian të vendeve tona mbyllet një periudhë e veçantë njëshekullore e historisë shqiptare, ajo e copëzimit të trojeve të banuara nga ta në shekuj dhe e veçimit të tyre nga njeri-tjetri. Me integrimin në BE krijohet mundësia për një zgjidhje virtuale të çështjes shqiptare (si hap i parë), sepse nuk do të ketë pengesa për një jetë mbarëkombëtare në komunikimin njerëzor, në aktivitetet dhe shkëmbimet ekonomike, në veprimtari shkencore e kulturore të përbashkëta. Sigurisht që hapat e mëtejshme, në realizimin e kësaj ëndrrë shekullore të shqiptarëve, do të varen nga vetë ata dhe forcat politike vendase, që do duhet të krijojnë një mentalitet të ri në aspektin e çështjes kombëtare, të cilën sot për sot pak e dëgjojmë.

Aleksandër MEKSI

Kemalettin KUZUCU, Layihalar Işığında Bağımsızlık Sürecinde Arnavutluk'un Sosyal ve Siyasal Durumu (1860-1908), Türk Dünyası İncemeleri Vakfı/Journal of Turkish World Studies, XII/2, 2012, f. 309-332.

(Gjendja Sociale dhe Politike në Periudhën e Pavarësisë së Shqipërisë në Dritën e Memorandumeve (Osmane) 1860-1908)

Siç dihet tashmë, në periudhën pesëshekullore të sundimit osman faktorit shqiptar luajti një rol mjaft të rëndësishëm në sferën ushtarake, duke nxjerrë udhëheqës supremë, që më vonë erdhën edhe në pozita të larta shtetërore, duke shërbyer si administratorë, por edhe si dijetarë të çmuar.

Autori turk, duke u bazuar në raportet osmane, na e prezanton gjendjen e shqiptarëve, me theks të veçantë atë të shekullit XIX, kur edhe lindi nacionalizmi në botën perëndimore. Nga ky nacionalizëm, edhe pse më pak të ndikuar, shqiptarët përsëri në një farë mënyre e shprehën pakënaqësinë e tyre. Atë që nuk e përmend autori është se a kishin shqiptarët të drejtë për një pavarësi njësoj si fqinjët e tyre.

Sipas autorit të këtij artikulli, nisma për pavarësi të Shqipërisë daton edhe më herët se Revolucioni Francez, madje që nga viti 1779 me një kryengritje të përbashkët të gegëve dhe toskëve. Ky grup udhëhoqej nga Mahmud Bushatliu, i cili e kishte përkrahjen e Austrisë. Kjo kryengritje shtypet nga Hasan Pasha, ndërsa pastaj dënohet nga popullata myslimane për arsye se bëri marrëveshje me Austrinë. Në vitin 1796 ai filloi të bashkëpunojë me Francën kundër Austrisë dhe Rusisë me qëllim që ta aneksojë Malin e Zi. Kjo politikë e dyanshme bëri që ai të vritet nga malazezët, thuhet në këtë artikull. Sipas autorit, shkaku i kryengritjes së palëve në fjalë është politika e paaftë osmane.

Në vitin 1835-1836 kryengritjet në Veri ishin bërë nga gegët, ndërsa në vitin 1844 në Jug ishin realizuar nga toskët, por këto dyja nuk ishin në koordinim me njëra-tjetrën. Në bazë të referencave që i përdor autori, shkaku i të gjitha kryengritjeve ishin tatimet e rënda, obligimi ushtarak dhe udhëheqja burokrate jo e mirë, ndërsa për gjithë këtë faktore ishte administrata vendase.

Zhvillimi social në trevat shqiptare

Në raportet e Ahmed Xhevdet Pashës, i cili në vitin 1861 caktohet si guvernator i Shkodrës, thuhet se shqiptarët janë guximtarë të mëdhenj, por të pacivilizuar, porse në raport nuk ceket shkaku i mos civilizimit të shqiptarëve. Pjesën më të madhe të Shqipërisë, thuhet në raport, e përbënin gegët, ndërsa një pjesë të vogël toskët. Në bazë të këtij raporti, shqiptarët ndahen në dy grupe.

Autori i përmend tiparet e gegëve dhe toskëve, duke i përshkruar edhe dallimet e vogla mes tyre. Toskët, thuhet aty, ishin shumë të afërt me grekët për nga e folmja e tyre, në gjuhën e tyre kishte shumë fjalë greke, ata u ngjanin shumë grekëve dhe nuk ishin këmbëngulës në qëllimet e tyre, thuhet në raportin që sjell autori. Ata me shumicë ishin ortodoksë, andaj paguanin tatim, por edhe ishin të liruar nga shërbimi ushtarak. Tentativa greke ishte që këtë pjesë të shqiptarisë ta

asimilojë. Në anën tjetër, gegët – që ishin të krishterë katolikë, e kryenin shërbimin ushtarak dhe, ndonëse dukeshin të ashpër, ishin të sinqertë në fjalë. Shumica ishin bujq dhe blegtorë, ndërsa pjesa tjetër prodhonte bozë, thuhet në raportin e Xhevdet Pashës që interpreton autori.

Në pjesën malësore thuhej se malësorët jetojnë njëjtë pa dallim feje. Malësori i krishterë nuk i afrohet një të krishteri tjetër sikur i afrohet një malësorit mysliman. Ata jetojnë të lirë mes vete në një harmoni të plotë, thuhet në artikull. Është me rëndësi të veçantë të thuhet se malësoret kishin në krye një krye udhëheqës, i cili i informonte dhe e rregullonte jetën sociale. Por, malësorët nuk ishin nën sundimin e sistemit, sepse ata kishin të drejtë të ecin me armë edhe kur nuk kishte luftë. Me siguri kjo është një strategji e shtetit që të mos i hidhërojë ata.

Në vitin 1879 valiu i Janinës Ahmet Rasim Pasha thotë se numri i shqiptarëve është dy milionë, 2/3 myslimanë dhe 1/3 krishterë. Ndërkaq Ahmed Xhevdet Pasha flet hollësisht për Shkodrën pa dallime fetare kur thotë se $\frac{3}{4}$ janë shqiptarë, ndërsa pjesa e Malit të Zi $\frac{1}{4}$ thuhet se janë boshnjakë dhe kroatë. Një të dhënë sjell guvernatori i Prizrenit Mehmet Izet, i cili për shqiptarët malësorë të Shkodrës thotë se ishin injorantë dhe shumë trima, por kishin prirje që mos të përkulen dhe nuk besonin në argumentet abstrakte që i paraqisnin administratorët derisa nuk e shihnin atë me sytë e tyre.

Sipas Mehmetit, vendi ishte i paurbanizuar dhe i pazhvilluar, njerëzit ishin të paarsimuar dhe nuk kishte siguri të mjaftueshme. Prodhimi i vetëm ishte qymyri dhe leshi nga bagëtitë. Andaj, thotë Mehmeti, për ta zgjidhur një problem të tillë nevojitet kohë. Por, ai nuk e përmend shkakun për ngecjen e shqiptarëve. Administratori osman ia hedh fajin luftës osmane-ruse në vitet (1877-1878), e cila u bë shkak për 12 mijë refugjatë.

Në raportin e vitit 1892 Mehmet Izeti për çështjen e arsimit shqip thotë se ky problem duhet të zgjidhet, sepse, në të kundërtën, tendencat nga jashtë për manipulim do të jenë edhe më të pranishme. Ai propozon të hapen shkolla, por nuk ceket se cila do të jetë gjuha e arsimit. Supozohet se ai aludon në gjuhën turke.

Hapat që i ndërmori Ahmed Xhevdet Pasha në Shkodër ishin ndërtimi i shkollave dhe i disa xhamive. Duke pasur parasysh se shqiptarët nuk ishin të gjithë myslimanë, kuptohet se ky ishte një avancim vetëm për një grup. Më herët në një raport të Sulltan Abdylazizit, në vitin 1863, potencohet se urgjentisht në malësi të Shkodrës duhet të ndërtohen shkolla dhe xhami. Ajo çka është pozitive mund të thuhet se është zhvillimi i arsimit të shqiptarët e komitetit mysliman, por jo edhe arsimit në gjuhën amtare, që për shqiptarët ishte problem kryesor.

Autori i këtij artikulli potencon bindjen e gjithë shqiptarëve, e sidomos të rilindësve, të cilët mendojnë së për mosemancipimin e shqiptarëve fajtorë është udhëheqësia osmane. Autori u referohet fjalëve të valiut Pashko Vasa, i cili e shpjegon moscivilizimin e shqiptarëve të braktisur nga arsimit dhe të privuar nga gjuha amtare. Pashko Vasa në vijim përmend barrierën që e tango zhvillimin e shqiptarëve, si në aspektin material, ashtu edhe në aspektin shpirtëror. Me këtë pengesë reflektohet gjendja e shqiptarëve në fund të sundimit osman. Edhe pse shqiptarët me sukses arritën ta ruajnë gjuhën, identitetin dhe guximin luftarak,

prapëseprapë në aspektin kulturor ata kishin ngelur shumë mbrapa fqinjëve të tyre, thotë Pashko Vasa.

Duke iu referuar fjalëve të rilindësve, autori potencon se ortodoksët shqiptarë ishin nën mbrojtjen e grekëve, kurse katolikët shqiptarë nën mbrojtjen e austriakëve dhe kjo, sipas tij, reflektonte një rrezik të madh për shqiptarët. Derisa ortodoksët dhe katolikët kaluan në arsimin modern, myslimanët vazhdonin me metodën e vjetër të arsimit. Kjo dukuri edhe më tepër i mllëfosi rilindësit shqiptarë. Siç dihet, qëllimi i rilindësve ishte të kalohet në metoda të reja të arsimit. Për këtë arsye konsideroj se autori në këtë rast është objektiv në problemin e arsimit shqiptar në kohën e Rilindjes Kombëtare.

Ardhja e Abdylhamitit në pushtet krijoi njëfarë reforme në arsim: nga viti 1894-99 u hapën shkollat dhe u ndërtuan xhamia, nuk ceket lloji i shkollave a ishin shkolla fetare, mejtepeve, siç e dimë ne, apo shkolla të përgjithshme. Sulltan Abdulhamiti, me qëllim që të sigurohet, kërkoi nga administrata t'i raportojë edhe për sa shkolla ka nevojë të ndërtohen në trevat shqiptare. Në vitet në vijim arsimit bëhet me participim, ndonëse kjo nuk ishte traditë te shqiptarët, sepse ata vite me radhë participimin e jepnin nga prodhimi i tokës. Në vendet ku nuk jepej participimi, mësimdhënia anulohet. Këtu mendoj se bëhet fjalë për vendet ku prodhimi tokësor ishte i dobët, aty ku tokat ishin jopjellore dhe popullata nuk mund t'i mbulonte harxhimet vjetore. Këto vendbanime me kokëfortësi vendosën që të mos japin participimin duke e abstenuar mësimin. Autori rrëfen qëllimin e Abdylhamitit i cili nuk dëshironte që fëmijët të mos arsimohen, sepse e urrente injorancën. Në vitin 1903 shteti osman mori përsipër që në vendet malore participimin shkollor ta mbulojë vetë.

Një shkak tjetër për mungesën e arsimit efektiv ishte edhe gjakmarrja ndërmjet shqiptarëve. Kjo dukuri e keqe vite me radhë e minonte zhvillimin kulturor të shqiptarëve. Autori përmend se shqiptarët në disa raste i vritnin edhe udhëheqësit që vinin nga Stambolli. Kjo ishte edhe arsye për mungesën e menaxhimit efektiv të vendit, thotë autori.

Një ndryshim tjetër që bëri Abdylhamiti ishte edhe ndalimi i bektashizmit dhe rritja e tatimeve për zejtarët dhe tregtarët e qytetit. Kjo në një mënyrë u dha malësorëve një autonomi për të mos e kundërshtuar qeverisjen. Me këto ndryshime Sulltani kishte për qëllim ta eliminojë dukurin e gjakmarrjes ose, së paku, ta zvogëlojë ritmin e kësaj. Sipas referimit të Ahmet Xhevdet Pashës, i cili thotë se nuk kishte ditë pa vrasje, me reformën e Tanzimatit kjo dukuri u zvogëluar dukshëm. Sulltan Abdylhamiti II i kushtoi kujdes të veçantë edhe çështjes së gjakmarrjes. Prandaj ai i urdhëroi udhëheqësit shtetërorë që ta ndalojnë këtë dukuri, duke ushtruar dënime të rëndë për ekzekutorin. Në anën tjetër bëri edhe pajtimin e familjeve të hasmuara mes vete. Ndërkaq ata të cilët nuk u pajtuan i mori nën sigurimin e shtetit.

Nga raporti i valiut të Kosovës, Mehmet Shakiri, gjakmarrja ishte zvogëluar përafërsisht shumë dhe se popullata mbeti e kënaqur me këto reforma. Autori e potencon edhe rolin e klerikëve fetarë në realizimin e këtyre reformave.

Problemet që rezultojnë me rritjen e nacionalizmit

Autori, duke iu referuar disa studiuesve të tjerë, përmend popujt e Ballkanit që e pranuan edhe fenë islame me shumicë, ndërsa shqiptarët i përmend si të fundit që u prekën nga ndjenja e nacionalizmit. Edhe pse elita intelektuale shqiptare dëshironte të krijojë një ambient antiosman, nga ky tekst kuptohet se ata ende nuk ishin ndarë nga osmanizmi shekullor.

Në këtë artikull përkufizohet problemi i kamotshëm i shqiptarëve, mungesa e një gjuhe letrare mbarëkombëtare të përbashkët. Edhe pse me Tanzimatin përmirësohet gjendja e arsimit të shqiptarëve, ky lloj arsimi i ndante shqiptarët në tre taborë. Fëmijët e shqiptarëve myslimanë ndiqnin mësim në shkolla turke, ortodoksët shqiptarë në shkolla greke dhe katolikët në shkolla italiane. Për rilindësit, si duket, kjo ishte pengesë e madhe për zhvillimin e përbashkët kulturor të shqiptarëve. Nga referenca që përdor autori mësojmë se politika e fshehtë osmane mbështetej në numrin e popullsisë shqiptare myslimane, që arrinte diku 75% të popullatës shqiptare, dhe ky grup ishte aleati i më mirë i shtetit osman.

Në këtë artikull çështja shqiptare shihet nga kënde të ndryshme. Nga këndvështrimi osman, çështja shqiptare i ngjante Kaukazit, që nënkuptonte se nuk ishte shumë punë e madhe, por ishte diçka e zakonshme. Gjithnjë sipas këtij teksti, historianët evropianë për shqiptarët thonë se duhet të emërtohet kombësia shqiptare, ndërsa historianët shqiptarë thonë se lëvizja shqiptare duhet të kuptohet si rilindje kombëtare.

Në artikull potencohet edhe roli i Lidhjes së Prizrenit për vetëdijesimin e shqiptarëve. Pas Traktatit të Shën Stefanit, me çka Serbia dhe Mali i Zi duhej t'i aneksonin tokat shqiptare, me çka lindi Lidhja e Prizrenit. Si hap i parë ishte formimi i organizatës “Bashkimi i shqiptarëve”. Me siguri Lidhja e Prizrenit ishte vazhdimësia e kësaj. Sipas autorit, organizata shqiptare për mbrojtjen e trojeve shqiptare e kishte përkrahjen e administratorëve osmanë, thuhet në këtë kumtesë. Por, që shqiptarët ta mbronin vetë vatanin e tyre, ndihma ishte indirekte nga shteti osman.

Autori duke iu referuar disa burimeve të tjera, përmend edhe kërkesat e lidhjes së Prizrenit, me theks të veçantë gjuhën shqipe dhe abetaren shqipe, që ishin kushtet kryesore për rilindësit. Edhe pse kishte dilema të ndryshme rreth cilit alfabet, në vitin 1879 vendosin për alfabetin latin me 36 shkronja. Autori, si referencë, potencon se çështja e alfabetit latin të shqiptarët ishte zgjuar edhe më herët se te turqit. Ne konstatojmë se Sulltan Abdulhamiti e refuzonte alfabetin latin.

Autori sjell deklaratën e Lidhjes së Prizrenit në raportet Osmane, duke potencuar kërkesat dhe rreziqet nga mospërfillja e këtyre kërkesave. Në kumtesë autori paraqet aspiratat e evropianëve duke i quajtur imperialistë, të cilët së pari mendonin t'i marrin tokat shqiptare, e pastaj nga Ballkani ta zhvendosnin edhe fenë që shqiptarët e kishin pranuar nga osmanët. Njëkohësisht ai përmend se të gjithë shqiptarët ishin të një qëndrimi – të gravitojnë në shtetin osman, por të mos të aneksohet edhe një copë e tokës shqiptare.

Projekti i Lidhjes së Prizrenit, sipas autorit, ishte që të bien poshtë idetë imperialiste të evropianëve, por që edhe shteti osman të lejonte bashkimin e katër

vilajeteve shqiptare. Ndryshe, shqiptarët kishin vendosur që t'i kapin armët për të drejtat e tyre. Sipas autorit, Lidhja e Prizrenit – edhe pse dukej kundër aneksimit të tokave shqiptare nga fqinjët – ai mendon se kjo lidhje ishte një projekt politik për avancimin kulturor të shqiptarëve. Njëkohësisht ai na e bën me dije se derisa dikush kërkon pavarësi të shqiptarëve, pronarët e tokave, bejlerët, e informuan shtetin osman se kjo lëvizje do të sjellë probleme më të mëdha. Bejlerët nuk dëshironin të bien në nivelin e një të krishteri, pra në pozitën që ata e kishin në shtet. Ankesën që bënë bejlerët jep të kuptohet se ata nuk e përkrahnin Lidhjen e Prizrenit.

Për ndjekjen e aktivitetit të Lidhjes së Prizrenit shteti osman e angazhoi Dervish Pashën. Sipas autorit, ai arriti ta zmbrapsë popullin nga ideja që e kishin për bashkim. Ky pasha nuk arriti të bisedojë me kreun e Lidhjes. Shtypjen që Dervish Pasha e bëri mbi shqiptarët, e arsyetonte me atë se udhëheqësia e Lidhjes së Prizrenit nuk dëshironte të bëjë negociata me Pashën. Ky i fundit e akuzon udhëheqësinë e Lidhjes, duke thënë se janë të ndikuar nga perëndimorët, ngase – sipas tij – ata më vonë edhe janë penduar për këtë gabim. Në këtë korrespondencë thuhet se me qëndrimin e Dervish Pashës u pajtua Prizreni, Novi Pazari, Shkupi dhe Dibra.

Strategjia e Dervish Pashës ishte që shqiptarët të largohen nga pavarësia dhe t'u kushtojnë kujdes çështjes së kufijve. Ai me siguri mendonte në kufijtë e shtetit osman, që kishin qenë më herët, ngase shqiptarët e kishin humbur një pjesë të tokave të veta. Në të vërtetë shteti osman këto toka i konsideronte si të vetat, por që i pat humbur në Kongresin e Berlinit.

Autori, duke iu referuar Sulejman Kylçes, përmend anët pozitive të sundimit të Dervish Pashës, për të cilin thotë se periudha e gjatë e sundimit në trojet shqiptare e bëri që ta njohë popullin shqiptar me të gjitha veçoritë që i ka ky popull. Autori thotë se Dervish Pasha e solli sigurinë në vend, përkohësisht e neutralizoi lëvizjen shqiptare dhe pasurinë që e merrte nga të pasurit ua ndante të varfërve. Analiza është e njëanshme, sepse nuk i përmend anët negative.

Në këtë artikull përmenden dy ideologët e nacionalizmit shqiptar, Pashko Vasa dhe Samiu, ky i fundit me emrin “Shemsedin”, të cilët edhe pse e zhvillonin aktivitetin e zgjimit kombëtar, ishin të vetëdijshëm se duhet të mbahet aleancë me shtetin osman derisa ai të ekzistojë, ngase rreziqet nga shtetet fqinje ishin shumë më të mëdha se rreziku osman. Edhe pse Pashko Vasa ishte katolik, ai e mendonte gjendjen e një shqiptari mysliman pasi të tërhiqet shteti osman nga këto troje dhe ky mund të konsiderohet si një parashikim i qëlluar i Vasës.

Autori sjell mendimet e disa historianëve, siç është Ramsour, i cili në lidhje me Abdylhamitin thotë se qasja e tij ishte që ta zhvishte bektashizmin nga rilindësit shqiptarë. Kurse Andonjani thotë se vetë Abdylhamiti e përkrahu lëvizjen shqiptare në Mal të Zi, për ta ndaluar ashtu hovin sllav në trojet osmane. Ose, siç thotë autori, ndihma e shtetit osman ishte e kushtëzuar, sepse këto toka konsideroheshin toka osmane. Në bazë të osmanlinjve, kjo mbrojtje nuk duhej të kuptohet si mbrojtje shqiptare, por duhej të cilësohet si mbrojtje osmane.

Autori, duke iu referuar burimeve të tjera turke, thotë se qëllimi i Abdylhamitit në këtë qasje ishte t'i zbusë nacionalistët shqiptarë dhe njëkohësisht

t'i afrojë konservatorët me bindje fetare, që ata në njëfarë mënyre t'u bëjnë ballë pushtuesve fqinj. Nga kjo shihet qartë se Abdylhamiti në mënyrë indirekte e ndihmonte lëvizjen shqiptare. Abdylhamiti, për t'i fituar konservatorët shqiptarë, duhej të bënte disa ndryshime në favor të shqiptarëve. Së pari bëri lirimin nga tatimi, pastaj e largoi ushtrinë e rregullt, duke bërë ushtri vetëm me pagesë, e pastaj krijoi një njësi mbrojtëse në sarajin e tij nga shqiptarët. Në mesin e liderëve konservatorë ishte edhe Isa Buletini, të cilit i dhanë dhurata të shumta. Kjo mënyrë ndoshta ishte diskriminim për palën e cila nuk ishte konservatore, sepse ashtu kuptohej njëfarë autonomie njëanshme.

Në vitet në vijim në shtetin osman bëheshin edhe sulme të armatosura nga shqiptarët, të cilët ishin në kundërshtim edhe me organizatën “Bashkim dhe Përparim”, në të cilën kishte edhe shqiptarë, thotë autori. E kemi shembullin e Ibrahim Temos, i cili llogaritet si njëri nga themeluesit e saj. Por, me paraqitjen e kësaj organizate, do të shihen të gjitha dilemat e imta, si për shqiptarët reformistë, ashtu për konservatorët dhe turqit nacionalistë. Por dallimet në mesin e nacionalistëve shqiptarë asgjësohen, me shpalljen e qeverisjes parlamentare, atëherë kur shqiptarët hynë në rrugën e bashkimit.

Ndikimi evropian dhe puna e misionarëve

Autori potencon se organizata “Bashkim dhe Përparim” ishte e vetëdijshme për qëllimin e imperialistëve evropianë për aneksimin e tokave pjellore shqiptare, potencialin e së cilës nuk e kishte vlerësuar sa duhet shteti osman. Në anën tjetër vendet fqinje e kishin perceptuar një gjë të tillë dhe dëshironin t'i aneksonin tokat shqiptare. Në vitin 1854, edhe pse pa sukses, Greqia ishte vërsulur drejt Epirit. Edhe pse aneksimi ushtarak grek ishte i pasuksesshëm, grekët vazhduan me mënyra të tjera tendencioze. Kjo në veçanti u duk në aktivitetin kulturor në trojet shqiptare. Së pari ishte hapja e shkollave greke dhe italiane, që në njëfarë mënyre ishte mbisundim politik. Kjo ua solli shqiptarëve një të mirë – zgjimin e vetëdijes kombëtare. Edhe pse me vonesë, shteti osman e hetoi një politikë të atillë dhe në shumë rajone filloi të hapë mejtepe.

Autori, duke e përdorur shkresën e valiut të Tërhallës, Ismail Rahmi Pasha, i cili politikën e të huajve e konsideronte propagandë të jashtme për manipulimin e shqiptarëve, si shembull e sjell një mëhallë myslimane në Vlorë, ku ishte një kishë pa kambanë. Kjo kishë 400 vjet me radhë ishte e atillë, por për një moment i vendoset kambana, e cila do t'i provokojë myslimanët e mëhallës. Ky qëndrim mund të jetë subjektiv i vetë dorëzuesit të raportit.

Nga referencat që janë përdorur në këtë artikull shihet qartë rreziku i dyanshëm për shqiptarët: njëri ishte nga sllavët dhe grekët, kurse tjetri ishte nga Evropa dhe turqit; këta të dytët i konsideronin turq shqiptarët myslimanë.

Duke iu referuar burimeve të tjera, autori thotë se propaganda italiane dhe austriake, duke dërguar misionarë të ndryshëm, në vendet shqiptare ishte bërë shumë e njohur. Në pjesën gege kishin ardhur misionarë jezuitë, që sipas autorit ua kishin turbulluar mendjen fëmijëve krishterë. Për këtë arsye shteti osman në vitin 1896 dha urdhër që të hapen shkollat idadije. Por, kjo bëhej me shumë vonesë. Në

raportin e asistentit të Ahmet Xhevdet Pashës thuhet se në Shkodër ishin përzënë disa peshkopë, kryemurgj e shumë misionarë të tjerë. Nga një raport tjetër osman shihet edhe më qartë propaganda e shekullit XX, ku Austrisë dhe Rusisë i jepet e drejta të hapë konsullata brenda shtetit osman. Hapja e konsullatave ruse ishte në një mënyrë me lejen shtetit osman për ta kontrolluar Austrinë.

Një rast tjetër me rëndësi është edhe ai që ndodhi në pjesën e toskëve, ku ishin vëzhguesit italianë: njëri nga këta dinte të flasë shqip dhe e provokonte popullatën se çështja e gjuhës shqipe do të rregullohet njësoj si gjuha bullgare. Të gjitha këto propaganda ishin në kundërshtim me politikën e shtetit osman. Vazhdueshmëria e politikës së konsullatave bëri që Abdylhamiti të ndërrojë disa ambasadorë ose administratorë që bashkëpunonin me ambasadorët.

Në vitin 1890, në një telegram të Hurshid Pashës nga Gorrica, raportohet për misionin e priftërinjve protestantë nëpër shkolla, të cilët ua lexonin fëmijëve Ungjillin në gjuhën shqipe. Sipas tyre, qëllimi ishte që ta zhvillojnë gjuhën shqipe, por pas kësaj fshihej propaganda për kthimin e fëmijëve në fenë e tyre. Hurshid Pasha e informoi valiun e Manastirit, por për këtë dukuri vali u heshtur plotësisht. Se për çfarë arsye vali u heshtte, mund të shpjegohet vetëm me interesin e shtetit osman.

Propaganda tjetër, që e paraqet autori në bazë të literaturës turke, është Napoloni III i Francës, i cili ia dha titullin e Princit mirditasit Bibë Doda, i cili më pas filloi ta proklamojë vetën si pasardhës i Skënderbeut. Kjo propagandë ishte në dëm të turqve. Autori përmend manovrimin politik të italianëve dhe austriakëve, që nxitnin popullatën kundër Portës. Autori sjell shembullin e rrugës postare, që shfrytëzonin shteti osman dhe Austria. Kështu, në vitin 1912 postieri osman arrestohet dhe vritet nga malësorët, kurse postieri austriak nuk pengohet fare.

Në një raport të Ahmed Xhevdet Pashës potencohet tentativa e jashtme për shpërbërjen e shqiptarëve. Megjithatë, shqiptarët nuk u ndanë ashtu siç dëshironin ata. Në një raport të vitit 1899 nënkuptohet se shqiptarët të gjithë njëzëri ishin betuar se nuk do të bëjnë gjakmarrje dhe se do të pajtohen mes vete dhe se nuk do të mbajnë armë e nuk do të bëjnë grabitje – ashtu ishin betuar para Padishahut.

Reformat që do të bëhen me marrëveshjen e Berlinit ishin në dëm të shtetit osman. Me këtë Evropës i hapej rruga për një ndërhyrje më të lehtë. Shembull i tillë është ai i Bullgarisë, që kërkonte një autonomi edhe në Rumelinë Lindore, në një tokë me emrin Maqedoni.

Një gjë mjaft me rëndësi që e paraqet autori në vitin 1879 ishte që disa toka shqiptare të banuara me shqiptarë myslimanë t'u jepeshin Greqisë dhe Bullgarisë. Kështu numri i myslimanëve në këto zona do të mbetej pakicë dhe identiteti shqiptar gradualisht do të shpërbëhej. Këtu mendojë se shqetësimin që paraqet autori është ilustrimi, se nëse bëhej numërimi, shqiptarët myslimanë do të ishin pakicë. Nga kjo shihet qartë se shteti osman ishte i vetëdijshëm për dëmtimin e shqiptarëve, por nuk kishte zgjidhje tjetër. E vetmja zgjidhje që mendohej ishte bashkimi i tokave shqiptare në statusin e vilajetit, ku do të udhëhiqte një vali me lejen e sulltanit. Në këtë formë vendi do të ishte i sigurt dhe do të vendosej një barrierë ndaj ambicieve të evropianëve. Në një referencë që e përdor autori shihet

se shteti osman nuk e përdorte emrin Maqedoni, por tri vilajetet (Manastiri, Selaniku dhe Kosova).

Por shumë shqiptarë nuk ishin të kënaqur me reformat që i ndërmori Abdylhamiti. Mospajtimi ishte në financa, në drejtësi dhe në arsim. Edhe pse autori mendon se kishte një grup shqiptarësh që dëshironin të jetojnë në tollovi, ku nuk funksionon ligji dhe shfrytëzonin situatën, madje ai përmend se shteti ishte në dijeni se ekzistonin çeta shqiptare që merren me vjedhje dhe tradhti dhe për t'u eliminuar këto çeta – sipas tij – duhej të krijohet një komision me pagesë mujore. Kundër kësaj iniciative dolën malësorët, të cilët nuk dëshironin që këto çeta të eliminohen. Siç duket nga kjo paraqitje, se një grup shqiptarësh, përveç që ishte kundër shtetit, ishin edhe kundër ligjit dhe dëshironin të jetojnë në kaos të plotë, thotë autori.

Për sa u përket reformave në Shqipëri, valiu i Kosovës, Hifzi Pasha, ishte i mendimit që të tubohet i gjithë armatimi ilegal, ndërsa valiu i Manastirit, Abdylkerim Pasha, nuk mendonte kështu – shqiptarët kufizoheshin me Malin e Zi dhe vazhdimisht kishte probleme, andaj në këtë zonë nuk duhej të tubohej armatimi, thotë ai. Nga këto memorandume, siç potencon edhe autori, nënkuptohet se problemi qëndronte tek siguria. Aty nuk diskutohet çështja e nacionalizmit dhe në çfarë mase kishte arritur ai. Në bazë të raporteve të Dervish dhe Shemsi Pashës, shoqëria islame nuk ishte e ndihmuar nga shqiptarët. Sipas tyre çështja shqiptare zgjidhet me favorizimin e faktorit fetar shqiptar, me atë që identiteti i tyre të jetë shqiptar mysliman. Kemi për këtë shembullin e Abdylhamitit me shpërbërjen e Lidhjes së Prizrenit, ku qëllimi i tij ishte që në këto treva ta forcojë fenë islame. Mendim i tij ishte që në vend të bektashinjve të sjellë shehlerë nakshibendinjë.

Sipas politikës së Abdylhamitit, për të qenë identiteti shqiptar aktiv, duhej që faktori fe – në masë shtetërore – të jetë kushti kryesor. Sipas Sulejman Kylçes, regresi i shqiptarëve qëndron te paaftësia e udhëheqësve osmanë. Ai sjell shembullin e valiut të Kosovës, Shemsi Pashës, i cili ishte pa kurrfarë arsimi. Kështu Shemsi Pasha nuk ishte ndonjë largpamës, nuk ishte i shkolluar dhe nuk i kuptonte fare ambiciet e të huajve.

Sulltan Abdylhamiti, edhe pse mori hapa për përmirësimin e gjendjes, prapëseprapë disa toka shqiptare që gravitonin në shtetin osman do t'i jepeshin Serbisë dhe Malit të Zi.

Pas vitit 1908 shteti osman ndoqi tri lloje politikash në lidhje me çështjen shqiptare: e para ishte periudha e pazarllëqeve; e dyta në funksion të ligjit “bashkimi i shqiptarëve me shtetin osman”, dhe e treta mbajtja e trojeve shqiptare përmes armës.

Por, kjo dha sinjale se shteti osman një ditë do ta humbë Rumelinë dhe njëkohësisht nacionalizmi shqiptar do të marrë hov edhe më shumë. Autori përmend periudhën 1908–1912 ose zhvillimin e nacionalizmit shqiptar, që përfundon me pavarësinë e Shqipërisë.

Murtezan IDRIZI

KRONIKA SHKENCORE

**DY KONFERENCA SHKENCORE: PËR PROF. SHABAN
DEMIRAJN NË ITSHKSH DHE PËR DREJTSHKRIMIN NË
TIRANË**

Fundi i vitit 2014 në fushën e gjuhësisë u shënua me dy tubime, njëri në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, më 19 nëntor, dhe tjetri në Tiranë më 9 dhjetor, i pari në nderim të jetës dhe veprës së akademikut Shaban Demiraj, kurse i dyti për diskutimin e reformës drejtshkrimore të propozuar nga Këshilli Ndërakademik i Gjuhës Shqipe. Tubimi i parë, në të cilin morën pjesë gjuhëtarë nga të tri njësitë shtetërore (Kosova, Shqipëria e Maqedonia), u lajmërua që në muajin shtator, duke u lënë të ftuarve kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur. Në të, kumtuesit vunë në dukje ndihmesat shkencore 60-vjeçare të akad. Shaban Demiraj në fushën e gramatikës së sotme e historike, në kualifikimin shkencor të pedagogëve të rinj të katedrës, të cilët i udhëhoqi vetë, si dhe në përgatitjen gjatë një gjysmë shekulli që u mor me mësimdhënie të mijëra mësuesve të gjuhës shqipe. Ky tubim u karakterizua nga fryma e mirënjohjes dhe e nderimit të thellë të ish-studentëve për profesorin e tyre, frymë që ka karakterizuar marrëdhëniet midis brezave të gjuhëtarëve dhe që përbën një model etik të admirueshëm, pa të cilin nuk mund të ketë përparim në asnjë fushë të shkencës. Tubimi i dytë, ndryshe nga i pari, i shpallur si “Konferencë shkencore ndërkombëtare” me temë “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe dhe diskutimet e sotme mbi të”, u njoftua në fillim të nëntorit, duke u lënë të ftuarve vetëm një muaj kohë për të përgatitur kumtimet e tyre. Sikundër thuhet në ftesë, me këtë tubim, departamenti i gjuhës shqipe i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë “synon nisjen e diskutimeve shkencore sa më konkrete, në lidhje me këto propozime.” Nga kjo “konferencë”, e kushdisata e mbajtur këta 24 vjet për drejtshkrimin, në të cilën “do të shqyrtohen propozimet e Këshillit Ndërakademik”, u ftuan “profesorë e kolegë që nuk janë pjesë e këtij institucioni”. Pra, janë “përfshirë” anëtarët e Këshillit Ndërakademik, që, në të vërtetë, janë frymëzuesit e saj, “duke qenë se ata janë shprehur nëpërmjet këtyre propozimeve”. Veç këtyre, organizuesit e kësaj konference, jo pa qëllim, nuk ftuan autorët e doracakut të drejtshkrimit, të cilëve nuk mund t'u tjetërsohet e drejta e autorit; nuk janë ftuar as pjesëmarrësit e Kongresit të Drejtshkrimit; nuk u ftuan për të shprehur objeksionet e tyre as gjuhëtarët që janë kundërshtarë të hapur të projektit ndërakademik. Nga pikëpamja e etikës, ky tubim i Tiranës është e kundërta e tubimit të ITSHKSH të Shkupit, duke dëshmuar një mungesë respekti për gjuhëtarët me ndihmesa në fushat që do të jenë objekt diskutimi. Në shkencë, si dhe në çdo mjeshtëri tjetër, nuk mund të ketë progres duke shpërfillur më të vjetrit; të rinjtë përgatiten e bëjnë përpara duke njohur mirë veprën e brezave para tyre dhe nën kujdesin e më të vjetërve. Shpërfillja e autoriteteve shkencore është një model etik i ri, i panjohur më parë, i zbatuar nga ata që i kanë ngjitur majat e karrierës akademike me shpejtësi marramendëse dhe pa derdhur djersë. Kjo sjellje është një model etike që nuk duhet ndjekur. Nuk ka në shkencë ndarje në studiues të punësuar dhe studiues

të pensionuar. Nxjerrja në pension nuk do të thotë fund i veprimtarisë shkencore të të pensionuarve dhe vetëm në Shqipëri u mbyllen këtyre dyert e institucioneve ose trajtohen sipas përkatësisë partiake. Mjafton të kujtojmë se akademikët Shaban Demiraj, Kristo Frashëri dhe shumë të tjerë gjysmën e veprave të tyre shkencore i kanë shkruar pas daljes në pension.

Nga pikëpamja e organizimit, ky tubim është një kopje e konferencës famëkeqe të Durrësit, e cila u karakterizua nga fryma përjashtuese, që atëherë u kritikua publikisht edhe nga dekani Rrokaj, tashmë organizues i tubimit të Tiranës. Kjo frymë përjashtuese e kësaj “konference” është vijim i së njëjtës frymë që karakterizoi edhe veprimtarinë e Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës, i cili largoi ose bëri të largoheshin prej tij zërat kundërshtues, duke u kthyer në një klan krahinor. Këtë e vërteton programi i “konferencës”, ku, nga lista e kumtuesve, shihet se nuk është një tubim ndërkombëtar, madje as kombëtar, po një tubim ku përfaqësohen vetëm 4 universitete të Shqipërisë dhe Instituti i Gjuhësisë, disa syresh pjesërisht. Në të vërtetë, ky tubim bëhet “për t’i dhënë një dorë Këshillit”, puna e të cilit u frenua për shkak të reagimit publik ndaj propozimeve të tij. Bashkëkryetarët dhe anëtarët më në zë të këtij Këshilli janë shprehur më se një herë se akademitë do të gjejnë mënyrën se si do të legalizohen propozimet e tij dhe si të merren “vendime përfundimtare që i imponohen popullit” (R. Ismajli). Pra, ky tubim bëhet për të vënë në zbatim strategjinë e Këshillit Ndërkademiq për t’i hedhur në diskutim propozimet e tij. Fakti që nismën për diskutimin e propozimeve të tij e ndërmerr një departament që ka në gjirin e tij një anëtar të Këshillit dhe dy anëtarë të grupit të drejtshkrimit, flet qartë për atë që departamenti i gjuhës shqipe i UT, në të cilin punuan gjuhëtarët që kodifikuan normat e gjuhës standarde, ka humbur identitetin e vet, duke u katandisur në një mashë të Këshillit Ndërkademiq. Në ftesë thuhet shkoqur se “konferenca synon nisjen e diskutimeve shkencore sa më konkrete, në lidhje me këto propozime”, d.m.th. tërheqjen e gjuhëtarëve në diskutime të pafund e të pafryt për gjëra që janë thënë e stërthënë, diskutime që do të kenë si rrjedhim bjerrjen e mëtejshme të prestigjit të gjuhës standarde. Duke mos dyshuar në qëllimin e mirë të masës së kumtuesve në këtë tubim, dalja e departamenteve të gjuhës shqipe si nismëtarë të diskutimeve për normat përbën një largim të tyre nga detyra themelore e shkollës, që është puna për zotërimin e normave të gjuhës standarde. Sepse nuk është faji i rregullave të drejtshkrimit dhe të gramatikës që në ftesën e nisur elektronikisht ka gabime drejtshkrimi e pikësimi, por mungesa e respektit për normat e gjuhës, që manifestohet edhe në një dokument zyrtar. Pikërisht, ajo që mungon sot është respekti për normat e gjuhës edhe nga ata që duhet t’i zbatojnë vetë me rigorozitet dhe t’ua kërkojnë edhe të tjerëve. Një diskutim për to në një fakultet ku përgatiten mësues të gjuhës shqipe, ndikon negativisht te studentët, të cilët, duke dëgjuar se bëhet fjalë për ndryshimin e normave, bjerrin kujdesin për përvetësimin dhe zbatimin e tyre, duke arsyetuar pse të lodhemi duke mësuar rregulla që do të ndryshojnë, le të presim sa të dalin rregullat e reja. Më anë tjetër, marrja në masë e studiuesve të gjuhës me çështjet e normës, sidomos të drejtshkrimit, përbën edhe një largim nga objekti i vërtetë i kërkimit të tyre shkencor, sepse drejtshkrimi përbën një aneks të gjuhësisë, kodet normative janë nënprodukt i studimit përshkrues e historik të rrafshëve të ndryshme

të gjuhës. Një konferencë shkencore në fund të vitit do të duhej të ishte një tubim ku të paraqiteshin rezultatet e kërkimit shkencor në fushat e fonetikës, të morfologjisë, sintaksës, leksikologjisë, semantikës etj. Është e pamundur që gjithë kumtuesit në këtë “konferencë” të jenë marrë tërë vitin me drejtshkrimin. Po të jetë kështu, atëherë kjo do të thotë se në Shqipëri gjuhësia ka marrë fund. Po edhe nëse janë marrë vetëm një muaj me hartimin e kumtesës, kjo do të thotë se do të përsëritin gjëra që i kanë thënë ata vetë ose të tjerë para tyre. As kjo nuk mund të jetë punë shkencore.

Organizuesve të kësaj “konference” do t’u kujtonim porosinë e Faik Konicës se për shqiptarët çështjet e gjuhës “nuk janë thjesht çështje filologjike, po çështje kombëtare”. Çështje kombëtare do të thotë që problemet e drejtshkrimit nuk mund të zgjidhen me imponim akademik, duke përjashtuar faktorët relevantë; rruga e përjashtimit sjell përçarjen e bashkësisë së gjuhëtarëve shqiptarë, që, siç është vënë në dukje, mund të çojë në përçarje kulturore e kombëtare. Autori i këtij shkrimi jo njëherë ka vënë në dukje se ç’rrugë duhet ndjekur për të zgjidhur problemet që kanë lindur. Qysh para konferencës së Durrësit, u kemi vënë mbi tryezë dekanit të atij Fakulteti dhe përgjegjëses së departamentit të gjuhës projektin për një konferencë mbarëkombëtare të profesorëve dhe profesorëve të asociuar që merren me gjuhën shqipe, e cila të kalonte në sitë të gjitha propozimet dhe me konsensus të gjerë të miratonte ndryshimet në normat e gjuhës. Këtë mendim, që e kemi nyjëtuar në shkrime e intervista, e shohim si të vetmen mënyrë për ta shpëtuar gjuhën nga ndërhyrje të gabuara dhe gjuhësinë shqiptare nga ngërthimi 20-vjeçar të drejtshkrimit.

Pra, për çështjen e gjuhës, sikundër porosit Konica, duhet të mendojmë dhe të veprojmë kombëtarisht, jo duke u nisur nga interesa të ngushtë klanesh apo individësh, të cilët me nisma të tilla synojnë të fitojnë pikë për të ngjitur edhe shkallën e fundit që i çon në majë të hierarkisë akademike.

Prof. dr. Rami MEMUSHAJ

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

STUDIME ALBANOLOGJIKE

10

2014

Kopertina
Imer Bajrami

Përpunimi kompjuterik
Besnik Emini

Shtypjen e këtij numri të revistës e mbështeti Komuna e Çairit